



MANUAL

PËR HETIMIN DISIPLINOR NDAJ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I GJYQËSISE



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

DEUTSCHE STIFTUNG FÜR
INTERNATIONALE RECHTLICHE
ZUSAMMENARBEIT E.V.



Projekt i zbatuar nga:



Consiglio
Superiore
della Magistratura

MANUAL

PËR HETIMIN DISIPLINOR NDAJ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Maj, 2021

“Asgjë nuk është e mundur pa njerëzit, asgjë nuk zgjat pa institucionet”

Zhan Mone (1888 – 1979)

Design & Layout: Adelajda Alla

Shtypur në shtypshkronjën MORAVA

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Opinionet e shprehura në këtë Manual janë opinione të ekspertëve të Misionit EURALIUS, mbështetur në praktikat më të mira të Shteteve Anëtare të BE-së/acquis së BE-së/të drejtës europiane dhe ndërkombëtare/praktikës gjyqësore të GJEDNJ/ose standardeve të tjera referuese, dhe janë diskutuar dhe dakordësuar me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, këndvështrimet e të cilit – të mbështetura në urdhrin e brendshëm ligjor – janë reflektuar. Manuali nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë si pararendës i vendimmarrjes së pavarur dhe autonome të autoriteteve shqiptare.

Publikimi ka vetëm qëllime informimi. Ai nuk parashikon asnjë të drejtë dhe nuk ushtron asnjë detyrim ndryshe nga ato të parashikuara apo të ushtruara nga legjislacioni i miratuar dhe i publikuar zyrtarisht në gjuhën shqipe. EURALIUS nuk ofron asnjë garanci në lidhje me saktësinë dhe heq dorë nga përgjegjësitë për përdorimet që mund të bëhen mbështetur në opinionet e shprehura në të.

EURALIUS
Ministria e Drejtësisë
Blvd Zogu I-rë
Tiranë
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@ild.al
Web: ild.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie.....	7
Tabela e Shkurtimeve.....	9
Tablela e Përkufizimeve	9
Hyrja e Manualit	11
KAPITULLI I	
Pasqyrë përmbledhëse.....	13
KAPITULLI II	
Standardet ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve	19
2.1. Hyrje	19
2.2. Standardet ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të magistratëve	20
2.3. Zbatimi i parimeve të përgjegjësisë disiplinore sipas përcaktimeve të Komentarit të Parimeve të Bangalores.....	28
2.4. Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magistratëve	36
2.5. Standardet Minimale në Proçedimet Disiplinore.....	49
2.6. Opinionet e Komisionit të Venecias, të kërkuara nga autoritetet shqiptare në kuadër të reformës në drejtësi	52
KAPITULLI III	
Analiza dhe vlerësimi i kudarit ligjor të sistemit të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.....	59
3.1. Hyrje.....	59
3.2. Risitë e sistemit disiplinor.....	59
3.3. Ndryshimet si pasojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese	63
3.4. Parimet e hetimit disiplinor	81
3.5. Kompetencat hetimore të ILD-së dhe fazat e hetimit disiplinor	95
3.6. Shkeljet dhe masat disiplinore	105
KAPITULLI IV	
Komentari i neneve 118 - 137 të ligjit për statusin	109
4.1. Hyrje.....	109
4.2. Komentari	109

Hyrje

Kapitulli I
Përmbledhje

Kapitulli II
Standardet ndërkombëtare

Kapitulli III
Analiza

Kapitulli IV
Komentari

KAPITULLI V	
Formularët standard.....	219
SF 1 Formulari i Ankesës	221
SF 2 Udhëzime për plotësimin e ankesës	225
SF 3 Konfirmimi i marrjes së ankesës.....	227
SF 4 Lista e kriterëve të pranimit	229
SF 5 Projekt vendim për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar	235
SF 6 Vendimi i ILD për kthimin e projektvendimit për arkivimin pas shqyrtimit fillestar.....	237
SF 7 Vendimi i ILD për ndryshimin e projektvendimit për arkivimin pas shqyrtimit fillestar.....	239
SF 8 Vendim i ILD për arkivimin pas shqyrtimit fillestar	241
SF 9 Njoftim i magjistratit për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar	243
SF 10 Njoftim i ankuesit për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar	245
SF 11 Projekt vendim për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar	247
SF 12 Vendimi i ILD për kthimin e projektvendimit për verifikimin pas shqyrtimit fillestar.....	249
SF 13 Vendimi i ILD për ndryshimin e projektvendimit për verifikimin pas shqyrtimit fillestar.....	251
SF 14 Vendim i ILD për verifikimin pas shqyrtimit fillestar.....	253
SF 15 Kërkesa për marrje dokumentacioni në kuadër të verifikimit të ankesës	255
SF 16 Vendim i ILD për arkivimin e ankesës pas verifikimit	257
SF 17 Njoftim i ankuesit për arkivimin e ankesës pas verifikimit	259
SF 18 Njoftim i magjistratit për arkivimin e ankesës pas verifikimit	261
SF 19 Projekt vendim për fillimin e hetimit disiplinor bazuar në ankesë.....	263
SF 20 Vendim për kthimin e projekt vendimit për fillimin e hetimit disiplinor bazuar në ankesë	267
SF 21 Vendim për ndryshimin e projekt vendimit për fillimin e hetimit disiplinor bazuar në ankesë.....	269
SF 22 Vendim i ILD për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit	271
SF 23 Njoftim i ankuesit për fillimin e hetimit disiplinor me nismën e ankuesit.....	275
SF 24 Njoftim magjistratit për fillimin e hetimit disiplinor me nismën e ankuesit.....	277
SF 25 Njoftim i këshillit për fillimin e hetimit disiplinor me nismën e ankuesit	279

SF 26 Akti i njoftimit të të drejtave	281
SF 27 Projekt vendim për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë.....	283
SF 28 Vendim për kthimin e projekt vendimit per fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë.....	287
SF 29 Vendim për ndryshimin e projekt vendimit për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë.....	289
SF 30 Vendim ILD për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë.....	291
SF 31 Njoftim për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë	295
SF 32 Njoftim i këshillit për vendimin e fillimit të hetimit disiplinor me iniciativë	297
SF 33 Akti i njoftimit të të drejtave	299
SF 34 Relacion për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor	301
SF 35 Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor	305
SF 36 Njoftim për zgjatjen e afatit të hetimit ankuesit.....	307
SF 37 Njoftim për zgjatjen e afatit të hetimit magjistratit.....	309
SF 38 Njoftim për zgjatjen e afatit të hetimit këshillave	311
SF 39 Relacion për riçeljen e hetimit disiplinor	313
SF 40 Vendim për riçeljen e hetimit disiplinor.....	315
SF 41 Njoftim për riçeljen e hetimit ankuesit	317
SF 42 Njoftim për riçeljen e afatit të hetimit magjistratit.....	319
SF 43 Njoftim për riçeljen e hetimit këshillave	321
SF 44 Relacion për shtimin e objektit te hetimit disiplinor	323
SF 45 Vendim për shtimin e objektit te hetimit disiplinor	325
SF 46 Raport për ndryshimin e hetimit disiplinor	327
SF 47 Vendim për ndryshimin e objektit te hetimit disiplinor	329
SF 48 Njoftim për ndryshimin/shtimin e objektit të hetimit disiplinor magjistratit	331
SF 49 Njoftim per ndryshimin/shtimin e objektit te hetimit disiplinor ankuesit ...	333
SF 50 Relacion për pezullimin e hetimit disiplinor.....	335
SF 51 Vendim për pezullimin e hetimit disiplinor	337
SF 52 Njoftim i ankuesit për pezullimin e hetimit disiplinor	339
SF 53 Njoftimi i magjistratit për pezullimin e hetimit disiplinor.....	341
SF 54 Njoftimi i këshillave per pezullimin e hetimit disiplinor	343

SF 55 Njoftim i kryetarit të gjykatës apo drejtuesit të prokurorisë për pezullimin e hetimit disiplinor	345
SF 56 Kërkesë për informacion.....	347
SF 57 Kujtesë për përcjellje informacioni.....	349
SF 58 Njoftim subjektiv për vënie gjobe	351
SF 59 Njoftim shërbimit përmbartimor për urdhrin e gjobës	353
SF 60 Njoftim për marrjen në pyetje.....	355
SF 61 Procesverbal për veprimin hetimor	357
SF 62 Procesverbal marrjes në pyetje	359
SF 63 Kërkesë për mbledhjen e provave	361
SF 64 Urdhër për vendosjen e gjobës	363
SF 65 Njoftim i seancës së marrjes në pyetje	365
SF 66 Raporti i Hetimit	367
SF 67 Vendim miratimi të raportit hetimit disiplinor	371
SF 68 Vendim për ndryshimin e raportit të hetimit	373
SF 69 Njoftim vendimi për mbylljen e hetimit disiplinor	375
SF 70 Marrëveshja e përbashkët e pranimit	377
SHTOJCAT	379
Shtojca 1	
Ekstrakt i dispozitave kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme për kompetencat disiplinore të ILD.....	381
Shtojca 2	
Vendimet e Gjykatës Kushtetuese	413
A. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 41 datë 16.05.2017	413
B. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 34 datë 10.04.2017	433
Shtojca 3	
Vendimi i KLGJ-së Nr. 316 datë 14.09.2020 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”	491
Shtojca 4	
Vendimi i KLP-së Nr. 260 datë 17.11.2020 “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”	519

PARATHËNIE

Reforma në Drejtësi është një nga zhvillimet më të rëndësishme, që ka ndodhur në vendin tonë në 30 vitet e fundit, me fokus një sistem drejtësie tërësisht të ri, me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, parimin e sigurisë juridike, si dhe forcimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë.

Me pritshmëri të larta publike, reforma në drejtësi, ishte një proces i jashtëzakonshëm, gjithëpërfshirës, në të cilin u kombinua ekspertiza më e mirë vendase dhe e huaj me standardet më të larta ndërkombëtare të fushës, me mbështetje të qartë nga partnerët strategjikë SHBA e BE, si dhe konsensusin absolut politik, që u materializua me një votim unanim në Kuvend në korrik të vitit 2016.

Pavarësia e sistemit të drejtësisë, si një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës është e domosdoshme për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, rritjen e përgjegjshmërisë së magistratëve, paanësinë e tyre në vendimmarrje. Nga ana tjetër, pavarësia nuk duhet parë si një qëllim në vetvete, e për këtë arsye, ajo duhet të shoqërohet me mjete dhe mekanizmat përkatës të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të siguruar që sistemi gjyqësor dhe ai i prokurorisë, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike.

Prandaj hetimi disiplinor i magistratëve, si një mekanizëm për të siguruar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, duhet të realizohet në mënyrë të tillë, që të garantojë balancën e duhur mes parimit të pavarësisë të sistemit të drejtësisë, nga njëra anë dhe parimeve të interesit publik në administrimin e drejtësisë, nga ana tjetër, bashkë me respektimin e të drejtave të individëve, për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Vetë kadri i ri ligjor rregullator, i miratuar si pjesë e reformës në drejtësi e në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, sanksionon se hetimi disiplinor ndaj magistratëve do të udhëhiqet nga parimet e procesit të rregullt ligjor, ligjshmërisë, barazisë para ligjit, prezumimit

të pafajësisë dhe vlerësimit të dyshimit, proporcionalitetit, pavarësisë e paanësisë së institucioneve disiplinore, drejtësisë së hapur, dhe konfidencialitetit e mbrojtjes së jetës private, duke garantuar integritetin dhe figurën e magjistratit dhe mirëadministrimin e drejtësisë.

Pikërisht nën dritën e këtyre këtyre parimeve është konceptuar edhe manuali i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Manuali i hartuar me asistencën dhe ekspertizën e ekspertëve ndërkombëtare dhe vendas të Misionit EURALIUS V, përmban një analizë dhe vlerësim të:

- Standardeve më të mira ndërkombëtare të sistemit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë këtu edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Kuadrit të ri ligjor në lidhje me sistemin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri;
- Komente për disa nga dispozitat më të rëndësishme ligjore të Kreut II “Procedurat hetimore” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (nenet 118-137);
- Formularë standard që trajtojnë në aspektin praktik të gjithë procesin e hetimit disiplinor duke filluar nga regjistrimi i ankesës ndaj magjistratëve deri në fillimin e procedimit disiplinor përpara Këshillit përkatës.

Duke përgëzuar autorët për përgatitjen e këtij dokumenti, dua të vë në dukje se analiza, komentet dhe veçanërisht modelet e formularëve standard, kanë një natyrë rekomanduese dhe nuk janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga personat përgjegjës për hetimet disiplinore. Gjithashtu ky manual duhet të konsiderohet si një dokument evolues, i cili do t’i nënshtrohet ndryshimeve në përputhje me praktikën e standardizuar të punës apo dhe amendimeve ligjore.

Jam besimplotë se ky manual, do t’i shërbejë punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorëve në përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke synuar garantimin e një qasjeje të njëjtë dhe uniforme, në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja ligjore, për të mundësuar funksionimin e një sistemi hetimi disiplinor, i cili të garantojë jo vetëm përgjegjshmërinë e magjistratëve, por mbi të gjitha të mundësojë rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Z. Artur Metani (Inspektori i Lartë i Drejtësisë)

Tablela e Shkurtimeve

GjK	Gjykata Kushtetuese
KP	Kodi Penal
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjEDNJ / Gjykata	Gjykata Evropiane për të Drejta te Njeriut
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
FS	Formatet Standarde
KPA	Kodi i Proçedurave Administrative
KE	Këshilli i Europës
KKGJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë
KKPE	Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Europianë
RREKGJ	Rrjetit Evropian i Këshillave për Gjyqësorin
MD	Ministria e Drejtësisë

Tablela e Përkufizimeve

VGjK Nr. 34	Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 34, datë 08.03.2017
VGjK Nr. 41	Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 41, datë 28.03.2017
Ligji për Statusin dhe ose Ligji nr. 96/2016	Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ligji Nr. 115/2016	Ligji Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes në Sistemin e Drejtësisë”, i ndryshuar
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar
Këshillat	Termi Këshill i Referohet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë
Parimet e Bangalores	Kodi i Bangalores mbi Sjelljen e Gjyqësorit i vitit 2001, i miratuar nga Grupi Gjyqësor mbi Fuqizimin e Integritetit të Gjyqësorit, dhe i rishikuar në Takimin e Drejtuesve, i mbajtur në Hagë, më 25-26 Nëntor 2002, është një dokument i Zyres për Drogat dhe Krimet të Kombeve të Bashkuara

Masat Zbatuese të Primeve të Bangalores	Masat për Zbatimin Efektiv të Parimeve të Bangalores për Sjelljen në Gjyqësor, të miratuara nga Grupi i Punës për Integritetin në Gjyqësor, Lusaka, Zambia, 21 dhe 22 Janar 2010
Karta Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve	Karta Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve dhe Memorandumi Shpjegues, Këshilli i Europës, Strasburg 8-10 Korrik 1998
Opinionet e Komisionit të Venecias	Opinionet e dhëna nga Komisioni i Venecias në kuadër të Reformës në Drejtësi
Opinion i Ndërmjetëm	Opinion i Komisionit të Venecias Nr. 824 / 2015 (CDL-AD(2015)045), mbi draft amendimet Kushtetuese në gjyqësor në Shqipëri, i miratuar në Mbledhjen Plenare të 105-të (Venecia 18-19 Dhejtor 2015)
Opinion Përfundimtar	Opinion i Komisionit të Venecias Nr. 824 / 2015 (CDL-AD(2016)009-e), mbi draftin e rishikuar të amendimeve mbi gjyqësorin (15 Janar 2016) në Shqipëri, e miratuar në mbledhjen plenare të 106-të të tij (Venecia, 11-12 Mars 2016)“

HYRJA E MANUALIT

“Manuali mbi hetimet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve” është hartuar në vitin 2021 në kundër të projektit të financuar nga Bashkimi European EURALIUS V *“Konsolidimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri”* nga një grup ekspertësh të EURALIUS V dhe ekspertët ligjorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Hartimi i Manualit konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për këtë institucion të themeluar rishtazi. Zyra e ILD-së u krijua më 1 Shkurt 2019, atëherë kur, nga Kuvendi i Shqipërisë, u zgjodh Kryeinspektori dhe më pas edhe anëtarët e tjerë, inspektorët, ndihmësit ligjorë, këshilltarët ligjorë dhe personeli administrativ.

Manuali përmban analiza ligjore, komente dhe formate standarde, të bazuara në legjislacionin e ri të sistemit të drejtësisë, , në mënyrë të veçantë në legjislacionin që lidhet me hetimet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 22 Korrik 2016 Ligji Nr.96/2016 *“Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (i cili ka hyrë në fuqi në Nëntor 2016) dhe Ligji Nr. 115/2016 “Mbi Organet e Qeverisjes në Sistemin e drejtësisë”, i miratuar më 3 Nëntor 2016.*

Vlen të theksohet se legjislacioni i ri në Shqipëri mbi sistemin e hetimeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë edhe themelimin e një institucioni krejtësisht të ri me kompetenca ekskluzive për hetimin disiplinor, përbën një risi e cila mund të konsiderohet se është rregulluar nga Kushtetuta dhe ligjet në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira Europiane.

Ky Manual synon të ndihmojë në interpretimin dhe zbatimin kuadrin të ri ligjor, sa i përket sistemit disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri. Ai përmban komentare mbi disa nga nenet e Ligjit për Statusin, referuar hetimit disiplinor të shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët. Gjithashtu, ai përmban formatet standarde të hartuara së fundmi, në përputhje me dispozitat e reja ligjore. Komentet dhe formatet standarde do të lehtësojnë kryesisht zbatimin e Pjesës V *“Përgjegjësia*

Disiplinore, Civile dhe Penale”, Kapitullit I “Dispozita të Përgjithshme” dhe Kapitulli II “Procedurat Hetimore” (Ligji për Statusin, Neni 100-Neni 137). Të dy grupet e materialeve kanë për qëllim të lehtësojnë inspektorët dhe ndihëmesit ligjorë të ngarkuar me hetimin disiplinor të magjistratëve.

Para hartimit të këtij Manuali, Ligji Nr. 96216 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes në Sistemin e Drejtësisë” janë ankimuar dy herë në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në kërkesën e parë e cila kundërshtonte Ligjin për Statusin, Gjykata Kushtetuese ka marrë Vendimin Nr. 34 datë 10 Mars 2017, duke shfuqizuar disa prej dispozitave që lidheshin me sistemin disiplinor. Amendimet përkatëse të ligjeve u miratuan në vitin 2019 nga Kuvendi.

Të gjitha komentet mbi dispozitat ligjore dhe formatet standarde të përfshira në këtë Manual, janë hartuar duke marrë në konsideratë amendimet ligjore.

Po ashtu, vlen të nënvizohet se të gjitha formatet standarde (70), janë hartuar bazuar mbi kërkesat e neneve të ligjit dhe mbulojnë kryesisht procedurat që duhet të kryhen gjatë procesimit disiplinor. Si rrjedhojë është e nevojshme që kur miratohet legjislacioni i ri, institucionet e reja qeverisëse duhet të mbështeten aktivisht nga projekte dhe programe ndërkombëtare gjatë përpjekjeve të tyre për të hedhur themele të njëjta ose të ngjashme për një zbatim të njëtrajtshëm të pjesëve të legjislacionit.

Është e nevojshme që të ketë një qasje të njëtrajtshme në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja ligjore, duke aplikuar procedura standartstandarde të cilat janë në përputhje me analizat e dispozitave ligjore dhe urdhërrëfyesit mbi interpretimin e tyre. Kjo mund të vlerësohet si një nga zgjidhjet më të sukseshme në procesin e forcimit të kapaciteteve të personave përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të ri.

Gjetjet, përfundimet dhe propozimet, përfshirë edhe formatet nuk kanë një natyrë detyruese për organet dhe personat përgjegjës për hetimet disiplinore. Megjithatë, të gjitha materialet e përfshira në këtë Manual janë hartuar bazuar mbi kuadrin e ri ligjor dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionin e ILD-së dhe si të tilla, të gjitha mund të përdoren në punën e përditshme të ILD-së. Këto dokumenta mund të ndryshohen ose të përshtaten sipas ndryshimeve dhe evolimeve të sistemit ligjor ose sipas kërkesave dhe nevojave insitucionale.

KAPITULLI I

PASQYRË PËRMBLEDHËSE

Qëllimi kryesor i këtij Manuali është që të vendosë në dispozicion të inspektorëve të ILD-së një mjet të dobishëm pune për zbatimin e legjislacionit të rim bi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu Manuali mund të jetë një mjet i dobishëm edhe për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe për komunitetin e jurisprudencës, që mund të shërbejë për të pasuruar njohuritë e tyre mbi risitë e sistemit të përgjegjësive disiplinore të miratuar si pjesë e reformës në drejtësi. Manuali përbëhet nga katër kapituj kryesorë dhe pesë anekse të cilat synojnë të lehtësojnë përdorimin e tij.

Standartet ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Kapitulli II)

Ky kapitull ka për qëllim të sjellë një pamje të përgjithshme të standarteve ndërkombëtare më të rëndësishme në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto standarte janë përpiluar nga një sërë organesh të rëndësishme ndërkombëtare të angazhuara në garantimin e cilësisë së sistemeve të drejtësisë.

Më poshtë jepet një përmbledhje e statuteve, rekomandimeve dhe opinioneve të mbledhura dhe të paraqitura në Kapitullin II të këtij Manuali. Ato janë ndarë sipas institucioneve apo organizatave të cilat kanë hartuar dokumentat e përmendura:

Këshilli i Evropës Rekomandime dhe Statute

- Rekomandimi Nr. R (94) – mbi pavarësinë, eficencën dhe rolin e gjyqtarëve
- Rekomandimi Rec (2000)19 – mbi rolin e prokurorit në sistemin e drejtësisë penale
- Rekomandimi CM/Rec (2010)12 – mbi gjyqtarët: pavarësia, efica dha përgjegjësitë
- Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve

OSCE – ODHIR Rekomandime

- Rekomandimi i Kjevit – mbi pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian Opinione

- Opinioni Nr. 1 (2001) – mbi standartet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe përvokueshmërinë e gjyqtarëve
- Opinioni Nr. 3/2002 – mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe veçanërisht etikën, sjelljen e papërshtatshme dhe paanshmërinë

Parimet e Bangalores

- Masat zbatuese të Parimeve të Bangalores

KEDNJ

Praktika gjyqësore mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve bazuar tek:

- Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt
- Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare
- Neni 10 – Liria e shprehjes
- Neni 1, Protokolle 1 – Mbrojtja e pronës
- Neni 4, Protokolle 7 – E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

Rrejtji Evropian i Këshillave për Gjyqësorin

- Standarte minimale për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të mbledhur dhe paraqitur nga RREKGJ

Opinionet e Komisionit të Venecias për reformën në drejtësi të Shqipërisë

- Opinioni i Ndërmjetëm - mbi draftin e ndryshimeve kushtetuese për gjyqësorin në Shqipëri, Dhjetor 2015
- Opinion Përfundimtar - mbi draftin e rishikuar të ndryshimeve kushtetuese për gjyqësorin, Mars 2016

Analiza dhe vlerësimi i kuadrit ligjor të sistemit të përgjegjësive disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në shqipëri (Kapitulli III)

Ky kapitull përmban një pasqyrë të përgjithshme të sistemit të procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që mban gjithashtu parasysh mënyrën se si ka ndryshuar sistemi pas reformës. Ky kapitull përqëndrohet në aspektin e hetimit disiplinor të ndjekur nga ILD. Më poshtë jepet një përmbledhje e përmbajtjes së Kapitullit II:

Risite e sistemit disiplinor

Kjo pjesë e kapitullit jep një analizë e dispozitave të reja kushtetuese në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të magistratëve, përfshirë analizën e ligjeve të reja të miratuara në zbatim të risive kushtetuese: Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Qeverisjen.

Nryshimet si rrjedhojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Shfuqizime

Gjykata Kushtetuese (Vendimi 34/2017) deklaroi në mospërputhje me kushtetutën dhe si rrjedhojë shfuqizoi nenet e mëposhtme të Ligjit për Statusin:

- Neni 101 mbi shkeljet disiplinore
- Neni 102 mbi shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;
- Neni 103 mbi shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit
- Neni 104 mbi shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale
- Neni 112, paragrafi 1, mbi masat disiplinore plotësuese
- Neni 141 paragrafi 1, fraza “*në masën që nuk çënon*” dhe gërmat “a”, “b” dhe “c” të këtij paragrafi.

Ndryshimet

Ligji Nr. 48/2019, që ka për qëllim ndryshimin e neneve të shfuqizuara në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Përputhshmëria e ndryshimeve

Ndryshimet janë analizuar në funksion të përputhshmërisë së tyre me vendimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe standardeve përkatëse ndërkombëtare.

Parimet e hetimit disiplinor

Neni 100 i Ligjit për Statusin parashikon disa parime të cilat do të udhëheqin procedimet disiplinore të magjistratëve, duke nisur nga faza e hetimit deri në fazën e vendimmarrjes. Kjo pjesë e kapitullit paraqet një analizë të plotë e zbatimit të këtyre parimeve në kuadrin e hetimit disiplinor:

- E drejta për një proces të rregullt
- Ligjshmëria
- Parimi i akuzës
- Parimi i barazisë para ligjit
- Prezumimi i pafajësisë dhe dyshimit në favor të magjistratit
- Parimi i proporcionalitetit
- Parimi i pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit
- Parimi i drejtësisë së hapur
- Parimi i konfidencialitetit, drejta e jetës private, mbrojtja e të dhënave personale dhe balancimi me parimin e informimit të publikut

Kompetencat hetimore të ILD-së dhe fazat e hetimit disiplinor

Kjo pjesë e kapitullit përmban një pasqyrë të përgjithshme të fazës hetimore të procedimeve disiplinore kundër magjistratëve. Ai përmban analizën e mëposhtëme:

- Kompetencat hetimore dhe aktet e ILD-së
- Fazat e hetimit disiplinor
- Shkeljet dhe masat disiplinore

Komentari i neneve 118 - 137 të ligjit për statusin (Kapitulli IV)

Ky kapitull është pjesa kryesore e Manualit. Ai përmban një analizë të hollësishme të neneve përkatëse të Ligjit për Statusin, të cilat janë thelbësore gjatë hetimit të shkeljeve disiplinore të magjistratëve nga ILD. Ky kapitull synon të ofrojë komente mbi çdo aspekt të nenit, në mënyrë që të thjeshtojë zbatimin e këtyre dispozitave gjatë punës së përditshme të inspektorëve të ILD-së.

Struktura e komentarit

Për të patur një strukturë koherente, komentari i çdo neni ndjek strukturën e mëposhtëme:

- Teksti i dispozitës
- Analiza e qëllimit të dispozitës
- Analiza e fushëveprimit të dispozitës
- Komentari i dispozitës
- Dispozitat e lidhura të Ligjit për Statusin apo ligjeve të tjera
- Standardet Ndërkombetare dhe Përputhshmëria

Nenet e komentuara

Kapitulli përmban komentarin e 20 neneve të mëposhtëme:

- Neni 118 - Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- Neni 119 - Ankesat
- Neni 120 - Kriteret për pranueshmërinë e ankesës
- Neni 121 - Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës
- Neni 122 - Verifikimi i ankesës
- Neni 123 - Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit
- Neni 124 - Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- Neni 125 - Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit
- Neni 126 - Pezullimi i hetimeve
- Neni 127 - Kërkesa për pezullimin e magjistratit
- Neni 128 - Bashkimi i procedimeve hetimore
- Neni 129 - Të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve gjatë hetimit
- Neni 130 - Ecuria e hetimeve
- Neni 131 - Kërkesat për marrjen në pyetje
- Neni 132 - Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera
- Neni 133 - Dokumentacioni i hetimit
- Neni 134 - Mbyllja e hetimit
- Neni 135 - Marrëveshje e përbashkët e pranimit
- Neni 136 - Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
- Neni 137 - Sistemi i menaxhimit të çështjeve

Formularët Standard (Kapitulli V)

Ky kapitull përmban 70 formularë standard të cilët janë përpunuar bazuar në dispozitat e Ligjit për Statusin që tregojnë veprime specifike procedurale që duhet të ndërmerren nga ILD gjatë fazës së hetimit. Këto formularë standard do të jenë një mjet thelbësor për punën e përditshme të inspektorëve të ILD-së. Për shkak të numrit të madh të këtyre formularëve, nuk janë listuar edhe këtu. Megjithatë një përmbledhje e fushave kryesore të mbuluara prej tyre jepet më poshtë:

Formularë standard sipas fushës

- Formularë standard për ankesat
- Formularë standard për arkimivin e ankesës
- Formularë standard për njoftime të ndryshme
- Formularë standard me draft vendimet e ILD-së gjatë fazave të ndryshme të hetimeve
- Formularë standard mbi kërkesa
- Formularë standard mbi lloje të ndryshme relacionesh përfshirë raportin e hetimit
- Formularë standard mbi lloje të ndryshme procesverbalesh
- Formular standard mbi urdhrin për vendosjen e gjobës
- Formular standard mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit

Shtojcat

Manuali përmbillet me pesë Shtojcat e mëposhtme të cilat përmenden në pjesë të ndryshme të kapitujve dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Shtojca 1 - Ekstrakt i dispozitave kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme për kompetencat disiplinore të ILD

Kjo shtojcë përmban koleksionin e disa neneve nga Ligji për Qeverisjen dhe Ligji për Statusin të cilat janë të rëndësishme për procedimin disiplinor. Nenet e mbledhura në ankes jepen njëkohësisht në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

Shtojca 2 – Vendimet e Gjykatës Kushtetuese

Kjo shtojcë paraqet dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese që janë të rëndësishme për temën e këtij manuali. Kjo shtojcë është e ndarë në dy nën-shtojca. Shtojca 2.A që përmban Vendimin e GJK nr. 41 datë 16.05.2017 dhe aneksin 2.B i cili përmban Vendimin e GJK nr. 34. datë 10.04.2017.

Shtojca 3 – Rregullorja disiplinore e KLGJ-së

Kjo shtojcë përmban tekstin e Vendimit të KLGJ-së Nr. 316 datë 14.09.2020 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Shtojca 4 – Rregullorja disiplinore e KLP-së

Kjo shtojcë përmban tekstin e Vendimit të KLP-së Nr. 260 datë 17.11.2020 “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”.

KAPITULLI II

STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

2.1. Hyrje

Ky kapitull synon të ofrojë një tablo të përgjithshme të standardeve më të rëndësishme ndërkombëtare në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për këtë qëllim, është parashtruar në pjesën e parë të tij një përmbledhje e dokumentave kryesore që trajtojnë këtë çështje.

Në seksionin 2.2 është parashtruar një përmbledhje e standardeve që rrjedhin nga një numër i madh i institucioneve ndërkombëtare të tilla si Këshilli i Evropës, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë etj. Këto standarde janë paraqitur në formën e një table kronologjike më qëllim që të jetë e mundur për lexuesin të kuptojë sesi janë zhvilluar këto standarde përgjatë viteve.

Për shkak të rëndësisë të Parimeve të Bangalores si përcaktues standartesh në nivelin ndërkombëtar mbi sjelljen e gjyqësorit një seksion i posaçëm i këtij kapitulli i kushtohet këtyre parimeve. .. Konkretisht seksioni 2.3 i këtij kapitulli ilustron parimet thelbësore mbi përgjegjësinë disiplinore që rrjedhin nga Parimet e Bangalores dhe gjithashtu masat e hollësishme për zbatimin e tyre.

Seksioni 2.4 ilustron standardet e krijuara nga GJEDNJ-ja gjatë shqyrtimit të çështjeve të lidhura me procedimet disiplinore të gjyqtarëve. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është gjithashtu e rëndësishme për vendosjen e standardeve për procedimet disiplinore, veçanërisht në termat e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtave të tjera të magjistratëve, subjekt të procedimeve disiplinore. Kështu seksioni 2.4 ofron një tablo të dobishme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, me impakt mbi procedimet disiplinore, bazuar në Nenin 6, 8 dhe 10 të KEDNJ-së dhe Nenin 1 të Protokollit 1 të GJEDNJ-së dhe Nenin 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së.

Bazuar në këto shembuj të standardeve ndërkombëtarë, seksioni 2.5 i këtij kapitulli ofron një përmbledhje të standardeve minimale për përgjegjësinë disiplinore, të cilat janë mbledhur dhe hartuar në vitin 2014-2015 nga Raporti i Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin.

Së fundmi, kapitulli mbyllet me seksionin 2.6, i cili përmban Opinione të Komisionit të Venecias, të hartuara në mënyrë të posaçme për reformën në drejtësi në Shqipëri. Përfshirja e këtyre opinioneve në këtë kapitull konsiderohet e rëndësishme duke marrë parasysh se ato përmbajnë disa udhëzime thelbësore lidhur me standardet që sistemi disiplinor duhet të ndjekë dhe të zbatojë.

2.2. Standardet ndërkombëtare për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve

Përgjegjësia disiplinore e magjistratëve ka qenë subjekt i diskutimeve të gjera, hartimit të akteve dhe rregulloreve në arenën ndërkombëtare. Rrjedhimisht, ka një numër të madh dokumentash ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë parimet, rregullat dhe procedurat e lidhura me aspekte të ndryshme të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në tabelën më poshtë paraqitet një përmbledhje e standardeve ndërkombëtare mbi këtë çështje, të renditura kronologjikisht për të treguar zhvillimet e parimeve dhe procedurave në çështjet disiplinore të magjistratëve.

Tabela 1 – Standardet Ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve

VITI 1994	KE Rekomandimi Nr. R (94) 12 ¹	Dështimi për të pëmbushur kompetencat dhe shkeljet disiplinore: “Kur gjyqtari dështon të kryejë detyrat e tij në mënyrën e duhur dhe efçente ose në rast të një shkeljeje disiplinore, duhet të merren të gjitha masat e duhura, të cilat nuk paragjykojnë pavarësinë e gjyqësorit. Në varësi të parimeve kushtetuese dhe të dispozitave ligjore dhe traditave të çdo shteti, këto masa mund të përfshijnë, për shembull: a. Përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i çështjeve; b. Transferimin e gjyqtarit në punë të tjera brenda gjykatës;
--------------	---	---

¹ Rekomandimi Nr. R (94) 12, Mbi pavarësinë, efçencën, dhe rolin e gjyqtarëve, Komitetit

		<p>c. Penalitete ekonomike, siç janë reduktimi i pagës për një periudhë të përkohshme; d. Pezullimin².</p> <p>Dështimi për të pëmbushur kompetencat dhe shkeljet disiplinore- organet dhe proçedurat</p> <p><i>Në rastet kur duhet të merren masa disiplinore “shtetet duhet të vlerësojnë krijimin, me ligj, të një organi të posaçëm kompetent i cili ka si detyrë vendosjen e masave dhe ndëshkimeve disiplinore, kur ato nuk janë marrë në shqyrtim nga një gjykatë, dhe vendimet e të cilit do të kontrollohen nga një organ më i lartë gjyqësor, ose që është vetë organi më i lartë gjyqësor. Ligji duhet të parashikojë proçedura të përshtatshme për të siguruar që gjyqtarëve në proçes t’u mundësohen të paktën të gjitha garancitë e një proçesi të rregullt ligjor sipas Konvetës, për shembull që çështjaduhet të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm dhe që kanë të drejtën të japin shpjegime për çdo akuzë”³.</i></p>
<p>VITI 1998</p>	<p>Karta Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve</p>	<p>Përgjegjësia – Procedimi Disiplinor dhe sanksioni</p> <p><i>“Shkelja nga një gjyqtar e një rës nga detyrat e përcaktuara në statut, mund të jetë shkak i një masë penalizuese vetëm nëpërmjet një vendimi, një propozimi, rekomandimi ose me miratimin e një gjykate ose autoritet të përbërë nga të paktën gjysma e antarëve gjyqtarë, të zgjedhur në kuadër të një procedure ku palët do të dëgjohen plotësisht, në të cilën gjyqtari në proçedim do të ketë të drejtën të përfaqësohet. Shkalla e sanksionit që mund të vendoset është e përcaktuar në statut dhe aplikimi i tyre i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit. Vendimi i një autoriteti ekzekutiv, një paneli gjyqësor, ose i një autoriteti që ka të drejtë të vendosë masa ndëshkuese, siç janë përcaktuar këtu, është objekt rishikimi nga një autoritet gjyqësor më i lartë”⁴.</i></p> <p>Përgjegjësia – Ankesa dhe organi kompetent</p> <p><i>“Çdo person duhet të ketë mundësinë të paraqesë në një organ të pavarur, pa respektuar ndonjë formalitet specifik, një ankesë lidhur me mosdhënien e drejtësisë në një rast të caktuar. Ky organ ka autoritetin, ta dërgojë</i></p>

i Ministrave të Këshillit të Europës, 13 Tetor 1994: [https://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR\(94\)12e.pdf](https://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR(94)12e.pdf)

2 Ibid, Parimi VI, paragrafi 1, faqe 3-4.

3 Ibid, Ibid, Parimi VI, paragrafi 3, faqe 4.

4 Karta Europiane mbi Statusin e Gjyqtarëve dhe Memorandumi Shpjegues, Këshilli i

		<p>çështjen tek një organ disiplinor, nëse pas një verifikimi dhe shqyrtimi të kujdesshëm rezulton se ka mospërmbushje të detyrimeve nga ana e gjyqtarit, si ato të parashikuara në paragrafin 5.1 të këtij dokumenti, ose të paktën ta rekomandojë çështjen te një autoritet që, në përputhje me statutin, është zakonisht kompetent për dërgimin e çështjes”⁵.</p>
VITI 2000	KE Rekomandim Rec(2000)19 ⁶	<p>Përgjegjësia disiplinore – procedimi</p> <p>“procedimi disiplinor kundër një prokurori është i rregulluar me ligj dhe duhet të garantojë një vlerësim dhe vendim të ndershëm dhe objektiv, i cili duhet t’i nënshtrohet një rishikimi të pavarur dhe të paanshëm”⁷;</p> <p>Përgjegjësia disiplinore – kodet e sjelljes</p> <p>“Shtetet duhet të sigurojnë që në zbatimin e detyrave të tyre prokurorët të udhëhiqen nga “kodet e sjelljes”. Shkelja e këtyre kodeve mund të passjellë masa ndërshtetëse në përputhje me paragrafin 5 më lart. Performanca e prokurorëve duhet të jetë objekt i një rishikimi të brendshëm”⁸.</p>
VITI 2001	KKGJE Opinion Nr. 1 (2001) ⁹	<p>Disiplina – autoriteti kompetent dhe procedimet</p> <p>...“ndërhyrja e një autoriteti të pavarur...me procedura që garantojnë të drejtën e mbrojtjes, është më rëndësi të veçantë në çështjet e procedimeve disiplinore”¹⁰;</p> <p>Disiplina – standardet e sjelljes</p> <p>...do të ishte me vlerë të përgatiteshin standarde të cilat përcaktojnë jo vetëm sjelljen që mund të shkaktojë shkarkimin nga detyra, por edhe të gjitha sjelljet që mund të sjellin si pasojë hapa disiplinore ose ndryshim të statusit, duke përfshirë për shembull transferimin në një gjykatë tjetër ose në një zonë tjetër”¹¹.</p>

Europës, Strasburg 8-10 Korrik 1998, paragrafi 5: <https://rm.coe.int/16807473ef>

5 Ibid, paragraph 5.3.

6 Rekomandimi Rec (2000)19, Mbi rolin e prokurorit në sistemin penal, Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës, 6 Tetor 2000: <https://www.refworld.org/docid/43f5c8694.html>

7 Ibid, Paragrafi 5, shkronja (e), faqe 5.

8 Ibid, Paragrafi 35, shkronja (f), faqe 9.

9 Opini nr.1 (2001), Mbi standardet që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve, e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europian (KKGJE), Nëntor 2001: <https://rm.coe.int/1680747830>

10 Ibid, Paragrafi 60, shkronja (b).

11 Ibid, Paragrafi 60, shkronja (c).

<p>VITI 2002</p>	<p>KKGJE Opinioni Nr. 3/2002¹²</p>	<p>Standardet e Sjelljes</p> <p><i>“(i) gjyqtarët duhet të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parimet e sjelljes profesionale¹³; (ii) këto parime duhet t’i ofrojnë gjyqtarëve udhëzime sesi duhet të veprojnë, në mënyrë që ata të tejkalojnë vështirësitë më të cilat përballen lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.”¹⁴.</i></p> <hr/> <p>Përgjegjësia Disiplinore – shkeljet, procedimet dhe autoriteti kompetent</p> <p><i>“(i) në çdo shtet statuti ose karta themelore e zbatueshme për gjyqtarët duhet të përcaktojë, për aq sa është e mundur në terma specifike, shkeljet që mund të sjellin ndëshkime disiplinore dhe gjithashtu procedurat që duhen ndjekur¹⁵;</i></p> <p><i>(ii) Lidhur me fillim e procedimit disiplinor, shtetet duhet të parashikojnë një organ të posaçëm ose një person me përgjegjësinë për pranimin e ankesave, për marrjen e parashtrimeve të gjyqtarit dhe për të vlerësuar në këtë këndvështrim, nëse ka ose jo baza të mjaftueshme kundër gjyqtarit për të vendosur mbi fillimin e një procedimi¹⁶;</i></p> <p><i>(iii) çdo procedim disiplinor i filluar duhet të vendoset nga një autoritet i pavarur ose panel gjyqësor, i cili vepron sipas një procedure që garanton të drejta të plota të mbrojtjes¹⁷”;</i></p>
<p>VITI 2010</p>	<p>Rekomandimet¹⁸ e Kievit</p>	<p>Disiplina – ndarja e kompetencave</p> <p><i>“Në mënyrë të që parandalohen akuzat për korporativizëm dhe në mënyrë që të garantohet një procedurë e drejtë disiplinore, Këshilli Gjyqësor nuk duhet të jetë kompetent për të dyja këto funksione:</i></p> <p><i>(a) të pranojë ankesa dhe të kryejë hetime disiplinore</i></p>

12 Opinioni Nr. 3/2002, Mbi parimet dhe rregullat rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në mënyrë të veçantë etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë, të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europian (KKGJE), Strasburg, 19 Nëntor 2002: <https://rm.coe.int/168070098d>

13 Ibid, paragrafi 49, shkronja (i), faqe 9.

14 Ibid, paragrafi 49, shkronja (ii), faqe 9.

15 Ibid, paragrafi 77, shkronja (i), faqe 15.

16 Ibid, paragrafi 77, shkronja (ii), faqe 15.

17 Ibid, paragrafi 77, shkronja (iii), faqe 15.

18 Rekomandimet e Kievit mbi Pavarësinë e Gjyqësorit në Europën Lindore, Kaukazin Lindor dhe Azinë Qendore OSCE dhe ODHIR, Kieve, 23-25 June 2010: <https://www.osce.org/files/f/documents/a/3/73487.pdf>

		<p>dhe njëkohësisht (b) të shqyrtojë rastin dhe të marrë një vendim për një masë disiplinore. Vendimet disiplinore duhet të jenë objekt <i>shqyrtimi një gjykatë kompetente në kuadër të ankimit...</i>¹⁹</p> <p>Procedimet Disiplinor – shkeljet “Procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve duhet të trajtojnë pretendime për shkelje profesionale që janë të rënda dhe të pafalshme dhe që e diskreditojnë gjyqësorin. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve nuk do të përfshijë përmbajtjet e vendimeve të tyre, përfshirë edhe ndryshimet në interpretimin e ligjit ndërmjet gjykatave; ose shembujt e gabimeve gjyqësore ose kritikizmit të gjykatave”²⁰.</p> <p>Një organ i pavarur vendimmarrës për disiplinën - “Duhet të jetë një organ i posaçëm i pavarur (gjykatë, komision ose këshill) që do të gjykojë çështjet e disiplinës gjyqësore (referojuni paragrafit 9). Organet që marrin vendime mbi çështjet e disiplinës gjyqësore nuk mundën gjithashtu të fillojnë procedimet disiplinore ose të nuk duhet të kenë brenda tyre anëtarë me të drejtë për t’i filluar ato (procedimet disiplinore). Këto organe do t’i ofrojnë gjyqtarit të akuzuar garancitë proceduriale, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur mbrojtjen dhe të drejtën për ta ankimuar vendimin në një gjykatë më të lartë. Transparenca do të jetë rregulli për secatat dëgjimore kundër gjyqtarëve. Këto seanca do të jenë të hapura, me përjashtim të rastit kur gjyqtari i akuzuar kërkon që seanca të zhvillohet me dyer të mbyllura. Në këtë rast gjykata duhet të vendosë nëse kërkesa është e justifikuar. Vendimi për disiplinën gjyqësore duhet të jetë i arsyetuar. Vendimi përfundimtar mbi masat disiplinore duhet të jetë publik.”²¹.</p>
VITI 2010	Masat Zbatuese të Primeve të Bangalores ²²	<p>Disiplina e Gjyqtarëve– shkeljet</p> <p>“Procedimet disiplinore kundër një gjyqtari mund të fillohen vetëm për shkelje të rënda. Ligji i zbatueshëm për gjyqtarët mund të përcaktojë, për aq sa është e mundur në terma specifikë, sjelljen që mund të shkaktojë masa disiplinore dhe po ashtu edhe procedurat</p>

19 Ibid, paragrafi 5, faqe 2.

20 Ibid, paragrafi 25, page 6.

21 Ibid, paragrafi 26, page 6.

22 Masat për Zbatimin Efektiv të Parimeve të Bangalores për Sjelljen në Gjyqësor, të miratuara nga Grupi i Punës për Integritetin në Gjyqësor, Lusaka, Zambia, 21 dhe 22

		<p>që duhe të ndiqen në këtë rast.”²³.</p>
		<p>Disiplina e Gjyqtarëve– ankesat</p> <p>“Një person që ngre akuza se ai ose ajo ka vuajtur nga një gabim për shkak të shkeljes së rëndë të gjyqtarit duhet të ketë të drejtën të ankohet te personi ose organi përgjegjës për fillimin e veprimeve disiplinore”²⁴.</p>
		<p>Disiplina e Gjyqtarëve– organi kompetent për ankesat</p> <p>“Duhet të caktohet me ligj një person ose organ i posaçëm që do të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, për të marrë përgjigjen e gjyqtarit dhe për të vlerësuar në kuadër të kësaj përgjigjeje, nëse ka baza të mjaftueshme për të filluar një veprim disiplinor. Në rast të një përfundimi të tillë, personi ose organi kompetent duhet ta referojë çështjen tek autoritetet disiplinore”²⁵.</p>
		<p>Disiplina e Gjyqtarëve – organi kompetent për procedimin disiplinor</p> <p>“Kompetenca për të proceduar një gjyqtar duhet t’i jepet një autoriteti ose paneli, i cili është i pavarur nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv, dhe që përbëhet nga gjyqtarë në detyrë ose në pension, por që mund të përfshijë edhe anëtarë jo gjyqtarë, duke siguruar që këta anëtarë nuk janë antarë të legjislativit dhe ekzekutivit”²⁶.</p>
		<p>Disiplina e Gjyqtarëve– procedimi</p> <p>“Të gjitha procedimet disiplinore duhet të përcaktohen duke ju referuar standardeve të mirpërcaktuara të sjelljes së gjyqësorit dhe në përputhje me procedurat që garantojnë të drejtën e plotë të mbrojtjes”²⁷.</p>
		<p>Disiplina e gjyqtarëve – masat ndëshkuese</p> <p>“Çdo juridiksion duhet të identifikojë masat ndëshkimore të lejueshme sipas sistemit të tij disiplinor dhe të sigurojë që këto masa ndëshkimore</p>

Janar 2010: <https://www.icj.org/wp-content/uploads/2015/08/JIG-Measures-effective-implementation-Bangalore-Principles-2010.pdf>

23 Ibid, paragrafi 15.1., page 15.

24 Ibid, paragrafi 15.2., faqe 15.

25 Ibid, paragrafi 15.3., faqe 15.

26 Ibid, paragrafi 15.4., faqe 15.

27 Ibid, paragrafi 15.5., faqe 15.

		<i>janë edhe në përputhje me parimet dhe propocionale në zbatim</i> ²⁸ .
VITI 2010	KE Rekomandimi CM/Rec(2010)12 ²⁹	<p>Përgjegjësia dhe procedimi disiplinor- shkeljet</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>“Interpretimi i Ligjit, vlerësimi i fakteve ose administrimi i provave nga ana e gjyqtarit për të vendosur për rastin nuk duhet të sjellë përgjegjësi civile ose disiplinore, me përjashtim të rasteve të keqbesimit dhe shkeljes së rëndë”</i>³⁰. - <i>“Gjyqtarët nuk duhet të jenë personalisht përgjegjës dhe të japin llogari kur vendimet e tyre ndryshohen ose prishen nga gjykata e apelit”</i>³¹. <p>Përgjegjësia dhe procedimi disiplinor – procedimi</p> <p><i>“Procedimet disiplinore duhet të ndiqen kur gjyqtarët dështojnë të kryejnë detyrat e tyre në një mënyrë të duhur dhe efçente. Procedime të tilla duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose nga një gjykatë me të gjitha garancitë për një proces të drejtë dhe t’i ofrojnë gjyqtarit të drejtën për ta apeluar vendimin dhe masën ndëshkuese. Masa ndëshkuese duhet të jetë propocionale”</i>³².</p> <p>Etika e Gjyqtarëve – parimet</p> <p><i>“Gjyqtarët duhet të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parime sjelljes etike dhe profesionale. Këto parime jo vetëm që përfshijnë detyrat, shkelja e të cilave mund të shkaktojë masa disiplinore, por ofrojnë edhe udhëzime për gjyqtarët sesi duhet të sillen”</i>³³.</p> <p>Etika e Gjyqtarëve – kodet</p> <p><i>“Këto parime duhet të shtjellohen në kode të etikës gjyqësore, të cilat duhet të frymëzojnë besimin e publikut te gjyqtarët dhe gjyqësori. Gjyqtarët duhet të lujnë një rol udhëheqës në zhvillimin e këtyre kodeve”</i>³⁴</p>

28 Ibid, paragrafi 15.8., page 15.

29 Rekomandimi CM/Rec(2010)12 mbi gjyqtarët: pavarësia, efçenca dhe përgjegjësitë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, e miratuar në Nëntor 2010: <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilites-of-judges/16809f007d>

30 Ibid, Kapitulli VII, paragrafi 66.

31 Ibid, Kapitulli VII, paragrafi 70.

32 Ibid, Kapitulli VII, paragrafi 69.

33 Ibid, Kapitulli VIII, paragrafi 72.

34 Ibid, Kapitulli VIII, paragrafi 73.

<p>VITI 2014</p>	<p>KKPE Opinioni Nr. 9(2014)³⁵</p>	<p>Përgjegjësia disiplinore</p> <p>- <i>“Standarded dhe parimet e të drejtave të njeriut vendosin se prokurorët janë përgjegjës për ushtrimin e detyrave të tyre dhe mund të jenë subjekt i procedimeve disiplinore”³⁶</i></p> <p>- <i>“Në një sistem demokratik të shtetit të së drejtës, shpallja i pafajshëm i një personi nuk mund të sjellë procedimin disiplinor kundër prokurorit të ngarkuar më atë çështje”³⁷.</i></p> <p>Përgjegjësia disiplinore</p> <p><i>“Shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që procedimet disiplinore kundër prokurorëve të përcaktohen nga ligji dhe të garantojnë një vlerësim të drejtë dhe objektiv dhe vendimi duhe të jetë objekt i një rishikimi të pavarur dhe paanshëm.”³⁸</i></p>
<p>VITI 2018</p>	<p>KKPE Opinioni Nr. 13(2018)³⁹</p>	<p>Llogaridhënia e Prokurorëve– përgjegjësia disiplinore dhe procedimet</p> <p><i>“Llogaridhënia e prokurorëve nuk ka si qëllim të ndërhyjë në pavarësinë e tyre. Megjithëse të pavarur, prokurorët japin llogari, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar sipas ligjeve kombëtare:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>• Ata janë subjekt, aty ku është e mundur, i procedimeve disiplinore të cilat duhet të bazohen në ligj, në rast të shkeljeve të rënda të funksionit (neglizhencë, përhapja e sekretit hetimor, shkelja e rregullave kundër korrupsionit etj.), për arsye të qarta dhe të përcaktuara; procedimi disiplinor duhet të jetë transparent, të zbatohen kritere të mirpërcaktuara dhe të mbahet përpara një organi, i cili është i pavarur nga ekzekutivi; prokurori nën procedim duhet të dëgjohet dhe të lejohet të mbrojë veten, me mbështetjen e këshilltarëve, të mbrohen nga ndikimet politike; të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën përpara një gjykatë; çdo masë ndëshkimore duhe të jetë e</i>

35 Opinioni Nr.9 (2014), mbi normat dhe parimet europiane për prokurorët, i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Europianë, Strasburg, 17 Dhjetor 2014: <https://rm.coe.int/168074738b>

36 Ibid, paragrafi 85.

37 Ibid, paragrafi 86.

38 Ibid, paragrafi 87.

39 Opinioni Nr. 13(2018), Mbi pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve të

		<i>nevojshme, e përshtatshme dhe në përpjestim me shkeljen</i> ⁴⁰ .
		Llogaridhënia e Prokurorëve – përgjegjësia disiplinore <i>“Përveçse kur gjenden në kushtet e kryerjes së një shkeljeje disiplinore ose haptazi kanë dështuar për të bërë punën e tyre siç duhet, prokurorët, ashtu si gjyqtarët, nuk mund të jenë personalisht përgjegjës për zgjedhjet e tyre në veprimtarinë publike, kur këto janë rezultat i analizave personale intelektuale dhe ligjore</i> ⁴¹ .

2.3.Zbatimi i parimeve të përgjegjësisë disiplinore sipas përcaktimeve të Komentarit të Parimeve të Bangalores

Një shtyllë e rëndësishme e standardeve ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve është përmbledhja e parimeve dhe masave të quajtura “Parimet e Bangalores” e cila ishte përmendur në Tabelën 1më sipër.

Projekt Kodi i Bangalores mbi Sjelljen e Gjyqësorit i vitit 2001, është miratuar nga Grupi Gjyqësor mbi Fuqizimin e Integritetit të Gjyqësorit, dhe rishikuar në Takimin e Drejtuesve, i mbajtur në Hagë, më 25-26 Nëntor 2002. Ky Kod është i bazuar në Nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila u paraqit në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 10 Dhjetor 1948, i cili parashikon se:

“Çdo person ka të drejtë për një proces të barabartë, të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij dhe në çdo proces penal kundër tij”.

Siç parashikohet në Preambulën e tyre, Parimet e Bangalores “...synojnë të krijojnë standard për sjelljen etike të gjyqtarëve. Ato janë hartuar për të ofruar udhëzime për gjyqtarët dhe për t’i siguruar gjyqësorit një ë kuadër rregullator të sjelljes gjyqësore. Ato synojnë gjithashtu të ndihmojnë anëtarët e ekzekutivit, të legjislativit, avokatët dhe publikun në përgjithësi, për ta kuptuar më mirë dhe për ta mbështetur gjyqësorin. Këto parime presupozojnë që gjyqtarët janë përgjegjës për sjelljen e tyre në institucionet përkatëse të themeluara për të garantuar standardet

Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Europeanë (KKPE), Strasburg, 23 Nëntor 2018: <https://rm.coe.int/opinion-13-cpe-2018-2e-independence-accountability-and-ethics-of-pros/1680907e9d>

40 Ibid, Kapitulli IV, paragrafi 47.

41 Ibid, Kapitulli IV, paragrafi 48.

gjqësore, të cilat po ashtu janë të pavarura dhe të paanshme, dhe janë krijuar me qëllim që plotësojnë dhe jo të anashkalojnë rregullat ekzistuese të detyrueshme për gjyqtarët⁴².

Për këtë arsye, në vitin 2007, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimet dhe Drogat, ka përgatitur gjithashtu edhe Komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen në Gjyqësor⁴³ si dhe dhe Masat për një zbatim efektiv të Parimeve të Bangalores për Sjelljen në Gjyqësor⁴⁴ siç përmendet në Tabelën 1 më sipër, duke i bërë kështu Parimet e Bangalores një instrument me vlerë për vendosjen e standarteve në sistemet gjyqësore të të gjitha shteteve.

Parimet e Bangalores të Sjelljes së Gjyqësorit identifikojnë gjashtë vlerat themelore:

- Pavarësinë
- Paanësinë
- Integritetin
- Korrektesën
- Barazinë
- Kompetencën dhe Kujdesin

Këto vlera thelbësore janë mbledhur dhe detajuar në Tablën xx mëposhtë që konsiderohet shumë e vlefshme për qëllimin e këtij Manuali. Më tej, parimet dhe zbatimi i tyre mund të përbëjnë një refencë të mirë për inspektorët gjatë hetimit disiplinor ose gjatë përgatitjes së raportit të hetimit, e gjithashtu edhe për Këshillat përkatëse gjatë procedimit disiplinor.

Tabela 2 - Vlerat, parimet dhe zbatimi i parimeve të Bangalores

PARIMET	PËRKUFIZIMET	ZBATIMI
PAVARËSIA	Pavarësia e Gjyqësorit është një parakusht për sundimin e ligjit dhe një garanci themelore për një proces të rregullt ligjor.	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar do të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur, bazuar në vlerësimin e tij të të gjitha fakteve dhe në përputhje me një kupturshmëri konsistente të ligjit, të lirë nga çdo ndikim i jashtëm, motive ose presjone, kërcënime ose ndërhyrje të drejtpërdrejta ose të tërthorta, nga çdo anë dhe për çdo arsye.

⁴² The Bangalore Principles of Judicial Conduct, 2002, Preamble, last paragraph.

https://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf

⁴³ Referohuni here.

⁴⁴ Referohuni here.

	<p>Një gjyqtar do ta shfaqë dhe do të japë shembullin e tij në nivel personal dhe në nivel individual.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar do të jetë i pavarur në lidhje me shoqërinë në përgjithësi dhe në lidhje me palët në një proces gjyqësor që ky gjyqtar po zhvillon. • Një gjyqtar jo vetëm që duhet të jetë i lirë nga çdo lidhje e papërshtatshme, ose ndikime nga ekzekutivi dhe legjislativi, por edhe të kujdeset që të mos jetë i ndikuar. • Në ushtimin e detyrave të tij, një gjyqtar do të jetë i pavarur nga kolegët e tij gjyqtarë në drejtim të marrjes së vendimeve, për të cilat ai është i detyruar t'i marrë në mënyrë të pavarur. • Një gjyqtar do të nxisë dhe dëshmojë pavarësi në ushtrimin e funksioneve të tij në mënyrë që të ruajë dhe çojë përpara pavarësinë operative dhe atë institucionale të gjyqësorit. • Një gjyqtar do të nxisë dhe promovojë standard të larta të sjelljes gjyqësore në mënyrë që të forcojë besimin e publikut tek gjyqësori, i cilë është kryesor në mbajtjen e pavarësisë gjyqësore.
<p>PAANËSIA</p>	<p>Paanësia është thelbësore për përmbushjen e duhur të detyrave të gjyqësorit.</p> <p>Ajo zbatohet në vendimmarrje, por edhe në në procesin nëpër të cilin kalon vendimmarrja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar duket t'i kryejë detyrat e tij gjyqësore pa favorizime, anshmëri ose paragjykime. • Një gjyqtar do të garantojë që sjellja e tij/saj, brenda dhe jashtë gjykatës ruan dhe mban besimin e publikut, profesionistëve të së drejtës dhe të palëve, në drejtim të paanshmërisë së gjyqtarit dhe të gjyqësorit. • Një gjyqtar, për aq sa është e arsyeshme, do të sillet në mënyrë të tillë që të minimizojë rastet në të cilat do të jetë e nevojshme që ai të përjashtohet nga seanca ose nga marrja e vendimit në një çështje të caktuar. • Një gjyqtar nuk duhet që me vetëdije,

		<p>gjatë procesit ose para tij, të bëjë komente që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet se do të ndikojnë në vendimin përfundimtar të këtij procesi ose që mund të dëmtojnë ndershmërinë e procesit. Gjyqtari nuk duhet të bëjë komentë në publik, sepse në të kundërt kjo do të ndikonte negativisht në një proces të rregullt ligjor të çdo personi dhe të çdo çështjeje.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjyqtari do të vetëpërfshihet nga pjesëmarrja në një procedurë në të cilën ai nuk është në gjendje të vendosë në mënyrë të paanshme ose që mund të duket nga një vëzhgues mesatar se ai nuk është në gjendje të vendosë në mënyrë të paanshme në rastin e dhënë. • Procedura të tilla përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm to, instancat në të cilat gjyqtari ka anshmëri ose paragjykim mbi njërin prej palëve ose personave, ose ka dijeni për faktet e parashtruara në proces. • Nëse një gjyqtar që më parë ka shërbyer si avokat ose si dëshmitar në një çështje ose njëri prej anëtarëve të familjes së tij ka një interes ekonomik në përfundimin e procesit, nëse përjashtimi i tij nuk kërkohet ose nuk mund të ngrihet një panel tjetër, për shkak të rrethanave urgjente, kjo do të krijonte një cënim serioz të drejtësisë.
<p>INTEGRITETI</p>	<p>Integriteti është themelor për përmbushjen e detyrimeve në gjyqësor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar duhet të garantojë që sjellja e tij/saj të jetë e pakundërshtueshme nga një vëzhgues i arsyeshëm. • Sjellja e një gjyqtari duhet të ngjallë besimin e njerëzve në integritetin e gjyqësorit. Drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet të shfaqet së jashtmi si e tillë.

<p>KORREKTËSIA</p>	<p>Korrektësia dhe shfaqja e jashtme e saj, janë themelore për të gjitha llojet e veprimtarisë së një gjyqtari.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar duhe të shmangë moskorrektesën dhe shfaqjen e kësaj moskorrektese në çdo aktivitet të tij. • Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm nga ana e publikut, një gjyqtar duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të vështira nga qytetarët e thjeshtë dhe duhet ta bëjë këtë me vullnetin e tij. Në mënyrë të veçantë, një gjyqtar duhet të sillet në mënyrë të qëndrueshme me dinjtetin e detyrës gjyqësore. • Në marrëdhëniet e tij/saj personale me anëtarë aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e drejtësisë, të cilët praktikojnë rregullisht ligjin në zyrën e tij/saj, një gjyqtar duhet të shmangë situatat që logjikshëm krijojnë dyshime ose duket sikur favorizon ose mban anën e njëres palë. • Një gjyqtar nuk do të marrë pjesë në vendimmarrjen e një çështjeje në të cilën ndonjë anëtar i familjes së gjyqtarit përfaqëson njëren palë ose ka lidhje të çfardolloy forme me rastin e dhënë. • Një gjyqtar nuk do të lejojë që banesa e tij të përdoret nga ndonjë anëtar i profesionit ligjor për të pritur klientë ose anëtarë të tjerë të këtij profesioni. • Një gjyqtar, si çdo qytetar tjetër, ka të drejtën e shprehjes, së besimit, të organizimit dhe të mbledhjes, por gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, një gjyqtar gjithmonë do ta drejtojë sjelljen e tij në mënyrë që të ruajë dinjtetin e detyrës gjyqësore dhe paanshmërinë e pavarësinë e gjyqësorit. • Një gjyqtar duhet të jetë i informuar rreth interesave personale dhe financiare të tij dhe duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të qenë i informuar edhe për interesat financiare të familjes së tij.
---------------------------	---	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar nuk duhet të lejojë që marrëdhëniet e tij familjare, shoqërore ose të tjerë të ndikojnë në sjelljen gjyqësore dhe në gjykimin e tij të çështjes. • Një gjyqtar nuk duhet të lejojë që prestigji i zyrës së tij të përdoret për të plotësuar interesa private të tij, një anëtar i familjes së tij apo të dikujt tjetër dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen ose t'i lejojë të tjerët të besojnë se janë në ndonjë pozitë të veçantë për të ndikuar tek gjyqtari dhe veprimtaria e tij. Informacioni konfidencial i përfituar për shkak të detyrës së tij nuk do të përdoret ose shpërndahehet nga gjyqtari ose ndonjë person tjetër, për arsye që nuk lidhen me gjykimin e çështjes. Në përputhje me detyrimin e zbatimit me korrektësi të detyrave gjyqësore, një gjyqtar mund të angazhohet në: <ul style="list-style-type: none"> - Shkrim, dhënien e leksioneve, pjesëmarrjen në aktivitete të lidhura me ligjin, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë ose çështje të lidhura me to; - Shfaqjen në një dëgjesë publike para një organi zyrtar që lidhet me ligjin, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë ose çështje të lidhura me to; - Shërbimin si anëtar i një organi zyrtar, ose komisioni tjetër qeveritar ose instance këshilluese, nëse kjo anëtarësi nuk krijon papajtueshmëri për paanshmërinë dhe asnjëanshmërinë politike të gjyqtarit; ose - në veprimtari të tjera që nuk e çenojnë dinjitetin dhe nuk ndërhyjnë në ushtimin e funksioneve të tij gjyqësore. • Një gjyqtar nuk mund të praktikojë ligjin (si avokat) ndërkohë që mban detyrën si gjyqtar.
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar mund të krijojë ose të bashkohet në shoqata gjyqtarësh ose të marrë pjesë në organizime të tjera që përfaqësojnë interesat e gjyqtarëve. • Një gjyqtar dhe anëtarët e familjes së tij, nuk mund të kërkojnë dhe as të pranojnë ndonjë dhuratë, nder, hua ose favor në lidhje me ndonjë veprim ose mosveprim që do të kryhet nga gjyqtari në lidhje me ushtimin e detyrave gjyqësore. • Një gjyqtar nuk do të lejojë me dijeninë e tij personelin e gjykatës ose ndonjë person tjetër nën autoritetin dhe urdhërat e gjyqtarit të kërkojnë ose pranojnë ndonjë dhuratë, nder, hua ose favor në lidhje me ndonjë veprim ose mosveprim që do të kryhet nga gjyqtari në lidhje me ushtimin e detyrave gjyqësore. • Për aq sa lejohe me ligji dhe nga kriteret e tjera për transparencën me publikun, një gjyqtar mund të pranojë ndonjë dhuratë ose çmim, sipas rastit kur këto janë ofruar dhe që nuk mund të perceptohen nga publiku si të qëllimshme për të ndikuar gjyqtarin në ushtrimin e detyrave gjyqësore ose që mund të krijojnë përshtypjen e paanësisë.
<p>BARAZIA</p>	<p>Garantimi i një trajtimi të barabartë të gjithëve para gjykatës është thelbësor për veprimtarinë e gjyqësorit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar do të jetë në dijeni dhe do të kuptojë qartë, diversitetin në shoqëri dhe diferencat e lindura nga burime të ndryshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar, racën, ngjyrën, gjininë, besimin fetar, kombësinë, aftësitë e kufizuara, moshën, statusin civil, orientimin seksual, statusin ekonomik dhe shoqëror dhe raste të tjera (“baza të paarsyeshme”). • Një gjyqtar, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve, nuk duhet të demostrojë anësi ose paragjykime në drejtim të ndonjë

		<p>personi ose grupi shoqëror për diverzitetin e përmendur më sipër.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar do t'i kryejë detyrat gjyqësore me vlerësimin e duhur për çdo person, siç mund të jenë palët, dëshmitarët, avokatët, personeli i gjykatës ose kolegët e tij, pa bërë diferencime mbi baza të paarsyeshme, të cilat janë të parëndësishme në ushtimin e detyrave të tyre. • Një gjyqtar nuk do të lejojë me dijeninë e tij që personeli i gjykatës ose ndonjë person tjetër të ndikojë në diferencimin midis këtij personeli, në një çështje para gjykatës për baza të paarsyeshme. • Një gjyqtar do t'i kërkojë avokatëve që paraqiten në procedimet përpara gjykatës shmangin shfaqjet diskriminuuese, nëpërmjet sjelljes dhe fjalëve, anëshmërinë ose paragjykimet mbi baza të paarsyeshme, përveçse kur diskriminimi ka rëndësi ligjore për rastin dhe mbrojtja është e legjitime.
<p>KOMPETENCA DHE KUJDESI</p>	<p>Profesionalizmi dhe kujdesi janë parakusht për veprimtarinë e gjyqësorit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria gjyqësore ka përparësi kundrejt çdo veprimtarie tjetër. • Një gjyqtar do t'i përkushtohet veprimtarisë së tij gjyqësore, e cila përfshin jo vetëm performancën e funksioneve gjyqësore dhe përgjegjësinë në marrjen e vendimeve, por edhe funksione të tjera me rëndësi për funksionet gjyqësore ose për veprimtarinë e gjykatës. • Një gjyqtar do të kryejë hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe zhvilluar aftësitë profesionale, njohuritë dhe cilësitë njerëzore të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave, duke përfutur nga trainimet dhe lehtësira të tjera që do t'i ofrohen, nën kontrollin gjyqësor. • Një gjyqtar do jetë i informuar mbi zhvillimet e rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë

	<p>konventat ndërkombëtare dhe instrumenta të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një gjyqtar do t'i kryejë të gjitha detyrat e tij, duke përfshirë vendimet, eficientën, drejtësinë dhe respektimin e afateve. • Një gjyqtar do të mbajë rend dhe qetësi në sallën e gjyqit dhe do të jetë i duruar, dinjitoz në marrëdhëniet me palët, të miturit, dëshmitarët, avokatët dhe të tjerët më të cilët ai ndërvepron për shkak të funksionit të tij. Gjyqtari do të kërkojë sjellje të ngjashme edhe nga ana e përfaqësuesve ligjore, personeli i gjykatës dhe personat e tjerë nën ndikimin, autoritetin dhe kontrollin e gjyqtarit. • Një gjyqtar nuk do të përfshihet në sjellje të papajtueshme me përgjegjësinë dhe kujdësin në kryerjen e funksioneve gjyqësore.
--	--

2.4. Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve

Një institucion i rëndësishëm ndërkombëtar, me efekte në sistemin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve është Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlen të theksohet se deri tani duket të ketë vetëm pak raste në shqyrtim të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që lidhen drejtpërdrejt me veprimet disiplinore të ndërmarra kundër magjistratëve. Kjo situatë buron pa dyshim nga fakti që vetëm së fundmi GJEDNJ-ja pranoi që e drejta parashikuar në Nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së për një proces të rregullt e dhe publik në përcaktimin e të drejtave civile, zbatohet, siç teqohet më poshtë, edhe në çështjet ku përballen autoritetet publike dhe nënpunësit civilë.

Megjithatë, kriteret epërcaktuara nga GJEDNJ-ja në lidhje me shumë çështje të procedimeve disiplinore që përfshijnë profesione të tjera janë me zbatueshmëri të përgjithshme dhe, në këtë mënyrë, me rëndësi edhe për magjistratët. Për më tepër, Gjykata Europiane tashmë ka konsideruar që Neni 6 § 1 mund të aplikohet edhe në lidhje me gjyqtarët, megjithëse

ata nuk janë pjesë e shërbimit civil, meqenëse ata i takojnë një shërbimi publik tipik⁴⁵.

Nuk ka arsye për të besuar se Gjykata nuk do të mbante një qëndrim të ngjashëm edhe në lidhje me prokurorët duke patur parasysh që Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Europeanë (KKPE) ka njohur formalisht që afërsia dhe natyra plotësuese e misionëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve krijon kërkesa dhe garanci të ngjashme në kuptimin e statusit të tyre dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë ato në lidhje me disiplinën. Prandaj shtjellimi i mëtejshëm nga GJEDNJ i kërkesave që rregullojnë disiplinën e gjyqtarëve do të jetë i një rëndësie të posaçme për procedimet e nisura në ngarkim të prokurorëve⁴⁶. Për më tepër në rastin specifik të Shqipërisë, prokurorët dhe gjyqtarët kanë të njëjtin status formal.

Seksioni i mëposhtëm përmban një analizë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Secili seksion përmban një referencë tek neni përkatës i Konventës, çështja(et)/tema(t) kryesore që trajtohen.

Neni 6 i Konventës E drejta për një proces të rregullt

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

A. Zbatueshmëria e nenit 6 në masat disiplinore në ngarkim të magjistratëve

- Për një kohë të gjatë, Gjykata mbajti qëndrimin që Neni 6 nuk zbatohet për procedimet disiplinore që rezultojnë në largimin nga detyra të një nëpunësi civil. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së do të shprehet që mosmarrëveshjet në lidhje me rekrutimin, karrierën dhe largimin nga shërbimi i nëpunësve, si rregull i përgjithshëm, dilnin jashtë fushëveprimit të Nenit 6, paragrafit 1, të Konventës.

⁴⁵ Olujić kundër Kroacisë, nr. 22330/05, 5 shkurt 2009, në par. 32. 24.

⁴⁶ Opinioni Nr. 4 (2014) mbi ‘Gjyqtarët dhe Prokurorët në një Shoqëri Demokratike’ (Deklarata e Bordosë) dhe Opinioni Nr 9 (2014) për normat dhe parimet europiane në lidhje me prokurorët (Karta e Romës).

Sipas Gjykatës, *“mosmarrëveshjet e punës ndërmjet autoriteteve dhe nëpunësve, detyrat e të cilëve ishin tipike për aktivitetet specifike të shërbimit publik, në masën që ky i fundit po vepronte si depozitues i autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit, nuk ishin ‘civile’ dhe ishin të përjashtuara nga fushëveprimi i Nenit 6, paragrafi 1, i Konventës. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës, shembulli tregues i këtyre aktiviteteve u dha nga forcat e armatosura dhe policia”* (Neigel kundër Francës 1997 dhe De Santa kundër Italisë 1997).

- Po ashtu, në lidhje me procedimet për largimin nga puna të një gjyqtari, Gjykata konstatoi që gjyqësori, duke mos qenë pjesë e shërbimit të zakonshëm civil, ishte megjithatë pjesë e shërbimit tipik publik (Pitkevich kundër Ruisë, Nr. 47936, 8 shkurt 2001). Një gjyqtar ka përgjegjësi specifike në fushën e administrimit të drejtësisë, që ka qenë një sferë në të cilën shtetet ushtronin kompetenca sovrane. Për pasojë, një gjyqtar merr pjesë drejtpërdrejt në ushtrimin e kompetencave të dhëna nga e drejta publike dhe përmbush detyra të destinuara për të garantuar interesat e përgjithshme të Shtetit.

Gjykata nxori përfundimin që mosmarrëveshja në lidhje me largimin e një gjyqtari nga detyra nuk ka të bëjë me të drejtat ose detyrimet ‘civile’ të kërkuarit brenda kuptimit të Nenit 6 të Konventës.

- Gjykata kështu ka zhvilluar një ‘kriter funksional’ që synon të përcaktojë, në çdo rast të veçantë, dhe bazuar tek përkufizimet ligjore të secilit Shtet, nëse posti i kërkuarit ka shkaktuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të kompetencave të dhëna nga e drejta publike dhe detyrat e përcaktuara për të garantuar interesat e përgjithshme të Shtetit ose autoriteteve të tjera publike, d.m.th., nëse ‘ekziston një ‘lidhje e posaçme besimi dhe besnikërie’ ndërmjet nëpunësit civil dhe Shtetit. (Pellegrin kundër Francës, § 66).
- Megjithatë, që nga viti 2007 ka patur ndryshim radikal në praktikën gjyqësore. Duke njohur që zbatimi i ‘kriterit funksional’ mund të çojë vetë në rezultate jo-normale, Dhoma e Madhe ka vendosur kritere për zbatimin e aspekteve civile të Nenit 6, paragrafi 1, në lidhje me mosmarrëveshjet e punës që prekin punonjësit e shtetit ose nëpunësit publikë. Ajo konsideroi që do të ketë një prezumim që Neni 6 zbatohet dhe një përjashtim nga fushëveprimi i Nenit 6 lejohet vetëm nëse qeveria e paditur provon (i) që ligji i saj i brendshëm e ka përjashtuar shprehimisht aksesin në gjykatë për pozicionin ose kategorinë e personelit përkatës dhe (ii) që një përjashtim i tillë justifikohet me shkaqe objektive në interes të Shtetit (Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës).

B. Paanësia dhe pavarësia e organit që nis procedimin disiplinor të magjistratit

- Në lidhje me procedimin disiplinor të një gjyqtari për sa i takon përmbushjes së detyrave të tij/saj, Gjykata ka konstatuar një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt për shkak të paanësisë të procedimeve disiplinore, për shkak se gjyqtari është akuzuar, gjykuar dhe ndjekur disiplinarisht nga të njëjtët persona (Kamenos kundër Qipros).
- Po ashtu, gjykata ka konstatuar një shkelje të Nenit 6, paragrafi 1, të Konventës bazuar në paanësinë e tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor Kombëtar (d.m.th., organi që ka filluar procedimin disiplinor në ngarkim të kërkuesit) për shkak se gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të gjyqtarit ata kanë dhënë intervista, publikuar në dy gazeta të ndryshme kombëtare, duke shprehur anësinë e tyre kundër kërkuesit (Olujic kundër Kroacisë).
- Në një çështje tjetër, Gjykata ka gjetur një shkelje të GJEDNJ-së për shkak të papajtushmërisë me parimet e pavarësisë dhe paanësisë që kërkohen nga Neni 6, paragrafi 1 i Konventës, për shkak se çështja e kërkuesit është vendosur nga këshilli, nga i cili vetëm një pakicë përbëhej nga gjyqtarët (anëtarët e tjerë jo-gjyqtarë janë emëruar drejtpërdrejt nga autoritetet e ekzekutivit dhe legjislativit).
- Gjithashtu, anëtarët e këshillit të cilët kanë zhvilluar hetime paraprake në çështjen e kërkuesit dhe kanë bërë kërkesa për largim nga detyra, më vonë morën pjesë në vendimet për largimin e kërkuesit nga detyra (Volkov kundër Ukrainës; Denisov kundër Ukrainës).

C. Kohëzgjatja e procedimeve brenda një afati të afati i arsyeshëm

- Procedimet disiplinore duhet të kryhen me shpejtësi.
- Në përgjithësi, gjykata nuk përcakton standarde specifike në lidhje me gjatësinë e procedimeve disiplinore. Duke përsëritur që arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të posaçme të çështjes, Gjykata është shprehur që një periudhë që shkon tej gjashtë viteve për të vendosur për çështjen e kërkuesit, veçanërisht në lidhje me atë që ishte e rëndësishme për kërkuesin, d.m.th., largimi i tij nga detyra, duket e tepërt.
- Gjykata është shprehur që ka patur një shkelje të nenit 6, paragrafi 1, i Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve (para KLGJ-së, pastaj para Dhomës së Parlamentit të Rajoneve dhe para Gjykatës Kushtetuese) (Olujic kundër Kroacisë, § 8).

D. Siguria juridike dhe procesi i rregullt

- Në Volkov kundër Ukrainës, Gjykata u shpreh që mungesa e çdo lloj afati parashkrimi në lidhje me procedimin për pushimin e një gjyqtari për 'shkelje të betimit' ka ndikuar mbi rregullsinë e procedimit, në shkelje të Nenit 6 § 1. Në rastin specifik, faktet e shqyrtuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vitin 2010 kishin të bënin me vitet 2003 dhe 2006 dhe kërkuesi ishte vendosur në një pozicion të vështirë, pasi ai duhej të përgatiste mbrojtjen e tij në lidhje me ngjarjet që kishin ndodhur në të shkuarën. Gjykata ishte e mendimit që afatet e parashkrimit u shërbejnë shumë qëllimeve të rëndësishme, që janë garantimi i sigurisë dhe marrjes formë të prerë, mbrojtjes së të pandehurve të mundshëm nga pretendimet e vjetra që mund të ishin të vështira për t'iu përgjigjur, dhe penguar çdo padrejtësi që lind nëse gjykatave u kërkohet të vendosnin për ngjarje që kanë ndodhur në të shkuarën e largët në bazë të provave që mund të jenë bërë të pabesueshme dhe të pa plota për shkak të kalimit të kohës (§ 132-135).

E. E drejta për seancë publike

- Gjykata ka theksuar që karakteri publik i procedimit i mbron palët ndaj administrimit të drejtësisë në Fshehtësi pa kontroll publik; kjo është gjithashtu një nga mjetet nëpërmjet të cilëve mund të ruhet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë të dukshme, publiciteti kontribuon në arritjen e qëllimit të Nenit 6, paragrafi 1, të gjykimit të drejtë, garantimi i të cilit është një nga themelet e një shoqërie demokratike. (shihni *Sutter v. Sëitserland*, § 26).
- Në të njëjtën kohë, Gjykata gjithashtu njeh që Neni 6, paragrafi 1, nuk i pengon gjykatat të vendosin shmangien nga ky parim, nën dritën e tipareve të posaçme të çështjes që u është paraqitur atyre: "*...shtypit dhe publikut mund t'i ndalohej gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*"; Zhvillimi i procedimeve, qoftë tërësisht apo pjesërisht me dyer të mbyllura, duhet të kërkohet me rigorozitet nga rrethanat e çështjes (shih *Diennet kundër Francës*, § 34, dhe *Martinie kundër Francës*, § 40). Për më tepër, Gjykata është shprehur që rrethanat e posaçme në lidhje me natyrën e çështjeve

që duhet të vendosen nga gjykata në procedimin përkatës, mund të justifikojnë heqjen dorë nga seanca publike⁴⁷.

- Megjithatë, Gjykata ka nënvizuar që në pjesën më të madhe të procedimeve disiplinore në lidhje me ata që punojnë në sistemin e drejtësisë penale, mbikëqyrja publike është thelbësore për të garantuar përgjegjshmërinë e operimit të sistemit⁴⁸.
- Sidoqoftë, vendimet për përjashtimin e publikut nga seancat disiplinore duhet të justifikohen nga organi që zhvillon seancën; duke ditur rëndësinë e vëzhgimit publik në këto raste, mos justifikimi i seancave të mbyllura mund të bëhet shkak për shkeljen e Nenit 6 të Konventës Europiane.
- Në çështjen *Olujić kundër Kroacisë* në të cilën Këshilli Gjyqësor Kombëtar e konsideroi të nevojshme të përjashtonte publikun me qëllim që të mbrohet dinjteti i kërkuarit dhe dinjteti i gjyqësorit si i tillë pa asnjë arsytim tjetër, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6, paragrafi 1, duke konsideruar që:
 - (i) kërkuari kërkoi shprehimisht një seancë publike (duke treguar që ai vetë nuk ishte i mendimit që dinjteti i tij kërkonte mbrojtje nëpërmjet përjashtimit të publikut),
 - (ii) u konstatua që përjashtimi i publikut nuk është absolut (në disa seanca disa përfaqësues të UNHCR-së dhe OSBE-së ishin të pranishëm)
 - (iii) mungesa e aksesit të publikut në procedimin para Këshillit Kombëtar Gjyqësor nuk u korrigjua në procedimet pasuese, meqenëse as organet e tjera të përfshira (Dhoma e Parlamentit të Rajoneve ose Gjykata Kushtetuese) nuk zhvilluan seanca publike (*Olujić kundër Kroacisë*, par 76).

47 Shih *Martinie kundër Francës*, § 41 “.....Kështu kërkon, veçanërisht që, gjykimet për sigurimet sociale, të cilat janë tepër teknike, shpesh trajtohen më mirë me shkrim se nëpërmjet parashtrimeve me gojë, dhe që, mbajtja e seancave në mënyrë sistematike mund të jetë pengesë për kujdesin e veçantë të kërkuar në çështjet e sigurimeve sociale, është e kuptueshme që në këtë sferë autoritetet duhet tu kushtojnë vëmendje kërkesave të eficientësisë dhe ekonomisë (shih për shembull, *Miller dhe Schuler-Zraggen*, e cituar më sipër). Duhet vënë në dukje që në pjesën më të madhe të rasteve në lidhje me gjykimet para gjykatave ‘civile’ vendimi mbi themelin e çështjes ka arritur në përfundimin që kërkuari kishte patur mundësinë për të kërkuar një seancë publike.’

48 P.sh., *Diennet kundër Francës*, nr. 18160/91, 26 shtator 1995, *Serre kundër Francës*, nr. 29718/96, 29 shtator 1999, *Hurter kundër Zvicrës*, nr. 53146/99, 15 dhjetor 2005, *Olujić kundër Kroacisë*, nr. 22330/05, 5 shkurt 2009, *Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë*, nr. 20688/04, 17 dhjetor 2013, *Ramos Nunes de Carvalho E Sá kundër Portugalisë*, nr. 55391/13, 21 qershor 2016 (që i është referuar Dhomës së madhe) dhe *Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës*, nr. 40575/10, 2 tetor 2018.

F. E drejta për një seancë verbale

- Magjistrati në fjalë duhet të ketë mundësinë e seancës dëgjimore verbale, d.m.th, një seancë në të cilën ai ose ajo dhe çdo dëshmitar do të dëshmojnë dhe do të merren në pyetje para organit disiplinor. Gjykata nënvizoi se e drejta për një seancë dëgjimore është veçanërisht e rëndësishme pasi mundëson që organi disiplinor të vlerësojë besueshmërinë e atyre që paraqiten në të. Nevoja për një të drejtë të tillë është theksuar edhe nga Komisioni i Venecias dhe çdo heqje dorë prej saj duhet të jetë e shprehur qartë.
- Në çështjet *Stojakovic k. Austrisë*, dhe *Gülmez k. Turqisë* Gjykata konstatoi një shkelje të Nenit 6 § 1, pasi organet disiplinore kishin dhënë vendimet e tyre vetëm në bazë të dosjes së çështjes pa mbajtur seancë dëgjimore.

G. Barazia e armëve

- Gjykata ka konsideruar se, për sa i takon procedurave disiplinore ndaj gjyqtarit, barazia e armëve nënkupton që gjyqtarit, për të cilin shqyrtohet çështja, duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij/të saj - përfshirë provat e tij/të saj - në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm përballë autoriteteve që sjellin ato procedura kundër një gjyqtari. Gjykata përsëriti se rregullat mbi pranueshmërinë e provave me qëllim sigurimin e së drejtës për një seancë të drejtë në vijim të nenit 6 §1 janë kryesisht çështje për rregullim me ligjin kombëtar dhe gjykatat kombëtare dhe se, rrjedhimisht, i lihet autoriteteve kombëtare të sigurojnë në secilin rast individual që kërkesat e një seance të rregullt janë përmbushur (shihni, *mutatis mutandis*, *Dombo Beheer B.V. k. Holandës* § 33).
- Në çështjen *Olujić k. Kroacisë*, në të cilën Këshilli Kombëtar Gjyqësor (KKGJ) pranoi të gjitha propozimet për të dëgjuar prova nga dëshmitarët e emëruar nga avokati i Qeverisë dhe asnjë nga propozimet e paraqitura nga kërkuesi, Gjykata konstatoi se ka pasur një kufizim të aftësisë së kërkuesit për të paraqitur çështjen e tij në një mënyrë të papajtueshme me garancitë e një gjykimi të drejtë të parashikuar në nenin 6 dhe, për rrjedhojë, një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me parimin e barazisë së armëve.
Në çështjen specifike, Gjykata vërejti që në procedurat disiplinore kundër kërkuesit Qeveria pretendoi si arsye pushimi nga puna se ai kishte mbajtur kontakte të vazhdueshme në publik me dy individë

që kishin historik kriminal. Linja e mbrojtjes e kërkuesit kishte për qëllim të tregonte se ai nuk kishte mbajtur kontakte të ngushta me këta dy individë, por që ata ndonjëherë frekuentonin të njëjtat vende publike. Dëshmitarët e paraqitur prej tij do të vërtetonin këtë linjë të mbrojtjes. NJC e justifikoi refuzimin e saj për të dëgjuar prova nga cilido prej dëshmitarëve të thirrur në emër të kërkuesit duke deklaruar se rrethanat e përmendura në provat e mbështetura nga kërkuesi ishin përcaktuar tashmë ose ato nuk ishin të rëndësishme për çështjen. Sipas mendimit të Gjykatës, arsyet e mbështetura nga KKGJ për refuzimin e pranimit të cilitdo prej dëshmitarëve të thirrur në emër të kërkuesit me qëllim vërtetimin e mbrojtjes së tij, nuk ishin të mjaftueshme.

- Në çështjen *Vanjak k. Croatia*, u konstatua një shkelje pasi organi disiplinor mori parasysh deklaratat e bëra nga persona që nuk ishin marrë në pyetje si dëshmitarë dhe në këtë mënyrë nuk ishin dëgjuar prej tij.
- Në çështjen *Baçichetti k. Italisë*, nr. 22584/06, 18 shkurt 2010, u konstatua një shkelje, pasi organi disiplinor, por jo kërkuesi, kishte qenë në dijeni të një raporti të rëndësishëm për procedurat disiplinore që kishte të bënte me shkeljet e pretenduara.

H. Publikimi i shpejtë i vendimit disiplinor

- Pavarësisht nëse seanca dëgjimore ishte e hapur apo e mbyllur, vendimet e marra në fund të procedurës disiplinore duhet të publikohen dhe teksti duhet të jetë i disponueshëm/i aksesueshëm për këdo që është i interesuar ta lexojë atë.
- Në rast arsyesh bindëse për ruajtjen e konfidencialitetit, Gjykata nuk është e bindur se mbrojtja e informacionit konfidencial që përfshihet në dosje e ka bërë të domosdoshëm kufizimin e publikimit të vendimeve në tërësinë e tyre, pasi ekzistojnë teknika për lejimin e një niveli të caktuar aksesit të publikut në vendime, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit delikat. Në mënyrë të veçantë, Shteti mund të miratojë mekanizma, për shembull të vendosë të botojë vetëm pjesën dispozitive të vendimit dhe thjesht të mohojë aksesin në informacione të veçanta që duhet të mbahen konfidenciale, ose të klasifikojë pjesërisht këto vendime sipas mundësive që paraqiten (Nikolova dhe Vandova k. Bullgarisë)
- Gjithashtu, prononcimi duhet të ndodhë në kohën e duhur.
- Në çështjen e Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë, Gjykata Evropiane konstatoi një shkelje të nenit 6 § 1, pasi, për shkak të

klasifikimit të çështjes së kërkuesit të parë si sekret, jo vetëm që Gjykata e Lartë Administrative shqyrtoi çështjen me dyer të mbyllura, por vendimet e dhëna nuk u bënë të ditura për publikun dhe nuk ishin të disponueshme në regjistrin e gjykatës ose në faqen e saj në internet, dhe as vetë kërkuesi i parë nuk mund të merrte një kopje. Dosja nuk u deklasifikua deri pas parashkrimit/skadimit të afatit ligjor në korrik 2009, që do të thotë, më shumë se pesë vjet pasi ishte dhënë vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë Administrative.

- Sidoqoftë, Gjykata ka theksuar se shkalla në të cilën zbatohet kjo detyrë për të dhënë arsye mund të ndryshojë në bazë të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në kuadrin e rrethanave të çështjes. Megjithëse neni 6 § 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, ai nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të hollësishme për çdo argument.

I. Arsyetimi i vendimit

- Vendimi i organit disiplinor duhet të arsyetohet posaçërisht në lidhje me çështjet që ndikojnë në besueshmërinë e provave tek të cilat mbështetet.
- Në çështjen *Vanjak k. Kroacisë*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 në procedurën disiplinore me arsyetimin se organi disiplinor nuk kishte dhënë arsye të kënaqshme për të pranuar një rrëfim nga kërkuesi si të saktë dhe origjinal kur ai kishte pretenduar se ishte marrë nën presion.

Neni 8 i Konventës

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

A. Ndërhyrje në të drejtën e respektit të jetës private

- Gjykata ka sqaruar se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin në vetvete nuk përjashtohen nga objekti i “jetës private” në kuptimin e nenit 8 të Konventës. Ekzistojnë disa aspekte tipike të jetës private,

të cilat mund të preken në mosmarrëveshje të tilla të pushimit nga puna, ose masa të tjera të ngjashme të pafavorshme. Këto aspekte përfshijnë (a) “rrethin e brendshëm” të kërkuarit, (b) mundësinë e kërkuarit për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët, dhe (c) reputacionin shoqëror dhe profesional të kërkuarit/aplikantit.

- Ekzistojnë dy mënyra në të cilat një çështje e jetës private zakonisht lind në një mosmarrëveshje të tillë: (i) ose për shkak të arsyeve themelore të masës së kundërshtuar (qasja e bazuar në arsye) ose (ii) për shkak të pasojave për jetën private (qasja e bazuar në pasojë).

(i) Qasja bazuar në arsye

Për shkak të funksionit të tij/saj, një magjistrat duhet të përmbushë rolin e tij/të saj me integritet. Sipas parimeve të RREKJ-së për etikën gjyqësore, një detyrë e tillë integriteti zbatohet si në jetën publike, ashtu edhe në jetën personale. Prandaj, magjistrati duhet të shmangë çdo sjellje dhe veprimtari që shkel ose kërcënon të dëmtojë imazhin publik dhe imazhin e magjistratit dhe të sistemit të drejtësisë. Në një çështje ku kërkuarja u pushua nga funksioni i saj si gjyqtare, jo thjesht për shkaqe profesionale, por edhe për shkak të pretendimeve për jetën e saj private, Gjykata analizoi me hollësi proporcionalitetin e hetimit në jetën personale dhe qëllimin legjitim të ndjekur.

- Në çështjen Özpınar k. Turqisë gjyqtarja u pushua nga puna, sepse ishte vërtetuar se nga qëndrimet dhe marrëdhëniet e saj: (a) kishte ofenduar dinjitetin dhe nderin e profesionit dhe kishte humbur dinjitetin dhe gjithë konsideratën personale; (b) kishte krijuar bindjen se ajo po kryente detyrat e saj duke u udhëhequr veçanërisht nga ndjenjat personale; (c) kishte shkuar në vendin e punës me vonesë pa asnjë justifikim, ishte larguar nga vendi i punës para se të mbaronte orari i punës dhe kishte munguar shumë herë. Konkretisht, akuzat ishin:
 - ajo ishte shpërngulur nga shtëpia e nënës së saj pas një debati, ndërkohë që ishte beqare, për të jetuar në një apartament qiraja e të cilit paguhej nga Z. X, i martuar dhe me katër fëmijë. Kishte një marrëdhënie me këtë avokat: e kishte lejuar vazhdimisht këtë avokat të hynte në zyrën e saj, të largohej nga gjykata me makinën e kësaj të fundit dhe kishte qenë për drekë me të. Në këtë mënyrë, kishte krijuar besimin e gjerë se çështjet në të cilat të pandehurit përfaqësoheshin prej tij do të gjykohehin në favor të tij,

- kishte krijuar besimin e gjerë se ajo mbante marrëdhënie të ngushta me burra të ndryshëm, duke përfshirë avokatin e përmendur,
 - në gjykatë, kishte debatuar me zë të lartë me nënën e tij që jeton në një shtëpi tjetër
 - disa ditë, kishte bërë shumë makiazh dhe kishte veshur, gjatë orarit të punës, minifund në një mënyrë që është e papajtueshme me cilësinë e gjyqtares,
 - e kishte zakon të shkonte me vonesë në vendin e punës pa asnjë justifikim, të largohej herët nga vendi i punës dhe të mungonte shumë herë.
- Gjykata arriti në përfundimin se hetimi për jetën e saj profesionale dhe personale, si dhe largimi i saj nga puna, siç rezultoi, mund të shihej si një ndërhyrje në të drejtën e saj për të respektuar jetën private. Në veçanti, Gjykata konstatoi se shkarkimi i kërkuesit dhe incidenca e rëndësishme në karrierën e saj ishte në shpërpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur, duke marrë parasysh gjithashtu mungesën e garancive në procedurën përkatëse. Gjykata theksoi se çdo magjistrat, i cili pushohet nga puna për arsye që kanë të bëjnë me manifestimet e jetës së tij private dhe jetës familjare, duhet të ketë masa mbrojtëse ndaj arbitraritetit. Në thelb, magjistrati duhet të ketë mundësinë të kundërshtojë para një organi të pavarur dhe të paanshëm faktet e pretenduara, duke paraqitur këndvështrimin e tij dhe duke hedhur poshtë argumentet e paraqitura nga autoritetet.

(ii) Qasja e bazuar tek pasoja

- Në mosmarrëveshjet në lidhje me shkeljen e Nenit 8, kur është në diskutim qasja e bazuar tek pasoja, ka një rëndësi thelbësore deri në cilën masë është prekur e të "rrethi i brendshëm" i aplikantit, mundësia për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët, dhe reputacioni i tij/saj shoqëror dhe profesional.
- Gjykata theksoi se sanksionet duhet të jenë proporcionale me rëndësinë e veprimeve të gabuara. Për këtë arsye, duhet të jenë të disponueshme një sërë sanksionesh, duke filluar nga ato të vogla siç janë paralajmërimet, deri në sanksione që përfshijnë pasoja të rënda, të tilla si pezullimi, transferimi ose shkarkimi i një gjyqtari.
- Është aplikanti/kërkuesi ai që duhet të tregojë bindshëm se pragu është arritur në çështjen e tij ose të saj. Kërkuesi duhet të paraqesë prova që vërtetojnë pasojat e masës së kundërshtuar. Vuajtja e një kërkuesi duhet të vlerësohet duke krahasuar jetën e tij/të saj para dhe pas masës në fjalë.

- Më tej Gjykata konsideron se në përcaktimin e seriozitetit të pasojave në çështjet që lidhen me punësimin është e nevojshme të vlerësohen perceptimet subjektive të pretenduara nga kërkuesi në kuadrin e rrethanave objektive që ekzistojnë në atë çështje të caktuar. Kjo analizë do të duhet të mbulojë si ndikimin material, ashtu edhe ndikimin jo-material të masës së pretenduar. Sidoqoftë, mbetet që aplikanti të përcaktojë dhe vërtetojë natyrën dhe shtrirjen e vuajtjes së tij/të saj, e cila duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar. Gjykata do të pranojë vetëm që neni 8 është i zbatueshëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe ndikojnë në jetën private të tij ose të saj në një shkallë mjaft të konsiderueshme (Denisov k. Ukrainës, 25 shtator 2018; Volkov k. Ukrainës).

Neni 10 i Konventës Liria e shprehjes

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve...”

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve”.

A. E drejta për lirinë e shprehjes

- Gjykata ka përsëritur që neni 10 zbatohet në vendin e punës, por gjithashtu ka nënvizuar se punonjësit i detyrohen punëdhënësit të tyre të jenë besnikë, të rezervuar dhe diskretë, veçanërisht në rastin e nëpunësve civilë.
- Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 10, ku masa disiplinore është shkaktuar si pasojë e pjesëmarrjes së magjistratit në debatin publik për reformat legjislative që prekin gjyqësorin dhe, përgjithësisht, çështje që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit.
- Gjykata gjithashtu ka hedhur poshtë proporcionalitetin e dënimit të vendosur ndaj aplikantit duke theksuar “efektin frenues” të masave të tilla mbi gjyqtarët që dëshirojnë të marrin pjesë në debat publik për efektivitetin e institucioneve gjyqësore (Baka k. Hungarisë; Kudeshkina k. Rosisë).

Neni 1, Protokollu 1 i Konventës, E drejta e gëzimit të qetë të pronës

“1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë i qetë pronat e tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, përveçse në rastin e interesit publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara me ligj dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

A. Proporcionaliteti në vendosjen e sanksionit

Në çështjen *Harabin k. Sllovakisë*, nr. 58688/11, 20 nëntor 2012, Gjykata konstatoi se Gjykata Kushtetuese që vendosi për kërkesin - e cila u vlerësua përgjegjëse për përdorimin e papërshtatshëm të fondeve publike dhe shkeljet e detyrimeve të tij statutore si Kryetar i Gjykatës së Lartë - një sanksion prej 70% të uljes së pagës së tij vjetore, nuk ka vepruar në kundërshtim me kërkesat sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1, sipas të cilit duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet”.

Neni 4, Protokollu 7 i Konventës E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

“1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti”.

A. Ne bis in idem⁴⁹

- Në rastin e procedurave disiplinore të ndërmarra ndaj një magjistrati në lidhje me të njëjtat fakte që kanë çuar në një dënim penal, Gjykata ka konstatuar se procedurat disiplinore ndaj kërkesit nuk mund të

49 Shihni gjithashtu opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2014)032, paragrafi 56: “Natyra e pavarur e detyrimeve penale dhe disiplinore që kanë elementë të ndryshëm përbërës dhe që zbatojnë standarde të ndryshme të provës nuk do të thotë se ata përjashtojnë njëri-tjetrin. Sanksionet disiplinore mund të jenë akoma të përshtatshme në rast të lirimit penal. Gjithashtu, fakti që procedimi penal nuk është filluar për shkak të mos vërtetimit të fajit penal ose fakteve në një çështje penale, nuk do të thotë që nuk ka pasur shkelje disiplinore nga gjyqtari në fjalë, pikërisht për shkak të natyrës së ndryshme të të dyjave detyrimeve. Nëse sjellja e gabuar e gjyqtarit mund të shkatërrojë besimin e publikut në gjyqësor, është në interes të gjyqësorit që të fillojë procedura disiplinore. Procedurat penale, megjithatë, nuk marrin në konsideratë aspektin e veçantë disiplinor të sjelljes së papërshtatshme, por fajin penal.”

- cilësohen si “procedura të mëtejshme penale” dhe për këtë arsye nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës (Kremzoë k. Austrisë; Demel k. Austrisë; Luksch k. Austrisë; Banfield k. Mbretërisë së Bashkuar; Klein k. Austrisë).
- Gjithashtu, në vendimin për të përjashtuar zbatueshmërinë e dispozitës penale të nenit 6 në faktet specifike të çështjes, Gjykata vlerëson se:
 - Dispozita e zbatueshme disiplinore nuk i drejtohej publikut të gjerë, por anëtarëve të një grupi të veçantë që kishin një status të veçantë dhe synonte që anëtarët e organit profesional të respektonin rregullat specifike që rregullojnë sjelljen e tyre profesionale (Albert dhe Le Compte k. Belgjikës (§ 30), Muller-Hartburg k. Austrisë (§§ 42-49);
 - Heqja e lirisë nuk ishte në diskutim asnjëherë për kërkuesin dhe gjobën, të cilën ai rrezikoi të merrte, megjithëse arritja e shumës që mund të konsiderohej si ndëshkuese, nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për ta cilësuar masën si penale (Muller-Hartburg, k. Austrisë, §§ 42-49);
 - autoritetet arritën ta mbanin vendimin e tyre brenda një sfoere thjesht administrative (Mullet k. Francës; Trubic k. Kroacisë (§ 26);
 - shkarkimi i gjyqtarit nuk përfshin përcaktimin e një akuze penale (Oleksander Volkov k. Ukrainës, (§ 93-95), Kamenos k. Qipros, (§51-53).

2.5. Standardet Minimale në Proçedimet Disiplinore

Siç tregohet në seksionet më sipër, të këtij kapitulli dhe gjithashtu edhe në Tabelën 1, ka patur përgjatë viteve një shumfishim të dokumentave ndërkombëtare dhe Europiane që trajtojnë standardet dhe proçedurat disiplinore të magjistratëve. Pavarësisht diferencave të tyre në shtrirjen e rregullimit dhe formulimit të standardit dhe proçedurës, të gjitha këto dokumenta kanë ngjashmëri të theksuara dhe përmbëjnë bashkësinë e standardeve minimale mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.

Këto standarde minimale janë mbledhur dhe prezantuar në Raportin e Standardeve Minimale të Gjyqësorit, të hartuar nga Rrjeti Europian i Këshillave për Gjyqësorin (RREKGJ)⁵⁰. Në këtë raport RREKGJ,

⁵⁰ Standardet Minimale mbi sjelljen gjyqësore V, Proçedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve, Rrjeti Europian i Këshillave për Gjyqësorin: https://www.ency.eu/images/stories/pdf/GA/Hague/encj_report_minimum_

koleksioni dhe analizi standard e mëparshme ndërkombëtare mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe hartoi një sërë parimesh të përgjithshme të sjelljes së gjyqtarëve, të tilla si:

- Gjyqtarët duhet të udhëhiqen nga parimet etike të sjelljes profesionale, që përfshijnë detyra dhe përgjegjësi, shkelja e të cilave mund të ndëshkohet nga masa disiplinore.
- Gjyqtarët nuk duhet të mbajnë përgjegjësi civile apo disiplinore për shkak të interpretimit të ligjit, vlerësimit të fakteve dhe administrimit të provave, me përjashtim të rasteve të keqdashjes dhe pakjudesisë së rëndë.
- Çdo masë disiplinore dhe procedurë duhet të rregullohet me ligj.
- Procedurat disiplinore të përcaktuara për të mundësuar llogaridhënien e gjyqësorit nuk duhet të lejohet të bëhen instrumentat të presionit ndaj gjyqtarëve.

Bazuar te të njëjtat burime dhe të të njëjtat parime të përgjithshme të RREKGJ përgatiti gjithashtu një listë më të detajuar të standardeve minimale që duhet të zbatohen në lidhje me procedimet disiplinore të gjyqtarëve. Këto standarde janë përmbledhur dhe paraqitur në tablën e mëposhtme:

Tabela 3 – Standardet Minimale të Procedimeve Disiplinore nga Raporti i RREKGJ⁵¹

1. Udhërrefyesit dhe/ose një kod sjelljeje/etike duhet të hartohet nga gjyqtarët ose nga një Këshill për Gjyqësorin. Anëtarët jo gjyqtarë mund të kërkohet të kontribuojnë duke këshilluar ose udhëzuar në lidhje me përmbajtjen e kodit apo udhërrefyesit.
2. Duhet të ketë një listë apo përshkrim të llojeve të sjelljeve etike/profesionale shkelja e të cilave është e papranueshme në secilin vend. Kjo listë apo ky përshkrim duhet të jetë në nivel kombëtar dhe jo në nivel Europian.
3. Një gjyqtar ka të drejtën e një jete private, por duhet të veprojë me nivelin më të lartë të integritetit në të dyja sferat në atë profesionale dhe atë private. Sjellja që mund të shkaktojë diskreditim të gjyqësorit, duhet të jetë objekt i procedimit disiplinor.
4. Duhet të eksizojë një organ kompetent i veçantë për të pranuar ankesat dhe për administrimin e tyre, i ndarë nga Ministria e Drejtësisë dhe që i përgjigjet vetëm Gjyqësorit.

standards_v_adopted_ga_june_2015.pdf

51 Standardet Minimale mbi sjelljen gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve, Rrjeti Europian i Këshillave për Gjyqësorin, Raporti 2014-2015, faqet 40-41.

<p>5. Normalisht një ankesë duhet të jetë e identifikueshme, megjithatë nëse një ankësë mund të paraqitet nga kushdo, duhe të ekzistojë një mekanizëm ose një procedurë e përshpjeguar nëpërmjet të cilës një ankesë mund të deklarohet e papranueshme ose mund të merret një vendim që ankesa të mos përparojë më tej. Procedura duhet të jetë nën kontrollin e një gjyqtari, një trupe gjyqtarësh ose një person që i përgjigjet drejtpërdrejt gjyqësorit.</p>
<p>6. Duhet të ekzistojë një person apo një trupë përgjegjëse e gjyqësori, e cila ka kompetencën të hetojë një ankesë. Hetimi duhe të përmbajë mundësinë e marrjes së provave me gojë ose me shkrim.</p>
<p>7. Personi apo trupa vendimmarrëse duhe të jetë e rregulluar me ligj. Kjo trupë duhet të jetë e përbërë nga një shumicë gjyqtarësh, dhe një gjyqtar ekspert dhe me përvojë në fushën e gjyqtarit nën hetim. Organi kompetent për disiplinën gjyqësore mund të jetë një Këshill kombëtar për Gjyqësorin (ose një komitet specifik apo departament brenda Këshillit Gjyqësor) ose një bord discipline kombëtar dhe i pavarur ose komitet i pavarur nga ekzekutivi apo gjyqësori.</p>
<p>8. Duhet të ketë një afat për paraqitjen e një ankese, i cili mund të zgjatet vetëm në rrethana përjashtimore.</p>
<p>9. Duhet të ketë një afat për mbylljen e hetimit, vendimmarrjen dhe vendosjen e sanksionit. Vendosja e çdo sanksioni duhe të merret menjëherë pas vendimit për themelin e çështjes dhe në çdo rast pa asnjë vonesë. Këto kufizime kohore mund të zgjaten vetëm në rrethana përjashtimore, siç mund të jenë kompleksiteti i hetimit, sëmundja e një gjyqtari apo një hetim penal paralel.</p>
<p>10. Është e padëshirueshme të publikohet emri i gjyqtarit përpara vendosjes së masës disiplinore. Kur vendoset sanksioni, gjykimi mund të publikohet ose jo (duke publikuar emrin e gjyqtarit ose jo).</p>
<p>11. Një gjyqtar mund të pezullohet vetëm në rastet më serioze dhe përjashtimore dhe kur është e nevojshme për administrimin e drejtësisë.</p>
<p>12. Nëse një gjyqtar është i pezulluar, duhet t'i jepet paga e plotë gjatë fazës së hetimit, përveç kur Gjyqtari shkakton vonesa apo nuk bashkëpunon gjatë hetimit ose dhe në rrethana të tjera përjashtimore. Ndonjë pagë e mbajtur gjatë fazës së hetimit do të ripaguhet në rast se më vonë vërtetohet se gjyqtari nuk e ka kryer shkeljen e pretenduar dhe nuk vendoset një masë disiplinore.</p>
<p>13. Një gjyqtar ka të drejtën të përfaqësohet nga një avokat ose të asistohet nga një i zgjedhur prej tij nëse ai/ajo e zgjedh këtë. Një gjyqtar i shpallur i pafajshëm duhe të jetë në gjendje të rikuperojë në mënyrë të arsyeshme shpenzimet e tij/saj ligjore gjatë procesit dhe kur është e përshtatshme nga Shteti.</p>

14. Të drejtat në vijim duhet t'i garantohen një gjyqtari që është subjekt i procedimit disiplinor: 1. Të jetë plotësisht i informuar për çështjen kundër tij/saj; 2. E drejta e përfaqësimit; 3. E drejta për tu paraqitur në çdo seancë dhe për tu dëgjuar dhe për të kërkuar prova me gojë ose me shkrim; 4. Të informohet menjëherë nëse një ankesë do të hetohet; 5. T'i jepet një kuadër kohor për hetimin e ankesës dhe për marrjen e vendimit; 6. Vendimi i marrë të jetë i arsyetuar; 6. E drejta e ankimimit.

15. Çdo sanksion duhet të jetë qartësisht i përcaktuar, i autorizuar nga ligji dhe proporcional në parim dhe zbatim në çështjen e dhënë.

16. Duhe të jetë e garantuar e drejta e ankimimit nga një gjykatë më e lartë, magjithëse kjo mund të mos jetë e zbatueshme për rastet e gjykatës më të lartë ose të legjislativit.

2.6. Opinionet e Komisionit të Venecias, të kërkuara nga autoritet shqiptare në kuadër të reformës në drejtësi⁵²

Ky seksion paraqet Opinionet e Komisionit të Venecias mbi reformën e drejtësisë Shqiptare, të dhëna gjatë viteve 2015-2020. Në mënyrë që të jenë të dobishme për qëllimet e Manualit, është paraqitur analiza e atyre pjesëve të opinionëve që përmbajnë rekomandime lidhur me sistemin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2.6.1. Opinionet e Komisionit të Venecias

Reforma thelbësore e sektorit të drejtësisë që po vazhdon në Shqipëri ka filluar me disa amendime të Kushtetutës së Shqipërisë. Me këto amendime të Kushtetutës, të cilat u miratuan nga Kuvendi në Korrik 2016, pushteti legjislativ filloi procesin e draftimit të një pakete të re ligjesh në lidhje me institucionet qeverisëse të gjyqësorit, statusit të magistratit, sistemin hetimor, Ligjet për Prokurorinë e Posaçme etj.

Komisioni i Venecias ka dhënë një sërë Opinionesh në lidhje me reformën në drejtësi në Shqipëri. Ato janë paraqitur kronologjikisht, duke filluar nga viti 2015 deri në vitin 2020, në tabelën 4 më poshte:

52 <https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?country=34&year=all>

Tabela 4 – Opinonet e Komisionit të Venecias mbi Reformën në Drejtësi në Shqipëri

VITI	OPINION NR.	TITULLI I OPINIONIT
2015	Opinion i Ndërmjetëm Nr 824/2015 ⁵³ CDL-AD(2015)045	<i>“Opinion i Ndërmjetëm mbi Draft Amendimet Kushtetuese në Gjyqësor në Shqipëri, i miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij Plenare të 105-të” (Venecia 18-19 Dhejtor 2015)”</i>
2016	Opinion Përfundimtar Nr. 824 / 2015 ⁵⁴ CDL-AD(2016)009-e	<i>“Opinion Përfundimtar mbi draftin e rishikuar të amendimeve mbi Gjyqësorin (15 Janar 2016) në Shqipëri, e miratuar në mbledhjen plenare të 106-të (Venecia, 11-12 Mars 2016)”.</i>
2016	Opinion Nr. 868/2016 ⁵⁵ CDL-AD(2016)036-e	<i>“Shqipëria – Prezantim Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese mbi Ligjin për Ri-vlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji për Vettingun), i miratuar në Mbledhjen Plenare të 109-të (Venecia 9-10 Dhjetor 2016)”</i>
2020	Opinion Nr. 978/2020 ⁵⁶ CDL-AD(2020)010	<i>“Shqipëria - Opinion mbi emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, e miratuar nga Komisioni i Venecias më 19 Qershor 2020 nga një procedurë me shkrim, e cila zëvendësoi Mbledhjen Plenare të 123-të.”</i>

2.6.2. Analiza e Komisioneve të Venecias

Komisioni i Venecias ka analizuar dy herë çështjet disiplinore në këndvështrim të amendimeve Kushtetuese, të cilat ju dërguan këtij Komisioni për vlerësim.

⁵³ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e)

⁵⁴ [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e)

⁵⁵ [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e)

⁵⁶ [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)010-e)

Amendimet e para të Kushtetutës janë objekt i analizës dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias, të dhëna në Opinionin e Ndërmjetëm Nr. 824/2015 të datës 18 Dhjetor 2015. Bazuar në këto rekomandime të Komisionit të Venecias një draft i dytë me amendimet të Kushtetutës u përgatit dhe u dërgua në Komision. Bazuar në këtë draft, Komisioni i Venecias hartoi Opininin Përfundimtar Nr. 824/2015.

Disa paragrafë të këtyre opinioneve janë të lidhura me statusin e magistratëve dhe përgjegjësinë disiplinore si dhe me organet disiplinore dhe institucionet e parashikuara në draft amendimet e kushtetutës në vitin 2015.

i. Opinioni i Ndërmjetëm

Në paragrafin 50 të Opinionit të Ndërmjetëm të Komisionit të Venecias, që trajton variantin e parë të Amendimeve Kushtetuese të cilat iu dërguan Komisionit të Venecias, janë ofruar disa mendime të rëndësishme lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Më konkretisht:

“Neni 29 përmend “përgjegjësinë disiplinore” e një gjyqtari por nuk përcakton se ky gjyqtar do të shkarkohet nga detyra për një shkeje të rëndë disiplinore. Në të njëjtën kohë Neni 31, i cili ndryshon Nenin 39 dhe është i zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative, parashikon se gjyqtari i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative mund të shkarkohet nga detyra si rezultat i një procedimi disiplinor. Është e kuptueshme që procedimet disiplinore mund të sjellin gjithashtu edhe shkarkimin e një gjyqtari të një niveli më të ulët, por kjo duhet të jetë e përcaktuar, veçanërisht në kuptim të Nenit 130 (i cili ndryshon Nenin 138) që deklaron se “koha e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve nuk mund të kufizohet”. Rekomandohet që dispozitat e sipërcituara të harmonizohen.”

Drafti final i amendimeve të Kushtetutës, të miratuara në Korrik 2016, përcakton se magistratët shkarkohen nga detyra në rast se kanë kryer një shkelje të rëndë disiplinore. Këto dispozita Kushtetuese janë detajuar më tej në Ligjin për Statusin, ku rregullohen shkarkimi i detyrueshëm dhe ai disckrecional.

Opinionin e Ndërmjetëm gjithashtu përmban një kapitull të veçantë (paragrafët 74-83) për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Më konkretisht, sipas paragrafit 75:

75. Komisioni i Venecias vëren se në vend të tre inspektoriateve që ekszistojnë aktualisht propozohet të krijohet një Inspektoriat i pavarur i cili do të përqëndrojë në duart e tij të gjitha funksionet hetimore. Në

terma praktikë kjo zgjidhje do të ekonomizojë burimet njerëzore dhe ato financiare dhe do ta theshtëztojë sistemin, kështu që ky duket të jetë një zhvillim pozitiv. Nga një këndvështrim më teorik, kjo zgjidhje është gjithashtu e pranueshme. Rrjedhimisht, Komisioni i Venecias që më herët vërejti se “sistemi [i cili] ofron ndarje të qartë të detyrave midis organit përgjegjës për hetimin (Këshilli i Lartë Gjyqësor) dhe organi i ngarkuar për të vendosur mbi aplikimin e një mase disiplinore (Bordi i Disiplinës) është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Bazuar në sa më lart, është e qartë se ndarja e funksioneve midis një organi/institucioni përgjegjës për hetimin disiplinor dhe një organi/institucioni përgjegjës për procedimin disiplinor që vendos masa disiplinore janë kosideruar si standarde ndërkombëtare që duhen ndjekur. Amendimet kushtetuese në fuqi dhe Ligji për Qeverisjen të miratuar në vitin 2016 i kanë respektuar këto standarde.

Sipas paragrafit 78:

78. “ILD është gjithashtu përgjegjës për “inspektimin” e gjykatave dhe prokurorëve. Nuk është e qartë se çfarë përfshin ky inspektim duke qënë se nuk është përmendur askund tjetër në Draft Amendime. Nuk është e qartë nëse është i njëjti “vlerësim” për të cilin është përgjegjës KLGJ. Komisioni i Venecias rekomandon që hetimi për shkeljet disiplinore të mbahet i ndarë nga çdo proces vlerësimi, i cili lidhet kyesisht me kompetencat sesa me shkeljet, dhe që shumë shpesh tregon për një keqfunksionim të sistemit më tepër sesa një shkelje individuale.”

Duke marrë në konsideratë këtë rekomandim të Komisionit të Venecias, amendimet Kushtetuese dhe kuadri i ri ligjor ka përcaktuar qartazi se inspektimet e gjykatave dhe të prokurorive përbëjnë një nga kompetencat thelbësore të ILD-së. Gjithashtu, është saktësuar se qëllimi i inspektimeve tematike është i ndryshëm nga qëllimi i “vlerësimit të performacës së gjykatave dhe prokurorive” e cila është kompetencë respektivisht e KLGJ-së dhe e Prokurorit të Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.

ii. Opinioni Përfundimtar

Opinioni Përfundimtar Nr. 824/2015 është dhënë nga Komisioni i Venecias, pas ndryshimit të draftit të parë të Kushtetutës së Shqipërisë, duke ndjekur rekomandimet e përcaktuara në Opinoinin e Ndërmjetëm.

Në Opinoinin Përfundimtar të Komisionit të Venecias janë përcaktuar rekomandime të rëndësishme, të cilat shërbyen për të përmirësuar sistemin disiplinor. Rekomandohet një dallim i qartë midis ILD-së dhe MD-së, kur bëhet fjalë për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve dhe

inspektimeve institucionale.

Së pari, në seksionin “Proçedimet disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve; regullat përkatëse të Minsitrisë së Drejtësisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” Komisioni i Venecias “mirëpret konstitucionalizmin” e kushteve për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, sa i përket gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.⁵⁷

Në të njëjtin kapitull, Komisioni i Venecias trajton kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku në paragrafin 29 të tij parashikohet:

29. “Në vijim të rishikimit të Draft Amendimeve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është më një organ kolegjal, por funksionet e inspektimit kryehen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (Inspektori ose ILD). Funksioni kryesor i inspektorit është të hetojë ankesat lidhur me shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve; megjithatë Drafti i rishikuar nuk e përcakton në mënyrë të qartë nëse inspektori lejohet të fillojë një hetimi edhe në mungesë të një ankese. Kjo duhe të saktësohet në Kushtetutë”.

Një rekomandim i ngjashëm është përcaktuar në paragrafin 30 sipas të cilit:

30. “Drafti i rishikuar duhet të specifikojë gjithashtu nëse “inspektimet” e gjykatave dhe prokurorëve (siç parashikohet në paragrafin 1 të Nenin 147/d) duhet të bëhen mbi bazën e një ankese ose me iniciativën e inspektorit. Është e paqartë se çfarë nënkupton një inspektim i tillë”.

Të dyja rekomandimet u morën në konsideratë në rishikimin përfundimtar të amendimeve kushtetuese dhe hapja e hetimit disiplinor kryesisht (*ex officio*) është tashmë e mirërregulluar nga Kushtetuta dhe nga Ligji për Statusin.

Siç u nënvizua edhe më lart, Komisioni i Venecias ka rishikuar dhe analizuar gjithashtu dispozitat e rishikuara të amendimeve Kushtetuese, që lidhen me ndarjen e kompetencave dhe pushtetit midis Minsitrisë së Drejtësisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo analizë mund të gjendet në paragrafët 31, 32, 33 të Opinionit Përfundimtar.

Opinionit përfundimtar tregon gjithashtu edhe parimet që duhet të udhëheqin proçedimin disiplinor. Sipas paragrafit 34 të Opinionit Përfundimtar, proçedimi disiplinor kundër gjyqtarëve do të bazohet në parimet të cilat garantojnë të drejtat e magjistratëve.

34 “Në këtë drejtim Komisioni i Venecias rithekson se proçedimi disiplinor kundër gjyqtarëve i bazuar tek sundimi i ligjit duhet t’i korrespondojë disa

⁵⁷ Komisioni i Venecias, Opinionit përfundimtar, Paragrafi 28.

parimeve bazike, të cilat përfshijnë parimet si vijon: masa ndëshkimore duhet të vijë si pasojë e shkeljes së një detyrimi të përcaktuar qartë në ligj; duhet të ketë një proces të rregullt ligjor kur palët të dëgjohen dhe gjyqtari të jetë i përfaqësuar; ligji duhet të përcaktojë shkallën e sanksionit; zbatimi i sanksionit duhet të jetë objekt i parimit të proporcionalitetit, duhet të garantohet e drejtat e ankimit tek një autoritet gjyqësor më i lartë.

Rekomandimi është marrë në konsideratë në Nenin 100 të Ligjit për Statusin, ku të gjitha këto parime janë listuar nga ligjvënësi. Gjithashtu, një sërë dispozitash ofrojnë garanci për zbatimin e parimeve gjatë procedimeve disiplinore.

Në përfundim, duhet nënvizuar se të dyja Opinionet, ai i Ndërmjetëm dhe ai Pëfundimtar nr. 824/2015 i ofrojnë ligjvënësit shqiptar rekomandime të qarta rreth reformimit të sistemit disiplinor për magjistratët në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këto rekomandime janë marrë parasysht në variantin përfundimtar të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara nga Kuvendi në Korrik 2016 dhe nga dy ligjet e reja, Ligji për Statusin dhe Ligji për Qeverisjen.

KAPITULLI III

ANALIZA DHE VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR TË SISTEMIT TË PËRGJEGJËSISË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË SHQIPËRI

3.1. Hyrje

Ky kapitull përmban një pasqyrim të përgjithshëm të sistemit të procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke u përqëndruar në analizën e njërit aspekt të tij dhe përkatësisht aspektin e hetimit disiplinor që ndiqet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ashtu siç shfaqet pas ndryshimeve të Ligjit për Statusin të ardhur si shkak i vendimit të Gjykatës Kushtetuese⁵⁸ (bashkëlidhur këtij manuali si Aneksi xx).

Në këtë kapitull do të trajtohen ndryshimet e Ligjit për Statusin që erdhën si pasojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe do të analizohet përputhshmëria e tyre si me vendimin e Gjykatës Kushtetuese ashtu edhe me standartet ndërkombëtare ekzistuese. Ky kapitull analizon gjithashtu parimet e hetimit disiplinor të rradhitura në nenin 100 të Ligjit për Statusin si dhe paraqet në mënyrë të përmbledhur fazat e hetimit disiplinor dhe kompetencat e ILD-së gjatë secilës fazë.

Kapitulli mbyllet me pasqyrimin e llojit të shkeljeve disiplinore dhe masave disiplinore kryesore dhe atyre plotësuese.

3.2. Risitë e sistemit disiplinor

3.2.1. Risitë Kushtetuese

Shqipëria ndërmorri një reformë gjithëpërfshirëse në drejtësi e cila filloi më 22 korrik 2016 kur Kuvendi miratoi ndryshime të rëndësishme të Kushtetutës në lidhje me sektorin e drejtësisë. Ndryshimet hynë në fuqi

⁵⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017.

më 11 gusht 2016 dhe janë pasuar nga miratimi i ndryshimit në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe shtatë ligjeve të reja që synojnë zbatimin e duhur të reformës kushtetuese.

Ndryshimi i parë i rëndësishëm kushtetues ka të bëjë me nenin 140 të Kushtetutës i cili parashikon përgjegjësinë disiplinore për të gjithë gjyqtarët dhe kriteret për shkarkimin dhe pezullimin nga detyra të gjyqtarëve. Në mënyrë të ngjashme, ligjvënësi ka miratuar një dispozitë të re kushtetuese, nenin 148/d i cili parashikon përgjegjësinë disiplinore të të gjithë prokurorëve dhe kriteret për shkarkimin dhe pezullimin nga detyra të prokurorëve. Sipas dispozitave **të reja**, vendimet e Këshillave për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të ankimueshme përpara Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, Kushtetuta parashikon përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit në Shqipëri, gjë e cila duhet të konsiderohet arritje e madhe e ndryshimeve të fundit ligjore.

Një ndër risitë e parashikuara nga ndryshimet kushtetuese është krijimi i një shërbimi të unifikuar inspektimi /Inspektori i Lartë i Drejtësisë⁵⁹, një organ i ri kushtetues, përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të inspektuar gjykatat dhe prokuroritë. Ky sistem do të zëvendësojë sistemin e mëparshëm të trefishtë të inspektimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. ILD-ja, si një organ i ri kushtetues i qeverisjes ka detyrimin të krijojë bazën për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit të ri ligjor që ka të bëjë me hetimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kushtetuta përcakton qartë të dyja fazat e procesit disiplinor: hetimi disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve do të bëhet nga ILD dhe procedimi disiplinor do të ndërmerret nga KLGJ ose KLP ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatësisht. Prandaj, organet vendim-marrëse për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve janë organet kolektive të qeverisjes, përkatësisht KLGJ dhe KLP. Përsa i përket ILD-së, ky organ i ri i qeverisjes është përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga të gjithë magjistratët. Ndarja e funksioneve gjatë procesit disiplinor konsiderohet një nga arritjet më të rëndësishme të reformës kushtetuese në fushën e drejtësisë dhe një risi që është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Bazuar në ndryshimet Kushtetuese për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë parashikuar një sërë institutesh të reja

59 Shih nenin 147/d, Kushtetuta.

ligjore, procedurash dhe kriteresh nëpërmjet ligjeve të reja, Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Qeverisjen.

3.2.2. Ligjet e reja që rregullojnë sistemin disiplinor

Pas ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi miratoi Ligjin për Statusin⁶⁰ më 6 tetor 2016 dhe Ligjin për Qeverisjen⁶¹ më 3 nëntor 2016. Duhet theksuar që në fillim se të dy ligjet rregullojnë aspekte të ndryshme të sistemit disiplinor:

Qëllimi i Ligjit për Qeverisjen është përcaktimi i parimeve dhe rregullave që orientojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës.

Qëllimi i Ligjit për Statusin është të përcaktojë statusin e magjistratëve duke parashikuar rregulla në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre; rekrutimin dhe emërimin; zhvillimin e karrierës dhe përfundimin e statusit të tyre; vlerësimin e performancës etike dhe profesionale; përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile.

i. Ligji për Qeverisjen

Bazuar në kuadrin kushtetues në lidhje me organet e reja të qeverisjes, ligji për qeverisjen shkon më tej me rregullimin e detajuar të organizimit, funksioneve, rregullave dhe procedurave të KLGJ, KLP, ILD, KED dhe SHM.

Në lidhje me organin e ri të qeverisjes, ILD-në, ligjvënësi në Shqipëri ka miratuar Pjesën IV të Ligjit për Qeverisjen, “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”, e përbërë nga katër kapituj; Kreu I “Dispozitat e Përgjithshme”, Kreu II “Statusi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kreu III “Inspektorët e ILD-së” dhe Kreu IV “Zyra e ILD-së” (neni 193- neni 216).

Sipas nenit 194⁶² Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha shkallëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjithashtu ligjvënësi përcakton qartësisht se ILD është i vetmi autoritet përgjegjës për hetimin disiplinor ndaj të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Dispozitat përkatëse ligjore përcaktojnë objektin e veprimtarisë të ILD-së

60 Ligji për statusin ka hyrë në fuqi më 22 nëntor 2016.

61 Ligji për qeverisjen ka hyrë në fuqi më 16 dhjetor 2016.

62 Shih nenin 194, Ligji për Qeverisjen.

duke filluar nga marrja dhe verifikimi i ankesës, për të vijuar me hetimin disiplinor dhe fillimin e procedimit disiplinor përpara Këshillit përkatës, KLGJ për gjyqtarët, dhe KLP për prokurorët.

ii. Ligji për Statusin

Ligji për Statusin synon të përcaktojë statusin e magistratëve duke parashikuar rregullat në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, rekrutimin, pranimin dhe emërimin, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale.

Përgjegjësia disiplinore, penale dhe civile e magistratëve rregullohet gjithashtu nga Pjesa V e këtij ligji, "Përgjegjësia Disiplinore, Penale dhe Civile". Kjo pjesë përbëhet nga gjashtë kapituj. Pesë prej tyre rregullojnë hetimin disiplinor, procedimin disiplinor, pezullimin e magistratëve gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor, ekzekutimin dhe regjistrimin e masave disiplinore. Nenet 100-157⁶³ janë dispozitat që mbulojnë të gjithë procesin, i cili do të zbatohet nga organet përgjegjëse për procedimindisiplinor të magistratëve.

Analiza e Pjesës V të Ligjit për Statusin, çon në konkluzionin që kuadri i ri ligjor në lidhje me hetimin disiplinor dhe procedimin disiplinor është përgatitur në mënyrë të detajuar dhe të plotë. Kriteret e reja, kërkesat, rregullat dhe procedurat janë parashikuar me ligj sipas kronologjisë së gjithë procesit. Kështu, interpretimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore lehtësohet nga ligjvënësi. Megjithatë, edhe dispozitat e detajuara ndonjëherë mund të krijojnë shkaqe për keqinterpretim. Për ta shmangur këtë, organet e reja të qeverisjes, pas krijimit të tyre, përgatisin aktet nënligjore të parashikuara në ligje, për të miratuar procedura standarde të punës dhe për të vendosur për rregullat e brendshme organizative të institucioneve. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se është e nevojshme që të ketë, që herët, një interpretim dhe zbatim uniform të dispozitave mbi hetimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga organet e qeverisjes që janë përgjegjëse për të kryer procedurat përkatëse. Gjithashtu, rekomandohet me vendosmëri, bashkëpunimi ndërmjet organeve të reja të qeverisjes për interpretimin e dispozitave ligjore të zbatueshme prej tyre.

Bazuar në ndryshimet kushtetuese, Ligji për Statusin prezanton një gamë të gjerë risish si, konceptetë reja, institute të reja ligjore, proceduradhe kërkesa të reja.

63 Vendimi nr. 34 datë 10.04.2017 shfuqizoi nenet 101-104të Ligjit për Statusin.

Arritjet kryesore të reformës legislative në lidhje me sistemin disiplinor të magistratëve janë përmbledhur më poshtë:

- Organet e reja qeverësise, të veçanta dhe të pavarura, parashikohen si organet përgjegjëse për hetimin dhe procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve: KLGJ, KLP, dhe ILD;
- Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve kanë përgjegjësi disiplinore;
- Anëtarët e Këshillave kanë përgjegjësi disiplinore;
- Legjislacioni rregullon të drejtat dhe detyrimet e magistratëve në hetim dhe procedim disiplinor në përputhje me parimin e një procesi të drejtë ligjor;
- Ankimimi kundër të gjitha vendimeve disiplinore rregullohet me ligj;
- Ligji parashikon që për çdo fazë të procesit disiplinor duhet të ketë vendime të arsyetuara dhe njoftimet përkatëse;
- Instituti i afatit të parashkrimit është reformuar në përputhje me standardet më të mira europiane;
- Ligji parashikon masa të ndryshme disiplinore, përfshirë masat shtesë disiplinore, të cilat jepen në përputhje me parimin e proporcionalitetit;
- Ligji parashikon qartësisht afatet kohore për çdo fazë të procesit disiplinor;
- Disa prej risive të parashikuara në ligj janë shtimi dhe ndryshimi i objektit të hetimit disiplinor, bashkimi i hetimit dhe procedimit disiplinor, marrëveshjet e përbashkëta të pranimit.

Pjesa më e madhe e dispozitave ligjore në lidhje me institutet e reja ligjore dhe kërkesat e parashikuara nga Ligji për Statusin mbi hetimin disiplinor janë komentuar nen për nen dhe janë përfshirë në Kapitullin 4 të këtij Manuali⁶⁴.

Gjithashtu në Aneksin XX bashkëlidhur këtij Manuali, pasqyrohen të gjitha nenet që kanë lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe me kompetencat e ILD-së..

3.3. Ndryshimet si pasojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese

3.3.1. Shfuqizimet

Në 10 Prill 2017, Gjykata Kushtetuese deklaroi në mospërputhje me Kushtetutën dhe si rrjedhojë shfuqizoi një sërë nenesh të Ligjit për Statusin, me anë të Vendimit nr. 34, datë 10.04.2017 (VGjK nr.34). Këto nene prekin procedimin disiplinor në tërësi dhe hetimin disiplinor në veçanti.

⁶⁴ Shih Komentet për nenet e ligjit për statusin, pjesa 2 e këtij Manuali

Nenet e shfuqizuara nga VGjK nr.34 të cilat kanë impakt në fazën e hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD-ja janë:

- i. Neni 101 mbi shkeljet disiplinore;
- ii. Neni 102 mbi shkeljet disiplinore në lidhje me hetimin e funksionit;
- iii. Neni 103 mbi shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;
- iv. Neni 104 mbi shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale;
- v. Neni 112 pika 1 mbi masat disiplinore plotësuese;
- vi. Neni 141 pika (1), shprehja “në masën që nuk çënon” dhe shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike⁶⁵.

Për secilin shfuqizim Gjykata Kushtetuese ka kryer analizën dhe ka dhënë aryestimin përkatës.

i. Shfuqizimi i Neneve 101, 102, 103 të Ligjit për Statusin

Për shfuqizimin e neneve 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Statusin, Gjykata Kushtetuese është bazuar në parimin e *sigurisë juridike* dhe në vlerësimin se paqartësia e formulimit të këtyre neneve çënon parimin e sigurisë juridike⁶⁶. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese është shprehur si më poshtë:

“73. Referuar neneve 101, 102 dhe 103, Gjykata konstaton se ato përmbajnë rregulla mbi përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale të magistratëve, duke rregulluar konkretisht shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë, shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit.

74. Nga analiza në tërësi e përmbajtjes së këtyre normave ligjore Gjykata vëren se mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet. Veçanërisht për shkak të rëndësisë që kanë për magistratin pasojat që sjell shkelja disiplinore (nga vërejtje konfidenciale, publike, ulje e përkohshme e pagës, ulje në detyrë, pezullim nga 3 muaj në 2 vjet, si dhe shkarkim), Gjykata vlerëson se terminologjia e përdorur dhe teknika legjislativë e hartimit të tyre, ngre dyshime serioze mbi kuptueshmërinë e ndryshme të tyre, çka mund të rezultojë në pasoja negative serioze për statusin e magistratit dhe përfitimet që lidhen me të”⁶⁷.

ii. Shfuqizimi i Neni 104 të Ligjit për Statusin

Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se ky nen ka parashikuar më

65 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017, dispozitivi i vendimit.

66 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017, paragrafi 76.

67 Po aty, paragrafet 73-74.

shumë raste shkarkimi të magjistratit sesa ato të përcaktuara në nenin 140 të Kushtetutës dhe e ka bërë këtë pa patur shprehimisht delegimin nga neni 140 i Kushtetutës. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese është shprehur si më poshtë:

“58. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ligjvënësi në nenet 104 dhe 152 ka parashikuar raste të tjera shkarkimi apo pezullimi për magjistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkueseve është i bazuar dhe duhet pranuar”⁶⁸.

iii. Shfuqizimi i Nenit 112 pika 1 e Ligjit për Statusin

Gjykata Kushtetuese ka përdorur parimin *ne bis in idem*. Ajo ka argumentuar se, masa disiplinore plotësuese e kthimit të pagës bruto të vitit të fundit në detyrë e parashikuar në pikën 1 të Nenit 112 të Ligjit për Statusin, ka një ashpërsi të tillë që përbën në thelb një dënim penal dhe si rrjedhojë është në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese është shprehur si më poshtë:

“115. Gjykata thekson se ashpërsia e masës disiplinore plotësuese me natyrë financiare në rastin konkret është e tillë sa ajo në thelb shndërrohet në dënim penal, që konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash e barabartë me pagën bruto të përfituar nga magjistrati i dënuar për veprën penale të korrupsionit gjatë vitit të fundit të ushtrimit të detyrës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se parashikimi njëkohësisht si nga Kodi Penal, ashtu dhe neni 112, pika 1, e ligjit i dy dënimeve penale për të njëjtin fakt bie ndesh me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë”⁶⁹.

iv. Shfuqizimi i Nenit 141 pika (1) e Ligjit për Statusin

Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e Nenit 141 pika (1), përkatësisht të shprehjes *“në masën që nuk cënon”* dhe shkronjave *“a”*, *“b”* dhe *“c”* të kësaj pike. Shfuqizimi i këtyre paragrafeve të nenit 141 është kryer nga Gjykata Kushtetuese bazuar në parimin e procesit të rregullt ligjor dhe përkatësisht në aspektin që parashikon të drejtën e aksesit në dosjen hetimore të subjektit të procedimit disiplinor. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese është shprehur si më poshtë:

“109. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, nisur nga rëndësia që paraqet respektimi gjatë procedimit disiplinor i parimeve të përcaktuara në nenin 100 të ligjit, vlerëson se shprehja e përdorur nga ligjvënësi në pikën 1 të

68 Po aty, paragrafi 58.

69 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017, paragrafi 115.

nenit 141 të ligjit “në masën që nuk cenon a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit” nuk siguron garancinë kushtetuese që buron nga e drejta për një proces të rregullt ligjor për mbrojtje efektive dhe barazi të armëve gjatë procedimit disiplinor të gjyqtarëve”⁷⁰.

3.3.2. Ndryshimet

Bazuar në shfuqizimet e VGjK nr. 34, me anë të Ligjit Nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (Ligji Nr.48/2019), ligjvënësi ndryshoi tekstin e neneve të shfuqizuara me qëllim përshtatjen e tyre me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese. Në tabelën më poshtë paraqitet teksti i neneve të sipërpërmendura përpara shfuqizimit nga VGjK Nr. 34 dhe pas ndryshimit të bërë me Ligjin Nr. 48/2019.

Tabela 5– Ndryshimet

LIGJI PËR STATUSIN	PËRPARA SHFUQIZIMIT	PAS NDRYSHIMIT
Neni 101	<p>Shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë</p> <p>1.Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste:</p> <p>a) kur vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;</p> <p>b) kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë, siç përcaktohet në treguesit e pikës 2, të këtij neni, ose dashjes, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale;</p> <p>c) në çdo rast tjetër që, në mënyrë të pajustificuar, kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që</p>	<p>Shkeljet disiplinore</p> <p>1.Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:</p> <p>a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyllje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;</p> <p>b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me</p>

70 Po aty, paragrafi 109.

	<p>diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.</p> <p>2. Pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Kufijtë midis çështjeve që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljeve të disiplinës nga magjistrati caktohen duke marrë në konsideratë këta tregues:</p> <p>a) shkallën e pakujdesisë;</p> <p>b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;</p> <p>c) pozicionin e magjistratit në sistem;</p> <p>ç) nëse fusha e ligjit, në të cilën magjistrati ushtron funksionin, vlerësohet si shumë e ndërlikuar, e re ose nuk është zhvilluar sa duhet nga jurisprudenca gjyqësore ose e prokurorisë;</p> <p>d) mundësinë e ardhjes së dëmit dhe intensiteti i pasojave të mundshme nga shkelja; si dhe</p> <p>dh) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me keqfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë si një i tërë.</p> <p>3. Në zbatim të këtij neni, shkeljet kryhen përmes veprimit dhe</p>	<p>dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.</p> <p>2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:</p> <p>a) shkalla e pakujdesisë;</p> <p>b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;</p> <p>c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;</p> <p>ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe</p> <p>d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.”</p>
--	---	--

	<p>mosveprimit të magjistratit. Magjistrati që kryhen, shkeljet disiplinore në veçanti në rastet e parashikuara në nenet 102 deri në 104, të këtij ligji, ka përgjegjësi disiplinore sipas këtij ligji.</p>	
Neni 102	<p>Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit</p> <p>1. Sipas parashikimeve të shkronjës “a” ose “b”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si më poshtë:</p> <p>a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit procedural, nëse magjistrati është ose vihet në dijeni të rrethanave të tilla;</p> <p>b) kërkesa e magjistratit për heqje dorë dhe miratimi i saj, sipas rastit, nga kryetari, nëse këto veprime:</p> <p>i) nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj;</p> <p>ii) bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose kur synojnë të shmangin magjistratin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga magjistratë të tjerë;</p> <p>iii) janë të vonuara në mënyrë të konside-rueshme;</p> <p>c) sjelljet, aktet dhe veprimet e tjera të magjistratit, të cilat, krijojnë përfitime të padrejta</p>	<p>Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit</p> <p>1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:</p> <p>a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyr ueshme, sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;</p> <p>b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim:</p> <p>i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;</p> <p>ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër;</p> <p>iii) nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;</p>

	<p>ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim/hetim ose ndjekja e objektivave, të cilat nuk kanë lidhje me detyrimet e magjistratit;</p> <p>ç) ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër i papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një magjistrati tjetër;</p> <p>d) përdorimi i parregullt i punës së të tjerëve për përmbushjen e detyrimeve ligjore, që i përkasin ushtrimit të funksionit të magjistratit ose delegimi tek të tretët i aktiviteteve të caktuara magjistratit;</p> <p>dh) mospërmbushja, në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur dhe të pajustificuar, përkatësisht, të funksioneve të gjyqimit ose hetimit, si dhe e detyrave të tjera që i caktohen magjistratit për shkak të funksionit të tij;</p> <p>e) vonesa dhe zvarritja e përsëritur dhe e pajustificuar e veprimeve procedurale dhe e nxjerrjes së akteve gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit.</p> <p>ë) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrë-dhëniet me pjesëmarrësit në proces, prokurorët, avokatët, dëshmitarët, ekspertët, subjektet e tjera të përfshira në proces, si edhe me kryetarin, kolegët dhe personelin e administratës gjyqësore;</p> <p>f) vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore.</p>	<p>c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magjistrati tjetër;</p> <p>ç) mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjyqimit ose hetimit;</p> <p>d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;</p> <p>dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;</p> <p>e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magjistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magjistratit;</p> <p>ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve;</p> <p>f) mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;</p> <p>g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;</p> <p>gj) moszbatimi pa shkaqe</p>
--	---	---

	<p>2.Sipas parashikimeve të shkronjave “a” ose “c”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ose në lidhje me ushtrimin e funksionit, brenda ose jashtë zyrës, janë në veçanti sjelljet dhe aktet e magjistratit si më poshtë:</p> <p>a) mospërbushja e pajustificuar e detyri-meve për të qenë i gatshëm dhe për t’u paraqitur në detyrë për nevojat e ushtrimit të funksionit pranë gjykatave ose prokurorive, nëse ky detyrim përcaktohet nga ligji ose nga vendimet e organeve kompetente;</p> <p>b) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorive, në lidhje me funksionet e magjistratit në gjykim ose hetim;</p> <p>c) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;</p> <p>ç) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;</p> <p>d) mospërbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyra për të garantuar përdorimin dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve;</p> <p>dh) shkelja e detyrimit të</p>	<p>të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;</p> <p>h) mospërbushja pa shkaqe të pajustificuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj;</p> <p>i) mosnjohimi nga magjistrati i kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;</p> <p>j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dënim për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;</p> <p>k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;</p> <p>l) mospërbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e</p>
--	--	--

	<p>konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezulton nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar, duke përfshirë lehtësimin për shkak të neglizhencës në bërjen publike ose shpërndarjen e informacioneve konfidenciale.</p> <p>e) bërja publike e mendimeve që kanë dhënë ose janë dhënë nga magjistratët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk ka marrë formën e një akti të bërë publik;</p> <p>ë) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të magjistratit të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij;</p> <p>f) mospërmbushja e kushteve shtesë për emërim për magjistratin që ushtron funksionin të gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;</p> <p>g) mospërmbushja në mënyrë të pajustificuar e detyrimit për të marrë pjesë të paktën në numrin e përcaktuar të veprimtarive të trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj.</p> <p>3. Sipas parashikimeve të shkronjës "a" ose "c", të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore janë në veçanti mosnjohjet nga ana e gjyqtarëve ose kryetarëve, si më poshtë:</p> <p>a) mosnjohimi i Këshillit nga magjistrati, lidhur me</p>	<p>lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;</p> <p>ll) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magjistrati ose magjistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;</p> <p>m) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij;</p> <p>n) mosnjohimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit;</p> <p>nj) mosnjohimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;</p> <p>o) mosnjohimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit;</p> <p>p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislationit në fuqi.</p> <p>2. Sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 1,</p>
--	--	---

	<p>ekzistencën e rasteve të papajtueshmërisë ambientale të magjistratit për ushtrimin e funksionit të tij, e veçanërisht në rastet e parashikuara në nenin 8, të këtij ligji, ose për shkaqe të mbarimit të mandatit;</p> <p>b) mosnjoftimi nga magjistrati i drejtuesit të gjykatës ose prokurorisë dhe Këshillit për ndërhyrjet ose ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga magjistratët e tjerë;</p> <p>c) mosnjoftimi nga magjistrati i drejtuesit të gjykatës ose prokurorisë dhe Këshillit, si edhe organeve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera;</p> <p>ç) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;</p> <p>d) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimet e funksionit, papajtueshmërisë ambientale të magjistratit për ushtrimin e funksionit të tij, dhe në lidhje me çështjet për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit.</p> <p>4. Sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet</p>	<p>të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si më poshtë:</p> <p>a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;</p> <p>b) parashtrimi i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra;</p> <p>?) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;</p> <p>ç) nxjerrja e akteve, ku pjesa përshkruese - arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të;</p> <p>d) marrja e vendimeve që lli m i s h t të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes;</p> <p>dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të</p>
--	---	---

	<p>disipli-nore gjatë ushtrimit të detyrës për veprimtaritë kryesore p ose që përmbajnë në arsyetim vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, të cilat të çojnë në ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;</p> <p>ç) nxjerrja e akteve ku pjesa përshkruese-arsyetuese parashtron arsyetime që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese të tij ose që nuk kanë lidhje me të;</p> <p>d) nxjerrja e akteve të cilat nuk lejohen nga ligji;</p> <p>dh) nxjerrja e akteve të paparashikuara nga dispozitat procedurale;</p> <p>e) nxjerrja e akteve për caktimin e masave të sigurimit personal, të ndryshme nga rastet e parashikuara nga ligji.</p> <p>5. Përveç parashikimeve në pikën 4, të këtij neni, zbatimi dhe interpretimi i këtij ligji nga magjistrati, ashtu si dhe vlerësimi i fakteve dhe provave në çështjet të hetuara nga ai nuk është objekt i procedimit disiplinor.</p>	<p>solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.”.</p>
<p><i>Neni 103</i></p>	<p>Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit</p> <p>Sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si vijon:</p> <p>a) anëtarësia në subjekte ose ushtrimi i veprimtarive, edhe</p>	<p>Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit</p> <p>Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:</p> <p>a) shkelja e rregullave</p>

	<p>të ligjshme, por që nuk janë në pajtim me detyrat dhe parimet e ushtrimit të rregullt të funksionit të magjistratit, të parashikuara në nenet nga 6 deri në 8 të këtij ligji;</p> <p>b) përdorimi i mandatit të magjistratit, me qëllim për të përfituar arritjen e përfitimeve të pajustificuara ose avantazhe për vete ose për të tjerët;</p> <p>c) pranimi dhe ushtrimi i detyrave dhe veprimtarive jashtë funksionit, në mungesë të lejes së miratuar për këtë qëllim, sipas ligjit, nga Këshilli;</p> <p>ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gja ku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve të biznesit të papërshtatshme me këta persona;</p> <p>d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpër-drejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit;</p> <p>dh) shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit, në veçanti në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit, sipas ligjit</p> <p>e) sjellja e papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në</p>	<p>të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji;</p> <p>b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;</p> <p>c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;</p> <p>ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;</p> <p>d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;</p> <p>dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të</p>
--	--	---

	<p>marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksio-narët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papër-shtatshme të pajustificuar.</p>	<p>prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.</p>
<p><i>Neni 104</i></p>	<p>Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale</p> <p>Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë:</p> <p>a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë;</p> <p>b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia;</p> <p>c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat "a dhe "b", të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë;</p> <p>ç) faktet e pranuar nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë</p>	<p>Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale</p> <p>1.Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.</p> <p>2.Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.</p> <p>3.Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra</p>

	<p>figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë vepër penale, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfituar nga falja dhe amnistia.</p>	<p>jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme.</p>
<p><i>Neni 112 pika 1</i></p>	<p>Masat disiplinore plotësuese</p> <p>1. Nëse magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e korrupsionit, Këshilli vendos përveç shkarkimit të magjistratit edhe kthimit të shumës së pagës bruto të vitit të fundit në detyrë të përfituar prej tij.</p>	<p><i>Shfuqizuar pa ndryshim</i></p>
<p><i>Neni 141 pika 1</i></p>	<p>Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor</p> <p>1. Gjatë procedimit disiplinor, magjistratit ose përfaqësuesit të tij u sigurohet akses në dosje në masën që nuk cenon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit. 	<p>Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor</p> <p>1. Gjatë procedurës disiplinore, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, Këshilli i siguron magjistratit kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.”</p> <p>1/1. E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë</p>

		<p>dhe dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:</p> <p>a) të drejtave themelore të një personi tjetër; ose</p> <p>b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose</p> <p>c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;</p> <p>ç) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor. E drejta e aksesit kufizohet për aq kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se Këshilli të marrë vendimin.</p>
--	--	---

3.3.3. Përputhshmëria e Ndryshimeve me VGjK nr. 34 dhe Standartet Ndërkombëtare

Siç u tha edhe më sipër, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se nenet 101, 102 dhe 103, cënonin parimin e *sigurisë juridike* për shkak të paqartësisë në formulim. Pavarësisht faktit se VGjK nr.34 nuk tregon specifikisht cilat formulime të neneve 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Statusin janë të paqarta, pas shfuqizimit të këtyre neneve, ligjvënësi ka miratuar tekstin e ri të tyre duke u përpjekur të shmangë të njëjtën paqartësi në formulim. Duke qënë se ndryshimet janë miratuar në vitin 2019, vit gjatë të cilit Gjykata Kushtetuese nuk ka qënë funksionale për shkak të mungesës së gjyqtarëve, teksti i ri i këtyre neneve nuk i është nënshtruar ende ndonjë shqyrtimi të kushtetueshmërisë. Gjithashtu për shkak se procedimet disiplinore kanë filluar vetëm së fundmi nuk ka ende një interpretim të këtyre neneve të krijuar nga praktika e zbatimit. Megjithatë më poshtë do të japim një vlerësim paraprak mbi tekstin e ri të këtyre neneve duke analizuar nëse, pas ndryshimeve të tyre janë më të qarta dhe nëse janë në përputhje me standartet ndërkombëtare që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.

i. Përputhshmëria e Nenit 101 të Ligjit për Statusin

Teksti i ri i nenit 101 të Ligjit për Statusin nuk përmban më shprehje të paqarta si *“sjellje të papërshtatshme”* ose si *“vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar”*. Në përgjithësi riformulimi i Nenit 101 të Ligjit për Statusin përdor një gjuhë më të qartë, më koncize dhe parametra ligjore.

Lind pyetja a është Neni 101 i Ligjit për Statusin në përputhje me standartet ndërkombëtare? Në komentarin e Parimeve të Bangalorit⁷¹, në pjesën në lidhje me disiplinën, pezullimin dhe shkarkimin përcaktohet se masat disiplinore të pezullimit dhe shkarkimit ndaj gjyqtarëve mund të merren vetëm për arsye të paaftësisë ose të sjelljeve që i bën ata të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin⁷². Gjithashtu parashikohet se masat disiplinore do të përcaktohen në përputhje me standarte të miratuara të sjelljes gjyqësore⁷³. Nevoja për të pastur standarte sjelljeve të magjistratëve mbi bazën e të cilave të kryhet vlerësimi i shkeljeve disiplinore theksohet sërish në Parimet e Bangalorit⁷⁴. E njëjta qasje pasqyrohet edhe dokumenta të tjera ndërkombëtare të cilat përmbajnë standarte për sistemin gjyqësor. P.sh Rrjeti Europian i Këshillave për Gjyqësorin⁷⁵ ka përcaktuar parimin se *“Gjyqtarët duhet të udhëhiqen nga parimet etike të sjelljes profesionale, të cilat përfshijnë detyra dhe përgjegjësi shkelja e të cilave që mund të ndëshkohet me masa disiplinore”*⁷⁶.

Gjithashtu, Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare ‘Për Pavarësinë, Efiçencën dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve’⁷⁷ (CM/Rec (2010) 12), ka parashikuar se veprimtaria e gjyqtarëve duhet të bazohet në parimet etike të sjelljes profesionale, se këto parime duhet të përmbliidhen në kode etike për hartimin e të cilave gjyqtarët duhet të kenë një rol drejtues⁷⁸.

Pra siç shihet qartë parimet ndërkombëtare për shkeljet disiplinore,

71 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct.

https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentary_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf

72 Po aty, Paragrafi 18.

73 Po aty, Paragrafi 19.

74 Po aty, Paragrafi 16.

75 www.encj.eu/office/encj.eu

76 ENCJ Report- Development of minimum judicial standards V 2014-2015, adopted The Hague 5 June 2015, page 17. https://www.encj.eu/images/stories/pdf/GA/Hague/encj_report_minimum_standards_v_adopted_ga_june_2015.pdf

77 Rekomandimi CM/Rec (2010) i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare ‘Për Pavarësinë, Efiçencën dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve’. <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilities-of-judges/16809f007d>

78 Po aty, Kapitulli VIII, Etika e Gjyqtarëve, paragrafet 72 dhe 73.

theksojnë se këto të fundit duhet të bazohen në rregullat e sjelljes etike dhe profesionale të magistratëve. Në këtë aspekt teksti i ri i Nenit 101 të Ligjit për Statusin është në përputhje me standartet ndërkombëtare pasi përmend si shkelje disiplinore sjelljet jo profesionale ose jo etike, mospërbushjen e detyrës, paaftësinë profesionale. Sipas neneve 61, paragrafi 2 gërma (ç) dhe 159, paragrafi 2 gërma (ç) Këshillat miratojnë rregullat e etikës për gjyqtarët dhe prokurorë, gjë që është sërish në përputhje me standartin ndërkombëtar. Vlen për t'u përmendur se rregullat e etikës nuk janë miratuar ende, pavarësisht faktet se procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë nisur të zhvillohen. Megjithatë Ligji për Statusin ka meritën që parashikon vetë, në nenet 102, 103 dhe 104 një listë të gjatë shkeljesh që përbëjnë një udhëzues të dobishëm për organet e procedimit disiplinor.

ii. Përputhshmëria e Nenit 102 të Ligjit për Statusin

Teksti i ri i nenit 102 të Ligjit për Statusin nuk përmban më shprehje të paqarta si *“ndjekja e objektivave, të cilat nuk kanë lidhje me detyrimet e magistratit”* ose si *“përdorimi i parregullt i punës së të tjerëve”* etj. Në përgjithësi riformulimi i Nenit 102 të Ligjit për Statusin përdor një gjuhë më të qartë, më koncize dhe përdor parametra ligjore.

Në lidhje me përputhshmërinë e Nenit 102 të Ligjit për Statusin me standartet ndërkombëtare mund të konsiderohet se për shkak të parashikimit të një liste të gjatë dhe të detajuar shkeljes, Neni 102 është në përputhje me standartet ndërkombëtare që kërkojnë ekzistencën në nivel kombëtar të një liste apo përkrahje të llojeve të sjelljeve etike/profesionale që përbëjnë shkelje disiplinore.

Në mospërputhje me standartin ndërkombëtar mund të jetë paragrafi 2 gërma (a) e Nenit 102 që parashikon se konsiderohet si shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit *“zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë”*. Kjo dispozitë bie ndesh me parimin ndërkombëtar të parashikuar nga CM/Rec (2010) 12 i cili shprehimisht thotë se *“Gjyqtarët nuk duhet të mbajnë përgjegjësi personale kur vendimi i tyre rrëzohet apo ndryshohet për shkak të ankimit”*⁷⁹.

iii. Përputhshmëria e Nenit 103 të Ligjit për Statusin

Teksti i ri i nenit 103 të Ligjit për Statusin nuk përmban më shprehje të paqarta si *“përdorimi i mandatit të magistratit, me qëllim për të përfutur*

⁷⁹ Rekomandimi CM/Rec (2010) 12, i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare 'Për Pavarësinë, Efiçencën dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Kapitulli VII, Detyra dhe Përgjegjësi, paragrafi 70. <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilities-of-judges/16809f007d>

arritjen e përfitimeve të pajustificuara”, “shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit” ose si “sjellje të papërshtatshme të pajustificuar”. Në përgjithësi riformulimi i Nenit 103 të Ligjit për Statusin përdor një gjuhë më të qartë, më koncize dhe që përmban parametra ligjore.

Përsa i përket përputhshmërisë me standartet ndërkombëtare duket se veprimet e përcaktuara si shkelje në nenin 103 janë në përputhje me standartet ndërkombëtare të tilla si paanshmëria e magjistratit⁸⁰ dhe shmangia e konfliktit të interesave dhe thyerjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor për shkak të veprimeve të magjistratëve.

iv. Përputhshmëria e Nenit 104 të Ligjit për Statusin

Siç u tha edhe mësipër, shfuqizimi i nenit 104 të Ligjit për Statusin, është bërë nga Gjykata Kushtetuese me argumentimin se pa pasur delegimin e Nenit 140 të Kushtetutës, neni 104 i Ligjit për Statusin ka shtuar edhe disa rastet të reja që çojnë në shkarkimin e magjistratit përtej atyre të parashikuara në nenin 140 të Kushtetutës.

Rastet e shkarkimit të parashikuara nga Neni 140 i Kushtetutës për gjyqtarët (dhe nga Neni 148/d i Kushtetutës për prokurorët), janë shkeljet e rënda etike ose profesionale që diskretitojnë figurën e magjistratit ose dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Për të adresuar gjetjet e Gjykatës Kushtetuese teksti i ri i nenit 104 të Ligjit për Statusin, teksa rradhit shkeljet disiplinore për kryerjen e një vepre penale, parashikon shprehimisht se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra do të jepet vetëm për dënimin me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Kështu neni 104 i Ligjit për Statusin është në përputhje me Kushtetutën dhe me gjetje e VGJK nr. 34.

Përsa i përket përputhshmërisë me standartet ndërkombëtare mund t'i referohemi parimeve të Bangalorit që parashikojnë se gjyqtarët janë subjekt i masave disiplinore të pezullimit ose shkarkimit vetëm për arsye të paaftësisë ose sjelljes që i bën të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin⁸¹. Bazuar në këtë parim mund të thuhet se parashikimi i Nenit 104 të Ligjit për Statusin është në përputhje me standartet ndërkombëtare pasi kryerja e një krimi nga magjistrati dëshmon se ky i fundit ka një sjellje që e dëshmon të paaftë për të kryer funksionin që kërkon një nivel të lartë integriteti.

80 Rekomandimi CM/Rec (2010) 12, i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare ‘Për Pavarësinë, Efiçencën dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Kapitulli VII, Detyra dhe Përgjegjësi, paragrafi 60.

81 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafi 18, faqja 35.

v. Përputhshmëria e Nenit 112 pika 1 e Ligjit për Statusin

Siç u tha edhe më sipër, shfuqizimi i nenit 112 pika 1 e Ligjit për Statusin, është bërë nga Gjykata Kushtetuese me argumentimin se masa disiplinore plotësuese e kthimit të pagës bruto të vitit të fundit në detyrë e parashikuar nga ky nen përbën në thelb një dënim penal dhe si rrjedhojë është në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*. Teksti i ri i Nenit 112 të Ligjit për Statusin e ka shfuqizuar tërësisht pikën 1 duke e hequr këtë dënim plotësues. Kështu Neni 112 i Ligjit për Statusin është tashmë në përputhje edhe me gjetjet e VGJK nr. 34 edhe me standartet ndërkombëtare dhe përkatësisht me parimin e të drejtës për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë të parashikuar edhe nga Neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

vi. Përputhshmëria e Nenit 141 pika 1 e Ligjit për Statusin

Siç u tha edhe më sipër, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e Nenit 141 pika (1) të Ligjit për Statusin, i cili kufizonte aksesin në dosje të magjistratit subjekt të procedimit disiplinor duke konstatuar se kjo ishte në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor. Pas ndryshimeve neni 141 është riformuluar tërësisht. Pika 1 e tij përcakton se magjistrat subjekt i procedimit disiplinor ka të drejtën e aksesit në dosje. Ndërsa pika e re 1/1 përcakton kufizimin e kësaj të drejte por në ndryshim me tekstin e vjetër përcakton disa parametra ligjore më të qarta në lidhje me rastet e kufizimit.

E drejta e aksesit në dosje është një nga parimet e procesit të rregullt ligjor dhe është standard ndërkombëtar që procedimi disiplinor ndaj magjistratëve duhet të zhvillohet në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor. Përkatësisht kjo parashikohet si nga Parimet e Bangalorit që parashikon se gjyqtarët kanë të drejtën e procesit të rregullt ligjor⁸² ashtu edhe nga Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i cili parashikon se procedimi disiplinor duhet të zhvillohet sipas rregullave të procesit të rregullt ligjor⁸³.

3.4. Parimet e hetimit disiplinor

Neni 100 i Ligjit për Statusin përmban parimet që duhet të udhëheqin procedimin disiplinor në tërësi. Meqënëse objekti i këtij Manuali është i kufizuar vetëm në fazën e hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD, parimet

82 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafi 17.

83 Rekomandimi CM/Rec (2010) 12, i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare 'Për Pavarësinë, Efiçencën dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Kapitulli VII, Detyra dhe Përgjegjësi, paragrafi 69.

e nenit 100 do të komentohen vetëm në aspektin e zbatueshmërisë së tyre gjatë fazes së hetimit disiplinor nga ILD. Si rrjedhojë disa parime mund të jenë të zbatueshme në mënyrë të kufizuar ose mund të mos jenë fare të zbatueshme gjatë fazës së hetimit disiplinor.

3.4.1. E drejta për një proces të rregullt

Neni 100, paragrafi 1, gërma (a) e Ligjit për Statusin parashikon se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm”*

Lind pyetja çfarë përfshihet në parimin e procesit të rregullt dhe si zbatohet ky parim gjatë procedurave hetimore të ndjekura nga ILD?

E drejta për një proces të rregullt⁸⁴ parashikohet në nenin 31 të Kushtetutës⁸⁵. Ajo parashikohet gjithashtu në nenin 6 të KEDNJ-së, konventë në të cilën Shqipëria është palë për shkak të ratifikimit të traktatit dhe për shkak të nenit 17 të Kushtetutës⁸⁶, që parashikon se për interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen standardet e KEDNJ-së. Si pasojë, për interpretimin e të drejtës së procesit të rregullt të zbatueshëm edhe gjatë fazës së hetimit disiplinor nga ILD-ja, do të zbatohen standardet e KEDNJ-së siç janë interpretuar gjerësisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) përmes disa vendimeve.

84 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (criminal limb), paragraph 137, updated on 31 August 2020 ; and Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (civil limb), paragraph 283, updated on 30 April 2020.

85 Kushtetuta, Neni 31: *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”*

86 Kushtetuta, Neni 17: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Vlen të përmendet shkurtimisht se e drejta e procesit të rregullt zbatohet si për procesin civil ashtu edhe për procesin penal. Disa të drejta procedurale të procesit të rregullt zbatohen njësoj për të dyja llojet e proceseve, ndërsa disa të drejta procedurale janë sepcifike. GJEDNJ-ja ka konsideruar që procedurat disiplinore përfshihen në aspektin civil të procesit të rregullt. Megjithatë parimet dhe procedurat e procesit të rregullt që zbatohen gjatë fazës së hetimit disiplinor, rregullohen në mënyrë të ngjashme si në aspektin civil ashtu edhe në aspektin penal të procesit të rregullt.

E drejta e procesit të rregullt përfshin të drejtën procedurale të palëve për të paraqitur *komente* dhe *vërejtje* gjatë të gjitha fazave të procedimit.

E drejta e procesit të rregullt përfshin gjithashtu të drejtën e *kontradiktoritetit*. *Parimi i kontradiktoritetit* do të thotë mundësia që i jepet palëve të procedimit të kenë dijeni dhe të japin komentet e tyre mbi të gjitha provat e marra ose mbi deklaratimet e bëra. Ky parim përkthehet në të drejtën procedurale të *zbardhjes së provave* the të *barazisë së armëve*.

Zbardhja e provave është një e drejtë e njohur nga GJEDNJ-ja e cila vlen si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale. Ka një rëndësi të veçantë në hetimin penal ku kërkohet që *“autoritetet e ndjekjes penale i zbardhin mbrojtjes të gjitha provat materiale në posedim të tyre që janë në favor ose në dëm të të akuzuarit”*⁸⁷. I njëjti parim vlen edhe në çështjet civile ku ekziston e drejta për bërjen e ditur të provave⁸⁸ që mund të kufizohet vetëm për arsye madhore (të tilla si siguria; mbrojtja e dëshmitarëve⁸⁹ etj.).

Barazia e armëve nënkupton që secilës palë duhet t’i jepet e njëjta mundësi për të paraqitur çështjen, përfshirë provat dhe se asnjë palë nuk duhet të jetë në disavantazh në krahasim me palën tjetër⁹⁰. Është e kuptueshme se si kjo e drejtë është e lidhur në mënyrë të ngushtë me të drejtën e zbardhjes së provave që është në fakt një *kusht i domosdoshëm (condicio sine qua non)* për realizimin e parimit të barazisë së armëve.

Si përfundim në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD, të drejtat procedurale të magjistratit subjekt i hetimit, bazuar në procesin e rregullt ligjor janë:

87 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (criminal limb), paragraph 159, updated on 31 August 2020.

88 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (civil limb), paragraph 365-366, updated on 30 April 2020.

89 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (criminal limb), paragraph 162, updated on 31 August 2020

90 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (civil limb), paragraph 347, updated on 30 April 2020.

- *E drejta e magjistratit për të paraqitur komentet dhe vërejtjet e tij / saj para ILD-së.*
- *E drejta e magjistratit që ILD t'i zbardhë të gjitha provat pro ose kundër, të përftuara gjatë hetimit disiplinor (përveç rastit kur ka arsye madhore që e pengojnë zbardhjen), në mënyrë që magjistrati të ketë të njëjtën mundësi si ILD-ja për të prezantuar dhe mbrojtur çështjen e tij / saj përpara Këshillave.*

Përsa i përket parimit tjetër të parashikuar në Nenin 100, paragrafi 1, gërma (a) – marrja e vendimit brenda një kohe të arsyeshme – ky parim nuk zbatohet gjatë hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD për të cilin Ligji për Statusin ka parashikuar afate të ngushta specifike.

3.4.2. Ligjshmëria

Neni 100, paragrafi 1, gërma (b) e Ligjit për Statusin parashikon se:

- “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:*
- b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;*

Siç mund të vërehet parimi i ligjshmërisë përmban dy parime: parimi i ‘detyrimit për të hetuar’ dhe parimi *mosdënimit pa ligj*’. Për shkak të specifikës së tyre, të dy parimet do të adresohen veçmas më poshtë:

i. Detyrimi për të hetuar

Detyrimi për të hetuar parashikohet nga Ligji për Statusin edhe si parim (i parashikuar në Nenin 100 këtu) edhe si një hap specifik procedural i parashikuar në Nenin 123 dhe 124 të Ligjit për Statusin (analizuar në mënyrë të thelluar në Kapitullin IV të këtij Manuali). Siç parashikohet nga ligjvënësi, ky detyrim zbatohet kur ILD-ja ka ‘shkaqe të mjaftueshme për të besuar’ se ka ndodhur një shkelje disiplinore.

Koncepti i shkakut të mjaftueshëm nuk përkufizohet nga Ligji për Statusin ose nga ndonjë pjesë tjetër e legjislacionit. Ai i ngjan me konceptet ‘shkak i arsyeshëm’ dhe ‘dyshimi i arsyeshëm’. Megjithatë mund të interpretohet se koncepti i ‘mjaftueshëm’ kërkon një shkallë më të ulët provueshmërie se koncepti i ‘arsyeshëm’. Në çdo rast, për interpretimin e detyrimit për të hetuar të ILD-së ne do të zbatojmë konceptin e ‘dyshimit të arsyeshëm’ i cili është ai i kërkuar për fillimin e hetimit të ILD-së si në nenin 123 ashtu edhe në nenin 124 të Ligjit për Statusin (*ju lutemi shikoni analizën më poshtë*

në paragrafin e artikujve përkatës).

Çfarë kuptimi ka koncepti i ‘dyshimit të arsyeshëm’? Interpretimi i këtij parametri ligjor është shumë i rëndësishëm pasi është baza mbi të cilën ILD do të fillojë hetimin disiplinor kundër magjistratit. Duhet të kemi parasysh se i gjithë institucioni i përgjegjësishëm disiplinore të magjistratit ka të bëjë ngushtësisht me pavarësinë e magjistratit, prandaj interpretimi i saktë i detyrimit për të hetuar është po aq i rëndësishëm. Në përgjithësi standardet ndërkombëtare kërkojnë që masa disiplinore ndaj magjistratëve të merret në rast të shklejes së rëndë⁹¹. Sidoqoftë nuk ka udhëzime të qarta ndërkombëtare që interpretojnë konceptin e ‘dyshimit të arsyeshëm’ që krijon detyrimin për të hetuar kundër magjistratit.

Një analizë e thelluar e këtij koncepti jepet nga disa vendime të GJEDNJ-së të cilat gjykojnë rastet e shkeljeve të nenit 5 të KEDNJ-së për të drejtën për liri dhe siguri⁹² dhe specifikisht ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të një personi. Duhet të mbajmë parasysh se parimi i ‘dyshimit të arsyeshëm’ në kontekstin e arrestimit ose ndalimit duhet të interpretohet në mënyrë më të ngushtë, sesa kur ky parim zbatohet për fillimin e procedimit disiplinor. Kjo për shkak të ndryshimit thelbësor mes dy procesve, gjatë procedimit penal është në diskutim liria fizike e një personi ndërsa gjatë procedimit disiplinor magjistrati, në pjesën më të madhe të rasteve, magjistrati nuk i nënshtrohet masave paraprake. Sidoqoftë, koncepti siç interpretohet nga GJEDNJ-ja na ofron një udhëzues të dobishëm, që mund ta përdorim për të interpretuar konceptin e ‘dyshimit të arsyeshëm’ të zbatueshëm ndaj detyrimit të ILD-së për të filluar hetimin disiplinor.

Pas sqarimit të mësipërm, koncepti i ‘dyshimit të arsyeshëm’ i shtjelluar nga GJEDNJ-ja përmban elementet e mëposhtëm:

- a. Arsyeshmëria e dyshimit varet nga rrethanat, megjithatë termi ‘i arsyeshëm’ tregon prapësinë që dyshimi duhet të përmbushë⁹³;
- b. Një dyshim është i arsyeshëm kur ekzistojnë fakte ose informacione

91 OSCE – ODHIR, “Note on international standards and good practices of disciplinary proceedings against judges”, Ms. Alice Thomas, Par. 33, page 15, Warsaw, 27 December 2018. https://www.osce.org/files/341_JUD_KAZ_27Dec2018_en.pdf

92 KEDNJ, Neni 5, paragrafi 1, gërma (c) parashikon: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një veprë penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një veprë penale ose të largohet pas kryerjes së saj”.

93 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 5 of the Convention, Right to liberty and security, paragraph 90, page 21, updated on 31 August 2020. https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_5_eng.pdf

- që do të kënaqnin një vëzhgues objektiv që personi mund të ketë kryer një shkelje⁹⁴;
- c. Faktet që ngrenë dyshimin nuk ka nevojë të jenë në të njëjtin nivel me ato që justifikojnë dënimin⁹⁵ që do të thotë se këto fakte mund të jenë të një niveli më të ulët;
 - d. Për të justifikuar një “dyshim të arsyeshëm” mjafton të kemi elementë të mjaftueshëm objektivë që faktet në fjalë kanë ndodhur me të vërtetë⁹⁶;
 - e. Së fundmi, faktet që krijojnë dyshimin e arsyeshëm duhet të përbëjnë një sjellje kriminale⁹⁷ (*sjellje kriminale në kontekstin e procedimit penal, shkelje disiplinore në kontekstin e hetimit disiplinor*).

Bazuar në sa më sipër, në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, detyrimi i ILD-së për të hetuar do të lindë kur:

Elementet objektive, ose informacioni, ose faktet në dispozicion të ILD-së, kur vlerësohen në mënyrë të arsyeshme si një vëzhgues objektiv, të bëjnë të besosh se magjistrati ka kryer një nga shkeljet disiplinore të parashikuara në nenet 101, 102, 103 dhe 104 të Ligjit të Statusit . Në terma praktikë kjo mund të paraqitet me shembujt e mëposhtëm:

- ✓ *ILD duhet të fillojë hetimin disiplinor kur merr njoftimin e dënimit të një magjistrati, me vendim përfundimtar, për një nga veprat penale të korrupsionit të parashikuara nga KP, e cila është një shkelje disiplinore sipas Nenit 104 të Ligjit për Statusin. Ky është një rast i lehtë sepse vendimi përfundimtar nuk është vetëm një fakt, por përbën tashmë një provë që nuk lë vend për asnjë dyshim.*
- ✓ *ILD duhet të fillojë hetimin disiplinor kur i vihen në dispozicion elemente objektive ose fakte që një magjistrat po kryen veprimtari të paguar jashtë funksionit (p.sh. pamjet video të një magjistrati që mban mësim në një universitet privat), pa marrë miratimin e mëparshëm të Këshilli përkatës, gjë që përbën një shkelje disiplinore sipas Nenit 103 të Ligjit për Statusin. Në këtë rast ILD nuk ka prova që magjistrati po paguhej nga Universiteti, megjithatë është e arsyeshme të bëhet ky supozim dhe të nisët hetimi disiplinor për të verifikuar këtë fakt.*

ii. Mosdënimi pa ligj

Parimi i mosdënimit pa ligj (*nullum crimen, nulla poena sine lege*) është një nga parimet thelbësore të sundimit të ligjit. Ky parim është parashikuar

⁹⁴ Po aty paragrafi 88.

⁹⁵ Po aty, paragrafi 89.

⁹⁶ Po aty, paragrafi 90.

⁹⁷ Po aty, paragrafi 90, fq. 22.

në Nenin 29 të Kushtetutës⁹⁸ dhe në Nenin 7 të KEDNJ-së⁹⁹. Ky parim përfshin parimet e mëposhtme:

- i. Parimin që vetëm ligji mund të përcaktojë një vepër penale dhe një dënim penal¹⁰⁰;
- ii. Parimin që e drejta penale nuk është retroaktive në kuptimin që një person nuk mund të dënohet për një sjellje e cila në momentin e kryerjes nuk ishte vepër penale;
- iii. Parimi se ligji penal nuk duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, në dëm të një personi të akuzuar, për shembull me analogji.

Së pari duhet vënë në dukje se sipas interpretimit të GJEDNJ-së, parimi i mosdënimit pa ligj nuk zbatohet në kontekstin e procedurave të hetimit., Në fakt GJEDNJ-ja ka përcaktuar se neni 7 i Konventës zbatohet vetëm kur personi është shpallur fajtor dhe se ky parim nuk përfshin çështjet e ndjekeve penale të papërfunduara¹⁰¹.

Si rrjedhojë, e vetmja mënyrë se si mund ta përdorim këtë parim gjatë fazës së hetimit disiplinor është të themi që hetimi disiplinor duhet të fillojë vetëm për ato sjellje të cilat renditen si shkelje disiplinore nga Ligji për Statusin dhe që ishin parashikuar si të tilla në çastin e kryerjes së shkeljes disiplinore të magjistratit.

3.4.3. Parimi i Akuzës

Neni 100, paragrafi 1, gërma (c) e Ligjit për Statusin parashikon se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar*

98 Kushtetuta, Neni 29: “1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. 3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.”

99 KEDNJ, Neni 7: “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.”

100 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 7 of the Convention – No punishment without law, paragraph 2, page 5, updated on 31 August 2020.

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_7_ENG.pdf

101 Ibid, paragraph 3, page 6.

duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore”.

Parimi i akuzës është një parim i cili zakonisht përdoret për ndjekjen penale. Në kuadër të ndjekjes penale ky parim përfshin detyrimin e organeve hetuese për të filluar ndjekjen penale sa herë që marrin dijeni për kryerjen e një vepre penale. Sistemet penale ndahen në sisteme penale që parashikojnë parimin e akuzës (ndjekjen e detyrueshme penale të çdo vepre penale) siç është p.sh Italia¹⁰² dhe sisteme penale të cilat ja lënë në dorë organit të akuzës që të vlerësojë nëse në rastin konkret është e dobishme nisja e ndjekjes penale për një vepër penale të caktuar (parimi i oportunitetit) siç është p.sh Anglia¹⁰³.

Pra Neni 100, paragrafi 1, gërma (c) e Ligjit për Statusin ka huazuar parimin e akuzës nga procedura e ndjekjes penale dhe e ka përshtatur dhe përfshirë atë në kuadër të procedimit disiplinor të magjistratëve. Bazuar në këtë parim, ligji kërkon nga çdo institucion apo zyrtar shtetëror, pa përjashtim, që të veprojë kryesisht duke paraqitur ankesë kundër një shkeljeje disiplinore të një magjistrati, sa herë që ka prova të mjaftueshme për këtë.

Së pari duhet vënë në dukje se ky parim e zgjeron numrin e institucioneve të cilat kanë detyrimin të paraqesin ankim tek ILD sipas nenit 119 të Ligjit për Statusin (Ministri i Drejtësisë; një anëtar i Këshillit; kryetari i gjykatës ose i prokurorisë). Tashmë, për shkak të këtij parimi, çdo institucion dhe çdo zyrtar shteti ka detyrimin të paraqesë ankim tek ILD për shkeljet disiplinore të magjistratit.

Së dyti duhet analizuar domethënia e shprehjes ‘prova të mjaftueshme për të besuar që ka një shkelje disiplinore’. Këtu duhet vënë në dukje se parimi i akuzës kërkon një nivel më të lartë provueshmërie sesa parimi i detyrimit për të hetuar nga ILD, analizuar më sipër. Në rastin e këtij të fundit mjaftonte vetëm ‘dyshimi i arsyeshëm’ ndërsa në rastin e parimit të akuzës standarti i kërkuar është ai i ‘provës’ që është një shkallë më lartë sesa dyshimi.

Bazuar në sa më sipër, në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, parimi i akuzës do të thotë se:

102 Neni 112 i Kushtetutës Italiane parashikon: “Prokurori ka detyrimin të kryejë ndjekjen penale”.

103 Sipas Kodit për Prokurorët e Kurorës, Prokurorët e Anglisë dhe Uellsit, kanë diskrecion të gjerë të vendosin nëse do të nisnin apo jo procedimin penal.
<https://www.cps.gov.uk/publication/code-crown-prosecutors>

Çdo institucion shtetëror apo funksionar publik ka detyrimin të paraqesë një ankesë tek ILD për shkeljen disiplinore të një magjistrati sa herë që ka prova të mjaftueshme se magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore. Në terma praktikë kjo mund të paraqitet me shembujt e mëposhtëm:

- Përfaqësuesi ligjor i një Ministrie (zyrtar publik), i cili gjatë një procesi gjyqësor konstaton se gjyqtari nuk paraqet kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kur plotësohen kushtet e parashikuara nga Neni 72 i KPrC, ka detyrimin të paraqesë kundër gjyqtarit në fjalë, ankesë për shkeljen disiplinore të parashikuar nga Neni 102, paragrafi 1, gërma (a) e Ligjit për Statusin.
- Një funksionar publik, i cili vjen në dijeni të ekzistencës së një dënimi penal të formës së prerë ndaj një magjistrati, ka detyrimin të paraqesë kundër magjistratit në fjalë, ankesë për shkeljen disiplinore të parashikuar nga Neni 104 i Ligjit për Statusin.

3.4.4. Parimi i barazisë para ligjit

Neni 100, paragrafi 1, gërma (ç) e Ligjit për Statusin parashikon se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
ç) parimin e barazisë para ligjit”.*

Parimi i barazisë përpara ligjit përkthehet në parimin e trajtimit të njëjtë në një situatë të njëjtë. Është një parim i përgjithshëm, i zbatueshëm për të gjithë qytetarët që mund të përfshihet në parimin e mos-diskriminimit. Ky parim parashikohet në Nenin 18 paragrafi i dytë i Kushtetutës¹⁰⁴ si edhe nga Neni 14¹⁰⁵ i KEDNJ-së.

Megjithatë në kontekstin e hetimit disiplinor të cilit i referohemi këtu, ky parim mund të interpretohet edhe si parimi i barazisë së armëve të subjektit disiplinor nga njëra anë dhe ILD-së nga ana tjetër. Siç u analizua edhe më sipër, parimi barazisë së armëve, është një nga elementet e parimit të procesit të rregullt që vesh subjektin e hetimit disiplinor me një sërë të drejtash procedural të përmendura po më sipër (shiko paragrafin 3.1).

¹⁰⁴ Kushtetuta, Neni 18, paragrafi 2: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”

¹⁰⁵ KEDNJ, Neni 14, Ndalimi i Diskriminimit: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

3.4.5. Prezumimi i pafajësisë dhe dyshimi në favor të magjistratit

Neni 100, paragrafi 1, gërmat (d) dhe (dh) të Ligjit për Statusin parashikojnë se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
d) prezumimin e pafajësisë”;
dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor”.*

Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe parimi i dyshimit në favor të të akuzuarit - *in dubio pro reo* - janë dy parime tipike të së drejtës penale që janë marrë nga kjo fushë dhe janë përfshirë nga ligjvënësi si parime që i përkasin edhe procedimit disiplinor. Parimi i prezumimit të pafajësisë është një parim i parashikuar nga Neni 30 i Kushtetutës¹⁰⁶ si edhe nga Neni 6 paragrafi 2 i KEDNJ-së¹⁰⁷. Ndërsa sipas GJEDNJ-së, parimi i dyshimit në favor të të akuzuarit është një *‘shprehje sepçifike e parimit të prezumimit të pafajësisë’*.¹⁰⁸ Nëpërmjet një sërë vendimesh GJEDNJ ka zbërthyer të dy këto parime dhe të drejtat procedurale që rrjedhin prej tyre. Më konkretisht GJEDNJ-ja ka përcaktuar se prezumimi i pafajësisë kërkon që anëtarët e trupit gjykues nuk duhet të fillojnë procedimin me paragjykimin se i akuzuari e ka kryer shkeljen për të cilën akuzohet, se barra e provës bie mbi akuzën dhe se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të akuzuarit¹⁰⁹.

Nga parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të dyshimit në favor të të akuzuarit rrjedhi disa të drejta procedurale të cilat shtjellohen shkurtimisht më poshtë.

i. Barra e provës

Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që barra e provës të bjerë mbi organin e akuzës. Sipas interpretimit të GJEDNJ-së kjo do të thotë që organi i akuzës ka detyrimin të informojë të akuzuarin për akuzën kundër tij në mënyrë që ky i fundit të përgatisë dhe paraqesë mbrojtjen¹¹⁰.

106 Kushtetuta, Neni 30: *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.”*

107 KEDNJ, paragrafi 2: *“Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.*

108 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (criminal limb), paragrafi 360, updated on 31 August 2020. https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_6_criminal_eng.pdf

109 Po aty, paragrafi 317.

110 Po aty, paragrafi 368.

GJEDNJ-ja ka theksuar se nëse të akuzuarit i lihet barra e provës dhe kjo është jashtëzakonisht e vështirë apo e paarritshme, aq sa ta bëjë të pa realizueshme mbrojtjen, kjo është problematike në kuadër të këtij parimi¹¹¹.

Nën të drejtën procedurale të barrës së provës GJEDNJ-ja ka trajtuar edhe parimin *in dubio pro reo*. Në zbatim të këtij parimi vendimet të cilat deklarojnë fajësinë por nuk janë të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme, konsiderohen problematike¹¹².

ii. Mbrojtja nga vetë-inkriminimi

Sipas GJEDNJ-së parimi i prezumimit të pafajësisë është ngushtësisht i lidhur me të drejtën për të mos e paditur veten¹¹³ që do të thotë se asnjë i akuzuar nuk duhet të ketë detyrimin që të japë prova ose të japë një dëshmi që dëmton mbrojtjen e tij.

iii. Deklarata Paragjykuese¹¹⁴

Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që askush nuk duhet të deklarojë se personi i akuzuar është fajtor, përpara se ky i fundit të dënohet me vendim të formës së prerë. Ky parim vlen jo vetëm për gjyqtarët dhe gjykatën por edhe për autoritetet e tjera publike si p.sh oficerë të policisë, Presidenti i Republikës, Ministri i Drejtësisë, Prokurori etj¹¹⁵. I njëjti parim vlen edhe për fushatat e shtypit. Bazuar në sa më sipër, parimi i prezumimit të pafajësisë dhe dyshimi në favor të magjistratit në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, ngarkojnë ILD-në me detyrimet e mëposhtme:

- Kur merr një ankesë kundër një magjistrati ILD duhet të nisë hetimin pa pasur paragjykimin se magjistrati është fajtor;
- Gjatë kryerjes së hetimit disiplinor ILD ka barrën e provës dhe duhet të kërkojë dhe të mbledhë të gjitha provat në favor apo kundër magjistratit në lidhje me shkeljen e pretenduar;
- ILD, pavarësisht kompetencave të parashikuar në nenin 129 paragrafi 2 të Ligjit për Statusin, nuk mund të pretendojë nga magjistrati të japë informacione apo prova që dëshmojnë për shkeljen disiplinore.
- ILD duhet të informojë magjistratin për akuzën e ngritur kundër tij në mënyrë që t'i japë kohë për përgatitjen e mbrojtjes përpara Këshillave.
- ILD nuk duhet të bëjë deklarata publike paragjykuese për shkeljen e magjistratit.

111 Po aty, paragrafi 370.

112 Po aty.

113 Council of Europe, ECHR, Guide on Article 6 of the Convention – Right to a fair trial (criminal limb), updated on 31 August 2020, paragrafi 355.

114 Po aty, paragrafet 335 – 354.

115 Po aty, paragrafi 345.

3.4.6. Parimi i proporcionalitetit

Neni 100, paragrafi 1, gërma (e) e Ligjit për Statusin parashikon se:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: e) parimin e proporcionalitetit”.

Në kontekstin e procedimit disiplinor parimi i proporcionalitetit kërkon që masa disiplinore që vendoset ndaj magjistratit duhet të jetë në proporcion me shkeljen. Ky parim është gjithashtu i njohur nga standartet ndërkombëtare mbi procedimin disiplinor të magjistratëve. Përshembull ky parim parashikohet nga Rekomandimi CM/Rec (2010) 12¹¹⁶ dhe gjithashtu nga parimet e Bangalorit sipas të cilave jo çdo lloj shkeljeje kërkon nisjen e procedimit disiplinor dhe si rrjedhojë marrjen e masave disiplinore¹¹⁷.

Bazuar në sa më sipër, parimi i proporcionalitetit në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, ngarkojnë ILD-në me detyrimet e mëposhtme:

ILD duhet t'i propozojë Këshillave vendosjen e një mase disiplinore e cila është në proporcion me shkeljen e pretenduar.

3.4.7. Parimi i pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit

Neni 100, paragrafi 1, gërma (ë) e Ligjit për Statusin parashikon se:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit”.

Parimi i pavarësisë së institucioneve disiplinore është një parim ndërkombëtarisht i njohur. Rekomandimi CM/Rec (2010) 12¹¹⁸ parashikon

116 Rekomandimi CM/Rec (2010) 12, i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare ‘Për Pavarësinë, Efiçencës dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Kapitulli VII, Detyra dhe Përgjegjësi, paragrafi 69.

117 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafi 19.

118 Rekomandimi CM/Rec (2010) 12, i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare ‘Për Pavarësinë, Efiçencës dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Kapitulli VII, Detyra dhe Përgjegjësi, paragrafi 46.

se institucionet të cilat kanë kompetenca mbi karrierën e magjistratëve duhet të jenë të pavarura nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv. Gjithashtu parimet e Bangalorit përcaktojnë se vendimet në lidhje me procedimet disiplinore duhet të jenë objekt i një shqyrtimit të pavarur¹¹⁹.

Parimi i pavarësisë së magjistratit është gjithashtu një standart ndërkombëtar thelbësor. Parimet e Bangalorit parashikojnë se nuk duhet të ketë ndërhyrje të papërshtatshme në ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe se pavarësia e gjyqtarëve nuk duhet të cënohet nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ por edhe nga asnjë bashkësi tjetër si p.sh organ profesional apo çdo bashkësi tjetër¹²⁰. Si rrjedhojë, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre institucionet e qeverisjes së magjistratëve, duhet të respektojnë pavarësinë e magjistratit që do të thotë se nuk duhet t'i përdorin kompetencat e tyre disiplinore për të ushtruar presion mbi magjistratët.

Bazuar në sa më sipër, parimi i pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, ngarkojnë ILD-në me detyrimet e mëposhtme:

- *ILD duhet të nisë hetimin disiplinor ndaj magjistratëve vetëm bazuar në gjykimin e tij të paanshëm se hetimi disiplinor është në përputhje me parametrat ligjore dhe jo i shtyrë nga ndikime të jashtme (organet ekzekutive, legjislative apo grupe të tjera interesi);*
- *Në ushtrimin e kompetencave të hetimit disiplinor ILD duhet të gjykojë me paanësi dhe objektivitet, i pa ndikuar nga presione të jashtme.*
- *Ushtrimi i kompetencave të hetimit disiplinor të ILD-së nuk duhet të përdoret për të ushtruar presion mbi magjistratë të caktuar për të ndikuar në vendimmarrjen e tyre në çështje të caktuara.*

3.4.8. Parimi i drejtësisë së hapur

Neni 100, paragrafi 1, gërma (ë) e Ligjit për Statusin parashikon se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
f) parimin e drejtësisë së hapur”.*

Parimi i drejtësisë së hapur është një parim i njohur që rrjedh nga e drejta e procesit të rregullt. Në nivel ndërkombëtar ky parim parashikohet në

119 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafi 20.

120 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafet 4 dhe 12.

Nenin 6 të KEDNJ-së që parashikon të drejtën e çdo personi që çështja e tij të dëgjohet publikisht.

Megjithatë në kontekstin e hetimit disiplinor të ndjekur nga ILD ky parim nuk zbatohet pasi gjatë hetimit disiplinor nuk parashikohen seanca dëgjimore publike të ILD-së me magjistratin subjekt të procedimit. Ky parim do të zbatohet vetëm gjatë fazës së procedimit disiplinor që ndiqen nga Këshillat.

3.4.9. Parimi i konfidencialitetit, e drejta e jetës private, mbrojtja e të dhënave personale dhe balancimi me parimin e informimit të publikut

Neni 100, paragrafi 1, gërma (g) e Ligjit për Statusin parashikon se:

*“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.*

dhe Neni 100, paragrafi 2 i Ligjit për Statusin parashikon se:

*“2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht:
a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza; b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë”.*

Parimet e parashikuara nga gërma (g) e paragrafit 1 të Nenit 100 të Ligjit për Statusin janë parime ndërkombëtarisht të njohura. Në kontekstin e procedimit penal zbatohet parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në kuadër të parimit të prezumimit të pafajësisë parashikuar në Nenin 6 paragrafi 2 i KEDNJ-së. Në kontekstin e procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve, parimet e Bangalorit parashikojnë se procedimi disiplinor i magjistratit në fazat fillestare të tij duhet të mbahet konfidencial përveçse kur parashikohet e kundërta nga gjyqtari¹²¹.

Nga ana tjetër paragrafi 2 i Nenit 100 të Ligjit për Statusin kërkon që institucionet e qeverisjes së drejtësisë të balancojnë parimet e konfidencialitetit me parimin e drejtësisë së hapur dhe parimin e informimit

121 UNDOC, Commentary on the Bangalore Principles of Judicial Conduct, paragrafi 17.

të publikut. Megjithatë ligji kërkon shprehimisht që ky balancim të bëhet në lidhje me akuzat e provuara. Kështu duke qënë se akuzat nuk mund të konsiderohen të provuara në fazën e hetimit disiplinor, balancimi i këtyre parimeve, siç kërkohet nga paragrafi 2 i Nenit 100 të Ligjit për Statusin, mund të bëhet vetëm nga Këshillat në fazën e shqyrtimit të shkeljes disiplinore..

Si rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, nga ILD-ja do të zbatohet vetëm parimi i konfidencialitetit dhe e drejta e jetës private dhe mbrojtja e të dhënave personale. Këto parime, në kontekstin e fazës së hetimit disiplinor, ngarkojnë ILD-në me detyrimin:

E zhvillimit të hetimit disiplinor duke ruajtur konfidencialitetin dhe pa bërë publike të dhënat personale të magjistratit ndaj të cilit po zhvillohet hetimi disiplinor.

3.5. Kompetencat hetimore të ILD-së dhe fazat e hetimit disiplinor

3.5.1. Kompetencat Hetimore dhe Aktet e ILD-së

Me ndryshimet e Kushtetutës si pasojë e procesit të reformës në drejtësi janë krijuar një sërë institucionesh të pavarura të pajisura me kompetenca për qeverisjen e sistemit të drejtësisë. Mes tyre është edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë i veshur me kompetencën e hetimit të shkeljeve disiplinore të magjistratëve (gjyqtarëve dhe prokurorëve). Kompetenca e re hetimore e ILD-së buron nga Neni 147/d paragrafi 1 i Kushtetutës i cili parashikon:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj”.

Kompetencat e ILD-së që burojnë nga neni i mësipërm i Kushtetutës listohen gjithashtu në mënyrë të detajuar edhe nga neni 194, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (Ligji për Qeverisjen), i cili përcakton objektin e veprimtarisë së ILD-së, dhe përkatësisht se:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin

e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.”

Duhet theksuar këtu se objekt i këtij manuali është vetëm kompetenca hetimore e ILD-së ndaj shkeljeve disiplinore të magjistratëve dhe se ligji që rregullon kompetencën e ILD-së në procedurat e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është Ligji për Statusin. Pasqyrimi i detajuar i kompetencave të ILD-së gjatë çdo faze të procedimit disiplinor jepet në Tabelën 6 në fund të këtij Kreu ndërsa këtu do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur aktet dhe veprimet kryesore të ILD-së gjatë hetimit disiplinor.

i. Vënia në lëvizje e hetimit të ILD-së

Hetimi disiplinor mund të vihet në lëvizje nëpërmjet paraqitjes së ankesës pranë ILD-së, ose me iniciativën e vetë ILD-së dhe përkatësisht në mënyrat e mëposhtme: :

- bazuar në ankimin me shkrim të çdo personi fizik, juridik, organi publik të interesuar; ankimin me shkrim të çdo institucion shtetëror ose zyrtari; ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë; ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku ushtron funksionin gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore; ankimin me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë ku ushtron funksionin prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.
- kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në Ligjin për Statusin.

Sa i përket hetimit disiplinor që vihet në lëvizje me nismë të ankuesit, neni 119 paragrafi 1 parashikon se ankues mund të jetë çdo person fizik ose juridik. Ndërsa neni 119 pika 2 i Ligjit për Statusin, përmban një parashikim të ri, duke rradhitur shprehimisht disa institucione, që sipas kësaj dispozite, janë të detyruara të paraqesin tek ILD një ankesë «nëse kanë informacion të besueshëm se magjistrati mund të ketë kryer një shkelje disiplinore”. Këto subjekte janë:

- Ministri i Drejtësisë;
- çdo anëtar i Këshillave (KLGJ dhe KLP);
- kryetari i Gjykatës ose Drejtuesi i Prokurorisë përkatëse.

Gjithashtu Ligji për Qeverisjen, në nenin 194 paragrafi 2 shkronja (c) e tij

parashikon se ILD-në vihet në lëvizje edhe nëpërmjet paraqitjes së ankimit me shkrim. nga Prokurori i Përgjithshëm. Pavarësisht se Prokurori i Përgjithshëm nuk është parashikuar shprehimisht në kategorinë e subjekteve që mund të vënë në lëvizje ILD-në sipas nenit 119 paragrafi 2 të Ligjit për Statusin, nëse do t'i referohemi përkufizimit të përcaktuar nga neni 2 shkronja (g) e këtij ligji, del qartësisht se termi kryetar përfshin edhe Prokurorin e Përgjithshëm. Njëkohësisht bazuar në parashikimet e ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”* (neni 13 paragrafi 2 dhe 38 paragrafi 1 të ligjit), Prokurori i Përgjithshëm është drejtuesi dhe përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, përgjegjës për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe të shkallës së parë. Për rrjedhojë, në interpretim të zgjeruar të dispozitave të sipërcituara ligjore, Prokurori i Përgjithshëm duhet parë si një nga subjektet që përfshihen në pikën 2 të nenit 119 të Ligjit për Statusin, pra si një nga subjektet që kanë detyrimin të paraqesin ankesën kur përmbushen kushtet e parashikuara në këtë nen.

Megjithatë të gjitha këto nene duhet të lexohen sëbashku me parimin e parashikuar në Nenin 100, paragrafi 1, gërma (c) e Ligjit për Statusin i cili parashikon se bazuar në parimin e akuzës *“çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore”*. Siç u theksua edhe në analizën e mësipërme të këtij neni ky parim e zgjeron numrin e institucioneve të cilat kanë detyrimin të paraqesin ankim tek ILD dhe tashmë çdo institucion dhe çdo zyrtar shteti ka detyrimin të paraqesë ankim tek ILD për shkeljet disiplinore të magjistratit. I vetmi ndryshim është se detyrimi i institucioneve të përmendura në nenin 119 paragrafi 2 i Ligjit për Statusin lind *“nëse kanë informacion të besueshëm”*, ndërsa detyrimi për çdo institucion dhe çdo zyrtar, sipas parimit të akuzës ,neni 100, paragrafi 1, gërma (c) e Ligjit për Statusin, lind kur institucioni ose zyrtari *“ka prova të mjaftueshme”*. Pra në rastin e fundit niveli i provueshmërisë së kërkuar për lindjen e detyrimit të paraqitjes së ankesës tek ILD është më i lartë.

ii. Formatit dhe Regjistrimi i Ankesave

Para fillimit të një hetimi disiplinor, ILD pranon dhe regjistron një ankesë si një parakusht për fillimin e hetimit disiplinor ose informacione të tjera, të cilat mund të konsiderohen si bazë për fillimin me iniciativë të një hetimi disiplinor. Me qëllim orientimin e ankimuesve dhe lehtësimin e procesit të paraqitjes së ankesave, në përputhje me parashikimet ligjore, ILD ka publikuar në faqen e tij zyrtare modelin e formularit të ankesës së

bashku me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij¹²².

Elementët që duhet të përmbajë ankesa, e cila paraqitet domosdoshmërisht në formë të shkruar janë të parashikuara në nenin 120, pika 2 e Ligjit për Statusin. Ligji parashikon që ankuesi njoftohet nga ILD për marrjen e ankesës brenda 5 ditëve nga marrja e saj.

iii. Shqyrtimi dhe Verifikimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës dhe njoftimit të ankuesit, ILD shqyrton ankesën dhe kontrollon nëse ankesa plotëson kriteret e pranueshmërisë, të parashikuara në shkronja “a” deri në “dh”, të paragrafit 1 të nenit 120 të ligjit. Një listë kontrolli për kriteret e parashikuara nga Ligji mund të hartohet dhe t’i bashkëngjitet çdo ankese. Nëpërmjet listës së kontrollit, ILD-ja shqyrton dhe konfirmon pranueshmërinë e ankesës duke siguruar plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore të domosdoshme. Ligji ka parashikuar një afat 3 mujor në dispozicion të ILD-së për shqyrtimin fillestar të ankesës dhe nëse është rasti, edhe verifikimin e saj dhe marrjen e një vendimi për fillimin e hetimit disiplinor.

Pas shqyrtimit të kriterëve të pranueshmërisë, ILD-ja nxjerr një vendim për arkivimin e ankesës, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë nuk përmbushen. Ky përbën edhe aktin e parë formal të ILD-së pas marrjes së ankesës. Vendimi i arkivimit të ankesës duhet të jepet i arsyetuar. Ankuesi dhe magjistratët përkatës kanë të drejtën të njoftohen për këtë vendim brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Ligji ka parashikuar mundësinë e ankimit të këtij vendimi në Këshillin përkatës, brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Gjatë shqyrtimit fillestar të ankesës në rast konstatimit të metave të natyrës teknike të ankesës, ILD mund të kërkojë plotësimin e tyre nga ankuesi në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së një vendimi në përfundim të shqyrtimit fillestar të saj.

Nëse ankesa i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe ILD-ja i konsideron faktet e paraqitura nga ankuesi si të pamjaftueshme për të filluar një hetim disiplinor, vetëm në bazë të ankesës, mund të verifikojë ankesën sipas parashikimeve të nenit 122 të ligjit. Për qëllime të verifikimit të ankesës ligji i jep të drejtë ILD-së:

- Të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit shtesë nga ankuesi;
- Të kërkojë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka

¹²² Me urdhrin nr.65, datë 28.9.2020 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar modelin e formularit të ankesës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të ILD në linkun <https://ild.al/ep-content/uploads/2020/10/Urdher-nr.-65-date-28.09.2020.pdf>

ndodhur shkelja;

- Të kërkojë marrjen e çdo informacioni tjetër nga Këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Rekomandohet të vendoset që në fillim një komunikim i drejtperdrejtë me gjykatat dhe prokuroritë për të përshpejtuar procesin e marrjes së informacionit përkatës.

Gjatë procesit të verifikimit, ILD vlerëson dhe vendos se çfarë dokumentesh dhe informacioni të kërkojë dhe të mbledhë në funksion të verifikimit të ankesës. Procesi i verifikimit të çdo ankese varet nga përmbajtja e saj dhe nga vlerësimi i ILD-së mbi dokumentet shitesë apo informacionet e nevojshme për marrjen e vendimit në lidhje me shkeljen e pretenduar disiplinore.

Duhet theksuar së në fazën e verifikimit të ankesës, nuk do të ndërmerren veprime të hetimit disiplinor. Çdo veprim hetimor mund të ndërmerret vetëm pasi të jetë marrë më parë vendimi për fillimin e një hetimi disiplinor bazuar në nenin 123 apo 124 të ligjit për Statusin.

iv. Arkivimi i Ankesës

Bazuar në nenin 118 pika 1 të Ligjit për Statusin, ILD brenda 3 muajve, në përfundim të procedurës së verifikimit, nëse nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor duhet të vendosë të arkivojë ankesën.

Pra Akti i dytë formal i ILD-së është vendimi për arkivimin e ankesës pas verifikimit. Edhe në këtë rast vendimi i arkivimit duhet të jetë i arsyetuar. Për këtë vendim njoftohet ankuesi dhe magjistrati përkatës ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Bazuar në parashikimet e nenit 119 pika 4 vendimi për arkivimin e ankesës pas procedurës së verifikimit do t'i njoftohet ankuesit brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ligji ka parashikuar mundësinë e ankimit të këtij vendimi në Këshill, brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

v. Fillimi i Hetimit

Mundësia tjetër e parashikuar në nenin 118 paragrafi 1 i Ligjit për Statusin, ILD brenda 3 muajve, nëse nuk vendos të arkivojë ankesën (në rastin e nisjes së hetimit në bazë të ankesës), vendosë të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar.

Në interpretim të kësaj dispozite rezulton se akti i tretë formal i ILD-së brenda periudhës 3 mujore është vendimi për fillimin e hetimit disiplinor në bazë të një ankese (neni 123) ose me iniciativë (neni 124).

Në lidhje me nisjen e hetimit me iniciativën e ILD-së ligji nuk sqaron se si ILD-ja vendos për faktet e ofruara nga media apo nga ndonjë burim tjetër informacioni. Kjo do të thotë që mbetet në diskrecion të ILD-së të vendosë për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit shtesë përkatës, për çdo çështje brenda kuadrit ligjor. Në çdo rast ligji për Statusin parashikon që kriteret për pranueshmërinë të parashikuara nga neni 120, pikat 1, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, dhe “dh”, të plotësohen nga informacioni i ofruar nga media apo nga një ankesë anonime.

Vlen të përmendet se kur ILD-ja vendos të fillojë një hetim disiplinor ndaj një magjistrati duhet gjithashtu të qartësohen pyetjet e mëposhtme:

- A ka ankesa të tjera në shqyrtim ndaj të njëjtëve magjistratë?
- A është duke u kryer ndonjë hetim disiplinor ndaj të njëjtëve magjistratë?
- A ka ndonjë çështje të prapambetur disiplinore ndaj të njëjtëve magjistratë?

vi. Aktet e ILD-së

Si përfundim, kuadri i ri ligjor për hetimin disiplinor të magjistratëve kërkon që ILD-ja të nxjerr një nga aktet formale (vendimet) e mëposhtme, në bazë të fakteve dhe provave të sjella nga ankuesi apo burime të tjera informacioni (në rast të fillimit të një hetimi *me iniciativë*):

- Vendimi për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar;
- Vendimi për verifikimin e ankesës ose informacionit (në rast verifikimit me iniciativë);
- Vendimi për arkivimin e ankesës pas verifikimit;
- Vendimi për fillimin e një hetimi disiplinor në bazë të një ankese;
- Vendimi për fillimin e një hetimi disiplinor me iniciativë.

Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe t’u komunikohet zyrtarisht ankuesve dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

3.5.2. Fazat e hetimit disiplinor

Sistemi i ri disiplinor parashikon përgjegjësi disiplinore për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët pa asnjë përjashtim. Kjo përbën një nga risitë e sistemit disiplinor i cili është në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë magjistratëve.

Ligji për Statusin ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë procedurat dhe afatet e hetimit disiplinor, të cilat janë si vijon:

- afatet e parashkrimit të hetimit të shkeljes disiplinore;
- afatet e procedimit të shkeljes;

- procedurën e paraqitjes së ankesave pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- kriteret për pranueshmerinë e ankesës;
- shqyrtimin fillestar të ankesës;
- vlerësimin dhe verifikimin e ankesës;
- vendimin për fillimin e hetimit bazuar në ankesë ose kryesisht;
- zgjerimin ose ndryshimin e objektit të hetimit;
- rastet e pezullimit të hetimit disiplinor;
- të drejtat dhe detyrimet e magjistratit gjatë hetimit;
- ecurinë e hetimeve;
- marrjen në pyetje të magjistratit ose e dëshmitarëve;
- marrjen e provave që i shërbejnë hetimit nga institucione të tjera;
- dokumentimin dhe mbylljen e hetimit;
- zgjidhjen me marrëveshje të përbashkët të shkeljes disiplinore që i atribuohet magjistratit dhe paraqitjen e kësaj marrëveshje për shqyrtim të mëtejshëm pranë KKLGG-së ose KLP-së .

Tabela 6 më poshtë përmban një pasqyrim të përmbledhur të fazave të procedimit disiplinor dhe kompetencave të ILD-së si gjatë fazave të hetimit disiplinor, ashtu edhe gjatë fazës së shqyrtimit të çështjes nga Këshillat.

Tabela 6 – Fazat e Procedimit disiplinor dhe Kompetencat e ILD

FAZAT E PROCEDIMIT DISIPLINOR		KOMPETENCA E ILD	LIGJI PËR STATUSIN
FAZA 1	SHQYRTIMI ANKESAVE	Marrja e ankesave	Neni 119 paragrafi 1
		Konfirmim i marrjes së ankesës dërguar ankuesit	Neni 119 paragrafi 4
		Shqyrtim i pranueshmërisë së ankesës	Neni 120 Neni 121 paragrafi 1
		Verifikimi i ankesës a. Verifikim i fakteve b. Kërkesë ankuesit për dokumenta dhe info shtesë c. Mbledhje info nga Këshillat; Gjykata; Prokuroria	Neni 121, paragrafi 2 gërma (a) Neni 122, paragrafët 1, 2 dhe 3
		Vendim për arkivimin e ankesës	Neni 121, paragrafi 2 gërma (a) Neni 122, paragrafi 4

		Njoftim i vendimit për arkivimin e ankesës dërguar ankuesit dhe magjistratit	Neni 122 paragrafi 5
FAZA 2	FILLIMI I HETIMIT	Vendim për fillimin e hetimit me nisëm të ankuesit	Neni 123 paragrafët 1 dhe 2
		Njoftim i vendimit për fillimin e hetimit me nisëm të ankuesit dërguar ankuesit, magjistratit dhe Këshillave	Neni 123 paragrafi 3
		Vendim për fillimin e hetimit me iniciativën e ILD-së	Neni 124
		Njoftim i vendimit për fillimin e hetimit me iniciativën e ILD-së dërguar magjistratit dhe Këshillave	Neni 124 paragrafi 3 Neni 123 paragrafi 3
FAZA 3	PEZULLIMI I HETIMIT	Pezullim i hetimit	Neni 126
		Njoftimi i pezullimit të hetimit dërguar ankuesit, magjistratit, gjykatës, prokurorisë, Këshillave	Neni 126 paragrafi 3
		Rifillimi i hetimit	Neni 126 paragrafi 2
FAZA 4		Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit	Neni 125 Neni 136
		Njoftim i vendimit për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit dërguar ankuesit, Këshillave dhe magjistratit	Neni 125 paragrafi 2 Neni 123 paragrafi 3
		Zgjatja e Afatit të Hetimeve	Neni 118 paragrafi 3
		Kërkesë për pezullimin e magjistratit dërguar Këshillave	Neni 127 Neni 151 Neni 152 Neni 153 gërma (b)
		Kërkesë për rishikimin e pezullimit të magjistratit dërguar Këshillave	Neni 156 paragrafi 2

	Bashkimi i procedimeve	Neni 128
	Kërkesë për dokumentacion, informacion dhe çdo provë drejtuar magjistratit nën hetim	Neni 129 paragrafi 2
	Thirrje dëshmitarësh	Neni 130 paragrafi 2
	Mbledhje të dhënash, dokumentash dhe provash nga gjykata, prokuroria, institucione shtetërore, organizata, dëshmitarë, magjistrati	Neni 130 paragrafi 2
	Kryerja e veprimeve hetimore	Neni 130 paragrafi 2
	Kërkesa për marrjen në pyetje të magjistratit, dëshmitarëve, persona të tjerë	Neni 131 paragrafi 1
	Njoftim i personave të thirrur për seancën e marrjes në pyetje	Neni 131 paragrafi 1
	Regjistrimi i seancës së marrjes në pyetje, nënshkrimi i procesverbalit, përfshirja në dosje	Neni 131 paragrafët 2, 3 dhe 4
	Kërkesë për marrje informacioni, dokumente ose prova që lidhen me hetimin drejtuar çdo organi publik, personi fizik ose juridik	Neni 132 paragrafi 1
	Përsëritja e kërkesës për marrje informacioni, dokumente ose prova që lidhen me hetimin drejtuar çdo organi publik, personi fizik ose juridik	Neni 132 paragrafi 4
	Urdhri për vendosjen gjobës për mospërbushjen e kërkesës së përsëritur për informacion, dokumente ose prova ndaj subjektit mospërbushës	Neni 132 paragrafi 4

		Kërkesë për lëshimin e urdhërit për dhënie informacioni mbi magjistratin drejtuar Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar	Neni 132 paragrafi 2
		Dokumentimi i veprimeve hetimore	Neni 133 paragrafet 1 dhe 2
		Hartimi i raportit të hetimit	Neni 133 paragrafi 3
FAZA 5	MARRËVESHJA E PRANIMIT	Hartimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit	Neni 135 paragrafët 1 deri në 4
		Fillimi ose vazhdimi i veprimeve hetimore ndaj magjistrati pas refuzimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit nga Këshilli	Neni 135 paragrafi 9
FAZA 6	MBYLLJA E HETIMIT	Vendimi për mbylljen e hetimit	Neni 134 paragrafi 1
		Njoftimi i vendimit për mbylljen e hetimit dërguar ankuesit, magjistratit, përfaqësuesit të magjistratit, Këshillit	Neni 134 paragrafi 2
		Hartimi i raportit përfundimtar për magjistratin e dalë në pension	Neni 134 paragrafi 3
		Paraqitja Këshillit të fakteve të zbuluara gjatë hetimit të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional	Neni 134 paragrafi 4
FAZA 7	RIÇELJA E HETIMIT	Riçelja e Hetimit	Neni 118 paragrafi 4 Neni 117 paragrafet 1 dhe 4
FAZA 8	FILLIMI I PROCEDIMIT	Paraqitja e raportit të hetimit dhe dosjes hetimore tek Këshilli	Neni 135 paragrafët 1 deri në 4
		Kryerja e veprimeve të tjera hetimore të kërkuara nga Këshilli	Neni 135 paragrafi 5

		Paraqitja e argumentave mbi shkeljet dhe propozimi i masë disiplinore gjatë seancës dëgjimore në Këshill	Neni 142 paragrafi 3 gërma (a)
		Ankim i vendimit të Këshillit	Neni 147 paragrafi 2

3.6. Shkeljet dhe masat disiplinore

Shkeljet dhe masat disiplinore rregullohen nga nenet 101 deri në 115 të Ligjit për Statusin, disa prej të cilave janë ndryshuar në vitin 2019 për shkak të shfuqizimit nga VGJK nr.34 (*shiko më sipër*). Panorama e shkeljeve dhe masave disiplinore që shfaqet pas ndryshimeve është e pasqyruar në tabelën 7 më poshtë:

Tabela 7 – Shkeljet dhe masat disiplinore

SHKELJET DISIPLINORE (Ligji për Statusin Nenet 101 –104)			MASAT DISIPLINORE (Ligji për Statusin Nenet 105 – 115)	
<i>Shkelje Gjatë Ushtrimit të Funkzionit</i> ¹²³	<i>Shkelje Jashtë Ushtrimit të funksionit</i> ¹²⁴	<i>Shkelje për Kryerje të Veprës Penale</i> ¹²⁵	<i>Masat Disiplinore Kryesore</i> ¹²⁶ dhe <i>Nivelet Shkeljes</i>	<i>Masa Disiplinore Plotësuese</i> ¹²⁷
Shkelje gjatë procedurës së dorëheqjes nga procedimi ose gjykimi i çështjes ¹²⁸	Shkelje e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin ose të kufizimeve për shkak të funksionit ¹²⁹	Dënim i formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtje penale për veprime ose mosveprime	<ul style="list-style-type: none"> • Vërejtje Konfidenciale¹³⁰ → E lehtë • Vërejtje Publike¹³¹ → E lehtë 	Trajnim ¹³²

123 Ligji për Statusin, Neni 101 dhe 102.

124 Ligji për Statusin, Neni 103.

125 Ligji për Statusin, Neni 104.

126 Ligji për Statusin, Neni 105.

127 Ligji për Statusin, Neni 112.

128 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (a) dhe (b).

129 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (a).

130 Ligji për Statusin, Neni 106.

131 Ligji për Statusin, Neni 107.

132 Ligji për Statusin, Neni 113.

		që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë ¹³³	<ul style="list-style-type: none"> • Ulje e përkohshme pagës¹³⁴ → Jo shumë e rëndë • Ulje në detyrë¹³⁵ → E rëndë • Pezullim¹³⁶ → Shumë e rëndë • Shkarkim¹³⁷ → Shumë e rëndë 	Largimi nga detyra e kryetarit ¹³⁸
Ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në funksionet e një magistrati tjetër ¹³⁹	Përdorimi i statusit të magistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve ¹⁴⁰	Dënim i formës së prerë për kryerjen e një krimi ¹⁴¹		
Shkelje të funksioneve specifike me veprime, mosveprime, delegime, papajtueshmëri, konflikt interesi ¹⁴²	Ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit ¹⁴³ ;			

133 Ligji për Statusin, Neni 104, paragrafi 1 dhe 2.

134 Ligji për Statusin, Neni 108.

135 Ligji për Statusin, Neni 109.

136 Ligji për Statusin, Neni 110.

137 Ligji për Statusin, Neni 111.

138 Ligji për Statusin, Neni 114.

139 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërma (c).

140 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (b).

141 Ligji për Statusin, Neni 104, paragrafi 3.

142 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (ç), (dh), (e), (g), (l), (p) dhe Neni 102, paragrafi 2.

143 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (c).

Vonesa procedurale ¹⁴⁴	Shoqërimi me persona ¹⁴⁵ : <ul style="list-style-type: none"> • në ndjekje penale • subjekt të një procedimit penal • persona të dënuar dhe të parehabilituar 			
Mungesa e pajustificuar në detyrë ¹⁴⁶	Përfitimi i padrejtë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji ¹⁴⁷			
Mos pjesmarrja në trajnimin detyrues ¹⁴⁸	Sjellje të tjera që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë ¹⁴⁹			
Mosnjof-time ¹⁵⁰				
Shkelja e rregullave të konfidencialitetit ¹⁵¹ dhe publicitetit				

144 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (d) dhe (ë).

145 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (ç).

146 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërma (f).

147 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (d).

148 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërma (h).

149 Ligji për Statusin, Neni 103, gërma (dh).

150 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (i), (n), (nj) dhe (o).

151 Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (j), (ll) dhe (m).

Moszbatisim i vendimeve të Këshillit; pengim i Këshillit dhe ILD-së, organeve publike ¹⁵²				
--	--	--	--	--

¹⁵² Ligji për Statusin, Neni 102, paragrafi 1, gërmat (gj) dhe (k).

KAPITULLI IV

KOMENTARI I NENEVE 118 - 137 TË LIGJIT PËR STATUSIN

4.1. Hyrje

Kapitulli IV i këtij Manuali përmban 20 komentare të dispozitave ligjore të Ligjit për Statusin, të cilat janë me rëndësi të veçantë për ILD-në për zbatimin e njërës prej kompetencave themelore, hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ligji për Statusin, i ndryshuar vendosi një sërë mekanizmesh për të garantuar ngritjen dhe funksionimin e një sistemi disiplinor të bazuar në parimet e pavarësisë, paanasësisë, objektivitetit, transparencës me qëllimin garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor për të gjitha palët subjekt të hetimit disiplinor.

Rëndësia e këtij kapitulli është e lidhur ngushtë me faktin se legjislacioni i ri shqiptar që lidhet me përgjegjësinë disiplinore të magistratëve është në fazat e para të zbatimit të tij dhe ekzistojnë disa pikëpyetje në lidhje me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e duhur të dispozitave ligjore përkatëse.

Ndaj Komentari i këtyre dispozitave, mendohet se do t'i shërbejë krjimit të një qasje të unifikuar për mënyrën e zhvillimit të procesit të hetimit disiplinor, duke lënë të hapur mundësinë e pasurimit të mëtejshëm të tyre referuar konsolidimit të praktikave të punës apo dhe jurisprudencës.

4.2. Komentari

4.2.1. Komente për nenin 118

Neni 118 “Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” përcakton:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit.

4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashikuar afatet, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 117, të këtij ligji.

5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, magjistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.”

i. Qëllimi i dispozitës

Kjo dispozitë synon përcaktimin e afateve të qarta dhe konkrete kohore brenda të cilave Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të kryejë veprimet procedurale në kuadër të hetimit disiplinor.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e strukturuar në pesë paragrafë, të cilët rregullojnë afatet e procedurës hetimore të ndjekur nga ILD.

Në paragrafin 1 dispozita parashikon afatin 3 mujor, brenda të cilit ILD-ja duhet të vendosë për arkivimin e ankesës së paraqitur nga një prej subjektet e parashikuara nga neni 119 i ligjit për Statusin apo fillimin e hetimit disiplinor.

Në pikën 2 dispozita parashikon afatin 6 mujor për kryerjen e hetimit disiplinor nga ILD.

Në pikën 3 dispozita ka përcaktuar zgjatjen e afatit 6 mujor të hetimit edhe me 3 muaj të tjerë, që mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë shkaqet e përmendura në këtë pikë¹⁵³.

Në pikën 4 dispozita parashikon mundësinë e riçeljes së hetimit disiplinor edhe pas kalimit të afateve të përcaktuara nga paragrafet e mësipërme, vetëm kur dalin në pah prova të reja dhe kur

153 Shiko shpjegimet e dhëna në komentarin e dispozitës

plotësohen kushtet e tjera të parashikuara në këtë pikë¹⁵⁴.

Në pikën 5, dhe të fundit, dispozita parashikon të drejtën e ankimit të magjistratit në rastet e mos zbatimit të afateve nga ILD.

iii. Komentari i dispozitës

Përcaktimi i afateve kohore të procedimit nga ILD luan dy funksione të rëndësishme. Së pari funksionin e vendosjes së garancive për respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor që përbën një nga parimet bazë të procedimit disiplinor¹⁵⁵ dhe së dyti funksionin e vendosjes së garancive për realizimin e parimit të drejtësisë së hapur¹⁵⁶ me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, duke përcaktuar afate të qarta brenda të cilave, pretendimet e tyre ndaj magjistratëve do të merren në shqyrtim nga institucionet përgjegjëse shtetërore.

a. Afati për fillimin e hetimit

Pika 1 e Nenit 118 parashikon si më poshtë:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës”.

Ky paragraf përcakton afatin për fazën e parë të procedurave hetimore të ILD-së. Kjo është faza e shqyrtimit fillestar të ankesës dërguar ILD-së dhe marrjen e vendimit nga ILD-ja nëse do të fillohen hetimet disiplinore ndaj magjistratit, subjekt të ankesës apo nëse ankesa do të arkivohet.

Nga ky nen kuptohet se gjatë kësaj faze të parë, ILD-ja do të kryejë shqyrtimin fillestar të ankesës i cili konsiston në vlerësimin nëse ankesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 120 të Ligjit për Statusin apo nuk i përmbush këto kritere dhe duhet të arkivohet në përputhje me parashikimet e neneve 121 dhe 122 të Ligjit për Statusin.

Gjatë këtij afati 3 mujor ILD, në veçanti për ankesat që në përmbajnë e tyre nuk ka informacion të qartë ka të drejtë të kryejë procedurat e verifikimit nëpërmjet marrjes së informacioneve dhe shpjegimeve shtesë, komunikimin me të tretët, dhe analizën e të gjitha të dhënave të grumbulluara për ankesën.

Për marrjen e këtij vendimi ILD-ja ka një afat kohor prej 3 muajsh nga data e marrjes së ankesës. Për llogaritjen e afatit të saktë kohor është shumë e rëndësishme të përcaktohet se cila do të konsiderohet data e

154 Shiko shpjegimet e dhëna në komentarin e dispozitës

155 Ligji për Statusin, Neni 100, paragrafi 1, gërma (a).

156 Ligji për Statusin, Neni 100, paragrafi 1, gërma (f).

marrjes së ankesës. Në këtë rast parashikimet e pikës 1 të nenit 118 të ligjit për Statusin mund të plotësohen me kërkesat e neneve 56 dhe 57 të Kodit të Procedurave Administrative. Neni 57 ka parashikuar në mënyrë specifike ditën që shënon fillimin e ecjes së afateve ndaj organit publik në rast të paraqitjes së një kërkesë nga pala e interesuar. Referuar këtij neni, dita e paraqitjes së kërkesës, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale që ecin në dëm të palës, konsiderohet ajo e:

- depozitimit të kërkesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur;
- depozitimit të kërkesës në kutinë postare të organit publik;
- paraqitjes së kërkesës në degët e institucionit;
- regjistrimit nga pajisja përkatëse për marrjen e mesazheve, nëse dokumenti elektronik dërgohet elektronikisht ose kërkesa në formë të shkruar dërgohet me faks.

Nga ana tjetër neni 56 pika 3 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar se: *“Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji”.*

Në rast se ankesa është depozituar në datë 20 qershor nëpërmjet shërbimit postar, afati 3 mujor fillon të llogaritet nga dita e nësërme e depozitimit të saj pra në 21 qershor pavarësisht afatit të mbërritjes dhe protokollimit të tij pranë Zyrës së ILD. Në këtë rast afati përfundimtar për të vendosur arkivimin apo fillimin e një hetimi disiplinor është data 21 Shtator.

Në çdo rast llogaritja e afatit përfundimtar duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 56 pika 4 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit, kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

b. Afati për fillimin e procedimit disiplinor

Pika 2 e nenit 118 parashikon si më poshtë:

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.

ILD-ja ka në dispozicion 6 muaj kohë për të vendosur nëse, hetimi disiplinor që ka nisur, bazuar në një ankesë¹⁵⁷ apo me iniciativën e

¹⁵⁷ Ligji për statusin, Neni 123.

vetë ILD-së¹⁵⁸, duhet të vazhdohet si procedim disiplinor nga Këshillat përkatës apo duhet të mbyllet. Afati 6 mujor i përcaktuar nga ky nen është lehtësisht i identifikueshëm. Ky afat fillon nga dita në të cilën ILD-ja nxjerr vendimin për fillimin e hetimit disiplinor që do të thotë që nga data e miratimit të këtij vendimi dhe përfundon brenda 6 muajve nga dita e nxjerrjes së vendimit për fillimin e hetimit, me përjashtim të rasteve kur ILD vendos zgjatjen e afateve të hetimit sipas pikës 3 të këtij neni.

Shembull: Në rast se vendimi i ILD për fillimin e hetimit është miratuar në datë 20 Qershor afati 6 mujor përfundon në 20 Dhjetor. Njësoj si më sipër edhe në këtë rast duhet të mbahen në konsideratë kërkesat e nenit 56 pika 4 të Kodit të Procedurave Administrative.

Siç kuptohet nga teksti i dispozitës, procedimi disiplinor fillon kur ILD i paraqet Këshillit përkatës raportin e hetimit dhe në të kundërt procedimi disiplinor nuk fillon, ose hetimi disiplinor përfundon kur ILD-ja nxjerr vendimin për mbylljen e hetimit. E rëndësishme është të theksohet se për të dyja llojet e vendimeve, të cilat krijojnë pasoja të ndryshme, afati është i njëjtë.

c. Zgjatja e afatit të hetimit

Pika 3 e Nenit 118 parashikon si më poshtë:

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit.

Kjo dispozitë merr parasysh rastin kur ILD-ja mund të ketë nevojë për më shumë kohë me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe parashikon zgjatjen e afatit të hetimit. Megjithatë kjo zgjatje nuk është e pakufizuar dhe nuk është lënë në diskrecion të ILD-së.

Së pari, zgjatja lejohet vetëm për 3 muaj të tjerë dhe dispozita nuk parashikon mundësinë e një zgjatjeje të dytë, pra ligji parashikon një periudhë kohore prej jo më shumë se 9 (nëntë) muaj për kryerjen e hetimit disiplinor. Zgjatja e periudhës e hetimit edhe me tre muaj të tjerë është një rast përjashtimor.

Së dyti zgjatja lejohet vetëm për disa rrethana shteruese të parashikuara nga vetë ligji. Ligjvënësi parashikon dy grupe rrethanash, të cilat mund të çojnë tek vendimi për zgjatjen e afatit të hetimit. Grupi i parë lidhet me thelbin e çështjes dhe grupi i dytë lidhet me situatën objektive të

¹⁵⁸ Ligji për statusin, Neni 124.

magjistratin nën hetim. Më konkretisht këto rrethana janë:

- kur çështja nën hetim është komplekse;
- kur objekti i hetimit është shtuar apo ndryshuar, sipas nenit 125 të Ligjit për Statusin;
- kur magjistrati është i sëmurë;
- kur magjistrati ndodhet në kushtet e pamundësisë.

Pyetja më e rëndësishme që ngrihet në lidhje me këtë paragraf është interpretimi i rasteve në të cilat ILD-ja mund të zgjasë afatin e hetimit.

Sic u përmend edhe më sipër grupi i parë i rrethanave të shtyrjes së afatit të hetimit lidhet me thelbin e çështjes dhe përkatësisht me kompleksitetin e rastit që po hetohet dhe shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit.

Përsa i përket kompleksitetit duhet shpjeguar se cilat çështje do të konsiderohen si komplekse duke i dhënë kështu shkas zgjatjes së afateve të hetimit. Kompleksiteti i rastit është një çështje që lind gjatë hetimit dhe mund të jetë e lidhur me natyrën e shkeljes disiplinore, nevojën për kryerjen e hetimeve, mbledhjen e fakteve, provave dhe të informacioneve që kërkojnë më tepër kohë.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme¹⁵⁹.

Mund të ndodhë që kompleksiteti të jetë edhe më i madh, në rast se hetimi ka filluar për një sërë shkeljesh ose kundër dy ose më shumë magjistratëve për një dhe të njëjtën shkelje. Vlerësimi i kompleksitetit të rastit është një çështje që mund të bëhet rast pas rasti nga ILD, por duhet të paraprihet nga një raport i hollësishëm i inspektorit të ngarkuar me çështjen ku të analizohen: veprimet hetimore të zhvilluara deri në atë moment prej tij, nevojën e kryerjes së veprimeve të metejshme të hetimit disiplinor, rëndësinë që ato kanë për ecurinë e hetimit disiplinor, arsyet se përse hetimi nuk mund të përfundojë brenda afatit etj. Është e rëndësishme që të theksohet se shtyrja e hetimit nuk duhet të lidhet në asnjë moment me neglizhencën e inspektorit që ka në shqyrtim dosjen për kryerjen e hetimit në përputhje me kërkesat ligjore, por ajo duhet të jetë e lidhur në mënyrë objektive me natyrën komplekse të rastit nën hetim disiplinor. Çështja e neglizhencës së inspektorit do të vlerësohet rast pas rasti.

159 Vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në praktikën e saj ka dhënë shpjegimin e mëposhtëm lidhur me termin “kompleksiteti i çështjes” në kuadër të Nenit 6 të Konventës:

“Kompleksiteti i çështjes lidhet me të dyja, edhe me faktet edhe me ligjin (Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë, § 55; Papachelas kundër Greqisë [GC], § 39). Ai mund të lidhet, për shembull, me përfshirjen e shumë palëve në një çështje (H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 72) ose me marrjen e shumë provave (Humen kundër Polonisë [GC], § 63).

Një çështje mund të jetë komplekse nga pikpamja ligjore për shkak të mungesës së precedentëve në nivel kombëtar, ose për shkak të nevojës për të patur një vendim paraprak nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, mbi një pyetje lidhur me interpretimin e legjislacionit të BE-së (Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy kundër Finlandës [GC], § 212). Në çështjen Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë [GC], procedimi që përfshinte edhe një palë private, u vlerësua si kompleks në aspektin praktik, sepse kërkoheshin shumë raporte ekspertësh (§ 210).

Kompleksiteti i procedimeve disiplinore vendase mund të shpejtojë kohën e gjatë të procedimit (Tierce kundër San Marinos, § 31). Megjithatë, pavarësisht pranimit të kompleksitetit, Gjykata ka gjetur se një kohëzgjatje prej njëzet e pesë vjetësh dhe gjashtë muajsh nuk përmbush kriterin e një “afati të arsyeshëm” (Cipolletta kundër Italisë, § 44).

Edhe nëse rasti vetë nuk është veçanërisht kompleks, mungesa e qartësisë në parashikueshmërinë e legjislacionit vendas, mund të shkaktojë veshtirësi në shqyrimin e tij dhe mund të kontribuojë bindshëm në zgjatjen e kohës së procedimit (Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerë kundër Rumanisë [GC], § 150).”

Në vijim të shpjegimit të dhënë nga jurisprudenca e GJEDNJ, rezulton se termi juridik “kompleksiteti i çështjes” është i zbatueshëm në të gjitha fushat e drejtësisë - penale, civile dhe administrative, përfshirë edhe çështjet disiplinore. Siç përcaktohet edhe nga GJEDNJ “Kompleksiteti i çështjes mund të lidhet edhe me faktet, edhe me ligjin”.

Kur kompleksiteti lidhet me faktet e hetimit disiplinor, mund t'i referohemi alternativave të mëposhtme:

- Hetimi disiplinor ka filluar për një magjistrat dhe për një shkelje disiplinore, e cila kërkon mbledhjen e shumë provave (shumë dëshmitarë do të intervistohen dhe disa prej tyre nuk gjenden gjatë hetimit 6 mujor, por sërish dëshmia e tyre mbetet kyçe për konkluzionet përfundimtare, shumë dokumenta duhet të mblidhen-

të cilat janë kërkuar nga institucionet përkatëse, letra rikujtuese janë dërguar, megjithatë nuk është marrë ende përgjigje. Disa prej këtyre dokumentave (të cilat duhet të përcaktohen qartësisht) janë thelbësore për konkluzionet përfundimtare.

- Hetimi disiplinor ka filluar për një magjistrat dhe për dy ose më shumë shkelje disiplinore, të cilat kërkojnë mbledhjen e provave nga gjykata/prokurori të ndryshme ose për të cilat kërkohet mbledhja e shumë të dhënave, që kanë qenë të pamundura gjatë periudhës 6 mujore (ato duhet të listohen qartësisht, në mënyrë që të sigurohet se gjatë periudhës 6 muajore të gjitha burimet hetuese janë shterruar dhe arsyeja e vetme e mosmbledhjes së provave ka qenë mungesa e kohës).
- Hetimi disiplinor ka filluar kundër dy ose më shumë magjistratëve për të njëjtën shkelje disiplinore (arsyetim i ngjashëm me dy alternativat më lart).

Kur kompleksiteti lidhet me ligjin, në këtë rast mund të jetë ligji për Statusin por mund të jetë gjithashtu Kodi i Procedurave Civile, Kodi i Procedurave Penale ose Kodi i Procedurave Administrative. Nga një këndvështrim praktik, këtu është shumë e rëndësishme të ofrohet një arsyetim në lidhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe të argumentohet mbi një mungesë të qartësisë apo të praktikës juridike ose për shkak të interpretimeve jo të njëjta të dhëna nga Këshillat dhe/ose Gjykata.

Përsa i përket, shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ky përbën një rast më matshëm për të justifikuar një zgjatje të afatit të hetimit, por që duhet të shoqërohet nga një analizë e kujdesshme. Analiza duhet të përmbajë:

- kohën në dispozicion ndërmjet vendimit për shtimin ose ndryshimin e objektit dhe periudhës së mbetur për kryerjen e hetimeve;
- natyrën e objektit të hetimit që shtohet apo ndryshohet;
- kohën që mund të nevojitet për kryerjen e veprimeve hetimore lidhur me objektin e shtuar apo të ndryshuar të hetimit etj.

Ndërsa grupi i dytë i rrethanave të shtyrjes së afatit të hetimit lidhet me situatën objektive të magjistratin nën hetim ku përmbledhen:

- sëmundja e magjistratit dhe
- pamundësia e magjistratit.

Duhet theksuar se si sëmundja ashtu edhe pamundësia e magjistratit janë parashikuar si arsye zgjatjeje me qëllim garantimin e të drejtave të magjistratit gjatë procesit të hetimit disiplinor në funksion të sigurimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Lind pyetja çfarë konsiderohet sëmundje dhe a mundet që çdo lloj sëmundje e magjistratit të sjellë si pasojë shtyrjen e afeteve të hetimit? Sëmundja e magjistratit nën hetim duhet të jetë për një periudhë të gjatë, e cila në krahasim me periudhën e hetimit çon në përfundimin se inspektori nuk ka pasur kohën për të marrë në pyetje magjistratin, kur një gjë e tillë është e rëndësishme në funksion të hetimit dhe nuk ka marrë dhe nuk ka verifikuar të dhënat e magjistratit për shkak të asaj sëmundje. Në çdo rast kjo rrethanë duhet të jetë e vërtetuar me dokumentacionin përkatës mjekësor (raport mjekësor, epikrizë) të lëshuar nga institucioni përkatës shëndetësor që ka në trajtim magjistratin. Mund të kërkohej informacion shtesë nga Gjykata ose Prokuroria përkatëse ku magjistrati nën hetimin disiplinor ushtron funksionet e tij / saj për të sqaruar periudhën kohore kur magjistrati ka përdorur një leje për shkak të sëmundjes. Në çdo rast arsyetimi i qartë i secilës çështje konkrete është i detyrueshëm.

Pamundësia e magjistratit gjatë hetimit është arsyeja tjetër për zgjatjen e afatit të hetimeve. Si raste të pamundësisë së magjistratit mund të përmendim vendimin e Këshillit përkatës për pezullimin e përkohshëm për arsye të pamundësisë fizike. Lejet prindërore të dhëna me vendimin përkatës të këshillave mund të përbëjnë gjithashtu një shkak të pamundësisë së magjistratit, por në vetvete leja prindërore, nuk mund të përbëjë apriori një shkak për zgjatjen e afeteve të hetimit. Në këtë kontekst duhet të vlerësohet se në cilat veprime është e nevojshme prania e magjistratit për të siguruar balancën e duhur ndërmjet respektimit të të drejtave të magjistratit nga njëra anë dhe moszvarritjes së hetimit disiplinore nga ana tjetër.

Është e rëndësishme të theksohet, se përpara se ILD të nxjerrë një vendimin për zgjatjen e periudhës së hetimit, duhet të vlerësojë nëse argumentet e paraqitura nga inspektori përgjegjës janë në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga pika 3 e nenit 118.

Në vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit mund të jepen argumentet në lidhje me veprimet hetimore të kryera deri në atë kohë sipas planifikimit dhe arsyet që bëjnë të nevojshëm zgjatjen e afatit të hetimit për shkak të:

- kompleksiteti i çështjes, e cila kërkon veprime hetuese shtesë;
- shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit, e cila kërkon hetime të reja;
- sëmundja e magjistratit nën hetim; ose
- pamundësia e magjistratit nën hetim, për të qenë i pranishëm gjatë periudhës së përcaktuar fillimisht për hetim dhe marrja e tij/saj në pyetje është thelbësore për vijimësinë dhe përfundimin e hetimit.

Ligji nuk bën parashikime në lidhje me njoftimin e këtij vendimi apo edhe

mundësinë e ankimit të tij. Nëse referojmë tek parashikimet e neneve 119 pika 4 dhe 129 pika 3 vendimet për shtimin apo ndryshimin e objektit të ankimit që përbën një nga rastet e zgjatjes së afatit të hetimit i njoftohen ankuesit dhe magjistratit. Pavarësisht se dispozita nuk shprehet për rastet e tjera të zgjatjes, vlerësojmë se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimit duhet t'i njoftohet në çdo rast magjistratit dhe ankuesit. Ndërkohë për sa i takon mundësisë së ankimit, kjo çështje duhet parë e lidhur me pikën 5 të nenit, paragraf që parashikon mundësinë e ankimit të magjistratit në Këshill vetëm kur nuk respektohen afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4 të dispozitës.

ç. Riçelja e hetimit disiplinor

Pika 4 e nenit 118 parashikon si më poshtë:

4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashkruar afatet, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 117, të këtij ligji.

Riçelja e hetimeve disiplinore është një mekanizëm përjashtimor i cili merret me një vendim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pas kalimit të afateve të hetimit disiplinor. Vendimi për riçeljen e hetimit disiplinor kushtëzohet nga plotësimi i disa kushteve:

- të kenë kaluar afatet e hetimit disiplinor (6 muaj afati i zakonshëm dhe 9 muaj afati i zgjatur);
- të dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur dhe ILD, brenda përpjekjeve të arsyeshme të ketë qenë në pamundësi për zbulimin dhe grumbullimin e kësaj prove gjatë afatit të hetimit;
- shkelja disiplinore të mos jetë parashkruar sipas afateve të parashikuara në pikat 1 dhe 4 të nenit 117 të ligjit.

Vendimi për riçeljen e hetimit duhet të japë arsyet se si provat/provat e reja për të cilat ILD është vënë në dijeni pas kalimit të afateve të hetimit, lidhen me shkeljen disiplinore dhe se përse prova/at e reja mund të ndryshojnë përfundimet e hetimit nëse do të duhej që të riçelej. Gjithashtu, është e rëndësishme të sqarohet se edhe data e administrimit të kësaj prove të re duhet të jetë pas përfundimit të afateve të hetimit disiplinor pasi vetëm një shkak i tillë i hap rrugën nxjerrjes së vendimit për riçeljen e hetimit.

Vendimi për riçeljen e hetimit disiplinor sjell efekte në zgjatjen e mëtejshme të hetimit disiplinor tej afatit 6 mujor ose 9 mujor të parashikuar nga ky

nen. Vendimi për riçeljen mund të merret për sa kohë nuk është marrë një vendim për mbylljen e hetimit, por janë tejkaluar afatet e hetimit.

Referuar termit “shkaqe të arsyeshme” apo “dyshim i arsyeshëm”, GJEDNJ ka hartuar guida të posaçme mbi kuptimin e termit “dyshim i arsyeshëm”, në kuadër të nenit 8 të Konventës, “E drejta për liri dhe siguri”, ku Gjykata ka vendosur si vijon: “Arsyeshmëria” e dyshimit në të cilën një person është i ndaluar formon një pjesë thelbësore të garacive të parashikuara në Nenin 5, paragrafi 1 (çështja Mehmet Hasan Altan kundër Turqisë, § 124; Fernandes Pedrosa kundër Portugalisë, § 87).

Një dyshim i arsyeshëm se është kryer një veprë penale presupozon ekzisencën e fakteve dhe të informacionit i cili duhet të përmbushë një kriter objektiv, se një person i caktuar ka kryer një veprë penale (çështja Ilgar Mammadov kundër Azerbaixhanit, § 88; Erdagöz kundër Turqisë, § 51; and Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 32). Rrjedhimisht, dështimi i autoriteteve për të bërë pyetje mbi bazueshmërinë e fakteve të një rasti, në mënyrë që të verifikojnë nëse një ankesë është e mirëmbështetur përbën shkelje të Nenit 5, paragrafi 1 (çështja Stepuleac kundër Moldavisë, § 73; Elçi and Others kundër Turqisë § 674).

Çfare është e arsyeshme varet nga të gjitha rrethanat, por faktet të cilën ngrenë një dyshim është e nevojshme të jenë të njëjtë nivel si ato që justifikojnë një dënim, ose ngitjen e një akuze (Merabishvili kundër Gjeorgjisë [GC], § 184).

Termi “arsyeshmëri” nënkupton gjithashtu një prag që dyshimi duhet të plotësojë për të përmbushur kriterin objektiv të probabilitetit të akuzave. Një kufizim i lirisë duhet të bazohet në elemente të mjaftueshëm objektivë për të justifikuar “dyshimin e arsyeshëm” se faktet e çështjes kanë ndodhur vërtet. Gjithashtu, faktet e parashtruara duhet të klasifikohen logjikshëm brenda njërës prej seksioneve që përshkruajnë sjelljen kriminale në Kodin Penal. Kështu që, qartazi nuk do të kishte dyshim të arsyeshëm nëse aktet ose faktet kundër personit të ndaluar nuk përbëjnë një veprë penale në kohën që kanë ndodhur (Kavala kundër Turqisë, § 128).

Në vlerësimin nëse standardi minimal për arsyeshmërinë e dyshimit, Gjykata ka çmuar kontekstin e përgjithshëm të fakteve të rastit siç janë: statusi i aplikantit, ecuria e ngjarjeve, mënyra në të cilën është kryer hetimi dhe sjellja e autoriteve (Ibrahimov and Mammadov kundër Azerbaixhanit §§ 113-131).

Ndërkohë që dyshimi i arsyeshëm duhet të ekzistojë në kohën e arrestimit dhe të paraburgimit, duhet të provohet se në rastet e tejzgjatjes së afatit të paraburgimit, dyshimi vazhdonte të mbetej i arsyeshëm gjatë gjithë kohës (Ilgar Mammadov kundër Azerbaixhanit, § 90).“

d. E drejta e ankimit

Pika 5 e nenit 118 parashikon si më poshtë:

5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, magjistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.”

Ky paragraf në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor dhe mjetit efektiv të ankimit parashikon mundësinë e magjistratit për të ankimuar mosrespektimin e afateve të hetimit disiplinor nga ILD. Në këtë rast, magjistrati ka të drejtën të ankohet pranë Këshillit përkatës për mosveprimin administrativ të ILD-së. Ky paragraf është në harmoni me nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative që i jep mundësinë çdo pale të procedurës administrative për të ushtruar mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në përmbajtjen e tij ky paragraf nuk ka parashikuar afatin brenda të cilit do të paraqitet ankimi ndaj mosveprimit administrativ në Këshillin përkatës. Në këtë rast mund të referojmë në parashikimet e bëra nga neni 132 pika 2 i Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se në rastin e mosveprimit administrativ, me përjashtim kur miratimi në heshtje është i zbatueshëm, ankimi duhet të paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës administrative.

iv. Nenet e lidhura

Neni 100 pika 1 shkronjat “a” dhe “f” të Ligjit të Statusit

Neni 117 i Ligjit të Statusit

Neni 119 i Ligjit të Statusit

Neni 120 pika 1 i Ligjit të Statusit

Neni 122 i Ligjit të Statusit

Neni 125 i Ligjit të Statusit

Neni 129 pika 3 i Ligjit të Statusit

Neni 136 pika 1, shkronja “a” i Ligjit të Statusit

Neni 144 pika 1, shkronja “b” i Ligjit të Statusit

Nenet 56 and 57 të Kodit të Procedurave Administrative

Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative

Neni 132 i Kodit të Procedurave Administrative

v. Standardet Ndërkombetare dhe Përputhshmëria

Sanksionimi i afateve në procedurën disiplinore të gjyqtarëve të prokurorëve është një standard i vendosur në një sërë Aktesh Ndërkombëtare, të tilla si: Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB, Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”.

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6 pika 1 të saj parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”*
- b. Ky parashikim garanton të drejtën për një proces të rregullt, dhe njëkohësisht jurisprudenca e GJEDNJ, e cila përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ.
- c. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB në vitin 1985, në paragrafin 17 për Disiplinën, Pezullimin dhe Shkarkimin nga detyra, parashikon që: *“Një akuzë ose ankesë kundër një gjyqtari, në cilësinë e tij/saj profesionale dhe gjyqësore, duhet të procedohet në mënyrë të përshtatshme dhe me ndershmëri sipas një procedure të përshtatshme”;*
- d. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Parimi VI pika 3 parashikon që: *“ligji duhet të parashikojë procedura të përshtatshme për të siguruar që gjyqtarët që i nënshtrohen procedurës disiplinore i janë siguruar të paktën garancitë për proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ, siç është psh shqyrtimi i çështjes brenda afateve të arsyeshme...”*.
- e. Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015 Standardet 8 dhe 9 parashikojnë se:

“8. Duhet të parashikohet një afat kohor për paraqitjen e ankesës e cila mund të zgjatet vetëm në rrethana përjashtimore”.

“9. Duhet të vendoset një afat kohor për përfundimin e hetimeve, marrjen e vendimit dhe vendosjen e sanksionit. Vendosja e ndonjë sanksioni duhet të bëhet menjëherë pas vendimit mbi bazueshmërinë e çështjes, dhe në çdo rast pa vonesë të panevojshme. Këto kufij duhet të jenë të afta të zgjaten vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë kompleksiteti i hetimit, sëmundja e gjykatësit ose një hetim penal”.

- f. Opinioni nr. 3 (2020) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGJE) (§ 67) dhe nën vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi parimet dhe rregullat qeverisëse të gjyqtarëve, sjellja profesionale në mënyrë të veçantë etika, sjellja e papërputhshme dhe Paanshmëria. Duhet të ekzistojë një filtër për trajtimin e ankesave në themel, në të kundërt gjyqtarët do ta gjejnë veten në mënyrë konstante përballë procedurave disiplinore, të sjella nga palët e zhgënjyera.
- g. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (Prg §77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekznizmat Disiplinorë) Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një trupë e veçantë duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur*
- h. Parimi VI-3 i Rekomandimit (94)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe Rekomandimi 3.12 mbi Rekomandimet e Këshillave për Gjyqësorin në Europës, Rrjeti Europian i Këshillave për Gjyqësorin, Romë 2011 – Raporti 2010-2011, RrEKGj dhe § 17 i Parimeve Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit), i miratuar në Kongresin e shtatë për ndalimin e Krimin dhe Trajtimit të Shkelësve, i mbajtur në Milano nga data 26 Gusht deri në 6 Shtator 1985 dhe i mbështetur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 Nëntorit 1985 dhe 46/146 e 13 Dhjetorit 1985: *“Çështjet Disiplinore duhet të dëgjohen brenda një afati të arsyeshëm dhe duhet të përcaktohet një kuadër kohor për fillimin e procedimit disiplinor dhe vendosjen e një sanksioni disiplinor.*

4.2.2. Komente për nenin 119

Neni 119 i Ligjit për Statusin mbi “Ankesat” përcakton:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga subjektet e mëposhtme:

- a. Ministri i Drejtësisë;*
- b. një anëtar i vetëm i Këshillit;*
- c. kryetari i gjykatës ose i prokurorisë.*

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.

5. Ankesa paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.

6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme¹⁶⁰ për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.

7. Ankesa mund të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara.

8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë publikon modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.”

i. Qëllimi i dispozitës

Neni 119 parashikon të drejtën e ankimimit, subjektet që kanë të drejtë të paraqesin ankesa dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave ndaj magjistratit për shkelje disiplinore. Kjo dispozitë është në harmoni me nenin 3 të ligjit për Statusin që parashikon, si një ndër vlerat që duhet të udheheqë veprimtarinë e magjistratit, atë të ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Këto rregulla, në përputhje me standardet ndërkombëtare, konfirmojnë të drejtën e individëve/personave juridik për t'u ankuar ndaj sjelljeve dhe veprimeve të magjistratit në funksion të realizimit të parimit të llogaridhënies.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Neni 119 është i strukturuar në 8 pika. Në pikat 1 dhe 2 janë parashikuar kategoritë e subjekteve që ka të drejtë të paraqesin ankesë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pika 3 përcakton ndalimin e shqyrtimit të ankesave anonime dhe ruajtjen e konfidencialitetit të ankuesit.

Në pikat 4 dhe 5 të nenit janë të parashikuara të drejtat themelore të ankuesit si dhe mënyra e paraqitjes së ankesës.

¹⁶⁰ Ju lutem referojuni Neni 118 për shpjegimin e termit “shkaqe të mjaftueshme”.

Pika 6 trajton pasojat që rrjedhin në rast të tërheqjes së ankesës. Ndërkohë pikat 7 dhe 8 përcaktojnë aktet që mund të shoqërojnë ankesën dhe formën standarde të ankesës. Ky parashikim i vjen në ndihmë ankuesve duke vendosur detyrimin e ILD për të publikuar modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare me qëllim orientimin dhe lehtësimin e veprimeve të ankuesit.

iii. Komentar i dispozitës

Pika 1 parashikon si më poshtë:

“Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik”

Ky paragraf parashikon si ankues *“çdo subjekt fizik ose juridik”* në përputhje me terminologjinë që përdor Kodi Civil për ndarjen e subjekteve¹⁶¹. Në këtë kategori mund të përfshihet çdo subjekt që mund të ketë pësuar një dëm nga veprimet, mosveprimet, apo sjelljet e magjistratit si në lidhje me ushtrimin e funksionit ashtu edhe jashtë ushtrimit të funksionit.

Pika 2 parashikon si më poshtë:

Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga subjektet e mëposhtme:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) një anëtar i vetëm i Këshillit;
- c) kryetari i gjykatës ose i prokurorisë.

Referuar këtij paragrafi në kategorinë e subjekteve ankuese janë përfshirë disa funksionarë publikë, të cilët ushtrojnë detyra shtetërore dhe që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kanë mundësinë objektive për të marrë të dhëna të besueshme se magjistrati ka kryer shkelje disiplinore. Në këtë kategori të dytë përfshihet:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- c) kryetari i gjykatës ose drejtuese i prokurorisë ku punon magjistrati që dyshohet se ka kryer shkeljen disiplinore (referuar specifikimeve të nenit 194 pika 2 shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar).

Duke iu referuar detyrave dhe kompetencave që këta funksionarë

¹⁶¹ Shiko nenet 1, 24-26 të Kodit Civil.

publikë ushtrojnë referuar ligjeve të posaçme si ligji nr.8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligji nr. 98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, rezulton se secili prej tyre gjatë ushtrimit të funksionit, ka mundësinë e marrjes së informacionit mbi sjelljen dhe veprimet/mosveprimet e magjistratit që mund të konsiderohen si të “dhëna të besueshme” për të besuar se ai/ajo mund të kenë kryer shkelje disiplinore.

Që një informacion apo e dhënë të mund të konsiderohet si e besueshme mund të mbahen në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- të paraqitet nga një burim i besueshëm informacioni (përfaqësues të institucioneve/ zyrtarëve që mbajnë pozicionet përkatëse që i lejojnë ata të kenë një akses në informacion);
- të përmbajë të dhëna të qarta, të kuptueshme, logjike dhe të cilat mund të kontrollohen duke mbledhur prova shtesë nga organe dhe institucione të ndryshme.

Subjektet ankuese që kanë të drejtë të vënë në lëvizje ILD, janë të përcaktuar edhe në nenin 194 pika 2 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Kjo dispozitë ligjore parashikon në shkronjën “c” të tij edhe një subjekt tjetër i cili vë në lëvizje ILD-në nëpërmjet paraqitjes së ankimit me shkrim, përkatësisht Prokurorin e Përgjithshëm. Siç kemi theksuar edhe më sipër, pavarësisht faktit se Prokurori i Përgjithshëm nuk parashikohet shprehimit në pikën 2 të nenit 119, duke qënë drejtues dhe përfaqësues i institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme në kuptim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (neni 13 pika 2 dhe 38 pika 1 të ligjit) Prokurori i Përgjithshëm duhet vlerësuar si një nga subjektet që përfshihen në kategoritë e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 119.

Duhet të theksojmë se në rastin e ankuesit të referuar në këtë paragraf, vënia e dispozicion e provave, informacionit dhe dokumentacionit që përbëjnë të dhëna të besueshme se magjistrati ka kryer shkeljen nuk është një e drejtë, por një detyrim dhe në funksion të parimit të akuzës, sipas të cilit çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore.

Pika 3 parashikon si më poshtë:

“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.”

Ky paragraf i cili përcakton detyrimin e ILD për të shqyrtuar ankesat e paraqitura, është në harmoni me kompetencat që Kushtetuta i ka ngarkuar ILD si organi përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore nda gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillave dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në lidhje me përjashtimin e ankesave anonime të parashikuara në këtë pikë, vlen të përmendet se kjo qasje është në përputhje me standartet ndërkombëtare por edhe me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon procedimin disiplinor të profesioneve të lira në fushën e drejtësisë, ku mund të përmendet ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Ky parashikim ka si qëllim të sigurojë mekanizmat e nevojshëm për mbrojtjen e magjistratëve nga ankesat subjektive dhe abuzive duke ruajtur njëkohësisht edhe rëndësinë e hetimit disiplinor. Pavarësisht se ankesat anonime nuk shërbejnë si bazë për fillimin e hetimit disiplinor, përsëri ato mund të shërbejnë si indicie për fillimit e hetimeve me nismën e vetë ILD në rast se në përmbajtjen e saj ankesa:

- i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për kryerjen e hetimit disiplinor;
- bëhet ndaj sjelljes që magjistratit që ka qënë në detyrë në kohën kur shkelja ka ndodhur;
- bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
- bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

Në këtë rast parashikimet e pikës 3 duhet të shikohen të lidhura me nenin 124 pika 1 të ligjit.

Pika 4 e nenit 119 parashikon si më poshtë:

“4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.”

Ky paragraf garanton respektimin e parimit të transparencës së

veprimtarisë së ILD dhe njëkohësisht i jep mundësinë ankuesit për të marrë pjesë gjatë procedurës disiplinore. Dispozita parashikon që çdo fazë e vendimmarrjes së ILD në lidhje me ankesën duke filluar me marrjen e saj, arkivimin (për shkak të mosplotësisë së kërkesave të pranueshmërisë apo mosekzistencën e fakteve të mjaftueshme për fillimin e hetimit), fillimin e hetimit, shtimin apo ndryshimin e objektit të hetimit dhe mbylljen e hetimit t'i njoftohet brenda 5 ditëve ankuesit. Ky parashikim i jep mundësinë ankuesit të jetë aktiv në proces duke i dhënë të drejtën të paraqesë pretendime dhe prova. Ky njoftim është edhe në funksion të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi garanton të drejtën e ankimit të vendimit të ILD për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.

Duke iu referuar neneve 121 pika 3 dhe 134 pika 2 rezulton se ankimi mund të paraqitet përpara Këshillit përkatës. Në lidhje me afat e paraqitjes së ankimit, bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore ankimi duhet të paraqitet brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Pika 5 e nenit 118 parashikon si më poshtë vijon:

“5. Ankesa paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.”

Referuar këtij paragrafi format e paraqitjes së ankesës të cilat janë: personalisht nga ankuesi, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks. Ky parashikim është në harmoni edhe me nenin 58 dhe 59 të Kodit të Procedurës Administrative dhe krijon njëkohësisht lehtësitë e nevojshme për paraqitjen e ankesave dhe ndaj personave që e kanë të pamundur të paraqiten personalisht pranë zyrës së ILD.

Pika 6 e nenit 118 parashikon si më poshtë vijon:

“6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.”

Ky paragraf trajton tërheqjen e ankesës e cila mund të bëhet në dy momente: i) përpara fillimit të hetimit disiplinor dhe ii) pasi të ketë filluar hetimi disiplinor.

Pasoja e tërheqjes së ankesës është si rregull arkivimi i saj, por paragrafi parashikon edhe një rast përjashtimor. Përjashtimisht, në rast të tërheqjes së ankesës, kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për të filluar hetimin disiplinor vendos fillimin e hetimit me iniciativën e tij bazuar në nenin 124 të ligjit. Ky shkak bën që vendimi për fillimin e hetimit disiplinor të shndërrohet nga një “vendim

i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit”, në një “vendim për fillimin e hetimit me iniciativën e ILD”.

Ky parashikim është në përputhje të plotë me nenin 64 pika 4 të Kodit të Procedurave Administrative që parashikon se tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.

Momenti i dytë i tërheqjes së ankesës është pasi ILD ka nxjerrë vendimin për fillimin e hetimit disiplinor. Në rastin kur ankesa tërhiqet pasi është marrë vendimi për fillimin e një hetimit disiplinor ndaj magjistratit kjo nuk sjell si pasojë mbylljen e hetimit të filluar. Arsyet e tërheqjes së ankesës mund të mbahet në konsideratë nga ILD gjatë procedurës së hetimit disiplinor dhe vlerësimit të rëndësisë, pasojave të shkeljes në rastin e fillimit të procedimit disiplinor.

Pika 7 e nenit 118 parashikon si më poshtë vijon:

“7. Ankesa mund të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara”.

Kjo pikë, parashikon të drejtën e ankuesit për të paraqitur edhe prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara. Ky rregull është një mundësi për ankuesin (person fizik apo juridik) dhe vjen në kuadër të bashkëpunimit gjatë procedurës hetimore.

Pika 8 e nenit 118 parashikon si më poshtë:

“8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë publikon modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave”.

Ky paragraf parashikon detyrimin që ILD të publikojë modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare. Ky parashikim synon lehtësimin e paraqitjes së ankesave por edhe orientimin e duhur të ankuesit në lidhje me elementët dhe kriteret e pranueshmërisë së një ankese. Me urdhrin nr. 65, datë 28.09.2020¹⁶², ILD ka miratuar modelin e formularit të ankesës. Njëkohësisht për të orientuar ankuesit mbi mënyrën e plotësimit të saj si pjesë e këtij akti nënligjor është përfshirë edhe udhëzimi për plotësimin e ankesës.

iv. Nenet e lidhura

Neni 3 i ligjit për Statusin

162 Urdhri mund të aksesohet në linkun: <https://ild.al/ep-content/uploads/2020/10/Urdher-nr.-65-date-28.09.2020.pdf>

Neni 121 pika 3 e ligjit për Statusin
Neni 134 pika 2 e ligjit për Statusin
Neni 124 i ligjit për Statusin
Neni 194 pika 2 shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë
Nenet 58 dhe 59 të Kodit të Procedurave Administrative
Neni 64 pika 4 e Kodit të Procedurave Administrative.

v. Standardet Ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Opinioni nr. 3(2002) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, i cili ka sjellë në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës parimet dhe rregullat që udhëheqin sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në pikën 67, vlerëson se: *“Një çështje e rëndësishme lidhet me hapat që mund të merren nga personat që pretendojnë se kanë vuajtur për shkak të gabimeve profesionale të gjyqtarit. Këta persona duhet të kenë të drejtë të paraqesin çdo ankesë që ata kanë tek personi ose organi përgjegjës për fillimin e procedurës disiplinore...”*
- b. Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarit, e Këshillit të Evropës në parimin 5.3 argumenton se: *“Çdo individ duhet të ketë mundësinë për të paraqitur pa formalitete të veçanta një ankesë që lidhet me dështimin e drejtësisë në një rast të caktuar tek një organ i pavarur”*
- c. Raporti i ENCJ *“Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”*, standarti 5 kërkon që: *“Një ankues normalisht duhet të identifikohet, por nëse një ankesë mund të bëhet nga kushdo, atehërë duhet të ketë një mekanizëm ose një procedurë përmbledhëse me të cilën ankesa mund të rrezohet ose të merret një vendim që ankesa të mos shqyrtohet më tej. Procedura duhet të jetë në kontrollin e një gjykatësi, ose një trupe gjyqtarësh, ose një personi që i përgjigjet drejtpërdrejt Gjyqësorit.”*
- d. Standarti 6 kërkon që: *“Të ketë një person ose një organ përgjegjës para Gjyqësorit i cili ka fuqi të hetojë ankesën. Hetimi duhet të përfshijë mundësinë e marrjes së provave me shkrim dhe / ose me gojë.*
- e. Opinioni nr. 3-(2002) KKGJE(§67) dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë) Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011) parashikon se: *Ankuesit në vetvete nuk mund të kenë të drejtën për të filluar ose këmbëngulur për një veprim disiplinor, por ata duhet të informohen mbi rezultatin e ankesës së tyre.*
- f. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit

- mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një trupë e veçantë duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor, që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur.*
- g. Parimet Bazë të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të shkelësve, 1985 *“Disiplina, pezullimi dhe shkarkimi”* parashikojnë se: *“Një masë apo një ankesë kundër një gjyqtari mbi aftësinë e tij profesionale do të trajtohet me eficientë dhe drejtësi sipas një procedure të caktuar. Gjyqtari ka të drejtë të proces të rregullt. Shqyrtimi i çeshtjes në fazet fillestare të saj do të mbahet konfidencial, përveçse kur kërkohet ndryshe nga gjyqtari”.*
- h. Draft – Deklarata Universale mbi Pavarësinë e Drejtësisë (*“Deklarata Singhvi”*), ECOSOC, 1985 parashikon se: *“Një ankesë kundër një gjyqtari do të trajtohet me eficientë dhe drejtësi sipas një procedure të caktuar dhe gjyqtari do të ketë të drejtë të komentojë mbi ankesën në fazën fillestare. Shqyrtimi i çeshtjes në fazet fillestare të saj do të mbahet konfidencial, përveçse kur kërkohet ndryshe nga gjyqtari”.*
- i. Pika 64 e Opinionit nr.10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGJE) parashikon se: *“Këshillit për Gjyqësorin i janë besuar çështje të etikës; ai mund të adresojë më tej ankesat e palëve ndërgjyqëse. Në mënyrë që të shmangët konflikti i interesit, procedurat disiplinore në instancë të parë, kur nuk janë adresuar brenda juridiksionit të një paneli disiplinor, është e preferueshme të trajtohen nga një komision i përbërë nga një përfaqësim domethënës gjyqtarësh, të zgjedhur nga kolegët e tyre, të ndryshëm nga anëtarët e Këshillit për Gjyqësorin dhe me dispozita për të drejtën e apelit në një gjykatë më të lartë”.*

4.2.3. Komente për nenin 120

Neni 120 i Ligjit për Statusin mbi “Kriteret për pranueshmërinë e ankesës” përcakton:

“1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

- a) *paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;*
- b) *i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;*
- c) *nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.*
- ç) *bëhet ndaj sjelljes së magistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja*

- e pretenduar ka ndodhur;*
- d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
 - dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

2. Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) gjenealitetet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;
- b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;
- c) emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë, në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.”

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij neni është është përcaktimi i kriterëve për pranueshmërinë e ankesës. Ankesa duhet të plotësojë disa kriterë bazë në mënyrë që ajo t'i nënshtrohet shqyrtimit, verifikimit dhe më pas fillimit të një hetimi disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Vlen të theksohen se mosplotësimi qoftë i njëres prej kriterëve të pranueshmërisë do të sjellë si pasojë arkivimin e ankesës.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e strukturuar në dy pragrafë.

Pika 1 e nenit parashikon në mënyrë shteruese kriteret e pranueshmërisë së ankesave. Pavarësisht se në pamje të parë këto kriterë mund të duken formale përmbushja e tyre paraqet rëndësi në lidhje me ecurinë e metejshme të shqyrtimit të ankesës. Pasoja juridike që ligji parashikon në rast të mosplotësimit të një ose më shumë të kriterëve të pranueshmërisë, është ajo e arkivimit të ankesës.

Në pikën 2 të dispozitës trajtohen forma e paraqitjes së ankesës si dhe elementët që ajo duhet të përmbajë.

iii. Komentari i dispozitës

Pika 1 e nenit 120 parashikon si më poshtë:

1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

- a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;
- b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin

- disiplinor;*
- c) *nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.*
 - ç) *bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;*
 - d) *bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;*
 - dh) *bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.*

Kriteret e parashikuara në shkronjën “a” lidhen me formën dhe elementët që duhet të përmbajë nga pikëpamja formale ankesa. Me qëllim që të konsiderohet e pranueshme ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar, të përmbajë gjeneralitetet ankuesit dhe adresën e tij. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme pasi siç parashikohet në nenin 119 pika 3, ILD ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat përveç atyre anonime. Ndërsa elementi i adresës duhet të pasqyrohet në ankim për të mundësuar njoftimin e ankuesit në lidhje me vendimmarrjen e metejshme të ILD dhe për t’i siguruar atij në mënyrë efektive realizimin e të drejtës së ankimit në rast nuk është është dakord me këtë vendimmarrje. Një tjetër element i rëndësishëm që duhet të përmbajë ankesa është një përshkrim i rrethanave të faktit që pretendohet se kanë ndodhur, e cila do të orientojë ILD për të identifikojë nëse ankesa paraqet dyshime të arsyeshme për të besuar se shkelja e pretenduar mund të ketë ndodhur. Me qëllim orientimin e drejtë të subjekteve në paraqitjen e ankesave, ILD ka miratuar me urdhrin nr.65, datë 28.09.2020, modelin e formularit të ankesës së bashku me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, urdhër i cili është publikuar në faqen zyrtare të ILD.

Kriteri i parashikuar në shkronjën “b” është i lidhur me institutin e parashkrimit shues të procesit disiplinor. Vlen të theksohet se përfshirja e institutit të parashkrimit është një risi e këtij ligji, në përputhje me standartet ndërkombëtare. Parashkrimi shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë administrativisht shkeljen disiplinore që pretendohet të jetë kryer nga magjistrati për shkak të kalimit të një kohe të caktuar nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore. Në pikën 1 të nenit 117 parashikohet se afati i parashkrimit për shkeljet disiplinore është 5 vjet. Referuar kësaj dispozite, nëse një ankese paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos arkivimin e saj për shkak të tejkalimit të afatit të parashkrimit. Duke marrë në konsideratë se parashkrimi është një institut juridik i cili sjell si pasojë humbjen e të drejtës për ndjekjen disiplinore të magjistratit, është përcaktuar si një nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës.

Në rastin kur konstatohet se ankesa i referohet fakteve që kanë ndodhur në tejkalim të afatit të parashkrimit vendimi i arkivimit të ankesës duhet të përmbajë një pasqyrë të saktë të datës në cilën pretendohen të ketë ndodhur faktet që përbëjnë shkelje disiplinore, datën që mban vendimi gjyqësor në rastin kur pretendimet e ngritura në ankesë i referohen shkeljeve që mund të kenë ndodhur gjatë procesit gjyqësor si dhe datën në të cilën është paraqitur ankesa. Vendimi duhet të përmbajë një përlogaritje të qartë afateve të parashkrimit të cilat çojnë në përfundimin se ankesa duhet të arkivohet për mospërmbushje të kriterit të pranueshmërisë të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 120 të ligjit për Statusin.

Kriteri i pranueshmërisë së ankesës përcaktuar në shkronjën “c” ka si qëllim mbrojtjen e magjistratëve nga ankesat që dukshëm nuk janë të pabazuara, apo kanë natyrë abuzive, nga njëra anë dhe ana tjetër të ruajë integritetin dhe seriozitetin e procesit të hetimit disiplinor.

Gjatë shqyrtimit fillestar të ankesës ILD shqyrton nëse ankesa është haptazi e pabazuar, përmban elementë abuzivë apo është paraqitur nga i njëjti ankuesi. Këto tre elementë nuk duhet të ekzistojnë në mënyrë komulative. Nesë gjatë shqyrtimit të fillestar vërtetohet qoftë njëri prej këtyre tre elementëve atëherë kjo përbën shkak të mjaftueshëm për arkivimin e ankesës.

Është e rëndësishme të evidentohet fakti që ILD nuk ka asnjë autoritet të shqyrtojë çështje për gabime gjyqësore. Pretendime të lidhura me gabime të tilla mund të kundërshtohen brenda sistemit të gjyqësor nëpërmjet procedurës së ankimit në gjykatën e një shkalle më të lartë.

Kriteri i pranueshmërisë i parashikuar në shkronjën “ç”, është një kriter për tu mbajtur në konsideratë nga ankuesi dhe vjen në linjë edhe me të dhënat që duhet të përmbajë ankesa. Ankesa duhet të identifikojë magjistratin, gjykatën apo prokurorinë ku ka ushtruar funksionin magjistrati në kohën kur nga ndodhur shkelja e pretenduar por ajo çka është e rëndësishme lidhet me faktin që ankesa t'i referohet sjelljes së magjistratit i cili ushtronte funksionin e tij në kohën kur ka ndodhur shkelja që pretendohet. Nëse gjatë shqyrtimit fillestar të ankesës konstatohet se magjistrati ndaj të cilit është paraqitur ankesa i ka përfunduar statusi për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 64 të Ligjit për Statusin ose është shkarkuar nga detyra me vendim të formës së prerë të institucioneve të rivlerësimit kalimtar¹⁶³, pavarësisht se ankesa është paraqitur ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qënë në detyrë në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja, në interpretim të qëllimit të Ligjit për Statusin,

¹⁶³ Neni 66 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

për kryerjen e hetimit disiplinor i cili ka si subjekt magjistratin në detyrë, çdo procedurë e kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë derisa nuk ka filluar hetimi disiplinor, përfundon në rast se magjistrati nuk ushtron më detyrën me vendim të organit kompetent duke sjellë si pasojë arkivim të ankesës. Në këtë rast parashikimet e nenit 120 pika 1 shkronja “ç” duhet parë të lidhura edhe me nenin 134 pika 1 shkronja “ç”, i cili parashikon mbylljen e hetimit në rastin kur magjistratit i mbaron statusi sipas kriterëve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “ç” të nenit 64 të ligjit për Statusin ose nuk ushtron funksionin në mënyrë të përhershme sipas nenit 67 të këtij ligji.

Kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh”, janë parashikuar në funksion të dy parimeve të rëndësishme të procedimit disiplinor të parashikuara në shkronjën “b” pika 1 të nenit 100 të ligjit për Statusin “parimi i ligjshmërisë” dhe “parimi i mosdënimit pa ligj”. Ajo çfarë është e rëndësishme të theksohet është që pretendimet e ankuesit duhet t’i referohen sjelljes, veprimeve/mosveprimeve të magjistratit të cilat janë klasifikuar si shkelje disiplinore, nga ligji në momentin kur pretendohet se shkelja ka ndodhur. Pra magjistrati nuk mund të hetohet, të procedohet disiplinarisht dhe as nuk mund të dënohet me një masë disiplinore për një shkelje disiplinore që nuk parashikohej si e tillë nga ligji, në kohën kur shkelja është kryer (e lidhur me edhe me mosdhënien e efektit prapaveprues të ligjit gjatë procesit disiplinor).

Njëkohësisht ankesa duhet t’i referohet sjelljes së magjistratit që nëse provohet se është kryer përbën shkelje disiplinore sipas ligjit. Kjo lidhet me faktin që ankesa duhet të përmbajë shpjegime për fakte dhe rrethana të sjelljes apo veprimeve/mosveprimeve të magjistratit, për të cilat organi që ushtron hetimin disiplinor dhe vendos për fillimin e procedimit disiplinor, duke iu referuar provave, fakteve dhe dokumentave të krijuara dyshimin e arsyeshëm për të besuar që magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

iv. Nenet e lidhura

Neni 64 i ligjit për Statusin

Neni 67 i ligjit për Statusin

Neni 100 i ligjit për Statusin

Neni 117 i ligjit për Statusin

Neni 119 pika 3 i ligjit për Statusin

Neni 121 i ligjit për Statusin

Neni 134 pika 1 shkronja “ç” e ligjit për Statusin

Neni 66 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Komisioni i Venecias: “Komente mbi prapaveprueshmërinë e parashkrimit në Gjeorgji”, 523, 2009);
- b. Rrjeti Evropian i Këshillave të Gjyqësorit, *Standardet Minimale Gjyqësore V: Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve*, 5 Qershor 2015;
- c. Opinioni nr. 3 (2020) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGJE) (§ 67) dhe nën vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi parimet dhe rregullat qeverisëse të gjyqtarëve, sjellja profesionale në mënyrë të veçantë etika, sjellja e papërputhshme dhe Paanshmëria parashikon se: *“Duhet të ekzistojë një filtër për trajtimin e ankesave në themel, në të kundërt gjyqtarët do ta gjejnë veten në mënyrë konstante përballë procedurave disiplinore, të sjella nga palët e zhgënjyera”*.
- d. Opinioni nr. 1 (2001) i KKGJE (§ 69), Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe § 66 i Rekomandimit CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe Parimi Themlor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: *“Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njej palëve ndërgjyqëse”*.
- e. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një trupë e veçantë duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”*.

4.2.4. Komente për nenin 121

Neni 121 i Ligjit për Statusin mbi “Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës” përcakton:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme.

2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:

- a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuara në pikën 1, të nenit 120, të këtij ligji;
- b) të verifikojë ankesën;
- c) të fillojë hetimin.

3. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

i. Qëllimi i dispozitës:

Qëllimi i këtij neni është përcaktimi i rregullave në lidhje me shqyrtimin fillestar dhe vlerësimin e ankesës dhe vendimmarrjen që merr ILD pas këtij shqyrtimi.

ii. Fushëveprimi i dispozitës:

Dispozita është e strukturuar në 3 paragrafë. Pikat 1 dhe 2 parashikojnë shqyrtimin fillestar të ankesës dhe pasojat e mundshme që rrjedhin nga procesi i shqyrtimit, përkatësisht:

- arkivimi i ankesës për mosplotësim të një apo disa kritereve të pranueshmërisë;
- verifikimi i ankesës; dhe
- fillimi i hetimit disiplinor.

Pika 3 parashikon mundësinë e ankuesit dhe të magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, për tu njohur me vendimmarrjen e ILD për arkivimin e ankesës dhe detyrimin e ILD për të njoftuar këtë vendim brenda një afati 5 ditor nga marrja e saj. Në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor është parashikuar e drejta e ankuesit për të ankimuar vendimin përkatës të arkivimit në këshillin përkatës.

iii. Komentari i dispozitës:

Pika 1 e nenit 121 parashikon si më poshtë:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme.

Ky paragraf parashikon që pas marrjes së ankesës dhe konfirmimit të ankuesit për marrjen e saj brenda 5 ditëve (neni 119 pika 4) ILD fillon shqyrtimin e saj fillestar. Shqyrtimi fillestar i ankesës përfshin verifikimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, të

parashikuara në nenin 120 të ligjit për Statusin. Përmbushja e kriterëve të pranueshmërisë siç e kemi theksuar edhe më parë përbën një element të rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë për ecurinë e ankesës. Ky moment përbën edhe shqyrtimin fillestar të ankesës.

Pika 2 e nenit 121 parashikon si më poshtë:

“2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:

- a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriterë të parashikuara në pikën 1, të nenit 120, të këtij ligji;
- b) të verifikojë ankesën;
- c) të fillojë hetimin.

Paraqitja e ankesës ka si pasojë të parë fillimin e shqyrtimit fillestar të saj dhe ka si rrjedhojë detyrimin e ILD për vlerësimin e saj dhe marrjen e një vendimi në përfundim të shqyrtimit fillestar i cili mund të jetë:

- a) Vendimi për arkivimin e ankesës. ILD vendos për arkivimin e ankesës, nëse kjo e fundit nuk përmbush një ose më shumë kriterë të pranueshmërisë të parashikuara në pikën 1 të nenit 120 të ligjit për Statusin. Ky parashikim vë theksin tek rëndësia e këtyre kriterëve, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe të njëkohshme në mënyrë që ankesa të konsiderohet e pranueshme dhe ILD të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm. Në rastin kur edhe vetëm një prej këtyre kriterëve nuk mosplotësohet ILD vendos për arkivimin e ankesës.

Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, ankuesit mund ti kërkohet plotësimi i të metave të ankesës, në përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë, duke i caktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Në veçanti plotësimi i të metave mund të aplikohet për kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në shkronja “a” ose “dh” të pikës 1 të nenit 120 të këtij ligji.

- b) Vendimi për verifikimin e ankesës. Pavarësisht se dispozita nuk e specifikon në mënyrë të shprehur, vendimi për verifikimin e ankesës merret kur kjo e fundit i përmbush kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në pikën 1 të nenit 120, por për shkak se ankesa nuk përmban informacion të qartë, ILD vendos verifikimin e ankesës në përputhje me nenin 122 të ligjit. Në rast se ILD vendos të verifikojë ankesën, ai ka të drejtë t'i kërkojë ankuesit çdo të dhënë, dokument apo shpjegim shtesë për rrethanat në të cilat pretendohet se ka ndodhur shkelja. Njëkohësisht ILD gëzon të drejtën të marrë informacionin që e konsideron të nevojshëm për qëllimet e kryerjes së verifikimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë, gjykata apo

prokuroria përkatëse (pranë të cilës ushtron funksionin magjistrati për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen).

- c) Vendimi i fillimit të hetimit. Vendimi i fillimit të hetimit merret nga ILD kur ankesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë dhe nëse nga shqyrtimi krijohet dyshime të arsyeshme¹⁶⁴ se shkelja mund të jetë kryer bazuar në faktet dhe provat e mbledhura që justifikojnë fillimin e hetimit. ILD ka në dispozicion një afat 3 muajor nga marrja e ankesës brenda së cilës mund duhet të përfundojë fazën e parë të procedurës disiplinore dhe të vendosë për të filluar hetimin me ankesë (sipas parashikimeve të nenit 123 të ligjit) ose kryesisht prej tij në përputhje me kërkesat e nenit 124 të ligjit.

Pika 3 e nenit 121 parashikon si më poshtë:

“3. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Referuar këtij paragrafi vendimi për arkivimin e ankesës në rast mospërmbushje të një ose disa kriterëve të pranueshmërisë jepet i arsyetuar. Arsyetimi i vendimit është në harmoni edhe me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative i cili në nenin 100 të tij kërkon që aktet administrative të jenë të arsyetuara. Vendimi i arkivimit i njoftohet ankuesit dhe magjistratit kundrejt të cilit është paraqitur ankesa brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi. Dispozita parashikon njëkohësisht të drejtën e ankuesit për të ankimuar në Këshill, vendimin e arkivimit të ankesës brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Dispozita shfaq mangësi në lidhje me vendimmarrjen e Këshillit pas shqyrtimit të ankesës kundër vendimit të arkivimit.

Këshillat, në këtë rast, mund të vendosin rrëzimin e ankesës duke konfirmuar vendimmarrjen e ILD ose pranimin e saj, duke i kërkuar ILD kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

Rregulla të detajuara në lidhje me vendimmarrjen e Këshillave gjatë shqyrtimit të ankimeve kundër vendimeve të arkivimit të ankesave vlerësohet se do të përcaktohen me akte nënligjore të këshillave respektivë.

Ligji nuk parashikon nëse vendimi për rrëzimin e ankesës së Këshillit përkatës është një vendim i formës së prerë. Nëse ky do të kish qënë

¹⁶⁴ Ju lutem referojuni shpjegimeve të dhëna në komentet e nenit 118 për termin “dyshime të arsyeshme”.

qëllimi i legjislatorit kjo duhet të ishte parashikuar në dispozita ligjore. Për rrjedhojë, në rast se Këshilli përkatës vendos rrëzimin e ankesës duke lënë në fuqi vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankesës bazuar në nenin 100 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ankuesi ka të drejtën t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

iv. Nenet e lidhura

Neni 119 pika 4 i ligjit për Statusin

Neni 120 i ligjit për Statusin

Neni 122 i ligjit për Statusin

Neni 123 i ligjit për Statusin

Neni 124 i ligjit për Statusin

Neni 100 i Kodit të Procedurave Administrative

Neni 100 pika 1 i ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Udhëzimi praktik mbi kriteret e pranueshmërisë, e përditësuar më 30 prill 2020, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Udhëzimi mbi Nenin 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për liri dhe siguri”, e përditësuar më 31 Gusht 2020, Këshilli i Europës;
- c. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)”, e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;
- d. Opinioni nr.3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii) dhe Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë) Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): “Një trupë e posaçme duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”.
- e. Neni 6.3 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Parimi VI-3 i Rekomandimit nr. (94) 12 të Komitetit të Minsitrave të Këshillit të Europës dhe paragrafi 64 i Opinionit nr. 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europeanë (§72) dhe Opinioni nr. 3 (2002)

KKGJE dhe Parimi Themelor nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, i miratuar gjate mbledhjes plenare të njëmbëdhjetë të KKGJE, në Strasburg 17-19 Nëntor 2010: *“Duhet të ketë instrumenta kundër vendimeve disiplinore. Shqyrtimi në apel duhet të kryhet përpara një gjykate më të lartë”*.

- f. Opinioni nr. 1 (2001) KKGJE (§ 69), dhe Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe § 66 të Rekomandimit CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe Parimi Themelor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: *“Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohej vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse”*.
- g. Parimet Bazë të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të shkelësve, 1985 *“Disiplina, pezullimi dhe shkarkimi”* parashikojnë se: *“Një masë apo një ankesë kundër një gjyqtari mbi aftësinë e tij profesionale do të trajtohet me efikasitet dhe drejtësi sipas një procedure të caktuar. Gjyqtari ka të drejtën për një proces të rregullt. Shqyrtimi i çështjes në fazet fillestare të saj do të mbahet konfidencial, përveçse kur kërkohet ndryshe nga gjyqtari”*.
- h. Draft – Deklarata Universale mbi Pavarësinë e Drejtësisë (*“Deklarata Singhvi”*), ECOSOC, 1985 parashikon se: *“Një ankesë kundër një gjyqtari do të trajtohet me efikasitet dhe drejtësi sipas një procedure të caktuar dhe gjyqtari do të ketë të drejtë të komentojë mbi ankesën në fazën fillestare. Shqyrtimi i çështjes në fazet fillestare të saj do të mbahet konfidencial, përveçse kur kërkohet ndryshe nga gjyqtari”*.

4.2.5. Komente për nenin 122

Neni 122 i Ligjit për Statusin *“Verifikimi i ankesës”* përcakton:

“1. Për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t’i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

4. Në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit,

ankesa arkivohet.

5. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.”

i. Qëllimi i dispozitës

Ky nen ka si qëllim detajimin e procedurës së verifikimit të ankesës, e cila përmbush kriteret e pranueshmërisë. Kjo dispozitë vjen në harmoni me kompetencat kushtetuese të përcaktuara për ILD nga neni 147/d i Kushtetutës, normë e cila parashikon se ILD është organi përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Kjo dispozitë ligjore është strukturuar në pesë paragrafë. Kjo dispozitë mbulon të gjithë procesin e verifikimit duke filluar nga arsyet e verifikimit, duke vazhduar me mënyrat e mbledhjes së informacionit shtesë dhe finalizimin e procesit të verifikimit me një nga pasojat e mundshme, atë të arkivimit të ankesës.

Pika 1 përcakton rastet kur ILD, merr një vendim për verifikimin e ankesës.

Pikat 2 dhe 3 përcaktojnë subjektet të cilat mund të vënë në dispozicion informacion dhe dokumentacion shtesë për ILD të cilët janë këshillat, gjykatat dhe prokuroritë përkatëse dhe ankuesi.

Pika 4 parashikon mundësinë e ILD për arkivimin e ankesës në rastin kur pas kryerjes së verifikimit nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit.

Pika 5 parashikon detyrimin e ILD për të njoftuar vendimin e arkivimit të ankesës pas verifikimit ankuesit dhe magjistratit brenda një afati 5 ditor nga marrja e saj. Në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor është parashikuar e drejta e ankuesit për të ankimuar vendimin përkatës të arkivimit në këshillin përkatës.

iii. Komentari i dispozitës

Pika 1 e nenit 122, parashikon si më poshtë:

“1. Për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit.

Ky paragraf, parashikon të drejtën e ILD për të verifikuar ankesën që nuk përmban informacion të qartë për sa i takon ekzistencës së fakteve dhe rrethanave që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor, e cila formalizohet nëpërmjet një vendimi. Është e rëndësishme të theksojmë se, që ankesa t'i nënshtrohet procedurës së verifikimit duhet që paraprakisht të ketë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në pikën 1 të nenit 120 të ligjit. Megjithatë çështja e qartësisë së informacionit që përmban një ankesë është një çështje e cila do të vlerësohet rast pas rasti në procedurën e shqyrtimit në ankesës me qëllim përfundimtar për të mbledhur faktet, të dhënat dhe informacion e mjaftueshëm, që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor, vlerësimi i ankesës duhet ti japë përgjigje këtyre pyetjeve minimum:

- Nëse faktet i referohen qartë sjelljes disiplinore, cila është shkelja përkatëse?
- A ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin për kryerjen e shkeljes disiplinore?
- A mund ta vlerësojmë rastin si një çështje të vlerësimit të performancës apo jo?
- A ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme që shkelja është kryer nga një magjistrat?
- Ku është caktuar ky gjyqtar për të përmbushur detyrimet e tij / saj?
- Si të vlerësohet afati i parashkrimit? etj.

Pika 2, e nenit 122, parashikon si më poshtë:

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar

Pika 3 e nenit 122, parashikon si më poshtë:

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Parashikimet e bëra në pikat 2 dhe 3 janë në funksion të detajimit të procedurës së verifikimit. Ky paragraf përshkruan veprimet që ka të kryejë ILD në këtë fazë siç janë:

- t'i drejtohet ankuesit duke i kërkuar paraqitjen e të dhënave, dhe dokumentacionit shtesë në lidhje me rrethanat dhe mënyrën që ka ndodhur shkelja që pretendohet se është kryer nga magjistrati.
- t'i drejtohet ankuesit duke i kërkuar të japë shpjegime shtesë në lidhje

me rrethanat dhe mënyrën që ka ndodhur shkelja që pretendohet se është kryer nga magjistrati.

- t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqsor sipas rastit, apo gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati për të cilin ka pretendime se ka kryer një shkelje disiplinore.

Nga përmbajtja e këtij paragrafi rezulton se procedura zhvillohet jo vetëm në formë të shkruar, nëpërmjet kërkimit dhe marrjes së dokumentacionit por edhe në mënyrë verbale nëpërmjet pyetjes së ankuesit. Marrja e informacionit dhe pyetja e ankuesit në këtë fazë nuk është e detyrueshme të realizohet në mënyrë formale në ndryshim nga procedura e marrjes në pyetje të magjistratit, dëshmitarëve ose të personave të tjerë gjatë fazës së hetimit disiplinor. Është në vlerësimin e ILD për të gjykuar formën më të mirë të marrjes së informacionit dhe nëse është e nevojshme pasqyrimi në një procesverbal i pyetjeve të drejtuara dhe informacionit të dhënë nga ankuesi. Në rast të paraqitjes së dokumentacionit me shkrim nga ankuesi gjatë dhënies së shpjegimeve në formë verbale është e këshillueshme që këto dokumente të protokollohen zyrtarisht dhe të përfshihen në dosje.

Njëkohësisht duke iu referuar këtij neni rezulton edhe roli aktiv i ILD-së, në procedurën e verifikimit. Në këtë rast ai mund t'i drejtohet edhe kryesisht Kryetarit të gjykatës, Drejtuesit të Prokurorisë apo edhe Këshillit përkatës për të marrë prej tyre informacionet, të dhënat e nevojshme, të cilat do të krijojnë dyshimin e arsyeshem se shkelja ka ndodhur në mënyrë që të argumentohet fillimi i hetimit disiplinor apo nëse nuk ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit, arkivimin e ankesës.

Në referencë të nenit 118 pika 1 është parashikuar që kjo procedurë të zgjasë për një afat 3 mujor. Ky afat mund të konsiderohet i mjaftueshem që kryerjen e veprimeve të tilla si: identifikimin e informacionit të paqartë, mbledhjen e informacionit nga ankuesi ose të tretët nëpërmjet korrespondencës së shkruar apo në mënyrë verbale, analizimin e fakteve dhe informacionit të mbledhur për të arritur në konkluzionin e arkivimit të ankesës apo fillimit të hetimit disiplinor.

Pika 4 e nenit 122, parashikon si më poshtë:

"4. Në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet.

Ky paragraf, parashikon mundësinë e arkivimit të ankesës. Në ndryshim nga parashikimi i dispozitës pararendëse (neni 121 pika 2 shkronja "a" i ligjit për Statusin) e cila parashikon arkivimin e ankesës në rast të mosplotësimit të një ose disa kritereve të pranueshmërisë, ky

paragraf parashikon një rast tjetër të arkivimit të ankesës, atë që merret në përfundim të procedurës së verifikimit. Vendimi i arkivimit në këtë rast merret ndaj ankesës që në aspektin formal i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë por që pas analizës ligjore të dokumentacionit, informacionit, dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës së verifikimit rezulton se faktet janë të pamjaftueshme për të justifikuar vendimmarrjen për fillimin e një hetimi disiplinor.

Pika 5 e nenit 122, parashikon si më poshtë:

“5. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.”

Sipas kërkesave të kësaj pike, vendimi për arkivimin e ankesës në rastin e fakteve të pamjaftueshme që të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor duhet të jepet i arsyetuar. Arsyetimi i vendimit është në harmoni edhe me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative i cili në nenin 100 të tij, kërkon që aktet administrative të jenë të arsyetuara. Arsyetimi duhet të jetë i qartë dhe mund të përmbajë: një përmbledhje të pretendimeve, informacionit dhe të dhënave të parashtruara nga ankuesi; një analizë të procedurës së verifikimit të kryer nga ILD. Vendimi i arkivimit i njoftohet ankuesit dhe magjistratit kundrejt të cilit është paraqitur ankesa brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi. Dispozita parashikon njëkohësisht të drejtën e ankuesit për të ankimuar në Këshill, vendimin e arkivimit të ankesës brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Këshillat, në këtë rast, mund të vendosin rrëzimin e ankesës duke konfirmuar vendimmarrjen e ILD ose pranimin e saj, duke i kërkuar ILD kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

Rregulla të detajuara në lidhje me vendimmarrjen e këshillave gjatë shqyrtimit të ankimeve kundër vendimeve të arkivimit të ankesave vlerësohet se do të përcaktohen me akte nënligjore të këshillave respektivë.

Ligji nuk parashikon nëse vendimi për rrëzimin e ankesës së Këshillit përkatës është një vendim i formës së prerë. Nëse ky do të kish qënë qëllimi i legjislatorit kjo duhet të ishte parashikuar në dispozita ligjore. Për rrjedhojë në rast se Këshilli përkatës rrëzimin e ankesës duke lënë në fuqi vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankesës, bazuar në nenin 100 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ankuesi ka të drejtën t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

iv. Nenet e lidhura

Neni 147/d i Kushtetutës

Neni 118 pika 1 ligjit për Statusin

Neni 120 i ligjit për Statusin

Neni 121 pika 2 shkronja "a" për Statusin

Neni 122 i ligjit për Statusin

Neni 123 i ligjit për Statusin

Neni 100 i Kodit të Procedurave Administrative

Neni 100 pika 1 i ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Udhëzimi praktik mbi kriteret e pranueshmërisë, e përditësuar më 30 prill 2020, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Udhëzimi mbi Nenin 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, "E drejta për liri dhe siguri", e përditësuar më 31 Gusht 2020, Këshilli i Europës;
- c. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, "E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)", e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;
- d. Opinioni nr. 1 (2001)-KKGJE (§ 69), Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave (§ 66) dhe Parimi Themelor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: "Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të krijohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse".
- e. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§ 67): "Duhet të ekzistojë një filtër për trajtimin e ankesave në themel, në të kundërt gjyqtarët do ta gjejnë veten në mënyrë konstante përballë procedurave disiplinore, të sjella nga palët e zhgënjyera"
- f. Paragrafi §60 i Opinionit nr.3-(2002) i KKGJE këshillon se nuk është korrekte të ndërthuren mosrespektimi i standardeve profesionale me shkëlqen që mund të sjelli potencialisht masa disiplinore. Këto duhet të jenë shkëlqje tepër serioze dhe të jo të dështohet për të vëzhguar standartet, të cilat përbëjnë praktikën më të mira (referuar Opinioni të Përbashkët Nr. 588/2010 të Komisionit të Venecias për Ukrainën dhe Parimi Themelor nr. 18 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, e miratuar gjatë mbledhjes plenare të KKGJE, në Strasburg më 17-19

- Nëntor 2010, § 72 i Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe § 57/58 i Opinionit nr. 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë.
- g. Parimet e Bangalores dhe Komentari i tyre janë një mjet i shkelqyer për të ofruar udhëzime mbi kuptimin e vijës së hollë që ndan çështjet e performancës dhe shkeljet disiplinore, të cilat mund të ndihmojnë në situatë të ndryshme, në mënyrë që të kemi një pamje të qartë nëse jemi ose jo përpara një shkelje disiplinore.
- h. Opinioni nr. 3-(2002)KKGJE (§67), dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Ankuesit në vetoete nuk mund të kenë të drejtën për të filluar ose insituar për një veprim disiplinor, por ata duhet të informohen mbi rezultatin e ankesës së tyre”*.
- i. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një trupë e posaçme duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”*.

4.2.6. Komente për nenin 123

Neni 123 i Ligjit për Statusin “Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit” përcakton:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të një procesi gjyqësor apo administrativ në lidhje me të njëjtat fakte.

3. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:

- a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
- b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar;
- c) parashtrimin e rrethanave dhe fakteve të pretenduara;
- ç) provat e mbledhura;

- d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;
- dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtrësë dhe dokumente mbështetëse brenda tre javëve nga marrja e vendimit.

4. Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit, sipas pikës 3, shkronja "b", të këtij neni, përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura."

i. Qëllimi i dispozitës

Dispozita ka si qëllim përcaktimin e rregullave të qarta për fillimin e një hetimi disiplinor bazuar në ankesë si dhe elementët që përmban vendimi për fillimin e hetimit disiplinor. Kjo dispozitë është në harmoni me kompetencën që Kushtetuta i ka dhënë ILD bazuar në nenin 147/d për kryerjen e hetimit disiplinor.

i. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e strukturuar në katër paragrafë që rregullojnë aspekte të ndryshëm të procesit të fillimit të hetimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve.

Pika 1 parashikon standardet për fillimin e hetimit disiplinor. Fillimi i hetimit duhet të bazohet në faktet dhe provat e mbledhura që duhet të sjellin dyshime të arsyeshme që një shkelje disiplinore mund të ketë ndodhur. Bazuar në analizën e fakteve dhe provave dhe përfundimet përkatës, ILD mund të nxjerrë një vendim për fillimin e hetimit disiplinor.

Pikat 2 dhe 3 rregullojnë elementët minimale formale, që duhet të përmbajë vendimi për fillimin e hetimit disiplinor.

Pika 4 trajton situatat kur ILD ka mbledhur informacion lidhur me sjellje ose veprime të përsëritura të magjistratit në raste të tjera, objekti i hetimit duhet të përmbajë edhe sjelljet e magjistratit në këto raste, në lidhje me të njëjtën situatë.

ii. Komentari i dispozitës

Pika 1, e nenit 123 parashikon si më poshtë:

"1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.

Ky paragraf trajton rastin kur ILD merr një vendim për fillimin e hetimit disiplinor. Dispozita kërkon një që vendimmarrja për fillimin e hetimit të mbështetet në dyshimin e arsyeshëm¹⁶⁵ se shkelja mund të ketë ndodhur duke u mbështetur në faktet dhe të dhënat e mbledhura gjatë procedurës së verifikimit të ankesës. ILD-ja mund të nxjerrë një vendim për fillimin e hetimit disiplinor kur nga analiza ligjore e fakteve, të dhënave, informacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit krijohet dyshimi i arsyeshëm që magjistrati mund të ketë kryer veprime apo sjellje që konsiderohen shkelje disiplinore në kuptim të ligjit.

Hetimi disiplinor mund të fillojë edhe pa një procedurë paraprake të verifikimit kur ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga ankesa dhe dokumentacioni që e shoqëron atë, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se shkelja disiplinore mund të ketë ndodhur.

Pika 2, e nenit 123, parashikon si më poshtë:

“2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të një procesi gjyqësor apo administrativ në lidhje me të njëjtat fakte.

Ky paragraf parashikon se marrja e vendimit për fillimin e një hetimi disiplinore në rast të plotësimit të kushtit të parashikuar nga pika 1, nuk të pengohet edhe nëse është duke u zhvilluar një procedurë tjetër administrative apo një proces gjyqësor në lidhje me të njëjtat fakte. Ky paragraf duhet të shikohet i lidhur me nenin 126 të ligjit, i cili parashikon mundësinë e pezullimit të hetimit disiplinor tashmë të filluar me vendim të ILD në rastin kur gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor dalin pengesa objektive në përcaktimin e faktit disiplinor. Pra ekzistenca e një procesi tjetër gjyqësor (qoftë me natyrë penale, civile apo administrative) apo zhvillimi i një procesi administrativ në lidhje me të njëjta fakte nuk do të pengojë fillimin e hetimit, por mund të pezullojë zhvillimin e tij në rast të plotësimit të kushteve të parashikuara nga neni 126.

Pika 3, e nenit 123 parashikon si më poshtë:

“3. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:

- a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
- b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar;
- c) parashtrimin e rrethanave dhe fakteve të pretenduara;
- ç) provat e mbledhura;
- d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;

¹⁶⁵ Referojuni shpjegimeve të dhëna për termin “dyshim i arsyeshëm” në komentet e nenit 118.

dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtrësë dhe dokumente mbështetëse brenda tre javëve nga marrja e vendimit.

Ky paragraf kërkon që vendimi i ILD për fillimin e hetimit të jetë i arsyetuar dhe t'i njoftohet subjektit që ka paraqitur ankesën, magjistratit dhe Këshillit përkatës.

Paragrafi nuk ka përcaktuar një afat të komunikimit të vendimit, por në këtë rast duhet bërë referim te neni 119 pika 4, i ligji për Statusin, i cili përcakton ndërmjet të tjerave se vendimi i fillimit të hetimit i njoftohet ankuesit brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Pavarësisht se neni 119 pika 4 nuk përcakton shprehimisht që ky afat do të zbatohet edhe për njoftimin e Këshillit përkatës dhe magjistratit, prezumojmë që do të aplikohet i njëjti afat edhe për njoftimin e këtij vendimi magjistratit dhe Këshillit. Njoftimi i vendimit të fillimit të hetimit magjistratit dhe ankuesit është veçanërisht i rëndësishëm dhe në funksion të realizimit të të drejtës së tyre për të paraqitur parashtrime dhe prova shtesë brenda 3 javëve nga marrja dijeni për vendimin.

Paragrafi përcakton qartazi informacionin minimal, që mund të përfshihet në vendimin e fillimit të hetimit. Legjislatori i ka kushtuar rëndësi të veçantë elementëve që duhet të përmbajë vendimi i fillimit të hetimit pasi të gjitha vendimet dhe aktet e tjera që mund të nxirren gjatë hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor i referohen këtij vendimi bazë. Kjo është arsyeja që kërkesat e këtij paragrafi të nenit 123 janë kaq rigoroze dhe duhet të zbatohen përkatësisht.

Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor duhet të përmbajë të paktën:

- emrat e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
- objektin e hetimit duke iu referuar shkeljes së pretenduar;
- prezantimin e fakteve dhe rrethanave të pretenduara;
- provat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit;
- afatet kohore përkatëse për hetimin; dhe
- të drejtat e magjistratit gjatë hetimit disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të depozituar deklarata dhe dokumente shtesë brenda tre javëve nga marrja e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor.

Nxjerrja e vendimit është një parakusht tepër i rëndësishëm për zbatimin e parimeve të parashikuara në Nenin 100 të ligjit për Statusin. Secila e dhënë që përmendet në këtë paragraf paraqet rëndësi në funksion të disa aspekteve të hetimit siç janë:

- organizimi i duhur i veprimeve hetimore;
- përgjegjshmëria në analizën e fakteve dhe provave të mbledhura;
- monitorimi dhe kontrolli i afateve të hetimit;
- të drejtat e magjistratit nën hetim;
- bashkëpunimin me Këshillat etj.

Paragrafi përcakton të dhënat minimale që duhet të përmbajë vendimi për fillimin e hetimit disiplinor. Ndërkohë që ky paragraf duhet parë i lidhur me nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative që parashikon arsyetimin e aktit administrativ. Këto dy parashikime duhet të shikohen si komplementare të njëra-tjetrës.

Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor është një akt administrativ me karakter individual. Sipas nenit 3 pika 1 shkronja "a" të Kodit të Procedurave Administrative "akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Duke marrë njëkohësisht në konsideratë sa më sipër dhe faktit që vendimi i fillimit të hetimit disiplinor i referohet një subjekti qartësisht të identifikueshëm, vlerësojmë se pjesa arsyetuese në përputhje me elementët që kërkon neni 100 i Kodit të Procedurave Administrative të bëhet pjesë integrale e vendimit për fillimin e hetimit dhe të mos jetë pjesë e një akti të veçantë. Për më tepër, siç analizohet më sipër, Ligji për Statusin nuk parashikon ndonjë akt tjetër që të përpilohet nga ILD-ja gjatë verifikimit të ankesës dhe/ose para nxjerrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor. Kjo nënkupton që vendimi i fillimit të hetimit duhet të përmbajë jo vetëm informacionin e detyrueshëm të përcaktuar në pikën 3 të nenit 123 por duhet edhe të arsyetohet sipas nenit 100 të KPA.

Duke qënë se vendimi i fillimi të hetimit përbën edhe aktin më të rëndësishëm formal për të iniciuar procedurën hetimore, nëpërmjet të cilës ILD fillon të hetojë administrativisht pretendimet e ankuesit për kryerjen e një shkelje nga magjistrati legjislatori me të drejtë nuk parashikon mundësi ankimi ndaj këtij vendimi.

Pika 4 e nenit 123, parashikon si më poshtë:

"4. Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit, sipas pikës 3, shkronja "b", të këtij neni, përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura."

Ky paragraf i referohet objektit të hetimit në kuptim të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni. Në të njëjtën kohë ky paragraf në mënyrë të qartë rekomandon që në vendimin e fillimit të hetimit disiplinor të përfshihen edhe sjelljet e magjistratit në raste të tjera në lidhje me të njëjtën situatë. Qëllimi kryesor i këtij paragrafi është ti japë ILD instrumentet e nevojshëm për të përfshirë në objektin e hetimit fakte të lidhura me sjellje apo veprime të magjistratit në raste të tjera, të lidhura me të njëjtën situatë.

Për shembull në rastin kur ankesa përmban pretendime për vonesa në arsyetimin e vendimit gjyqësor në një çështje specifike gjyqësore dhe gjatë procesit të verifikimit konstatohet se vonesat kanë ndodhur jo vetëm në një rast specifik, por edhe në raste të tjera gjatë një periudhe të ndryshme kohore, këto raste të tjera mund të përfshihen në objektin e hetimit disiplinor. Parashikimet e këtij paragrafi duhet të interpretohen të lidhura me parashikimet e nenit 122 pika 3 të ligjit për Statusin.

iii. Nenet e lidhura

Neni 147/d i Kushtetutës

Neni 100 i ligjit për Statusin

Nenet 102,103 dhe 104 i ligjit për Statusin

Neni 119 pika 4 i ligjit për Statusin

Neni 122 pika 3 i ligjit për Statusin

Neni 126 i ligjit për Statusin

Neni 100 i Kodit të Procedurave Administrative

iv. Standardet ndërkombëtare dhe përputshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB ne vitin 1985;
- c. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”.
- d. Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015 Standardet.
- e. Opinioni nr. 3-(2002) KKGJE (paragrafi §60) këshillon se nuk është korrekte të ndërthuren mosrespektimi i standardeve profesionale me shkeljen që mund të sjellë potencialisht masa disiplinore. Këto duhet të jenë shkelje tepër serioze dhe jo të dështohet për të vëzhguar standardet të cilat përbëjnë praktikat më të mira (referuar Opinioni të

- Përbashkët Nr. 588/2010 të Komisionit të Venecias për Ukrainën dhe Parimi Themelor nr. 18 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, e miratuar gjatë mbledhjes plenare të KKGJE, në Strasburg më 17-19 Nëntor 2010 dhe § 72 i Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe § 57/58 të Opinionit nr 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë).
- f. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010, Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një organ i posaçëm duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”*.
 - g. Rekomandimi i CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare “Mbi Pavarësinë, Eficencën dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve” Kapitulli VI- Statusi i Gjyqtarëve – (§ 69) – “Kapitulli VII- Detyra dhe Përgjegjësitë” parashikon se: *“Procedimet disiplinore mund të fillojnë kur gjyqtari dështon të përmbushë detyrimet e tij në mënyrën e duhur dhe eficiente. Këto procedime duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose nga një panel, me të gjitha garancitë e një procesi të drejtë dhe t’i mundësohet gjyqtarit e drejta për të ankimuar vendimin dhe masën disiplinore. Masa disiplinore duhet të jetë propocionale”*.
 - h. Opinioni nr. 1 (2001)-KKGJE (§ 69), Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave (§ 66) dhe Parimi Themelor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: *“Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse”*.
 - i. Parimi VI i rekomandimit nr. (94)12 për Pavarësinë, Efiçencën dhe Rolin e Gjyqtarëve, të Komitetit të Ministrave më 13 Tetor 1994 në takimin e 518-të (§ 1) parashikon se: *“Në rast të një shkeljeje disiplinore, duhe marrë të gjitha masat e nevojshme, të cilat nuk paragjykojnë pavarësinë gjyqësore”*.
 - j. Karta Universale e Gjyqtarëve, Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve (SHNGJ) 1999 “Administrimi dhe veprimi disiplinor” parashikon se: *“Administrimi dhe veprimtaria disiplinore. Administrimi i gjyqësorit*

dhe veprimtaria disiplinore kundrejt gjyqtarëve duhet të organizohet në një mënyrë të tillë, që të mos dëmtojë pavarësinë legjitime të gjyqësorit, dhe kjo duke marrë në konsideratë objektivitetin dhe natyrën e çështjes. Aty ku nuk garantohej në mënyra të tjera që janë ngritur mbi tradita të konsoliduara, administrimi gjyqësor dhe veprimtaria disiplinore duhet të kryhet nga organe të pavarura, që përfshijnë një shumicë substanciale gjyqësore. Procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të merret vetëm kur kjo është e parashikuar në ligj paraprakisht dhe në përputhje me rregullat e paracaktuara proceduriale”.

- k. Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave për Gjyqtarët të Vendeve Anëtare: Pavarësia, Efiçenca dhe Përgjegjësitë, Këshilli i Europës, 2010, prg 70, parashikon se: “70.Gjyqtarët nuk duhe të jenë personalisht përgjegjës kur vendimi i tyre priset apo ndryshohet nga gjykata e apelit”.

4.2.7. Komente për nenin 124

Neni 124 i Ligjit për Statusin “Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij neni është përcaktimi i rasteve të fillimit të një hetimi disiplinor me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo dispozitë është në harmoni me kompetencën që Kushtetuta i ka dhënë ILD për kryerjen e hetimit disiplinor, në nenin 147/d të saj.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e strukturuar në tre paragrafë.

Pika 1 i referohet kushteve ligjore për fillimin e një hetimi disiplinor me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky paragraf përmban parashikime të qarta për burimet e informacionit që shërbejnë si bazë për fillimin e hetimit me iniciativë, duke referuar median dhe ankuesit anonime. Në këtë paragraf parashikohen edhe kriteret që duhet të përmbushë informacioni i marrë nga media apo ankuesit anonimë në mënyrë që të shërbejë si indicie për fillimin kryesisht të hetimit disiplinor.

Pika 2 kërkon që vendimi për fillimin e hetimit me iniciativë të jetë i arsyetuar dhe të parashtrijë rrethanat faktike të verifikueshme.

Pika 3 i referohet parashikimeve të nenit 123 pikat 2 deri në 4 të cilat janë të zbatueshme edhe rastet e një vendimi për fillimin e hetimeve me iniciativë të ILD.

iii. Kommentar i dispozitës

Pika 1 e nenit 124, parashikon si më poshtë:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Ky paragraf parashikon formën e dytë të fillimit të hetimit disiplinor nga ILD, atë të fillimit të hetimit disiplinor me iniciativë të vetë ILD ose siç njihet ndryshe fillimi kryesisht i hetimit.

Vendimmarrja për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë, kërkon informacion ose të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, që mund të verifikohen nëse është e nevojshme. Faktet dhe rrethanat duhet të sjellin dyshimin e arsyeshëm¹⁶⁶ që shkelja e pretenduar të jetë kryer nga magjistrati.

Të dhëna thelbësore mbi faktet duhet të vlerësohen rast pas rast, por në çdo rast duhet të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se shkelja disiplinore ka ndodhur, referuar veprimeve/mosveprimeve dhe sjelljeve që përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara në nenet 102 deri 104 të ligjit për Statusin.

Ligji nuk sqaron në mënyrë specifike se cilat do të konsiderohen burime të besueshme informacioni. Nëse burimi i informacionit do të

¹⁶⁶ Referojuni shpjegimeve të dhëna për termin “dyshim i arsyeshëm” në komentet e nenit 118.

konsiderohet apo jo i besueshëm kjo është një çështje që do të vlerësohet rast pas rasti. Që një informacion apo e dhënë të mund të konsiderohet si e besueshme mund të mbahen në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- të paraqitet nga një burim i besueshëm informacioni (përfaqësues të institucioneve/ zyrtarëve që mbajnë pozicionet përkatëse që i lejojnë ata të kenë një akses në informacion);
- të përmbajë të dhëna të qarta, të kuptueshme, logjike të cilat mund të kontrollohen duke mbledhur prova shtesë nga organe dhe institucione të ndryshme.

Siç është theksuar edhe në komentet për nenin 119 të ligjit, ILD nuk ka detyrimin të marrë në shqyrtim ankesat anonime. Pavarësisht kësaj, ankesat anonime apo edhe informacioni i marrë nga media mund të shërbejnë si inicië për fillimin kryesisht të një hetimi disiplinor në rast se në përmbajtjen e saj ankesa anonime apo informacioni plotëson kriteret e parashikuara në nenin 120 pika 1 shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, përkatësisht:

- i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për kryerjen e hetimit disiplinor;
- bëhet ndaj sjelljes që magjistratit që ka qënë në detyrë në kohën kur shkelja ka ndodhur;
- bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
- bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

Legjislatori ka përjashtuar parashikimet e shkronjave “a” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 120 pasi këto dy parashikime i referohen formës së shkruar të ankesës dhe përbajtjes së saj e cila nuk mund të zbatohet në rastin e fillimit të një hetimi me iniciativë të ILD.

ILD ka diskrecion për të vendosur për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit përkatës shtesë në lidhje me çdo çështje brenda kuadrit të përcaktuar nga ligji dhe kur nga procesi i verifikimit lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer, ILD vendos fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë të tij.

Pikat 2 dhe 3, të nenit 124 parashikojnë si më poshtë:

“2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

Pikat 2 dhe 3 kërkojnë që edhe vendimi i ILD për fillimin e hetimit me iniciativën e tij të jetë i arsyetuar. Duke referuar në parashikimet e pika 2 dhe 4 të nenit 123 rezulton se vendimi për fillimin e hetimit me iniciativën e ILD duhet të përmbajë të paktën:

- emrat e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
- objektin e hetimit duke iu referuar shkëljes së pretenduar;
- prezantimin e fakteve dhe rrethanave të pretenduara;
- provat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit;
- afatet kohore përkatëse për hetimin; dhe
- të drejtat e magjistratit gjatë hetimit disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të depozituar deklarata dhe dokumente shtesë brenda tre javëve nga marrja e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor.

Njëkohësisht ky vendim referuar përmbajtjes së neneve 123 pika 2 dhe 129 pika 3 duhet t'i njoftohet magjistratit dhe Këshillit përkatës. Duke qënë se nuk është përcaktuar një afat i qartë njoftimi dhe në pamundësi për referuar në nenin 119 pika 4 të ligjit një çështje që lind në zbatimin e këtij neni është afati brenda të cilit vendimi i fillimit të hetimeve kryesisht duhet t'i njoftohet këshillit dhe magjistratit. Me qëllim që të sigurohet uniformiteti në zbatimin e dispozitave ligjore për fillimin e hetimeve mund të prezumojmë që njoftimi i vendimit magjistratit dhe këshillit përkatës të bëhet brenda 5 ditëve, kjo edhe në funksion të realizimit të së drejtës së magjistratit për të paraqitur parashtrime dhe prova brenda 3 javëve nga marrja dijani për vendimin.

Parashikimi i nenit 123 pika 3 shkronja “dh” i parë në lidhje me nenin 129 pika 1 na con në konkluzionin se magjistrati nuk ka të drejtë të ankimojë vendimin e ILD për fillimin e një hetimi disiplinor me iniciativën e tij.

iv. Nenet e lidhura

Neni 147/d i Kushtetutës

Nenet 102,103 dhe 104 i ligjit për Statusin

Neni 119 pika 4 i Ligjit për Statusin

Neni 120 pika 1 shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh” i ligjit për Statusin

Neni 123 pika 2 dhe pika 3 shkronja “dh” dhe pika 4 i Ligjit për Statusin

Neni 129 pikat 1 dhe 3 të Ligjit për Statusin

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB

- ne vitin 1985;
- c. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”.
 - d. Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015 Standardet.
 - e. Opinioni nr. 3-(2002) KKGJE (paragrafi §60) këshillon se nuk është korrekte të ndërthuren mosrespektimi i standardeve profesionale me shkeljen që mund të sjellë potencialisht masa disiplinore. Këto duhet të jenë shkelje tepër serioze dhe jo të dështohet për të vëzhguar standardet të cilat përbëjnë praktikat më të mira (referuar Opinioni të Përbashkët Nr. 588/2010 të Komisionit të Venecias për Ukrainën dhe Parimi Themelor nr. 18 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, e miratuar gjatë mbledhjes plenare të KKGJE, në Strasburg më 17-19 Nëntor 2010 dhe § 72 i Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe § 57/58 të Opinioni nr 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europeanë).
 - f. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010, Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një organ i posaçëm duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”.*
 - g. Rekomandimi i CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare “Mbi Pavarësinë, Eficencën dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve” Kapitulli VI- Statusi i Gjyqtarëve – (§ 69) – “Kapitulli VII- Detyra dhe Përgjegjësitë” parashikon se: *“Procedimet disiplinore mund të fillojnë kur gjyqtari dështon të përmbushë detyrimet e tij në mënyrën e duhur dhe eficiente. Këto procedime duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose nga një panel, me të gjitha garancitë e një procesi të drejtë dhe t’i mundësohet gjyqtarit e drejta për të ankimuar vendimin dhe masën disiplinore. Masa disiplinore duhet të jetë propocionale”.*
 - h. Opinioni nr. 1 (2001)-KKGJE (§ 69), Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave (§ 66) dhe Parimi Themelor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: *“Procedimet disiplinore duhet të kryhen në*

përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohej vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeher palëve ndër-gjyqësore”.

- i. Parimi VI i rekomandimit nr. (94)12 për Pavarësinë, Efiçencën dhe Rolin e Gjyqtarëve, të Komitetit të Ministrave më 13 Tetor 1994 në takimin e 518-të (§ 1) parashikon se: *“Në rast të një shkeljeje disiplinore, duhe marrë të gjitha masat e nevojshme, të cilat nuk paragjykojnë pavarësinë gjyqësore”.*

4.2.8. Komente për nenin 125

Neni 125 i Ligjit për Statusin “Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit” përcakton:

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji.

2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

i. Qëllimi i dispozitës

Ky nen parashikon mundësinë e ILD për të vendosur në lidhje me shtimin ose për ndryshimin e objektit të hetimeve disiplinore, nëse gjatë zhvillimit të hetimeve ngrihet një dyshim i arsyeshëm se një shkelje tjetër (e ndryshme nga shkelja e përcaktuar fillimisht në vendimin për fillimin e një hetimi disiplinor) mund të ketë ndodhur.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita ligjore është strukturuar në 2 paragrafë.

Pika 1 parashikon nxjerrjen e një vendimi për shtimin apo ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor në rastin kur gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër disiplinore. Vendimi do të jetë në përputhje me nenin 124, të ligjit për Statusin i cili parashikon fillimin e një hetimi disiplinor me iniciativë.

Pika 2 i referohet nenit 123, pikat 2 deri 4, të cilat janë të zbatueshme edhe rastet e një vendimi për fillimin e hetimeve me iniciativë të ILD.

iii. Komentar i dispozitës

Pika 1 e nenit 125 parashikon si më poshtë:

“1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji.”

Rregulli i pikës 1 i jep mundësinë ILD që të ndryshojë apo të shtojë me vendim objektin e hetimit disiplinor, nëse gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të ketë ndodhur një shkelje tjetër disiplinore e cila nuk është e njëjtë me atë për të cilën ka filluar hetimi disiplinor. Vendimi për shtimin apo ndryshimin e objektit të hetimit do të jetë në përputhje me Nenin 124¹⁶⁷, të ligjit i cili parashikon fillimin e një hetimi disiplinor me iniciativë (pra ky është një vendim që do të merret me iniciativë të ILD). Ky vendim do të bazohet në të dhëna thelbësore të mbledhura gjatë fazës së hetimit disiplinor, që mbështesin dyshime të arsyeshme se magjistrati mund të ketë kryer një shkelje tjetër disiplinore. Siç është thekuar edhe në qëllimin e dispozitës me termin shkelje tjetër disiplinore kuptohet një shkelje të ndryshme nga ajo e përcaktuar fillimisht në vendimin për fillimin e një hetimi disiplinor. Shkelja tjetër disiplinore mund të jetë tërësisht e ndryshme nga shkelja disiplinore e përcaktohet në objektin e hetimit ose mund të jetë e njëjta shkelja disiplinore por kur i referohet fakteve dhe rrethanave të ndryshme nga ato të përcaktuara në vendimin e fillimit të hetimit.

Vendimi për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit duhet të jepet i arsyetuar duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Vendimi për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor duhet të marrë në konsideratë vendimin për fillimin e hetimit disiplinor dhe raportin e inspektorëve të ngarkuar për kryerjen e hetimit.

Informacioni që paraqitet nga inspektorët duhet të përmbajë të dhëna të qarta në lidhje faktet e mbledhura dhe të verifikuara prej tyre, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm¹⁶⁸ se magjistrati subjekt hetimi disiplinor ka kryer një shkelje tjetër duke çuar në konkluzionin se objekti i hetimit disiplinor do të shtohet ose ndryshohet.

Pika 2 e nenit 125 parashikon si më poshtë:

“2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.”

Ky paragraf kërkon që përmbajtja e nenit 125 të lexohet e lidhur me kërkesat e nenit 123 pikat 2 deri 4 të ligjit për Statusin. Kjo nënkupton që vendimi për

167 Lutem referojuni komenteve për nenin 124 të ligjit për Statusin.

168 Lutem referojuni kuptimit të dhënë për dyshimin e arsyeshëm në komentet e nenit 118 të ligjit për Statusin.

shtimin/ndryshimin e objektit të hetimit duhet të arsyetohet dhe t'i bëhet i njohur magjistratit subjekt hetimi disiplinor, ankuesit nëse hetimi është filluar me nismë të ankuesit (në përputhje me kërkesën e nenit 119 pika 4) dhe Këshillit përkatës. Në lidhje me afatin e njoftimit të këtij vendimi në referencë të nenit 119 pika 4 të ligjit për Statusin, ankuesi njoftohet për vendimin e shtimit/ndryshimit të objektit brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Edhe në njoftimin e magjistratit neni 129 pika 3 i ligjit për Statusin parashikon se vendimi për shtimin/ndryshimin e objektit të hetimi i njoftohet magjistratit brenda të njëjtit afat (5 ditë) nga momenti i marrjes.

Një çështje e rëndësishme ka të bëjë me përmbajtjen e vendimit për shtimin/ndryshimin e objektit të hetimit. Pika 2 e nenit 125 referon në zbatimin e kërkesave të nenit 123 të ligjit për Statusin, për atë që ato gjejnë aplikimi. Nga një lexim i përbashkët i këtyre dy neneve mund të vlerësojmë se:

- Vendimi për shtimin e objektit të hetimit mund të jepet kur bazuar në faktet, të dhënat e mbledhura nga inspektorët gjatë hetimit disiplinor ngrihen dyshime të arsyeshme se është kryer një shkelje tjetër disiplinore, e ndryshme nga ajo e përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor. Vendimi për shtimin e objektit të hetimit duhet të qartësojë se:
 - cila është shkelja e re e dyshuar të jetë kryer;
 - rrethanat dhe faktet e mbledhura nga inspektorët të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se është kryer një shkelje tjetër disiplinore;
 - faktet që do të hetohet dhe provat që duhen mbledhur për të provuar ekzistencën e shkeljes së dytë;
 - afatin e hetimit. Këtu duhet të mbahet në konsideratë parashikimi i nenit 118 pika 3 të ligjit për Statusin, i cili përcakton mundësinë e zgjatjes së hetimit edhe me 3 muaj mbi afatin e zakonshëm 6 mujor gjithashtu edhe në rast të një vendimi për shtimin/ndryshimin e objektit të hetimit.
 - parashtrimin e të drejtave të magjistratit si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtrësia dhe dokumente mbështetëse për objektin e shtuar të hetimit disiplinor. Edhe në këtë rast vlerësojmë se magjistrati ka në dispozicion një afat 3 javor nga marrja e vendimit për shtimin e objektit të hetimit për të paraqitur parashtrësia dhe dokumentacion shtesë.
- Vendimi për ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor do të nxirret kur të dhënat e mbledhura gjatë hetimit disiplinor të filluar të tregojnë se një tjetër shkelje është kryer, një shkelje e ndryshme nga ajo e përcaktuar me anë të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor.

Vendimi për ndryshimin e objektit të hetimit duhet të qartësojë se:

- cila është shkelja tjetër që dyshohet të jetë kryer;
- rrethanat dhe faktet e mbledhura nga inspektorët të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se është kryer një shkelje e ndryshme nga ajo për të cilën ka filluar hetimi disiplinor;
- faktet që do të hetohet dhe provat që duhen mbledhur për të provuar ekzistencën e shkeljes tjetër;
- afatin e hetimit. Këtu duhet të mbahet në konsideratë parashikimi i nenit 118 pika 3 të ligjit për Statusin, i cili parashikon mundësinë zgjatjen e hetimit edhe me 3 muaj mbi afatin e zakonshëm 6 mujor gjithashtu edhe në rast të një vendimi për shtimin/ndryshimin e objektit të hetimit.
- parashtrimin e të drejtave të magjistratit si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtrësia dhe dokumente mbështetëse për objektin e ndryshuar të hetimit disiplinor. Edhe në këtë rast vlerësojmë se magjistrati ka në dispozicion një afat 3 javor nga marrja e vendimit për ndryshimin e objektit të hetimit për të paraqitur parashtrësia dhe dokumentacion shtesë.

iv. Nenet e lidhura

Neni 118 pika 3 i ligjit për Statusin

Neni 119 pika 4 i ligjit për Statusin

Neni 123, pikat 2 deri 4 të i ligjit për Statusin

Neni 124 i ligjit për Statusin

Neni 129 pika 3 i ligjit për Statusin

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudeca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB ne vitin 1985;
- c. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”.
- d. Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015.
- e. Opinioni nr. 3-(2002) KKGJE (paragrafi §60) këshillon se nuk është korrekte të ndërthuren mosrespektimi i standardeve profesionale me shkeljen që mund të sjellë potencialisht masa disiplinore. Këto

- duhet të jenë shkelje tepër serioze dhe jo të dështohet për të vëzhguar standardet të cilat përbëjnë praktikën më të mira (referuar Opinionit të Përbashkët Nr. 588/2010 të Komisionit të Venecias për Ukrainën dhe Parimi Themelor nr. 18 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, e miratuar gjatë mbledhjes plenare të KKGJE, në Strasburg më 17-19 Nëntor 2010 dhe § 72 i Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe § 57/58 të Opinionit nr 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë).
- f. Opinioni nr. 3-(2002) i KKGJE (§77-ii-iii), Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010, Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënie (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekanizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – 2011): *“Një organ i posaçëm duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur”.*
- g. Rekomandimi i CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare “Mbi Pavarësinë, Eficencën dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve” Kapitulli VI- Statusi i Gjyqtarëve – (§ 69) – “Kapitulli VII- Detyra dhe Përgjegjësitë” parashikon se: *“Procedimet disiplinore mund të fillojnë kur gjyqtari dështon të përmbushë detyrimet e tij në mënyrën e duhur dhe eficiente. Këto procedime duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose nga një panel, me të gjitha garancitë e një procesi të drejtë dhe t’i mundësohet gjyqtarit e drejta për të ankimuar vendimin dhe masën disiplinore. Masa disiplinore duhet të jetë proporcionale”.*
- h. Opinioni nr. 1 (2001)-KKGJE (§ 69), Parimi VI-1 i Rekomandimit (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave (§ 66) dhe Parimi Themelor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve: *“Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse”.*
- i. Parimi VI i rekomandimit nr. (94)12 për Pavarësinë, Eficencën dhe Rolin e Gjyqtarëve, të Komitetit të Ministrave më 13 Tetor 1994 në takimin e 518-të (§ 1) parashikon se: *“Në rast të një shkeljeje disiplinore, duhe marrë të gjitha masat e nevojshme, të cilat nuk paragjykojnë pavarësinë gjyqësore”.*

4.2.9. Komete për nenin 126

Neni i Ligjit për Statusin 126 “Pezullimi i Hetimeve” përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ve^Ndos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:

- a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati;
- b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.

2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

3. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe Këshilli njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.

5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117, i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

i. Qëllimi i dispozitës

Kjo dispozitë rregullon veprimtarinë e ILD-së, kur gjatë hetimit disiplinor të magjistratit, evidentohet një pengesë në zhvillimin e mëtejshëm të hetimit deri në zhdukjen e kësaj pengese. Ky nen ka si qëllim përcaktimin e rregullave të qarta për pezullimin e hetimit disiplinor të filluar si dhe përcaktimin i kushteve kumulative për marrjen e një vendim pezullimi të hetimeve.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita përmban gjashtë paragrafë, të cilët i referohen aspekteve të ndryshme të pezullimit.

Dispozita shtrihet deri tek ILD, ankuesi, magjistrati nën hetim disiplinor, gjykatat respektive, prokuroritë dhe organet e tjera në të cilat gjendet një procedurë penale, civile, administrative e filluar, siç parashikohet në paragrafin 1 të nenit 126. Të drejtat dhe detyrimet të të gjithë palëve të interesuara të përmendura më sipër renditen në mënyrë të plotë nga ligjvënësi.

Aspektet e strukturës së dispozitës mund të përmbliidhen në pikat e mëposhtme:

- ILD është institucioni kompetent për të vendosur lidhur me pezullimin e një hetimi disiplinor të filluar tashmë (qoftë me iniciativën e tij apo bazuar një një ankesë), kur përmbushen disa kushte.
- Nxjerrja e një akti (vendimi) formal nga ILD është e nevojshme për pezullimin e hetimit.
- Ligji parashikon pezullimin e hetimit disiplinor vetëm sipas kushteve të përcaktuara në nenit 126. Për pasojë, asnjë rrethanë tjetër nuk mund të jetë arsye për një vendim për pezullimin e hetimit, përveç alternativës së parashikuar nga neni 130, pika 3, shkronja "a"¹⁶⁹.
- Vendimi për pezullimin nuk mund të ankimohet.

iii. Komentari i dispozitës

Pika 1 e nenit 126 parashikon si më poshtë:

"1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:

- a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati;
- b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi."

Ky paragraf parashikon kushtet kumulative, që duhet të përmbushen përpara marrjes së një vendimi për pezullimin e hetimit disiplinor nga ILD. Është e rëndësishme të theksojmë se ky nen zbatohet në rastin e një hetimi disiplinor tashmë të filluar nga ILD ose mbi bazën e një ankese (neni 123) ose me iniciativën e vetë ILD (neni 124). Pra tashmë ILD bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të tilla që justifikojnë fillimin e hetimit ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Kushtet kumulative të cilat e detyrojnë ILD për të marrë një vendim për pezullimin e hetimit disiplinor janë:

- ekzistenca e një hetimi penal të filluar ose procesi gjyqësor penal, administrativ ose civil;
- njëra nga palët të jetë magjistrati subjekt hetimi disiplinor; dhe
- shkelja e pretenduar të lidhet me të njëjtat fakte të cilat do të përcaktohen nga vendimi (gjykatës apo prokurorisë).

Kushti i parë kërkon ekzistencën e një hetimi penal qoftë pranë prokurorisë së juridiksionit të zakonshëm apo pranë prokurorisë së

¹⁶⁹ Shih më poshtë pjesën "Nenet Përkatës", nën të njëjtin koment.

posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërsa procesi gjyqësor që përbën shkak për pezullimin e hetimit disiplinor mund të zhvillohet përpara gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm (civile apo penale) dhe gjykata të posaçme (administrative apo gjykata të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar).

Sipas kushtit të dytë dhe të tretë që një hetim penal apo një proces gjyqësor, (pavarësisht nëse është penal, civil apo administrativ) të përbëjë shkak për pezullimin e hetimit duhet që ai të ketë lidhje me hetimin disiplinor për sa i takon:

- Subjektit, pra magjistrati ndaj të cilit ka filluar hetimi disiplinor të jetë njëkohësisht edhe palë në një hetim penal apo në një proces gjyqësor penal, civil ose administrativ.
- Objektit në kuptimin, që shkelja që dyshohet të ketë kryer magjistratit dhe për të cilin ka filluar hetimi disiplinor të lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi nga organi kompetent.

Një pyetje që shtrohet është se si do të marrë informacion ILD që ndaj magjistratit ndaj të cilit ka filluar një hetim disiplinor është duke u zhvilluar një hetim penal apo një proces gjyqësor. Ky informacion mund të jepet nga vetë magjistrati që është palë në procesin hetimor apo gjyqësor kjo bazuar në nenin 129 pika 2 të ligjit, nga vetë Këshillat përkatës të cilët njoftohen për fillimin e hetimit ndaj magjistratit ose nga mjetet e informimit publik. Ekzistenca e një hetimi penal apo e një procesi gjyqësor ku palë është magjistrati subjekt hetimi dhe që lidhet me njëjtat fakte për të cilën po zhvillohet hetimi disiplinor është një çështje që do të vlerësohet nga inspektorët e ngarkuar me hetimin bazuar në dokumentet zyrtare, që do të paraqiten nga organi përkatës (gjykata ose prokuroria) të cilat vërtetojnë procedurën e filluar përpara organit tjetër, si edhe konfirmojnë faktin se procedura e filluar lidhet me të njëjtat fakte dhe me të njëjtin magjistrat.

Vendim për pezullimin e hetimit disiplinor, merret nga ILD bazuar në informacionin e vënë në dispozicionin nga inspektor/inspektorët përkatës ose të marrë drejtpërdrejtë nga ILD. Në këtë vendim duhet të argumentohen provat që u morrën për vërtetimin e kushteve të pezullimit nga organi përkatës (gjykata apo prokuroria); cilësinë në të cilën magjistrati merr pjesë në këtë proces; vlerësimin se shkelja për të cilën po hetohet disiplinarisht magjistrati lidhet me të njëjtat faktet për të cilat magjistratit po hetohet penalisht apo është palë në një proces gjyqësor civil, penal apo administrativ.

Në krahasim me Nenin 126, ku pezullimi është i detyrueshëm, nëse plotësohen parakushtet kumulative të paragrafit 1, ILD do të vendosë

për pezullimin e hetimit ose jo sipas parashikimit të Nenit 130, pika 3. Në rastin e pezullimit të detyrueshëm, magjistrati, subjekt i hetimit disiplinor është palë në procesin gjyqësor ose hetimor, ndërsa në rastin e pezullimit sipas nenit 130 pika 3 shkronja “a”, magjistrati i cili është subjekt i hetimit disiplinor po shqyrton një çështje në hetim apo në gjykim.

Arsyetimi i vendimit për pezullim bazuar në nenin 130, pika 3, shkronja a) duhet të përmbajë argumente të ndryshme nga ato të parashtruara në arsyetimin e vendimit të pezullimit të detyrueshëm sipas nenit 126. Ky vendim do të duhet të trajtojë në pjesën e tij arsyetuese çështjet e mëposhtme:

- Si lidhet shkelja e pretenduar për të cilën ka filluar një hetim disiplinor me çështjen e filluar në një gjykatë ose prokurori;
- Cilat janë arsyet se përse hetimi i filluar disiplinor nuk mund të vazhdoje përpara nxjerrjes së vendimit të formës së prerë për hetimin penal apo çështjet gjyqësore të filluar dhe që po procedohet apo gjykohet ndaj magjistrati;
- Cilat janë arsyet mbi bazën e të cilat çmohet se vijimësia e hetimit disiplinor të filluar mund të konsiderohet si ndërhyrje në pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e çështjes? Në këtë rast vendimi i pezullimit të hetimit disiplinor duhet të mbështetet në një arsyetim dhe një vlerësim sa më objektiv të rastit dhe të pretendimeve që parashtrohen nga magjistrati.

Pika 2 e neni 126 parashikon si më poshtë:

2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

Kjo pikë trajton afatin e pezullimit të hetimit. Sipas këtij paragrafi hetimi disiplinor do të pezullohet deri në momentin që institucioni kompetent (gjykata apo prokuroria) të marrë një vendim të formës së prerë.

Në këtë paragraf nuk është shprehur qartë se çdo të ndodhë me afatin 6 mujor brenda të cilit ILD duhet të përmbyllë hetimin disiplinor. Në këtë rast vlerësojmë se në momentin e marrjes së një vendimi pezullimi, afati 6 mujor në përfundim të të cilit ILD duhet të vendosë për mbylljen e hetimit apo fillimin e procedimit disiplinor, duhet të pezullohet dhe të fillojë të rillogaritet pas shfuqizimit të vendimit të pezullimit.

Momenti i marrjes formë të prerë të një vendimi është i rregulluar në kodet përkatëse procedurale (përkatësisht neni 451 i Kodit të Procedurës Civile; neni 45 dhe 65 i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar si dhe

nenet 328, 329, 329/a, dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale). Njoftimi për marrjen e një vendimi të formës së prerë nga institucioni kompetent duhet t'i njoftohet ILD.

Pika 3 e nenit 126 parashikon si më poshtë:

“3. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe Këshilli njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.”

Ky paragraf parashikon detyrimin për njoftimin e vendimit të pezullimit të hetimit disiplinor. Ky vendim i njoftohet të gjithë palëve të interesuara ku përfshihet magjistrati që është subjekt i hetimit disiplinor, ankuesi, gjykata, prokuroria dhe Këshilli. Njoftimi i magjistratit, ankuesit, dhe Këshilli bëhet për efekt të mbajtjes së informuar të këtyre subjekteve për ecurinë e hetimit disiplinor bazuar në nenin 129 që parashikon të drejtat e magjistratit, por edhe të parimit të drejtësisë së hapur. Ndërkohë informimi i gjykatës dhe prokurorisë përkatëse për vendimin e pezullimit të hetimeve, ka si qëllim vendosjen e linjave të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë që po zhvillon hetimin dhe gjykatës përpara së cilës po zhvillohet procesi gjyqësor me qëllim dërgimin e pa vonesë të informacioneve dhe vendimeve që merren gjatë procesit të hetimit apo procedurës gjyqësore ndaj magjistratit për të cilin është pezulluar hetimi disiplinor. Ky detyrim shërben të garantuar se të gjitha institucionet, organet dhe personat e përfshirë do të kenë mundësinë të informojnë ILD-në, sa herë që dalin rrethana të reja, të cilat mund të ndikojnë në hetimin disiplinor të pezulluar.

Për marrjen në kohën e duhur të informacionit se vendimi që ka shërbyer si shkak pezullimit të hetimit disiplinor, ka marrë formë të prerë, pika 3 përcakton detyrimin e gjykatës, prokurorisë së interesuar apo institucioneve të tjera, që mund ta administrojnë këtë informacion t'i përcjellin ILD-së pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës. Dispozita nuk parashikon një afat konkret brenda të cilit vendimi duhet t'i dërgohet ILD nga momenti që ai merr formë të prerë, gjithsesi përdorimi i termit pa vonesë nënkupton që ai duhet të përcillet menjëherë dhe në çdo rast pa vonesa të paarsyeshme.

Pika 4 e nenit 126 parashikon si mëposhtë:

“4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.”

Ky paragraf trajton efektet që vendimi i formës së prerë në përfundim të një procesi gjyqësor ku magjistrati është palë do të ketë mbi ecurinë e hetimit disiplinor. Bazuar në pikën 3, organet kompetente janë të detyruar t'i japin ILD-së “pa vonesë, çdo vendim të marrë gjatë hetimit dhe procedimit respektiv”. Ndërkohë Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet t'i referohet vetëm fakteve të përcaktuara në vendimin e formës së prerë të gjykatës. Një vendim i formës së prerë në favor të magjistratit nuk e pengon hetimin e kryer nga ILD-ja. Vendimet e organeve të tjerë parashikuar nga Neni 126 nuk janë detyrues për ILD. Edhe në rastin kur vendimi përfundimtar i gjykatës është në favor të magjistratit, (vendimi pafajësie apo vendimi pushimi i akuzës) për shkak të elementëve që janë verifikuar në një proces gjyqësor kjo nuk do të konsiderohet si shkak për mbylljen e hetimit disiplinor dhe nuk mund të pengojë zhvillimin e një hetimi disiplinor të filluar nga ILD.

Ky paragraf përbën një referencë e qartë për pavarësinë e ILD-së në ushtimin e kompencës së njohur nga Kushtetuta për hetimin disiplinor dhe fillimin e procedimit disiplinor. Ai duhet analizuar duke pasur parasysh interpretimin se çdo procedurë – hetim disiplinor, hetim penal, administrativ, etj. – bazohet në rregullat respektive procedurale të parashikuara nga Ligjet, kështu që organet dhe institucionet do t'i zbatojnë rregullat e tyre të procedurave dhe do t'i vlerësojnë faktet nga këndvështrimi i parashikimeve të tyre materiale.

Siç shprehet edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 mbështetur edhe në opinionin e Komisionit të Venecias (CDL-AD(2014)032), të datës 14 Tetor 2014 “përgjegjësia penale dhe ajo disiplinore kanë natyrë dhe objektiva të ndryshëm, janë subjekt i standardeve të ndryshme mbi provën dhe kanë elemente të ndryshme përbërëse, si dhe po ashtu nuk përjashtojë njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, autoritetet disiplinore nuk janë të detyruar të përfundojnë procedimin disiplinor kur fillon një çështje penale për të njëjtën shkelje. Për të evituar shkeljen e parimit ne bis in idem këto autoritete duhet të kenë mundësinë të përfundojnë procedurën nëse ata e konsiderojnë që çështja disiplinore ka natyrë penale (natyra e shkeljes dhe pesha e masës disiplinore korresponduese do të jenë kriteret drejtuese në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së). Në rast se shkelja subjekt i procesit penal nuk është e njëjta shkelje që lind nga fakte identike ose kur procesi disiplinor nuk ka natyrë penale, nuk ka arsye për të përfunduar procesin disiplinor për shkak të fillimit të procesit penal bazuar në të njëjtin material disiplinor.

Ndalimi i gjykimit të dyfishtë dhe ndëshkimit për të njëjtën shkelje në dy procese të ndryshme penale, referuar nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, në parim nuk përjashton fillimin e procesit disiplinor për të njëjtën shkelje paralelisht me procesin penal.”

Pika 5 e nenit 126 parashikon si më poshtë:

“5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117, i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.”

Ky paragraf parashikon ndërprerjen e afatit të parashkrimit të parashikuar në nenin 117. Sipas pikës 1 të këtij neni afati i parashkrimit për shkeljet disiplinore është 5 vjet, afati i cili fillon nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar disiplinore. Ndërprerja e afatit të parashkrimit do të vazhdojë deri në ditën që do të bjerë shkak i pezullimit, pra deri kur ILD të vendosë shfuqizimin e vendimit të pezullimit, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

Ndërprerja e parashkrimit, sipas parashikimit nga Neni 126, është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Pika 6 e nenit 126 parashikon si më poshtë:

“6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.”

Pika 6 parashikon se vendimi për pezullimin e hetimeve nuk mund të ankimohet. Ky paragraf e trajton vendimin e pezullimit të hetimit disiplinor si një vendim të ndërmjetëm, ndaj të cilit mund të ushtrohet ankimi bashkë me vendimin për mbylljen e hetimeve sipas nenit 134 të ligjit.

iv. Nenet e lidhura

Neni 100 i ligjit për Statusin

Neni 117 i ligjit për Statusin

Neni 123 i ligjit për Statusin

Neni 124 i ligjit për Statusin

Neni 129 pika 3 i ligjit për Statusin

Neni 130 pika 3 shkronja “a” e ligjit për Statusin

Neni 134 i ligjit për Statusin

Neni 451 i Kodit të Proces Civile

Neni 45 dhe 65 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

Nenet 328, 329, 329/a, dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e GJEDNJ.
- b. Karta Europiane për të drejtat themelore të Bashkimit Europian, Gazeta zyrtare e BE, 26.10. 2012.
- c. Rrjeti Evropian i Këshillave të Gjyqësorit, *Standardet Minimale*

Gjyqësore V: Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve, 5 Qershor 2015 (Versioni në gjuhën angleze https://www.encj.eu/images/stories/pdf/GA/Hague/encj_report_minimum_standards_v_adopted_ga_june_2015.pdf, vizituar për herë të fundit në datën 29.01.2018);

- d. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, *Opinioni Nr. 3(2002) për rregullat dhe parimet e qeverisjes së sjelljes profesionale të gjyqtarëve, veçanërisht etikës, paanshmërisë dhe papajtueshmërisë me detyrën i Këshillit* (Versioni në gjuhën angleze <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&Ref=CCJE=FEF2E0&BackColorIntranet=FEF2E0&BackColorLogged=c3c3c3&direct=true>, vizituar për herë të fundit më 29.01.2018

4.2.10. Komente mbi Nenin 127

Neni 127 Kërkesa për pezullimin e magjistratit

Në çdo fazë të procedurës së hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon Këshillin lidhur me faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit, sipas parashikimeve në nenin 151, të këtij ligji, ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i dispozitës është parashikimi i kompetencës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të iniciuar pezullimin e detyrueshëm të magjistratit në kuadrin e një procedure të caktuar.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e përbërë nga një paragraf, ka një strukturë të thjeshtë dhe është e vendosur në pjesën e V-të të kapitullit II të Ligjit për Statusin, i cili parashikon rregulla gjithpërfshirëse mbi kryerjen e procedurave hetimore nga ana e ILD.

Kjo dispozitë parashikon dy lloj kompetencash të ILD në kudër të procedurës së pezullimit të mgjistratëve.

Kompetenca e parë lidhet me detyrimin e ILD për të informuara Këshillin përkatës mbi ekzistencën e fakteve të cilat e bejnë të detyrueshëm pezullimin e magjistratit nga detyra, ne përputhje me përcaktimet e nenit 151 të Ligjit për Statusin.

Ndërkohë, e njëjta dispozitë lidhet me të drejtën e ILD për të kërkuar pezullimin e magjistratit në kontekstin e procedimit disiplinor, sipas përcaktimeve të nenit 152 të këtij ligji.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

a. Detyrimi për të informuar në rastet te pezullimit të detyrueshëm

Neni 127 i Ligjit për Statusin parashikon që ILD “do të informojë Këshillin mbi faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit, sipas parashikimeve në nenin 151, të këtij ligji, ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsye të parashikuara në nenin 152 të këtij ligji”. Këto fakte janë:

- Magjistrati është subjekt i masës së sigurimit personal “arrest me burg” për një vepër penale;
- Magjistrati është subjekt i masës së sigurimit personal “arrest shtëpie” për një veper penale;
- Magjistrati akuzohet për një vepër penale të rëndë të kryer me dashje.

Vendosja e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest shtëpie” për kryerjen e një veprë penale janë fakte lehtësisht të verifikueshme, sepse ato vendosen bazuar në një vendim gjykate në përputhje me Nenet 237, 238 dhe Nenin 245 të Kodit të Procedurës Penale. Vlen të theksohet se në përputhje me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, kocepti i veprës penale i përhshin të dyja krimet dhe kundravajtjet penale. Si rezultat, detyrimi për të informuar ekziston në të gjitha rastet kur magjistrati është subjekt i një prej masave të sigurimit të përmendura më lart, pavarësisht nëse ka kryer një krim apo kundravajtje penale.

Gjithashtu, marrja e statusit të të akuzuarit në një moment procedural të rregulluar nga Kodi i Procedurës Penale dhe përkatësisht nga Neni 34 i tij, që parashikon se cilësimi si i akuzuar merret pas njoftimit të akuzës subjektivit të akuzuar. Kushti kumulativ është që magjistrati të jetë i akuzuar për një krim të rëndë.

Termi “i rëndë” nuk përkufizohet në Ligjin për Statusin dhe rrjedhimisht në mënyrë që të identifikojmë se çfarë do të konsiderohet “e rëndë”, do t’i referohemi legjislacionit penal. Në përputhje me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, krime të rënda klasifikohen:

- Veprat penale të listuara në Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale¹⁷⁰;
- Të gjitha veprat penale të kryera në një grup të strukturuar kriminal, një organizatë kriminale, organizatë terroriste dhe një bandë kriminale.¹⁷¹
- Veprat penale për të cilat jepet dënimi me burgim të përjetshëm;

Në kuadër të një pezullimi të detyrueshëm të një gjyqtari, në përputhje me kërkesat e nenit 151 të Ligjit për Statusin, ILD do të informojë

¹⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale, Neni 75, shkronja (a);

¹⁷¹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 75, shkronja (b);

Këshillin përkatës mbi ekzistencën e një rrethane konkrete e cila krijon *ipso lege* pezullimin e magjistratit. Informacioni që plotësohet nga ILD ashtu si edhe informacioni që do t'i dërgohet kryetarit të gjykatës dhe drejtuesve të drejtuesve të prokurorive në pozitën e autoritetit përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 151, paragrafi 3 të Ligjit për Statusin ka vetëm natyrë informuese lidhur me faktet që kanë sjellë pezullimin e detyrueshëm të magjistratit nga këshilli përkatës.

Për të zbatuar detyrimin e informimit të Këshillat, ILD duhet ta ketë informacionin e mësipërm, pra informacionin mbi masën e sigurimit personal të magjistratit dhe informacionin mbi cilësimin e tij si i pandehur për një krim të rëndë të kryer me dashje. Pyetja që shtrohet është nëse ILD ka detyrimin për tu angazhuar në mbledhjen e këtij informacioni apo detyrimi lind në momentin që faktet e mësipërme bëhen publike ose kur ILD vihet në dijeni të tyre në forma të tjera. Ligji për Statusin nuk përmban ndonjë detyrim që ILD të mbledhi aktivisht këtë informacion. Neni 151, paragrafi 3 i Ligjit për Statusin, përcakton se kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, të cilët marrin vendimet e sipërcituara, ia përcjellin informacionin Këshillave, por nuk ka një detyrim që i njëjti informacion t'i përcillet gjithashtu edhe ILD-së. Si rezultat, nuk duket të ketë një detyrim që ILD të angazhohet për mbledhjen e informacionit, por ai ka vetëm detyrimin që pas marrjes së këtij informacioni- në çfarëdo lloj forme- t'ia dergojë Këshillave.

b. Kërkesa për pezullim në rastet e procedimeve disiplinore

Neni 127 i Ligjit për Statusin parashikon se ILD *“ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji. Arsyet e shtjelluara në Nenin 152 të Ligjit për Statusin përcaktojnë se “qëndrimi në detyrë i magjistratit të akuzuar:*

- *paragjykon hetimin penal ose disiplinor,*
- *pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit penal ose disiplinor;*
- *diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit,*

Bazuar në sa më lart, kur dorezohet një kërkesë e tillë për pezullimin e magjistratit në Këshillin përkatës, ILD ka diskrecion të vlerësojë nëse jemi para aryeve të listuara më lart.

Veprimet proceduriale që ILD duhet të kryejë në kontaktin e një pezullimi të detyrueshëm është dorëzimi i informacionit. Ligji nuk parashikon ndonjë procedurë të posaçme për përcjelljen e këtij informacioni, kështu që procedura e krijuar nga ILD për dorëzimin e informacionit zyrtar duhet të jetë në formën e një shkrese zyrtare, e cila përmban përshtypimin e

rrethanave të përcaktuara në Nenin 151 të Ligjit për Statusin dhe nevojën për pezullimin e magjistratit. Ky informacion jo detyrimisht do të përcillet në kuadrin e një procedmi disiplinor të nisur nga ILD.

Veprimet procedurale që ILD do të zbatojë në kuadrin e pezullimit për shkak të një procedimi disiplinor, sipas kërkesave të nenit 152 të Ligjit për Statusin, është paraqitja e kërkesës për pezullimin e magjistratit nga detyra. Ligji nuk përcakton ndonjë procedurë specifike për dorëzimin e kërkesës, kështu që procedura e ndjekur nga ILD për dorëzimin e kërkesave formale do të zbatohet edhe në këtë rast. Kërkesa e paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të jetë e motivuar dhe e arsyetuar lidhur me ekzistencën e rrethanave si dhe kjo kërkesë duhet të paraqitet domosdoshmërisht në kuadër të një procedimi disiplinor të nisur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për sa më sipër arrihet në konkluzionin se në varësi të rrethanave apo shkaqeve të cilat lidhen me pezullimin e magjistratit nga ushtrimi i detyrës, si në rastin e pezullimit të detyruar apo në rastin e pezullimit për shkak të procedimit disiplinor roli i inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i ndryshëm si në aspektin procedural ashtu edhe për nga lloji i akteve të cilat duhet të hartojë. Në të njëjtën kohë, në interpretim gjuhësor të përmbajtjes së nenit 127 si dhe në interpretim sistematik të kësaj dispozite me parashikimet e nenit 138 dhe dispozitave të pjesës V, Kreu V, të Ligjit për Statusin rezulton se nga pikëpamja e teknikës legjislative përmbajtja e nenit 127 nuk përkon me titullin e saj, si dhe konstatohet mungesa e unifikimit të termave lidhur me formën apo përmbajtjen e kërkesës që duhet të paraqitet nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim pezullimin e magjistratit.

Referuar rastit të pezullimit të detyrueshëm të magjistratit nga detyra ashtu edhe në rastin e pezullimit për shkak të procedimit disiplinor, Kushtetuta ka përcaktuar Këshillin përkatës si Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organin kompetent për dhënien e këtij vendimi të ndërmjetëm, vendim i cili mund të merret nga ana e Këshillit përkatës me nismën e tij apo me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

iv. Nenet e lidhura

Kjo dispozitë është hartuar dhe do të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të harmonizuar me parashikimet e Nenit 140, paragrafi 3, Neni 148/d, paragrafi 4 i Kushtetutës dhe neni 138 e dispozitat e pjesës V, Kapitulli V të Ligjit për Statusin, i cili përcakton në mënyrë gjithpërfshirëse rregullat mbi pezullimin e magjistratit.

Në analizë të nenit 140, pika 3 dhe neni 148/d, pika 4 të Kushtetutës rezulton se kushtetutëbërësi e ka lidhur pezullimin e magjistratit në rastet kur: a) kur ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor sipas ligjit. Në interpretim dhe në zbatim të këtyre neneve, si dhe në kuadër të delegimit të shprehur nga norma kushtetuese legjislatori ka parashikuar në nenin 151 dhe 152 të Ligjit për Statusin rregulla mbi pezullimin e magjistratit nga detyra.

Neni 151 i Ligji për Statusin ka të bëjë me pezullimin e detyruar të magjistratit nga ushtrimi i detyrës, i cili është një pezullim *ipso lege* për shkak të vërtetimit të disa rrethanave konkrete të cilat janë parashikuar në mënyrë shteruese në këtë dispozitë. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale, si dhe kur ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje. Ndërsa neni 152 i Ligji për Statusin ka të bëjë me rastin kur në kuadër të një procedimi disiplinor vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatit e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

Neni 127 i Ligjit për Statusin është po ashtu i lidhur edhe me disa nene të legjislationit penal. Më konkretisht:

- i. **Kodi Penal**, nenet si vijon: 1, 34, 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;
- ii. **Kodi i Procedurës Penale**, nenet si vijon: 75/a, 237, 238 dhe 245.

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria:

Formulimi i neneve 151 dhe 152 të Ligjit për Statusin-të lidhura ngushtësisht me nenin 127 të Ligjit për Statusin- është në përputhje të plotë me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni i Venecias, i cili në opinionin e tij CDL-AD(2017) 018, (Opinion mbi ligjin e sistemit gjyqësor në Bullgari) shprehet se: “...Komisioni i Venecias pranon që një gjyqtar, kundër të cilit janë dërguar akuza serioze, mund të pezullohet nga detyrat. Sidoqoftë, duhet t’i përkasë Dhomës Gjyqësore të verifikojë se sa serioze dhe të bazuara janë këto akuza. Në versionin aktual të nenit 230, Dhoma Gjyqësore e SJC duket se kryen vetëm një rol zyrtar të aprovimit të pezullimit sa herë që prokuroria ka filluar mekanizmin sipas nenit 230. Në vend të kësaj, ligji për sistemin gjyqësor duhet të përcaktojë qartë se Dhoma Gjyqësore duhet të rishikojë përmbajtjen e akuzave dhe të vendosë nëse provat kundër gjykatësit janë mjaft bindëse (pa

genë domosdoshmërisht “përtej dyshimit të arsyeshëm”) dhe nëse ka vend për pezullim. Kur e bën këtë, Dhoma Gjyqësore e SJC duhet të jetë në gjendje të përcaktojë afate të shkurtra kohore për hetime kundër gjyqtarëve të pezulluar.”

Këto dispozita janë formuluar në harmoni edhe me Notën shpjeguese të publikuar nga OSBE “Mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të procedimit disiplinore ndaj gjyqtarëve” e cila argumenton se: “...[...].Në rrethana të jashtëzakonshme dhe serioze, një gjyqtar i paditur mund të pezullohet nga puna gjatë fazës së hetimit - kjo është më pak disiplinore, dhe më shumë një masë e përkohshme, paraprake. Masat e tilla do të justifikohen vetëm nga natyra dhe rëndësia e veprës së pretenduar dhe / ose nëse pezullimi i gjykatësit mund të rrezikojë integritetin ose pavarësinë e tij / saj. Pezullimet e tilla në asnjë mënyrë nuk duhet të paragjykojnë rezultatin e procedurave. Kështu, ndërsa pezullohen, gjyqtarët duhet të marrin pagë të plotë, përveç nëse ato vonojnë paarsyeshëm procedurat ose nuk bashkëpunojnë me hetimin. Një numër vendesh evropiane parashikojnë këtë lloj pezullimi por e lejojnë atë vetëm në raste të rralla dhe të jashtëzakonshme në lidhje me vepra të rënda disiplinore, ose kur vlerësohet e domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut në gjyqësor ose sistemin gjyqësor, ose kur një çështje penale është duke pritur kundër gjyqtar...[...].”

4.2.11 Komente mbi Nenin 128

Neni 128 i Ligjit për Statusin “Bashkimi i procedimeve hetimore” përcakton:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i dispozitës është parashikimi i rregullit për bashkimin e procedimeve hetimore të filluara nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim shmangien e përsëritjes së procedurave hetimore që kanë të bëjnë me të njëjtat fakte (*objekti*) ose të njëjtin magjistratë (*subjekti*).

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita ka karakter procedural dhe është vendosur në pjesën V, Kreu II, të Ligjit për Statusin, i cili parashikon në mënyrë të detajuar rregullat për zhvillimin e procedurës hetimore nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo dispozitë është formuluar dhe duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të harmonizuar me dispozitat e këtij Kreu.

Në zbatim të parimit të *proporcionalitetit*, pra që ndaj magjistratit të jepet

ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij dhe në përputhje me shkëlqen disiplinore që ka kryer, si dhe në zbatim të parimit të *deburokratizimit dhe eficiencës*, me qëllim zhvillimin e një procedure administrative në mënyrë sa më të shpejtë dhe efektive dhe në respektim të afateve ligjore, zbatimi i kësaj dispozite sjell disa pasoja pozitive lidhur në zhvillimin e procedimit hetimor.

Zbatimi i duhur i kësaj dispozite sjell si pasojë: (i) shkurtrimin dhe respektimin e afateve për zhvillimin e procedimeve hetimore nga ana e inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) shmangien e mbivendosjes apo përsëritjes së procedurave të cilat duhet të ndiqen nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (iii) eficientësinë dhe efektivitetin mbi zhvillimin e procedurave hetimore; dhe (iv) respektimin e të drejtave të magjistratëve, subjekte të hetimit disiplinor.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

Në zbatim të përmbajtjes së nenit 128 të Ligjit për Statusin bashkimi i procedimeve hetimore është i detyrueshëm: (i) në rastin e ankesave të paraqitura të cilat janë i referohen të njëjtit fakt disiplinor (veprimi/mosveprimi i magjistratit) si dhe; (ii) në rastin e ankesave të paraqitura ndaj të njëjtit magjistrat për fakte të ndryshme disiplinore.

Në interpretim gjuhësor të kësaj dispozite rezulton se kjo dispozitë përcakton vetëm kriterin i cili duhet të mbahet në konsideratë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për bashkimin e procedimeve hetimore, i cili është fakti disiplinor apo subjekti. Gjithashtu, në analizë të dispozitave të Ligjit për Statusin, paraprakisht vlerësohet se kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë të harmonizuar me një sërë nocionesh të cilat shprehin koncepte apo faza të ndryshme të procesit disiplinor, por që njëkohësisht nuk janë shpjeguar lidhur me përmbajtjen e tyre në Ligjin për Statusin. Këto janë koncepte si “fakti disiplinor”, “shkelja disiplinore”, “objekti i hetimit”, “procedimi hetimor”, apo “procesi disiplinor”.

Në të njëjtën kohë, dispozita nuk parashikon rregulla të tjera lidhur me mënyrën apo formën se si do të veprohet nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me bashkimin e procedimeve hetimore në varësi të fazës së procedimit hetimor si: (i) në rastin e ankesave të paraqitura lidhur me të njëjtin fakt disiplinor dhe të njëjtin magjistrat, por të cilat janë në faza të ndryshme trajtimi të saj si shqyrtimi fillestar, verifikimi apo hetimi; (ii) në rastin e ankesave të paraqitura lidhur me fakte të ndryshme disiplinore dhe të njëjtin magjistrat, por të cilat janë në faza të ndryshme trajtimi; (iii) në rastin e ankesave të paraqitura lidhur me të njëjtin fakt disiplinor dhe të njëjtin magjistrat, si dhe në të njëjtën kohë

janë në të njëjtën fazë trajtimi; (iv) në rastin e ankesave të paraqitura lidhur me fakte të ndryshme disiplinore dhe të njëjtin magjistrat si dhe në të njëjtën kohë janë në të njëjtën fazë trajtimi.

Ekzistenca e fazave të ndryshme të procedimeve do të shfaqte vështirësi gjatë zbatimit në praktikë pasi në varësi të këtyre fazave, veprimet procedurale të cilat kryhen nga ana e inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë të ndryshme. Gjithashtu Ligji për Statusin nuk përmban asnjë parashikim për ndarjen e procedimeve hetimore, pasi në varësi të përfundimit të procedurës hetimore, mund të rezultojë nevoja që ankesa të ndryshme të kenë trajtime të ndryshme si për shembull për një ose disa ankesa mund të pezullohet hetimi disiplinor, ndërsa për ankesat e tjera mund të vijohet me mbylljen e hetimit apo paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor.

Në këtë kuadër në aspekt të zbatimit në praktikë të këtij rregulli paraprakisht vlerësohet që me qëllim bashkimin e procedimeve hetimore duhet që të gjitha ankesat të përmbushin kriteret e pranueshmërisë sipas kërkesave të nenit 120 të Ligjit për Statusin, si dhe të jenë në të njëjtën fazë të trajtimit të tyre (hetimi disiplinor). Nëse njëra nga ankesat është në proces verifikimi dhe ankesa/t e tjera lidhet/n me të njëjtat fakte, nuk është nevoja që edhe ato të verifikohen. Nëse ankesa/t e reja lidhen me një shkelje tjetër të kryer nga i njëjti magjistrat, verifikimi i ankesës/ankesave varet nga përmbajtja e tyre. Pas verifikimit dhe në varësi të rezultatit të verifikimit, bashkimi i procedimeve hetimore është i mundshëm. Në këto raste, është shumë e rëndësishme përllogaritja e afatit për secilën procedurë, siç parashikohet nga neni 118, paragrafi 1 i Ligjit për Statusin. Ka 3 muaj kohë nga marrja e secilës ankesë për të vendosur për arkivimin e ankesës ose fillimin e hetimit.

Nëse janë filluar dy ose më shumë hetime, bashkimi i hetimeve duhet të vazhdojë me numrin e regjistrimit (protokollit) të hetimit i cili ka filluar i fundit. Në këtë mënyrë, përllogaritja e afateve duhet të jetë në përputhje me datën e Vendimit për fillimin e hetimit, i cili është dhënë i fundit. Kjo duhet parashikuar në mënyrë të shprehur në Vendimin për bashkimin e procedimeve hetimore. Nëse ka ankesa të paraqitura dhe hetime të filluara, atëherë do të jetë e vlefshme data e dhënies së Vendimit për fillimin e hetimeve. Në këto kushte, përllogaritja e afateve kohore duhet të jetë në përputhje me këtë Vendim.

Është e mundur që vendimi për bashkimin e procedimeve hetimore të përmbajë gjetje dhe konkluzione që lidhen me kompleksitetin e hetimit. Për shembull në rastet kur janë disa shkelje të cilat duhet hetuar ose kur vetë shkeljet kërkojnë veprime disiplinore komplekse. Në këtë rast, këshillohet që ky Vendim të zgjasë gjithashtu afatin e hetimit me tre muaj,

siç parashikohet nga neni 118, paragrafi 3 i Ligjit për Statusin. Titulli i vendimit duhet ndryshuar në përputhje me Ligjin-Vendim për Bashkimin procedimeve hetimore dhe zgjatjen e afatit të hetimit. Baza ligjore për këtë është Neni 118, paragrafi 3 dhe Neni 128 i Ligjit për Statusin. Dhënia e dy vendimeve në një është e rekomandueshme në rastet kur plotësohen kërkesat e ligjit.

Bashkimi i procedimeve hetimore ka një ndikim pozitiv mbi organizimin e punës së Zyrës së ILD-së, nëpërmjet shmangies së dublimit të procedurave. Një parakusht i rëndësishëm për bashkimin e procedimeve hetimore është organizimi i brendshëm dhe funksionimi i duhur i Zyrës. Të dhënat që lidhen me procesin e bashkimit të procedimeve hetimore duhen mbledhur dhe përditësuar rregullisht. Kjo do të thotë që procesi i monitorimit dhe vlerësimi i hetimeve në vazhdim dhe ankesat e paraqitura duhet të kryhen rregullisht nga Zyra e ILD-së nëpërmjet miratimit të rregullave të qarta lidhur me këtë proces.

iv. Nenet e lidhura

Neni 79 “Rastet e bashkimit të procedimeve” i Kodit të Procedurës Penale;

v. Standardet Ndërkombëtare dhe përputhshmëria

a. Këshilli i Europës “*Mekanizma Efektive per Procedimet te Tejzgjatura*”, e aksesueshme këtu: <https://www.coe.int/en/web/human-rights-intergovernmental-cooperation/work-completed/remedies-for-length-of-proceedings>

a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6 pika 1 të saj parashikon se:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Ky parashikim garanton të drejtën për një proces të rregullt, dhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ.

b. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Parimi VI pika 3 parashikon që: *“ligji duhet të parashikojë procedura të përshtatshme për të siguruar që gjyqtarët që i nënshtrohen procedurës disiplinore i janë siguruar*

të paktën garancitë për proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ, siç është psh shqyrtimi i çështjes brenda afateve të arsyeshme...".

- c. Raporti i ENCJ "Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve", miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015 Standardet 8 dhe 9 parashikojnë se:

"8. Duhet të parashikohet një afat kohor për paraqitjen e ankesës e cila mund të zgjatet vetëm në rrethana përjashtimore".

"9. Duhet të vendoset një afat kohor për përfundimin e hetimeve, marrjen e vendimit dhe vendosjen e sanksionit. Vendosja e ndonjë sanksioni duhet të bëhet menjëherë pas vendimit mbi bazueshmërinë e çështjes, dhe në çdo rast pa vonesë të panevojshme. Këto kufij duhet të jenë të afta të zgjaten vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë kompleksiteti i hetimit, sëmundja e gjykatësit ose një hetim penal".

- d. Çështjet Disiplinore duhet të dëgjojen brenda një afati të arsyeshëm dhe duhet të përcaktohet një kuadër kohor për fillimin e procedimit disiplinor dhe vendosjen e nje sanksioni disiplinor. (Parimi VI-3 i Rekomandimit n° R (94)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe Rekomandimi 3.12 mbi Rekomandimet e Këshillave për Gjyqësorin në Europës, Rrjeti European i Këshillave për Gjyqësorin, Romë 2011 – Raporti 2010-2011, RrEKGj dhe and § 17 i Parimeve Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit), i miratuar në Kongresin e shtatë për ndalimin e Krimit dhe Trajtimit të Shkelësve, i mbajtur në Milano nga data 26 Gusht deri në 6 Shtator 1985 dhe i mbështetur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 Nëntorit 1985 dhe 46/146 e 13 Dhjetorit 1985.

4.2.12. Komente mbi Nenin 129

Neni 129 i Ligjit për Statusin "Të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve gjatë hetimit" përcakton:

1. Magjistrati është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, sipas nenit 123 ose 124, të këtij ligji, dhe i garantohet aksesin në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë nga magjistrati informacion, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i dispozitës është garantimi i të drejtave të magjistratit për t'u njohur me materialet në dosjen e inspektimit në masën që lidhet me objektin për të cilin po hetohet magjistrati. Qëllim tjetër i kësaj dispozite janë detyrimet e vendosura për ILD-në për t'i siguruar akses magjistratit në dosjen hetimore; sigurimin e informacionit, dokumentacionit për provat e dosjes nga magjistrati/përfaqësuesi i tij; dhe përcaktimi i njoftimit të vendimit (pavarësisht llojit të vendimit) të marrë brenda një afati pesë ditor.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita përbëhet nga tre paragrafë. Në paragrafin e parë parashikohet e drejta e magjistratit për të pasur akses në dosjen hetimore. Në paragrafin e dytë parashikohet detyrimi i magjistratit për të vënë në dispozicion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo informacion, dokument ose provë që ka lidhje me hetimin i cili po zhvillohet nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa në paragrafin e tretë parashikohet e drejta e magjistratit për t'u njoftuar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vendimet e marra nga ana e tij për sa i përket arkivimit të ankesës, fillimin e hetimit disiplinor, shtimi ose ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor apo mbylljen e hetimit disiplinor.

iii. Komentar i dispozitës

Kjo dispozitë zbatohet ndaj magjistratit, si subjekt direkt i hetimit në ngarkim të tij, si edhe ndaj përfaqësuesit të zgjedhur prej magjistratit, kur ILD-ja ka arritur në një vendim lidhur me hetimi. Dispozita shtrihet edhe ndaj ILD-së duke përcaktuar detyrime për zbatimin e saj dhe afatin brenda të cilit duhet të merret vendimi për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit. nisur nga parashikimet e nenit 129, detyrimi për ILD-në është që në përmbyllje të procesit hetimor të zhvilluar, të dalë me një vendim ndaj ankesës së ardhur në ngarkim të magjistratit.

Neni 129 i Ligjit Për Statusin është formuluar duke pasur parasysh se magjistrati në një procedurë disiplinore është subjekti ndaj të cilit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka inicuar një proces hetimor. Përmes parashikime të këtij neni, magjistratit i ofrohet dhe garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, proces i cili kërkon respektimin e të drejtës për t'u njohur, dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes. Të gjithë këto elemente garantojnë të drejtën kushtetuese të secilit për një proces të rregullt ligjor si një e drejtë themelore, lidhur me procesin hetimor. Nga ana tjetër

parashikimet e pikës 1 të këtij neni, respektojnë parimin i barazisë së armëve që nënkupton një ekuilibër të drejtë mes mgjistratit nën hetim dhe ILD- që duhet të respektojë këtë të drejtë. Çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre, pikërisht vendosja e detyrimit të ILD-së për të vënë në dispozicioni materiet e dosjes hetimore.

Nisur nga gjuha e përdorur nga ligjvënësi, për pikën 1 të këtij neni, aksesin në dosjen e hetimit i garantohet magjistratit, kur ndaj tij ka një ankesë me nismë të ankuesit dhe kur hetimet kanë filluar me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar mbi të dhëna thelbësore nga fakte që rezultojnë nga burime të besueshme dhe lind një dyshim i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Në vlerësim të këtij parashikimi, magjistratit i lind e drejta të njihet me ato fakte që përbëjnë objektin e hetimit dhe duhet t'i vihet në dispozicion për njohje i gjithë dokumentacioni përkatës mbi të cilat justifikohet fillimi i hetimit dhe propozohet marrja e masës disiplinore. Gjuha e përdorur për këtë nen, lidh garancinë e njohjes me informacionin e dosjes, me një kufizim për akses në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit. Hartuesit jo paqëllim kanë vendosur një kufizim të së drejtës për njohje me materialin hetimor, pasi e drejta e njohjes mund të jetë e kufizuar në atë masë që është e domosdoshme për njohje nga magjistrati dhe kufizimi duhet të jetë proporcional në drejtim të të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve nga të dhënat e dala nga hetimi.

Pika 2 e këtij neni parashikon të drejtën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar çdo informacion nga magjistrati që paraqitet si nevojë gjatë procesit hetimor. Ky parashikim kërkon bashkëpunimin e magjistratit për t'iu përgjigjur kërkesave të ILD-së në vlerësimin objektiv të të gjitha dyshimeve të ngritura dhe marrjen e një vendimi sipas fakteve dhe provave që do të administrohen.

Pika 3 e këtij neni parashikon detyrimin e ILD-së, që pas verifikimit të çdo pretendimi dhe rrethane të paraqitur, të arrijë në një vendim në lidhje me hetimin e zhvilluar. Lloji i vendimit që mund të merret nga ILD- janë ato të parashikuar nga ky nen dhe në respektim të afati të përcaktuar. Parashikimet e pikës 3 të nenit 129 duhen lexuar në harmoni me parashikimet e bëra edhe në pikë 4 të nenin 119, për mes të cilës parashikohet detyrimi i ILD-së për të njoftuar edhe ankuesin brenda pesë ditëve për vendimin e marrë. Njoftimi i magjistratit është parakusht ligjor dhe një garanci për të drejtën e magjistratit nën hetim për të apeluar aketet e nxjerra nga ILD në rastet kur shprehimisht është e përcaktuar me ligj.

Veprimet procedurale që duhet të kryejë ILD-ja në kuadër të procesit

hetimor është kërkesa për dërgim të informacionit, vlerësimi të dokumentacionit, informacionit apo çdo prove që është e nevojshme për hetimin nga ana e ILD.

Ligji nuk parashikon ndonjë akt specifik për llojin e informacionit, por sa i përket rasteve kur paraqitet nevoja e marrjes në pyetje të magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë, i njofton për kohën dhe vendin e seancës. Ligji parashikon për regjistrimin e seancës së marrjes në pyetje, duke parashikuar edhe procedurën përmes parashikimeve të bëra në nenin 131, pikat 2-3.

Ndërsa sa i takon kërkesave në lidhje me mbledhjen e provave nga institucione të tjera, ligji parashikon për marrjen e informacioneve me kërkesë, brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar në kërkesë. Në çdo rast informacioni i kërkuar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të jetë një shkresë zyrtare e motivuar dhe e arsyetuar dhe të përmbajë përshkrimin e lidhur me ekzistencën rrethanave dhe informacionit të kërkuar, duke qenë shterues në kërkimin e informacionit, por njëkohësisht të qartë në artikullimin e saktë të informacionit të kërkuar që lidhen me nevojat të procesit hetimor. Kujdes duhet treguar ndaj informacioneve që ka një kufizim të përcaktuar me ligj se nuk mund të vihet në dispozicion.

Nëse informacioni i kërkuar nga ana e ILD-së, përbën informacion konfidencial ose kur në informacion ka të dhëna të mbrojtuar nën regjimin e mbrotjes së të dhënave personale, ILD duhet të vijojë me kërkesë drejtuar GJKKO, për të urdhëruar dhënien e informacionit.

Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe të parashtrojë të gjitha dhënat faktet dhe provat që provojnë dyshimin e arsyeshëm se shkelja ekziston dhe është e mbështetur në prova dhe fakte të marra në përputhje me paarashikimet e ligjit për marrjen e tyre. Për këtë qëllim duhet përgatitur kërkesa drejtuar GJKKO dhe gjykata duhet të ndjekë procedurat për për lëshimin e urdhrit nga gjykata.

Në lidhje me aktet e njoftimit të vendimeve ato do të konceptohen me shkresë zyrtare, ku do të njoftohet ankuesi në mënyrë të përmbledhur për arsye që kanë çuar ILD-në në vendimmarrjen përkatëse.

iv. Nenet e lidhura

Neni 119 123, 124, 131, dhe neni 132 të Ligjit për Statusin.

Në respektim të këtij neni rezulton që nenet të lidhura të jenë nenet respektive të Kodit të Procedurës Penale që përcaktojnë shqyrtimin e

kërkesave pranë GJKKO, për lëshimin e urdhrit për dhënie informacionit konfidencial apo kur ka të dhëna personale, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

a. Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në përuthje me Nenin 6 paragrafi 3 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duhet të garantohen minimalisht standardet procedurale të mëposhtme:

- Sapo hetimi disiplinor të ketë filluar, gjyqtari ka të drejtën t'i komunikohet përmbajtja e dosjes dhe materialet paraprake të hetimit, nëse ka patur një proces të tillë;
- Gjyqtari nën hetim mund të asistohet nga një avokat;
- Parimi i ballafaqimit të fakteve duhe të respektohet;
- Gjyqtari i akuzuar duhet të ftohet për të paraqitur parashtrimet dhe shpjegimet e tij dhe mekanizmat e mbrojtjes mbi faktet në të cilat ai/ ajo është akuzuar.
- Seanca dëgjimore duhet të jetë me dyer të hapura, vendimi duhe të jetë i arsyetuar dhe në përpjestim me seriozitetin e shkëljes si dhe duhe të behet publik.

b. Procedurat e procedimeve disiplinore kundër gjyqtarëve duhe të zbatohen duke garantuar mbrojtjen e plotë të drejtave, paragrafi § 71 dhe paragrafi § 77.iii) të Opinionit nr. 3 (2002) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (KKGJE) mbi parimet dhe rregullat që drejtojnë sjelljen profesionale të gjyqtarit, në mënyrë të veçantë etika, sjellja e papërshtatshme dhe paanshmëria.

c. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë (KKGJE) në Opinionin e tij nr. 10 (2007) në vëmendjen e Komitetit të Minsitrave të Këshuilli të Europës, mbi Këshillin për Gjyqësorin në shërbim të shoqërisë, shprehimisht përcakton në Kapitullin VI “Këshilli për Gjyqësorin në funksion të llogaridhënies dhe transparencës së Gjyqësorit”, paragrafi 92 “Kur Këshilli për Gjyqësorin ka autoritet disiplinor, gjyqtarët që janë subjekt i procedimeve disiplinore do të informohen plotësisht mbi bazat e vendimit, në mënyrë që ata të vlerësojnë nëse mund të përgatisin një apel kundër këtij vendimi. Gjithashtu, Këshilli për Gjyqësorin mund të konsiderojë publikimin e vendimeve të janë përfundimtare dhe formale, në mënyrë që të informojnë, jo vetëm të gjithë gjyqësorin, por edhe publikun e gjerë mbi metodën mbi të cilën janë kryer procedimet dhe të tregojnë se gjyqësori nuk synon të mbulojë verimet e dënueshme të anëtarëve të tij”.

4.2.13. Komente mbi Nenin 130

Neni 130 i Ligjit për Statusin “Ecuria e hetimeve”¹⁷² përcakton

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të nenit 123 të këtij ligji.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione publike apo subjekte private, dëshmitarë dhe ose magjistrati, dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

3. Kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë që të mos cenohet pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

- a) pezullon hetimet, sipas rasteve të parashikuara në nenin 126 të këtij ligji;
- b) vazhdon me hetimin nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij neni është përcaktimi i qartë i qëllimit të hetimit pas vlerësimit të fakteve dhe provave që lidhin shkeljen e pretenduar me magjistratin ndaj të cilit është ngritur një pretendim për një shkelje të mundshme. Qëllim tjetër është përcaktimi i mënyrës së vijimit të punës nga ana e ILD-së, për të mos ndikuar apo vendosur në kushte presion i (intimiduar/frikësuar) magjistratin në çështjen në proces, kur ndaj tij ka pretendime për një shkelje e cila mund të jetë e lidhur me atë çështje në proces, por edhe e ndryshme nga çështja në proces. Ndaj legjislatori ka përcaktuar kushtet për pezullimin e hetimet disiplinor.

ii. Fushëveprimi i dispozitës;

Dispozita është hartuar me stil të thjeshtë dhe përmban 3 paragrafë, të cilët gjejnë zbatim ndaj inspektorëve përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve hetimore, por edhe ndaj magjistratit, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt sa i takon pretendimeve për një shkelje. Dispozita shtrin fushëveprimin e e saj edhe ndaj subjeteve të përfshira në procedimin disiplinor, si ankues, dëshmitarë, institucione shtetërore, organizata etj.,

172 (ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 15/2020, datë 12.2.2020).

iii. Komentari i dispozitës;

Kjo dispozitë, parashikon në mënyrë të përmblodhur vijimin e punës nga ana e inspektorit përgjegjës, i cili në përcaktimin e objektit të hetimit, duhet të ketë vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit, bazuar në dëshmi, fakte e prova se shkelja e pretenduar lidhet me një veprim a mosveprim të magjistratit.

Paragrafi 1 i kësaj dispozite në mënyrë të shprehur i referohet nenit 123 “Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit”, të Ligjit për Statusin. Arsyeja është se ligjvënësi përsëri kujton rëndësinë e qëllimit të hetimit, ku të gjithë elementët e shkeljes së pretenduar duhet të përcaktohen qartë. Vendimi për fillimin e hetimit do të shërbejë si udhëzim për inspektorin përgjegjës në lidhje me pyetjen vijuese: çfarë do të hetohet dhe provohet nga provat që duhet të mbledhen, verifikohen dhe analizohen në përputhje me rrethanat.

Vlerësimi i pretendimeve duhet të jetë i mbështetur në ligj dhe në prova, në mënyrë që të provohet kryerja e shkeljes, andaj është me rëndësi të veçantë që inspektori të grumbullojë të dhëna përmes dokumenteve të marra nga çdo subjekt i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni. Pas mbledhjes dhe vlerësimit të tyre, inspektori përgjegjës duhet të tregojë dilgjencën e duhur për të arritur në konkluzionin se cilat pretendime qëndrojnë dhe të vijojë me ndërtimin e akuzës ndaj magjistratit. Ndërtimi i akuzës, duhet të jetë objektiv dhe provat e mbledhura të jenë të pakundërshtueshme në drejtim të atribuimit të shkeljes., pasi standardi i zbatueshëm nga ana e inspektorit është ai i prezumimit të pafajësisë dhe faktimi i shkeljes së pretenduar përtej dyshimit të arsyeshëm. Parë në këtë këndvështrim, inspektori përgjegjës duhet të marrë në konsideratë jo vetëm faktet që lidhin pretendimin e shkeljes ndaj magjistratit, por edhe ato fakte të cilat janë në favor të magjistratit. Respektimi i këtij standardi nga ana e inspektorit, jo vetëm që i shërben vlerësimit të punës individuale të tij në kujdesin dhe dilgjencën profesionale të treguar, por ndikon në ndërtimin e një akuzë të bazuar me të fakte dhe prova që janë të pakundërshtueshme. Qëllimi madhor i procedimit disiplinor, nuk është të penalizojë sa më shumë magjistratë, por të barazpeshojë veprimin a mos veprimin e tij në raport të drejtë me shkeljen që i atribuohet. Një qasje e tillë, i shërben përmbushjes së misionit të ILD-së, por edhe respektimit të vlerave dhe parimeve të procedimit disiplinor të përcaktuara në nenin 100 të Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, zbatimi me korrektësi i parashikimeve ligjore nga ana e inspektorit përgjegjës dhe ruajtja e standardeve të mësipërme, i shërben forcimit të rolit të ILD-së dhe vlerave që përfaqëson ky organ kushtetues në sistemin e drejtësisë.

Neni 130, parashikon në paragrafin e tretë të tij se hetimet kryhen në situatën kur ai është duke ushtruar detyrën dhe fakti që ka një hetim të nisur ndaj tij, pikërisht ndaj çështjes objekt i shkeljes së pretenduar, nuk duhet të ndikojë në ushtrimin e detyrës dhe magjistratti duhet të garantojë paanshmërinë dhe objektivitetin në realizimin e detyrës. Ky parashikim kërkon ndërprerjen e përkohshme të veprimeve hetimore, pavarësisht fazës së ndodhur ndaj fjalës e dytë e këtij neni kërkon që të merret vendimi i pezullimit, kur në procesin penal a civil, shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. Parashikimi i bërë në këtë pikë, kërkon një vlerësim të ILD-së, nisur nga faktet dhe rethanat, nëse mund të realizohet një hetim në mënyrë të tillë që të mos çënojë procesin e nisur në gjykatë apo prokurori. Nëse nga vlerësimi i të dhënave rezulton se procesi i hetimit mund të japë shkak ndikimit të çështjes në shqyrtim, pranë gjykatës s apo prokurorisë, ILD-ja duhet të pezullojë hetimin. Një parashikim i tillë e bën nxjerrjen e një akti, diskrecional për aq kohë sa ka të dhëna që mund të ndikojnë procesin para gjykatës apo prokurorisë, ndryshe nga sa parashikon neni 126 i ligjit për statusin ku vendimi i pezullimit bëhet i detyrueshëm kur përmbushen kushtet e përcaktuara në paragrafët “a” dhe “b” të këtij neni.

Ky parashikim kërkon nxjerrjen e një akti procedural, siç është ai i vendimit të pezullimit të hetimit, i cili shërben për të ndërprerë afatet e nenit 117 të Ligjit për Statusin, por edhe *vetëm rastin kur shkelja lidhet me një proces në zhvillim para gjykatës ose në prokurori* dhe hetimi kryhet në një mënyrë që nuk çënon ecurinë e procesit të nisur. Vendimi i pezullimit duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë:

- a) shpjegimin e situatës faktike dhe qëllimin mbi të cilën është marrë vendimi;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen;
- d) lidhjen e pretenduar me çështjen e filluar në gjykatë dhe prokurori;
- e) arsyet pse nuk mund të vazhdojë hetimi disiplinor përpara nxjerrjes së vendimit të formës së prerë për çështjen e filluar;
- f) arsyet pse vijimësia e hetimit disiplinor mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit në gjykim apo hetimin e çështjes së filluar’;
- g) arsyet pse vijimi i çështjes së filluar konsiderohet si ndërhyrje;
- ç) me raste shpjegimin për diskrecioni e përdorur dhe pse është përdorur në mënyrë e përcaktuar.

Veprimet procedurale janë ato hetimore dhe vendimi i pezullimit Pezullimi do të vazhdojë derisa organi kompetent të nxjerrë një vendim

përfundimtar (paragrafi 2). Ndërkohë, afatet e parashkrimit parashikuar nga Neni 117 do të ndërpriten sipas parashikimit në paragrafin 5.

Po kështu akti i pezullimit duhet t'i njoftohet, magjistratit, këshillave dhe ankuesit, për këtë qëllim do të përgatitene njoftimet përkatëse.

iv. Nenet e lidhura

Neni 100, i Ligjit për Statusin

Neni 117, i Ligjit për Statusin

Neni 123 i Ligjit për Statusin

Neni 126, i Ligjit për Statusin

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

a. **Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut**, në nenin 6 pika 1 të saj parashikon se:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Ky parashikim garanton të drejtën për një proces të rregullt, dhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ.

b. Karta e Madhe Europiane për të Drejtat Themelore, Neni 48 “Parimi i pafajësisë dhe e drejta e mbrojtjes”.

c. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB në vitin 1985, në paragrafin 17 për Disiplinën, Pezullimin dhe Shkarkimin nga detyra, parashikon që: *“Një akuzë ose ankesë kundër një gjyqtari, në cilësinë e tij/saj profesionale dhe gjyqësore, duhet të procedohet në mënyrë të përshtatshme dhe me ndershmëri sipas një procedure të përshtatshme”;*

d. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Parimi VI pika 3 parashikon që: *“ligji duhet të parashikojë procedura të përshtatshme për të siguruar që gjyqtarët që i nënshtrohen procedurës disiplinore i janë siguruar të paktën garancitë për proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ, siç është psh shqyrtimi i çështjes brenda afateve të arsyeshme...”*.

e. Raporti i ENCJ “Standartet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015 Standardet 8 dhe 9 parashikojnë se:

“8. Duhet të parashikohet një afat kohor për paraqitjen e ankesës e cila mund të

zgjatet vetëm në rrethana përjashtimore”.

“9. Duhet të vendoset një afat kohor për përfundimin e hetimeve, marrjen e vendimit dhe vendosjen e sanksionit. Vendosja e ndonjë sanksioni duhet të bëhet menjëherë pas vendimit mbi bazueshmërinë e çështjes, dhe në çdo rast pa vonesë të panevojshme. Këto kufij duhet të jenë të afta të zgjaten vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë kompleksiteti i hetimit, sëmundja e gjykatësit ose një hetim penal”.

- f. Çështjet Disiplinore duhet të dëgjoen brenda një afati të arsyeshëm dhe duhet të përcaktohet një kuadër kohor për fillimin e procedimit disiplinor dhe vendosjen e nje sanksioni disiplinor. (Parimi VI-3 i Rekomandimit n° R (94)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe Rekomandimi 3.12 mbi Rekomandimet e Këshillave për Gjyqësorin në Europës, Rrjeti European i Këshillave për Gjyqësorin, Romë 2011 – Raporti 2010-2011, RrEKGj dhe **and** § 17 i Parimeve Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit), i miratuar në Kongresin e shtatë për ndalimin e Krimit dhe Trajtimit të Shkelësve, i mbajtur në Milano nga data 26 Gusht deri në 6 Shtator 1985 dhe i mbështetur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 Nëntorit 1985 dhe 46/146 e 13 Dhjetorit 1985.

4.2.14. Komente mbi Nenin 131

Nenin 131 i Ligjit për Statusin “Kërkesat për marrjen në pyetje” përcakton:

1. *Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se marrja në pyetje e magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.*
2. *Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për detyrë të sigurojë që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:*
 - a) *personi që merret në pyetje duhet të informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio;*
 - b) *regjistrimi duhet të përmbajë gjenealitetet e personave që janë thirrur për t’u pyetur;*
 - c) *në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;*
 - ç) *në përfundim të seancës, personi i marrë në pyetje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe*

regjistrohen korigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklaratimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.

3. *Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje duhet të përmblihet në procesverbal, si dhe mund të transkribohet. Magjistrati nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.*
4. *Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.*

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij neni është të përcaktojë kushtet për paraqitjen e kërkesave për marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose personave të tjerë që paraqesin rëndësi për hetimin si edhe kushtet për procedurën që ndiqet në raste të marrjes në pyetje dhe formalitetet e nevojshme për bërjen pjesë të dosjes.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Nisur nga teknika e hartimit të kësaj dispozite, ajo rezulton e hartuar me një stil të thjeshtë, e përbërë nga 4 paragrafë, ku secili prej tyre parashikon kushtet dhe procedurat për marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe personave të thirrur për tu marrë në pyetje.

iii. Komentari i dispozitës

Dispozita është e ndërtuar në linjën e dispozitave procedurale të parashikuara nga kodet procedurale civile, penale dhe administrative, duke përcaktuar se për marrjen në pyetje të subjekteve, përfshi këtu magjistratin, dëshmitarët ose personat e tjerë që mund të kenë informacion mbi rastin objekt hetimi.

Pasi janë identifikuar personat e tjerë dhe dëshmitarët, përcillet akti i njoftimit për datën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

Sipas paragrafit të dytë të këtij neni marrja në pyetje, duhet të jetë e regjistruar në format audio, duke përcaktuar edhe për procedurat e nevojshme që duhet të ndiqen nga ILD-ja, sipas së cilës, në fillim të seancës personit të thirrur i lexohet se seanca do të regjistrohet, përmenden emri/emrat e personave dhe vijon seanca. Çdo ndërpreje e seancës do të dokumentohet me regjistrim, ashtu si edhe çdo saktësim i bërë nga ana të intervistuarit dhe në përfundim të procedurës do të regjistrohet edhe ora e mbylljes së seancës duke evidentuar çdo ndërprerje dhe në fund të intervistës, regjistrohet edhe ora e përfundimit të saj.

Regjistrimi duhet të pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në

procesverbal i cili përfshihet në dokumentacionin pjesë e dosjes hetimore.

Në rast se paraqitet nevoja, regjistrimi mund të transkriptohej. Në fund të procedurës, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë palët që kanë qenë të pranishëm në seancën e marrjes në pyetje.

Parashikimet e bëra në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, janë të një rëndësie të veçantë, për procesin e marrjes në pyetje e për pasojë në hetimet e zhvilluara nga ILD-ja, në kushtet kur në ushtrimin e pushtetit të dhënë me ligj, ILD-ja ka një rol vendimmarrës në lidhje me marrjen në shqyrtim të interesave të ligjshëm të të dy subjekteve (ankuesin dhe magjistratin ndaj të cilit është ushtruar ankim), duhet gjykojë në mënyrë proporcionale dhe të dokumentojë provat dhe dëshmitë e paraqitura nga njëra anë dhe duhet të respektojë të drejtat e magjistratit objekt hetimi, sikurse është përcaktuar në nenin 129 të ligjit për statusin.

Po kështu këto parashikime përcaktojnë detyrimin që ka ILD-ja, në dokumentimin e procesit dhe rëndësinë e vlerësimit të dëshmive dhe qartësisht të rrethanave që kanë diktuar nisjen e hetimit, në mënyrë që përfundimet e veprimeve hetimore të jenë të plota dhe të pakontestueshme para Këshillave.

Zbatimi i kërkesave ligjore, organizimi i procedurave transparente dhe në garantim të plotë të së drejtës për t'u dëgjuar, njohur me dosjet dhe të drejtës për t'u informuar, janë gur themeli për standardet e punës dhe së paraqitur nga ILD-ja .

Në të njëjtën kohë, respektimi i parashikimeve të bëra në nenin 131, garanton edhe parimin e transparencës së veprimeve të kryera në një procedurë të marrjes në pyetje. Kjo për faktin se zbatimi i kërkesave ligjore të nënparagrafëve "c" dhe "ç", siguron mjetet efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të personave të prekur.

Akti procedural që duhet të hartohet është "procesverbali", i përmbledhur, i cili duhet të përmbajë të gjithë elementët e parashikuar nga neni 133, i ligjit për Statusin. Ligji parashikon edhe transkriptimin e seancës në kjo është e mundur. Procesverbali bëhet pjesë e dosjes dhe nëse bëhet transkriptimi duhet të jetë pjesë e dosjes hetimore gjithashtu.

Përsa i përket transkriptit ligji nuk përcakton ndonjë formalitet të caktuar, por për analogji dhe për aq sa mund të jetë e zbatueshme të ndiqen udhëzimet përkatëse për sa i takon mbajtjes së seancave audio, sipas udhëzimit nr. 353, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio*", i ndryshuar.

iv. Nenet e lidhura

Nenet 133 paragrafi 2 i Ligjit për Statusin;

Udhëzimi Nr. 353 datë 03.09.2013 i Ministrisë së Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

v. Standardet Ndërkombëtare dhe përputhshmëria

1. Publikimi i Këshillit të Europës “Një hyrje e shkurtër mbi intervistimin hetimor- një udhëzues për praktikantët”, e cila ofron një udhëzim mbi mbajtjen e intervistës gjatë një procesi hetimor, e aksesueshme në linkun e mëposhtëm: https://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop/newsroom/_/asset_publisher/lf1Iqv64qGrg/content/a-neq-publication-a-brief-introduction-to-investigative-interviewing-a-practitioner-s-guide-is-made-available-to-law-enforcement-officers?_101_INSTANCE_lf1Iqv64qGrg_viewMode=view;

- a. Publikimi i Këshillit të Europës “ Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut mbi standardet e mbledhjes së provave në procedimet penale”, e aksesueshme në linkun e mëposhtëm: <https://rm.coe.int/council-of-europe-georgia-european-court-of-human-rights-case-study-ev/16807823c3>;
- b. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)”, e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;

4.2.15. Komente mbi Nenin 132

Neni 132 i Ligjit për Statusin “Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera” përcakton:

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik duhet të zbatojë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga inspektori në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Nëse gjatë hetimit disiplinor të magjistratit ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, regjistrime telefonike ose prova të tjera, të cilat mbrohen nga garancitë për konfidencialitet ose mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t’i kërkojë Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, lëshimin e një

urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për magistratin.

3. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përsërit kërkesën, në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë gjobë deri në 100 000 lekë, si dhe njofton organin përgjegjës disiplinor.

5. Urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.

6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në Këshillin përkatës brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij.

i. Qëllimi i Nenit 132

Ligjvënësi synon të vendosë rregulla të qarta në lidhje me detyrimet e të gjithë organeve publike, personave fizikë dhe juridikë për të përmbushur kërkesat e ILD-së për të marrë informacion, dokumente ose prova të tjera në lidhje me një hetim. Qëllimi i dispozitës është vendosja e rregullave procedurale të komunikimit ndërmjet ILD-së dhe organeve të tjera, personave dhe institucioneve, duke përfshirë vendosjen e një sanksioni financiar nga ILD-ja nëse kërkesa e përsëritur nuk përmbushet nga institucionet, organet ose personat brenda afatit të përcaktuar.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozitat rregullojnë objektin dhe mënyrën e komunikimit ndërmjet ILD-së dhe të gjithë organeve, personave fizikë dhe juridikë brenda kuadrit të hetimeve disiplinore të filluara. Dispozita është e mirë strukturuar, e qartë dhe përmban të gjitha hollësitë e nevojshme për të vendosur rregullat dhe format standarde që duhen aplikuar nga ILD-ja për të siguruar zbatimin e duhur. Dispozita është në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

Kërkesat e parashikuara në këtë dispozitë ligjore mund të ndahen në dy kategori kryesore: rregulla për ILD dhe rregullat për organet e tjera, institucione ose persona të cilëve ju adresohet kërkesa e ILD.

Kërkesa për informacion, dokumenta, regjistrime telefonike dhe prova është një e drejtë e ILD në kuadrin e secilit prej hetimeve disiplinore në hetim dhe do të bazohet mbi rregulla të qarta procedurale.

Kërkesat ndaj ILD-së:

Kërkesa e parë është që kërkesa e ILD-së të shtjellohet vetëm në rastin e hetimeve disiplinore të filluara.

Kërkesa e dytë është që informacioni i kërkuar nga ILD-ja të jetë në lidhje me magjistratin nën hetim dhe në lidhje me hetimin.

Kërkesa e tretë ka të bëjë me objektin e kërkesës. ILD-ja mund të kërkojë informacion, dokumente ose prova të tjera në lidhje me një hetim, përveç kur është i kufizuar me ligj.

Kërkesa e katërt është që kërkesa të jetë e arsyetuar dhe tregojë se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se magjistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur (paragrafi 3).

Kërkesa e pestë ka të bëjë me afatin për dhënien e informacionit të kërkuar - ILD-ja përcakton afate të arsyeshme në kërkesën e tij. Kjo do të thotë që institucioni të cilit i kërkohet të japë informacion do të ketë kohën e mjaftueshme për të marrë kërkesën, të kërkojë dhe të mbledhë informacionin dhe t'i përgjigjet përkatësisht ILD-së. Në çdo rast, kufizimi kohor konsiderohet në pajtim me specifikat e informacionit të kërkuar.

Kërkesa e fundit ka të bëjë me përsëritjen e kërkesës nëse përgjigja nuk është marrë brenda afatit kohor të përcaktuar në kërkesën e parë.

Kërkesë e veçantë e ILD-së

Ligji parashikon mundësinë e një kërkesë të veçantë nga ILD-ja e cila i paraqitet Gjykatës AntiKorrupsion dhe Krimin të Organizuar (GJKKKO) për të nxjerrë një urdhër për deklarimin e informacionit mbi magjistratin, i cili është i mbrojtur nga një garanci e konfidencialitetit ose mbrojtja e të dhënave personale (paragrafi 2). Në këtë rast, ILD-ja i paraqet gjykatës një arsyetim që tregon qartazi nevojën lëndore dhe specifike për informacionin e kërkuar. Interpretimi i këtij paragrafi sjell konkluzionin që këto kërkesa duhet të ushtrohen nga ILD-ja si një përjashtim dhe nëse konkluzionet e hetimit disiplinor varen thelbësisht nga informacioni i kërkuar që të deklarohet nga GJKKKO.

Kërkesat kundrejt organeve, institucioneve dhe personave të tjerë fizik ose juridik, të cilëve iu adresohet kërkesa e ILD

Detyrimi për të dhënë informacionin e kërkuar nga ILD-ja është i parashikuar për çdo organ publik, person fizik ose juridik. Kërkesa e parë për organin/ personin përkatës është dhënia e informacionit të kërkuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga ILD-ja. Nëse informacioni i kërkuar nuk ekziston tek institucioni/ organi ose nëse ka shkaqe të tjera që nuk lejojnë dhënien e informacionit të kërkuar, personi përgjegjës i përgjigjet përkatësisht ILD-së. Nëse kërkesa i është drejtuar gabimisht një organi/ personi përkatës dhe ky i fundit nuk ka akses tek informacioni i kërkuar nga ILD-ja, ky e informon ILD-në përkatësisht. Çdo pengesë tjetër që mund të pengojë zbatimin në kohë të kërkesës i njoftohet ILD-së. Kërkesa e dytë lidhet me kërkesën e dytë të ILD-së dhe detyrimin për t'u përgjigjur brenda afatit kohor të përcaktuar nga ILD-ja. Përndryshe, ligji parashikon një mundësi që ILD-ja të caktojë një gjobë deri në 100 000 lekë.

Paragrafi që ka të bëjë me caktimin e një gjobe në rastin e mospërbushjes së kërkesës së dytë të ILD-së është një institut ligjor i prezantuar rishtazi. Ky institut ligjor i ri i prezantuar nëpërmjet dispozitave të veçanta të Nenit 116 dhe Nenit 132 ka për qëllim disiplinimin e organeve dhe personave në përbushjen e detyrimeve të tyre ndaj ILD-së dhe Këshillit.

Ligji për Statusin përmban dy dispozita ligjore të cilat parashikojnë mundësinë për dënimin me gjobë nga ana e ILD-së – Neni 132 para. 4 dhe 5 dhe Neni 116 “Masat për shmangien e vonesave”. Këto dispozita përmbajnë kërkesa të veçanta për vendosjen e gjobës dhe u referohen rrethanave, objekteve, pasojave etj. të ndryshme. Lind nevoja për përgatitjen e një forme standarde të veçantë për zbatimin e këtyre dispozitave. Për shembull, Neni 116 lejon vendosjen e gjobës deri në 100 000 lekë ndaj magjistratit nën hetim ose procedim disiplinor, ndaj përfaqësuesit të tij/saj, ndaj dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit në rast se ata cenojnë dinjitetin e ILD-së ose Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën. Parakushti kryesor për vendosjen e gjobës bazuar në Nenin 116 është që autoriteti kompetent duhet të paralajmërojë dhe udhëzojë magjistratin mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Autoriteti kompetent mund të vendosë gjobën vetëm pas paralajmërimit dhe udhëzimit, si dhe nëse sjellja përsëritet në të njëjtin drejtim. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë. Kjo do të thotë që përsëritja e shkeljes duhet të provohet nga autoriteti kompetent nëpërmjet provave përkatëse (procesverbali i veprimeve hetimore, procesverbali i seancave, dokumente zyrtare të tjera). Neni 116 parashikon mundësinë e ushtrimit të ankimit ndaj vendimit për dënimin me gjobë, i cili paraqitet tek Këshilli në rast se gjoba vendoset nga ILD ose tek gjykata kompetente në rast se gjoba vendoset nga Këshilli. Sa i përket procedurës së parashikuar nga Neni 132, ankimi

ndaj këtij vendimi të ILD-së nuk parashikohet nga ky nen.

Pika 2 e nenit 116 dhe pika 4 e nenit 132 të Ligjit për Statusin përcaktojnë gjobën në kufirin maksimal, duke mos dhënë kritere që vlerësohen në caktimin e shumës konkrete të gjobës në një rast të veçantë. Në këto raste, zbatohet ligji nr. 10279/2010 “Për kundravajtjet administrative” (Ligji për Kundravajtjet), i cili në nenet 11 pika 2 dhe 18 parashikon se në caktimin e masës së gjobës, duhen mbajtur parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezultoi i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi; d) kritere të tjera shtesë të miratuara nga vetë organi.

Në kushtet kur neni 116 hesht për elementët formalë të vendimit për caktimin e gjobës, atëherë zbatohet neni 19 pika 1 e Ligjit për Kundravajtjet, i cili përcakton këto elementë të vendimit: a) organin që ka nxjerrë aktin; b) identitetin e kundërvajtësit; c) shpjegimin e përmbledhur të fakteve dhe të provave ku mbështetet vendimi; ç) shkeljen e kryer, duke referuar në nenin 116 të Ligjit për Statusin ku mbështetet vendimi; d) masën e dënimit me gjobë; dh) cilësimin si titull ekzekutiv për masën e gjobës; e) të drejtën e ankimit, organin ku paraqitet ankimi dhe afatin e paraqitjes së ankimit prej 24 orë nga marrja dijeni e vendimit për vendosjen e gjobës siç parashikohet nga Neni 116.

Sa i përket Nenit 132, duke qenë se ankimimi ndaj vendimeve të dhëna në bazë të këtij neni, nuk parashikohet nga legjislatori, dispozita që zbatohet do të jetë Neni 26 i Ligjit për Kundravajtjet

Administrative, i cili parashikon rregullat e përgjithshme për ankimimin ndaj vendimeve të kundravajtjeve administrative, i cili parashikon dënim me gjobë, nxjerrë nga organi administrativ.

Me rëndësi për t’u theksuar është që me krijimin e tyre, KLGJ dhe ILD duhet të përgatisin rregulla të brendshme (udhëzime) në mënyrë që të lehtësojnë dhe njehsojnë zbatimin e të dy procedurave për dënimin me gjobë (Neni 116 dhe Neni 132). Ky udhëzim duhet të përmbajë elementët formalë të vendimeve mbi dënimet me gjobë; kriteret për vendosjen e shumës konkrete të gjobës; mënyrën e mbledhjes dhe vërtetimit të fakteve të cilat janë si parakushte për dënimin me gjobë; format standarde të të dy vendimeve, njoftimet, kërkesat për informacion sipas Nenit 132 etj.

Neni 132 duhet zbatuar sipas të gjitha kërkesave ligjore të renditura më sipër. Është me rëndësi të veçantë që ILD-ja kontrollon me kujdes çdo parakusht dhe kërkesë të parashikuar nga ligji para se të vendosë dënimin me gjobë.

Neni 132, para. 5 i Ligjit për Statusin parashikon që “Urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.” që do të thotë se menjëherë pas marrjes së urdhrin dhe njoftimit nga ILD-ja, përbaruesi është i detyruar të ekzekutojë urdhrin. Kjo dispozitë tregon konceptimin nga ligjvënësi që ILD-ja do të përmbushë detyrimet e tij/saj para vendosjes së gjobës në përputhje të plotë me ligjin.

Duhet theksuar se në fund të paragrafit 4, neni 132, parashikohet që ILD-ja “...të njoftojë organin përgjegjës disiplinor”. Në fakt, është e qartë që njoftimi i duhet dërguar personit përkatës ndaj të cilit vendoset gjoja.

iv. Nenet e lidhura

Neni 8/a i Kodit të Procedurës Penale

Neni 43 i Kodit të Procedurës Penale

Neni 87 i Kodit të Procedurës Penale

Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale

Neni 150 i Kodit të Procedurës Penale

Neni 151 i Kodit të Procedurës Penale

Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale

v. Standardet Ndërkombëtare dhe Përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6 pika 1 të saj parashikon se:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Ky parashikim garanton të drejtën për një proces të rregullt, dhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ.

- b. Publikimi i Këshillit të Europës “ Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut mbi standardet e mbledhjes së provave në procedimet penale”, e aksesueshme në linkun e mëposhtëm:

<https://rm.coe.int/council-of-europe-georgia-european-court-of-human-rights-case-study-ev/16807823c3>;

- c. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)”, e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;

4.2.16. Komente mbi Nenin 133

Nenin 133 i Ligjit për Statusin “Dokumentacioni i hetimit”, përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit që kryen veprimin;
- b) datën e kryerjes së veprimit;
- c) subjektin dhe objektin e veprimi^T;
- ç) pjesëmarrësit;
- d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;
- dh) nënshkrimin e inspektorit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë në këto veprime;

3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

- a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent;
- b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;
- c) veprimet e kryera gjatë hetimit;
- ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;
- d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;
- dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;
- e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij neni është përcaktimi i dokumentacionit të nevojshëm që prodhohet nga ILD-ja për një proces hetimor. Procesverbali duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikat “a” – “dh” të pikës 2, duke udhëzuar në mënyrë të qartë inspektorin e dosjes, të llojit të informacionit që duhet të dokumentojë për procesin e nisur. Qëllimi tjetër është të garantojë që veprimet hetimore të jenë të dokumentuara, për të garantuar një proces të rregullt dhe transparent ndaj magjistratit nën hetim. Po kështu shërben për të qartësuar proceset e punës, duke orinetuar edhe elementët formalë që duhet të jenë në procesverbal, i cili ka efekt të dokumentimit të proceseve të punës së kryer nga inspektori i çështjes. Dokumentimi dhe dokumentimi i veprimeve dhe analizave të kryera për

efekt të hartimit të raportit të hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përcjelljen pranë Këshillave përkatës.

Dispozita ka një teknikë të qartë hartimi, e cila mundëson kuptimin e saktë të saj në përcaktimin e llojit të dokumentacionit me të dhënat e nevojshme për t'u plotësuar nga ana e inspektorit përgjegjës në një rast hetimor.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dokumentimi i hetimit është ngushtësisht i lidhur me parimet themelore të administrimit të drejtësisë siç janë: sundimi i ligjit, parimi i një procesi të rregullt ligjor dhe drejtësia procedurale, e cila është një parim ligjor që garanton një veprimtari të ligjshme gjatë një vendimmarrjeje administrative. Ajo i referohet ligjshmërisë së procedurës në cilën është marrë një vendim dhe jo drejtësisë në aspektin substancial të këtij vendimi. Një person mund të kërkojë rishikim të një vendimi administrativ mbi bazën moszbatimit të drejtësisë procedurale. Në vlerësimin e gjykatës nëse është mohuar ky parim, ose jo, do të vlerësohen dy çështje:

- Nëse ka patur një detyrim për të zbatuar drejtësinë procedurale; dhe
- Nëse ekziston një detyrim i tillë, a është zbatuar ajo në rastin konkret. Në përgjithësi, drejtësia procedurale kërkon që vendimet të jenë në përputhje me:
 - Parimin e paanshmërisë nga ana e vendimmarrësit;
 - Parimin e racionaliteti ose bazueshmërisë në prova, duke dhënë mundësinë e vërtetimit së fakteve;
 - Parimin e degjesës- duke i mundësuar personave të prekur mundësinë për:
 - Për të qenë të pranishëm në çështje;
 - Për të parashtruar pretendimet e tyre, të cilat do të merren në konsideratë para marrjes së vendimit.

Dispozita, e ndërtuar në tre paragrafë, të cilët trajtojnë aspekte të formës, ka një stil gjuhësor të thjeshtë duke vendosur detyrimin për të dokumentuar çdo veprim hetimor dhe përcaktimin e elementëve përmbajtësorë të dokumentimit. Dispozita përcakton detyrimin për dokumentimin nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por ajo shtrihet në mënyrë ndaj figurës procedurale të inspektorit përgjegjës, por edhe në mënyrë të nënkuptuar ndaj magjistratit, i cili mund të njihet me procesverbalin, nëse kërkon një gjë të tillë, në pajtim me parashikimet e nenit 129 të ligjit për statusin. Me të njëjtin informacion të dokumentuar me procesverbal mund të njihet edhe Këshilli përkatës ose magjistrati në hetim. Dispozita aplikohet për të gjitha dosjet hetimore pa përjashtim dhe garanton njëtrajtshmëri të elementëve formalë të dokumentacionit.

Këshilli përkatës ose magjistrati nën hetim mund të paraqitet me të njëtin informacion të dokumentuar në procesverbal. Kjo dispozitë është e zbatueshme për të gjithë dokumentacionin e hetimit pa përjashtim dhe garanton uniformitetin e elementeve formale të dosjes.

iii. Komentari i dispozitës

Kjo dispozitë kërkon që çdo pretendim i hetuar të dokumentohet me veprime konkrete dhe ILD të marrë në konsideratë të gjitha faktet që i atribuohen magjistratit për shkeljen e pretenduar.

Të gjitha faktet e dokumentuara bëhen pjesë e dosjes hetimore me qëllim garantimin e njëtrajtshmërisë së informacionit, strukturës së tij por edhe të aspektit përmbajtësor të procesverbalit. Rëndësia e dokumentimit të të veprimeve hetimore, është garanci e dyanshme si ndaj rregullshmërisë së veprimeve hetimore të dosjes të përgatitur nga ILD-ja, po ashtu edhe ndaj magjistratit, i cili mund të ketë pretendime në lidhje me veprimet e kryera. Është e rëndësishme që inspektori përgjegjës të hartojë procesverbal, për çdo veprim hetimor që ndërmerret, duke përpiluar dhe procesverbalin përkatës.

Dispozita trajton edhe aspekte procedurale kur hetimi ka ardhur në fund të tij dhe ILD-ja del me një akt procedural si raporti i hetimit, i cili dokumenton përmbylljen e fazës së verifikimi dhe përgatitjes së një faze tjetër, atë të procedimit. Dispozita krahas elementeve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni lë të hapur edhe mundësinë e përfshirjes së një hapësire vlerësuese të ndonjë informacioni tjetër që mund të përfshihet në raportin e hetimit. Përdorimi i termit “të paktën”, lejon që të përfshihen edhe të dhëna të tjera, të cilat duhet të jenë të analizuar dhe të mbështetura në dokumente dhe të përmendura në raport. Ndaj një rasti të tillë duhet treguar kujdes nga ana e inspektorit përgjegjës pasi sipas parashikimeve të bëra në nenin 139, shkronja c e ligjit për Statusin mund të përbëjë shkak për mbylljen e procedimit disiplinor, pa seancë dëgjimore nga e Këshillit përkatës nëse raporti i hetimit nuk është i arsyetuar sipas përcaktimeve të këtij neni.

Dokumentacioni i përcaktuar nga ky nen nuk mund të shihet si shterues, por duhet parë si një listë verifikuese e elementeve formalë të çdo veprimi hetimor nga ana e inspektorit përgjegjës, i cili duhet të sigurohet se çdo veprim hetimor, është i hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit.

Rëndësia e paraqitjes në formë të shkruar, përmes procesverbalit, sa herë që kryhet një veprim hetimor.

Veprimet që do të duhet të ndërmerren nga inspektori janë dinamike,

në varësi të rrethanave që kanë diktuar nisjen e hetimit, por nisur nga parashikimet e nenit 133, aktet procedurale janë procesverbali dhe raporti i hetimit.

iv. Nenet e lidhura;

Neni 129 i Ligjit për Statusin

Neni 130 i Ligjit për Statusin

Neni 131 i Ligjit për Statusin.

Neni 139 i Ligjit për Statusin

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6 pika 1 të saj parashikon se:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Ky parashikim garanton të drejtën për një proces të rregullt, dhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ.

b. Mbrojtja e së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut- Një udhëzues për praktikuesit e së drejtës, Këshilli i Europës.

c. Publikimi i Këshillit të Europës “Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut mbi standardet e mbledhjes së provave në procedimet penale”, e aksesueshme në linkun e mëposhtëm: <https://rm.coe.int/council-of-europe-georgia-european-court-of-human-rights-case-study-ev/16807823c3>;

d. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)”, e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;

4.2.17. Komente mbi Nenin 134

Neni 134 i Ligjit për Statusin “Mbyllja e hetimit”, përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

- a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
- b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;
- c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;
- ç) magjistrati i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;
- d) magjistrati ka vdekur.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet t'i njoftojë vendimin magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij ankuesit dhe Këshillit përkatës. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi tregon të drejtën e ankuesit për të ankimuar këtë vendim në Këshillin përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimohet këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

3. Në rastet kur magjistrati ka dalë në pension, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe iu bëhet me dije palëve dhe Këshillit përkatës.

4. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, duhet t'i paraqiten Këshillit për shqyrtim të mëtejshëm.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i dispozitës është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të qarta për mbylljen e hetimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e strukturuar në katër paragrafë që rregullojnë aspekte të ndryshme të vendimit për mbylljen e hetimeve dhe pasojat e mbylljes së hetimit. Duhet shprehur që legjislacioni i ri përmban një listë kërkesash ligjore që duhet të merren parasysh në rastet kur ILD-ja vendos të mbyllë hetimin.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

Në lidhje me paragrafin 1: Në pajtim me Nenin 134, paragrafi 1, ka dy shkaqe ligjore për mbylljen e hetimit: i pari është i zbatueshëm nëse pretendimi është i papabazuar në provat e mbledhura gjatë hetimit; i dyti është i zbatueshëm nëse provat e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm

i hetimit çon tek një nga konkluzionet e renditura nga germa 'a' deri tek germa 'd' e paragrafit 1.

Paragrafi i dytë rregullon aspektet procedurale të mbylljes së hetimit disiplinor, i cili përfshin njoftimin, vendimin e arsyetuar të përgatitur nga ILD dhe të drejtën për apelimin e vendimit. Në fakt, këto janë ekzaktësisht arsyet ligjore për mbylljen e hetimit. Disa prej tyre lidhen me subjektin e hetimit dhe disa me objektin.

Me qëllim që të arrihet në konkluzionin se provat janë të pamjaftueshme, inspektori i ngarkuar do të paraqesë shpjegime të plota se të gjitha provat e mundshme janë mbledhur dhe analizuar drejt. Pas kësaj, duhet të jetë e qartë se cili prej elementeve të shkeljes nuk është provuar dhe gjithashtu analiza e të gjithë elementeve që ka mbështetur përfundimin e pashmangshëm se shkelja nuk ka ndodhur.

Në lidhje me paragrafin 3: Ligji parashikon dy akte të ndryshme që duhet të nxirren për mbylljen e hetimit - vendimi ose raporti përfundimtar. Raporti përfundimtar sipas nenit 134, paragrafi 3, nxirret vetëm në rast se magjistrati ka dalë në pension. Vendimi dhe raporti përfundimtar janë shumë të ngjashëm pasi ato duhet të përmbajnë të njëjtat fakte përkatëse që çojnë në konkluzionin që hetimi do të mbyllet. Pasojat e të dy akteve janë të njëjtat - mbyllja e hetimit. Ekzistojnë disa dallime ndërmjet tyre, si njoftimi për Këshillin në rastin e nxjerrjes së një raporti përfundimtar; mosparashikimi i ankimit kundër Raportit Përfundimtar sipas Nenit 134 etj.

Në lidhje me marrëdhënien ndërmjet Vendimit për mbylljen e hetimit dhe raportit të hetimit: Një referencë tek raporti i hetimit është e nevojshme pasi ky raport përmban të gjithë informacionin sipas parashikimit në Nenin 133 të Ligjit të Statusit në lidhje me konstatimet e plota të hetimit disiplinor. Megjithatë, Vendimi për mbylljen e hetimit u paraqitet palëve dhe mund të ankimohet para Këshillit përkatës. Për palët (ankuesin dhe magjistratin nën hetim), Vendimi për mbylljen e hetimit është dokumenti përkatës që mund të motivojë atë për të paraqitur një ankim ndaj vendimit të ILD-së. Për këtë, konstatimet kryesore të përfshira në raportin e hetimit, që çojnë në përfundimin se hetimi do të mbyllet, duhet të përsëriten në këtë vendim.

Në lidhje me ankimin ndaj vendimit për mbylljen e hetimit (paragrafi 2): Vendimi për mbylljen e hetimit mund të ankimohet nga ankuesi para Këshillit përkatës. Ligji nuk parashikon ndonjë akt formal për Këshillin në këtë aspekt. Megjithatë, rregulli i përgjithshëm është që Këshilli duhet të japë vendim. Në rast ankimi, Këshilli mund të veprojë në këto

mënyra: të konfirmojë vendimin për mbylljen e hetimit dhe të mos pranojë kërkesën, të rrëzojë vendimin për mbylljen e hetimit dhe të urdhërojë ILD-në (Kryeinspektorin) të kryejë hetime të mëtejshme. Çështja tjetër është si do të procedojë ILD-ja (Kryeinspektori) në rast se Këshilli do të vendosë rrezimin e vendimit për mbylljen e hetimit dhe hetim të mëtejshëm. Është e arsyeshme për ILD-në që të japë vendim për hetime të mëtejshme. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet që në pajtim me nenin 147, paragrafi 2, i Ligjit për Statusin, ILD-ja ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit në çështjet disiplinore tek gjykata kompetente.

Në lidhje me disa dispozita të tjera që kërkojnë nxjerrjen e një vendimi për hetime të mëtejshme: Janë edhe disa dispozita të tjera ligjore që janë identifikuar gjatë analizës së paragrafit 2 të Nenit 134, që i referohen gjithashtu ‘hetimit të mëtejshëm’ dhe vendimit përkatës të ILD-së.

I pari prej tyre ka të bëjë me interpretimin e nenit 126, para. 2, i Ligjit të Statusit. Pasi organi kompetent të nxjerrë vendimin përfundimtar sipas parashikimit të Nenit 126, par 2, ILD-ja vendos për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit të pezulluar. Ligji nuk parashikon ndonjë akt formal në këtë çështje, megjithatë, është e nevojshme që ILD-ja të nxjerrë një vendim për hetimin e mëtejshëm për të vërtetuar datën e ‘rifillimit’ të veprimeve hetimore. Opsioni tjetër është i parashikuar nga Neni 138, par. 5 – në rast se Këshilli vendos t’i rikthejë çështjen hetimore ILD-së para caktimit të një seance dhe t’i kërkojë ILD-së “kryerjen e hetimeve të mëtejshme”.

iv. Nenet e Lidhura

Neni 64, paragrafi 1 i ligjit për Statusin

Neni 67 i ligjit për Statusin

Neni 100 i ligjit për Statusin

Neni 117 i ligjit për Statusin

Neni 126 paragrafi 2 i ligjit për Statusin

Neni 133 i ligjit për Statusin

Neni 134, paragrafi 1 i i ligjit për Statusin

Neni 138 paragrafi 5 i ligjit për Statusin

Neni 147 i ligjit për Statusin

Neni 66 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

v. Standarded ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Udhëzimi mbi Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, *“E drejta për një proces të rregullt ligjor (dhoma civile)”*, e përditësuar më 30 Prill 2020, Këshilli i Europës;

- b. Një trupë e posaçme duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur (§77-ii-iii, Opinioni n° 3-(2002) i KKGJE dhe Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekznizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogërat dhe Krimin – 2011).
- c. Duhet të ketë instrumenta kundër vendimeve disiplinore. Shqyrtimi në apel duhet të kryhet përpara një gjykate më të lartë (Neni 6.3 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Parimi VI-3 i Rekomandimit n°R (94) 12 të Komitetit të Minsitrave të Këshillit të Europës dhe paragrafi 64 i Opinioni n° 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë dhe §72, Opinioni n° 3 (2002) KKGJE dhe Parimi Themelor nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, i miratuar gjate mbledhjes plenare të njëmbëdhjetë të KKGJE, në Strasburg 17-19 Nëntor 2010.
- d. Procedimet disiplinore duhet të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse (shikoni § 69, Opinioni n° 1 (2001)-KKGJE dhe Parimi VI-1 i Rekomandimit n° R (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe § 66 të Rekomandimit CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe Parimi Themlor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve.

4.2.18. Komente mbi Nenin 135

Neni 135 i Ligjit për Statusin “Marrëveshje e përbashkët e pranimit”, përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.
2. Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si dhe masën disiplinore të përshtatshme.
3. Palët hartojnë me shkrim dhe nënshkruajnë marrëveshjen, e cila dorëzohet në Këshillin përkatës.

4. Marrëveshja duhet të përmbajë:

- a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati;
- b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakord;
- c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli.

5. Këshilli përkatës pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:

- a) marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;
- b) nëse rezulton se magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, si dhe nëse ai ka dhënë pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij të lirë;
- c) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, të jenë në përputhje me këtë ligj.

6. Këshilli përkatës refuzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:

- a) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;
- b) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij;
- c) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarinimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore;
- ç) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me këtë ligj;
- d) magjistrati është detyruar të pranojë marrëveshjen;
- dh) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen.

7. Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, ajo do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor, e cila nuk ankimohet.

8. Nëse Këshilli refuzon marrëveshjen, atëherë çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me shkeljen disiplinore, në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve.

9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshje.

10. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikën 9, të këtij neni, magjistrati ka të drejtë të ankimojë mos-veprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i dispozitës është krijimi i një instituti të ri ligjor - Marrëveshja e Përbashkët e Pranimit (MPP) dhe parashikimi i rregullave procedurale gjatë zbatimit të këtij instituti. Dispozita e Nenit 135 synon të thjeshtëzojë procesin e hetimit disiplinor dhe të procedimit disiplinor duke shmangur procedimet përpara Këshillit dhe ankimet ndaj vendimeve disiplinore përpara Gjykatës. Krijimi i një instituti të ri ligjor do të kishte efekt pozitiv në përshpejtimin e procedurave disiplinore, do të reduktonte numrin e seancave dëgjimore të procedimeve disiplinore përpara Këshillave, etj. Ky institut i ri ligjor është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita është e re për sistemin e gjyqësorit në Shqipëri, dhe instituti i ri ligjor i parashikuar për hetimet dhe procedimet disiplinore është i ngjashëm me parashikimet e miratuara kohët e fundit në Kodin e Procedurës Penale, të cilat kanë lidhje me “Gjykimin me Marrëveshje”. Ashtu si edhe në qasjen e përdorur për hetimin penal dhe procedurat penale, ligjvënësi prezantoi dhe miratoi Nenin 135 “Marrëveshja e përbashkët e pranimit”, Ligji për Statusin. Dispozita është e strukturuar në tre grupe të veçantë paragrafësh. I pari lidhet me përmbajtjen e marrëveshjes dhe rregullave procedurale që zbatohen nga ILD. Grupi i dytë i paragrafëve lidhet me Këshillat dhe kompetencat e tyre në rastin kur marrëveshja miratohet. I treti lidhet me Këshillat në rastin kur MPP-ja refuzohet.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

Në lidhje me fushën e veprimit të marrëveshjes dhe procedurën për të arritur një marrëveshje

Pyetja e parë e cila ngrihet në lidhje me interpretimin e Nenit 135 është se kur mund të arrihet një marrëveshje midis ILD dhe magjistratit. Paragrafi 1 parashikon se ILD dhe magjistrati mund të bien dakord për një MPP “në çdo moment” pa shpjeguar nëse kjo mund të ndodhë gjatë hetimit, ose gjatë procedimit disiplinor të filluar. Megjithatë, interpretimi i saktë mund të bëhet i mundur me anë të interpretimit të paragrafit 9, në të cilin parashikohet se: “Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj Marrëveshje”.

Ligji parashikon dy variante në rast se MPP-ja kundërshtohet nga Këshilli:

Varianti i parë lejon ILD të vazhdojë me hetimin disiplinor, i cili është i zbatueshëm nëse MPP-ja firmoset gjatë hetimit të filluar.

Varianti i dytë është për nisjen e një hetimi, i cili është i zbatueshëm në rast se MPP-ja firmoset pasi është përfunduar hetimi disiplinor.

Dosja e çështjes së hetimit disiplinor duhet të dorëzohet së bashku me MPP-në në rast se hetimi ka filluar, ose në rast se hetimi ka përfunduar por dosja e çështjes nuk i është dorëzuar ende Këshillit. Nëse MPP nënshkruhet gjatë procedimit të filluar disiplinor, dosja e çështjes tashmë është në Këshill dhe Kryeinspektori do të dorëzojë vetëm marrëveshjen.

Marrëveshja duhet të përmbajë të gjithë informacionin e duhur në lidhje me vendimin për fillimin e hetimit disiplinor. Në rast se pas çeljes së hetimit ka vendime të tjera (për shembull vendimi për shtimin e objektit të hetimit), ato gjithashtu duhet të përfshihen në MPP.

ILD-ja (Kryeinspektori) dhe gjyqtari duhet të bien dakord se të dhënat e mbledhura çojnë në përfundimin se magjistrati ka kryer një shkelje konkrete dhe magjistrati duhet ta pranojë këtë shkelje.

Marrëveshja për masën disiplinore kërkon që masa të respektojë Ligjin për Statusin dhe të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Nëse këto kërkesa nuk përmbushen nga palët, Këshilli mund ta kundërshtojë MPP-në.

Gjyqtari duhet të deklarojë se ai/ajo e kupton MPP-në dhe përmbajtjen e saj, jep pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij/saj të lirë dhe ai/ajo është i/e informuar se MPP-ja është objekt për miratim nga Këshilli. Ligji parashikon një deklaratë nga magjistrati për faktin se ai ka informacion se MPP-ja është subjekt vetëm i miratimit të Këshillit. Megjithatë, qasja e zakonshme e zbatueshme për marrëveshjet është që palët nënshkruajnë marrëveshjen pas konfirmimit me shkrim se ato e kuptojnë përmbajtjen e saj dhe japin pëlqimin e tyre me shkrim me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Duke pasur parasysh se njëri nga parakushtet që marrëveshja të kundërshtohet nga Këshilli, sipas parashikimit të paragrafit 6, shkronja d) është: “magjistrati është detyruar të pranojë Marrëveshjen”, rekomandohet që deklarata ku magjistrati shpreh pranimin me vullnetin e tij të lirë të përfshihet në MPP.

Mbi kompetencat e Këshillit në lidhje me marrëveshjen e përbashkët të pranimit

Këshilli mund ta pranojë ose kundërshtojë marrëveshjen. Në të dyja rastet, Këshilli duhet të lëshojë një vendim të arsyetuar, i cili nuk është i ankimeshëm.

Vendimi i arsyetuar për pranimin e marrëveshjes duhet të përmbajë një shpjegim të qartë në lidhje me kërkesat e parashikuara në paragrafin 5. Arsyetimi thelbësor duhet të parashikohet në përputhje me shkronjën c) të paragrafit 5, ku pohohet se: “Masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati kanë rënë dakord, janë në përputhje me këtë ligj.” Pyetja kryesore është se si do të vlerësojë Këshilli nëse masat disiplinore, për të cilat ILD dhe magjistrati kanë rënë dakord, janë në përputhje me Ligjin për Statusin. Parakushti i parë është që masat respektive të parashikohen nga Ligji (Neni 105). Parakushti i dytë është që masat respektive të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat lidhen me zbatimin e çdo sanksioni disiplinor (Neni 106 – Neni 111, Ligji për Statusin). Parakushti i tretë është shkëlja respektive për tu dënuar nga sanksioni disiplinor më i përshtatshëm, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, sipas parashikimit të Nenit 115, Ligji për Statusin. Kështu, do të zbatohet parimi i proporcionalitetit midis shkeljes së kryer dhe sanksionit për të cilin është rënë dakord.

Në lidhje me masat plotësuese, duhet theksuar se Vendimi nr. 34 datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese mbi Ligjin për Statusin, ka shfuqizuar paragrafin 1 të Nenit 112 “Masat Disiplinore Plotësuese”, e cila duhet marrë në konsideratë në rastin e MPP.

Gjithashtu, në vijim të kërkesave të parashikuara nga paragrafi 5 i këtij neni, Këshilli do të përfshijë në arsyetimin e Vendimit për pranimin e Marrëveshjes argumentet e mëposhtëm, të cilët lidhen me kërkesat e parashikuara në paragrafin 6: magjistrati i thirrur rregullisht ka ndjekur seancën dëgjimore ose nuk ka ndjekur seancën dëgjimore, por e justifikoi mungesën e tij/saj (1); magjistrati ka nënshkruar marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë, ç’ka konfirmohet me shkrim dhe konfirmohet gjithashtu edhe gjatë seancës dëgjimore (2); magjistrati nuk e tërhoqi pranimin për Marrëveshjen (3). Qëllimi i kësaj qasje është që të sqarohet se gjatë arsyetimit të vendimit, Këshilli ka kontrolluar të gjitha kërkesat përkatëse përpara se të vendosë ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen.

Në lidhje me vendimin për refuzimin e marrëveshjes, paragrafi 6 përmban një listë shteruese me parakushtet për refuzimin e saj. Secili prej tyre duhet të përbëjë një shkak të veçantë për kundërshtim. Sipas Paragrafit 6, shkronja dh), magjistrati mund ta tërheqë pranimin për Marrëveshjen dhe kjo është një arsye e mjaftueshme për Këshillin që të kundërshtojë Marrëveshjen. Ligji nuk e specifikon se kur mund ta zbatojë këtë të drejtë magjistrati, çka do të thotë se duhet të interpretohet sa më gjerë të jetë e mundur - nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes deri në datën kur Këshilli nxjerr Vendimin e tij.

Kërkesa tjetër për refuzimin e Marrëveshjes, e cila meriton një vëmendje dhe interpretim të veçantë është paragrafi 6, shkronja d), në të cilën parashikohet se: “magjistrati është detyruar ta pranojë Marrëveshjen”. Shqetësimi kryesor nga pikëpamja praktike mund të ishte se si mund të ndodhë një situatë e tillë hipotetike, nëse Marrëveshja është nënshkruar nga magjistrati dhe përmban një deklaratë sipas shpjegimit të mësipërm. Megjithatë, ligjvënësi e ka përfshirë këtë parashikim të rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat e magjistratit në përputhje me parimin për një gjykim të drejtë. Këshilli më pas vendos sipas rastit.

Në lidhje me pasojat e vendimit të Këshillit

Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, vendimi i tij është i formës së prerë dhe data e lëshimit do të konsiderohet si data e mbylljes së procedimit disiplinor. Nga kjo datë, hyn në fuqi afati kohor në lidhje me detyrimin e Këshillit për ekzekutimin e vendimit (Shiko Nenin 148, Ligji për Statusin).

Nëse Këshilli refuzon Marrëveshjen, ka një sërë pasojash të parashkruara nga Ligji, si më poshtë vijon: “çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me shkeljen disiplinore, në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve”.

Ky parashikim ka nevojë për një shpjegim: është e qartë se legjislatori synon të shmangë çdo pasojë negative për të dyja palët nëse marrëveshja nuk pranohet. Çdo deklaratë brenda Marrëveshjes dhe përpara Këshillit në lidhje me Marrëveshjen nuk mund të përdoret në favor ose kundër palëve. Qëllimi i kësaj dispozite është që pas refuzimit të Marrëveshjes, hetimi disiplinor të vazhdojë sikur kjo marrëveshje të mos jetë nënshkruar dhe të mos i jetë dorëzuar Këshillit. Afati për hetimin pas refuzimit është një muaj pas datës së refuzimit të Marrëveshjes.

iv. Nenet e lidhura

Neni 105 i Ligjit për Statusin

Neni 106 i Ligjit për Statusin

Neni 111 i Ligjit për Statusin

Neni 115 i Ligjit për Statusin

Neni 148 i Ligjit për Statusin

Neni 406/d deri 406/f i Kodit të Procedurës Penale

Nenet 12 deri 23 të Ligjit Nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

v. Standarded ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve, Strasburg 29/04/1957, Këshilli i Europës;
- b. Udhëzuesi European për Ligjëbërjen e Ndërmjetësimit, Komisioni European për Efiçencën e Drejtësisë, miratuar në mbledhjen plenare të tij, më 13 dhe 14 Qershor 2019, e aksesueshme në linkun: <https://rm.coe.int/cepej-2019-9-en-handbook/1680951928>.

4.2.19. Komente mbi Nenin 136

Nenin 136 i Ligjit për Statusin “Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcakton:

1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

- a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;
- b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i këtij parashikimi është të përcaktojë veprimet që duhet të ndërmerren ILD-ja, nëse gjatë procedimit disiplinor ka arsye të dyshojë se magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore tjetër. Ky nen përcakton rregullime për mënyrën e ndërmarrjes së veprimeve nga ana e ILD-së për një rast të tillë dhe veprimet procedurale që duhet të realizojë.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Ky nen është i zbatueshëm për magjistratët ndaj të cilëve ILD ka kryer një procedurë hetimore dhe ka dërguar raportin hetimor të Këshilli përkatës. Pas dorëzimit të raportit, rezultojnë të dhëna të tjera se është kryer edhe një shkelje tjetër.

iii. Komente mbi aspekte të ndryshme të dispozitës

Nga pikëpamja strukturore dispozita është hartuar me dy paragrafë, të cilët kanë një teknikë të thjeshtë shkrimi, duke vendosur veprimet që do të ndërmerren ILD-ja, në bashkërendim me Këshillin përkatës. Paragrafi

i parë i këtij neni parashikon dy mënyra aplikimi për ILD-në, në rastin e parë ILD-ja mund të kërkojë ndërprejen e procedimit disiplinor, dhe të realizojë hetimin të mëtejshëm, duke paraqitur rezultatet e hetimit në raportin e hetimit të mëtejshëm nga ku mund të marrë vendim për të shtuar apo ndryshuar objektin e hetimit.

Në rastin tjetër, ILD-ja mund që t'i kërkojë Këshillit përkatës të shtojë ose të ndryshojë objektin e hetimit nëse vlerëson nuk ka nevojë të kryejë veprime hetimore të mëtejshme.

Kur Këshilli çmon se çështja ka nevojë për zhvillimin e veprimeve të mëtejshme hetimore i dërgon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çështjen dhe i kërkon të kryejë veprime të mëtejshme apo të hetojë pretendimet e tjera për magjistratin nën hetim, sipas nenit 144 të ligjit për statusin.

ILD-ja me krjimin e një dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e një shkelje tjetër mund të kërkojë me shkresë/ose seancë ndërprerjen e procedimit, duke parashtruar arsytet që përlligjin këtë kërkesë.

Kërkesa duhet të jetë e mbështetur nën garancinë e kryerjes së hetimeve të mëtejshme, të cilat duhet të dokumentohen sipas parashikimeve të nenit 133 dhe nenit 134. Kjo dispozitë rregullon gjithashtu periudhën prej një muaji për masën e mëtejshme të hetimit që duhet të merret nga ILD-ja në rast se Këshilli përkatës vendos për miratimin e kërkesës së tij për përfundimin e procedimit disiplinor në përputhje me paragrafin 1, shkronja a.

Gjithashtu ILD-ja, në varësi të çështjes dhe kur vlerëson se nuk është nevoja e kryerjes së hetimit të mëtejshëm mund t'i kërkojë Këshillit shtimin ose ndryshim e objektit

Shkronja 'a' e paragrafit 1, përcakton se Këshilli mund të dërgojë çështjen tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kur çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, andaj ILD-ja duhet të kryejë veprimet e nevojshme disiplinore, për qëllime të ndryshimit apo shtimit të objektit të procedimit disiplinor.

Sa i përket veprimeve që duhet të realizohen nga inspektori përgjegjës, ato duhet të jenë në varësi të rrethanave të rastit, ku për ndryshimin apo shtimin e objektit evidentohen faktet e renditura dhe të analizuar, duke marrë kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e objektit të ndryshuar apo të shtuar të hetimit.

ILD-ja i rinjofton magjistratit të gjitha të drejtat që ai/ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të Ligjit për Statusin, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse për

objektin e shtuar të hetimit disiplinor, brenda një afati të arsyeshëm nga njoftimi për marrjen e vendimit nga Këshilli. Afati i arsyeshëm duhet të jetë i tillë që të lejojë zhvillimin e hetimit për ndryshimin apo shtimin e objektit brenda afatit një mujor nga momenti i miratimit të kërkesës për ndërprerjen e procedimit disiplinor.

Në drejtim të akteve procedurale, inspektori përgjegjës, harton raportin emëtejshtëm të hetimit të arsyetuar dhe përgatit projektvendimin e ndryshimit/shtimit të objektit të hetimit disiplinor dhe e përcjell pranë ILD-së. Me miratimin e vendimit nga ILD-ja, përgatitet shkresa për njoftimin e palëve (ankuesin dhe magjistratin) në procedurën hetimore duke i njoftuar edhe të drejtën për dorëzimin e parashtresave dhe dokumenteve mbështetëse për objektin e ndryshuar/shtuar të hetimit, sipas një afati arsyeshëm.

v. Nenet e lidhura

Neni 129, të ligjit për statusin

Neni 133, të ligjit për statusin

Neni 134, të ligjit për statusin

Neni 144 të ligjit për statusin.

v. Standartet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudeca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- b. Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit, të miratuara nga OKB ne vitin 1985;
- c. Rekomandimi (94) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”.
- d. Raporti i ENCJ “Standardet Minimale Gjyqësore V, Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve”, miratuar në Hagë në 5 Qershor 2015.
- e. Paragrafi §60 i Opinionit nr. 3-(2002) KKGJE këshillon se nuk është korrekte të ndërthuren mosrespektimi i standardeve profesionale me shkeljen që mund të sjelli potencialisht masa disiplinore. Këto duhet të jenë shkelje tepër serioze dhe të jo të dështohet për të vëzhguar standardet të cilat përbëjnë praktikën më të mira (referuar Opinionit të Përbashkët Nr. 588/2010 të Komisionit të Venecias për Ukrainën dhe Parimi Themelor nr. 18 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, e miratuar gjatë mbledhjes plenare të KKGJE, në Strasburg më 17-19 Nëntor 2010 dhe § 72 i Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave

dhe § 57/58 otë Opinionit nr 10 (2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë.

- f. Një trupë e posaçme duhet të ketë përgjegjësinë për të pranuar ankesa, të ketë përfaqësimin e gjyqtarit dhe të vlerësojë nëse është apo jo një rast i mjaftueshëm kundër një gjyqtari për të nisur një procedim disiplinor që do të vendoset nga një autoritet ose gjykatë e pavarur (§77-ii-iii, Opinioni n° 3-(2002) i KKGJE dhe Parimi Nr. 6 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve, Nëntor 2010 dhe Rezoluta Nr. 2 e Budapestit mbi vetqeverisjen e gjyqësorit: Balancimi midis Pavarësisë dhe Llogaridhënies (KKGJE – Maj 2008 dhe Rekomandimi Nr. 4.9 i Udhëzimit mbi Fuqizimin e Integritetit dhe Aftësive të Gjyqësorit (Kodi i Sjelljes dhe Mekznizmat Disiplinorë)- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogërat dhe Krimin 2011).
- g. Rekomandimi i CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Minsitrave të Shteteve Anëtare “Mbi Pavarësinë, Eficencën dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve” Kapitulli VI- Stuatasi i Gjyqtarëve – (§ 69) – “Kapitulli VII- Detyra dhe Përgjegjësitë” ‘69. Procedimet disiplinore mund të fillojnë kur gjyqtari dështon të përmbushë detyrimet e tij në mënyrën e duhur dhe eficente. Këto procedime duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose nga një panel, me të gjitha garancitë e një procesi të drejtë dhe t’i mundësohet gjyqtarit e drejta për të vendimin dhe masën disiplinore. Masa disiplinore duhet të jetë propocionale.’
- h. Procedimet disiplinore duhe të kryhen në përputhje me parimet kushtetuese të pavarësisë së veprimtarisë së gjyqësorit, sipas të cilit procedimet disiplinore nuk mund të kenë ndonjë vlerësim mbi aktet gjyqësore të gjyqtarit, i cili mund të kritikohet vetëm nëpërmjet ushtrimit të së drejtës ë apelit, e drejtë që ligji ia njeh palëve ndërgjyqëse (shikoni § 69, Opinioni n° 1 (2001)-KKGJE dhe Parimi VI-1 i Rekomandimit n° R (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës dhe § 66 të Rekomandimit CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministrave dhe Parimi Themlor nr.4 i Kartës së Madhe të Gjyqtarëve.
- i. *‘Në rast të një shkeljeje disiplinore, duhen marrë të gjitha masat e nevojshme, të cilat nuk paragjykojnë pavarësinë gjyqësore’.* - § 1, parimi VI i Rekomandimit nr. (94)12 për Pavarësinë, Efiçencën dhe Rolin e Gjyqtarëve, të Komitetit të Ministrave më 13 Tetor 1994 në takimin e 518-të.

4.2.20. Komete mbi Nenin 137

Nenin 137 i Ligjit për Statusin “Sistemi i menaxhimit të çështjeve”, përcakton:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon dhe administron një sistem të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore.

2. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) gjenealitetet dhe adresën e magjistratit nën hetim;
- b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur;
- c) objektin e hetimit;
- ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit;
- d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor;
- dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore;
- e) informacione të tjera, sipas rastit.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton dispozita të hollësishme për:

- a) formatin dhe të dhënat që administrohen në regjistër;
- b) informacionin shtesë që përfshihet në sistem;
- c) mënyrën e mbajtjes së sistemit;
- ç) informacionin e sistemit që është i hapur për publikun, si dhe informacion që është i aksesueshëm vetëm nga magjistrati nën hetim.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbledh dhe përpunon të dhënat në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

i. Qëllimi i dispozitës

Qëllimi i kësaj dispozite është i dyfishtë, pasi qëllimi parësor i saj është të përcaktojë krijimin dhe administrimin e një sistemi të elektronik të menaxhimit të çështjeve i cili ka për bazë hedhjen e të dhënave, përpunimin dhe gjurmimin në kohë reale të të dhënave. Dispozita ka për qëllim edhe përcaktimin e kushteve minimale që duhet të përmbajë sistemi elektronik, por nuk ka për qëllim të kufizojë kriteret apo kategori të tjera informacioni për nevoja të mbarëvajtjes së punës.

Krahas kushteve për krijimin e sistemit, dispozita ka si qëllim tjetër edhe përcaktimin e rregullave për administrimin e këtij sistemit, që nënkupton përcaktimin e roleve të përdoruesve të sistemit, ndërveprimin me baza të tjera të dhënash, rregullat për hedhjen e informacionit, parametrat e sigurisë teknike të informacionit, gjenerimi e informacioneve të ndryshme dhe statistikave, rregulla të për përdorimit qarkullimit të informacionit në sistem. Të gjithë këto rregulla do të miratohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

ii. Fushëveprimi i dispozitës

Dispozita për nga formulimi i saj, ka në përmbajtje 4 paragrafë me një teknikë të thjeshtë hartimi, që përcakton kushtin e krijimit të një baze të dhënash, kriteret për llojin e informacionit, rregullat për administrimin e

saj dhe për përmbajtjen e kësaj baze të dhënash.

Gjithashtu kjo dispozitë në mënyrë të nënkuptuar parashikon se baza e të dhënave duhet të jetë e mirëstrukturuar dhe e organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të dhënat të hidhen sipas hapave proceduralë që parashikon ligji nga momenti i marrjes së ankesës deri në fund të procedimit disiplinor. Të dhënat që mbahen në sistem do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në punën e përditshme të inspektorëve, në raportimin që i bëhet ILD-së, në llogaridhënien e Institucionit kundrejt organeve të tjera, por edhe rritjen e përgjegjshmërisë personale të inspektorëve dhe stafit mbështetës të ILD-së.

Kjo dispozitë shtrin efektet e zbatimit për të gjithë personelin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që do të pajiset me të drejtë aksesit dhe përpunimit të informacionit në sistem.

iii. Komentari i dispozitës

Sa i përket parashikimeve të nenit 137 të ligjit për Statusin e Magjistratëve, nisur nga terminologjia e përdorur për termin “sistem i menaxhimit të çështjeve”, nënkupton një bazë të dhënash elektronike, e cila në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 3 të ligjit nr. 10325/2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, është grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues. Edhe pse dispozita nuk ka në mënyrë të shprehur se sistemi i përcaktuar në këtë nen i referohet, një baze të dhënash, kuptimi i saj qartësohet, nisur nga parashikimet e bëra edhe përmes ligjit nr. 115/2016, ku konkretisht neni 216, ligjvënësi ka përcaktuar se sistemi është elektronik dhe ka përcaktuar rregulla të rëndësishme për zhvillimin e tij.

Neni 216 synon të vendosë zhvillimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit, duhet të sigurojë që sistemit të mundësojë të paktën:

- rregullave për krijimin, funksionimin, ndërveprimin dhe sigurinë e sistemit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi;
- rregulla për mirëmbajtjen;
- rregulla për përmirësimin periodik të sistemit, në respektim të ndryshimeve të legjisllacionit procedural;
- gjenerimin e informacioneve statistikore.

Ndërsa neni 92 i Ligjit për Organet e Qeverisjes, parashikon se Këshilli i Ministrave përcakton politikat e përgjithshme për sistemin e teknologjisë së informacionit për organet e sistemit të drejtësisë, ku ndër të tjera duhet të jenë të përcaktuara masat mbrojtëse, të cilat sigurojnë vetëm akses të organeve të sistemit të drejtësisë, përveç rasteve kur të dhënat janë me natyrë statistikore ose kur parashikohet ndryshe në ligj; dhe sigurimin e aksesit të plotë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmbajnë të gjithë sistemet e teknologjisë së informacionit që kanë lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe zyrat e prokurorisë.

Nisur nga këto parashikime, konstatohet vullneti i legjislatorit, për të garantuar pavarësinë e zhvillimit të teknologjisë së organve qeverisëse të sistemit të drejtësisë, por në të njëjtën kohë, duke vendosur rregulla detyruese për këto organe që sistemet e tyre të jenë, konform funksioneve të tyre kushtetuese e ligjore nga njëra anë dhe nga an tjetër, sistemet të ruajnë pavarësinë funksionale dhe kushtetuese të secilit institucion, nën koordinimin e politikave të përgjithshme por edhe përmes krijimit të një qendre koordinuese për këto sisteme, të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore nga pushteti ekzekutiv.

Krijimi i sistemeve elektronike do të mundësojë rritjen e efikasitetit të organeve të sistemit të drejtësisë, kontroll ndaj veprimtarisë funksionale, por edhe llogaridhënies së organeve të sistemit.

Krahas kompetencave për hetim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka kompetenca të parashikuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në nenin 194 dhe 204 të Ligjit për Qeverisjen, të cilat kanë të bëjnë me inspektimet institucionale dhe tematike. Këto kompetenca të reja kërkojnë planifikim të inspektimeve, shtjellim të metodologjisë për inspektime, miratim të formularit standard për raporte në përfundim të inspektimeve dhe bazuar në të gjitha këto, përgatitjen dhe miratimin e një platforme të re për inspektimet institucionale dhe tematike.

Kjo platformë mund të kërkojë vlerësime të mëtejshme nëse do të jetë pjesë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, apo do të jetë një komponent përbërës i sistemit të parashikuar nga neni 137 të ligjit për Statusin, dhe nenet 92 e 216 të ligjit për qeverisjen.

Edhe pse dispozita nuk përcakton aspekte të gjenerimit të dokumentacionit elektronik, mund të lindë si nevojë edhe analizimi i parashikimeve të legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik dhe nënshkrimin elektronik të akteve procedurale që do të hidhen në sistem, me qëllim që vlefshmëria dhe komunikimi i tyre të jetë konform kërkesave të ligjit

procedural mbi bazën e të cilit vepron ILD-ja, por edhe legjislacionit horizontal që normon çështje të lidhura.

Parashikimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 137, kërkojnë një përshkrim të detajuar të fazave procedurale hetimore që ndiqen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga momenti i marrjes së ankesës deri në fund të procedimit disiplinor. Zhvillimi i procedurave hetimore nga ana e ILDs-së duhet të reflektojë të gjitha hapat procedurale që parashikon kuadri i ri ligjor, i cili në mënyrë të përmbledhur, e ndan procesin disiplinor në tri faza të rëndësishme. Faza e parë duhet të fillojë nga data e marrjes së ankesës deri në datën e dhënies së një vendimi për arkivimin e ankesës ose për fillimin e hetimit disiplinor. Faza e dytë duhet përcaktuar nga data e fillimit të hetimit disiplinor deri në datën e raportit përfundimtar të hetimit. Faza e tretë duhet përcaktuar nga data e dorëzimit të dosjes disiplinore dhe raportit tek Këshilli përkatës deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit. Çdo fazë e hetimit disiplinor duhet të reflektojë të dhënat që do të administrohen nga stafi aktual i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Parashikimet e nenit 137 të ligjit për Statusin, kërkojnë nxjerrjen e akteve nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet që të hartohen rregulla për sa i përket formatit të të dhënave që do të administrohen në regjistër, llojin e informacionit shtesë, mënyrën e mbajtjes së sistemit, informacion të hapur për publikun dhe informacion për njohje vetëm nga magjistrati. Njerrja e këtyre rregullave kërkon që të jenë të harmonizuar me ligjin kuadër të bazave të të dhënave shtetërore, ku përcaktohet se në aktin e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen:

- a) institucionin administrues të bazës së të dhënave shtetërore;
- b) të dhënat parësore dhe dytësore;
- c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
- ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;
- d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

Procedurat dhe rregullat e detajuara për krijimin, regjistrimin, përfundimin e funksionimit, administrimin, ndërveprimin dhe sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore, realizon nga autoriteti rregullator koordinues, që në përputhje me ligjin nr. 10325/2010, është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në cilësinë e autoritetit rregullator koordinues të bazave të të dhënave shtetërore, përgjegjës për rregullimin dhe koordinimin e përgjithshëm të bazave të të dhënave shtetërore,. Referuar kompetencave të saj, miratuar me vendimin nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, bazat e të dhënave shtetërore të sistemit të drejtësisë janë të përjashtuara

nga fushëveprimi i saj.

Sa më sipër, miratimi i projektvendimit për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë krijon bazat për kuadrin insituacional dhe rregullator, për aspekte teknike të ngritjes së sistemit elektronik, regjistrimit të tij, komponentëve të sigurisë, ndërveprimet të sistemit dhe komunikimit me sisteme të tjera brenda kompetencave dhe kuadrin ligjor në fuqi.

iv. Nenet e lidhura

Neni 92, i ligjit nr. 115/2016

Neni 194 i ligjit nr. 115/2016

Neni 204 i ligjit nr. 115/2016

Neni 216, i ligjit nr. 115/2016

Ligj 10325/ 2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”

Vendimi i Këshillit të Ministrave, datë **2 Dhjetor 2020** “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”.

v. Standardet ndërkombëtare dhe përputhshmëria

- a. Këshilli i Bashkimit Europian “Aksesi në Drejtësi- gjetja e mundësive për dixhitalizim”, e miratuar në takimin e datës 7 Tetor 2020 dhe e aksesueshme në linkun në vijim:
<https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2020/10/13/digital-justice-council-adopts-conclusions-on-digitalisation-to-improve-access-to-justice/#>
- b. Këshilli i Europës “Cilësia e Drejtësië, përfshirë edhe transformimin dixhital të gjyqësorit” e cila përfshin një sërë instrumentash dhe është e aksesueshme në linkun në vijim:
<https://www.coe.int/en/web/cepej/cepej-work/quality-of-justice>
- c. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e cila mund të aksesohet në faqen zyrtare të OKB:
<https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/>
- d. Parimet e Bangalores për Sjelljen në Gjyqësor (2002), e Kombeve të Bashkuara, e aksesueshme në linkun në vijim:
https://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf
- e. Organizata “Transparency International”, Lufta kundër Korrupsionit në Gjyqësor, e aksesueshme në linkun në vijim:
https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/Topic_guide_on_judicial_corruption_.pdf

KAPITULLI V

FORMULARËT STANDART

Disa prej parimeve më të rëndësishme të një proçesi disiplinor kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, të parashikuara në Nenin 100 të Ligjit për Statusin kërkojnë garanci për zbatimin e tyre, të cilat duhet të krijohen në nivel organizativ nga ILD. Formularët standard janë një nga garancitë më të rëndësishme për zbatimin e duhur të parimeve të një proçesi të rregullt ligjor, parimit të barazisë para ligjit, parimit të pavarësisë dhe paanësisë të autoriteteve që kanë kompetencat hetimore dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve.

Në total janë 70 formularë standard të përfshirë në këtë kapitull, të cilët mbulojnë të gjitha hapat proceduriale të trajtuara në Kapitullin II “Procedurat disiplinore” (Nenin 117-Nenin 137), Pjesa V “Përgjegjësia disiplinore, civile dhe penale” e Ligjit për Statusin.

Përdorimi i këtyrë formularëve në proçesin hetimor të ILD-së pritet të sjellë një sërë përfitimesh të tilla si: përshpejtimi i hartimit të dokumentave, përmirësimi i saktësisë dhe konsistencës së dokumentave, efencës së kohës dhe cilësisë si dhe rritjen e profesionalizmit të personelit.

Duhet të theksojmë, se Formularët Standard kanë si qëllim parësor unifikimin e mënyrës së zbatimit praktik të parashikimeve ligjore që rregullojnë fazat e ndryshme të hetimit disiplinor, si rrjedhojë ato kanë natyrë orientuese në punën e inspektorëve dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Njëkohësisht këto formularë standard mund të jenë objekt rishikimi të mëtejshëm në varësi të ndryshimeve ligjore apo dhe të nevojave që do të lindin nga konsolidimi i praktikave të punës.

Në përfundim vlen të theksohet se, pavaresisht se këto formularë standard i referohen vetëm magjistratëve, në përputhje me terminologjinë e Ligjit për Statusin, ato përfshijnë për analogji edhe subjektet e tjera në fushën e kompetencës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë siç janë: anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 147/d pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 194, pika 1 të Ligjit për Qeverisjen.

SF 1 FORMULARI I ANKESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË FORMULARI I ANKESËS

I.

INFORMACION MBI TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT			
Emri/Mbiemri i ankuesit:			
Emri/Mbiemri i personit juridik:			
Nr. Personal/Shtetësia:			
Emri/Mbiemri i Përfaqësuesit të personit juridik:			
Adresa e përhershme:			
Adresa për korrespondencën (nëse është e ndryshme nga adresa e përhershme)			
Adresa elektronike (e-mail)			
Numrat e telefonit	Nr. fiks:	Punë/Zyrë:	Celulari:
Forma e ankesës	<input type="checkbox"/> Me postë elektronike	<input type="checkbox"/> Personalisht	<input type="checkbox"/> Faks
	<input type="checkbox"/> Me postë të rregullt		
Konfidencialiteti i identitetit	Kërkoni të ruani konfidencialitetin e identitetit tuaj?		
	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	

Kapitulli V
Formularët standard

II.

INFORMACION MBI TË DHËNAT E SUBJEKTIT
Subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa: <input type="checkbox"/> Gjyqtar <input type="checkbox"/> Prokuror <input type="checkbox"/> Anëtar KLGJ <input type="checkbox"/> Anëtar KLP <input type="checkbox"/> Prokuror i Përgjithshëm
Emri dhe mbiemri i subjektit: _____
Gjykata/Prokuroria në të cilën gjyqtari/prokurori ushtron ose ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar:

III.

OBJEKTI I ANKESËS	
Shkelja disiplinore e pretenduar është: <input type="checkbox"/> në lidhje me ushtrimin e funksionit <input type="checkbox"/> jashtë ushtrimit të funksionit <input type="checkbox"/> për shkak të kryerjes së veprës penale	
Cila është ankesa juaj? (Ju lutemi jepni detaje mbi faktet, rrethanat dhe datën se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar)	_____ _____ _____ _____

IV.

OPSIONALE Nëse ankesa juaj ka lidhje me çështje gjyqësore/nën hetim, ju lutemi plotësoni informacionin përkatës në fushat e mëposhtme. Nëse jo, vazhdoni me plotësimin e pjesës IV	
INFORMACION NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN	
Numri i çështjes	
Lloji i çështjes Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!	<input type="checkbox"/> Civile <input type="checkbox"/> Administrative <input type="checkbox"/> Penale

<p>Përfshirja e ankuesit në çështjen e lartpërmendur:</p> <p>Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!</p>	<input type="checkbox"/> Padi tës <input type="checkbox"/> I paditur <input type="checkbox"/> I pandehur <input type="checkbox"/> Ankues <input type="checkbox"/> Avokat <input type="checkbox"/> Dëshmitar <input type="checkbox"/> Tjetër Nëse tjetër, ju lutem specifikoni _____	
<p>Faza aktuale e procesit</p>	<input type="checkbox"/> Në gjykim <input type="checkbox"/> Pas gjykimit <input type="checkbox"/> Gjykata e Shkallës së Parë _____ <input type="checkbox"/> Gjykatë Apeli _____ <input type="checkbox"/> Gjykatë e Lartë <input type="checkbox"/> Nën hetim <input type="checkbox"/> Prokuroria e Shkallës së Parë _____ <input type="checkbox"/> Prokuroria e Apelit _____	
<p>A jeni ankuar më parë për të njëjtat fakte?</p> <p>Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse dhe parashtroni të dhënat e kërkuara!</p>	<input type="checkbox"/> Po Numri i regjistrimit i ankesës dhe/ose numri i çështjes tek Zyra e Inspektorit: _____	<input type="checkbox"/> Jo

V.

<p>OPSIONALE</p> <p>LISTA E DOKUMENTEVE BASHKËLIDHUR</p>
--

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- 6.
- 7.

VI.

KËRKESË E VEÇANTË, KONFIDENCIALITETI

Deklaratë konfidencialiteti

Me anë të kësaj deklaratë Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr përsipër të mos përdorë dhe të mos i transmetojë personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga ankuesi, përveç nëse autorizohet shprehimisht nga ky i fundit, ose kërkohet me ligj. Ky detyrim vlen për çdo fazë të shqyrtimit të ankesës.

Përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk do të përdorë ose përhapë asnjë të dhënë personale që merr dijëni gjatë veprimtarisë së tij për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me veprimtarinë e tij.

Në çdo rast informacioni i paraqitur konsiderohet konfidencial dhe do të përdoret vetëm nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D.) për qëllime të shqyrtimit të ankesës.

***Shënim:** Nëse pjesë të caktuara të formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, mund të shtoni pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.*

Data

Nënshkrimi i Ankuesit/

Përfaqësuesi i Ankuesit

SF 2 UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E ANKESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Adresa

Tel: +355

www.

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E ANKESËS PËR SHKELJE DISIPLINORE TË PRETENDUAR NDAJ GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

I nderuar ankues,

Angazhimi ynë është për të siguruar veprimtarinë e funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrën më të mirë dhe të ligjshme të mundur. Ju lutemi plotësoni saktë të gjithë formën e ankesës, duke u përpjekur të ndiqni udhëzimet e mëposhtme. Ju lutemi mbani parasysh se qëllimi i vetëm i këtyre udhëzimeve është t'ju ndihmojë ju në përgatitjen dhe paraqitjen e ankesës tuaj, por jo që t'a bëjë më të komplikuar plotësimin apo t'ju pengojë ju për ankesat.

UDHËZIME

1. Ankesa juaj duhet të jetë në formë të shkruar¹⁷³.
2. Ju mund ta paraqisni ankesën tuaj, duke plotësuar formën standarde të ankesës. Forma standarde e ankesës mund të plotësohet me shkrim dore ose në mënyrë elektronike. Nëse e plotësoni me shkrim dore, ju lutemi të përdorni shkronja shtypi, në mënyrë që teksti të jetë i lexueshëm.
3. Plotësoni të gjithë informacionin e kërkuar në fushat përkatëse.

Vini re që ka edhe fusha opsionale, për të cilat ju mund të mos jepni informacion. Nëse nuk jepni informacion për fushat opsionale, nuk jeni të detyruar të jepni arsye pse nuk jepni informacion.

Kushtojini vëmendje fushave që kërkojnë informacion në lidhje me objektin e ankesës! Mbani parasysh se Inspektori i Lartë i Drejtësisë

¹⁷³ Siç parashikohet nga neni 120, paragrafi 2 i Ligjit nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ndryshuar, ankesa duhet të bëhet me shkrim.

është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve (por jo të personelit të caktuar në sistemin gjyqësor apo të prokurorisë të Republikës së Shqipërisë).

4. Parashtroni në mënyrë të saktë faktet në lidhje me shkeljen e pretenduar të gjyqtarit apo prokurorit. Kjo do të ndihmojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të identifikojë nëse ankesa juaj paraqet dyshime të arsyeshme për të besuar se shkelja e pretenduar mund të ketë ndodhur.

Ju lutem vini re, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka asnjë autoritet të shqyrtojë çështje për gabime gjyqësore. Gabime të tilla mund të korrigjohen brenda sistemit të gjykatave nëpërmjet procedurës së ankimit në gjykatë. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka asnjë autoritet të ndikojë mbi gjykatën që ju të përfitoni një rezultat në ndryshëm në çështjen tuaj gjyqësore. Nëse keni për qëllim të ndryshoni rezultatin e çështjes tuaj, diskutojeni këtë pa vonesë me një avokat.

5. Parashtroni informacionin e duhur mbi dëshmitarë dhe persona të tjerë të cilët kanë njohuri mbi ngjarjen, për të cilën ju paraqisni ankesë.

6. Bashkëlidhni të gjitha dokumentet e nevojshme në dispozicion, të cilat sipas mendimit tuaj vërtetojnë deklaratimet e fakteve të bëra në ankesë. Ju lutem jepni të dhëna se ku mund të gjendet informacioni i nevojshëm (i.e. emri i institucionit, personi juridik etj).

7. Vendorsni datën dhe nënshkrimin në ankesë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të respektojë në mënyrë rigoroze të gjitha detyrimet e tij në lidhje me konfidencialitetin.

8. Dërgoni ankesën së bashku me dokumentet e bashkëlidhura në adresën e mëposhtme postare, nr. fax. ose adresë elektronike: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Rr. _____ Nr. __, Tiranë; Nr. Fax. _____, adresa elektronike: _____@ild.al

VINI RE: Ankesat e dërguara në adresë të gabuar mund të mos trajtohen.

9. Ankesa juaj mund të paraqitet në mënyrë elektronike me e-mail, nëpërmjet postës ose drejtpërdrejtë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

10. Ju lutem kini parasysh se tërheqja e ankesës nga ana juaj nuk përbën arsye për arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativë si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.

11. Ankesat dhe dokumentet e bashkëlidhura nuk do të kthehen.

SF 3 KONFIRMIMI I MARRJES SË ANKESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

Lënda: Konfirmim për marrjen e ankesës tuaj

**Z./Znj. [Emri dhe mbiemeri i ankuesit]
[Adresa e ankuesit]**

I/E nderuar Z. / Znj. [emri i ankuesit],

Me anë të këtij njoftimi, në zbatim të nenit 119 pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konfirmon marrjen e ankesës suaj.

Ankesa juaj është regjistruar me numrin hyrës në regjistër, numër:/....., datë [vendosen numri dhe data e regjistrimit].

Jeni të lutur të përdorni këtë numër në çdo korrespondencë në të ardhmen.

Ankesa juaj do të shqyrtohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përputhje me parashikimet e Pjesës V, Kreu II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe parashikimet e Pjesës IV, Kreu I dhe III të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe ju do të njoftoheni për çdo vendim që do të merret në lidhje me këtë ankesë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 4 LISTA E KRITEREVE TË PRANIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Ankesa nr. __reg.__

Tiranë, më .../.../2021

LISTKONTROLLI I PRANUESHMËRISË SË ANKESËS

LISTKONTROLLI PËR KLASIFIKIMIN E ANKESËS/INFORMACIONIT TJETËR NË LIDHJE ME PRETENDIMIN PËR SHKELJE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

Sipas nenit 123 dhe nenit 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) fillon hetimin disiplinor në rastet kur:

- Bazuar në një ankesë të depozituar në ILD nga një person fizik ose juridik, nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të ketë ndodhur;
- Me iniciativën e tij (*ex officio*), kur ka një dyshim të arsyeshëm se mund të jetë kryer shkelja, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme.

Forma standarde në LISTKONTROLL ka për qëllim të lehtësojë shqyrtimin fillestar të ankesave dhe të përdoret për arsyetimin e vendimeve për arkivimin e ankesave, vendimeve për verifikim të ankesave dhe vendimeve për fillimin e një hetimi disiplinor. Gjithashtu, listkontrolli rekomandohet për t’u përdorur nga personeli administrativ i ILD-së për plotësimin e të dhënave përkatëse në regjistra.

I: KRITERET PËR PRANUESHMËRINË E ANKESAVE:

A i përmban ankesa të dhënat e mëposhtme? Ju lutem zgjidhni kutinë/ të ku është e aplikueshme:

- Gjenealitetet dhe adresa e ankuesit;
- Ankuesi kërkon ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të tij;
- Përshkrimi i rrethanave të fakteve që pretendohen të kenë ndodhur;
- Emri dhe mbiemri i gjyqtarit/prokurorit;
- Gjykata/Prokuroria në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Shënim: Nëse ankuesi është anonim (gjenealitetet dhe adresa e ankuesit nuk janë përfshirë në ankesë), ILD mund të përdorë informacion nga ankesa për të kryer një verifikim ose *ex officio* të propozojë fillimin e një hetimi disiplinor.

Nëse emri i gjyqtarit/prokurorit nuk përmendet nga ankuesi, atëherë, emri mund të identifikohen nga ILD-ja nëpërmjet mbledhjes së informacionit shtesë nga gjykata/prokuroria përkatëse ose nga ankuesi, dhe ankesa do të shqyrtohet.

Kriteret për pranueshmërinë sipas nenit 120, paragrafi 1, ligji për Statusin:

Ju lutem zgjidhni kutinë/të, nëse ankuesi:

- I referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;
- Nuk përmban elementë abuzivë, nuk është haptazi e pabazuar, ose ankesa të përsëritura nga i njëjti ankues;
- Bëhet ndaj sjelljes së magjistratit i cili ka qenë në detyrë në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar;
- Bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi, në kohën që ka ndodhur shkelja e pretenduar;
- Bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

Shënim: Kriteret e parashikuara nga neni 120, paragrafi 1, janë të zbatueshme për çdo burim tjetër informacioni, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vazhdon me verifikimin dhe/ose fillimin e një hetimi disiplinor, me iniciativën e vet (*ex officio*).

II: TREGUESIT SHITESË PËR FILLIMIN E VLERËSIMIT TË PËRMBAJTJES SË ANKESËS

Subjekti¹⁷⁴:

¹⁷⁴ Që do të thotë se subjekti është/ishte mbajtës i pozicionit në kohën që kanë ndodhur faktet e pretenduara.

- Gjyqtari _____, Gjykata _____
- Prokurori _____, Prokuroria _____

Pretendimet të cilave u referohet ankesa/burimi tjetër i informacionit përkatës:

- Paraqesin pakënaqësi në lidhje me vendimin gjyqësor/aktet e prokurorit gjatë hetimeve dhe kanë si qëllim korrigjimin e ndonjë gabimi eventual të bërë gjatë procesit të vendimit që mund të korrigjohet brenda sistemit gjyqësor/ të prokurorisë nëpërmjet mjeteve procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- Kërkojnë ndihmë juridike apo ndihmë tjetër nga ILD-ja;
- Kërkojnë të ndikojnë në procedurat para gjykatës/prokurorisë (përsheptimin e procedurës, rezultatin e synuar të procedurës, etj.);
- Përfaqësojnë një apo më shumë ankesa false, fyese apo joserioze që përmbajnë pretendime për një apo më shumë shkelje të ndryshme nga një subjekt që është nën hetim, pa u mbështetur me fakte ose prova për të vërtetuar këto pretendime, *ankesa të pabazuara* ;
- Paraqesin abuzime të tjera të së drejtës për ankim (të ndryshme nga sa më sipër), duke përfshirë ankesa që përsërisin ankesat e depozituara më parë ose ankesat të cilat kanë qëllime propaganduese;
- Kanë të bëjnë me sjellje që nuk janë të dyshimta dhe që – nëse provohen që janë kryer – nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
- I referohen sjelljes, së gjyqtarëve/prokurorëve e cila nuk është klasifikuar si shkelje disiplinore, nga ligji në momentin kur pretendohet se shkelja ka ndodhur; ;
- Paraqesin disa fakte të tjera që janë jashtë objektit të veprimtarisë së ILD-së. Ju lutem përshkruani shkurtimisht se çfarë janë ato saktësisht:
-
-

Shënim: Nëse nga ankesa/burimi i informacionit është e qartë se një nga kutitë e listuara më lartë duhet të zgjidhet, nuk ka dyshim të arsyeshëm për të besuar se shkelja mund të ketë ndodhur dhe ankesa nuk duhet të trajtohet më tej. Nëse ankesa nuk është e qartë sa duhet, mund të jetë e nevojshme të kryhet një verifikim për të qenë të sigurt në këto çështje.

Treguesit shtesë janë të zbatueshëm për çdo burim tjetër informacioni, ku ILD vlerëson bazën ligjore për të nisur *ex officio* një hetim disiplinor.

III: ÇËSHËTJE E LIDHUR ME VEPRIMTARINË PROFESIONALE APO SHKELJE DISIPLINORE ?

Një pakujdesi në performancë nuk përbën shkelje disiplinore, nëse ajo ndodh nga një keqkuptim apo gabim i kuptueshëm, ose nëse gjyqtari/prokurori nuk ka vepruar të paktën me pakujdesi.

Një pakujdesi në performancën e një gjyqtari/prokurori duhet të konsiderohet si shkelje disiplinore vetëm nëse gabimet në ofrimin e shërbimit janë qartësisht përtej asaj se çfarë pritet normalisht nga një gjyqtar/prokuror i nivelit mesatar.

Për caktimin e kufijve midis çështjeve të veprimtarisë profesionale në një anë dhe shkeljeve disiplinore nga ana tjetër, mund të merren parasysh si më poshtë: shkalla e pakujdesisë, shpeshësia e kryerjes së veprimit/mospërprimit apo sjelljes, pozita e gjyqtarit/prokurorit brenda sistemit, nëse fusha e ligjit në të cilën ai/ajo vepron konsiderohet të jetë shumë komplekse, dëmin, mundësinë e shkaktimit të dëmit dhe shkalla e pasojave, që mund rezultojë nga sjellja, si dhe çdo situatë që është jashtë kontrollit të gjyqtarit/prokurorit dhe që lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

Për të lehtësuar këtë përcaktim, ju lutem kontrolloni si më poshtë:

A është kryer sjellja e dyshuar e papërshtatshme e një gjyqtari/prokurori në mënyrën e mëposhtme?

- Subjekti i ankesës nuk ka përmbushur detyrën së tij/saj dhe/ose të paktën me pakujdesi ka shfaqur sjellje të të pahijshme, duke marrë parasysh elementë si shpeshësia e ndodhjes së gabimeve apo fusha e ligjit, në të cilën ai/ajo vepron.
- Subjekti i ankesës ka shfaqur sjellje të tilla që dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, duke marrë parasysh - ndër të tjera - pozitën e gjyqtarit/prokurorit brenda sistemit dhe publicitetin e ngjarjes, si dhe mundësinë e shkaktimit të dhe shkallën e dëmit apo të pasojave që rezultojnë ndoshta nga sjellja.
- Pa ndonjë shkak të arsyeshëm.

Shënim: Nëse asnjë nga kutitë e listuara më lartë nuk është zgjedhur, sjellja duhet të vlerësohet si çështje e veprimtarisë profesionale, e cila nuk përbën shkelje.

Çështjet e veprimtarisë profesionale duhet të trajtohen në kuadër të vlerësimeve dhe/ose nëpërmjet udhëzimeve të përditshme, të cilat kryetarët e gjykatave/drejtuesit e prokurorisë duhet t'u japin magistratëve në gjykatën/prokurorinë përkatëse.

Ankesat e tilla dhe rezultatet përkatëse të ILD-së duhet të përcillen në Këshillin përkatës dhe/ose tek kryetari i gjykatës/ drejtuesi i prokurorisë përkatëse.

Nëse dallimi midis shkeljeve disiplinore dhe çështjeve të performancës konsiderohet si i pamundur në këtë fazë, ILD-ja mund të bëjë qartësimin e saktë pas verifikimit të ankesës, ose edhe pas përfundimit të hetimit disiplinor. Vlerësimi i hershëm rekomandohet për të kursyer kohën dhe burimet.

IV: KATEGORIA E SHKELJES DHE BAZA PËR FILLIMIN E NJË HETIMI

- Shkelja mund të ndodhë nëpërmjet veprimit, mosveprimit ose sjelljes.
- Një shkelje mund të ndodhë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja përbën një formë të fajësisë dhe nënkupton kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve ose shfaqjen e sjelljeve qëllimisht të gabuara. Pakujdesi një formë tjetër e fajësisë nënkupton indiferencë pavarësisht nëse veprimi është i gabuar apo jo (shih gjithashtu më poshtë).
- Në çdo rast, një sjellje vlerësohet aq e rëndë sa të përbëjë një shkelje, nëse ajo kryhet me një qëllim të pandershëm, shtypës, apo korruptiv, nën të cilën përgjithësisht mund të përfshihen frika dhe favori.

Sjellja e papërshtatshme e gjyqtarit/prokurorit, siç pretendohet në ankesë/burime të tjera të informacionit konsiderohet të përfshijë elemente të një ose më shumë prej shkeljeve¹⁷⁵.

Ju lutem zgjidhni rutinë për të përcaktuar kategorinë e shkeljes:

- Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit të magjistratit;
- Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit të magjistratit;
- Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale.

Shëno shkeljen konkrete disiplinore që pretendohet se ka ndodhur

Pas shqyrtimit fillestar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:

- Të arkivojë ankesën
- Të verifikojë ankesën
- Të fillojë hetimin

/Firma/

¹⁷⁵ Shih nenet 102-104 të Ligjit për Statusin të cilët përmbajnë një listë shteruese të shkeljeve disiplinore.

SF 5 PROJEKT VENDIM PËR ARKIVIMIN E ANKESËS PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më..../.....2021

ILD

Miratohet Ndryshohet Kthehet

Dt. ____/____/____

PROJEKT VENDIM

“Për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”

Në zbatim të neneve 120, 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit z/znj. (vendoset emri i ankuesit¹⁷⁶), konstatoj:

i. Përmbajtja e ankesës

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për kryerjen e shkeljes disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë] nga ana e gjyqtarit/prokurorit.

Ankesës i janë bashkëlidhur këto akte¹⁷⁷:

ii. Analiza e çështjes

Nga shqyrtimi fillestar i ankesës rezulton se [duke dhënë rezultatet e

176 Ne rastin kur ankuesi është person juridik vendoset emri i personit juridik.

177 Citohen në mënyrë të përmbledhur aktet që i bashkëlidhen ankesës.

shqyrtimit fillestar].

Në këto kushte, kjo ankesë nuk përmbush kriterin/et e pranueshmërisë referuar nenit 120, pika 1, shkronja [*sipas rastit konkret, cilën prej kriterit/kritereve nuk përmbush ankesa*] e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja “a”, të këtij ligji.

iii. Propozime

Bazuar në nenin 121, pika 2 shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, propozoj:

Arkivimin e ankesës me nr.____datë [*vendoset numri i regjistrit të ankesës në ILD*] së [*vendoset emri i ankuesit*], ndaj veprimtarisë së magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete*].

Të njoftohet ankuesi si dhe magjistrati/ët: [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete*], me rezultatet e mësipërme.

Të njoftohet ankuesi mbi të drejtën e ankimit sipas nenit 121 pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

INSPEKTOR
[emër mbiemër]

SF 6 VENDIMI I ILD PËR KTHIMIN E PROJEKTVENDIMIT PËR
ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

“Për kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr. _____
prot, datë _____ “Për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit [*vendos Nr. prot dhe datën e projekt vendimit*], të inspektorit [*emri i inspektorit*], propozohet arkivimi i ankesës nr. Prot, datë të ankuesit [*vendos nr. e regjistrimit dhe emrin e ankuesit*] ndaj veprimtarisë së magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për kryerjen e shkeljes disiplinore të pretenduar [*vendos shkeljen konkrete dhe dispozitën ligjore që e parashikon si të tillë*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast kthimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

_____.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 214 pika 7, shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës, me numër, datë [*vendos numrin dhe datën e projekt vendimit*], për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. regj. date [*vendos numrin e regjistrimit të ankesës në ILD*] ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatë/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*].
2. Inspektori përgjegjës të bëjë plotësimet dhe/ose korrigjimet përkatëse në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim.
3. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vend hyn ne fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 7 VENDIMI I ILD PËR NDRYSHIMIN E PROJEKTVENDIMIT
PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

“Për ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr. _____ prot, datë _____ “Për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit [*vendos nr. prot datën e projekt vendimit*], të inspektorit [*emri i inspektorit*], propozohet arkivimi i ankesës nr. Prot, datë të ankuesit [*vendos nr. e regjistrimit dhe emrin e ankuesit*] ndaj veprimtarisë së magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për kryerjen e shkeljes disiplinore të pretenduar [*vendos shkeljen konkrete dhe dispozitën ligjore që e parashikon si të tillë*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast ndryshimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

4. Ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës, me numër, datë [*vendos numrin dhe datën e projekt vendimit*], për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. regj. date [*vendos numrin e regjistrimit të ankesës në ILD*] ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokuratorit*], në Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] dhe vijimin e procedurës për verifikimin e ankesës/fillimin hetimit disiplinor.

5. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 8 VENDIM I ILD PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT
FILLESTAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../.....2021

V E N D I M

**“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga
shtetasi/ja¹⁷⁸ z/znj _____”**

Në bazë të nenit 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 204 pika 1 shkronja “j”, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, bazuar në projektvendimin nr. _____, datë _____, të inspektorit përgjegjës;

KONSTATOJ

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendoset pretendimi konkret, në lidhje me ushtrimin e funksionit, jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së veprës penale].

Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendosen faktet dhe rrethanet e pretenduara nga ankuesi].

Nga shqyrtimi fillestar rezultoi se [duke dhënë rezultatet e shqyrtimit fillestar për rastin konkret duke analizuar rast pas rasti kriteret e pranueshmërisë së ankesës].

Në këto kushte, kjo ankesë nuk përmbush kriterin/et e pranueshmërisë

178 Në rastin kur ankuesi është institucion ose person juridik privat të vendoset emri i institucioni apo personit juridik

referuar nenit 120, pika 1, shkronja [sipas rastit konkret, cilën prej kriterit/kritereve nuk përmbush ankesa] të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja “a”, të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar nenin në 120 pika 1 shkronja [sipas rastit konkret cilën prej prej kriterit/kritereve nuk përmbush ankesa], nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës nr.____datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në *ILD*] të paraqitur nga shtetasi/shtetësja [vendoset emri i ankuesit], ndaj veprimtarisë së magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete].
2. Në zbatim të nenit 121 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ky vendim t`i njoftohet ankuesit [vendoset emri i ankuesit] dhe magjistratit¹⁷⁹ [emri i magjistratit] brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi, ankuesi, mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e këtij vendimi.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

179 Në rastet kur magjistratit i ka perfunuar statusi me vendim të keshillit dhe ankesa është arkivuar, bazuar në kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120 pika 1, shkronja ç, njoftimi i magjistratit nuk dergohet/kryhet.

**SF 9 NJOFTIM I MAGJISTRATIT PËR ARKIVIMIN E ANKESËS
PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. ____ Prot.

Tiranë më,/...../2021

Lënda: Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar

**Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]
[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]**

I/E nderuar z./znj. [emri i magjistratit],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. ____ regj, datë ____ [vendoset numri i regjistrit të ankesës në Zyrën e ILD dhe data] të paraqitur nga (vendoset emri i ankuesit), ka konkluduar se ankesa nuk përmbush kriterin [vendoset kriterin/let konkret sipas vendimit të arkivimit] për pranueshmëri sipas parashikimit në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për këtë arsye, është vendosur arkivimi i ankesës bazuar në nenin 121 pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 121 pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ju lutemi gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi, një kopje të vendimit “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi/ja z./znj. _____”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 10 NJOFTIM I ANKUESIT PËR ARKIVIMIN E ANKESËS PAS
SHQYRTIMIT FILLESTAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2021

Lënda: Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar

**Z./Znj. _____ (Emri i ankuesit)
_____ (Adresa e ankuesit)**

I/E nderuar z./znj. [*emri i ankuesit*],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), pas shqyrtimit fillestar të ankesës tuaj nr. ____ regj, datë ____ [*vendoset numri i regjistrimit të ankesës në Zyrën e ILD dhe data*], ka konkluduar se ankesa juaj nuk përmbush kriterin [*vendoset kriteri/et konkret sipas vendimit të arkivimit*] për pranueshmëri sipas parashikimit në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për këtë arsye, është vendosur arkivimi i ankesës tuaj bazuar në nenin 121 pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 119 pika 4 dhe nenit 121 pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ju lutemi gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi, një kopje të vendimit për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar.

Në përputhje me nenin 121, pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ju keni të drejtë të ankimoni këtë vendim në Këshillin e Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 11 PROJEKT VENDIM PËR VERIFIKIMIN E ANKESËS PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

ILD

Miratohet Ndryshohet Kthehet

Dt. ____/____/_____

PROJEKT VENDIM

“Për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”

Në zbatim të nenit 120, 121, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit z/znj. (vendoset emri i ankuesit)¹⁸⁰, konstatoj:

i. Përmbajtja e ankesës

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për kryerjen e shkeljes disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë] nga ana e gjyqtarit/prokurorit.

Ankesës i janë bashkëlidhur këto akte¹⁸¹:

ii. Analiza e çështjes

Nga shqyrtimi fillestar i ankesës rezulton se ankesa përmbush kriteret

180 Në rastin kur ankuesi është person juridik vendoset emri i personit juridik

181 Citohen në mënyrë të përmbledhur aktet që i bashkëlidhen ankesës.

e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (të jepet një vlerësim i analizës së kritereve të pranueshmërisë).

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës [dhe dokumentave bashkëlidhur saj, nëse ka] u vlerësua se ankesa nuk ka informacion të qartë në lidhje me faktet në vijim [vendosni saktësisht çfarë nuk është e qartë]. Për pasojë, është e nevojshme të kryhet verifikimi i këtyre fakteve për të konkluduar nëse faktet janë të mjaftueshme për të filluar hetimin disiplinor. Pretendimet e ankuesit nëse provohen përbëjnë shkak për fillimin e hetimit disiplinor për shkeljen disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë].

Për sa më sipër, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, çmohet verifikimi i ankesës së paraqitur nga (vendoset emri i ankuesit), dhe marrja e të dhënave shtesë nga (vendoset institucioni pranë cilit do të kërkohen të dhënat shtesë) për të konkluduar nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme për ndërmarrjen e nismave konkrete përkatëse.

iii. Propozime

1. Verifikimin pas shqyrtimit të fillestar të ankesës së paraqitur nga (vendoset emri i ankuesit dhe nr dhe data e ankesës).
2. Në funksion të procedurës së verifikimit të ankesës të kryhen veprimet e mëposhtme:
 - a. Të marret informacion nga [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë] ose [në mënyrë alternative institucioni tjetër që duhet marrë informacioni si dhe lloji i informacionit që do të kërkohet];
 - b. Ankuesit t’i kërkohet të paraqesë të dhëna ose dokumente shtesë si vijon [vendos dokumentet konkrete] ose
 - c. Ankuesi të thirret për të dhënë shpjegime shtesë për rrethanat dhe mënyrën që ka ndodhur shkelja e pretenduar nëse është e nevojshme].

INSPEKTOR
[emër mbiemër]

SF 12 VENDIMI I ILD PËR KTHIMIN E PROJEKTVENDIMIT PËR
VERIFIKIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

“Për kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr. _____
prot, datë _____ “Për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit [*vendos Nr. prot dhe datën e projekt vendimit*], të inspektorit [*emri i inspektorit*], propozohet verifikimi i ankesës nr. Prot, datë të ankuesit [*vendos nr. e regjistrimit dhe emrin e ankuesit*] ndaj veprimtarisë së magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për kryerjen e shkeljes disiplinore të pretenduar [*vendos shkeljen konkrete dhe dispozitën ligjore që e parashikon si të tillë*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast kthimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PER KETO ARSYE:

Bazuar ne nenin 214 pika 7, shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA:

1. Kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës, me numër, datë [*vendos numrin dhe datën e projekt vendimit*], për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. regj. date [*vendos numrin e regjistrimit të ankesës në ILD*] ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*].
2. Inspektori përgjegjës të bëjë plotësimet dhe/ose korrigjimet përkatëse në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim.
3. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 13 VENDIMI I ILD PËR NDRYSHIMIN E PROJEKTVENDIMIT
PËR VERIFIKIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më..../.....2021

V E N D I M

**“Për ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr.
_____ prot, datë _____ “Për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit
fillestar”**

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit [*vendos nr. prot datën e projekt vendimit*], të inspektorit [*emri i inspektorit*], propozohet verifikimi i ankesës nr. Prot, datë të ankuesit [*vendos nr. e regjistrimit dhe emrin e ankuesit*] ndaj veprimtarisë së magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për kryerjen e shkeljes disiplinore të pretenduar [*vendos shkeljen konkrete dhe dispozitën ligjore që e parashikon si të tillë*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast ndryshimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës, me numër, datë [*vendos numrin dhe datën e projekt vendimit*], për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. regj. date [*vendos numrin e regjistrimit të ankesës në ILD*] ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] dhe vijimin e procedurës për arkivimin e ankesës/fillimin e hetimit disiplinor.

2. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 14 VENDIMI IILD PËR VERIFIKIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

“Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi/ja¹⁸² z/znj. _____”

Në bazë të nenit 121, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 204 pika 1 shkronja “j”, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, bazuar në projektvendimin nr. _____, datë _____, të inspektorit përgjegjës;

KONSTATOJ

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendoset pretendimi konkret, në lidhje me ushtrimin e funksionit, jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së veprës penale].

Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendosen faktet dhe rrethanet e pretenduara nga ankuesi].

Nga shqyrtimi fillestar rezultoi se, ankesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës [dhe dokumentave bashkëlidhur saj, nëse ka] u vlerësua se ankesa nuk ka informacion të qartë në lidhje me faktet në vijim [vendosni saktësisht çfarë nuk është e qartë]. Për pasojë, është

182 Në rastin kur ankuesi është institucion ose person juridik privat të vendoset emri i institucionit apo personit juridik

e nevojshme të kryhet verifikimi i këtyre fakteve për të konkluduar nëse ato janë të mjaftueshme për të filluar hetimin disiplinor. Pretendimet e ankuesit nëse provohen përbëjnë shkak për fillimin e hetimit disiplinor për shkeljen disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë].

Për sa më sipër, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, çmohet verifikimi i ankesës së (vendoset emri i ankuesit) dhe marrja e të dhënave shtesë (vendoset institucioni pranë të cilit do të kërkohen të dhëna shtesë), të cilat janë të nevojshme për të konkluduar nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme për ndërmarrjen e nismave konkrete përkatëse.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “b”, nenin 122 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Verifikimin pas shqyrtimit të fillestar të ankesës së paraqitur nga (vendoset emri i ankuesit dhe nr dhe data e ankesës).
2. Në funksion të procedurës së verifikimit të ankesës të kryhen veprimet e mëposhtme:
 - a. Të merret informacion nga [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë] ose [në mënyrë alternative institucioni tjetër që duhet marrë informacioni si dhe lloji i informacionit që do të kërkohet];
 - b. Ankuesit t’i kërkohet të paraqesë të dhëna ose dokumente shtesë si vijon [vendos dokumentet konkrete] ose
 - c. Ankuesi të thirret për të dhënë shpjegime shtesë për rrethanat dhe mënyrën që ka ndodhur shkelja e pretenduar nëse është e nevojshme].

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 15 KËRKESA PËR MARRJE DOKUMENTACIONI NË KUADËR TË VERIFIKIMIT TË ANKESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Kërkohej informacion dhe dokumentacion për verifikimin e një ankese

[Emri i institucionit / organit]¹⁸³

[Adresa e personit / institucionit]

I/E nderuar z./znj. [vendosni emrin]

Me anë të vendimit nr. prot, datë (vendoset numri dhe data e vendimit) “Për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar” Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasit (vendoset emri i ankuesit dhe nr e data e regjistrimit të ankesës), ndaj magjistratit (vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit ndaj të cilit është paraqitur ankesa dhe gjykata/prokuroria ku ushtron funksionin).

Në bazë të nenit 122 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë çmon se ka vend për marrjen e të dhënave dhe dokumentacionit shtesë [vendosni informacionin konkret që kërkohet dhe/ose titullin e dokumenteve, duke referuar nr e çështjes dhe palët që i përket çështja¹⁸⁴].

Pas marrjes së këtij informacioni do të vlerësohet nëse ka vend për fillimin e hetimit disiplinor për rastin konkret. Bashkëlidhur gjeni vendimin “Për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”.

183 Ketu perfshihen institucionet si vijon: gjykatat/prokurorite/keshillat ne peputhje me nenin 122 pika 3. Pavarsishte kesaj kjo liste nuk eshte shteruese.

184 Rekomandohet që nëse Inspektori kërkon dokumente, të nxjerra nga institucioni përkatës për qëllime të tjera (për shembull protokollin e seancave, protokollin nga intervista, mendimet e ekspertëve, etj) të sqarohet në kërkesë që kopja e dokumentit përkatës përmban një verifikim të kryetarit përmes njësimin të kopjes me dokumentin origjinal.

Me qëllim respektimin e afatit ligjor të verifikimit të ankesës të përcaktuar nga neni 118, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është e nevojshme që informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar të paraqitet brenda datës [*vendos datën*].

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 16 VENDIMI I LD PËR ARKIVIMIN E ANKESËS PAS VERIFIKIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

**Për arkivimin pas verifikimit të ankesës paraqitur nga shtetasi/ja¹⁸⁵ z/
znj _____**

Në zbatim të neneve 120 dhe 121 shkronja "b", dhe 122 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, bazuar në projektvendimin nr. _____, datë _____, të inspektorit përgjegjës;

KONSTATOJ

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. regj. [vendoset numri i regjistrit të ankesës], që lidhet me sjelljen e magjistratit [vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit], në [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete], për çështjen gjyqësore nr. datë [vendoset atributet e çështjes gjyqësore] ose [vendoset pretendimi i ngritur nëse ankesa lidhet me veprimtari jashtëgjyqësore]. Inspektori i Lartë i Drejtësisë procedoi me verifikimin e ankesës bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për shkak të informacionit të paqartë të paraqitur në ankesë. Konkretisht, u procedua me mbledhjen e të dhënave për [vendoset fakti që është verifikuar dhe aktet shkresore të mbledhura për të].

Nga verifikimi i të dhënave konstatohet se ankesa përmban këto pretendime [vendos faktet përkatëse të ankesës dhe dokumentet bashkëlidhura saj]. Nga analiza e fakteve të mbledhura në procesin e verifikimit, u konstatua se [vendoset faktet e reja, që kanë dalë nga procesi i verifikimit dhe dokumentet që tregojnë këto fakte]. Nisur nga sa më sipër, nga të gjitha aktet e grumbulluara në funksion të verifikimit të ankesës, mungojnë

185 Në rastin kur ankuesi është institucion ose person juridik privat të vendoset emri i institucioni apo personit juridik

dyshimet e arsyeshme të cilat të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] për shkeljen disiplinore të parashikuara nga (vendoset lloji i shkeljes disiplinore dhe dispozita përkatëse ligjore) dhe për këtë arsye ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 122 pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 122 pika 4 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

VENDOSA

1. Arkivimin e ankesës së shtetasit [vendoset emri i ankuesit dhe numri dhe data e regjistrimit të ankesës] në lidhje me sjelljen e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], në [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete].
2. Në zbatim të nenit 122 pika 5 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të njoftohet ankuesi dhe magjistrati brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi, ankuesi, mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor/ të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e tij.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 17 NJOFTIM I ANKUESIT PËR ARKIVIMIN E ANKESËS PAS VERIFIKIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas verifikimit

Z./Znj. (Emri i ankuesit)

(Adresa e ankuesit)

I/E nderuar z./znj. [*emri i ankuesit*],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), pas verifikimit të ankesës tuaj nr. ____ regj, datë _____ [*vendoset numri i regjistrimit të ankesës në Zyrën e ILD dhe data*], ka konkluduar se ankesa juaj nuk përmban fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor. Për këtë arsye, bazuar në nenin 122 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është vendosur arkivimi pas verifikimit i ankesës tuaj.

Në mbështetje të nenit 119 pika 4 dhe nenit 122 pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ju lutemi gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi, një kopje të vendimit për arkivimin e ankesës pas verifikimit.

Në përputhje me nenin 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ju keni të drejtë të ankimoni këtë vendim në Këshillin e Lartë Gjyqësor/ të Prokurorisë, brenda 1 jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 18 NJOFTIM I MAGJISTRATIT PËR ARKIVIMIN E ANKESËS
PAS VERIFIKIMIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më,/...../2021

Lënda: Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas verifikimit

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/E nderuar z./znj. [emri i magjistratit],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga ankuesi [vendoset numri i regjistrit të ankesës në Zyrën e ILD dhe data], ka konkluduar se ankesa nuk përmban fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor. Për këtë arsye, bazuar në nenin 122 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është vendosur arkivimi pas verifikimit i ankesës.

Në mbështetje të nenit 122 pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ju lutemi gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi, një kopje të vendimit për arkivimin e ankesës pas verifikimit.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 19 PROJEKT VENDIM PËR FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME NISMË TË ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më..../.....2021

ILD

Miratohet Ndryshohet Kthehet

Dt. ____/____/____

PROJEKT VENDIM

Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit

Në zbatim të nenit 121, nenit 123 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, i ndryshuar, pas shqyrtimit fillestar/verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasit z/znj. (vendoset emri i ankuesit), konstatoj

i. Përmbajtja e ankesës

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për kryerjen e shkeljes disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë] nga ana e gjyqtarit/prokurorit.

Ankuesi ka paraqitur prova në lidhje me shkeljen e pretenduar të gjyqtarit/prokurorit [vendos emrin] për veprimtarinë e tij/saj gjatë ushtrimit të funksionit [ose –shkelje jashtë ushtrimit të funksionit/ për shkak të kryerjes së veprës penale].

ii. Analiza e çështjes

Ankuesi u referohet fakteve që dyshohet se kanë ndodhur [*vendos datën ose periudhën e shkeljes së pretenduar*], brenda afatit të parashkrimit të shkeljeve disiplinore në zbatim të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin). Duke konsideruar se janë plotësuar të gjitha kriteret e parashikuara në nenin 120 të Ligjit për Statusin, ankesa vlerësohet e pranueshme.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës dhe dokumenteve bashkëngjitur, konstatohet se informacioni i paraqitur nga ankuesi, është i mjaftueshëm për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*].

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës dhe dokumenteve bashkëngjitur, është proceduar me verifikimin e saj¹⁸⁶, bazuar në vendimin për verifikim [*vendos numrin dhe datën e këtij vendimi*] për marrjen e dokumenteve shtesë [*vendosen dokumentet e mbledhura gjatë verifikimit*] nga [*vendosen emrat e institucioneve ose të personave, prej të cilëve janë marrë dokumentacionet*]. Nga ky proces verifikimi u saktësua [*përshkrim i shkurtër i të dhënave të saktësuara gjatë verifikimit*].

Nga analiza e të fakteve dhe i gjithë informacioni i paraqitur në ankesë [*dhe verifikimi nëse është kryer*] konstatohet se ka dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore e pretenduar [*vendos llojin e shkeljes dhe dispozitën përkatëse ligjore që e parashikon si të tillë*] mund të jetë kryer nga gjyqtari/prokurori [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatën/Prokurorinë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*].

Si përfundim, i kësaj analize, vlerësohet se ka vend për të nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor të veprimitarisë së gjyqtarit/prokurorit (vendoset *emri i gjyqtarit/prokurorit*), në Gjykatën/Prokurorinë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*], duke urdhëruar mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme që hedhin dritë mbi faktet e pretenduara në ankesë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 123 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar propozoj:

186 Ky paragraf është opsional në rast se ILD ka proceduar me verifikimin e ankesës.

iii. Propozime

1. Fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*].

2. Për qëllim të hetimit disiplinor, të merren në Gjykatën/Prokurorinë/Keshillit/Institucionin shtetëror/Personin juridik privat përkatës [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë//Keshillit/institucionit/personit juridik privat përkatës*] dokumentacioni që lidhet me (të evidentohet dokumentacioni i nevojshëm që do të kërkohet gjatë hetimit disiplinor).

3. Për efekt të hetimit disiplinor të evidentohet çdo e dhënë që lidhet me përmbajtjen e ankesës, si dhe të dhënat që tregojnë shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit/prokurorit, apo të dhëna për vlerësimin e tij profesional. Për këtë qëllim të merren kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e hetimit, si dhe të merren shpjegime nga gjyqtari/prokurori, sekretaria gjyqësore, kryetari i gjykatës/drejtuesi i prokurorisë, si dhe çdo subjekt tjetër që mund të ketë dijeni për rrethanat e hetimit.

4. Të njoftohet ankuesi si dhe magjistrati (*vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit*), së Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete*], për vendimin e fillimit të hetimit disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

INSPEKTOR
[emri mbiemri]

**SF 20 VENDIM PËR KTHIMIN E PROJEKT VENDIMIT PËR
FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME NISMË TË ANKUESIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

VENDIM

**“Për kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës
nr. _____, datë _____ “Për fillimin e hetimit disiplinor me
nismë të ankuesit”**

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit të datës [vendos datën e projekt vendimit], lëshuar nga inspektori [emri i inspektorit], propozohet fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore të pretenduar [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë], pas një ankese të paraqitur nga [vendos emrin e ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD].

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës dhe dokumenteve bashkëngjitur, konstatohet se informacioni i paraqitur nga ankuesi [ose fakteve dhe rrethanave të vërtetuara nga inspektori] nuk krijon dyshimin e arsyeshëm për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [vendos emrin] të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë].

Vendoset arsyetimi në rast kthimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së

sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Kthimin e projekt vendimit të inspektorit [*emri i inspektorit*], lëshuar me datë [*vendos datën e projekt vendimit*], për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*].

2. Inspektori përgjegjës të bëjë plotësimet dhe/ose korrigjimet përkatëse në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim dhe t'i paraqesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë projekt vendimin e rishikuar brenda [*vendos afatin duke konsideruar edhe afatet e parashikuara nga neni 118 i Ligjit për Statusin*].

3. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 21 VENDIM PËR NDRYSHIMIN E PROJEKT VENDIMIT PËR
FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NISMË TË ANKUESIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

**Për ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr.
_____ prot, datë _____ “Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të
ankuesit”**

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit të datës [*vendos datën e projekt vendimit*], lëshuar nga inspektori [*emri i inspektorit*], propozohet fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*], pas një ankese të paraqitur nga [*vendos emrin e ankuesit*], me nr. datë [*vendoset numri i regjistrit të ankesës në ILD*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar të ankesës/verifikimit të ankesës, vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast ndryshimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Ndryshimin e projekt vendimit të nxjerrë nga inspektori [*vendos emrin e inspektorit*], me datë [*vendos datën e projekt vendimit*], për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*] dhe vijimin e procedurës për arkivimin/verifikimin e ankesës (nëse verifikimi nuk është kryer përpara se të propozohet fillimi i hetimit disiplinor).

2. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 22 VENDIM I ILD PËR FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME NISMË TË ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

VENDIM

Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit

Në zbatim të neneve 120, 121, dhe 123 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 204, pika 1, shkronja “j” dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, bazuar në projektvendimin nr. _____, datë _____, të inspektorit përgjegjës;

KONSTATOJ

Ankesa e paraqitur nga [vendoset emri i ankuesit], me nr. datë [vendoset numri i regjistrimit të ankesës në ILD] ngre pretendime për veprimtarinë e magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendoset pretendimi konkret, në lidhje me ushtrimin e funksionit, jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së veprës penale].

Konkretisht, ai pretendon për shkelje disiplinore [vendosen faktet dhe rrethanat e pretenduara nga ankuesi].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të parimit të ligjshmërisë si organ kompetent në ushtrim të funksioneve të tij ligjore ka analizuar (vendoset faktet dhe rrethanat e marra në shqyrtim nga ILD) me qëllim identifikimin e elementeve juridike si dhe fakteve apo rrethanave, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor. Në rastin konkret, dyshimi i arsyeshëm nënkupton ekzistencën e atyre elementeve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit të shqyrtuara e vlerësuara në tërësi, të cilat në bazë të gjendje të logjikshme dhe të paanshme i krijojnë bindjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi ekzistencën e një veprimi/

mosveprimi apo sjellje të magjistratit e cila parashikohet si shkelje disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj si dhe në kohën e konstatimit të saj, shkelja disiplinore mund të jetë kryer dhe se kjo shkelje është kryer nga magjistrati ndaj të cilit do të nisë hetimi disiplinor.

Nga analiza e të fakteve dhe i gjithë informacion i paraqitur në ankesë [dhe verifikimi¹⁸⁷ nëse është kryer] konstatohet se ka dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore e pretenduar [vendos llojin e shkeljes dhe dispozitën përkatëse ligjore që e parashikon si të tillë] mund të jetë kryer nga gjyqtari/prokurori [emri i gjyqtarit/prokurorit], në Gjykatën/Prokurorinë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse].

Si përfundim, i kësaj analize, vlerësohet se ka vend për të nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor të veprimtarisë së gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], në Gjykatën/Prokurorinë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse], duke urdhëruar mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme që hedhin dritë mbi faktet e pretenduara në ankesë, që lidhen me hetimin e shkeljes disiplinore të parashikuar (vendosen referencat përkatëse ligjore që parashikojnë shkeljen disiplinore).

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 120, 123, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë].
2. Hetimi disiplinor të kryhet nga inspektori/inspektorët [emrat e inspektorëve].
3. Për qëllim të hetimit disiplinor, inspektori/ët [emrat e inspektorëve] të administrojnë provat, dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë, gjykata/prokuroria/institucionet shtetërore/personat juridik privat.
4. Për qëllim të hetimit disiplinor, inspektori/ët [emrat e inspektorëve] të paraqiten në Gjykatën/Prokurorinë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për mbledhjen e provave të nevojshme.

187 Të vendoset nëse është kryer verifikimi

5. Për efekt të hetimit disiplinor të evidentohet çdo e dhënë që lidhet me përmbajtjen e ankesës, si dhe të dhënat që tregojnë shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit/prokurorit, apo të dhëna për vlerësimin e tij profesional. Për këtë qëllim të merren kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e hetimit, si dhe të merren shpjegime nga gjyqtari/prokurori, sekretarja gjyqësore, kryetari i gjykatës/drejtuesi i prokurorisë, si dhe çdo subjekt tjetër që mund të ketë dijeni për rrethanat e hetimit.

6. Inspektori/ët t'i bëjnë me dije gjyqtarit/prokurorit [emri] të gjitha të drejtat që ai gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të Ligjit për Statusin, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

7. Ngarkohet inspektori/ët [vendosen emrat e inspektorëve] të përfundojnë hetimin disiplinor dhe të hartojnë raportin përfundimtar brenda [vendos afatin në përputhje me nenin 118 të Ligjit për statusin] nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Raporti i hetimit të nënshkruhet nga inspektori/ët që janë ngarkuar me hetimin disiplinor. Arsyetimi i raportit të hetimit të bëhet nga inspektori [vendoset emri i inspektorit që relaton].

8. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet ankuesit [emri i ankuesit], gjyqtarit/prokurorit [emri] dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, brenda pesë ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 23 NJOFTIM I ANKUESIT PËR FILLIMIN E HETIMIT
DISIPLINOR ME NISMËN E ANKUESIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

Lënda: Njoftim mbi vendimin e fillimit të hetimit disiplinor me nismën e ankuesit

Z./Znj. (Emri i ankuesit)

(Adresa e ankuesit)

I/E nderuar z./znj. [*emri i ankuesit*],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), pas shqyrtimit fillestar/verifikimit të ankesës tuaj nr. ____ regj, datë ____ [*vendoset numri i regjistrit të ankesës në Zyren e ILD dhe data*], ka konkluduar se ankesa përmban dyshime të arsyeshme se shkelja e pretenduar disiplinore mund të jetë kryer. Për këtë arsye, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor me nismën e ankuesit bazuar në nenin 123, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 119 pika 4 dhe nenit 123 pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ju lutem gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi, një kopje të vendimit për fillimin e hetimit disiplinor.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 24 NJOFTIM MAGJISTRATIT PËR FILLIMIN E HETIMIT
DISIPLINOR ME NISMËN E ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. ____ Prot.

Tiranë më,/..../2021

Lënda: Njoftim për fillimin e hetimit disiplinor me nismën e ankuesit dhe të drejtat e magistratit

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret],

Në zbatim të nenit 123 dhe 129 të ligjit të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë ____ ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj jush, për shkelje disiplinore [vendos shkeljen dhe dispozitën ligjore përkatëse].

Në zbatim të nenit dhe 123 pika 3 shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ju keni të drejtë të dorëzoni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo parashitje apo dokument mbështetës brenda tre javëve nga marrja dijani për këtë vendim.

Bashkëlidhur gjeni një kopje të vendimit për fillimin e hetimit disiplinor dhe Aktin e njoftimit (në 2 kopje), në të cilin ju bëhen të njohura edhe të drejtat që ju gëzoni përgjatë këtij hetimi disiplinor. Një kopje e këtij akti njoftimi, pas nënshkrimit të plotë të tij, të ridërgohet menjëherë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rezultatet e përfundimit të këtij procesi e drejta juaj për akses në dosjen e hetimit do t’ju komunikohen zyrtarisht.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 25 NJOFTIM I KËSHILLIT PËR FILLIMIN E HETIMIT
DISIPLINOR ME NISMËN E ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Njoftim vendimi për fillimin e hetimit disiplinor

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR/KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË

Adresa:

Tiranë

I/E nderuar Z/Znj,

Në mbështetje të nenit 123, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bashkëlidhur po ju njoftojmë Vendimin nr. _____, datë _____, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 26 AKTI I NJOFTIMIT TË TË DREJTAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

AKT NJOFTIMI

Në zbatim të neneve 123 dhe 129, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ju njofton:

Vendimin nr. _____, datë _____ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit”, për shkelje disiplinore të parashikuar nga [vendoset dispozita e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar që e parashikon si të tillë].

Në zbatim të neneve 123 dhe 129 si dhe vendimit nr. _____ prot, datë _____ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ju bëjmë me dije edhe të drejtat që ju gëzoni përgjatë këtij hetimi disiplinor:

1. Të përfaqësoheni vetë, ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Aksesi në dosjen e hetimit, duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.
3. Të dorëzoni parashtresë dhe dokumente mbështetëse brenda tre javëve nga marrja e njoftimit të këtij vendimi të fillimit të hetimit disiplinor.
4. Të kërkonti të dakordësoni marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që ju atribuohet.
5. Të drejtën të njoftoheni për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor.
6. Të ushtroni të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve të njoftuara, për

të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

Data e marrjes dijeni _____/_____/_____

Magjistrati

(Emër, Mbiemër, nënshkrim)

SF 27 PROJEKT VENDIM PËR FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME INICIATIVË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më..../.....2021

ILD

Miratohet Ndryshohet Kthehet

Dt. ____/____/_____

PROJEKT VENDIM Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë

Në zbatim të neneve 120, 121, 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, konstatoj

ii. Përmbajtja e informacionit

Në datën [vendos datën kur u mor informacioni nga ILD], Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori dijeni mbi disa të dhëna thelbësore që lidhen me veprimtarinë e gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse]. Këto të dhëna u paraqiten nga [vendos burimin e informacionit, media, deklaratë publike, ankesë anonime etj.].

Burimi i informacionit [media, deklaratë publike, ankesë anonime etj.] paraqet të dhëna të besueshme mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jetë kryer shkelje disiplinore nga gjyqtari/prokurori [emri i gjyqtarit/prokurorit] në lidhje me çështjen gjyqësore nr../ aktin e prokurorisë nr. date [vendosen atributet e çështjes] ose [vendos pretendimet nëse të dhënat u referohen veprimtarisë jashtë funksionit ose për shkak të kryerjes së një vepre penale].

iii. Analiza e çështjes

Pas shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit të informacionit, u procedua me verifikimin e tij¹⁸⁸, bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit për verifikim] për marrjen e dokumenteve shtesë [vendosen dokumentet e mbledhura gjatë verifikimit] nga [vendosen emrat e institucioneve ose të personave, prej të cilëve janë marrë dokumentacionet]. Nga ky proces verifikimi u saktësua [përshkrim i shkurtër i të dhënave të saktësuara gjatë verifikimit].

Këto të dhëna u referohen fakteve të ndodhura me datë [vendos datën ose periudhën e shkeljes], brenda afatit të parashkrimit për hetimet disiplinore siç parashikohet në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Faktet lidhen me veprimtarinë e gjyqtarit/prokurorit në detyrë në momentin kur shkelja mund të jetë kryer.

Analiza e fakteve dhe rrethanave të verifikuara konfirmojnë dyshimet se shkelja disiplinore [vendos një përshkrim të shkurtër të shkeljes disiplinore konkrete dhe dispozitën ligjore që e parashikon si të tillë] mund të jetë kryer nga gjyqtari/prokurori [emri i gjyqtarit/prokurorit], i Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse].

Si përfundim, i kësaj analize, vlerësohet se ka vend për nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor të veprimtarisë së gjyqtarit/prokurorit (vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit), në Gjykatën/Prokurorinë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse], duke urdhëruar mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme që hedhin dritë mbi faktet e pretenduara në informacionin e paraqitur nga (vendoset burimi i informacionit).

Për sa më lart, bazuar në nenin 123 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar propozoj:

iv. Propozime

1. Fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë].

2. Për qëllim të hetimit disiplinor, të merren në Gjykatën/Prokurorinë/ Keshillat/Institucionin/ Shtetëror/Personin juridik privat përkatës

¹⁸⁸ Ky paragraf vendoset vetëm në rast se ILD ka proceduar me verifikimin e informacionit të marrë.

[vendoset emri i gjykatës/prokurorisë/keshillat/institucionit shteteror/personit juridik privat përkatës] dokumentacioni që lidhet me (të evidentohet dokumentacioni i nevojshëm që do të kërkohet gjatë hetimit disiplinor).

3. Për efekt të hetimit disiplinor të evidentohet çdo e dhënë që lidhet me përmbajtjen e ankesës, si dhe të dhënat që tregojnë shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit/prokurorit, apo të dhëna për vlerësimin e tij profesional. Për këtë qëllim të merren kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e hetimit, si dhe të merren shpjegime nga gjyqtari/prokurori, sekretarja gjyqësore, kryetari i gjykatës/drejtuesi i prokurorisë, si dhe çdo subjekt tjetër që mund të ketë dijeni për rrethanat e hetimit.

4. Të njoftohet magjistrati (vendoset emri i gjyqtarit/prokurorit), së Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë konkrete], për vendimin e fillimit të hetimit disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

INSPEKTOR
[emri mbiemri]

SF 28 VENDIM PËR KTHIMIN E PROJEKT VENDIMIT PËR
FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME INICIATIVË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

VENDIM

**“Për kthimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës
nr. _____, datë _____ “Për fillimin e hetimit disiplinor me
iniciativë””**

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja “b” ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit të datës [vendos datën e projekt vendimit], lëshuar nga inspektori [emri i inspektorit], propozohet fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore të pretenduar [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë].

Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të parashtruara nga inspektori në projekt vendim, nuk krijohet dyshim i arsyeshëm për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [vendos emrin] të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë].

Vendoset arsyetimi në rast kthimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7 shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 214 pika 7 shkornja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Kthimin e projekt vendimit të inspektorit [*emri i inspektorit*], lëshuar me datë [*vendos datën e projekt vendimit*], për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*].

2. Inspektori përgjegjës të bëjë plotësimet dhe/ose korrigjimet përkatëse në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim dhe t'i paraqesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë projekt vendimin e rishikuar brenda [*vendos afatin duke konsideruar edhe afatet e parashikuara nga neni 118 i Ligjit për Statusin*].

3. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 29 VENDIM PËR NDRYSHIMIN E PROJEKT VENDIMIT PËR
FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME INICIATIVË**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më..../.....2021

V E N D I M

**Për ndryshimin e projekt vendimit të inspektorit përgjegjës nr. _____
prot, datë _____ "Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë"**

Në zbatim të neneve 120, 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 214 pika 7 shkronja "c" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

KONSTATOJ

Në bazë të projekt vendimit të datës [*vendos datën e projekt vendimit*], lëshuar nga inspektori [*emri i inspektorit*], propozohet fillimi i hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas shqyrtimit fillestar/verifikimit të informacionit të paraqitur nga [*media, deklaratë publike, ankesë anonime etj*], vlerëson për sa më poshtë:

Vendoset arsyetimi në rast ndryshimi, në përputhje me parashikimet e nenit 214 pika 7, shkronja "c" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

_____.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 214 pika 7, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar

VENDOSA

1. Ndryshimin e projekt vendimit të nxjerrë nga inspektori [*vendos emrin e inspektorit*], me datë [*vendos datën e projekt vendimit*], për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore të pretenduar [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*] dhe vijimin e procedurës për arkivimin/verifikimin e rastit (nëse verifikimi nuk është kryer përpara se të propozohet fillimi i hetimit disiplinor.

2. Ngarkohet inspektori përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 30 VENDIM ILD PËR FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME INICIATIVË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

VENDIM

Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë

Në zbatim të neneve 120, 121, 123 dhe 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 204 pika 1 shkronja “j”, nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, bazuar në projektvendimin nr. _____, datë _____, të inspektorit përgjegjës;

KONSTATOJ

Informacioni i paraqitur nga [*media, deklaratë publike, ankesë anonime etj.*] paraqet të dhëna të besueshme mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jetë kryer shkelje disiplinore [*vendoset pretendimi konkret, në lidhje me ushtrimin e funksionit, jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së veprës penale*]nga gjyqtari/prokurori [*emri i gjyqtarit/prokurorit*].

Nga vlerësimi i kushteve të pranueshmërisë së ankesës të përcaktuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet si më poshtë (vlerësohen të gjitha kriteret e pranueshmërisë të parashikuara nga neni 120 i ligjit për Statusin).

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të parimit të ligjshmërisë si organ kompetent në ushtrim të funksioneve të tij ligjore ka analizuar (vendoset faktet dhe rrethanat e marra në shqyrtim nga ILD) me qëllim identifikimin e elementeve juridike si dhe fakteve apo rrethanave, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor. Në rastin konkret, dyshimi i arsyeshëm nënkupton ekzistencën

e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit të shqyrtuara e vlerësuara në tërësi, të cilat në bazë të gjendje të logjikshme dhe të paanshme i krijojnë bindjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi ekzistencën e një veprimi/mosveprimi apo sjellje të magjistratit e cila parashikohet si shkelje disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj si dhe në kohën e konstatimit të saj, shkelja disiplinore mund të jetë kryer dhe se kjo shkelje është kryer nga magjistrati ndaj të cilit do të nisë hetimi disiplinor.

Nga analiza e fakteve, rrethanave dhe i gjithë informacion i paraqitur në ankesë [*dhe verifikimi*¹⁸⁹ nëse është kryer] konstatohet se ka dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore e pretenduar [*vendos llojin e shkeljes dhe dispozitën përkatëse ligjore që e parashikon si të tillë*] mund të jetë kryer nga gjyqtari/prokurori [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatën/Prokurorinë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*].

Si përfundim, i kësaj analize, vlerësohet se ka vend për të nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor të veprimitarisë së gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], në Gjykatën/Prokurorinë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*], duke urdhëruar mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme që hedhin dritë mbi faktet e pretenduara në ankesë, që lidhen me hetimin e shkeljes disiplinore të parashikuar (vendosen referencat përkatëse ligjore që parashikojnë shkeljen disiplinore).

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 120, 123 dhe 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për shkeljen disiplinore [*vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë*].
2. Hetimi disiplinor të kryhet nga inspektori/inspektorët [*emrat e inspektorëve*].
3. Për qëllim të hetimit disiplinor, inspektori/ët [*emrat e inspektorëve*] të administrojnë provat, dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë, gjykata/prokuroria/institucionet shtetërore/personat juridik privat.

189 Të vendoset nëse është kryer verifikimi

4. Për qëllim të hetimit disiplinor, inspektori/ët [*emrat e inspektorëve*] të paraqiten në Gjykatën/Prokurorinë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] për mbledhjen e provave të nevojshme.

5. Për efekt të hetimit disiplinor të evidentohet çdo e dhënë që lidhet me përmbajtjen e ankesës, si dhe të dhënat që tregojnë shkelje me pasojë përgjegjësine disiplinore të gjyqtarit/prokurorit, apo të dhëna për vlerësimin e tij profesional. Për këtë qëllim të merren kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e hetimit, si dhe të merren shpjegime nga gjyqtari/prokurori, sekretarja gjyqësore, kryetari i gjykatës/drejtuesi i prokurorisë, si dhe çdo subjekt tjetër që mund të ketë dijeni për rrethanat e hetimit.

6. Inspektori/ët t'i bëjnë me dije gjyqtarit/prokurorit [*emri*] të gjitha të drejtat që ai gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të Ligjit për Statusin, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

7. Ngarkohet inspektori/ët [*vendosen emrat e inspektorëve*] të përfundojnë hetimin disiplinor dhe të hartojnë raportin përfundimtar brenda [*vendos afatin në përputhje me nenin 118 të Ligjit për statusin*] nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Raporti i hetimit të nënshkruhet nga inspektori/ët që janë ngarkuar me hetimin disiplinor. Arsyetimi i raportit të hetimit të bëhet nga inspektori [*vendoset emri i inspektorit që relaton*].

8. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet ankuesit [*emri i ankuesit*], gjyqtarit/prokurorit [*emri*], Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda pesë ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 31 NJOFTIM PËR FILLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR ME INICIATIVË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më,/...../2021

Lënda: Njoftim për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë dhe të drejtat e magistratit

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret],

Në zbatim të neneve 123, 124 dhe 129 të ligjit të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë _____ ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj jush, për shkelje disiplinore [vendos shkeljen dhe dispozitën ligjore përkatëse].

Në zbatim të nenit 124 pika 3 dhe 123 pika 3 shkronja "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ju keni të drejtë të dorëzoni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo parashtrëse apo dokument mbështetës brenda tre javëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

Bashkëlidhur gjeni një kopje të vendimit për fillimin e hetimit disiplinor dhe Aktin e njoftimit (në 2 kopje), në të cilin ju bëhen të njohura edhe të drejtat që ju gëzoni përgjatë këtij hetimi disiplinor. Një kopje e këtij akti njoftimi, pas nënshkrimit të plotë të tij, të ridërgohet menjëherë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultatet e përfundimit të këtij procesi e drejta juaj për akses në dosjen e hetimit do t'ju komunikohen zyrtarisht.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 32 NJOFTIM I KËSHILLIT PËR FILLIMIN E HETIMIT
DISIPLINOR ME INICIATIVË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

Lënda: Njoftim vendimi për fillimin e hetimit disiplinor

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR/KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË

Adresa:

Tiranë

I/E nderuar Z/Znj,

Në mbështetje të nenit 123, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bashkëlidhur po ju njoftojmë Vendimin nr. _____, datë _____, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 33 AKTI I NJOFTIMIT TË TË DREJTAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

AKT NJOFTIMI

Në zbatim të neneve 123, 124 dhe 129, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ju njofton:

Vendimin nr. _____, datë _____ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë", për shkelje disiplinore të parashikuar nga [vendoset dispozita e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar që e parashikon si të tillë].

Në zbatim të neneve 123, 124 dhe 129 si dhe vendimit nr. _____ prot, datë _____ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ju bëjmë me dije edhe të drejtat që ju gëzoni përgjatë këtij hetimi disiplinor:

1. Të përfaqësoheni vetë, ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Aksesi në dosjen e hetimit, duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.
3. Të dorëzoni parashtresë dhe dokumente mbështetëse brenda tre javëve nga marrja e njoftimit të këtij vendimi të fillimit të hetimit disiplinor.
4. Të kërkonti të dakordësoni marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që ju atribuohet.
5. Të drejtën të njoftoheni për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor.
6. Të ushtroni të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve të njoftuara, për

të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

Data e marrjes dijeni _____/_____/_____

Magjistrati

(Emër, Mbiemër, nënshkrim)

SF 34 RELACION PËR ZGJATJEN E AFATIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

RELACION

Për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor

Bazuar në nenin 118 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse], konstatoj,

i. Përmbajtja e informacionit

Në zbatim të Vendimit [vendos numrin dhe datën e vendimit], ka filluar hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] bazuar në ankesën [vendos ankuesin dhe atributet e ankesës] ose me iniciativë të ILD-së. Objekti i hetimit lidhet me dyshime të arsyeshme për pretendimin e shkeljes disiplinore [vendos shkeljen disiplinore konkrete dhe dispozitën që e parashikon si ë tillë, siç parashtrohet në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Në zbatim të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor [vendos numrin dhe datën e vendimit], janë kryer këto veprime hetimore: [jepen argumentet në lidhje me veprimet hetimore të kryera deri në atë kohë sipas planifikimit të tilla si: një përmbledhje të shkurtër të personave të pyetur, të provave të marra, si dhe çdo vendim¹⁹⁰ të marrë gjatë hetimit, nëse ato reflektojnë arsyetimin e zgjatjes

190 Për shembull, vendimet për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit do të ishin një prej shkaqeve të zgjatjes së afatit të hetimit dhe ata duhet të përfshihen në arsyetimin e këtij Vendimi. Data e nxjerrjes së Vendimit për zgjerimin ose ndryshimin e objektit të hetimit dhe raporti ndërmjet kësaj date dhe pjesës së mbetur të afatit të hetimit të përcaktuar fillimisht me vendimin për fillimin e hetimit disiplinor mund të jetë justifikim

së afatit të hetimit, vendosni faktet e tjera¹⁹¹ që janë marrë gjatë hetimit dhe reflektoni mbi arsyetimin e zgjatjes së afatit të hetimit për shkak të:

- kompleksiteti i çështjes, e cila kërkon veprime hetuese shtesë;
- shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit, e cila kërkon hetime të reja;
- sëmundja e magjistratit nën hetim; ose
- pamundësia e magjistratit nën hetim, për të qenë i pranishëm gjatë periudhës së përcaktuar fillimisht për hetim dhe marrja e tij/saj në pyetje është thelbësore për vijimësinë dhe përfundimin e hetimit.

ii. Analiza e çështjes

Duke analizuar këto të dhëna konstatohet se brenda afatit të hetimit të përcaktuar fillimisht në Vendim [vendos afatin e përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor], që përfundon më [vendos datën kur përfundon afati] janë planifikuar dhe kryer pjesa më e madhe e veprimeve hetimore¹⁹².

Afati i hetimit disiplinor përfundon më [vendosni pjesën e mbetur të afatit të hetimit]. Por, për të konkluduar mbi objektin e hetimit, duhet të kryhen edhe disa veprime të tjera hetimore, që janë [vendosni pjesën e mbetur të veprimeve hetimore¹⁹³].

Pjesa e mbetur e afatit të hetimit nuk është e mjaftueshme për të përmbushur veprimet hetimore të mbetura dhe për të përfunduar hetimin disiplinor. Ky konkluzion lidhet me faktin se [vendosni shkaqet që duhet të jenë në pajtim me një prej shkaqeve ligjore të parashikuara nga Neni 118, pika 3 - kompleksiteti i çështjes, që kërkon veprime të mëtejshme hetimore (1), sëmundja e magjistratit nën hetim (2) ose mosqenia i disponueshëm nga ana e magjistratit nën hetim (3) për të qenë i pranishëm gjatë periudhës së përcaktuar fillimisht për hetimin dhe marrja e tij/saj në pyetje është thelbësore për vazhdimin dhe përfundimet e hetimit].

iii. Propozime

Bazuar në nenin 118 pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, propozoj:

i mjaftueshëm për zgjatjen e afatit të ankimit.

191 Faktet e tjera mund të jenë për shembull: sëmundja e magjistratit nën hetim e provuar me një dokument mjekësor të lëshuar nga institucioni përkatës shëndetësor që ka në trajtim magjistratin që nuk e ka lejuar atë të jetë i/e pranishëm gjatë hetimit dhe për tu intervistuar; pamundësia e magjistratit për të qenë i pranishëm gjatë hetimit duke qenë i provuar me dokument zyrtar që tregon cilat janë shkaqet konkrete të mungesës së magjistratit - për shembull: pjesëmarrja në një trajnim jashtë shtetit për një kohë të gjatë.

192 Ky deklaram është i rëndësishëm me qëllim që të jetë e qartë që inspektori përgjegjës i ka përmbushur detyrimet e tij/saj në përputhje me ligjin.

193 Për shembull: intervistat, marrja e informacionit shtesë, verifikimi i dokumenteve, ekspertiza, etj.

1. Zgjatjen me [vendos deri në 3 muaj] muaj të tjerë të afatit të hetimit disiplinor të filluar nëpërmjet Vendimit [vendos numrin dhe datën e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor] ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse].

2. Afati i zgjatur i hetimit përfundon me datë [vendos datën kur përfundon afati i zgjatur].

3. Inspektorët përgjegjës [vendos emrat e inspektorëve], duhet – brenda periudhës së hetimit – të kryejnë veprimet e mëtejshme hetimore [vendos nëse duhen kryer veprime hetimore të tjera nga ato që janë parashtruar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

4. Të njoftohet ankuesi [emri i ankuesit nëse hetimi ka filluar bazuar në ankesë], gjyqtari/prokurori [emri] dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, për rezultatet e mësipërme.

INSPEKTOR

[emri mbiemri]

SF 35 VENDIM PËR ZGJATJEN E AFATIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../.....2021

VENDIM

Për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor

Bazuar në nenin 118 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] si dhe relacionit nr. __, datë __, të inspektorit përgjegjës ku propozohet zgjatja e afatit të hetimit disiplinor,

KONSTATOJ

Në zbatim të Vendimit [vendos numrin dhe datën e vendimit], ka filluar hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] bazuar në ankesën [vendos ankuesin dhe atributet e ankesës] ose me iniciativë të ILD-së. Objekti i hetimit lidhet me dyshime të arsyeshme për pretendimin e shkeljes disiplinore [vendos shkeljen disiplinore konkrete dhe dispozitën që e parashikon sit ë tillë, siç parashtrohet në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Në zbatim të Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor [vendos numrin dhe datën e vendimit], janë kryer këto veprime hetimore: [jepen argumentet në lidhje me veprimet hetimore të kryera deri në atë kohë sipas planifikimit të tilla si: një përmbledhje të shkurtër të personave të pyetur, të provave të marra, si dhe çdo vendi të marrë gjatë hetimit, nëse ato reflektojnë arsyetimin e zgjatjes së afatit të hetimit, vendosni faktet e tjera që janë marrë gjatë hetimit dhe reflektoni mbi arsyetimin e zgjatjes së afatit të hetimit]. Duke analizuar këto të dhëna konstatohet se brenda afatit të hetimit disiplinor të përcaktuar fillimisht në Vendim [vendos afatin e përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor], që përfundon më [vendos datën kur përfundon afati] janë planifikuar dhe kryer pjesa më e madhe e veprimeve hetimore¹⁹⁴.

194 Ky deklaram është i rëndësishëm me qëllim që të jetë e qartë që inspektorit përgjegjës

Afati i hetimit disiplinor përfundon më [vendosni pjesën e mbetur të afatit të hetimit]. Por, për të konkluduar mbi objektin e hetimit, duhet të kryhen edhe disa veprime të tjera hetimore, që janë [vendosni pjesën e mbetur të veprimeve hetimore¹⁹⁵].

Pjesa e mbetur e afatit të hetimit nuk është e mjaftueshme për të përmbushur veprimet hetimore të mbetura dhe për të përfunduar hetimin disiplinor. Ky konkluzion lidhet me faktin se [vendosni shkaqet që duhet të jenë në pajtim me një prej shkaqeve ligjore të parashikuara nga Neni 118, pika 3 - kompleksiteti i çështjes, që kërkon veprime të mëtejshme hetimore (1), sëmundja e magjistratit nën hetim (2) ose mosqenia i disponueshëm nga ana e magjistratit nën hetim (3) për të qenë i pranishëm gjatë periudhës së përcaktuar fillimisht për hetimin dhe marrja e tij/saj në pyetje është thelbësore për vazhdimin dhe përfundimet e hetimit].

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 118 pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar:

VENDOSA:

1. Zgjatjen me [vendos deri në 3 muaj] muaj të tjerë të afatit të hetimit disiplinor të filluar nëpërmjet Vendimit [vendos numrin dhe datën e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor] ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse].
2. Afati i zgjatur i hetimit përfundon me datë [vendos datën kur përfundon afati i zgjatur].
3. Inspektorët përgjegjës [vendos emrat e inspektorëve], duhet – brenda periudhës së hetimit – të kryejnë veprimet e mëtejshme hetimore [vendos nëse duhen kryer veprime hetimore të tjera nga ato që janë parashtruar në vendi].
4. Inspektorët përgjegjës të përfundojnë raportin e hetimit disiplinor brenda [vendos datën, duke pasur parasysh edhe kohën e nevojshme për shqyrtimin e raportit].
5. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet ankuesit [emri i ankuesit nëse hetimi ka filluar bazuar në ankesë], gjyqtarit/prokurorit [emri] dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË

i ka përmbushur detyrimet e tij/saj në përputhje me ligjin dhe vonesa e hetimit nuk është për shkak të sjelljes së papërshtatshme të tij/saj.

195 Për shembull: intervistat, marrja e informacionit shtesë, verifikimi i dokumenteve, ekspertiza, etj.

SF 36 NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT TË HETIMIT ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

Lënda: Njoftim mbi vendimin zgjatjes së afatit të hetimit disiplinor me nismën e ankuesit¹⁹⁶

Z./Znj. (Emri i ankuesit)

(Adresa e ankuesit)

I/E nderuar z./znj. [*emri i ankuesit*],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 118 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. _____, datë _____ (vendoset numri dhe data e vendimit) “Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit”.

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

¹⁹⁶ Ky format standard është i aplikueshëm vetëm në rastin e hetimit disiplinor të filluar me nismë të ankuesit.

SF 37 NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT TË HETIMIT
MAGJISTRATIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë më,/...../2020

Lënda: Njoftim për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret],

Në zbatim të nenit 118 pika 3 të ligjit të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë _____ ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. ____, datë _____ (vendoset numri, data dhe titulli i vendimit).

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 38 NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT TË HETIMIT
KËSHILLAVE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. ____ Prot.

Tiranë më,/...../2020

Lënda: Njoftim për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor

Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë

I/E nderuar Z./Znj. [*emri i Kryetarit/s Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë*]

Në zbatim të nenit 118 pika 3 të ligjit të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë ____ ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. ____, datë ____ (vendoset numri dhe data e vendimit dhe titulli i vendimit).

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 39 RELACION PËR RIÇELJEN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

RELACION

Për riçeljen e hetimit disiplinor

Në zbatim të nenit 118, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

i. Përmbajtja e informacionit

Në zbatim të Vendimit [*vendos numrin dhe datën e vendimit*], ka filluar hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] bazuar në ankesën [*vendos ankuesin dhe atributet e ankesës*] ose me iniciativë të ILD-së.

Objekti i hetimit disiplinor, lidhet me dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore e parashikuara në [*vendos shkeljen disiplinore konkrete dhe dispozitën që e parashikon sit ë tillë, siç parashtrohet në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor*] mund të jetë kryer. Periudha e hetimit e përcaktuar në Vendimin nr. __, datë _____ “Për fillimin e hetimit disiplinor” [*vendos afatin e përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor*] ishte brenda [*vendos afatin*] muajsh¹⁹⁷ dhe përfundoi më [*vendos datën kur përfundoi afati*].

ii. Analiza e çështjes

Pas kalimit të afateve të hetimit disiplinor, jemi vënë të dijeni të provave të reja të cilat mund të ndryshojnë përfundimet e hetimit. Prova të reja në lidhje me të njëjtën shkelje disiplinore të pretenduar, u vunë në

197 Fjalja e mëposhtme është opsionale, në varësi të hetimit konkret të zhvilluar “Hetimi është zgjatur me 3 muaj në pajtim me nenin 118 pika 3 të Ligjit për Statusin me një vendim për zgjatjen e hetimit të nxjerrë më [*vendosni datën*]”.

dispozicion të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹⁹⁸ më datë [vendos datën e marrjes së provave përkatëse – p.sh. të nxjerra nga një institucion, si vendim gjykatë, raport, etj. dhe një përshkrim të shkurtër mbi këto prova]. Pas analizës së provave të reja konstatohet se ka arsye të besueshme se shkelja disiplinore mund të jetë kryer. Nga ana tjetër, konstatohet se afatet e hetimit disiplinor të shkeljes së pretenduar nuk janë parashkruar.

iii. Propozime:

Bazuar në nenin 118 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, propozoj:

1. Riçeljen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për kryerjen e shkeljes disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë].
2. Të njoftohet gjyqtari/prokurori [emri] dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, për rezultatet e mësipërme.

INSPEKTOR
[emri mbiemri]

¹⁹⁸ Duhet të jetë e qartë kur dhe si kanë dalë provat e reja përkatëse për ILD-në dhe pse këto prova mund të ndryshojnë përfundimet e hetimit. Është gjithashtu e rëndësishme të jepet një shpjegim i shkurtër si provat e reja kanë të bëjnë me të njëjtën shkelje që është hetuar gjatë hetimit disiplinor në fjalë.

SF 40 VENDIM PËR RIÇELJEN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.../.....2021

V E N D I M

Për riçeljen e hetimit disiplinor

Në zbatim të nenit 118 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe relacionit nr. __, datë _____, të inspektorit përgjegjës ku propozohet riçelja e hetimit disiplinor,

KONSTATOJ

Në zbatim të Vendimit [*vendos numrin dhe datën e vendimit*], filloi hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], të Gjykatës/Prokurorisë [*vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse*] bazuar në ankesën [*vendos ankuesin dhe atributet e ankesës*] ose me iniciativë të ILD-së. Objekti i hetimit disiplinor, lidhet me dyshime të arsyeshme se shkelja disiplinore e parashikuar [*vendos shkeljen disiplinore konkrete dhe dispozitën që e parashikon si të tillë, siç parashtrohet në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor*] mund të jetë kryer.

Periodha e hetimit e përcaktuar në Vendimin [*vendos afatin e përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor*] ishte brenda [*vendos afatin*] muajsh¹⁹⁹ dhe përfundoi më [*vendos datën kur përfundoi afati*].

Pas kalimit të afateve të hetimit disiplinor, jemi vënë të dijeni të provave të reja të cilat mund të ndryshojnë përfundimet e hetimit.

Prova të reja në lidhje me të njëjtën shkelje disiplinore të pretenduar, u

¹⁹⁹ Fjalja e mëposhtme është opsionale, në varësi të hetimit konkret të zhvilluar “Hetimi është zgjatur me 3 muaj në pajtim me nenin 118 pika 3 të Ligjit për Statusin me një vendim për zgjatjen e hetimit të nxjerrë më [*vendosni datën*]”.

vunë në dispozicion të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë²⁰⁰ më datë [vendos datën e marrjes së provave përkatëse – p.sh. të nxjerra nga një institucion, si vendim gjykate, raport, etj. dhe një përshkrim të shkurtër mbi këto prova]. Pas analizës së provave të reja konstatohet se ka arsye të besueshme se shkelja disiplinore mund të jetë kryer. Nga ana tjetër, konstatohet se afatet e hetimit disiplinor të shkeljes së pretenduar nuk janë parashkuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 118 pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar

VENDOSA

1. Riçeljen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [emri i gjyqtarit/prokurorit], të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për kryerjen e shkeljes disiplinore [vendoset shkelja disiplinore konkrete dhe neni përkatës që e parashikon si të tillë].
2. Inspektorët përgjegjës [vendos emrat e inspektorëve], të kryejnë veprimet e mëtejshme hetimore [vendos veprimet e mëtejshme hetimore që duhet të kryehen pas riçeljes] dhe të përfundojnë raportin e hetimit disiplinor brenda datës _____.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet, gjyqtarit/prokurorit [emri] dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, brenda pesë ditëve nga marrja e këtij vendimi.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

²⁰⁰ Duhet të jetë e qartë kur dhe si kanë dalë provat e reja përkatëse për ILD-në dhe pse këto prova mund të ndryshojnë përfundimet e hetimit. Është gjithashtu e rëndësishme të jepet një shpjegim i shkurtër si provat e reja kanë të bëjnë me të njëjtën shkelje që është hetuar gjatë hetimit disiplinor në fjalë.

SF 41 NJOFTIM PËR RICELJEN E HETIMIT ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2020

Lënda: Njoftim mbi vendimin e riceljes se hetimit disiplinor me nismën e ankuesit²⁰¹

Z./Znj. (Emri i ankuesit)

(Adresa e ankuesit)

I/E nderuar z./znj. [*emri i ankuesit*],

Ju bëjmë me dije se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 118 pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka vendosur riceljen e hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. _____, datë _____ (vendoset numri, data dhe titulli i vendimit).

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për riceljen e hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

201 Ky format standard është i aplikueshëm vetëm në rastin e hetimit disiplinor të filluar me nismë të ankuesit.

SF 42 NJOFTIM PËR RIÇELJEN E AFATIT TË HETIMIT
MAGJISTRATIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. ____ Prot.

Tiranë më, ____/____/2020

Lënda: Njoftim për riceljen e hetimit disiplinor

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret],

Në zbatim të nenit 118 pika 4 të ligjit të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë ____ ka vendosur riceljen e hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. ____, datë ____ (vendoset numri, data dhe titulli i vendimit).

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për riceljen e hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 43 NJOFTIM PËR RICËLJEN E HETIMIT KËSHILLAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. ____ Prot.

Tiranë më,/...../2020

Lënda: Njoftim për riceljen e hetimit disiplinor

Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë

I/E nderuar Z./Znj. [Kryetari/ja Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë]

Në zbatim të nenit 118 pika 4 të ligjit të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. __, datë ____ ka vendosur riceljen e hetimit disiplinor të filluar me vendimin nr. ____, datë ____ (vendoset numri, data dhe titulli i vendimit).

Bashkëlidhur këtij njoftimi, lutem gjeni një kopje të vendimit “Për riceljen të hetimit disiplinor”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 44 RELACION PËR SHTIMIN E OBJEKTIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___2021

RELACION

“Për shtimin e objektit të hetimit disiplinor”

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. Prot [vendos numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], konstatoj

i. Përmbajtja e informacionit

Hetimi disiplinor nr. Prot [vendos Numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës [vendos emrin e gjykatës konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose me iniciativë), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkeljeje disiplinore. Faktet lidhen me veprimtaritë ose sjelljen e magjistratit për [vendos shpjegimin në lidhje me veprimtarinë ose sjelljen e magjistratit e cila është shpjeguar tashmë në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor rezultojnë faktet e mëposhtme: [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara].

ii. Analiza e çështjes

Duke analizuar faktet dhe rrethanat e grumbulluara (parashtrohet në mënyrë të përmbledhur, informacioni i ri, mënyra sesi u sigurua) arrihet në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një shkeljeje tjetër disiplinore që lidhet me [shkrutimisht jepin shpjegime mbi shkeljen tjetër disiplinore dhe referencën ligjore përkatëse].

iii. Propozime

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar propozoj:

1. Shtimin e objektit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të [*vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete*]. Objekti fillestar i hetimit lidhur me [*shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes*] shtohet duke përfshirë edhe hetimin e shkeljes lidhur me [*shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes së re*].

2. Për qëllime të objektit të shtuar të hetimit disiplinor të hetohen faktet e mëposhtme [*vendos faktet specifike që duhet të hetohen në lidhje me shkeljen e re*], duke marrë kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e objektit të shtuar të hetimit, si dhe të merren në pyetje [*përcakto subjektet që duhen pyetur në shtesë të vendimit të fillimit të hetimit disiplinor apo edhe subjektet që duhen ripyetur për faktet shtesë*].

3. Hetimi disiplinor për objektin e shtuar të kryhet nga inspektori përgjegjës për hetimin fillestar, i cili duhet të paraqesë raportin e hetimit disiplinor brenda _____ (*të vendoset afati i përfundimit të hetimit disiplinor sipas objektit të shtuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e nenit 118 pika 3 të ligjit nr.96/2016, i cili përcakton mundësinë e zgjatjes së hetimit edhe me 3 muaj mbi afatin e zakonshëm 6 mujor gjithashtu edhe në rast të një vendimi për shtimin/ndryshimin e objektit të hetimit*).

4. Magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] t’i bëhen me dije të gjitha të drejtat që ai/ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe e drejta për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse për objektin e shtuar të hetimit disiplinor, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

INSPEKTORI
[Emër Mbiemër]

SF 45 VENDIM PËR SHTIMIN E OBJEKTIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2021

VENDIM

“Për shtimin e objektit të hetimit disiplinor”

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. Prot [vendos numrin],, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] dhe relacionin e inspektorit përgjegjës nr. _____, datë _____, ku propozohet shtimi i objektit të hetimit disiplinor,

KONSTATOJ

Hetimi disiplinor nr. Prot [vendos Numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës [vendos emrin e gjykatës konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose me iniciativë), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkeljeje disiplinore. Faktet lidhen me veprimtaritë ose sjelljen e magjistratit për [vendos shpjegimin në lidhje me veprimtarinë ose sjelljen e magjistratit e cila është shpjeguar tashmë në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor rezultojnë faktet e mëposhtme: [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara].

Duke analizuar faktet dhe rrethanat e grumbulluara (parashtrohet në mënyrë të përmbledhur, informacioni i ri, mënyra sesi u sigurua) arrihet në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një shkeljeje

tjetër disiplinore që lidhet me [shkrutimisht jepin shpjegime mbi shkeljen tjetër disiplinore dhe referencën ligjore përkatëse].

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Shtimin e objektit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete]. Objekti fillestar i hetimit lidhur me [shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes] shtohet duke përfshirë edhe hetimin e shkeljes lidhur me [shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes së re].

2. Për qëllime të objektit të shtuar të hetimit disiplinor të hetohen faktet e mëposhtme [vendos faktet specifike që duhet të hetohen në lidhje me shkeljen e re], duke marrë kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e objektit të shtuar të hetimit, si dhe të merren në pyetje [përcakto subjektet që duhen pyetur në shtesë të vendimit të fillimit të hetimit disiplinor apo edhe subjektet që duhen ripyetur për faktet shtesë].

3. Hetimi disiplinor të kryhet nga inspektori përgjegjës për kryerjen e hetimit fillestar disiplinor, i cili duhet të paraqesë raportin e hetimit disiplinor brenda [vendos afatin e ri] nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Inspektori t'i bëjë me dije magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të gjitha të drejtat që ai/ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtrësia dhe dokumente mbështetëse për objektin e shtuar të hetimit disiplinor, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 46 RELACION PËR NDRYSHIMIN E OBJEKTIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

RELACION

“Për ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor”

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. Prot [vendos numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], konstatoj,

i. Përmbajtja e informacionit

Hetimi disiplinor nr. Prot [vendos Numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës [vendos emrin e gjykatës konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose me iniciativë), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkelje disiplinore. Faktet lidhen me veprimtaritë ose sjelljen e magjistratit për [vendos shpjegimin në lidhje me veprimtarinë ose sjelljen e magjistratit e cila është shpjeguar tashmë në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor rezultojnë faktet e mëposhtme: [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara].

ii. Analiza e çështjes

Duke analizuar faktet dhe rrethanat e mbledhura [parashtrihen informacioni i ri, mënyra sesi u sigurua dhe arsye përse këto fakte përbëjnë një shkelje tjetër disiplinore] arrihet në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një shkeljeje të re disiplinore të ndryshme nga ajo për të cilën ka filluar hetimi disiplinor. Rrjedhimisht, objekti fillestar i hetimit

disiplinor ka një shkak të ndryshëm, për të cilin duhet të hetohet dhe të mblidhen prova të reja dhe konkretisht, objekti i hetimit për shkelje disiplinore që lidhet me *[shkurtimisht përmendni shkeljen konkrete të hetimit fillestar]* do të ndryshojë me shkeljen disiplinore *[shkurtimisht shpjegoni shkeljen konkrete dhe referencat ligjore]*.

iii. Propozime

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar propozoj:

1. Ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit *[emri i gjyqtarit/prokurorit]* të *[vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete]*. Objekti fillestar i hetimit lidhur me *[shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes]* ndryshon duke përfshirë hetimin e shkeljes lidhur me *[shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes së re]*.

2. Për qëllime të objektit të ndryshuar të hetimit disiplinor të hetohen faktet e mëposhtme *[vendos faktet specifike që duhet të hetohen në lidhje me shkeljen e re]*, duke marrë kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e objektit të ndryshuar të hetimit, si dhe të merren në pyetje *[përcakto subjektet që duhen pyetur për shkak të objektit të ri, të ndryshëm nga ai i vendimit të fillimit të hetimit disiplinor apo edhe subjektet që duhen ripyetur për faktet e reja]*.

3. Hetimi disiplinor për objektin e ndryshuar të kryhet nga inspektori përgjegjës për hetimin fillestar, i cili duhet të paraqesë raportin e hetimit disiplinor brenda _____ *(të vendoset afati i përfundimit të hetimit disiplinor sipas objektit të ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e nenit 118 pika 3 të ligjit për Statusin, i cili përcakton mundësinë e zgjatjes së hetimit edhe me 3 muaj mbi afatin e zakonshëm 6 mujor gjithashtu edhe në rast të një vendimi për ndryshimin e objektit të hetimit)*.

4. Magjistratit *[emri i gjyqtarit/prokurorit]* t’i bëhen me dije të gjitha të drejtat që ai/ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse për objektin e ndryshuar të hetimit disiplinor, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

INSPEKTORI
[Emër Mbiemër]

SF 47 VENDIM PËR NDRYSHIMIN E OBJEKTIT TË HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2021

VENDIM

“Për ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor”

Bazuar në nenin 125 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. Prot [vendos numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] dhe relacionin e inspektorit përgjegjës nr. _____, datë _____, ku propozohet ndryshimi i objektit të hetimit disiplinor,

KONSTATOJ

Hetimi disiplinor nr. Prot [vendos Numrin], datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës [vendos emrin e gjykatës konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose me iniciativë), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkelje disiplinore. Faktet lidhen me veprimtaritë ose sjelljen e magjistratit për [vendos shpjegimin në lidhje me veprimtarinë ose sjelljen e magjistratit e cila është shpjeguar tashmë në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor].

Nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor rezultojnë faktet e mëposhtme: [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara].

Duke analizuar faktet dhe rrethanat e mbledhura [parashtrohen informacioni i ri, mënyra sesi u sigurua dhe arsye përse këto fakte përbëjnë një shkelje tjetër disiplinore] arrihet në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një shkelje të re disiplinore të ndryshme nga ajo për të

cilën ka filluar hetimi disiplinor. Rrjedhimisht, objekti fillestar i hetimit disiplinor ka një shkak të ndryshëm, për të cilin duhet të hetohet dhe të mblidhen prova të reja dhe konkretisht, objekti i hetimit për shkelje disiplinore që lidhet me [shkurtimisht përmendni shkeljen konkrete të hetimit fillestar] do të ndryshojë me shkeljen disiplinore [shkurtimisht shpjegoni shkeljen konkrete dhe referencat ligjore].

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete]. Objekti fillestar i hetimit lidhur me [shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes] ndryshon duke përfshirë hetimin e shkeljes lidhur me [shpjego shkurtimisht thelbin e shkeljes së re].

2. Për qëllime të objektit të ndryshuar të hetimit disiplinor të hetohen faktet e mëposhtme [vendos faktet specifike që duhet të hetohen në lidhje me shkeljen e re], duke marrë kopje të akteve që dokumentojnë rezultatet e objektit të ndryshuar të hetimit, si dhe të merren në pyetje [përcakto subjektet që duhen pyetur për shkak të objektit të ri, të ndryshëm nga ai i vendimit të fillimit të hetimit disiplinor apo edhe subjektet që duhen ripyetur për faktet e reja].

3. Hetimi disiplinor të kryhet nga inspektori përgjegjës për kryerjen e hetimit fillestar disiplinor, i cili duhet të paraqesë raportin e hetimit disiplinor brenda [vendos afatin e ri] nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Inspektori t’i bëjë me dije magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të gjitha të drejtat që ai/ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me nenin 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtresa dhe dokumente mbështetëse për objektin e shtuar të hetimit disiplinor, brenda tre javëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 48 NJOFTIM PËR NDRYSHIMIN/SHTIMIN E OBJEKTIT TË
HETIMIT DISIPLINOR MAGJISTRATIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më...../.....2021

Lënda: Njoftim për shtimin (*ose ndryshimin*) e objektit të hetimit disiplinor

Magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit konkret]

[Gjykata/Prokuroria ku ushtron detyrën]

I/e nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në nenin 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ (*vendosen atributet e vendimit të ILD*) ka vendosur ndryshimin [*ose shtimin*] e objektit të hetimit disiplinor me shkeljen disiplinore [*citohet shkelja disiplinore e shtuar ose e ndryshuar në krahasim me objektin fillestar të hetimit disiplinor*].

Në përputhje me nenin 129 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lutem gjeni bashkëlidhur një kopje të vendimit [*vendos atributet e vendimit për shtimin ose ndryshimin e objektit disiplinor*] për ndryshimin [*ose shtimin*] e objektit të hetimit disiplinor.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 49 NJOFTIM PËR NDRYSHIMIN/SHTIMIN E OBJEKTIT TË
HETIMIT DISIPLINOR ANKUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më...../.....2021

Lënda: Njoftim për shtimin (*ose ndryshimin*) e objektit të hetimit disiplinor

Z/Znj. Z/Znj. [emri i ankuesit]

[adresa e ankuesit]

I/E nderuar z./znj. [emri i ankuesit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në nenin 125 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ (*vendosen atributet e vendimit të ILD*) ka vendosur ndryshimin [*ose shtimin*] e objektit të hetimit disiplinor me shkeljen disiplinore [*citohet shkelja disiplinore e shtuar ose e ndryshuar në krahasim me objektin fillestar të hetimit disiplinor*].

Në përputhje me nenin 129 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lutem gjeni bashkëlidhur një kopje të vendimit [*vendos atributet e vendimit për shtimin ose ndryshimin e objektit disiplinor*] për ndryshimin [*ose shtimin*] e objektit të hetimit disiplinor.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 50 RELACION PËR PEZULLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../...../2021

RELACION

“Për pezullimin e hetimit disiplinor”

Bazuar nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. _____ prot, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete]²⁰², konstatoj

i. Përmbajtja e informacionit

Hetimi disiplinor nr. _____ prot, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose “me iniciativë”), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkeljeje disiplinore (vendos referencat përkatëse ligjore për kryerjen e shkeljes disiplinore).

Nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor janë nxjerrë faktet e mëposhtme [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara]. Gjatë hetimit disiplinor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u vu në dijeni që për të njëjtat fakte ka filluar një proces tjetër [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete]. Në këtë procedim,

²⁰² Duhet të theksohet që dokumentet zyrtare të cilat provojnë procedurën në shqyrtim nga organi ose institucionet e tjera si edhe faktet se procedura në shqyrtim lidhet me të njëjtat fakte dhe të njëjtin magjistrat të përcaktuar në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor, do të kërkohen nga institucioni përkatës dhe do të futen në fashikullin e hetimit disiplinor.

magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] i Gjykatës/Prokurorisë [*vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete*] merr pjesë në cilësinë [*vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur*].

ii. Analiza e çështjes

Duke analizuar faktet e mësipërme, (të argumentohet si lidhet shkelja e pretenduar me çështjen e filluar në gjykatë/prokurori) rezulton se hetimi disiplinor duhet pezulluar pasi zhvillimi i procedimit [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, administrativ apo civil*], në të cilin magjistratit merr pjesë në cilësinë e [*vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur*] lidhet me të njëjtat fakte për të cilat ka filluar hetimi disiplinor ndaj magjistratit.

iii. Propozime

Bazuar në nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, propozoj,

1. Të pezullohet hetimi disiplinor ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të Gjykatës/Prokurorisë [*vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete*] deri në dhënien e vendimit të formës së prerë për procedimin [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi*].

2. Të ndërpriten afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Të njoftohet magjistrati [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ankuesi [*emri i ankuesit*], gjykata, prokuroria përkatëse që është duke zhvilluar procedimin penal apo procesin gjyqësor.

4. Në aktin e njoftimit drejtuar gjykatës dhe prokurorisë [*saktëso emrin e gjykatës ose të prokurorisë*] t’i bëhet me dije detyrimi i tyre për të paraqitur pa vonesë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo vendim që merret gjatë procedimit [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi*].

5. Në mbështetje të pikës 6 të nenit 126 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar kundër këtij vendimi nuk mund të paraqitet ankim.

INSPKTORI/E
[emër mbiemër]

SF 51 VENDIM PËR PEZULLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../...../2021

VENDIM

“Për pezullimin e hetimit disiplinor”

Bazuar nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. _____ prot, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] dhe në relacionin e inspektorit përgjegjës nr. _____, datë _____ ku propozohet pezullimi i hetimit disiplinor,

KONSTATOJ

Hetimi disiplinor nr. _____ prot, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] ka filluar bazuar në një ankesë (ose me iniciativë), pasi faktet dhe rrethanat e pretenduara ngrinin dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një shkelje disiplinore (vendos referencat përkatëse ligjore për kryerjen e shkeljes disiplinore).

Inspektorët e caktuar raportuan më [vendos datën e raportit] se nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor janë nxjerrë faktet e mëposhtme [një paraqitje e përmbledhur e veprimeve të kryera për marrjen në pyetje dhe mbledhjen e provave të tjera, duke treguar faktet e grumbulluara]. Gjatë hetimit disiplinor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u vu në dijeni që për të njëjtat fakte ka filluar një proces tjetër [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete]. Në këtë procedim, magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] i Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/

prokurorisë konkrete] merr pjesë në cilësinë [*vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur*].

Duke analizuar faktet e mësipërme, (të argumentohet si lidhet shkelja e pretenduar me çështjen e filluar në gjykatë/prokurori) rezulton se hetimi disiplinor duhet pezulluar pasi zhvillimi i procedimit [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, administrativ apo civil*], në të cilin magjistratit merr pjesë në cilësinë e [*vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur*] lidhet me të njëjtat fakte për të cilat ka filluar hetimi disiplinor ndaj magjistratit.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Pezullimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të Gjykatës/Prokurorisë [*vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete*] deri në dhënien e vendimit të formës së prerë për procedimin [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi*].
2. Të ndërpriten afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*], Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ankuesit [*emri i ankuesit*], gjykatës, prokurorisë përkatëse që është duke zhvilluar procedimin penal apo procesin gjyqësor.
4. Në aktin e njoftimit drejtuar gjykatës dhe prokurorisë [*saktëso emrin e gjykatës ose të prokurorisë*] t’i bëhet me dije detyrimi i tyre për të paraqitur pa vonesë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo vendim që merret gjatë procedimit [*saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi*].
5. Në mbështetje të pikës 6 të nenit 126 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar kundër këtij vendimi nuk mund të paraqitet ankim.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 52 NJOFTIM I ANKUESIT PËR PEZULLIMIN E HETIMIT
DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../...../2021

Lënda: Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor

Z/Znj. [emri i ankuesit]

[adresa e ankuesit]

I/E nderuar z./znj. [emri i ankuesit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ [vendos numrin dhe datën e vendimit të pezullimit] ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] të [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] të filluar me vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor].

Shkak për pezullimin e hetimit disiplinor është fillimi i procedimit [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete] për të njëjtat fakte, mbi të cilat kishte filluar hetimi disiplinor. Në këtë procedim, magjistrati [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] merr pjesë në cilësinë [vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur].

Në përputhje me nenin 126 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju dërgojmë bashkëlidhur një kopje të vendimit “Për pezullimin e hetimit disiplinor [vendos atributet e vendimit].

Në mbështetje të nenit 126, pika 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ndaj të pezullimit të hetimit disiplinor nuk mund të bëhet ankim.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 53 NJOFTIMI I MAGJISTRATIT PËR PEZULLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot. Tiranë, më...../...../2021

Lënda: Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor

Z./Znj. Magjistrati [emri i gjyqtarit/prokurorit],

[gjykata/prokuroria ku ushtron aktivitetin]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i gjyqtarit/prokurorit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ [vendos numrin dhe datën e vendimit të pezullimit] ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor të filluar me vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor].

Shkak për pezullimin e hetimit disiplinor është fillimi i procedimit [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete] për të njëjtat fakte, mbi të cilat kishte filluar hetimi disiplinor. Në këtë procedim, magjistrati [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] merr pjesë në cilësinë [vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur].

Bashkëlidhur lutem gjeni një kopje të vendimit “Për pezullimin e hetimit disiplinor” [vendos atributet e vendimit].

Në mbështetje të nenit 126, pika 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar ndaj vendimit të pezullimit të hetimit disiplinor nuk mund të bëhet ankim.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 54 NJOFTIMI I KËSHILLAVE PËR PEZULLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../...../2021

Lënda: Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor

Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë

I/E nderuar Z./Znj. [Kyetarit/e i/e Këshilli të Lartë Gjyqësor/Këshillit i Lartë i Prokurorisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ [vendos numrin dhe datën e vendimit të pezullimit] ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor të filluar me vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor].

Shkak për pezullimin e hetimit disiplinor është fillimi i procedimit [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete] për të njëjtat fakte, mbi të cilat kishte filluar hetimi disiplinor. Në këtë procedim, magjistrati [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] merr pjesë në cilësinë [vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur].

Bashkëlidhur lutem gjeni një kopje të vendimit “Për pezullimin e hetimit disiplinor” [vendos atributet e vendimit].

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

**SF 55 NJOFTIM I KRYETARIT TË GJYKATËS APO DREJTUESIT TË
PROKURORISË PËR PEZULLIMIN E HETIMIT DISIPLINOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../...../2021

Lënda: Njoftim për pezullimin e hetimit disiplinor

Z/Znj [Emri i Kryetarit/ Drejtuesit]

Kryetar i Gjykatës/ose Drejtues i Prokurorisë

[Vendos emrin e Gjykatës/Prokurorisë]

I/E nderuar z./znj. [emri i Kryetarit/Drejtuesit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. _____, datë _____ [vendos numrin dhe datën e vendimit të pezullimit] ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] të [vendos emrin e gjykatës konkrete] të filluar me vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor].

Shkak për pezullimin e hetimit disiplinor është fillimi i procedimit [saktëso nëse është hetim penal ose proces gjyqësor penal, civil apo administrativ, duke vendosur numrin dhe datën e fillimit të këtij procedimi] nga [vendos organin kompetent për procedimin tjetër: Gjykatën ose prokurorinë konkrete] për të njëjtat fakte, mbi të cilat kishte filluar hetimi disiplinor. Në këtë procedim, magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] merr pjesë në cilësinë [vendos cilësinë që ai ka: person nën hetim, i pandehur, paditës apo i paditur].

Bashkëlidhur lutem gjeni një kopje të vendimit “Për pezullimin e hetimit disiplinor” [vendos atributet e vendimit].

Sjellim në vëmëndjen tuaj se në përputhje me nenin 126 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, keni detyrimin për të dërguar pa vonesë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procedimit përkatës, që është shkak i pezullimit të hetimit disiplinor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 56 KËRKESË PËR INFORMACION



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më...../.....2021

Lënda: Kërkesë në lidhje me mbledhjen e provave

Drejtuar: Z / Zj. [Emri i personit]

[pozicioni i personit]

[emri i institucionit / organit]

[adresa e personit / institucionit]

I/E nderuar Z / Zj [vendosni emrin]

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, referuar vendimit për fillimin e hetimit disiplinor me nr. ____ prot., [vendos nr] datë [dd/mm/vv] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], ka gjetur shkaqe të arsyeshme [vendos shkaqet e arsyeshme] për të dyshuar që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore.

Nisur nga kjo, dokumentet e mëposhtme [vendos listën e dokumenteve dhe/ose provave/informacioni] konsiderohen thelbësore për të përcaktuar nëse ka ndodhur shkelja.

Për këto arsye, kërkojmë nga ana juaj vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të listuar më sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 132 të ligjit nr. 96/2016 «Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar, brenda datës [vendos datën].

ju kërkojmë që t'i përgjigjeni kësaj kërkesë në përputhje me dispozitat e nenit 132 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe t'i jepni dokumentet e mësipërme [vendos listën e dokumenteve dhe/ose provave/informacionin]

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më [*vendos datën*].

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 57 KUJTESE PËR PËRCJELLJE INFORMACIONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Kujtesë për kërkesën në lidhje me mbledhjen e provave

Drejtuar: Z / Zj. [emri i personit]

[pozicioni i personit]

[emri i institucionit / organit]

[adresa e personit / institucionit]

I/E nderuar Z./Zj. [emri i personit],

Me shkresën nr. ____ prot., datë [dd/mm/vv], Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar për dokumente shtesë [vendos listën e dokumenteve dhe/ose provave/informacionit] në lidhje me magjistratin [emri i gjyqtarit/magjistratit] e Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], nga verifikimet tona, nuk rezultojnë të ketë një përgjigje informacionin e kërkuar brenda afatit kohor të përcaktuar në shkresë.

Sa më lart, kërkojmë përgjigjen ndaj kësaj kërkesë në përputhje me dispozitat e nenit 132 të ligjit nr 96/2016 «Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar brenda datës [vendos datën].

Ju kujtojmë që mosdhënia e përgjigjes ndaj kërkesës së dytë brenda afatit të përcaktuar më sipër, passjell ushtrimin e së drejtës të parashikuar në paragrafin 4, të nenit 132 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilës Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vendos gjobë, me vlerën deri i në 100.000 Lek.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 58 NJOFTIM SUBJEKTIT PËR VËNIE GJOBE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.
më _____.____.2021

Tiranë,

Lënda: Njoftim për vënie gjobe.

Drejtuar: Z./Zj. [emri i personit]

[emërtimi i institucionit/organit]

[adresa e personit/institucionit]

I/e nderuar Z./Zj. [vendos emrin],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 132, pika 4 dhe 5 e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka nxjerrë urdhër për vënien e gjobës prej [vendos gjobën në shifra dhe fjalë] ndaj [vendos emrin e personit, institucionit/organit] për mosdhënie përgjigje ndaj kërkesës së dytë të datës [vendos datën e kërkesës së dytë] për t’i dhënë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacion në lidhje me hetimin disiplinor të filluar [vendos numrin e protokollit dhe datën e nxjerrjes së Vendimit për fillimin e hetimit disiplinor].

Një kopje e këtij urdhri i njoftohet përmbarimor përkatës për ekzekutimin e tij, si edhe organit përgjegjës disiplinor.

Bashkëlidhur gjeni një kopje të urdhrin për vënien e gjobës të nxjerrë më [vendos datën e nxjerrjes së urdhrin].

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 59 NJOFTIM SHËRBIMIT PËRMBARIMOR PËR URDHRIN E GJOBËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

Lënda: Njoftim për vënien e gjobës

Drejtuar: Z./Zj. [emri i përmbartuesit]

[adresa e zyrës përmbartimore]

I/e nderuar Z./Zj. [vendos emrin e përmbartuesit],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në nenin 132, par. 4 dhe 5 i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndyshuar, , ka nxjerrë një urdhrin nr. ___, datë __ [“vendos titullin e urdhrin”] për vënien e gjobës prej [vendos shumën e gjobës në shifra dhe fjalë] ndaj [vendos emrin e personit, institucionit/organit] për mosdhënien e përgjigjes ndaj kërkesës së përsëritur me nr. ___ prot., datë [vendos datën e kërkesës së dytë] për të vënë në dispozicion informacionin, dokumente ose prova [cilëso llojin e të dhënave që është kërkuar nga ILD], për qëllime të hetimit disiplinor të filluar [vendos numrin e protokollit dhe datën e nxjerrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor].

Në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 5, të nenit 132, urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv dhe shërbimi përmbartimor ngarkohet me ekzekutimin e urdhrin përkatës

Sa më sipër, lutemi të gjeni bashkëlidhur një kopje të urdhrin për vënien e gjobës të nxjerrë më [vendos datën e nxjerrjes së urdhrin për ekzekutim.]

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 60 NJOFTIM PËR MARRJEN NE PYETJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Njoftim për marrje në pyetje.

Drejtuar: Magjistrati [emri i gjyqtarit/prokurorit],
[gjykata/prokuroria e veprimitarisë së tij]

ose Dëshmitar [vendosni emrin e dëshmitarit]

ose Persona të tjerë [vendosni emrin e personit i cili do të merret në pyetje]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i magjistratit/dëshmitarit ose personit tjetër],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në vendimin [vendosni numrin dhe datën], ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendosni emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendosni gjykatën/prokurorisë specifike] për [vendosni shkeljen që po hetohet]. Në kuadër të këtij hetimi disiplinor është vlerësuar se marrja juaj në pyetje në cilësinë e [vendosni se si është i lidhur me hetimin në fjalë magjistrati/dëshmitari ose çdo person tjetër] paraqet rëndësi për objektin e hetimit. Për këtë qëllim dhe në bazë të nenit 131 dhe 133 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ju njoftojmë të paraqiteni në datën [vendosni datën] në ambientet e [vendosni vendin].

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se marrja në pyetje do të regjistrohet në audio dhe do të përmbledhet në procesverbal. Ju keni të drejtë që në përfundim të pyetjeve, të saktësoni çdo gjë që keni deklaruar, si dhe të shtoni çdo gjë që vlerësoni se është e rëndësishme për hetimin. Në përfundim të seancës dëgjimore, ju mund të kërkonti dëgjimin e regjistrimit dhe korrigjimet apo shpjegimet tuaja lidhur me deklaratimet e mëparshme të regjistruara, do të regjistrohen sërish.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 61 PROCESVERBAL PËR VEPRIMIN HETIMOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PROCESVERBAL

“Për kryerjen e veprimit hetimor [vendos llojin e veprimit hetimor]”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin dhe mbiemrin] të gjykatës /prokurorisë [vendos gjykatën/prokurorinë konkrete] për [vendos shkeljen që po hetohet]. Në bazë të këtij vendimi dhe bazuar në nenin 133 pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar mbahet ky procesverbal për të dokumentuar kryerjen e veprimit hetimor [vendos llojin e veprimit hetimor që po kryhet].

1. Inspektori i cili realizon veprimin [vendosni emrin dhe mbiemrin]

2. Data dhe vendi, ku po realizohet veprimi hetimor [vendosni datën dd/mm/vv dhe vendin]

3. Objekti dhe fusha e veprimit [përshkruani shkurtimisht faktin që pritet të zbulohet nga marrja në pyetje dhe lidhjen e tij me objektin e hetimit]

4. Pjesëmarrësit [vendosni emrat dhe mbiemrat dhe të dhënat personale të magjistratit, dëshmitarit ose personit tjetër të lidhur me veprimin hetimor]

i. _____

ii. _____

iii. _____

5. Përshkrim i detajuar i veprimit të ndërmarrë [*përshkruani hollësisht dhe saktësisht të gjitha veprimet që ndërmerren për kryerjen e veprimit hetimor*]

Procesverbali lexohet nga personat pjesëmarrës, të cilët deklarojnë se e pranojnë përmbajtjen e tij dhe në vijim, nënshkruhet rregullisht prej inspektorit dhe personave pjesëmarrës.

Nënshkrimi i Inspektorit:

[*emër, mbiemër dhe nënshkrim*]

Nënshkrimet e pjesëmarrësve:

[*emër, mbiemër dhe nënshkrim*]

i.

ii.

iii.

SF 62 PROCESVERBAL MARRJES NË PYETJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PROCESVERBAL

“Për marrjen në pyetje²⁰³ të [vendos magjistratin, dëshmitarin apo personin e tretë me emër dhe mbiemër]”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit], ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin dhe mbiemrin] të gjykatës [vendos gjykatën konkrete] për [vendos shkeljen që po hetohet]. Në bazë të këtij vendimi dhe të neneve 131 dhe 133²⁰⁴ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, i ndryshuar dhe në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, mbahet ky procesverbal për pyetjen e [vendos magjistratin, dëshmitarin apo personin e tretë me emër dhe mbiemër].

1. Inspektori(ët) që kryen/jnë marrjen në pyetje: [vendosni emrin dhe mbiemrin]

2. Data e marrjes në pyetje dhe vendi i marrjes në pyetje: [vendosni datën dd/mm/vv dhe vendin]

3. Objekti dhe fusha e marrjes në pyetje [përshkruani shkurtimisht faktin që pritet të zbulohet nga marrja në pyetje dhe lidhjen e tij me objektin e hetimit]:

203 Sipas Nenit 131 të Statusit për Ligjin, marrja në pyetje do të regjistrohet në audio. Kërkesat në lidhje me regjistrimin parashikohen në mënyrë të detajuar në Ligj. Marrja në pyetje e regjistruar do të përmbledhet në procesverbal dhe nëse është e mundur - do të transkriptohet.

204 Për aq kohë sa marrja në pyetje është një veprim hetimor, rregullat e procedurës së dokumentacionit të hetimit janë të zbatueshme edhe për dokumentacionin e marrjes në pyetje.

4. Personi i marrë në pyetje [vendosni emrin dhe të dhënat personale të magjistratit, dëshmitarit ose personave të tjerë të intervistuar]

5. Përmbledhja e marrjes në pyetje [përmbliidheni intervistën sa më shumë të jetë e mundur dhe bëni kujdes që intervista të regjistrohet edhe në audio]

Procesverbali lexohet nga personi i pyetur, i cili deklaron se e pranon përmbajtjen e tij dhe në vijim, nënshkruhet rregullisht prej inspektorit dhe personit të pyetur.

Nënshkrimi i Inspektorit

Nënshkrimi i personit të pyetur

[emër, mbiemër dhe nënshkrim]

[emër, mbiemër dhe nënshkrim]

SF 63 KËRKESË PËR MBLEDHJEN E PROVAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

Lënda: Kërkesë për përcjellje dokumentacioni.

Drejtuar: Z/Zj. [emri i personit]
 [pozicioni i personit]
 [emri i institucionit / organit]
 [adresa e personit / institucionit]

Tiranë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, referuar vendimit për fillimin e hetimit disiplinor nr. prot _____ datë [dd/mm/vv] ndaj magjistratit [emri i magjistratit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], ka gjetur shkaqe të arsyeshme [vendos shkaqet e arsyeshme] për të dyshuar që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore.

Nisur nga kjo, dokumentet e mëposhtme [vendos listën e dokumenteve dhe/ose provave/informacioni] konsiderohen thelbësore për të përcaktuar nëse ka ndodhur shkelja.

Për këto arsye, kërkojmë nga ana juaj vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të listuar më sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 132 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më [vendos datën].

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 64 URDHËR PËR VENDOSJEN E GJOBËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

U R D H Ë R

Nr. _____, datë _____.____.2020

“PËR VËNIEN E GJOBËS NDAJ [VENDOS EMRIN E ORGANIT PUBLIK, PERSONIT FIZIK OSE JURIDIK] ”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të nenit 204, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 132, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

KONSTATOVA SE:

Bazuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. _____ prot., datë [dd/mm/vv] ndaj gjyqtarit [emri i gjyqtarit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete], i ka paraqitur kërkesë [vendos emrin e organit publik, personit fizik ose juridik] më [vendos datë] për të marrë informacion në lidhje me një hetim të filluar dhe magjistratin në hetim. Kërkesa është në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara në nenin 132, të ligjit nr.96/2016.. Dokumentet [ose provat/apo informacioni] e kërkuara janë thelbësore për të përcaktuar nëse ka ndodhur shkelja dhe për konkluzionet mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit/prokurorit në hetim.

Personi përgjegjës [vendos emrin e organit publik, personit fizik ose juridik] nuk është përgjigjur brenda afatit të caktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kërkesën e parë të datës [vendos afatin e kërkesës së parë].

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përsëritur kërkesën më [vendos datën] dhe ka caktuar një afat të ri [vendos afatin e kërkesës së dytë]. Kërkesa e dytë

thekson rëndësinë e dokumenteve të kërkuara dhe arsyet e përsëritjes së kërkesës, duke vënë në dukje se në rast mosdhënie të dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar në kërkesë, passjell ushtrimin e së drejtës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vendosur gjobë.

Në kushtet kur personi përgjegjës [*vendos emrin e organit publik, personit fizik ose juridik*] nuk është përgjigjur brenda afatit të caktuar në kërkesën e dytë, pa i dhënë inspektori të Lartë të Drejtësisë shpjegime në lidhje arsyet e mosdhënies së përgjigjes për të dyja kërkesat.

Kështu, gjatë periudhës ndërmjet kërkesës së parë dhe ditës së nxjerrjes së këtij urdhri [*vendos datë e kërkesës së parë dhe datë e Urdhrit*], Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka mundur të kryejë dhe të përfundojë hetimin disiplinor.

PËR KËTO ARSYE

dhe sipas nenit 132, paragrafi 4 dhe 5 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Të vendoset gjobë në shumën [*vendos shumën e gjobës e cila do të jetë deri në 100.000 lek në shifra dhe fjalë*] ndaj [*vendos emrin e organit publik, personit fizik ose juridik*]
2. Urdhri për vënien e gjobës përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor.
3. Një kopje e këtij urdhri i dërgohet shërbimit përmbarimor gjyqësor për ekzekutimin e urdhrit.
4. Të njoftohet [*vendos emrin e organit publik, personit fizik ose juridik*], për të drejtën e ankimit dhe afatin e ankimit.
5. Një kopje e këtij urdhri i dërgohet [*vendos emrin e personit, institucionit/ organit*].

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 65 NJOFTIM I SEANCËS SË MARRJES NË PYETJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Njoftim për marrje në pyetje.

Drejtuar: Magjistrati [emri i gjyqtarit/prokurorit],

[gjkata/prokuroria e veprimtarisë së tij]

ose Dëshmitar [vendosni emrin e dëshmitarit]

ose Persona të tjerë [vendosni emrin e personit i cili do të merret në pyetje]

I/E nderuar Z./Znj. [emri i magjistratit/dëshmitarit ose personit tjetër],

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në vendimin [vendosni numrin dhe datën], ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendosni emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendosni gjykatën/prokurorisë specifike] për [vendosni shkëlqjen që po hetohet]. Në kuadër të këtij hetimi disiplinor është vlerësuar se marrja juaj në pyetje në cilësinë e [vendosni se si është i lidhur me hetimin në fjalë magjistrati/dëshmitari ose çdo person tjetër] paraqet rëndësi për objektin e hetimit. Për këtë qëllim dhe në bazë të nenit 131 dhe 133 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ju njoftojmë të paraqiteni në datën [vendosni datën] në ambientet e [vendosni vendin].

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se marrja në pyetje do të regjistrohet në audio dhe do të përmbledhet në procesverbal. Ju keni të drejtë që në përfundim të pyetjeve, të saktësoni çdo gjë që keni deklaruar, si dhe të shtoni çdo gjë që vlerësoni se është e rëndësishme për hetimin. Në përfundim të seancës dëgjimore, ju mund të kërkonti dëgjimin e regjistrimit dhe korrigjimet

apo shpjegimet tuaja lidhur me deklaratimet e mëparshme të regjistruara, do të regjistrohen sërish.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 66 RAPORTI I HETIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

RAPORT

“Për hetimin disiplinor ndaj [vendos emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit] të gjykatës [vendos emrin e gjykatës] për [vendos shkeljen e hetuar]”

Bazuar nenin 133, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. _____ prot, datë [vendos datën] ndaj magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete] dhe në relacionin²⁰⁵ datë [vendos datën e relacionit] të inspektorëve kompetentë për hetimin disiplinor [vendos emrat e inspektorëve të caktuar për të kryer hetimin]²⁰⁶,

i. Përmbajtja e informacionit

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] ka filluar hetimin disiplinor ndaj gjyqtarit/prokurorit [vendos emrin dhe mbiemrin] të gjykatës/prokurorisë [vendos gjykatën/prokurorinë konkrete] për [vendos shkeljen që është hetuar]. Në bazë të këtij vendimi, dhe të nenit dhe 133 pika 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në përfundim të

²⁰⁵ Raporti i inspektorit/(inspektorëve) të caktuar për të kryer hetimin disiplinor mund t'i paraqitet gojarisht Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Ligji nuk parashikon formularë, procedura apo kërkesa të veçanta në këtë drejtim.

²⁰⁶ Duhet të theksohet që dokumentet zyrtare të cilat provojnë procedurën në shqyrtim nga organi ose institucionet e tjera si edhe faktet se procedura në shqyrtim lidhet me të njëjtat fakte dhe të njëjtin magjistrat të përcaktuar në Vendimin për fillimin e hetimit disiplinor, do të kërkojnë nga institucioni përkatës dhe do të futen në fashikullin e hetimit disiplinor.

hetimit disiplinor është përgatitur ky raport nga inspektorët kompetentë [vendosni emrin dhe mbiemrin e inspektorëve] të caktuar në vendimin e fillimit të hetimit disiplinor.

Siç është përcaktuar edhe në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor, shkaku dhe objekti i hetimit disiplinor kanë qenë [vendosni ato shkaqe siç janë përcaktuar në vendimin e fillimit të hetimit disiplinor, duke patur kujdes që nëse gjatë hetimit disiplinor është vendosur ndryshimi ose shtimi i objektit të hetimit, të vendosen edhe shkaqet e përcaktuara në këto vendime].

ii. Veprimet hetimore

Gjatë hetimit disiplinor janë realizuar veprimet e mëposhtme: [vendosni veprimet shkurtimisht, duke treguar edhe lidhjen e tyre me objektin e hetimit].

iii. Deklarimet e personave të pyetur

Gjatë hetimit disiplinor u morën në pyetje gjyqtari/prokurori [vendosni emrin, mbiemrin dhe gjykatën/prokurorinë e tij], dëshmitarët [vendosni emrat dhe mbiemrat] dhe personat e tjerë [vendosni emrat]. Për pyetjen e tyre, në përputhje me nenet 131 dhe 133 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është proceduar me regjistrimin audio, si dhe me mbajtjen e procesverbaleve të nënshkruara rregullisht. Regjistrimi audio dhe procesverbalet janë pjesë e dosjes së hetimit disiplinor.

Në mënyrë të përmbledhur gjyqtari/prokurori deklaroi [paraqit një përmbledhje të deklarimeve sipas objektit të hetimit].

Dëshmitari, në mënyrë të përmbledhur, deklaroi [paraqit një përmbledhje të deklarimeve sipas objektit të hetimit].

Ndërsa personi, në mënyrë të përmbledhur, deklaroi [paraqit një përmbledhje të deklarimeve sipas objektit të hetimit].

iv. Faktet e pranuar dhe të papranuara, vlerësimi i provave dhe fuqia e tyre provuese.

Nga veprimet hetimore dhe deklaratimet e personave të pyetur konstatohet se [jepni një paraqitje të qartë dhe të saktë të faktit të konstatuar nga hetimi disiplinor, duke bërë lidhjen me provat e grumbulluara që mbështesin këto fakte dhe fuqinë provuese të tyre. Gjithashtu, të saktësohet pse disa pretendime apo prova të kundërta nuk qëndrojnë].

v. Analiza ligjore e fakteve të pranuar

Duke analizuar faktet e konstatuara [analizoni pse fakti i konstatuar përbën

shkelje disiplinore apo pse hetimi disiplinor duhet mbyllur. Analiza duhet të përqëndrohet në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe zbatimin e tij në mënyrë korrekte dhe uniforme].

vi. Propozime

Në mbështetje të fakteve të analizuara në këtë raport dhe në bazë të neneve [të vendoset baza ligjore] propozohet [të vendoset propozimi konkret për mbylljen e hetimit OSE për fillimin e procedimit disiplinor dhe masën disiplinore konkrete].

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 67 VENDIM MIRATIMI TË RAPORTIT HETIMIT DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

V E N D I M

“PËR MIRATIMIN E HETIMIT DISIPLINOR DATË [VENDOSNI DATËN]”

Bazuar në nenin 134, pika 1 dhe pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe neneve 204 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] është zhvilluar hetimi disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin dhe mbiemrin] të gjykatës/prokurorisë [vendos gjykatën/prokurorisë konkrete] për [vendos ankuesin/ose përcakto nëse është ankesë ex-officio dhe shkeljen që u hetua].

Në Raportin e Hetimit Disiplinor ndaj veprimtarisë së magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendosni gjykatën/prokurorisë konkrete], i datës [vendosni datën e raportit] është konkluduar se [paraqit në mënyrë të përmbledhur konkluzionet mbi faktet e analizuar në Raportin e Hetimit]. Raporti i Hetimit në përfundim propozon mbylljen e hetimit disiplinor të filluar. Shkak për mbylljen e hetimit është fakti [përdorni një prej hipotezave të listuara më poshtë, që është e zbatueshme në rastin konkret dhe që përkon me raportin e hetimit]:

1. Pretendimet e ankesës janë të pabazuara në fakte OSE
2. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm i hetimit çojnë në përfundimin se faktet janë të pamjaftueshme për të provuar se shkelja disiplinore ka ndodhur OSE:

3. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm i hetimit çojnë në përfundimin se çështja tashmë ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm, i cili është mbyllur ose gjykuar me anë të një vendimi të formës së prerë në një procedim disiplinor [*vendos atributet e vendimit të formës së prerë*] OSE;

4. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm çojnë në përfundimin se çështja është parashkruar, për shkak të kalimit të afatit kohor [*vendos afatin konkret të parashkrimit*] përfundimit të afatit kohor OSE;

5. Emërimi i gjyqtarit/prokurorit është ndërprerë bazuar në kriteret e përcaktuara në shkronjat "b" deri në "ç", pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 ose gjyqtari/prokurori nuk ushtron funksionin në mënyrë të përhershme sipas nenit 67 të këtij ligji [*përcaktoni kriterin respektiv për ndërprerjen*]; OSE

6. Gjyqtari/prokurorika vdekur më [*vendosni datën*].

Propozimet e dhëna nga inspektorët e ngarkuar janë të arsyeshme dhe të bazuara në ligj.

PËR KËTO ARSYE

VENDOS

1. Të miratoj Raportin e Hetimit datë [*vendos datën*] ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të Gjykatës/Prokurorisë [*vendosni gjykatën/prokurorinë përkatëse*] për [*vendosni shkeljen konkrete disiplinore të hetuar*].

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet ankuesit [*emri i ankuesit*] dhe magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] ose përfaqësuesit të tij/saj [*emri i përfaqësuesit*].

3. Një kopje e Raportit të Hetimit t'i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë për t'u mbajtur në konsideratë në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale²⁰⁷ të magjistratit [*vendosni emrin dhe gjykatën/prokurorinë*].

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të ankohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor/të Prokurorisë, brenda **1 jave** nga dita e marrjes dijeni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

²⁰⁷ Ky është opsional, në varësi të gjetjeve të Raportit të Hetimit - nëse ka fakte të cilat mund të konsiderohen si të nevojshme për vlerësimin e performancës.

SF 68 VENDIM PËR NDRYSHIMIN E RAPORTIT TË HETIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

V E N D I M

“PËR NDRYSHIMIN E RAPORTIT TË HETIMIT DATË [vendosni datën]”

Bazuar në nenin 204 dhe nenin 214, pika 7, shkronja “c” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, dhe nenit 134 pika 1 dhe pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe neneve 204 dhe 214

KONSTATOJ:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit], zhvilloi hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin dhe mbiemrin] të gjykatës/prokurorisë [vendos gjykatën/prokurorinë konkrete] për [vendos ankuesin dhe shkeljen që u hetua]. Në bazë të Raportit të Hetimit Disiplinor [vendos datën e raportit] dhe të nenit 134 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në nenin 204 e 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në Raportin e Hetimit Disiplinor ndaj veprimtarisë së magjistratit [emri i gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendosni gjykatën/prokurorinë konkrete], i datës [vendosni datën e raportit] është konstatuar se [paraqit në mënyrë të përmbledhur konkluzionet mbi faktet e analizuara në Raportin e Hetimit]. Raportit i Hetimit në përfundim propozon mbylljen e hetimit disiplinor të filluar. Shkak për mbylljen e hetimit është pretendimi [përdorni një prej hipotezave të listuara më poshtë, që është e zbatueshme në rastin konkret dhe që përkon me raportin e hetimit]

7. Pretendimet e ankesës janë të pabazuara në fakte OSE
8. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm i hetimit çojnë në përfundimin se faktet janë të pamjaftueshme për të provuar ose nuk provohet se shkelja disiplinore ka ndodhur OSE:
9. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm i hetimit çojnë në përfundimin se çështja tashmë ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm, i cili është mbyllur ose gjykuar me anë të një vendimi të formës së prerë në një procedim disiplinor [*vendos atributet e vendimit të formës së prerë*] OSE;
10. Faktet e mbledhura dhe rezultati i përgjithshëm çojnë në përfundimin se çështja është parashkruar, për shkak të kalimit të afatit kohor [*vendos afatin konkret të parashkrimit*] përfundimit të afatit kohor OSE;
11. Emërimi i gjyqtarit/prokurorit është ndërprerë bazuar në kriteret e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “ç”, pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 ose gjyqtari/prokurorinuk ushtron funksionin në mënyrë të përhershme sipas nenit 67 të këtij ligji [*përcaktoni kriterin respektiv për ndërprerjen*];

Propozimet e dhëna në Raportin e Hetimit nuk janë bindëse dhe të arsyeshme, sepse [*shpjegoni cili nga shkaqet e sipërcituara për mbylljen e hetimit disiplinor nuk është plotësuar dhe pse*]. Rrjedhimisht, nuk është vërtetuar se akuzat janë të pabazuara ose evidencat e mbledhura dhe rezultati përfundimtar i hetimit nuk shpie në konkluzionet e propozuara.

PËR KËTO ARSYE VENDOSA

1. Të ndryshoj Raportin Hetimor ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të Gjykatës/Prokurorisë [*vendosni gjykatën/prokurorisë përkatëse*] për [*vendosni shkeljen konkrete disiplinore të hetuar*].
2. Gjatë rishikimit të Raportit të Hetimit të vlerësohen [*përmend elementët të cilët vlerësohen të rëndësishëm për t’u parashkruar në raportin e hetimit të rishikuar, nga inspektorët e ngarkuar*].
3. Inspektorët e ngarkuar do të vazhdojnë hetimin disiplinor ndaj magjistratit [*emri i gjyqtarit/prokurorit*] të Gjykatës/Prokurorisë [*vendosni gjykatën/prokurorisë përkatëse*] për [*vendosni shkeljen konkrete disiplinore të hetuar*], në përputhje me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Statusin dhe do të dorëzojnë te Inspektori i Lartë i Drejtësisë raportin e rishikuar të hetimit.

Ky vendim hyn në fuqi me njëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 69 NJOFTIM VENDIMI PËR MBYLLJEN E HETIMIT
DISIPLINOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Njoftim për mbylljen e hetimit.

Drejtuar: Magjistratit *[emri i gjyqtarit/prokurorit],*
[gjykata/ prokuroria ku ushtron aktivitetin]

OSE: Përfaqësuesi i magjistratit *[emri i përfaqësuesit, adresa*
*e tij/saj]*²⁰⁸

Për dijeni: *[emri i ankuesit në rast se hetimi ka filluar me nismë të ankuesit,*
adresa e ankuesit]

Për dijeni: Këshilli i Lartë *[vendos emërtesën e saktë të Këshillit përkatës]*

I/e nderuar Z./Zj. *[emri i magjistratit ose përfaqësuesit të tij/saj],*

Bazuar në nenin 134, paragrafi 1, germa *[ju lutem vendosni germen përkatëse të paragrafit 1 – nga “a” tek “d”]* dhe paragrafit 2, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me vendimin për fillimin e hetimit disiplinor nr. _____ prot., datë *[dd/mm/vv]* ndaj magjistratit *[emri i gjyqtarit/prokurorit]* të Gjykatës/Prokurorisë *[vendos emrin e gjykatës/prokurorisë konkrete]*, ILD ka vendosur të mbyllë hetimin.

Lutemi të gjeni bashkëlidhur një kopje të vendimit për mbylljen e hetimit datë *[vendos datën e lëshimit të vendimit]*.

208 Kjo është opsionale në rastet kur magjistrati ka një përfaqësues. Neni 134, para.2 parashikon detyrimin e ILD të njoftojë njërin prej tyre – gjyqtarin/prokurorin ose përfaqësuesin e tij/saj.

Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill [*vendos emërtesën e Këshillit përkatës sipas rastit*] brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

SF 70 MARRËVESHJA E PËRBASHKËT E PRANIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË (EMËRTESA E STRUKTURËS)

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

MARRËVESHJE E PËRBASHKËT PRANIMI

Në Tiranë, sot më [vendos datën] midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse], në kuadër të hetimit disiplinor lidhet kjo Marrëveshje e Përbashkët e Pranimit, bazuar në nenin 135, paragrafët 1- 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Bazuar në vendimin [vendos numrin dhe datën e vendimit] Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] për shkeljen disiplinore të pretenduar [vendos bazën ligjore që e parashikon si të tillë]. Gjatë hetimit disiplinor u mblodhën të dhënat e mëposhtme në lidhje me shkeljen kundër magjistratit: [përshkruani shkurtimisht të dhënat e mblledhura - përmbledhja e fakteve].

Hetimi disiplinor ndaj magjistratit [vendos emrin e gjyqtarit/prokurorit] të Gjykatës/Prokurorisë [vendoset emri i gjykatës/prokurorisë përkatëse] në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Përbashkët të Pranimit është [vendosni fazën e hetimit - i filluar, i përfunduar dhe raporti i Hetimit i hartuar, i përfunduar dhe dosja e çështjes së bashku me raportin e Hetimit i dërgohet Këshillit për të nisur procedimin disiplinor, e përfunduar, dosja e çështjes i dërgohet Këshillit dhe procedimi disiplinor ka filluar²⁰⁹].

209 Bazuar në interpretimin e Nenit 135 (paragrafi 1 dhe paragrafi 9) Marrëveshja e Përbashkët e Pranimit mund të nënshkruhet në çdo moment pas hapjes së hetimit disiplinor dhe përpara vendimit të Këshillit për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit. Për më shumë detaje shikoni Komentet në Nenin 135 të Ligjit për Statusin.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe gjyqtari/prokurori [vendos *emrin*] i Gjykatës/Prokurorisë [vendoset *emri* i gjykatës/prokurorisë përkatëse] janë dakord se të dhënat e mbledhura çojnë në përfundimin se magjistrati ka kryer shkeljen e mëposhtme, të pranuar nga magjistrati: [përshkruani shkeljen disiplinore, provat që mbështesin shkeljen e kryer dhe dispozitën ligjore që e parashikon këtë shkelje].

Sipas nenit 105 të ligjit nr. 96/2016, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe gjyqtari/prokurori [*emri*] i Gjykatës/Prokurorisë [vendoset *emri* i gjykatës/prokurorisë përkatëse] bien dakord për masën disiplinore [vendosni masën sipas parashikimit të shkronjës respektive të nenit 105, pika 1, duke arsyetuar pse kjo masë është në përputhje me ligjin nr. 96/2016 sipas kriterëve të nenit 115].

Gjyqtari/prokurori [*emri*] deklaron se ai/ajo e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, jep rregullisht pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij/saj dhe se është i informuar se Marrëveshja është objekt i miratimit të Këshillit [vendos emërtesën e përkatëse të Këshillit].

Kjo Marrëveshje e Përbashkët Pranimi hartohet në 3 kopje origjinale, një prej të cilave i jepet gjyqtarit/prokurorit, një i jepet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe një i dërgohet Këshillit [vendos emërtesën e përkatëse të Këshillit]. Kopja e Marrëveshjes drejtuar Këshillit i dërgohet këtij organi [së bashku me dosjen e çështjes- nëse është e zbatueshme²¹⁰] brenda 3 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes.

Palët pasi e lexojnë marrëveshjen dhe bien dakord me përmbajtjen e saj, e nënshkruajnë atë rregullisht.

GJYQTARI/PROKURORI

[*emri*]

Nënshkrimi:

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ARTUR METANI

Nënshkrimi:

²¹⁰ Dosja e çështjes së hetimit disiplinor duhet të dorëzohet së bashku me Marrëveshjen e Përbashkët të Pëlqimit, në rast se hetimi është i filluar, ose nëse hetimi është i përfunduar, por dosja e çështjes nuk është dorëzuar në Këshill ende. Nëse MPP nënshkruhet gjatë procedimit disiplinor të filluar, dosja e çështjes tashmë është në Këshill kështu që ILD duhet të dorëzojë vetëm marrëveshjen.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

EKSTRAKT I DISPOZITAVE KUSHTETUESE DHE LIGJORE TË ZBATUESHME PËR KOMPETENCAT DISIPLINORE TË ILD

LEGJISLACIONI	NENI	TEKST
Kushtetuta	Neni 140 Par. (1)	1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
Kushtetuta	Neni 147/d Par. (1)	1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.
Ligji i Qeverisjes	Neni 6, Par. (1) Procedura disiplinore	1. Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji i Qeverisjes	Neni 6, Par. (2) Procedura disiplinore	2. Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
Ligji i Qeverisjes	Neni 6, Par. (4) Procedura disiplinore	4. Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të këtij ligji, ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji i Qeverisjes	Neni 104 Par. (1) Procedura disiplinore	1. Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Prokurorisë hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të procedurave dhe rregullave të këtij ligji, ligjit, të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji i Qeverisjes	Neni 104, Par. (2) Procedura disiplinore	2. Gjykata Kushtetuese shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
Ligji i Qeverisjes	Neni 104, Par. (4) Procedura disiplinore	4. Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji i Qeverisjes	Neni 194, Par. (1) Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;
Ligji i Qeverisjes	Neni /194, Par. (2) Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	2. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në: a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar; b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë; c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm; ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës

		ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore; dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.
Ligji i Qeverisjes	Neni 194, Par. (3) Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	3. Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji i Qeverisjes	Neni 195 Zbatimi i ligjeve të tjera	Në ushtrimin e funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë udhëhiqet nga parimet dhe ndjek procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
Ligji i Qeverisjes	Neni 204 Par. (1) (c) Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	1. Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme: c) nxjerr urdhra të përgjithshëm me natyrë administrative ose procedurale për mbarëvajtjen dhe metodën e punës, për koordinimin e punës midis inspektorëve, ose midis tyre dhe organeve të tjera publike, për garantimin e kuptimit dhe zbatimit uniform të ligjit në lidhje me verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe inspektimin, për garantimin e zbatimit të rregullave etike e profesionale nga inspektorët dhe personeli administrativ dhe për çdo çështje tjetër me natyrë të përgjithshme, pasi merr mendimin e mbledhjes së inspektorëve;
Ligji i Qeverisjes	Neni 204 Par. (1) (ç) Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	ç) nxjerr udhëzime jodetyruese në lidhje me çështje konkrete të trajtuara nga inspektorët;

Ligji i Qeverisjes	Neni 204 Par. (1) (ë) Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	ë) mbikëqyr dhe udhëheq metodologjikisht punën e inspektorëve;
Ligji i Qeverisjes	Neni 204 Par. (1) (i) Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	i) bën shpërndarjen e punës tek inspektorët dhe vendos zëvendësimin e tyre në bazë të kriterëve objektive dhe transparente, duke mbajtur parasysh ngarkesën, përvojën, kualifikimet dhe pengesat e mundshme ligjore të inspektorëve;
Ligji i Qeverisjes	Neni 204 Par. (4) Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	4. Udhëzimet jodetyruese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara në pikën 1, shkronja “ç”, të këtij neni, bëhen gjithnjë në formë shkresore. Në qoftë se inspektori, të cilit i drejtohet udhëzimi, nuk bie dakord me të, ai informon me shkrim Inspektorin e Lartë duke dhënë shpjegimet përkatëse. Udhëzimet e Inspektorit të Lartë, objeksionet e inspektorit dhe argumentet e mëtejshme të Inspektorit të Lartë bëhen pjesë e dosjes përkatëse.
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (2) Detyrat e inspektorëve	2. Në ushtrim të detyrave të tyre, inspektorët kryejnë verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore të subjekteve të parashikuara në nenin 194, pika 1, të këtij ligji, mbledhin të dhëna dhe vlerësojnë çdo informacion ose akt që çmojnë se është ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (3) Detyrat e inspektorëve	3. Inspektorët kanë të drejtë të hyjnë në ambientet ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet e procedimit disiplinor, të inspektojnë, të kopjojnë, shumëfishojnë dhe marrin çdo informacion ose dokument të nevojshëm për kryerjen e detyrës.

Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (4) Detyrat e inspektorëve	4. Inspektorët mund të kërkojnë nga çdo person fizik a juridik ose institucion publik informacion, dokumente, dëshmi me gojë ose me shkrim mbi çdo çështje që lidhet me objektin e verifikimit, hetimit ose inspektimit që është duke u kryer
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (5) Detyrat e inspektorëve	5. Çdo person fizik ose juridik ose institucion publik është i detyruar që: a) të bashkëpunojë me inspektorët në procedurën e verifikimit, hetimit, të inspektimit; b) të japë akses, në përputhje me pikën 2 të këtij neni; c) të respektojë kërkesat e pikës 3 të këtij neni.
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (6) Detyrat e inspektorëve	6. Në përfundim të procedurës së verifikimit, hetimit të shkeljes ose inspektimit, inspektori harton projektvendimin përkatës dhe ia dorëzon atë menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (7) Detyrat e inspektorëve	7. Inspektori i Lartë shqyrton projektvendimet e inspektorëve për të verifikuar respektimin e kërkesave lidhur me formën, plotësinë e përmbajtjes, përkimin e vendimit me praktikën e punës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të gjykatave dhe vendos: a) miratimin e projektvendimit dhe dërgimin e tij pranë organit disiplinor; b) kthimin e projektvendimit me propozimin për të bërë korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme, sipas kërkesave të kësaj pike; c) ndryshimin e projektvendimit në rast se inspektori nuk bie dakord me propozimin e Inspektorit të Lartë. Në këtë rast, projektvendimi i inspektorit i bashkëngjitet vendimit përfundimtar të Inspektorit të Lartë.
Ligji i Qeverisjes	Neni 214 Par. (8) Detyrat e inspektorëve	8. Në programimin dhe zhvillimin e inspektimeve, inspektori vepron me nismë të tij.

Ligji për statusin	Neni 4 Par. 1-2 Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes	1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit.
Ligji për statusin	Neni 6 Par. (1) Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit	1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me: a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.
Ligji për statusin	Neni 7 Par. 1-4 Kufizimet për shkak të funksionit	1. Gjatë ushtrimit të funksionit, magjistrati nuk duhet: a) të bëjë publike të dhëna ose informacione për çështjet që i janë caktuar; b) të bëjë publike mendimet që ka dhënë gjatë hetimeve ose seancave gjyqësore, përveç rasteve kur mendimi është publikuar nëpërmjet një vendimi; c) të bëjë deklarata publike që mund të krijojnë përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar. 2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk e ndalojnë magjistratin të ushtrojë përgjegjësitë si magjistrat shtypi, lidhur me marrëdhëniet me publikun në gjykata dhe në prokurori. 3. Magjistrati nuk mund të marrë pjesë në grevë.

		<p>4. Magjistratit i ndalohet:</p> <p>a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;</p> <p>b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;</p> <p>c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi;</p> <p>ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;</p> <p>d) të jetë ekspert në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 9</p> <p>Par. 1-3</p> <p>Veprimtaritë jashtë funksionit</p>	<p>1. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, vetëm nëse këto veprimtari:</p> <p>a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;</p> <p>b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;</p> <p>c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve.</p> <p>ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;</p> <p>d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe formë pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;</p> <p>dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.</p> <p>2. Me përjashtim të botimeve shkencore ose</p>

		<p>trajtimeve, magjistrati ndalohej të përdorë titullin e magjistratit në veprimtaritë jashtë funksionit, si dhe merr masa që palët e treta të mos e përdorin titullin e tij në këto veprimtari.</p> <p>3. Magjistrati mund të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 100</p> <p>Par. 1</p> <p>Parimet e procedimit disiplinor</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:</p> <p>a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;</p> <p>b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;</p> <p>c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;</p> <p>ç) parimin e barazisë para ligjit;</p> <p>d) prezumimin e pafajësisë;</p> <p>dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor;</p> <p>e) parimin e proporcionalitetit;</p> <p>ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit;</p> <p>f) parimin e drejtësisë së hapur;</p> <p>g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p>

Ligji për statusin	Neni 100 Par. 2 Parimet e procedimit disiplinor	2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht: a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza; b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.
Ligji për statusin	Neni 101 Par. 1 Shkeljet disiplinore	1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyshje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paafësi të dukshme profesionale.
Ligji për statusin	Neni 101 Par. 2 Shkeljet disiplinore	2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh: a) shkalla e pakujdesisë; b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; ç) dëmtimi, mundësia e shkakimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

Ligji për statusin	<p>Neni 102 Par. 1</p> <p>Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit</p>	<p>1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magistratit, si më poshtë:</p> <p>a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;</p> <p>b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim:</p> <p>i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;</p> <p>ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magistrat tjetër;</p> <p>iii) nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;</p> <p>c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magistrati tjetër;</p> <p>ç) mospërbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;</p> <p>d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;</p> <p>dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;</p> <p>e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magistratit;</p> <p>ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve;</p>
--------------------	--	---

		<p>f) mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;</p> <p>g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;</p> <p>gj) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;</p> <p>h) mospërbushja pa shkaqe të pajustificuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj;</p> <p>i) mosnjohimi nga magjistrati i kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;</p> <p>j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijëni për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;</p> <p>k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;</p> <p>l) mospërbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;</p> <p>ll) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magjistrati ose magjistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;</p> <p>m) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij;</p> <p>n) mosnjohimi i Këshillit për ekzistencën e</p>
--	--	--

		<p>shkaqeve të mbarimit të mandatit;</p> <p>nj) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;</p> <p>o) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit;</p> <p>p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 102</p> <p>Par. 2</p> <p>Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit</p>	<p>2. Sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si më poshtë:</p> <p>a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;</p> <p>b) parashtrimi i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra;</p> <p>c) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;</p> <p>ç) nxjerrja e akteve, ku pjesa përshkruese - arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të;</p> <p>d) marrja e vendimeve qëllimisht të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes;</p>

		<p>dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 103</p> <p>Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit</p>	<p>Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:</p> <p>a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji;</p> <p>b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;</p> <p>c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;</p> <p>ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;</p> <p>d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;</p> <p>dh) raste të tjera të sjelljes që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.</p>

Ligji për statusin	<p>Neni 104</p> <p>Par. 1-3</p> <p>Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale</p>	<p>1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.</p> <p>2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.</p> <p>3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 117</p> <p>Par. 1-4</p> <p>Afatet e parashkrimit</p>	<p>1. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit.</p> <p>2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.</p> <p>3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit.</p> <p>4. Pavarësisht parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të këtij neni, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet</p>

		e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet.
Ligji për statusin	Neni 118 Par. 1-5	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.</p> <p>3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magistratit.</p> <p>4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashkruar afatet, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 117, të këtij ligji.</p> <p>5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij neni, magistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.</p>
Ligji për statusin	Neni 119 Par. 1-8 Ankesat	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik.</p> <p>2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që një magistrat ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga subjektet e mëposhtme:</p> <p>a) Ministri i Drejtësisë;</p>

		<p>b) një anëtar i vetëm i Këshillit;</p> <p>c) kryetari i gjykatës ose i prokurorisë.</p> <p>3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.</p> <p>4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.</p> <p>5. Ankesa paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.</p> <p>6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.</p> <p>7. Ankesa mund të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 120</p> <p>Par. 1-2</p> <p>Kriteret për pranueshmërinë e ankesës</p>	<p>1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;</p> <p>b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;</p> <p>c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.</p> <p>ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;</p> <p>d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të</p>

		<p>parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;</p> <p>dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.</p> <p>2. Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe përmban të dhënat e mëposhtme:</p> <p>a) gjenealitetet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;</p> <p>b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;</p> <p>c) emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë, në të cilën magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 121</p> <p>Par. 1-3</p> <p>Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme.</p> <p>2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:</p> <p>a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 120, të këtij ligji;</p> <p>b) të verifikojë ankesën;</p> <p>c) të fillojë hetimin.</p> <p>3. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 119, të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 122</p> <p>Par. 1 – 5</p> <p>Verifikimi i ankesës</p>	<p>1. Për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente</p>

		<p>shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar.</p> <p>3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.</p> <p>4. Në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet.</p> <p>5. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 123</p> <p>Par. 1-4</p> <p>Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të një procesi gjyqësor apo administrativ në lidhje me të njëjtat fakte.</p> <p>3. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin; b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar; c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara; ç) provat e mbledhura; d) periudhën kohore përkatëse për hetimin; dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtrësë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit. <p>4. Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit,</p>

		sipas pikës 3, shkronja “b”, të këtij neni, përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura.
Ligji për statusin	Neni 124 Par. 1-3 Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. 3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
Ligji për statusin	Neni 125 Par. 1-2 Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit	1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji. 2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
Ligji për statusin	Neni 126 Par. 1-6 Pezullimi i hetimeve	1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.

		<p>2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.</p> <p>3. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe Këshilli njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.</p> <p>4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.</p> <p>5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117, i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.</p> <p>6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.</p>
Ligji për statusin	Neni 127 Kërkesa për pezullimin e magjistratit	Në çdo fazë të procedurës së hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon Këshillin lidhur me faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit, sipas parashikimeve në nenin 151, të këtij ligji, ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.
Ligji për statusin	Neni 128 Bashkimi i procedimeve hetimore	Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat.
Ligji për statusin	Neni 129 Par. 1-3 Të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve gjatë hetimit	<p>1. Magjistrati është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, sipas nenit 123 ose 124, të këtij ligji, dhe i garantohet aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë nga magjistrati informacion, dokumente</p>

		<p>ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.</p> <p>3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 130 Par. 1-3</p> <p>Ecuria e hetimeve</p>	<p>1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të nenit 123 të këtij ligji.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë dhe/ose magjistrati, dhe ndërmer veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.</p> <p>3. Kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë që të mos cenojë pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë:</p> <p>a) pezullon hetimet, sipas rasteve të parashikuara në nenin 126 të këtij ligji;</p> <p>b) vazhdon me hetimin nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 131 Par. 1-4</p> <p>Kërkesat për marrjen në pyetje</p>	<p>1. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se marrja në pyetje e magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për detyrë të sigurojë që seanca e marrjes në pyetje të</p>

		<p>regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:</p> <p>a) personi që merret në pyetje duhet të informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio;</p> <p>b) regjistrimi duhet të përmbajë gjenealitetet e personave që janë thirrur për t'u pyetur;</p> <p>c) në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;</p> <p>ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyetje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklaratimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.</p> <p>3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje duhet të përmbledhet në procesverbal, si dhe mund të transkribohet. Magjistrati nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.</p> <p>4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 132</p> <p>Par. 1-6</p> <p>Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera</p>	<p>1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik duhet të zbatojë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga inspektori në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.</p> <p>2. Nëse gjatë hetimit disiplinor të magjistratit ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, regjistrime telefonike ose prova të tjera, të</p>

		<p>cilat mbrohen nga garancitë për konfidencialitet ose mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t'i kërkojë Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për magjistratin.</p> <p>3. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magjistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.</p> <p>4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përsërit kërkesën, në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë gjobë deri në 100 000 lekë, si dhe njofton organin përgjegjës disiplinor.</p> <p>5. Urdhri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përmbartimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.</p> <p>6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në Këshillin përkatës brenda 24 orëve nga marrja dijene e tij.</p>
Ligji për statusin	Neni 133 Par. 1-3 Dokumentacioni i hetimit	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.</p> <p>2. Procesverbali duhet të përmbajë:</p> <p>a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit që kryen veprimin;</p> <p>b) datën e kryerjes së veprimit;</p> <p>c) subjektin dhe objektin e veprimit;</p> <p>ç) pjesëmarrësit;</p> <p>d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;</p> <p>dh) nënshkrimin e inspektorit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë</p>

		<p>në këto veprime;</p> <p>3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmbantë paktën:</p> <p>a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent;</p> <p>b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;</p> <p>c) veprimet e kryera gjatë hetimit;</p> <p>ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;</p> <p>d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;</p> <p>dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;</p> <p>e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 134 Par. 1-4</p> <p>Mbyllja e hetimit</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:</p> <p>a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;</p> <p>b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;</p> <p>c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;</p> <p>ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat "b" deri</p>

		<p>në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;</p> <p>d) magjistrati ka vdekur.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet t'i njoftojë vendimin magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij ankuesit dhe Këshillit përkatës. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi tregon të drejtën e ankuesit për të ankimuar këtë vendim në Këshillin përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.</p> <p>3. Në rastet kur magjistrati ka dalë në pension, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe iu bëhet me dije palëve dhe Këshillit përkatës.</p> <p>4. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, duhet t'i paraqiten Këshillit për shqyrtim të mëtejshëm.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 135 Par. 1-10</p> <p>Marrëveshje e përbashkët e pranimit</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.</p> <p>2. Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si dhe masën disiplinore të përshtatshme.</p> <p>3. Palët hartojnë me shkrim dhe nënshkruajnë marrëveshjen, e cila dorëzohet në Këshillin përkatës.</p> <p>4. Marrëveshja duhet të përmbajë:</p> <p>a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati;</p>

	<p>b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakord;</p> <p>c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli.</p> <p>5. Këshilli përkatës pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:</p> <p>a) marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;</p> <p>b) nëse rezulton se magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, si dhe nëse ai ka dhënë pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij të lirë;</p> <p>c) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, të jenë në përputhje me këtë ligj.</p> <p>6. Këshilli përkatës refuzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:</p> <p>a) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;</p> <p>b) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij;</p> <p>c) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarinimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore;</p> <p>ç) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese, për të cilat kanë rënë dakord Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me këtë ligj;</p> <p>d) magjistrati është detyruar të pranojë marrëveshjen;</p> <p>dh) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen.</p> <p>7. Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, ajo do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor, e cila nuk ankimohet.</p> <p>8. Nëse Këshilli refuzon marrëveshjen, atëherë çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me</p>
--	---

		<p>shkeljen disiplinore, në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve.</p> <p>9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të fillojë ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshje.</p> <p>10. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikën 9, të këtij neni, magistrati ka të drejtë të ankimojë mos-veprimin administrativ të tij te Këshilli përkatës.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 136 Par. 1-2</p> <p>Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë</p>	<p>1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:</p> <p>a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;</p> <p>b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.</p> <p>2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 137 Par. 1 – 4</p> <p>Sistemi i menaxhimit të çështjeve</p>	<p>1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon dhe administron një sistem të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore.</p> <p>2. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:</p> <p>a) gjenealitetet dhe adresën e magistratit nën hetim;</p> <p>b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur;</p> <p>c) objektin e hetimit;</p> <p>ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit;</p>

		<p>d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor;</p> <p>dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore;</p> <p>e) informacione të tjera, sipas rastit.</p> <p>3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton dispozita të hollësishme për:</p> <p>a) formatin dhe të dhënat që administrohen në regjistër;</p> <p>b) informacionin shtesë që përfshihet në sistem;</p> <p>c) mënyrën e mbajtjes së sistemit;</p> <p>ç) informacionin e sistemit që është i hapur për publikun, si dhe informacion që është i aksesueshëm vetëm nga magjistrati nën hetim.</p> <p>4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbledh dhe përpunon të dhënat në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 138 Par. 1-5</p> <p>Fillimi i procedurës disiplinore</p>	<p>1. Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.</p> <p>2. Këshilli:</p> <p>a) përcakton datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;</p> <p>b) njofton palët për datën e seancës dëgjimore të paktën 15 ditë para saj.</p> <p>3. Këshilli mund të zgjasë afatin e parashikuar në pikën 2, shkronja “a”, të këtij neni, deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat duhet të bëhen publike.</p> <p>4. Këshilli:</p> <p>a) shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen;</p> <p>b) merr prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;</p>

		<p>c) kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë ose i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të thërrasë ekspertë.</p> <p>5. Këshilli mund t'i kërkojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryerjen e hetimeve të mëtejshme, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen veprimet hetimore sipas kërkesës së Këshillit.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 142 Par. 1- 4</p> <p>Seanca disiplinore</p>	<p>1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.</p> <p>2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:</p> <p>a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;</p> <p>b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;</p> <p>c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.</p> <p>3. Në seancë dëgjimore para Këshillit:</p> <p>a) Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;</p> <p>b) magjistrati ose përfaqësuesi i tij paraqesin argumentet mbrojtëse.</p> <p>4. Përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.</p>
Ligji për statusin	<p>Neni 144 Par. 1-2</p> <p>Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor</p>	<p>1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:</p> <p>a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë</p>

		<p>ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuor;</p> <p>b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.</p> <p>2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të këtij ligji.</p>
Ligji për statusin	Neni 145 Pezullimi i procedimit disiplinor	Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
Ligji për statusin	Neni 147 Par. 2 E drejta e ankimit për vendimet disiplinore	2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore në gjykatën kompetente.
Ligji për statusin	Neni 152 Par. 1-2 Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor	<p>1. Kur Këshilli krijon bindjen se vazhdimi në detyrë i magjistratit, për të cilin është paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 138, të këtij ligji, dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit, mund të vendosë pezullimin e tij nga detyra.</p> <p>2. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156, të këtij ligji.</p>
Ligji për statusin	Neni 153 Fillimi i procedimit të pezullimit	Pezullimi nga detyra i magjistratit, në kuptimin e nenit 152, mund të vendoset nga një Këshill: a) me nismën e vet;

		b) me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
Ligji për statusin	Neni 156 Par. 2 Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit	2. Këshilli kryesisht ose me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të magjistratit mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, dhe vendos sipas rastit: a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit; b) revokimin e pezullimit; ose c) lënien në fuqi të pezullimit.

SHTOJCA 2

VENDIMET E GJYKATËS KUSHTEUTESE

A. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 41 datë 16.05.2017

Vendim nr. 41 datë 16.05.2017 (V-41/17)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.03.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr.10 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH, JO MË PAK SE 1/5 E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar në gjykim nga z. Oerd Bylykbashi, z. Gazmend Bardhi dhe z. Ivi Kaso.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar në gjykim nga znj. Vasilika Hysi, znj. Yllka Banushi dhe z. Alban Brati.

SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar në gjykim nga z. Erjon Bani.

UNIONI I GJYQTARËVE TË SHQIPËRISË, në mungesë.

UNIONI I PROKURORËVE TË SHQIPËRISË, në mungesë.

SHOQATA KOMBËTARE E PROKURORËVE TË SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI: Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 5, neneve 19-58, nenit 61, nenit 103, neneve 117-156, nenit 159, nenit 169/5, nenit 235, si dhe të nenit 285 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 60/1, 61/4, 78, 81/2, 116, 131/a, 134/c, 147, 147/a, 147/c, 149, 149/a, 149/c, 149/d, si dhe pikat 5 dhe 6 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 27, 49, 50, 51, 51/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkonte pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, i cili kërkonte rrëzimin e kërkesës, si dhe të subjektit të interesuar, Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve, që kërkonte pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”²¹¹. Në ligj parashikohen parimet dhe rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes gjyqësore, si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED).

2. Kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë duke kundërshtuar dispozitat e ligjit që rregullojnë procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë dhe joprokurorë të KLGJ-së dhe KLP-së, kompetencat e këtyre organeve, përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së, organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës, si dhe kompetencën e ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë në mbledhjet e KLP-së.

II

3. *Kërkuarisi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për kundërshtimin e ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, konkretisht të nenit 5, neneve 19-58, nenit 61, nenit 103, neneve 117-156, nenit 159, 169/5, nenit 235, si dhe të nenit 285 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke argumentuar si vijon:

3.1. Kërkuarisi legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 131/a dhe 134/c të Kushtetutës.

3.2. Dispozitat, konkretisht nenet 19 deri 59, që parashikojnë mënyrën

211 Fletore Zyrtare nr.231, datë 01 dhjetor 2016.

e përzgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë dhe joprokurorë të organeve të KLGJ-së dhe KLP-së, kompetencat e këtyre organeve, organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës, si dhe kompetencën e ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë në mbledhjet e KLP-së bien në kundërshtim me Kushtetutën.

3.3. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë të KLGJ-së dhe KLP-së, e parashikuar në ligj, bie në kundërshtim me nenet 147 dhe 149 të Kushtetutës, duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës dhe parimin e hierarkisë së normave. Ligji ka shndërruar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve, si dhe ka dubluar kompetencat e tyre. Sistemi i emërimit në këto organe është i përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe është e pamundur që ligji të krijojë një sistem të ri emërimi, që bie në kundërshtim me Kushtetutën. Ligji vendos Kuvendin në marrëdhënie bashkëpunimi me organe të tjera, si komisioni *ad hoc*, dekanati i fakulteteve, mbledhja e posaçme e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë apo komisioni i shoqërisë civile, duke i ngushtuar kompetencën kushtetuese sekretarit të përgjithshëm dhe nënkomisionit pranë Komisionit të Ligjeve, pasi do të vlerësojnë një numër të kufizuar kandidatësh. Për dy anëtarë që zgjidhen nga radhët e pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, përzgjedhja paraprake bëhet sipas votimit numerik dhe nuk garantohet kriteri i përzgjedhjes nga radhët e juristëve me integritet të lartë moral dhe profesional.

3.4. Kompetencat e Avokatit të Popullit janë të përcaktuara në mënyrë shteruese nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 60) dhe nuk është parashikuar mundësia për t'i shtuar këto kompetenca me ligj. Parashikimi në ligjin objekt kërkesë të rolit të Avokatit të Popullit në verifikimin dhe shqyrtimin e kriterëve të kandidatëve për në KLGJ bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi del jashtë natyrës së veprimtarisë së këtij organi.

3.5. Në ligj nuk parashikohet asnjë rregull që të garantojë përgjegjshmërinë e anëtarëve të organeve, si komisioni i pavarur *ad hoc*, dekanati i fakulteteve apo komisioni i shoqërisë civile.

3.6. Nenet 5 dhe 103 të ligjit, të cilat parashikojnë rastet që sjellin përgjegjësi disiplinore të anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së, nuk janë në pajtim me parimin e sigurisë juridike për sa i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje. Këto nene kanë të njëjtën përmbajtje dhe parashikojnë se për aq sa gjejnë zbatim zbatohen dispozitat e ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky parashikim është evaziv dhe krijon mundësi abuzimi në praktikë. Në ligj duhet të parashikohen në mënyrë të qartë rastet që përbëjnë shkelje të rëndë disiplinore dhe etike për anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së.

3.7. Lidhur me kompetencat e organeve të KLGJ-së dhe KLP-së në nenet 61 deri në 159 të ligjit është parashikuar se këto organe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komisione ose mbledhje plenare. Në analizë të pikës 2 të nenit 61 të ligjit në kompetencë të mbledhjes plenare nuk janë të parashikuara disa çështje, si vlerësimi dhe transferimi i gjyqtarëve, vendimet mbi masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, propozimi i kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, si dhe propozimi dhe administrimi i buxhetit.

3.8. Nenet që parashikojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës nuk mund të jenë pjesë e ligjit, pasi Shkolla e Magjistraturës nuk është as organ i krijuar me Kushtetutë, as institucion i parashikuar nga Kushtetuta. Shkolla e Magjistraturës nuk ka fituar personalitet juridik nga Kushtetuta dhe nuk ka kompetenca kushtetuese, por vetëm përmendet prej saj. Ky institucion duhet të përjashtohet nga rregullimi procedural i nenit 81/2/a, ku parashikohet se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta miratohen me 3/5-at, por duhet të miratohet me ligj sipas kriterëve të nenit 78/1 të Kushtetutës. Miratimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës me shumicë të cilësuar do të sjellë pamundësi miratimi me shumicë të thjeshtë në rast të ndryshimeve të mundshme për funksionimin e kësaj shkolle.

3.9. Në nenin 147/a të Kushtetutës është parashikuar e drejta e ministrit për të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e KLGJ-së kur diskutohen çështje për planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor. E drejta e ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e KLP-së dhe të komisioneve të përhershme të Këshillit parashikohet edhe në nenin 169/5 të ligjit, por kompetenca e ministrit për të marrë pjesë në mbledhjet e KLP-së nuk parashikohet nga Kushtetuta. Kjo kompetencë cenon parimin e hierarkisë së normave, pasi ligji ka tejkaluar Kushtetutën.

3.10. Neni 235 i ligjit bie në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 149/d të Kushtetutës, ku parashikohet kompetenca e KED-së për të kryer verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve. Pjesë e vlerësimit të kriterëve morale është dhe vlerësimi i pasurisë. Në nenin 235 të ligjit parashikohet se kompetencën për të kryer kontroll pa asnjë mbikëqyrje e ka ILDKPKI-ja dhe jo KED-ja. Në këtë rast ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi ILDKPKI-ja ndërhyr në kompetencat e KED-së, pasi vlerësimi i kriterëve drejtohet dhe kontrollohet nga KED-ja.

4. *Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë*, ka paraqitur parashtrime

me shkrim, duke argumentuar si vijon:

4.1. Pretendimi i kërkuesit se dispozitat që rregullojnë mënyrën e zgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë për organet e KLGJ-së dhe KLP-së cenojnë Kushtetutën, është i pabazuar. Kushtetutëbërësi në mënyrë të vetëdijshme nuk ka rregulluar drejtpërdrejtë mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë të KLD-së dhe KLP-së. Kuvendi ka miratuar ligjin nr.115/2016, në të cilin është parashikuar procedura e përzgjedhjes dhe verifikimit paraprak të kandidatëve. Pretendimi i kërkuesit vjen si rezultat i interpretimit të fragmentizuar të Kushtetutës.

4.2. Procesi i përzgjedhjes brenda grupeve profesioniste nuk cenon kompetencën përfundimtare të Kuvendit për të zgjedhur anëtarët e Këshillit. Ky proces i mundëson Kuvendit të ushtrojë kompetencën e tij kushtetuese në mënyrën që urdhëron Kushtetuta. Pretendimi i kërkuesit se në ligj është parashikuar një kompetencë që nuk parashikohet nga Kushtetuta është i pabazuar. Në Kushtetutë nuk është parashikuar ndalimi i organeve përzgjedhëse. Në nenet 147 dhe 149 të Kushtetutës parashikohet zhvillimi i një procedure të caktuar brenda Kuvendit, por njëkohësisht dhe përfaqësimi i disa nëngrupeve specifike të juristëve me cilësi të larta morale dhe profesionale.

4.3. Në rastin e zgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë Kushtetuta ka bërë dallimin midis dy koncepteve “përzgjedhje” dhe “zgjedhje”, të cilat ushtrohen në faza të ndryshme. Mënyrën e rregullimit të procesit të përzgjedhjes Kushtetuta ia ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Sistemi i përzgjedhjes bëhet jashtë organit të Kuvendit, si filtër paraprak nga komisionet e pavarura *ad hoc*. Në përfundim, zgjedhja e anëtarëve bëhet nga Kuvendi, sikurse parashikohet nga Kushtetuta.

4.4. Pretendimi i kërkuesit se ligji ka parashikuar një procedurë të re për zgjedhjen e kandidatëve jomagjistratë për KLGJ-në dhe KLP-në është i pabazuar. Procesi i përzgjedhjes dhe i verifikimit paraprak të kandidatëve nuk cenon kompetencën e Kuvendit, pasi verifikimi paraprak është një proces ndihmës. Procedura e zgjedhjes fillon dhe mbaron nga Kuvendi, si organ i parashikuar nga Kushtetuta.

4.5. Pretendimi i kërkuesit për mungesën e përgjegjshmërisë së anëtarëve të komisioneve është i pabazuar. Procedura e parashikuar nga ligji për përzgjedhjen e tyre garanton profesionalizëm dhe përgjegjësi.

4.6. Pretendimi se në mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve nga radhët e pedagogëve për anëtarë të KLD-së dhe KLGJ-së nuk respektohet parimi i përzgjedhjes sipas meritokracisë, është i pabazuar. Procedura e parashikuar nga ligji se këta kandidatë zgjidhen nëpërmjet votimit të

mbledhjes së fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, pra sipas metodës së pikëzimit, garanton zgjedhjen e individit që ka mbështetje më të madhe.

4.7. Pretendimi se kompetencat e Avokatit të Popullit janë të parashikuara në mënyrë shteruese në Kushtetutë dhe se ligji nuk mund t'i japë kompetenca të tjera është i pabazuar. Roli i Avokatit të Popullit është i përcaktuar në Kushtetutë, por me ligj mund t'i jepen kompetenca të tjera në funksion të misionit të tij. Gjithashtu, me amendamentet kushtetuese i janë dhënë përgjegjësi të reja, të parashikuara nga nenet 149/d/3, 179/8/11 dhe C/6/7 të Kushtetutës.

4.8. Kërkuesi ka pretenduar se dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së janë evazive dhe të paqarta. Ligjvënësi me qëllim mospërsëritjen e dispozitave ligjore i është referuar ligjit për statusin e magjistratit.

4.9. Pretendimi i kërkuesit se parashikimi në ligj për krijimin e komisioneve vendimmarrëse të KLGJ-së dhe KLP-së cenon vendimmarrjen e këtyre organeve, është i pabazuar. Në Kushtetutë parashikohet krijimi i komisioneve me funksion vendimmarrës dhe jo lehtësues apo asistues, si rrjedhim parashikimi ligjor nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

4.10. Pretendimi i kërkuesit se rregullat për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës nuk duhet të jenë pjesë e ligjit për organet e sistemit të drejtësisë, pasi nuk është institucion kushtetues, është i pabazuar. Me ndryshimet kushtetuese, Shkolla e Magjistraturës është ngritur në nivelin e organeve të tjera kushtetuese dhe i është dhënë një personalitet i caktuar juridik me kompetenca specifike kushtetuese. Shkolla e Magjistraturës është organi i vetëm me kompetencë për të përgatitur gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nuk do të pranohen në sistemin e drejtësisë pa e përfunduar atë. Shkolla e Magjistraturës ka funksion në përgatitjen e magjistratëve, ushtron kompetenca kushtetuese gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe i janë dhënë kompetenca të rëndësishme në lidhje me institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

4.11. Pretendimi se pjesëmarrja e ministrit të Drejtësisë në mbledhjet e KLGJ-së dhe KLP-së gjatë diskutimit të çështjeve për planifikimin strategjik dhe për buxhetin krijon ndërhyrje në kompetencat e këtyre organeve, është i pabazuar. Roli i ministrit gjatë mbledhjeve ka si qëllim sigurimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe për këtë qëllim, meqenëse Kushtetuta nuk e ka parashikuar pjesëmarrjen e ministrit në mbledhjet e KLP-së, por vetëm të KLGJ-së, duke pasur parasysh funksionin e ngjashëm të dy institucioneve ligjvënëse, ligji e

ka parashikuar pjesëmarrjen e ministrit edhe gjatë mbledhjeve të KLP-së kur diskutohen çështjet për planifikimin strategjik dhe buxhetin, por pa të drejtë vote.

4.12. Pretendimi për shfuqizimin e neneve 5 dhe 103 të ligjit është i pabazuar, pasi referimi në një ligj tjetër që parashikon rregulla të detajuara ka pasur si qëllim mospërsëritjen e normave juridike. Për sa kohë anëtari i KLGJ-së dhe KLP-së ka statusin e magjistratit, shkeljet disiplinore të parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” do të konsiderohen shkelje edhe për anëtarin e KLGJ-së dhe KLP-së.

4.13. Pretendimi se neni 235 i ligjit bie në kundërshtim me Kushtetutën është i pabazuar. Organi kompetent për vlerësimin e kriterëve ligjore dhe morale është KED-ja, e cila për njohuri specifike kërkon informacion dhe mbledhje dokumentacioni nga institucione të tjera. Për verifikimin e pasurisë ligjvënësi ka krijuar ILDKPKI-në, e cila ka kompetencë të kontrollojë dhe verifikojë pasuritë, si dhe t’ia kalojë informacionin KED-së.

5. *Subjekti i interesuar, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve*, paraqiti parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

5.1. Dispozitat që parashikojnë procedurat e emërimit të anëtarëve jogjyqtarë të KLGJ-së bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në nenin 147 të saj është parashikuar një procedurë ekskluzive parlamentare. Kuvendi është organi ku paraqiten, vlerësohen dhe votohen kandidatët jogjyqtarë. Ligji e ka deformuar këtë procedurë, duke e kthyer në një sistem kooperimi institucional.

5.2. Veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi del jashtë veprimtarisë së parashikuar nga neni 60/1 i Kushtetutës.

5.3. Neni 5 i ligjit bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi i mungon qartësia. Termi “për aq sa gjen zbatim” lë hapësirë interpretimi dhe shton mundësinë e abuzimeve në praktikë.

5.4. Neni 61/1/2 i ligjit bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kushtetuta ka parashikuar se KLGJ-ja i ushtron kompetencat në mbledhje plenare me përbërje të plotë prej 11 anëtarësh. Komisionet e parashikuara nga ligji kanë rol lehtësues dhe nuk mund të kenë rol vendimmarrës për çështje të shprehura qartësisht në Kushtetutë. Mbledhja plenare nuk ka në kompetencë çështje të rëndësishme, si vlerësimin, transferimin dhe procedimet disiplinore

të gjyqtarëve. Kjo kompetencë u është dhënë komisioneve, duke cenuar garancinë dhe pavarësinë e statusit të gjyqtarëve. Nga analiza e ligjit arrihet në përfundimin se ligjërisht KLGJ-ja nuk funksionon me përbërje të plotë sipas Kushtetutës, por çështje të rëndësishme, si ato të disiplinës, emërimit, transferimit dhe vlerësimit të gjyqtarëve do të shqyrtohen nga anëtarët jogjyqtarë të komisioneve. Si rrjedhim, nenet 61, 66, 73 dhe 76 të ligjit bien në kundërshtim me Kushtetutën.

5.5. Neni 36/3 i ligjit ku parashikohet zgjedhja e kandidatëve jogjyqtarë nga radhët e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë cenon të drejtën e punës. Kjo dispozitë parashikon se mund të kandidojnë për anëtarë të KLGJ-së vetëm pedagogët me kohë të plotë. Kushtetuta nuk bën dallim mes pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të fakulteteve të drejtësisë.

5.6. Shkolla e Magjistraturës hyn në kategorinë e institucioneve kushtetuese, pasi Kushtetuta i ka dhënë personalitet juridik kushtetues duke i njohur edhe kompetenca kushtetuese. Për rrjedhojë, ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës” duhet të miratohet me 3/5-at e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

6. **Subjekti i interesuar Unioni i Gjyqtarëve** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

7. **Subjekti i interesuar Shoqata Kombëtare e Prokurorëve** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

8. **Subjekti i interesuar Unioni i Prokurorëve** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar çështjen e legjitimitit të kërkesit (*locus standi*) si një nga aspektet kryesore që lidhen me inicimin e gjykimit kushtetues me objekt kontrollin abstrakt të normës juridike. Kushtetuta, në nenin 134/1 të saj, ka përcaktuar rrethin e subjekteve, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, ndërsa kriteri i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në pikën 2 të po këtij neni, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në lidhje me legjitimitimin e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134/1/c të Kushtetutës, bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të

vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr.7, datë 24.02.2016; nr.19, datë 15.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më sipër, kërkuesi përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar dhe si i tillë legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore të kundërshtuara.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* bazuar në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pasi kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën mund të paraqitet brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi.

B. Për themelin e kërkesës

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të hierarkisë së normave juridike

12. Kërkuesi ka pretenduar se disa nene të ligjit objekt shqyrtimi cenojnë parimin e shtetit të së drejtës në këndvështrimin e parimit të hierarkisë së normave juridike. Konkretisht, nenet për të cilat kërkuesi pretendon se vijnë në kundërshtim me parimin e hierarkisë së normave parashtrihen si më poshtë:

12.1. *Kërkuesi pretendon se nenet 19-58 dhe 117-156 të ligjit*, ku parashikohet respektivisht mënyra e përzgjedhjes e kandidatëve jomagjistratë për organet e KLGJ-së (nenet 19-58) dhe KLP-së (nenet 117-156), bien në kundërshtim me parimin e hierarkisë së normave kushtetuese. Në ligj gjatë procesit të përzgjedhjes janë parashikuar organe të cilat nuk parashikohen nga Kushtetuta, duke krijuar një sistem të ri në përzgjedhjen e kandidatëve jomagjistratë. Lidhur me kompetencat e Avokatit të Popullit kërkuesi ka pretenduar se pjesëmarrja e tij gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë që vijnë nga radhët e avokatisë cenon Kushtetutën. Institucionit të Avokatit të Popullit i janë shtuar kompetenca të reja të parashikuara nga Kushtetuta.

12.2. *Kërkuesi ka pretenduar se nenet 61 dhe 159 të ligjit*, ku parashikohen respektivisht kompetencat e mbledhjes plenare të KLGJ-së dhe të mbledhjes plenare të KLP-së, bien në kundërshtim me nenet 147/a/2 dhe 149/a të Kushtetutës. Sipas kërkuesit, komisionet e këtyre organeve

kanë marrë kompetenca, të cilat Kushtetuta i parashikon shprehimisht si kompetenca të KLGJ-së dhe KLP-së, me përbërje të plotë prej 11 anëtarësh. Kushtetuta nuk lejon që ligji të transferojë vendimmarrjen e KLGJ-së dhe KLP-së tek komisionet e krijuara për funksione të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.

12.3. *Gjithashtu kërkuesi ka pretenduar se neni 169/5 i ligjit, ku parashikohet e drejta e ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e KLP-së dhe të komisioneve të përhershme të Këshillit kur diskutohen çështje për planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor, bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi nuk parashikohet në nenin 149/a të saj. Ndërkohë, në nenin 147/a është parashikuar e drejta e ministrit për të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e KLGJ-së kur diskutohen çështje për planifikim strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.*

12.4. *Kërkuesi ka pretenduar se nenet 243 deri në 275, si dhe neni 285 të ligjit, që parashikojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës, nuk mund të jenë pjesë e tij, pasi Shkolla e Magjistraturës nuk është organ i krijuar me Kushtetutë, si dhe nuk është institucion i parashikuar nga Kushtetuta. Shkolla e Magjistraturës nuk ka fituar personalitet juridik nga Kushtetuta dhe nuk ka kompetenca kushtetuese, por vetëm përmendet prej saj. Miratimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës me shumicë të cilësuar do të sjellë pamundësi miratimi me shumicë të thjeshtë në rast të ndryshimeve të mundshme për funksionimin e kësaj shkolle.*

13. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacisë së Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr.55, datë 27.07.2016; nr.16, datë 10.04.2015; nr.5, datë 05.02.2015; nr.5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në preambulën e Kushtetutës dhe në nenin 4 të saj deklarohet parimi

i shtetit të së drejtës, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin nr.16, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në nenin 4/3 të Kushtetutës parashikohet se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përjashtimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave. Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit (*shih vendimin nr.22, datë 24.04.2015; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Fryma dhe qëllimi i kushtetutëbërësit në lidhje me rregullimet kushtetuese nuk mund të anashkalohet dhe organi i vetëm i cili ka autoritetin të vlerësojë pajtueshmërinë e normave ligjore me ato kushtetuese është Gjykata Kushtetuese. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të tyre. Arsytimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr.20, datë 01.06.2011; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

B.1.1. Për pretendimin për shfuqizimin e neneve 19-58 dhe 117-156 të ligjit

17. Gjykata në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare vëren se pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e neneve 19-60 dhe 117-156 të ligjit objekt shqyrtimi nuk arriti të merrte shumicën e votave të

gjqtarëve prej 5 anëtarësh të kërkuar nga ligji. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Gjatë shqyrtimit të çështjes 4 gjyqtarë votuan për pranimin e kërkesës dhe 3 për rrëzimin e saj²¹². Nisur nga ky fakt, bazuar në nenin 73 të këtij ligji, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

B.1.2. Për pretendimet për papajtueshmëri me Kushtetutën të neneve 61 dhe 159 të ligjit

18. Gjykata konstaton se në nenet 147/a dhe 149/a të Kushtetutës janë të parashikuara kompetencat e KLGJ-së dhe KLP-së. Në pikën 2 të tyre përcaktohet se ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë KLGJ-së dhe KLP-së. Në këto nene parashikohet se KLGJ-ja dhe KLP-ja organizohen dhe e ushtrojnë veprimtarinë në komisione ose në mbledhje plenare, duke përcaktuar në pikën 2 të nenit 61 kompetencat e mbledhjes plenare të KLGJ-së dhe në pikën 2 të nenit 159 kompetencat e mbledhjes plenare të KLP-së. Konkretisht, kompetencat e mbledhjes plenare, si organ, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së, sipas ligjit objekt shqyrtimi janë: a) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë gjyqtarët/prokurorët, administratën gjyqësore/të prokurorisë, personat privatë dhe organet publike; b) miraton akte për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit; c) emëron dhe ngre në detyrë gjyqtarët/prokurorët mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës; ç) vendos masën disiplinore të shkarkimit mbi gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme/mbi prokurorët e prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me dy të tretat e votave mbi propozimin e Komisionit Disiplinor; d) shqyrton ankimet kundër vendimeve të komisioneve, me përjashtim të atyre vendimeve që rrëzojnë vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimeve ose pushimin e hetimeve, sipas pikës 14 të nenit 62 të këtij ligji dhe pikës 13 të nenit 160; dh) miraton udhëzime të përgjithshme jodetyruese; e) miraton rregulla të detajuara për funksionimin e administratës së Këshillit; ë) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për veprimtarinë e tyre; f) shqyrton ankimet kundër udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ose të drejtuesve të prokurorisë; g) miraton rregulla të detajuara mbi menaxhimin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit nga institucionet e sistemit të

²¹² Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo. Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha dhe Fatmir Hoxha.

*prokurorisë në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë*²¹³.

19. Të gjitha kompetencat e tjera që nuk përmenden në këto pika ushtrohen nga komisionet, që janë organet nëpërmjet të cilave KLGJ-ja dhe KLP-ja organizohen dhe ushtrojnë funksione e tyre. Bazuar në nenet 62 dhe 160 të ligjit, komisionet e përhershme të KLGJ-së dhe KLP-së janë katër. Konkretisht: Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale; Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Këto komisione përbëhen nga tre anëtarë dhe pranë çdo komisioni caktohen edhe dy anëtarë zëvendësues. Komisionet ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime sipas fushave të tyre ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit.

20. Këshillat mund të krijojnë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta, si në rastin e shqyrtimit të ankimeve kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit ndaj vendimeve të komisioneve mund të ushtrohet ankim në mbledhjen plenare, vendimi i këtij komisioni të përkohshëm është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej para mbledhjes plenare. Vendimet e komisioneve merren me shumicë të votave, në prani të të gjithë anëtarëve, si dhe brenda muajit janar të çdo viti kalendarik komisionet e përhershme paraqesin në mbledhjen plenare raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

21. Gjykata konstaton se kompetencat, si transferimi i gjyqtarëve/prokurorëve, vendosja e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të të gjitha niveleve, propozimi Presidentit të Republikës i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, propozimi Kuvendit i kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, propozimi dhe administrimi i buxhetit apo dhe miratimi i rregullave të etikës dhe mbikëqyrja e respektimit të saj, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta, nuk janë parashikuar si kompetenca që ushtrohen respektivisht nga mbledhjet plenare të KLGJ-së dhe KLP-së. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se të gjitha kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta duhet të implementohen si të tilla në ligj dhe nuk mund t'u delegohen komisioneve.

22. Gjykata thekson se si komisionet e përhershme edhe ato të përkohshme janë organizma ndihmës në varësi të KLGJ-së dhe KLP-së dhe si të tillë

²¹³ Kompetencat e parashikuara në shkronjat "f" dhe "g" të nenit 159 janë vetëm për mbledhjen plenare të KLP-së.

nuk mund të ushtrojnë atributet që Kushtetuta ua ka njohur në mënyrë të shprehur këtyre të fundit.

23. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit se nenet 61 dhe 159 të ligjit bien ndesh me Kushtetutën është i bazuar, e si i tillë duhet pranuar.

B.1.3. Për pretendimin për shfuqizimin e nenit 169/5 të ligjit

24. Duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave, Gjykata e vlerëson të bazuar edhe pretendimin për shfuqizimin e nenit 169/5 të ligjit.

25. Kushtetuta e ka rikonceptuar KLP-në si një organ që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Gjykata konstaton se në nenin 149/a të Kushtetutës, ku parashikohen funksionet e KLP-së, nuk është parashikuar kompetenca e ministrit të Drejtësisë për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit. Në të kundërt, në nenin 147 të Kushtetutës parashikohet pjesëmarrja e ministrit, pa të drejtë vote, në mbledhjet e KLGJ-së kur diskutohen çështjet për planifikimin strategjik dhe buxhetin.

26. Gjykata vlerëson se mosparashikimi nga Kushtetuta të pjesëmarrjes të ministrit të Drejtësisë gjatë mbledhjeve të KLP-së nuk përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i nenit 149/a të Kushtetutës shpreh dhe synon të garantojë pavarësinë e organit të KLP-së në përgjithësi dhe të Prokurorisë në veçanti nga ndërhyrjet e pushteteve të tjera, veçanërisht të atij ekzekutiv.

27. Gjykata vëren se ligjvënësi duke parashikuar në nenin 169, pika 5 pjesëmarrjen e ministrit të Drejtësisë ose përfaqësuesit të tij pa të drejtë vote gjatë mbledhjeve të KLP-së dhe të komisioneve të përhershme, tejkalon Kushtetutën duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave juridike.

28. Gjykata vëren se rastet kur kushtetutëbërësi ka vlerësuar bashkëpunimin e organit të prokurorisë, KLP-së dhe pushtetit ekzekutiv i ka përcaktuar në nene të veçanta. Konkretisht, në nenin 148/b të Kushtetutës parashikohet se Prokurori i Përgjithshëm propozon dhe administron buxhetin e Prokurorisë me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme. Ndërsa në nenin 149/a/d parashikohet se KLP-ja propozon dhe administron buxhetin e saj. Në nenin 169 të ligjit nr.115/2016, objekt shqyrtimi parashikohet se ministri i Drejtësisë koordinon zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë. Ministri i Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore

në fushën e drejtësisë penale, pasi ka marrë mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të prokurorëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në Prokurorinë e Përgjithshme ose në zyrat e Prokurorisë. Ministri i Drejtësisë ose përfaqësues të tij mund të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në mbledhjen e Asamblesë së Personelit Akademik dhe të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, në mbledhjen e posaçme të drejtuesve të institucioneve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se parashikimi ligjor lidhur me kompetencën e ministrit të Drejtësisë ose përfaqësuesit të tij për të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e KLP-së ose komisioneve të përhershëm është në tejkalim të Kushtetutës, si rrjedhim pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e nenit 169/5 është i bazuar dhe duhet të pranohet.

B.1.4. Për pretendimin për shfuqizimin e neneve 243 deri në 275 dhe 285 të ligjit për rregullimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës

30. Kërkuesi ka argumentuar se këto rregulla nuk mund të jenë pjesë e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pasi Shkolla e Magjistraturës nuk është organ i krijuar me Kushtetutë, si dhe nuk është institucion i parashikuar nga Kushtetuta.

31. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese e kanë bërë dallimin ndërmjet *institucioneve kushtetuese*, nga njëra anë, dhe *institucioneve me rëndësi kushtetuese* apo të *parashikuara nga Kushtetuta*, nga ana tjetër. Institucionet kushtetuese konsiderohen si elemente të domosdoshme dhe të pandashme të shtetit, sepse mungesa e njërit do të sillte ndalimin e veprimtarisë së plotë shtetërore dhe zëvendësimi i tyre me institucione të tjera nuk mund të mos shkaktoje ndryshime në mënyrë rrënjësore të formës së shtetit. Struktura bazë e këtyre institucioneve përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë e të plotë nga Kushtetuta. Megjithatë, Gjykata çmon të nevojshme të theksojë se ndërsa *institucionet kushtetuese* janë përcaktuar në Kushtetutë, jo të gjitha institucionet e parashikuara në Kushtetutë konsiderohen si “institucione/organe kushtetuese”. Pra, dallimi mes institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, pavarësisht nga fakti i përmendjes shprehimisht prej saj, qëndron në faktin se të parat janë organe të nevojshme e të pashmangshme

në përcaktimin e formës së shtetit e të qeverisjes, ndërsa të dytat kontribuojnë për përcaktimin e rregullimit demokratik kushtetues dhe si organe ndihmëse nuk janë thelbësore për strukturën kushtetuese të shtetit (*shih vendimin nr.25, datë 05.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka arritur në konkluzionin se Kushtetuta, në nenin 81, pika 2, shkronja "a", me termin "*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*", ka pasur parasysh një shtrirje të gjerë të tij, duke përfshirë në të njëjtin rregullim procedural miratimin e ligjeve, si për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese, ashtu edhe për institucionet e parashikuara prej saj. Në këtë rregullim kushtetues nuk përfshihen vetëm institucionet kushtetuese, sipas kuptimit të dhënë më lartë, por edhe ato institucione të parashikuara nga Kushtetuta, të cilat nëpërmjet saj kanë fituar si personalitetin juridik, ashtu edhe kompetencën kushtetuese. Jo çdo institucion që përmendet në Kushtetutë duhet të përfshihet domosdoshmërisht në procedurën e miratimit të ligjit sipas nenit 81, pika 2, shkronja "a". Ky qëndrim është rrjedhojë e faktit të ekzistencës së dallimit thelbësor ndërmjet *institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta* dhe institucioneve që vetëm sa përmenden prej saj. Kuptimi i termit "*institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta*" lidhet me vullnetin e kushtetutëbërësit për t'i dhënë institucionit personalitet juridik, me qëllim përmbushjen prej tij të kompetencës specifike kushtetuese. Në Kushtetutë përmenden edhe institucione të tjera, të cilat nuk pajisen prej saj me kompetencë kushtetuese (*shih vendimin nr.25, datë 05.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencës e saj ka mbajtur qëndrimin se Shkolla e Magjistraturës nuk përfshihet në rrethin e organeve të parashikuara nga Kushtetuta. Ajo përfaqëson një institucion publik, që gëzon cilësinë e personit juridik të krijuar me ligj. Ky institucion gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara nga kuadri ligjor në fuqi (*shih vendimin nr.20, datë 15.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Por nga ana tjetër i ndryshëm është pozicioni që i është dhënë Shkollës së Magjistraturës me ndryshimet kushtetuese. Nga përmbajtja e dispozitave të Kushtetutës Shkollës së Magjistraturës i është dhënë një personalitet juridik, duke e njohur si të vetmin institucion që bën përzgjedhjen paraprake të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, kompetenca lidhur me testimin e këshilltarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative dhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe edukimin njëvjeçar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve ndaj të cilëve

jepet masa disiplinore për ndjekjen e një trajnimi të detyrueshëm dhe më pas testimin e tyre.

35. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se miratimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës me një shumicë prej 3/5-at e votave të anëtarëve të Kuvendit nuk krijon antikushtetutshmëri, por synon garantimin e pavarësisë dhe qëndrueshmërinë e Shkollës së Magjistraturës, duke e vendosur në nivelin e organeve, funksionimi dhe organizimi i të cilave rregullohet me ligj të posaçëm për shkak të funksioneve të saj specifike në raport me institucionet e tjera të arsimit. Si rrjedhim, pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e neneve 243 deri 275 të ligjit është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

36. Kërkuesi ka pretenduar se nenet 5 dhe 103 të ligjit, në të cilat parashikohet se dispozitat e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkeljet disiplinore të magjistratëve aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe për anëtarin e KLGJ-së dhe për anëtarin e KLP-së, kanë cenuar parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike, pasi nuk evidentojnë qartë rastet që përbëjnë shkelje disiplinore.

37. Subjekti i interesuar Kuvendi ka prapësuar se referimi në një ligj tjetër, që parashikon rregulla të detajuara, ka pasur si qëllim mospërsëritjen e normave juridike. Për sa kohë anëtari i KLGJ-së dhe KLP-së ka statusin e magjistratit, shkeljet disiplinore të parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” do të konsiderohen shkelje dhe për anëtarin e KLGJ-së dhe të KLP-së.

38. Gjykata në kuadër të respektimit të parimit të sigurisë juridike ka theksuar se vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, që vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr.36, datë 15.10.2007; nr.52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma janë të pajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr.14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se nisur nga rëndësia që paraqet çështja e përgjegjësisë disiplinore në organe kushtetuese, si KLGJ-ja dhe KLP-ja, shprehjet e përdorura nga ligjvënësi në nenin 5 “*mbi shkeljet disiplinore të magjistratëve aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe për anëtarin e KLGJ-së*” dhe në nenin 103 “*mbi shkeljet disiplinore të magjistratëve zbatohen për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme edhe mbi anëtarin e KLP-së*” nuk sigurojnë qartësinë dhe garancinë kushtetuese të këtyre organeve, duke krijuar premisa për arbitraritet në zbatimin e tyre në praktikë.

41. Në zbatim të frymës së parimit të sigurisë juridike, Gjykata çmon se për shkak të specifikës dhe statusit të anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së, përcaktimi i përgjegjësive disiplinore në mënyrë shteruese në nenet 5 dhe 103 të ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” është detyrim ligjor që rrjedh nga Kushtetuta. Gjykata çmon se mosparashikimi ose referimi të një ligj tjetër cenon statusin e këtyre organeve kushtetuese, që duhet të kenë siguri juridike gjatë qëndrimit në detyrë. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e neneve 5 dhe 103 të ligjit objekt shqyrtimi është i bazuar.

Ç. Për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve

42. Kërkuesi ka pretenduar se neni 235 i ligjit bie në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 149/d të Kushtetutës. Në këtë nen parashikohet kompetenca e KED-së për të kryer verifikimet e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Pjesë e vlerësimit është edhe vlerësimi i pasurisë së kandidatëve, të cilin ligji parashikon se kryhet pa asnjë mbikëqyrje nga ILDKPKI-ja dhe jo nga KED-ja. Si rrjedhim, sipas kërkuesit ky rregullim cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi për vlerësimin e kriterëve të kandidatëve ILDKPKI-ja ndërhyr në kompetencat e KED-së.

43. Subjekti i interesuar Kuvendi ka prapësuar se organi kompetent për vlerësimin e kriterëve ligjore dhe morale është KED-ja, e cila për njohuri specifike kërkon informacion dhe mbledhje dokumentacioni

nga institucione të tjera. Për verifikimin e pasurisë ligjvënësi ka krijuar ILDKPKI-në, e cila ka kompetencë të kontrollojë dhe verifikojë pasuritë, si dhe t'ia kalojë informacionin KED-së.

44. Gjykata në jurisprudencën e saj, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve, ka theksuar se ky parim në demokraci si formë e qeverisjes synon kryesisht të mënjanohet rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që përputhen i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimet nr.24, datë 09.06.2011; nr.19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjithashtu, kjo Gjykatë ka theksuar se krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet pushteteve, si dhe organeve të tjera kushtetuese duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet tyre, por kjo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që parimet e lartpërmendura të mos shkelen (*shih vendimet nr.10, datë 06.03.2014; nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në çështjen konkrete kërkuesi ka pretenduar për ndërhyrje në kompetencat e KED-së nga ILDKPKI-ja për vlerësimin e kriterëve të kandidatëve. Gjykata konstaton se bazuar në nenin 235 të ligjit pas dërgimit të emrave të kandidatëve ose paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, KED-ja i pajis ata me formularët për deklarimin e pasurisë dhe të interesave financiarë. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve, kandidatët i dorëzojnë të plotësuar pranë ILDKPKI-së. Ky institucion, bazuar në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, kontrollon saktësinë dhe vërtetësinë e formularëve të deklarimit të pasurisë dhe të interesave financiarë të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

47. Gjykata çmon se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve gjen zbatim në raportin ndërmjet organit të KED-së dhe ILDKPKI-së gjatë procesit të vlerësimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si rrjedhim pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e nenit 235 të ligjit nr.115/2016 është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/c të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës²¹⁴.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 5, të nenit 61, të nenit 103, të nenit 159 dhe të nenit 169, pika 5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

214 Gjyqtarët Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo votuan edhe për shfuqizimin e neneve 19 deri 58, si dhe 117 deri 156 të ligjit objekt shqyrtimi.

B. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 34 datë 10.04.2017

Vendim nr. 34 datë 10.04.2017 (V-34/17)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Bashkim Dedja, Kryetar, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Vitore Tusha, anëtarë, me sekretare Edmira Babaj, në datën 08.03.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr.1 Akti, që i përket:

KËRKUES: **SHOQATA KOMBËTARE E GJYQATARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar në gjykim nga z.Erjon Bani.

UNIONI I GJYQATARËVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Gerd Hoxha dhe z.Luan Hasneziri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar znj. Vasilika Hysi dhe znj. Yllka Banushi.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.

OBJEKTI: *Deklarimi dhe shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare i nenit 8; nenit 9, pika 1, shkronja "c", fjalia e dytë dhe pikat 7 dhe 8; nenit 12, pika 2, shkronja "b", pjesa e fundit e fjalisë; nenit 19, pika 5, shkronja "b"; nenit 23, pikat 10 dhe pika 11, fjalia e parë; nenit 26, pika 4, shkronja "b"; nenit 28, shkronja "c"; nenit 42, pika 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç", pika 4, shkronjat "a", "b", "c", "ç", si dhe pikat 8 e 9; nenit 43; nenit 44, pika 1, shkronjat "b" dhe "c"; nenit 46, pika 5; nenit 47, pika 2, shkronja "a", shprehja "nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale", shkronja "b", shprehja "nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale", pikat 4 dhe 5, shprehja "nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë", pika 6, shkronja "a"; nenit 48, pika 12, fjalia e fundit; nenit 53, pikat 3 dhe 10; nenit 64, pika 1, shkronja "b", shprehja "vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë", shkronja "c" dhe pika 5; nenit 66, pika 1, shkronjat "a" dhe "b"; nenit 78, pika 3, pjesa e fundit e fjalisë së parë dhe pika 5, paragrafi i fundit; nenit 87, pikat 5*

dhe 6; nenit 95, pikat 5 dhe 6; nenit 102, pika 1, shkronja “g”, pika 2, shkronjat “a” dhe “ç”, pika 3, shkronjat “a” dhe “ç”; nenit 104, shkronja “ç”; nenit 105, pika 1, shkronja “d”; nenit 110; nenit 112, pika 1; nenit 117; nenit 119, pika 2, shkronja “a”; nenit 138, pika 1; nenit 141, pika 1; nenit 147, pika 2; nenit 150; nenit 152; nenit 153, shkronja “ç”; nenit 160; nenit 161, pika 2, shprehja “me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji” dhe pika 3; nenit 162, pika 1, pika 2, shkronja “b”, si dhe pika 6, shprehja “me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”; nenit 164, pika 1, shkronja “a”, shprehja “nuk kanë shkaqe të mbarimit të statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji” dhe pika 2; nenit 165; nenit 166, pika 1 dhe pika 2, shkronja “b”; nenit 167, pika 3, shkronja “b”, shprehja “ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”; nenit 168, pika 2, shkronja “b”, shprehja “me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”; nenit 169, pikat 3, 5 dhe 6; nenit 173, pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.96/2016 deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 11, 17, 18, 30, 33, 34, 42, 49, 138, 140, 147, 147/a dhe 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, përfaqësuesit e kërkuësve, Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë dhe Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 ka miratuar ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë të paketës të ligjeve të reformës në drejtësi.

2. Ligji nr.96/2016 përmban 175 nene, të cilat krahas *parimeve të përgjithshme (pjesa I, nenet 1-2) rregullojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve (pjesa II, nenet 3-27)*, ku gjejnë trajtim të veçantë papajtueshmëritë, kufizimet dhe veprimtaritë e tjera, paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore, leja dhe ulja e kohës së punës, si dhe të drejtat e tjera (*kreu I-V*); zhvillimin e karrierës së magjistratëve (*pjesa III, nenet 28-67*) ku rregullohen çështje të rekrutimit të kandidatëve magjistratë, emërimi dhe caktimi në pozicion, transferimi, ngritja në detyrë, komandimi, mandati i kufizuar dhe mbarimi i statusit të magjistratit (*kreu I -VIII*); vlerësimin e magjistratëve (*pjesa IV, nenet 68-99*), ku trajtohen kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit, si dhe procedurat e vlerësimit (*kreu II dhe III*); *përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale (pjesa V, nenet 100-159)*, ku gjejnë rregullim procedurat hetimore, fillimi i procedimit disiplinor, ekzekutimi dhe regjistri i masave disiplinore, pezullimi dhe detyrimet civile e penale (*kreu II-VI*), si dhe *dispozitat kalimtare dhe të fundit (pjesa VI, nenet 160-173)*.

II

3. **Kërkesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 02.12.2016 me kërkesë për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr.96/2016 dhe pezullimin e zbatimit në tërësi të tij, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

3.1 *Lidhur me legjitimitimin*: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (SHKGJRS) dhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (UGJSH), në kuptim të nenit 134/1/h të Kushtetutës dhe nenit 49/2/d të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, legjitimohen *ratione personae* për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, pasi janë organizata të regjistruara si persona juridikë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, respektivisht SHKGJ-ja me vendimin nr.2160, datë 25.01.2008 dhe UGJSH-ja me vendimin nr.2171, datë 04.02.2008. Në nenin 3 të statusit të SHKGJ-së sanksionohet se ajo “*synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor, si dhe mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve antikushtetuese që kanë të bëjnë me këtë sistem apo me statusin*

e gjyqtarëve.” Kurse në nenin 1 të statusit të UGJSH-së parashikohet se shoqata ka për qëllim, midis të tjerash, “*të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*”. Nisur nga arsyet e krijimit dhe fakti se dispozitat objekt kundërshtimi, duke cenuar një sërë parimesh e standardesh kushtetuese, ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e tyre, ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë së tyre dhe çështjes kushtetuese së pretenduar. Edhe për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor të miratimit të ligjit objekt kundërshtimi, në referim të kërkesave të nenit 50 të ligjit organik të GJK-së, të ndryshuar.

3.2 *Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit*: me hyrjen në fuqi të ligjit në datën 22.11.2016, referuar neneve 160/1 dhe 173/1, është krijuar vakum institucional me pasoja të rënda shtetërore deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), si organi i vetëm i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor. Ligji, në kundërshtim flagrant me nenin 179 të Kushtetutës, dispozitë e cila nuk vendos kufizime deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), i ka hequr KLD-së kompetencat që lidhen me: (a) emërimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, b) transferimet e gjyqtarëve; c) emërimet dhe shkarkimet e kryetarëve të gjykatave; d) komandimet e tyre; e) emërimin e inspektorëve të KLD-së. Në këtë kuptim zbatimi i ligjit objekt kundërshtimi, i cili mund të paralizojë punën e gjykatave, për shkak se KLD-ja nuk mund të veprojë me shpejtësi, cenon parimin e shtetit të së drejtës, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të statusit të gjyqtarëve, përfshirë të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe të drejtën e karrierës, të drejtën e promovimit, emërimin si kryetar gjykate dhe të drejtën për t’u promovuar në përputhje me ligjin, parimin e sigurisë juridike, parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë përpara ligjit, garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës. Sa më sipër, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese, përbën shkak të mjaftueshëm për pezullimin e ligjit si e vetmja mundësi për të parandaluar pasojat që mund t’i vijnë funksionimit normal të shtetit të së drejtës.

3.3 *Lidhur me themelin e çështjes, kërkesit pretendojnë së është cenuar*:

3.3.1 *Parimi i shtetit të së drejtës*:

3.3.1.1 Referuar nenit 179, pikat 5 dhe 12 të Kushtetutës, kryetari i KLD-së dhe anëtarët qëndrojnë në detyrë deri në krijimin e KLGJ-së, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, parashikim që garanton vazhdimësinë

institucionale. Dispozita kushtetuese nuk vendos kufizime për sa u takon kompetencave të KLD-së dhe nuk parashikon mundësinë e rregullimit të marrëdhënies përkatëse me anë të ligjit. Në këtë kuptim, nenet 160/1 “Organet kompetente në periudhën kalimtare” dhe 173/1 “Shfuqizime”, të cilat i kufizojnë kompetencat KLD-së në periudhën tranzitore deri në krijimin e KLGJ-së, bien ndesh me nenin 179, pikat 5 dhe 12 të Kushtetutës dhe cenojnë parimin e hierarkisë së akteve normative, si element i shtetit të së drejtës.

3.3.1.2 Neni 104 “Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale”, parashikon shkaqe të ndryshme të përgjegjësisë disiplinore krahasuar me ato të nenit 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, e cila i ka diferencuar shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës që lidhen me shkelje e rënda profesionale dhe etike nga ato sjellje që në vetvete përbëjnë vepër penale.

3.3.1.3 Po ashtu, parashikimi kushtetues i nenit 140, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të cilat rregullojnë pezullimin nga puna të gjyqtarit me vendim të KLGJ-së nuk respektohen nga neni 152 “Pezullimi mbi bazë diskrecioni”, që përcakton si të tilla: “a) kur ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal; b) kur merr cilësinë e të pandehurit për një vepër penale të kryer nga pakujdesia; c) kur kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore”.

3.3.1.4 Neni 143 i Kushtetutës përcakton shprehimisht papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe ato të cilat janë përjashtim nga ky kufizim. Nga ana tjetër, neni 8 i ligjit “Papajtueshmëria ambientale”, që rregullon rastet e papajtueshmërisë për shkak të lidhjeve të ngushta familjare midis magjistratëve është një shkak i ri kufizimi, që shkon përtej rregullimit kushtetues të neneve 17, 18, 49, 138 e 145 të Kushtetutës. Po ashtu, duhet të shfuqizohet neni 44, pika 1, shkronja “c” “Transferimi pa pëlqim”, që parashikon transferimin e magjistratit pa pëlqimin e tij si rezultat i papajtueshmërisë ambientale, si dhe neni 102, pika 3, shkronja “a” “Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”, që parashikon si shkelje disiplinore mosnjohimin nga magjistrati të Këshillit për rastet e papajtueshmërisë ambientale.

3.3.1.5 Për sa i takon rasteve të uljes së pagës, edhe pse ato janë përcaktuar shprehimisht si të tilla nga Kushtetuta në nenin 138, ligji në nenin 26 “Ulja e ngarkesës” shkon tej parashikimit kushtetues, duke u njohur respektivisht Këshillave kompetencën për të miratuar rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë, veç të tjerash, uljen e pagës dhe të përfitimeve të tjera kur gjyqtarit i miratohet kërkesa për uljen e ngarkesës në punë për shkaqe shëndetësore (kur ai paraqitet në punë, por jo me

ngarkesë të plotë). Ky rregullim ligjor bie ndesh edhe me parimin e proporcionalitetit, pasi sëmundja është një fakt natyror që nuk varet nga vullneti i magjistratit.

3.3.1.6 Nenet 136/3 dhe 147/2 të Kushtetutës, që rregullojnë, respektivisht zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të anëtarit të KLGJ-së nga radhët e juristëve të spikatur, përcakton, midis të tjerash, edhe kriterin e mosmbajtjes të funksioneve politike në administratën publike ose të pozicioneve drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Po ashtu, neni 179/b i Kushtetutës përcakton se procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë edhe ish-gjyqtarë e ish-prokurorë, ish-këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto institucione të paktën 3 vjet". Në kundërshtim me parashikimet e mësipërme, ligji në nenin 28 "Kriteret e pranimit në formimin fillestar" dhe nenin 53/2 "Parimet e komandimit të magjistratëve" nuk parashikon si kriter mosmbajtjen e posteve politike në administratën publike dhe, gjithashtu, nuk përjashton mundësinë e komandimit të magjistratit në pozicione pune në administratën publike që konsiderohen si pozicione politike. Po ashtu, pikat 1 dhe 2/b të nenit 166 "Dispozita kalimtare për ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë" shkon përtej rregullimit kushtetues jo vetëm për faktin se bën dallim midis ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve që e kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturë me ata që nuk e kanë përfunduar atë, por edhe se vendos një afat të ri kohor të ushtrimit të detyrës "për 9 vjet në 20 vitet e fundit".

3.3.1.7 Referimi i nenit 64, pika 1, shkronja "c" për përcaktimin e moshës së daljes në pension, në ligjin nr.7703/1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bie ndesh me nenin 81/2, shkronja "e", të Kushtetutës, pasi ligji në fjalë është ligj i miratuar me shumicë të thjeshtë dhe mund të ndryshohet me efekt përkeqësues në çdo rast.

3.3.2 *Parimi i sigurisë juridike dhe i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit:*

3.3.2.1 Neni 28 "Kriteret e pranimit në formimin fillestar" parashikon kushte të ndryshme për t'u emëruar gjyqtar apo inspektor në KLD, të cilat nuk kanë ekzistuar më parë në ligjet nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nr.8588/2000 "Për organizimin dhe funksionim e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar apo nr.8811/2001 "Për organizimin dhe funksionim e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar.

3.3.2.2 Neni 42 i ligjit, pika 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç", pika 4, shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe pikat 8 e 9, që përcaktojnë rregullat e transferimit, si dhe neni 43 "Procedura e lëvizjes paralele" parashikojnë kritere të cilat

pengojnë karrierën profesionale dhe ngritjen në detyrë të magistratëve. Lëvizja paralele haset vetëm në administratën shtetërore dhe zbatohet për nëpunësin civil. Vendet e lira që krijohen në gjykatat e apelit mund të plotësohen vetëm përmes lëvizjes paralele, duke mos lejuar që ato të plotësohen nga gjyqtarë të gjykatave të tjera, madje duke i ndaluar ata që minimalisht të paraqesin kërkesë për t'u promovuar e ngritur në detyrë. Ky kufizim bie ndesh me aktet ndërkombëtare që garantojnë statusin e gjyqtarit dhe po ashtu me jurisprudencën kushtetuese. Për të njëjtat arsye duhet shfuqizuar edhe neni 47, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe pikat 4 e 5, mbi kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë, ku parashikohen ndalime joproporcionale, si eksperiencia në një seksion të posaçëm apo në fushën e së drejtës së përshtatshme për pozicionin e lirë.

3.3.2.3 Neni 64, pika 1 nuk përmban rregullime specifike në lidhje me moshën e pensionit për gjyqtarët e shkallës së parë apo të apelit, kurse në lidhje me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë moshë përcaktohet shprehimisht 70 vjeç. Norma ligjore referon indirekt në ligje të tjera, siç është ai nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili parashikon se nga data 01.01.2016 deri 31.12.2032 moshë e daljes në pension për burrat për punët e kategorisë së dytë (ku përfshihen edhe gjyqtarët) është 65 vjeç, kurse për gratë është 60 vjeç për periudhën 2013-2014 dhe 60 vjet e 6 muaj për periudhën 2015-2016. Nga ana tjetër, ligji i ri ka përkeqësuar një gjendje të rregulluar nga neni 20 i ligjit nr.9877/2008 "Për organizmin e pushtetit gjyqësor" që përcaktonte moshën 65 vjeç për daljen në pension. Për më tepër, në nenin 27 ligji parashikon në mënyrë të unifikuar për të gjitha kategoritë e gjyqtarëve moshën për pension të parakohshëm, duke përcaktuar kriterin "të paktën 60 vjeç".

3.3.2.4 Në kundërshtim me nenet 136 dhe 179/4 të Kushtetutës, që rregullojnë kohëzgjatjen dhe vazhdimësinë e mandatit të kryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës së Lartë, neni 64, pika 1, shkronja "b", shprehja "vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë", neni 66, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", shprehja "me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji", neni 162, pikat 1 dhe 6, shprehja "nuk kanë shkaqe të mbarimit të statusit të magistratit ose të mandatit të tyre, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji", nenit 164, pika 1, shkronja "a", shprehja "nuk kanë shkaqe të mbarimit të statusit të magistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe pika 2, neni 167, pika 3, shkronja "b", shprehja "ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe neni 168, pika 2, shkronja "b", shprehja "me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" çojnë

në largimin nga detyra të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës së Krimeve të Rënda, të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, të magistratëve të komanduar dhe të inspektorëve të KLD-së, nëse ata nuk plotësojnë kushtet për t'u emëruar sipas nenit 28 të ligjit apo kur vendimi i emërimit është absolutisht i pavlefshëm.

3.3.2.5 Neni 161/3 “Dispozita kalimtare për magistratët në Gjykatën e Lartë” ka përcaktuar afate kohore të ndryshme për mbarimin e mandateve kushtetuese e ligjore të Kryetarit të Gjykatës së Lartë (2 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit), të kryetarëve të emëruar nga KLD-ja (9 muaj pas krijimit të KLGJ-së), kurse për inspektorët e KLD-së parashikon se ata mund të vazhdojnë ushtrimin e detyrës sipas mandatit të mëparshëm. Ndërprerja e mandatit me fuqi prapavepruese cenon edhe të drejtën e pagës, nisur nga përcaktimet e neneve 17 dhe 26/3 të ligjit.

3.3.2.6 Neni 103 “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit” parashikon nocione si “sjellje e papërshtatshme” dhe “shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit”, të cilat lënë hapësira për interpretim, duke e bërë dispozitën të paqartë dhe jo në përputhje me qëllimin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma.

3.3.3 *Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve:*

3.3.3.1 Neni 46 “Transferimi i përkohshëm”, që parashikon se drejtuesi i prokurorisë së posaçme transferon prokurorin për periudhën që është rënë dakord, bie ndesh me dispozitat kushtetuese që rregullojnë organizimin dhe funksionim e organit të prokurorisë përfshi, edhe atë të Posaçme, pasi i njeh drejtuesit të Prokurorisë së Përgjithshme kompetencat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3.3.3.2 Neni 66, pika 1, shkronja “b” dhe pika 4, i njeh Këshillave kompetencën për të deklaruar mbarimin e statusit të magistratit kur vendimi i emërimit (dekreti i Presidentit) është i pavlefshëm, edhe pse këtë kompetencë e kanë gjykatat administrative sipas nenit 17/1/c të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

3.3.3.3 Kushtetuta e ka parashikuar KLGJ-në si të vetmin autoritet për caktimin e masave disiplinore dhe Gjykatën Kushtetuese si organin kompetent për të shqyrtuar ankimin kundër vendimit të shkarkimit të gjyqtarit. Ligji në nenet 146 “Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës” dhe 147 “E drejta e ankimit për vendimet disiplinore” i njeh të drejtën Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) të ankimojë në gjykatën kompetente çdo vendim të KLGJ-së për çështjet disiplinore. Ky formulim nuk duhet interpretuar se ILD-ja ka të drejtë të ankimojë edhe vendimin e KLGJ-së për rrëzimin

e kërkesës për caktimin e masës disiplinore. Gjykata kompetente në këtë rast nuk ka autoritet të caktojë një masë të re disiplinore, por vetëm të ndryshojë vendimin e KLGJ-së, duke e rrëzuar kërkesën. Ky qëndrim është në përputhje edhe me praktikën e mëparshme kur ministrit të Drejtësisë, i cili kishte filluar një procedim disiplinor ndaj një gjyqtari, nuk i njihej e drejta e ankimit kundër vendimit të KLD-së që e rrëzonte kërkesën.

3.3.3.4 Neni 119, pika 2 “Ankesat” siguron ndërhyrje të papërshtatshme të pushtetit ekzekutiv në pushtetin gjyqësor, për faktin e mundësisë që është sanksionuar në shkronjën “b” për paraqitjen e ankesës në ILD nga një anëtar i Këshillit. Ky parashikim konfondon rolin e organeve që kanë të drejtë të marrin masa ndaj magjistratëve, pasi paraqitja e kërkesës për caktimin e masës disiplinore nga ILD-ja, duhet të shoqërohet me dorëheqjen e këtij anëtari, pasi roli i tij vendimmarrës në këtë rast është thelbësisht i kompromentuar.

3.3.4 Parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor:

3.3.4.1 Neni 9, pikat 7 dhe 8 “Veprimtaritë jashtë funksionit”, që përcakton detyrimin e magjistratit për të njoftuar kryetarin e gjykatës për veprimtaritë jashtë funksionit e të papaguara, për deklarata të përgjithshme të magjistratit që lidhen me pushtetin gjyqësor ose prokurorinë, ose për pjesëmarrjen e tij në diskutimet e ligjeve, bie ndesh me nenin 145 të Kushtetutës dhe aktet ndërkombëtare, duke cenuar pavarësinë e brendshme të tij.

3.3.4.2 Neni 23 “Pushimet vjetore”, fjalia e parë e pikës 11, që parashikon kompetencën e kryetarit për dhënien e pushimeve vjetore, i vendos magjistratët në raporte varësie dhe hierarkike me kryetarin e tyre, duke i shndërruar nga institucione kushtetuese të pavarura në institucione të varësisë hierarkike.

3.3.4.3 Neni 78, pika 3, togfjalëshi “dhe në çdo rast nëse kryetari nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar” i pamjaftueshëm”, i jep mundësi kryetarit që për shkaqe abuzive dhe personale ta vlerësojë pamjaftueshëm magjistratin. Për rrjedhojë, karriera e gjyqtarit mbyllet për disa vjet, pasi në mungesë të vlerësimit “shumë mirë” ai nuk mund të promovohet. Të njëjtat pasoja sjell edhe parashikimi i pikës 5 të këtij neni, që përcakton se “në çdo rast vlerësimi “pamjaftueshëm” nuk i jepet magjistratit nëse kryetari i gjykatës e ka vlerësuar atë “shumë mirë”, dhe po ashtu i pikave 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 87, që i njeh kryetarit të gjykatës rol të papërshtatshëm në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, duke cenuar pavarësinë e brendshme.

3.3.4.4 Neni 102, pika 2, shkronja “g”, “Shkeljet disiplinore në lidhje

me ushtrimin e funksionit” konsideron si masë disiplinore mosmarrjen pjesë pa arsye të gjyqtarit në numrin minimal të trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës. Ky parashikim bie ndesh me nenet 140 e 145 të Kushtetutës dhe aktet ndërkombëtare, që garantojnë patundshmërinë dhe pavarësinë e jashtme të pushtetit gjyqësor. Një qëndrim indiferent i gjyqtarit ndaj këtyre trajnimeve mund të konsiderohet si ndikues në vlerësimin profesional dhe etik, por në asnjë rast si shkelje disiplinore. Neni 102, pika 3, shkronja “ç” parashikon si shkelje disiplinore mosnjoftimin e ILD-së nga ana e kryetarit të gjykatës kur ai ka dijeni të kryerjes së shkeljeve disiplinore nga magjistratët. Ky parashikim i jep kryetarit rolin e informatorit dhe të agentit të fshehtë, madje mund të kthehet edhe në mjet abuziv, ndërkohë që ILD-ja përmes inspektimeve tematike e periodike të veprimtarisë së magjistratit, si dhe të letrave të personave fizikë e juridikë, dhe të letrave të palëve ndërgjyqëse mund të verifikojë shkeljet disiplinore.

3.3.4.5 Neni 153, shkronja “ç” “Fillimi i procedimit të pezullimit” parashikon pezullimin e magjistrati me kërkesë të kryetarit, kur ky i fundit vlerëson se magjistrati është i paaftë fizikisht ose mendërisht për të ushtruar funksionin. Kjo kompetencë e kryetarit çon në humbjen e çdo lloj pavarësie të magjistratit.

3.3.5 *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:*

3.3.5.1 *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk respektohet si rezultat i parashikimit ligjor të nenit 147/2 “E drejta e ankimit për vendimet disiplinore”, i cili i njeh gjykatës kompetente autoritetin të shqyrtojë në themel çështjen disiplinore dhe të ndryshojë vendimin e KLGJ-së duke vendosur një masë të re disiplinore.

3.3.5.2 *E drejta e mbrojtjes efektive dhe barazia e armëve:* neni 141 i ligjit “Të drejtat dhe detyrimet e palëve në procesin disiplinor” nuk garanton akses të plotë të gjyqtarit në dosjen që përmban aktet e procedimit disiplinor, dhe kjo bie në kundërshtim edhe me rregullin e respektimit *mutatis mutandis* të parimeve të procesit penal. Edhe arsyet që rendit neni 141 si kufizuese të aksesit nuk janë të arsyeshme dhe proporcionale, si të tilla nuk respektojnë kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës.

3.3.5.3 *E drejta e ankimit, referuar nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së,* pasi neni 48, pika 12 “Ngritja në detyrë në gjykata më të larta ose të specializuara” në fjalinë e fundit përcakton se: “Vendimet e Këshillave për mosçaktivimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe në Prokurorinë e Posaçme janë të formës së prerë”. Po ashtu kjo e drejtë cenohet edhe nga neni 93, pika 7 “Projektraporti i vlerësimit”,

i cili përcakton të drejtën e magjistratit të ankohet në Gjykatën e Lartë vetëm kur Këshilli e vlerëson atë në një nivel më të ulët se “mirë, duke i mohuar të drejtën e ankimit kur vlerësohet “mirë” ose “shumë mirë”. Ky ndalim i mohon gjyqtarit të drejtën e promovimit dhe të karrierës, që kërkon dy vlerësime të njëpasnjëshme “shumë mirë”.

3.3.5.4 *Parimi ne bis in idem*, referuar neneve 23, 104 dhe 112 të ligjit.

3.3.5.4.1 Neni 23 “*Pushimet vjetore*” parashikon se nëse magjistrati ka kryer mungesa në detyrë, të cilat nuk janë miratuar, ato zbriten nga periudha e pushimeve vjetore. Pavarësisht nëse jepet masë disiplinore ose jo, magjistrati nuk paguhet për ditët e munguara”. Parashikimi i disa penaliteteve në të njëjtën kohë për të njëjtin veprim, siç është mungesa në detyrë, bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 100, pika 1, shkronja “e” të ligjit.

3.3.5.4.2 Neni 104 “Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale” bie nesh me nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, i cili jo vetëm ka përcaktuar në mënyrë shteruese rastet e shkarkimit dhe ato të pezullimit, por dhe i ka diferencuar shkeljet që lidhen me sjelljen profesional dhe etike nga ato që në vetvete përbëjnë vepër penale. Shkarkimi në rastin kur gjyqtari dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ka natyrë konstatuese dhe jo vlerësuese nga ana e KLGJ-së, e cila nuk mund të fillojë procedim disiplinor në këtë rast.

3.3.5.4.3 Neni 112, pika 1 “Masa disiplinore plotësuese” parashikon se kur magjistrati dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale në fushën e korrupsionit, KLGJ-ja përveç shkarkimit ka të drejtë të urdhërojë kthimin e pagës bruto të vitit të fundit në detyrë, që vetvete përbën një dënim me gjobë. Në këtë kuptim, referuar nenit 36 të Kodit Penal është gjykata ajo që vendos dënimet plotësuese ndaj një të pandehuri. Jo vetëm KLGJ-ja nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë, por në referim të jurisprudencës kushtetuese caktimi i dy dënimeve kryesore është i ndaluar.

3.3.5.5 *Prezumimi i pafajësisë*: neni 138, pika 1 “Fillimi i procedurës disiplinore” parashikon se kur ILD-ja ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore fillon procedimin disiplinor dhe i paraqet një raport së bashku me dosjen Këshillit. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon prova të plota, te jeto çdo dyshimi të arsyeshëm, kërkesë e cila, në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës nuk plotësohet nga ky parashikim. Edhe neni 169, pika 5 “Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve” parashikon se rregullimet për pagat dhe përfitimet e tjera janë të zbatueshme për magjistratin, i cili kalon me

sukses procesin e rivlerësimit, por në asnjë rast jo më shpejt se data 1 janar 2019. Rivlerësimi nuk është gjë tjetër veçse një proces disiplinor ku duhet të gjejnë zbatim *mutatis mutandis* edhe parimet e zbatueshme në procesin penal, përfshi edhe prezumimin e pafajësisë.

3.3.6 *Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, në referim të nenit 18 të Kushtetutës:*

3.3.6.1 Neni 12, pika 2, shkronja “b” që përcakton se: “magjistratët që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar shkalla e parë” është diskriminues dhe joproporcional, pasi magjistratët e të njëjtit nivel paguhen me paga të kategorive të ndryshme. Konkretisht, paga e këtyre magjistratëve kategorizohet G2, kurse paga e prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme kategorizohet G3. Po ashtu, referuar edhe nenit 169 të ligjit, rezulton se ai lejon trajtim të diferencuar të gjyqtarëve të së njëjtës shkallë, duke zbatuar trajtim financiar të ndryshëm midis tyre në varësi të kohës së përfundimit të procesit të rivlerësimit.

3.3.6.2 Neni 28 “Kushtet e pranimit në formimin fillestar”, në kundërshtim me nenin 179, pika 10, parashikon si kriter për t’u zgjedhur magjistrat përfundimin e Shkollës së Magjistraturës, kriter i cili duhet të shtrihet për të gjithë gjyqtarët që janë në detyrë, përfshi edhe ata që nuk e kanë përfunduar këtë shkollë. Për shkak të fuqisë prapavepruese që i japin këtij parashikimi nenet 64, pika 1, shkronja “b” dhe 66, pika 1, shkronja “a” nënkuptohet që të gjithë gjyqtarët që s’kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës duhet të largohen nga detyra.

3.3.6.3 Po ashtu, edhe neni 61, pika 1, shkronja “c” dhe pika 5, që përcakton moshën të ndryshme të daljes në pension për gjyqtarët meshkuj në krahasim me ato femra është diskriminues për shkak të gjinisë së tyre.

3.3.7 *E drejta për punë:*

3.3.7.1 Neni 8 “Papajtueshmëria ambientale” i ligjit që përcakton transferimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pa pëlqimin e tij, duke i ndryshuar vendin e punës, është masë joproporcionale. Kufizues i kësaj të drejte është edhe rregullimi i nenit 19, pika 5, shkronja “b” që parashikon detyrimin e magjistratit të kthejë 50% të shumës së përfituar gjatë tri vjetëve të Shkollës së Magjistraturës, nëse statusi i tij përfundon para 5 vjetëve të ushtrimit të funksionit.

3.3.7.2 Neni 26, pika 4, shkronja “b”, që parashikon se KLGJ-ja mund të ulë pagën e gjyqtarit për arsye të uljes së ngarkesës për shkaqe të pavarura nga vullneti i gjyqtarit (arsye shëndetësore), cenon të drejtën për të siguruar jetën me të ardhura të ligjshme.

3.3.7.3 Neni 28 “Kriteret e pranimit fillestar” çon në largimin nga puna të gjyqtarëve të cilët nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, por që kanë plotësuar kriteret ligjore në fuqi në kohën e emërimit.

3.3.7.4 Neni 64, pika 1, shkronja “c” dhe pika 5, duke përcaktuar një moshë të ndryshme të daljes në pension për gjyqtaret femra krahasuar me ata meshkuj, bën që kategoria e parë të mos paguhet në përputhje me vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit për sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme.

3.3.7.5 Nenet 161, pika 3 “Dispozita kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë” dhe 164, pika 2 “Dispozita kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”, që ndërpresin me fuqi prapaveprues mandatin kushtetues të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe mandatin e kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, cenon krahas së drejtës së karrierës, edhe të drejtën për pagë.

3.3.7.6 Neni 169, pika 5 “Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”, që çon në trajtim financiar të pabarabartë të gjyqtarëve që kryejnë të njëjtat detyra për një kohë të pacaktuar, cenon të drejtën për t’u paguar në përputhje me vendin e punës, kualifikimin profesional, me qëllim sigurimin e jetesës me mjete të ligjshme.

3.3.8 Parimi i proporcionalitetit:

3.3.8.1 Neni 9, pika 1, shkronja “c” “Veprimtaritë jashtë funksionit”, që parashikon kriterin “nuk i kalojnë 200 orë jashtë orarit të punës për vit”, është antikushtetues sa kohë sfera publike është e ndarë nga ajo private. Ndërkohë justifikohet nga interesi publik dhe është proporcional kufizimi i orëve përgjatë orarit të punës.

3.3.8.2 Neni 12, pika 1, shkronja “b” “magjistratët që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shkalla e parë” është joproporcional, pasi magjistratët e të njëjtit nivel paguhen me paga të kategorive të ndryshme.

3.3.8.3 Sipas nenit 105, pika 1, shkronja “d” “Masat disiplinore” dhe nenit 110 “Pezullimi si masë disiplinore”, gjyqtari mund të pezullohet deri në 2 vjet nga detyra, duke përfutur një pagë minimale. Pezullimi, si në të gjitha ligjet procedurale, nuk mund të jetë masë disiplinore, por një masë e përkohshme deri në zgjidhjen e situatës ligjore. Mjeti i zbatuar në këtë rast nuk është efektiv, pasi sa kohë gjyqtari vlerësohet se nuk është i papërshtatshëm dhe i padenjë për të dhënë drejtësi, atëherë qytetarët privohen nga dhënia e shërbimit të drejtësisë, si dhe cenohet buxheti i shtetit duke paguar një gjyqtar pa ushtruar detyrën.

3.3.8.4 Neni 117 “*Afatet e parashkrimit*” parashikon se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 vjetëve. Norma ligjore nuk i kategorizon shkeljet disiplinore, por dispozita shton një rregull të ri që e zgjat afatin e parashkrimit me një vit kur gjyqtari kryen të njëjtën shkelje dhe nëse shkelja përbën vepër penale, afatet e parashkrimit llogariten sipas Kodit Penal. Edhe ky parashikim bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës, pasi afatet e parashkrimit për një shkelje disiplinore që nuk përbën vepër penale nuk mund të jenë më të gjata se ato që parashikon KP-ja në nenin 66, i cili i kategorizon afatet në varësi të rëndësisë së shkeljes penale.

3.3.8.5 I pajustificuar nga interesi publik është edhe rregullimi i nenit 169, pika 5 që kufizon përfitimin e pagës, por edhe afati kohor deri më 1 janar 2019 i caktuar për marrjen e pagës së re. Sipas relacionit shpjegues të projektligjit rregullimi ligjor synon “*përmirësim rrënjësor të trajtimit financiar dhe të masave mbështetëse gjatë dhe pas lënies së detyrës, duke u mbështetur në parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që t’i mbrojë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit*”.

4. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka prapësuar me shkrim si vijon:

4.1. Në lidhje me legjitimimin e kërkuesve: Referuar nenit 134, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 Për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae*, pasi nuk provojnë që ligji i kundërshtuar lidhet me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre. Argumentet e tyre lidhen me dispozitat tranzitore të ligjit ose nene të tjera të tij, të cilat rregullojnë veprimtarinë e organeve të qeverisjes së pushtetit gjyqësor ose edhe të subjekteve të tjera. Nisur nga qëllimi dhe objektivat e tyre, të shprehura këto në statutet respektive, kërkuesve nuk u atribuohen të drejta e detyrime që lidhen me organet e qeverisjes së pushtetit gjyqësor. Për më tepër, legjitimimi i shoqatave kërkuese është i papranueshëm për faktin se ndryshimet kushtetuese njohin tashmë Këshillat si organe përgjegjëse për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Kushtetuta e ka kufizuar veprimtarinë e shoqatave dhe nuk lejon që të kundërshtohet çdo lloj dispozite *a priori*, vetëm sepse lidhet me gjyqësorin. Edhe për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesit nuk kanë argumentuar një pjesë të pretendimeve, parashtrojnë kërkesa për të drejta e detyrime që u atribuohen organeve të qeverisjes së gjyqësorit, kanë referenca të gabuara në Kushtetutë dhe ligje, kundërshtojë koncepte dhe terma që janë pjesë e Kushtetutës, dhe po ashtu kanë keqkuptuar

norma ligjore të cilat janë të qarta. Për më tepër, ata nuk mund të kundërshtojnë nenin 28, shkronja “c”, pasi lidhet me kriteret e pranimit të çdo personi në formimin fillestar, nenet 160, 161, pika 1, 162, pika 2, shkronja “b”, 164, pika 2, 165, 166, pika 1 dhe pika 2, shkronja “b” dhe 173, dispozita tranzitore që rregullojnë kompetencat e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në periudhën kalimtare deri në ngritjen e sistemit të ri, dhe as nenin 95, pasi mungojnë argumentet. Po ashtu, kërkuesit nuk legjitimohen të kundërshtojnë ato dispozita të ligjit që rregullojnë çështjet e prokurorëve ose të ndihmësve ligjorë, këshilltarëve apo inspektorëve të KLD-së, pasi këto kategori nuk gjejnë rregullim në statutet e tyre.

4.2. *Kërkesa për pezullimin e ligjit* është e pabazuar për faktin se çështjet që ngrihen nuk kanë lidhje me të drejtat dhe liritë e gjyqtarëve dhe as me veprimtarinë e kërkuesve. Argumentet e parashtruara lidhen vetëm me kompetencat e KLD-së dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, të përcaktuara në nenet 160 dhe 173 të ligjit. Po ashtu, kërkesa për pezullim nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe ajo e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED). Ligjvënësi e ka rregulluar funksionimin e KLD-së deri në ngritjen e institucioneve të reja në prill të vitit 2017, kjo me qëllim që të mos krijohet vakum institucional dhe për të siguruar funksionimin e pushtetit gjyqësor. Pranimi i kërkesës për pezullim do të sillte pasoja të dëmshme dhe të pakthyeshme për reformën në drejtësi dhe po ashtu kaos ligjor, pasi në kushtet e pezullimit të nenit 173 të ligjit të kundërshtuar është i pamundur rikthimi në fuqi i ligjit nr.8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i cili është shfuqizuar nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”.

4.3. *Në lidhje me themelin:*

4.3.1. *Për pretendimin e cenimit të parimit të shtetit të së drejtës nga dispozitat tranzitore:* Kushtetuta e ndryshuar parashikon kompetencat e KLGJ-së dhe jo ato të KLD-së. Ligjvënësi ka rregulluar pozitën e KLGJ-së dhe të institucioneve të tjera në mënyrë kalimtare deri në krijimin e organeve të reja, duke i kufizuar disa kompetenca, dhe nga ana tjetër, duke i lënë disa të tjera, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë. Organet të cilat në kuadrin e reformës në drejtësi shkrihen ose riformohen nuk mund të kenë kompetenca thelbësore, siç është emërimi ose shkarkimi.

4.3.2. Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi që KLD-së i janë hequr kompetencat e emërimit dhe të transferimit të gjyqtarëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit, të emërimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe të emërimit të inspektorëve të KLD-së. Kjo e fundit është kompetente për të dhënë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, referuar nenit 160 të ligjit,

kurset neni 114 parashikon vendosjen e masës disiplinore plotësuese të largimit të magjistratit nga detyra e kryetarit të gjykatës, me propozim të ministrit të Drejtësisë. Për më tepër, instituti i transferimit jo vetëm është rikonceptuar, por kompetenca transferuese e KLD-së në periudhën kalimtare është zgjeruar, pasi ajo ushtrohet krahas çështjeve specifike, edhe për të siguruar funksionimin e gjyqësorit. Është kompetencë e ligjvënësit të përcaktojë detyrat e KLD-së gjatë periudhës kalimtare, e bërë kjo si me ligjin objekt kundërshtimi, si dhe ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”.

4.3.3. Për papajtueshmërinë ambientale (neni 8): Ligjvënësi e ka parashikuar për herë të parë konceptin e papajtueshmërisë që krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, duke parashikuar edhe rregullat për shmangien dhe zgjidhjen e situatave të tilla. Ky parashikim, i njohur edhe në vende të tjera europiane, si Italia, Austria, etj., nuk është një shkak i ri papajtueshmërie, por është në pajtim me përcaktimet e nenit 143 të Kushtetutës. Kufizimi nuk ka të bëjë me funksionin, por me vendin ku ushtrohet detyra, çka do të thotë se nuk përbën kufizim të së drejtës për të ushtruar profesionin, por një garanci në dhënien e drejtësisë për qytetarët, duke marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit.

4.3.4. Për uljen e ngarkesës së çështjeve të magjistratit (neni 26/4/b): Ligji është hartuar duke marrë në konsideratë standardet e Kartës Europiane, sipas së cilës niveli i shpërblimit të një gjyqtari në krahasim me një tjetër të jetë subjekt i faktorëve të tillë, si kohëzgjatja e shërbimit, natyra dhe rëndësia e detyrave, vështirësia e tyre, etj. Referuar edhe Rekomandimit (2010)12 të KE-së, niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që t'i mbrojë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Kërkuessit e kanë keqkuptuar dispozitën, pasi ajo do të gjejë zbatim jo për gjyqtarët që punojnë me kohë të plotë, por për ata të cilët do të punojnë me kohë të reduktuar për arsyet e përcaktuara nga vetë ligji (sëmundje e përkohshme deri 2 vjet dhe studime jashtë kursit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës) deri 3 vjet. Përcaktimi i rregullave të detajuara mbetet kompetencë e Këshillave dhe nuk përbën cenim të neneve 138 dhe 17 të Kushtetutës.

4.3.5. Për kriteret e pranimit në formimin fillestar (neni 28): Në kërkesë mungojnë argumentet në lidhje me këtë pretendim, për më tepër kërkuessit nuk legjitimohen, pasi norma e kundërshtuar rregullon statusin e kandidatit për magjistrat. Megjithatë kriteri i përcaktuar nga shkronja “e”, “nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit...”, do të thotë të heqë dorë prej këtyre funksioneve para kandidimit. Ky parashikim nuk bie ndesh me rregullimin e nenit 53 të ligjit, pasi komandimi është lëvizja

e magjistratit në një pozicion jomagjistrati brenda sistemit të drejtësisë, i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.

4.3.6. *Për pretendimin e shkeljeve disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale (neni 104/ç):* Ligji, në përputhje me rekomandimet e opinionit nr.3(2002) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (CJE), parashikon për herë të parë parimet që udhëheqin KLGJ-në dhe ILD-në në procedimin disiplinor të magjistratëve, duke filluar nga hetimi deri në marrjen e vendimit. Parashikimet ligjore mbi përgjegjësinë disiplinore civile ose penale udhëhiqen nga parimet e procesit të rregullt ligjor. Neni 140/2/b i Kushtetutës nuk parashikon shkarkimin për të gjitha shkeljet disiplinore, ndërkohë pika 1 e këtij neni parashikon se ato rregullohen me ligj, duke ia lënë ligjvënësit kompetencën e përcaktimit të veprimeve ose mosveprimeve që konsiderohen shkelje disiplinore, të parashikuara konkretisht në nenet 104, 105/1/dh dhe 111. Në këtë kuptim, pretendimi për cenimin e parimit *ne bis in idem* është i pabazuar, pasi referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, ashtu dhe asaj kushtetuese vendase, një person i dënuar penalisht mund t'i nënshtrohet edhe procesit civil për dëmin e shkaktuar.

4.3.7. *Pezullimi mbi bazë diskrecioni (neni 152):* Kushtetuta në neni 140/3 parashikon vetëm rastet dhe arsyet e pezullimit të detyrueshëm të magjistratit me vendim të KLGJ-së, ndërkohë në pikën 3/c të këtij neni Kushtetuta ia atribuon të drejtën ligjit për të përcaktuar rastet kur fillon procedimi disiplinor. Madje legjislacioni italian ose ai austriak parashikojnë rastet e pezullimit mbi bazë diskrecioni pa seancë dëgjimore, në rast se është në interes të detyrës ose për shkak të natyrës së shkeljes. Të pabazuara janë edhe pretendimet në lidhje me nenet 105 dhe 110 të ligjit, që rregullojnë *pezullimin si masë disiplinore*, pasi pezullimi nga detyra është masë që njihet nga neni E i Kushtetutës. Ligjvënësi ka respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi parashikon mundësinë e pezullimit për 3 muaj deri në 2 vjet, si dhe rastet kur zbatohet masa disiplinore.

4.3.8. *Për dispozitat kalimtare për ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët (neni 166, pikat 1 dhe 2, shkronja "b"):* Ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët nuk janë subjekte të statutit të kërkuesve. Për sa i takon rregullimit kushtetues, neni 179/b, pika 4 nuk përcakton kriteret që duhet të plotësojnë këto dy kategori, duke ja deleguar ligjit këtë kompetencë. Për më tepër, ka dallim midis dy kategorive, magjistratëve që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës dhe atyre që kanë ushtruar funksionin si magjistratë 9 vjet në 20 vjetët e fundit, por që nuk kanë mbaruar SHM-në.

4.4 *Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike:*

4.4.1 Pretendimi për nenet 161, pika 3 dhe 164, pika 2 është i pabazuar, sepse me hyrjen në fuqi të paketës ligjore të reformës në drejtësi gjyqarët e Gjykatës së Lartë janë pjesë e sistemit gjyqësor dhe mbajnë përgjegjësi disiplinore ashtu si gjyqarët e shkallëve të tjera. Në këtë kuptim edhe kryetari i GJL-së nuk trajtohet ndryshe nga gjyqarët e tjerë. Zgjedhja e bërë nga ligjvënësi për qëndrimin në detyrë të kryetarëve aktualë të gjykatave deri në krijimin e Këshillave është sa proporcionale, aq dhe e drejtë dhe i shërben kalimit sa më qetë të periudhës kalimtare në kushtet kur kryetarëve u shtohet gati një vit e gjysmë në këtë pozicion. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e pagës së tyre, pasi shtesa në fjalë lidhet me funksionin që kryejnë. Po ashtu, mungojë argumentet kushtetuese në lidhje me statusin e inspektorëve të KLD-së, që janë subjekte të reformimit tërësor, dhe po ashtu për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, statusi i të cilëve rregullohet nga Kushtetuta dhe ligjet organike.

4.4.2 *Për pretendimin e shkeljeve disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit (neni 103):* Termat që kërkuesit pretendojnë se janë të paqartë janë pjesë e termave të përdorur nga Kushtetuta, Aneksi DH, dhe po ashtu kanë një përdorim të konsoliduar në legjislacionin e disa vendeve të tjera.

4.5 *Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si rezultat i dhënies së të drejtës ILD-së për ankimin e vendimeve për masat disiplinore (nenet 146 dhe 147)* është i pabazuar. E drejta e ILD-së për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Këshillave është model i njohur në vende evropiane, si Italia dhe Austria apo më gjerë, si Gjeorgjia dhe Moldavia dhe i mbështetur edhe nga Komisioni i Venecias (*Opiniononi CLD-AD (2014)032 dhe Opiniononi i Përbashkët nr.755/2014, CLD-AD (2014), 006*).

4.6 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të barazisë së armëve, nga rregullimet e neneve 100 dhe 141 për procedimin disiplinor dhe të drejtat e palëve, është i pabazuar.* Nenet sigurojnë një balancë midis drejtësisë së hapur, parimit të mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit. Për këtë arsye aksesimi në dosjen disiplinore duhet të sigurohet në përputhje me ruajtjen e kësaj balance. Mundet që në fazat e hetimit paraprak, aksesimi në dosje të rrezikojë procesin dhe për këtë arsye ligji ka parashikuar kufizimin e aksesit për një kohë të caktuar ose për një pjesë të dokumenteve, kur ato përmbajnë të dhëna sensitive që mbrohen nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky rregullim është proporcional dhe zbatohet edhe në hetimet ose gjykimet e çështjeve të ndryshme. Në lidhje me pretendimin për cenimin e nenit 150 të ligjit kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente.

4.7 *Për pretendimin e cenimit të parimit ne bis in idem:*

4.7.1 *Pushimet vjetore (neni 23)*: Detyrimi i parashikuar nga ligji që kur magjistrati mungon pa arsye në punë këto ditë i zbriten nga periudha e pushimeve vjetore, ka për qëllim të kompensojë dëmin e krijuar në aspektin civil dhe jo atë penal. Kryetari i gjykatës ose prokurorisë është funksionari i cili ka detyrën të administrojë sa më efektshëm institucionin referuar edhe ligjit nr.96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”. Në këtë kuptim nuk është shkelje e pavarësisë së gjyqtarëve, por çështje administrimi.

4.7.2 *Masat disiplinore plotësuese (neni 112)*: Parimi i proporcionalitetit kërkon një gamë të gjerë dënimesh, me qëllim që të mundësohet dhënia e një mase në përputhje me rrezikshmërinë e shkeljes. Veçanërisht në rastet kur magjistrati dënohet për veprën penale të korrupsionit, ai jo vetëm merr masën e shkarkimit, por edhe të kthimit të pagës deri në një vit. Kjo masë synon uljen e të tilla shkeljeve që cenojnë imazhin e gjyqtarit dhe ulin besimin e publikut në dhënien e drejtësisë.

4.7.3 *Dispozitat tranzitore për magjistratët (neni 169, pika 5)*: Pretendimi për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të magjistratëve nuk qëndron për faktin se pabarazia nuk lidhet me pagën, por me kohën kur ajo do të merret, e cila lidhet me përfundimin e procesit të rivlerësimit. Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi për trajtim diskriminues midis gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme dhe atyre të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit, për faktin se të dyja kategoritë nuk ndodhen në kushte të njëjta për t’u trajtuar njëjloj.

4.8 *Për pretendimin e cenimit të parimit të proporcionalitetit nga afatet e parashkrimit (neni 117)*: Qëllimi dhe afatet e parashkrimit synojnë mbrojtjen e të dënuarit. Për shkeljet disiplinore afati i parashkrimit është 5 vjet, thuhet sa në shumicën e vendeve europiane apo edhe në Gjeorgji. Madje në Austri kuadri ligjor nuk parashikon afat të tillë.

4.9 *Për pretendimin e cenimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor*:

4.9.1 Neni 119, pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, që përcakton subjektet që mund të bëjnë ankesë pranë ILD-së, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, nuk bie ndesh me nenin 145 të Kushtetutës dhe nuk përbën ndërhyrje ose shkelje të pavarësisë, por përkundrazi garanton pavarësinë, paanësinë dhe profesionalizmin e gjyqtarëve.

4.9.2 Është i pabazuar pretendimi i kërkuesve se parashikimi i nenit 9/1/c “nuk mund të kalojnë më shumë se 200 orë punë jashtë orarit në vit” bie ndesh me nenet 17 dhe 143 të Kushtetutës. Ligji ka parashikuar në mënyrë të detajuar llojet e veprimtarive jashtë funksionit dhe 200 orë janë mëse të mjaftueshme dhe proporcionale për të siguruar edhe përfundimin e

gjykimit brenda afateve ligjore dhe pa zvarritje të proceseve. Edhe pse miratimin e japin Këshillat, njoftimi i kryetarit nevojitet në kuadër të mirëadministrimit të gjykatës/prokurorisë.

4.9.3 Edhe pretendimi për trajtim financiar të ndryshëm të gjyqtarëve të niveleve të njëjta është i pabazuar, pasi veçantia e veprimtarisë së magistratëve të gjykatave të posaçme justifikon kategorizimin e ndryshëm të tyre.

4.9.4 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi se neni 19/5/b i ligjit bie ndesh me nenin 49 të Kushtetutës, pasi ndryshe nga profesionet e tjera, magistratët përfitojnë bursë gjatë formimit fillestar në SHM. Për rrjedhojë, parashikimi i detyrimit për kthimin e 50% të shumës së paguar nga shteti nuk bie ndesh me Kushtetutën. Të tilla parashikime gjenden në legjisllacionet e shumicës së vendeve europiane.

4.9.5 Edhe neni 47/6/a, në lidhje me të cilin, në kërkesën që ka shtuar objektin, mungojnë argumentet, nuk bie ndesh me Kushtetutën, por reflekton standardet ndërkombëtare në lidhje me ngritjen në detyrë të magistratëve, bazuar në profesionalizëm dhe meritokraci.

4.9.6 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin nga neni 48/12 i ligjit i së drejtës për ankim efektiv, për faktin se vendimi i këshillave për mosaktimin në detyrë në gjykatat e prokuroritë e posaçme është i formës së prerë. Moscaktimi i një magistrati në një detyrë tjetër nuk cenon asnjë element të statusit apo përfitime të tij. Natyra përfundimtare e vendimeve justifikohet edhe për shkak të natyrës së veçantë të strukturave që do të gjykojnë veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

4.9.7 Edhe pretendimi se kompetenca e kryetarit për të vlerësuar magistratët (neni 78/3/5 dhe neni 87/5/6) bie ndesh me nenin 145 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi vendimi i vlerësimit merret nga Këshillat. Ligji parashikon se sistemi i vlerësimit bazohet në parimet e pavarësisë, meritokracisë, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit.

4.9.8 Pretendimi për cenimin e nenit 102/2/g nuk është argumentuar në kërkesë, megjithatë mbetet çështje e diskrecionit të ligjvënësit të vlerësojë si shkelje disiplinore mosmarrjen pjesë në trajnime të magistratëve. Edhe pretendimet për nenin 102/3, shkronjat “a” dhe “b”, janë çështje që i takojnë oportunitetit të ligjvënësit, pasi parashikimi ligjor rregullon njoftimet e magistratëve nga kryetari dhe jo vendimmarrjen.

4.9.9 I pabazuar është edhe pretendimi se neni 138/a/ç, që rregullon fillimin nga ILD-ja të procedimit disiplinor, cenon prezumimin e pafajësisë. Kjo

procedurë nuk ka karakter vendimmarrës, pasi vendimin e merr KLGJ-ja pas kalimit të disa hallkave procedurale.

4.9.10 Edhe pretendimi se nenet 64/1/b dhe 66/1/a/b përmbajnë rregullime që shkojnë tej rasteve të deleguara nga Kushtetuta është i pabazuar, sepse neni 136 i saj parashikon se kriteret të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj. Për më tepër, neni 66 i ligjit nr.96/2016 parashikon rastet e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë.

4.9.11 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi për shfuqizimin e togfjalëshit “me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e mandatit”, pasi kategoritë e gjyqtarëve janë të ndryshme, p.sh gjyqtarët e GJL-së janë me mandat me kohëzgjatje të caktuar dhe në përfundim të tij nuk mund të jenë më anëtarë të saj. Për gjyqtarët e krimeve të rënda togfjalëshi ka tjetër rëndësi, nisur nga fakti se gjykatat e posaçme janë struktura të reja dhe kriteret për personelin janë specifike. Në këtë kuptim nuk qëndron pretendimi i kërkuesve se ata nuk janë më gjyqtarë. Nëse një gjyqtar në detyrë në gjykatën e posaçme nuk plotëson kërkesat e nenit 162/2, atëherë ai transferohet në gjykatat e tjera, sipas rregullave të nenit 60 të ligjit. I pabazuar është edhe pretendimi për magjistratët e komanduar, si dhe për mbarimin e mandatit të inspektorëve jo-magjistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, pasi për këto kategori ka rregulla të reja, në përputhje me parashikimet ligjore të ligjeve specifike.

4. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

5. Gjykata, nisur nga prapësimi i subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae* dhe *ratione materiae*, vlerëson të shprehet paraprakisht në lidhje me çështjen e legjitimitit të SHKGJ-së dhe të UGJSH-së.

6. Çështjen e legjitimitit Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimin nr.14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në lidhje me legjitimitimin e shoqatave, si subjekte iniciuese sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje gjykimin kushtetues duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston te e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr.33, datë 24.06.2010; nr.4, datë 23.02.2011; nr.43, datë 06.10.2011; nr.37, datë 13.06.2012; nr.14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vëren se kategoria e subjekteve kushtetuese të përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, është zgjeruar në kuadrin e ndryshimeve kushtetuese. Veçanërisht në lidhje me kategorinë e subjekteve të kushtëzuara, Gjykata konstaton se në të janë përfshirë, midis të tjerash, edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, kurse organizatat janë parashikuar si kategori e veçantë në shkronjën "h" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Gjykata, gjithashtu, vëren se norma kushtetuese e ka rikonfirmuar shprehimisht kërkesën që subjektet mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

9. Referuar rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja "h", i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2, i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, SHKGJ-ja dhe UGJSH-ja legjitimohen *ratione personae*, pasi janë subjekte juridike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, respektivisht me vendimet nr.2160, datë 25.01.2008 dhe nr.2171, datë 04.02.2008. Në nenin 3 të statusit të SHKGJ-së sanksionohet se ajo "*synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor, si dhe mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve*

antikushtetuese, që kanë të bëjnë me këtë sistem apo me statusin e gjyqtarëve". Kurse në nenin 1 të statusit të UGJSH-së parashikohet se shoqata ka për qëllim, midis të tjerash, "të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv". Siç rezulton edhe nga vendimet për regjistrimin si persona juridikë, anëtarët e kërkuesve janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, SHKGJ-ja dhe UGJSH-ja përfshihen në rrethin e subjekteve të kushtëzuara që përcakton neni 134, pika 1, shkronja "h" i Kushtetutës, pasi janë krijuar si shoqata dhe gëzojnë personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

10. Bazuar në statutin, aktin e themelimit, natyrën e veprimtarisë së kërkuesve dhe faktin se dispozitat objekt kundërshtimi ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e tyre, Gjykata çmon se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë së tyre dhe çështjes kushtetuese të pretenduar, për rrjedhojë kërkuesit legjitimohen t'i drejtohen kësaj Gjykate.

11. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata e vlerëson të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, se kërkuesit nuk legjitimohen. Pavarësisht se ndryshimet kushtetuese njohin tashmë Këshillat si organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Kushtetuta nuk përmban ndonjë rregullim të shprehur apo të nënkuptuar që mund të interpretohet se kufizon veprimtarinë e shoqatave të krijuara si grupime vullnetare gjyqtarësh për të kundërshtuar normat ligjore kur ato pretendojnë dhe argumentojnë lidhjen e drejtpërdrejtë me veprimtarinë e tyre. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se faktet dhe rrethanat në çështjen konkrete janë të tilla që përbëjnë arsye bindëse dhe nuk justifikojnë ndryshimin e jurisprudencës së konsoliduar kushtetuese në lidhje me legjitimitimin *ratione personae dhe ratione materiae* të shoqatave.

12. Edhe për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata çmon se kërkuesit e kanë paraqitur kërkesën brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

13. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se SHKGJ-ja dhe UGJSH-ja plotësojnë elementet formale të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit abstrakt kushtetues.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi

14. Kërkuesit kanë kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kërkesë, duke argumentuar se nga hyrja në fuqi të tij në datën 22.11.2016 është krijuar vakum institucional me pasoja të rënda shtetërore deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), si organi i vetëm i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor, referuar neneve 160/1 dhe 173/1 të tij. Ligji, në kundërshtim flagrant me nenin 179 të Kushtetutës, dispozitë e cila nuk vendos kufizime deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), i ka hequr KLD-së kompetencat që lidhen me (a) emërimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, b) transferimet e gjyqtarëve; c) emërimet dhe shkarkimet e kryetarëve të gjykatave; d) komandimet e tyre; e) emërimin e inspektorëve të KLD-së.

15. Sipas kërkuesve, zbatimi i ligjit objekt kundërshtimi, cenon parimin e shtetit të së drejtës, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të statusit të gjyqtarëve, përfshirë të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe të drejtën e karrierës, të drejtën e promovimit, emërimin si kryetar gjykate dhe të drejtën për t'u promovuar në përputhje me ligjin, të sigurisë juridike, parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë përpara ligjit, garantimin e të drejtës së mbrojtjes, si dhe garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, ligji i kundërshtuar mund të paralizojë veprimtarinë e gjykatave për shkak të mosfunksionimit të plotë të KLD-së. Sa më sipër, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese, sipas kërkuesve, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për pezullimin e ligjit si e vetmja mundësi për të parandaluar pasojat që mund t'i vijnë funksionimit normal të shtetit të së drejtës.

16. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, e ka prapësuar këtë pretendim, duke argumentuar se çështjet që ngrihen nuk kanë lidhje me të drejtat dhe liritë e gjyqtarëve dhe as me veprimtarinë e shoqatave kërkuese dhe, po ashtu, kërkesa nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe ajo e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED).

17. Gjykata, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesit në seancën e datës 08.03.2017, vlerësoi se, në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577/2000, i ndryshuar, në rastin konkret nuk përmbushen kriteret ligjore lidhur me mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve nga zbatimi i këtij ligji. Për rrjedhojë, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të papabuar.

C. Për themelin e çështjes

C.1 Për pretendimin e cenimit të hierarkisë së akteve normative

18. Kërkuesit kanë pretenduar se neni 8 në raport me nenin 44, pika 1, shkronja "c", neni 26, neni 28, neni 53/2, neni 64, pika 1, shkronja "c", neni 104, neni 152, neni 166, pika 1 dhe pika 2, shkronja "b", si dhe nenet 160/1 dhe 173/1 të ligjit kanë rregulluar situata të caktuara në mungesë të delegimit të shprehur të normave kushtetuese.

19. Po ashtu, Gjykata, referuar përmbajtjes së kërkesës, konstaton se kërkuesit kanë kundërshtuar edhe nenin 9, pika 1 shkronja "c", me pretendimin se cenon parimin e proporcionalitetit, nenin 64, pika 5, duke argumentuar se cenon të drejtën për punë, kurse lidhur me nenet 161, pikat 2 dhe 3, 162, pikat 1 dhe 6, 164, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, 167, pika 3, shkronja "b", si dhe 168, pika 2, ato parashtrojnë se normat ligjore cenojnë parimin e sigurisë juridike si në drejtim të dhënies fuqi prapavepruese normave ligjore, ashtu dhe paqartësisë së formulimeve ligjore.

20. Bazuar në parimin *iura novit curia*, Gjykata rithekson se ajo ka në kompetencë të vlerësojë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtuar para saj. Në këtë kuptim, Gjykata, në rastin konkret çmon se, pavarësisht cilësimit që iu është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesit, ato do të vlerësohen në këndvështrimin e detyrimit të ligjvënësit për respektimin e hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr.2, datë 03.02.2010; nr.1, datë 12.01.2011; nr.23, datë 08.06.2011; nr.25, datë 28.04.2014; nr.22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kushtetuta në nenin 116 të saj përcakton hierarkinë e burimeve të së drejtës, si një prej vlerave themelore të shtetit të së drejtës, ku pushteti ligjvënës ka rol primar. Përcaktimi në Kushtetutë i hierarkisë së akteve, si dhe sanksionimi i parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në ushtrimin e funksioneve të organeve kushtetuese, të cilat ushtrohen nëpërmjet nxjerrjes së akteve normative, është mishërimi më i plotë i parimit të shtetit të së drejtës në një sistem parlamentar (*shih vendimin nr.5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Piramida e akteve normative përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e

barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr.3, datë 20.02.2006; nr.5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata ka theksuar se Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore e politike të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore. Por Kushtetuta, përveç kësaj, mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lerë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm (*shih vendimin nr.3, datë 20.02.2006; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Fryma dhe qëllimi i kushtetutëbërësit në lidhje me rregullimet kushtetuese nuk mund të anashkalohet dhe organi i vetëm i cili ka autoritetin të vlerësojë pajtueshmërinë e normave ligjore me ato kushtetuese, është Gjykata Kushtetuese. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të tyre. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr.20, datë 01.06.2011; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kërkuar shfuqizimin e dispozitave kalimtare 160/1 e 173/1 të ligjit, duke argumentuar se ato kanë kufizuar kompetencat e KLD-së në periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGJ-së, në kundërshtim me nenin 179, pikat 5 dhe 12 të Kushtetutës.

25. Referuar ndryshimeve kushtetuese, Gjykata konstaton se KLGJ-ja është një organ i ri kushtetues, i përbërë nga 11 anëtarë, (6 gjyqtarë dhe 5 jogjyqtarë) që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (neni 147). Kushtetutëbërësi, në nenin 147, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" ka përcaktuar kompetencat, rastet e përgjegjësisë disiplinore, ato të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLGJ-së, si dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit. Në lidhje me krijimin e KLGJ-së, kushtetutëbërësi ka përcaktuar një periudhë kalimtare prej tetë muajsh nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese,

duke përcaktuar në nenin 179, pika 5 të Kushtetutës se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së. Nga ana tjetër, Kushtetuta në pikën 12 të po këtij neni parashikon qëndrimin e Presidentit të Republikës si kryetar i KLD-së deri në krijimin e KLGJ-së.

26. Në lidhje me ligjin nr.96/2016, objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se ai është një pjesë e paketës së reformës në drejtësi, që, përveç rregullimeve ligjore mbi të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile, përmban edhe disa rregullime të tjera me natyrë kalimtare, të cilat, në detajim të dispozitave kalimtare kushtetuese, përcaktojnë organet kompetente në këtë periudhë, si dhe kompetencat përkatëse të tyre. Konkretisht, në nenin 160, ligji ka parashikuar KLD-në (dhe inspektoratet ekzistuese) si organe, të cilat do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetenca, si: emërimi i magistratëve kandidatë të diplomuar në vitin 2016, caktimi i tyre në pozicion brenda afatit kohor sipas ligjit, vendosja e masave disiplinore, me propozim të ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji, pezullimi i gjyqtarëve, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj, mbikëqyrja e trajnimit të gjyqtarëve, sipas këtij ligji dhe ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", vlerësimi i punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", marrja e masave disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi, vërtetimi i ndërprerjes së emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit, si dhe transferimi përkohësisht i gjyqtarëve për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata.

27. Përveç sa më sipër, Gjykata konstaton se KLD-së i jepen kompetenca të tjera edhe nga dispozita kalimtare, neni 173 i ligjit, e cila, krahas parashikimit se me hyrjen në fuqi të tij shfuqizohet pjesa e më e madhe e ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", përcakton edhe kompetencat që do të ushtrojë KLD-ja në periudhën kalimtare: "*b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre.*".

28. Gjykata, për të analizuar bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të kërkuesve, vlerëson se në rastin në shqyrtim duhet të zbatohet standardi i interpretimit pajtues me Kushtetutën, në mënyrë të veçantë me nenin 179 të Kushtetutës. Kjo metodë, analizon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese. Bazuar në këtë metodë interpretimi, Gjykata ka arritur në përfundimin se një ligj i kundërshtuar është kushtetues, me kusht që normat e tij të interpretohen në atë mënyrë siç ka bërë Gjykata në vendimin e saj (*shih vendimet nr.29, datë 31.05.2010; nr.33, datë 24.06.2010; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke i vlerësuar rregullimet ligjore të neneve 160/1 e 173/1 të ligjit në kontekstin e detyrimeve që imponon parimi i shtetit të së drejtës për respektimin e hierarkisë së akteve normative, Gjykata konstaton paraprakisht se neni 179 i Kushtetutës nuk përmban rregullim apo delegim të shprehur për ligjvënësin lidhur me përcaktimin e kompetencave që do të ushtrojë KLD-ja në periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGJ-së. Megjithatë, Gjykata vlerëson se ky konstatim nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se *“anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, sipas ligjit”* shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Për sa kohë vullneti i kushtetutëbërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, Gjykata vlerëson se KLD-ja ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës.

30. Në lidhje me pretendimet se nenet 8 dhe 44, pika 1, shkronja “c” të ligjit e tejkalojnë rregullimin kushtetues të neneve 138 e 143, Gjykata konstaton se normat objekt kundërshtimi rregullojnë çështjen e papajtueshmërisë ambientale, e cila nënkupton atë lloj papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të magjistratit, që krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose persona të tjerë në lidhje të ngushtë gjaku ose me ligj, sipas parashikimeve të KPC-së. Ligji ka parashikuar detyrimin e magjistratit për të njoftuar pa vonesë Këshillat përkatës, të cilët ose e caktojnë magjistratin në një seksion tjetër, ose në rast pamundësie, transferojnë një nga magjistratët në papajtueshmëri në gjykatën ose prokurorinë më të afërt të mundshme të të njëjtit nivel, në rast se magjistrati përmbush të

gjitha kriteret e parashikuara për këtë pozicion. Transferimi për shkak të papajtueshmërisë ambientale ka përparësi ndaj lëvizjeve paralele, kurse në rastin e krijimit të marrëdhënieve familjare, që çojnë në papajtueshmëri ambientale, magjistrati transferohet edhe pa pëlqimin e tij (neni 44/1/c).

31. Gjykata vëren se ligjvënësi, duke marrë si kriter lidhjet e ngushta familjare dhe ato që krijohen për shkak të ligjit midis magjistratëve, ka vendosur në nenin 8 krahas ndalimit të përgjithshëm për mosushtrimin e funksionit “*në gjykatë ose prokurori*” dhe ndalimet specifike që përfshijnë: “*(mos) ushtrimin e funksionit në gjykatën administrative të shkallës së parë nëse një gjyqtar me lidhje të ngushta familjare me të ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, ose anasjelltas; në seksionin civil të gjykatës së shkallës së parë nëse një gjyqtar me lidhje të ngushta familjare me të ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit që ka nën juridiksion gjykatën e shkallës së parë, ose anasjelltas; në seksionin penal të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë dhe në prokurorinë në juridiksionin e saj nëse një magjistrat tjetër, me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit që ka në juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, ose anasjelltas*”. Po ashtu, Gjykata konstaton se kufizimi vlen edhe për gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

32. Kushtetuta ka përcaktuar në nenin 138 sistemin e garancive, që synojnë të sigurojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe kufizimet përkatëse, kurse në nenin 143 ajo ka parashikuar rastet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, duke renditur si kriter ndaluese “*veprimtarinë tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe të delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*”.

33. Kuptimi dhe rëndësia e sistemit të garancive që lidhen me statusin e gjyqtarit është analizuar edhe më parë nga jurisprudenca kushtetuese. Një ndër çështjet e trajtuara në kontekstin e mësipërm është edhe ajo e pajtueshmërisë me Kushtetutën të kriterit ligjor ndalues të mospasjes së konfliktit të interesit apo lidhjeve nepotike midis gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kriteri, i cili ndalonte zgjedhjen si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, është analizuar nga Gjykata në kontekstin e të drejtës/garancisë për karrierë, pjesë integrale e statusit të gjyqtarit, që mbrohet nga neni 138 i Kushtetutës (shih vendimin nr.40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Në atë çështje Gjykata arriti në përfundimin se krijimi i besimit te publiku për sa i përket integritetit dhe imazhit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë është një qëllim që i përgjigjet interesit publik të mirëadministrimit të drejtësisë, por në lidhje me mjetin e zgjedhur ai nuk

ishte proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi.

34. Gjykata rithekson se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre dhe mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë. Statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve (*shih vendimet nr.31, datë 02.12.2009; nr.40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Sipas jurisprudencës kushtetuese, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që ata kanë, pra dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime për sa i takon figurës së tyre (*shih vendimin nr.23, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin konkret, Gjykata çmon se ligjvënësi, duke e lidhur ushtrimin e funksionit të magjistratit në një gjykatë të caktuar (seksion apo edhe juridiksion), ndër të tjera, edhe me vlerësimin e kriterit shtesë “*papajtueshmëri ambientale*”, të përcaktuar në nenin 8, vendos një kufizim për karrierën e gjyqtarëve, të cilët, si rezultat i situatave ndaluese për shkak të lidhjeve të gjakut edhe për shkak të ligjit, transferohen, masë kjo që mund të jetë e përkohshme ose e përhershme, apo edhe kundër pëlqimit të tyre (*shih kreun IV – Transferimi*).

37. Gjykata vlerëson se karriera, si pjesë integrale e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës (paga dhe përfitimet e tjera), është në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve. Për rrjedhojë, kufizimi i karrierës së magjistratit nga ligjvënësi, tej urdhërimit të nenit 143 të Kushtetutës, nëpërmjet parashikimit të kriterit ndalues të “*papajtueshmërisë ambientale*”, nuk është në përputhje me qëllimin që kërkohet të arrihet. Në këtë kuptim, Gjykata e vlerëson si të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar,

Kuvendit të Shqipërisë se parashikimi ligjor nuk përbën kufizim të së drejtës për të ushtruar profesionin, por ka të bëjë me vendin ku ushtrohet detyra, dhe po ashtu është një garanci në dhënien e drejtësisë për qytetarët, duke marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve se nenet 8 dhe 44, pika 1, shkronja “c”, të ligjit bien ndesh me nenin 138 dhe 143 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhet pranuar.

39. Duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi si më sipër, Gjykata e vlerëson të bazuar edhe pretendimin tjetër të parashtruar nga kërkuesit në lidhje me nenin 9, pika 1, shkronja “c”, të ligjit, që rregullon veprimtaritë jashtë funksionit, për shkak të parashikimit të kriterit kufizues “*nuk i kalojnë 200 orë jashtë orarit të punës për vit*”. Gjykata e vlerëson pozitive qasjen lejuese të ligjvënësit lidhur me parashikimin e të drejtës së magjistratit që të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, edhe jashtë orarit të punës. Po ashtu, Gjykata e çmon legjitimitetin interesin e ligjvënësit për sa u takon ndalimeve për të tilla veprimtari gjatë orarit të punës, pasi synohet garantimi i dinjitetit në ushtrimin e funksionit, moskrijimi i perceptimeve të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit, respektimi i interesave thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, pavarësisht rëndësisë së objektivit të ligjvënësit dhe pranisë së interesit publik për një sistem gjyqësor efektiv dhe magjistratë të angazhuar në ushtrimin e funksionit të tyre, bazuar në kërkesën kushtetuese për ndërhyrje legjislative proporcionale, në rastin konkret mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi në fjalinë e fundit e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 9 bie ndesh me nenin 17 dhe 143 të Kushtetutës.

40. Gjykata vëren se kërkuesit kanë parashtruar në kërkesë pretendime edhe për nenin 26 të ligjit, duke argumentuar se ndonëse ulja e ngarkesës parashikohet si e drejtë e magjistratit, fakti që kjo e drejtë shoqërohet edhe me ulje të pagës, bie ndesh me nenin 138 të Kushtetutës, që përcakton elementet e statusit të gjyqtarit, përfshi edhe pagën, pa të cilat nuk mund të garantohet ushtrimi në mënyrë të pavarur i funksionit.

41. Kushtetuta në nenin 138, i cili është pjesë e ndryshimeve kushtetuese, parashikon se paga dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen, përveç rasteve kur: a) *nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit, ose emergjenca të tjera financiare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht sipas ligjit.*

Gjykata vëren se ndryshimet kushtetuese në nenin 138 kanë parashikuar tre kritere që justifikojnë uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, ku kriteri i parë nuk lidhet me vullnetin apo sjelljen e gjyqtarit, kriteri i dytë është rrjedhë e ligjit (mbarimi i mandatit *ipso lege*), kurse kriteri i tretë lidhet ngushtësisht me sjellje/situata të tilla që përbëjnë shkelje disiplinore apo me cilësitë profesionale të magjistratit (pamjaftueshmëria profesionale).

42. Ligji të drejtën e magjistratit për ulje të ngarkesës së çështjeve në rast nevoje e ka lidhur edhe me uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, duke vendosur kushtin “jo më shumë se 75 për qind”. Referuar normës ligjore, Gjykata konstaton se dy janë situatat për të cilat magjistrati ka të drejtë për ulje ngarkese: a) sëmundja e përkohshme, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet; b) studimet jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet.

43. Duke e analizuar këtë pretendim të kërkueseve nga këndvështrimi i detyrimeve që burojnë për ligjvënësin nga nenet 138 dhe 116 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se, pavarësisht faktit që *prima facie* togfjalëshi “ka të drejtë” mund të interpretohet si “risi”, siç arsyetohet edhe në relacionin shoqërues të ligjit, pra për një garanci më shumë për magjistratin sesa për penalizim të tij, ulja deri në 75 për qind e pagës në rast të një ulje proporcionale të ngarkesës, pavarësisht rrethanave, nuk është proporcionale me qëllimin e ligjvënësit për garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

44. Në vlerësimin e Gjykatës, në rastin konkret Kushtetuta është cenuar në frymën dhe shkronjën e saj, pasi ligji në nenin 26 ka shtuar kritere përjashtuese tej atyre që përcakton neni 138 i Kushtetutës. Për sa kohë norma ligjore objekt kundërshtimi nuk është detajim i ndonjërit prej rasteve përjashtimore të përcaktuara nga Kushtetuta, ligjvënësi në formulimin e saj duhet të kishte pasur parasysh faktin se në çdo rast magjistratët duhet të gëzojnë pavarësi ekonomike të mjaftueshme dhe se paga e tyre nuk mund të ulet poshtë një niveli minimal të tillë që është i papajtueshëm me funksionin e gjyqtarit.

45. Në këtë kuptim, Gjykata, duke marrë në konsideratë edhe faktin se subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, përveç argumentit se kjo normë ligjore është një e drejtë e magjistratit, nuk solli asnjë argument tjetër shtesë për të provuar se situata dhe rrethanat e vlerësuara paraprakisht për këtë rregullim ligjor nuk cenonin parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuesve është i bazuar dhe duhet pranuar.

46. Gjykata konstaton se një tjetër pretendim i kërkuesve që argumentohet

me mosrespektimin e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës është ai që lidhet me nenin 64 të ligjit, që ka përcaktuar arritjen e moshës së pensionit, si kriter për mbarimin e statusit të magjistratit.

47. Referuar jurisprudencës kushtetuese, e cila ka reflektuar vazhdimisht standardet ndërkombëtare mbi statusin e gjyqtarit, Gjykata rithekson se pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimet nr.31, datë 02.12.2009; nr.40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht moshën e daljes në pension 70 vjeç vetëm për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë. Në lidhje me magjistratët e tjerë, ligji në pikën 5 të nenit 64 parashikon se statusi i tyre mbaron në fund të muajit në të cilin kanë mbushur moshën e pensionit kur ata plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj për të dalë në pension. Po ashtu, Gjykata konstaton se ligji në nenin 27 ka parashikuar mbushjen e moshës 60 vjeç si kufirin për të përfituar pension të parakohshëm.

49. Bazuar në interpretimin literal të normës, Gjykata vlerëson se ligjvënësi përmes përdorimit të shprehjes “*kushtet e parashikuara në ligj*” e ka lidhur daljen në pension të magjistratit me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon kuadri ligjor për pensionet në Republikën e Shqipërisë. Duke e analizuar rregullimin ligjor për pensionin e pleqërisë së magjistratëve në kontekstin e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës zbatimi i normës ligjore, sipas formulimit aktual, ngre dyshime serioze për mosrespektimin e disa parimeve kushtetuese. Konkretisht, ligjvënësi, duke ulur moshën e daljes në pension nga 65 vjeç që ishte më parë, në një moshë të papërcaktuar shprehimisht, por të përcaktueshme rast pas rasti nga kuadri ligjor për pensionet e pleqërisë në RSH-së, ka krijuar një gjendje pasigurie juridike në radhët e magjistratëve, kjo për faktin se referuar bazës kushtetuese për miratimin e ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ai është ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë, çka mbart rrezikun potencial që mund të ndryshohet në mënyrë të vazhdueshme, në varësi të politikave sociale dhe përshtatjen e skemës së pensioneve apo rishikimin e moshës së pensionit, me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Nga ana tjetër, prania e parashikimeve ligjore të paharmonizuara për pensionin e parakohshëm dhe atë të pleqërisë, ku për të dyja rastet mosha e përcaktuar nga ligjvënësi është 60 vjeç, si dhe rreziku i trajtimit të pabarabartë të gjyqtarëve për shkak të gjinisë, pasi, sipas legjislacionit në fuqi, mosha e daljes në pension e femrave ndryshon nga ajo e meshkujve, në vlerësimin e Gjykatës përbëjnë arsye bindëse për të arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesve për papajtueshmërinë me nenet 18 dhe 138 të

Kushtetutës të nenit 64, pika 5 është i bazuar dhe duhet pranuar.

50. Për sa i përket pretendimit për shfuqizimin e nenit 104 të ligjit, që rregullon shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale, dhe nenit 152, që përcakton transferimin mbi bazë diskrecioni, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë argumentuar se rregullimet ligjore parashikojnë raste shkarkimi dhe pezullimi për magjistratët në tejkalim të atyre të përcaktuara respektivisht nga neni 140, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronjat “a” dhe “b” të po këtij neni.

51. Gjykata vëren se kushtetutëbërësi e ka lidhur shkarkimin e gjyqtarit me dy kategori shkeljesh: *së pari*, shkeljet e rënda profesionale ose etike, që diskretitojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe, *së dyti*, kryerjen e një krimi, për të cilin gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë (*neni 140/1*). Për sa u përket shkaqeve të pezullimit të gjyqtarit, Gjykata konstaton se norma kushtetuese rendit si të tilla: “a) kur ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor sipas ligjit.” (*neni 140/3*). Si në rastin e shkarkimit, ashtu edhe të pezullimit të një gjyqtari nga detyra, Kushtetuta ka përcaktuar KLGJ-në si organin kompetent për dhënien e vendimit.

52. Referuar ligjit, Gjykata vëren se çështjet e përgjegjësisë disiplinore, civile dhe penale rregullohet nga një sërë nenesh (*nenet 100 –116*), të cilat sanksionojnë parimet e procedimit disiplinor, shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë, shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit dhe jashtë tij, *shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale* si dhe masat disiplinore, të cilat përfshijnë edhe pezullimin e shkarkimin e magjistratit (*nenet 100-111*).

53. Gjykata konstaton se ligjvënësi e ka lidhur shkarkimin nga detyra të magjistratit me vërtetimin e shkaqeve të tilla si: “a) kur shkelja është shumë e rëndë²¹⁵; b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi

215 Sipas nenit 115, në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh këto kritere: a) llojin dhe rrethanat e shkeljes; b) shkallën e fajësisë dhe motivin; c) pasojat e shkeljes; ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; ë) sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; f) sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; g) çdo çështje tjetër që Këshilli e konsideron të rëndësishme.

të rëndë, sipas nenit 101, shkronja “b”, të këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.” (neni 111/1).

54. Përveç sa më sipër, Gjykata vëren se neni 104 i ligjit parashikon edhe shkaqe të tjera që çojnë në shkarkimin e magjistratit nga detyra, duke konsideruar si të tilla faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati: a) është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilën ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë; b) është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia; c) është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a dhe “b”, të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë; ç) faktet e pranuar nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë vepër penale, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfituar nga falja dhe amnistia.

55. Bazuar në interpretimin literal të nenit 104, Gjykata konstaton se shkronjat “a” dhe “b” e zbërthejnë nocionin “krim” të përdorur nga neni 140/2/b i Kushtetutës në “vepër penale me dashje” ose “vepër penale nga pakujdesia”; shkronja “c” përfshin një numër të pacaktuar veprash penale të ndryshme nga ato të dy shkronjave të para, por e lidh faktin penal edhe me pasojën diskredituese ndaj figurës së gjyqtarit, duke e përzier deri diku atë me shkakun e shkarkimit që parashikon neni 140/2 shkronja “a” e Kushtetutës. Ndërsa në shkronjën “d” zgjerohet tërësisht kategoria e veprave penale, duke e lidhur shkarkimin e magjistratit edhe me ato raste kur vepra penale është shuar, kur ndjekja penale s’mund të fillojë ose s’mund të vazhdojë, është rehabilituar, apo ka përfituar nga falja apo amnistia.

56. Edhe në lidhje me pezullimin e magjistratit, Gjykata vëren se përveç nenit 110, që përcakton rregullat për pezullimin për një periudhë nga 3 muaj deri në dy vjet, shoqëruar me një pagë minimale, neni 152 parashikon edhe pezullimin mbi bazë diskrecioni, duke i njohur Këshillit autoritetin për të pezulluar magjistratin nëse: a) ndaj magjistratit ka filluar hetimi penal; b) kur ndaj tij është caktuar masa e arrestit për një vepër penale të kryer nga pakujdesia; c) kur ndaj tij kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore. _

57. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ligjvënësi në nenet

104 dhe 152 ka parashikuar raste të tjera shkarkimi apo pezullimi për magjistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkueseve është i bazuar dhe duhet pranuar.

58. Lidhur me pretendimet për nenet 161, pikat 2 dhe 3, 162, pikat 1 dhe 6, 164, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, 167, pika 3, shkronja "b" dhe 168, pika 2, Gjykata paraprakisht sjell në vëmendje se normat e kundërshtuara janë dispozita të tjera kalimtare të ligjit, dhe si të tilla, referuar jurisprudencës kushtetuese, ato rregullojnë momentin e kalimit nga një sistem në një tjetër, duke parashikuar mënyrën si do zbatohen dispozitat e reja në lidhje me situatat faktike ose marrëdhëniet ekzistuese. Me plotësimin e këtij qëllimi (realizimin e këtij kalimi) ato e humbasin efektin e tyre (*shih vendimin nr.24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Gjykata vëren se normat e mësipërme ligjore rregullojnë vazhdimësinë e statusit dhe qëndrimin në detyrë sipas mandatit të mëparshëm të gjyqtarëve të niveleve apo kategorive të ndryshme, duke përfshirë *magjistratët* në Gjykatën e Lartë, *gjyqtarët* në Gjykatat e Krimeve të Rënda, *magjistratët* e gjykatave dhe prokurorive të tjera, *magjistratët* e komanduar në institucione të tjera, si dhe për inspektorët *me statusin e gjyqtarit* në KLD. Referuar përmbajtjes së tyre, Gjykata konstaton se dispozitat kalimtare e lidhin vijimësinë e detyrës së magjistratit me plotësimin e dy kritereve që përfshijnë "*me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji*" dhe rezultatet e rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr.84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".

60. Ashtu siç u shpreh edhe më sipër, Gjykata rithekson se fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës. Kjo vlerë kushtetuese garantohet veçanërisht nga neni 179/a i Kushtetutës, i cili parashikon shprehimisht se mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë përjashtuar nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 (kur verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik) dhe 45, pika 3 (si rregull ata që janë dënuar me burgim me vendim përfundimtar të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ose të tjerë sipas rasteve përjashtimore dhe të justifikuara) të Kushtetutës. Përveç sa më sipër, Kushtetuta përmban një

rregullim të veçantë në nenin 179, pika 10 për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përcaktuar se ata që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, qëndrojnë në detyrë dhe i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës.

61. Jurisprudenca kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se mbarimi përpara afatit i mandatit të gjyqtarit sigurisht që mund të ndodhë dhe ky është një moment që njihet në praktikën kushtetuese dhe ligjore, por vetëm nëse vërtetohen ato raste, të cilat nuk kanë të bëjnë me mbarimin natyrshëm dhe në rrugën normale të tij, siç mund të jenë dorëheqja, arritja e moshës së pensionit, dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, etj. (*shih vendimin nr.51, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese*)

62. Referuar një analize të harmonizuar të normave ligjore, Gjykata vëren se “shkaqet për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji” përfshijnë dorëheqjen me shkrim para Këshillit përkatës (neni 64), vërtetimin e kushteve të pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit (neni 66), mbushjen e moshës së pensionit (neni 64/5), shkarkimin nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji (pjesa V), si dhe vërtetimin e faktit të pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 67).

63. Veçanërisht në lidhje me kushtet e pazgjedhshmërisë të përcaktuara në pikën 1 të nenit 66 të ligjit, Gjykata vëren se ato përfshijnë (a) *mosplotësimin nga magjistrati të kriterëve të përcaktuara sipas nenit 28 të këtij ligji, që lidhet me pranimin në formimin fillestar, dhe (b) pavlefshmërinë e vendimit të emërimit të magjistratit dhe kur ai nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston*. Nisur nga kjo teknikë referuese e përdorur në hartimin e normave ligjore të analizuara më sipër, Gjykata vlerëson se përcaktimi nga ligjvënësi i detyrimit të magjistratit për të plotësuar, midis të tjerash, edhe kriteret e nenit 28 të ligjit, nuk do të thotë gjë tjetër veçse plotësim i detyrimit ligjor për të përfunduar Shkollën e Magjistraturës.

64. Në vështrim të sa më sipër, nisur nga vullneti i kushtetutëbërësit, i shprehur në nenin 179, pika 10 për qëndrimin në detyrë të gjyqtarëve e prokurorëve që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe parashikimin e tyre si subjekt i rivlerësimit kalimtar, si dhe për sa kohë nenet 179/a dhe 179/b të Kushtetutës kanë përcaktuar qartë kriteret që çojnë në mbarimin ose pavlefshmërinë e mandatit të magjistratit, të zgjedhur ose të emëruar, duke i lidhur ato shprehimisht me rregullimet e neneve 6/1, 45, pika 3 të Kushtetutës, si dhe me rezultatet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Gjykata çmon se kërkesa ligjore e përcaktuar në nenet 161, pika 2, 162, pikat 1 dhe 6, 164, pika 1, shkronja “a”, 167, pika 3, shkronja “b” dhe 168, pika 2 për të vlerësuar qëndrimin

ose jo në detyrë të magistratëve në Gjykatën e Lartë, gjyqtarëve në Gjykatat e Krimeve të Rënda, magistratëve të gjykatave dhe prokurorive të tjera, magistratëve të komanduar në institucione të tjera, si dhe për inspektorët me statusin e gjyqtarit në KLD sipas kriteve për mbarimin e statusit të magistratit, në zbatim të pjesës III të kreut VIII të këtij ligji ku përfshihet edhe përfundimi i Shkollës së Magistraturës, është në tejkalim të Kushtetutës.

65. Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga kërkuesit në lidhje me nenin 161, pika 3, nenin 162, pika 6 dhe nenin 164, pika 2, ku parashikohen respektivisht mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Lartë, i kryetarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit dhe i kryetarëve të gjykatave dhe prokurorive pas 9 muajve nga krijimi i Këshillave, Gjykata rithekson se funksioni i kryetarit të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit apo të gjykatave të zakonshme, si drejtues administrativ, buron nga pasja e cilësisë themelore të gjyqtarit. Koncepti ligjor për mandatin e gjyqtarit gjen shprehjen e vet në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1985, në pikën 12 të së cilës përcaktohet se *“... gjykatësit, qofshin të emëruar ose të zgjedhur, nuk mund të hiqen derisa... nuk kanë arritur fundin e mandatit të vet”*, gjithashtu edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në pjesën e nëntë *“Gjykatat”*, veçanërisht në nenet 136 deri 140, njeh dhe pranon si mandat atë të gjyqtarit (*shih vendimin nr.51, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Në vështrim të sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë se parimet themelore të shtetit të së drejtës nënkuptojnë, midis të tjerave, edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueseve për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe sigurisë juridike, për shkak të fuqisë prapavepruese të neneve të analizuara, është i bazuar.

C.2 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

67. Kërkuesit kanë pretenduar se parimi i sigurisë juridike cenohet jo vetëm për shkak të dhënies fuqi prapavepruese parashikimeve ligjore dhe, për rrjedhojë, shkeljes së të drejtave të fituara, por edhe sa i takon paqartësisë së formulimit të normave të caktuara ligjore.

68. Gjykata, paraprakisht, vlerëson se pretendimi i kërkueseve në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike nga neni 28, neni 42, pika 3, shkronjat *“a”*, *“b”*, *“c”* dhe *“ç”*, pikat 8 e 9 të tij, neni 43, neni 47, pika 2, shkronjat *“b”* dhe *“c”*, si dhe pikat 4 e 5 të tij, nuk është ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë këto norma nuk do të analizohen.

69. Në lidhje me nenin 103, objekt kundërshtimi Gjykata vëren se kërkuessit kanë argumentuar se për shkak të përdorimit të termave si “sjellje e papërshtatshme” ose “shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit”, të cilat lënë hapësira për interpretim, dispozita është e paqartë dhe jo në përputhje me qëllimin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma. Përveç sa më sipër, Gjykata, bazuar në kompetencën që neni 49 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i ka njohur asaj që rast pas rasti të përcaktojë kufijtë e shqyrtimit të çështjes, vlerëson të analizojë nëse edhe neni 101, i pakundërshtuar nga kërkuessit, si dhe neni 102 në tërësi, i kundërshtuar në kontekstin e cenimit të pavarësisë së brendshme të pushtetit gjyqësor, përmbushin ose jo kërkesën kushtetuese për qartësi e kuptueshmëri.

70. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007; nr.40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (shih vendimet nr. 36, datë 15.10.2007; nr.40, datë 07.07.2014; nr.10, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

71. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e individit dhe shoqërisë të shteti e ligji, madje edhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë edhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancisë (shih vendimet nr.40, datë 07.07.2014; nr.11, datë 06.03.2014; nr.9, datë 26.02.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr.26, datë 02.11.2005; nr.34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

72. Referuar neneve 101, 102 dhe 103, Gjykata konstaton se ato përmbajnë rregulla mbi përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale të magistratëve, duke rregulluar konkretisht shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë, shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit.

73. Nga analiza në tërësi e përmbajtjes së këtyre normave ligjore Gjykata vëren se mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet. Veçanërisht për shkak të rëndësisë që kanë për magistratin pasojat që sjell shkelja disiplinore (nga vërejtje konfidenciale, publike, ulje e përkohshme e pagës, ulje në detyrë, pezullim nga 3 muaj në 2 vjet, si dhe shkarkim), Gjykata vlerëson se terminologjia e përdorur dhe teknika legjislative e hartimit të tyre, ngre dyshime serioze mbi kuptueshmërinë e ndryshme të tyre, çka mund të rezultojë në pasoja negative serioze për statusin e magistratit dhe përfitimet që lidhen me të.

74. Përveç sa më sipër, Gjykata konstaton se paqartësia e normave reflektohet në tërësinë e ligjit, për rrjedhojë i sugjerohet ligjvënësit që në procesin e rishikimit të ligjit, objekt kundërshtimi, të marrë në konsideratë nevojën për përmirësimin në tërësi të terminologjisë së përdorur në hartimin e normave ligjore, për të garantuar pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën.

75. Për arsyet e mësipërme, Gjykata e vlerëson të bazuar pretendimin e kërkuësve për cenimin e sigurisë juridike për shkak të formulimit të paqartë të neneve 101, 102 dhe 103 të ligjit.

C.3 Për pretendimin e cenimit të parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor

76. Kërkuësit kanë pretenduar se neni 9, pikat 7 dhe 8, neni 23, pikat 10 dhe 11, fjalia parë, neni 78, pikat 3 dhe 5, neni 87, pikat 3, 4, 5, 6 dhe neni 153, shkronja "ç" cenojnë pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor për shkak të parashikimit në këto norma të raporteve të varësisë midis magistratit dhe kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, ose të dhënies këtyre të fundit të kompetencave të cilat bien ndesh me përcaktimet e nenit 145 të Kushtetutës dhe aktet ndërkombëtare në lidhje me pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Përveç sa më sipër, bazuar në parimin *iura novit curia*, Gjykata sjell në vëmendje se analiza në vijim krahas neneve të mësipërme përfshin edhe pretendimet e kërkuësve në lidhje me nenin 95, pika 7.

77. Kushtetuta në nenin 145/1 parashikon: "*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*". Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës,

kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr.5, datë 16.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 145/1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (pavarësia nga pushteti e tjera), ka edhe një pavarësi të brendshme (gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve) (*shih vendimin nr.40, datë datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*)

78. Referuar standardeve ndërkombëtare për pavarësinë e pushtetit gjyqësor, Gjykata thekson se pavarësia e brendshme e pushtetit gjyqësor është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e jashtme e tij. Një organizim hierarkik i gjyqësorit, në kuptimin e varësisë së gjyqtarëve ndaj kryetarëve të gjykatave ose shkallëve më të larta në procesin e tyre vendimmarrës, përbën një cenim të pastër të këtij parimit. Një gjyqtar në ushtrimin e funksioneve të tij është vartës i askujt; ai ose ajo është bartës i një funksioni shtetëror dhe, në këtë kuptim, i shërben dhe përgjigjet vetëm ligjit. Është aksiomë se një gjyqtar kur vendos për një çështje, nuk vepron mbi bazën e urdhrave ose udhëzimeve të ndonjë pale të tretë brenda ose jashtë gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit nuk është vetëm e pushtetit si një i tërë *vis-à-vis* pushteteve të tjera të shtetit, sepse ka edhe një aspekt të "brendshëm". Çdo gjyqtar, pavarësisht vendit të tij në sistemin gjyqësor, ushtron të njëjtin autoritet gjykimi. Në çështjet gjyqësore ai është i pavarur edhe *vis-à-vis* gjyqtarëve të tjerë, si dhe në raport me kryetarin e gjykatës ose gjykatat e tjera të apelit ose të larta (*shih për më tepër opinionet e Komisionit të Venecias CDL(2007)003 dhe CDL-AD(2010)004*).

79. Po ashtu, Gjykata rithekson se pavarësia gjyqësore individuale sigurohet krahas procedurave të emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve mbi bazën e kualifikimit profesional dhe integritetit personal, edhe nëpërmjet kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit e sigurisë financiare, pavarësisë në vendimmarrje, si dhe garantimit të të drejtave vetjake (*shih opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2012)014*).

80. Duke iu rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se pikat 7 dhe 8 të nenit 9, të analizuara edhe më sipër, kanë si objekt rregullimi detyrimin e magjistratit për të njoftuar kryetarin për veprimtaritë jashtë funksionit të papaguara, të cilat nuk janë kompetencë e Këshillit. Sipas pikës 8 të këtij neni "*Kryetari raporton të paktën një herë në vit në Këshillat përkatës për natyrën dhe numrin e orëve, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit të magjistratëve në gjykatën ose prokurorinë respektive*". Gjykata konstaton gjithashtu se ligjvënësi ka parashikuar kompetenca për kryetarin e gjykatës edhe në lidhje me dhënien e pushimeve vjetore (neni 23, pika 11, fjalia e parë). Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më

shumë se tre ditë i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre. Ligji e ndalon magistratin të kryejë mungesa në detyrë, me përjashtim të rasteve të sëmundjes dhe aksidentit. Në rast se mungesat kryen dhe janë të pamiratuara ato zbriten nga periodha e pushimeve vjetore dhe pavarësisht nëse jepet masë disiplinore ose jo, magjistrati nuk paguhet për ditët e munguara (neni 23, pika 10).

81. Po ashtu, kompetenca të tjera të kryetarit që kundërshtohen nga kërkuesit janë ato lidhen me vlerësimin e magistratit (neni 78, pika 3) dhe fillimin e procedimit të pezullimit nga KLGJ-ja me kërkesë të kryetarit kur ai vlerëson se magjistrati nuk mund të qëndrojë përkohësisht në detyrë për shkaqe që lidhen me shëndetin fizik ose mendor (neni 153, shkronja “ç”).

82. Veçanërisht në lidhje me kompetencën e kryetarit për vlerësimin e magistratëve, Gjykata, referuar normave ligjore për kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit (kreu II), si dhe procedurës së vlerësimit dhe ecurisë së saj (kreu III, seksioni 2 dhe 3), konstaton se mendimi i kryetarit është një nga burimet e vlerësimit, krahas kriterëve të tjera (neni 77).

83. Vlerësimi i magistratit bazohet në katër kriterë: a) aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; b) aftësitë organizative; c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional (neni 78, pika 1). Për sa u përket niveleve të vlerësimit, ato përfshijnë: a) “Shkëlqyeshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta; b) “Shumë mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren; c) “Mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare; ç) “Mjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren. d) “I pamjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët (neni 71).

84. Në lidhje me mendimin e kryetarit, si burim për vlerësimin përfundimtar të magistratit nga Këshilli përkatës, ligji ka përcaktuar se i njoftohet magistratit brenda 4 javëve nga data e marrjes së njoftimit për vlerësimin (neni 87, pika 3). Po ashtu, magjistrati, brenda tre ditëve nga njoftimi, gëzon të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin, për t’u takuar me të, si dhe për të paraqitur kundërshtimet e mundshme për vlerësimin në procesverbalin e takimit (neni 87, pika 5).

85. Në lidhje me vlerësimet, përveç parashikimit të niveleve si më sipër, Gjykata vëren se vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kriterë dhe “mirë”

për njërin prej tyre dhe, në çdo rast, nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm” (neni 78, pika 3). Gjithashtu, sipas ligjit, edhe vlerësimi “i pamjaftueshëm” nuk i jepet magjistratit nëse kryetari i gjykatës e ka vlerësuar atë “shumë mirë” (pika 5, fjalia e fundit).

86. Gjykata, gjithashtu, konstaton se nëse vlerësimi për magjistratin është “i pamjaftueshëm” (ose edhe më i ulët), paga e tij ulet me dy për qind gjatë dy viteve kalendarike. Në rastin e vlerësimit “i pamjaftueshëm” Këshilli i dorëzon raportin e vlerësimit ILD-së dhe magjistrati ka të drejtë të ankimojë në Gjykatën e Lartë vendimin e Këshillit që e ka vlerësuar atë me një nivel më të ulët se sa “mirë” (neni 95, pika 7).

87. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pavarësisht disa garancive të përcaktuara nga normat e analizuara më sipër, të cilat *prima facie* duket se sigurojnë një pozicion të balancuar dhe rol asnjëanës të kryetarit në raport me magjistratin, siç është edhe rasti i rregullimeve të nenit 87, pikat 3, 4, 5 dhe 6, rregullimet e tjera ligjore të neneve 9, pikat 7 dhe 8, 23, pikat 10 dhe 73, pika 3, shprehja “nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm”” dhe pika 5, shkronja “b”, fjalia e fundit, nuk respektojnë kërkesën kushtetuese për pavarësi individuale të gjyqtarit, e cila duhet ta karakterizojë atë gjatë ushtrimit të funksionit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se ky element i pavarësisë së pushtetit gjyqësor nuk garantohet as nga neni 95, pika 7, i cili e ka kufizuar të drejtën e ankimit vetëm ndaj vendimeve të Këshillit që e kanë vlerësuar magjistratin “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”. Edhe pse ligjvënësi ka sanksionuar shprehimisht në ligj qëllimin e vlerësimit të magjistratit, duke synuar, midis të tjerash, edhe zhvillimin e karrierës bazuar në meritë, si dhe parimet mbi të cilat bazohet dhe zbatohet vlerësimi, Gjykata çmon se formulimet ligjore të analizuara më sipër jo vetëm nuk e garantojnë, por bëhen pengesë serioze për respektimin e parimit të pavarësisë së brendshme të magjistratit, të zhvillimit të karrierës profesionale dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë vlerësimit, ku e drejta e ankimit për aktin e vlerësimit përbën një aspekt të rëndësishëm (neni 69, shkronjat “a”, “b” dhe “ç”).

88. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësve në lidhje me nenin 153, shkronja “ç” nuk janë ngritur në nivel kushtetues, kurse për sa u takon argumenteve për nenin 9, pikat 7 dhe 8, nenin 23, pika 10, nenin 78, pika 3, shprehja “nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm”” dhe pika 5, shkronja “b”, fjalia e fundit, si dhe nenin 95, pika 7, shprehja “me një nivel më të ulët se sa “mirë””, Gjykata vlerëson se rregullimet ligjore në fjalë nuk kanë

arritur të sigurojnë njëkohësisht elementet e pavarësisë së brendshme të magistratit, për rrjedhojë pretendimet e kërkuësve për papajtueshmërinë e tyre me nenin 145/1 të Kushtetutës janë të bazuara dhe duhen pranuar.

C.4 Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit

89. Kërkuësit kanë pretenduar se neni 12, pika 2, shkronja "b", neni 28, neni 64, pika 1, shkronja "c" dhe pika 5, si dhe neni 169, pika 5 përmbajnë rregullime ligjore, që i vendosin magistratët në pozita të pabarabarta e diskriminuese, duke cenuar nenin 18 të Kushtetutës.

90. Gjykata paraprakisht sjell në vëmendje se analiza do të vijojë vetëm në lidhje me nenin 169, pikat 5 dhe 6 të ligjit, pasi në vlerësimin e saj argumentet për nenet 12, pika 2, shkronja "b", 28 dhe 64, pika 1, shkronja "c" nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

91. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive (*shih vendimin nr.48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

92. Sipas jurisprudencës kushtetuese parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlljoita për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përlligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007; nr.19, datë 09.07.2009; nr.4, datë 12.02.2010; nr.71, datë 27.11.2015; nr.10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

93. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës, jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde. Në të tilla raste Gjykata shqyrton nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përlligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përlligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet

e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjete i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimin nr.48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, ato duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdeseshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (*shih vendimet nr.16, datë 25.07.2008; nr.52, datë 05.12.2012; nr.33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

94. Gjykata, referuar garancive që burojnë nga Karta e Gjyqtarëve apo Rekomandimi (94)12 për pavarësinë, eficiencën dhe rolin e gjyqtarëve, rithekson se paga e gjyqtarëve duhet t'i korrespondojë dinjitetit të profesionit dhe se një pagë e përshtatshme është e domosdoshme për të mbrojtur gjyqtarët nga ndërhyrje të jashtme të papërshtatshme. Niveli i pagës duhet të përcaktohet në dritën e kushteve sociale të vendit dhe duhet të jetë e krahasueshme me nivelin e pagave të nëpunësve civilë të nivelit të lartë. Paga duhet të bazohet mbi një standard të përgjithshëm, kritere objektive dhe transparente dhe jo në vlerësimin e performancës individuale të gjyqtarit. Bonuset të cilat përfshijnë elemente diskrecioni duhet të përjashtohen (*shih për më tepër edhe opinionin e Komisionit të Venecias, CDL-AD(2010)004 mbi pavarësinë e gjyqtarëve, prg.46*).

95. Gjykata vëren se sipas relacionit shpjegues të projektligjit "paga dhe trajtimi financiar aktual i gjyqtarit nuk mbajnë parasysh në masë të mjaftueshme dinjitetin e detyrës e të profesionit, natyrën e përgjegjësive të funksionit gjyqësor, shkallën e vështirësive në përmbushjen e tij, numrin e lartë të papajtueshmërive dhe ndalimeve të posaçme për të kryer veprimtari të tjera që sjellin të ardhura, nevojën për ta mbrojtur nga presionet dhe ndikimet në veprimtarinë e tij gjyqësore e në sjelljen e tij në tërësi, si edhe nevojat e integritetit social të tij dhe të familjes në shoqëri". Për këtë arsye rregullimi ligjor, sipas ligjvënësit, synon "përmirësim rrënjësor të trajtimit financiar dhe të masave mbështetëse gjatë dhe pas lënies së detyrës, duke u mbështetur në parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që t'i mbrojë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit".

96. Objektivi i mësipërm i ligjvënësit është sanksionuar në nenin 11 të ligjit, ku parashikohet se paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tij. Paga e magjistratit, sipas nenit 12 të ligjit caktohet në bazë të kriterëve të ndryshme, të cilat përfshijnë: a) shkallën e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin; b) vjetërsinë në ushtrimin e funksionit; c) fushën e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin; ç) pozicionin drejtues. 3. Përfitimet e tjera financiare përfshijnë: a) kompensimin për transferimin e përkohshëm ose skemën e delegimit; b) shpërblimin për aftësi; c) pensionin shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjisllacionit për pensionet shtetërore suplementare; ç) çdo përfitim tjetër, duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit, të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi. Po ashtu, paga e magjistratit caktohet sipas përkatësisë së magjistratit në grupin dhe nivelin e pagës.

97. Referuar dispozitave kalimtare, konkretisht nenit 169, Gjykata vëren se rregullimet ligjore të kreut II, pjesa III “Paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore” janë të zbatueshme për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janari 2019. Sipas ligjvënësit, gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera. Ndërkohë, sipas pikës 6 të nenit 169, magjistrati që ka kaluar procesin e rivlerësimit pas datës 1 janar 2019, gëzon të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji, brenda tre muajve nga vendimi i formës së prerë të rivlerësimit.

98. Gjykata vëren se ligjvënësi e ka kushtëzuar zbatimin e skemës së re të trajtimit financiar të magjistratëve me dy kriterë, që përfshijnë kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit dhe plotësimin e një afati kohor i cili shtrihet deri në 1 janar 2019. Gjykata konstaton se deri në datën 1 janar 2019 magjistratët do të vijojnë të përfitojnë pagë dhe përfitime të tjera në përputhje me parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse pas datës 1 janar 2019 trajtimi financiar i tyre varet nga kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit, çka nënkupton se ata magjistratë që e kanë kaluar me sukses këtë proces gëzojnë të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera para hyrjes në fuqi të ligjit

me ato sipas këtij ligji, kurse për ata që ende nuk e kanë përfunduar atë proces, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera (pika 5 e nenit 169).

99. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se rregullimi ligjor i fjalisë së fundit të pikës 5 të nenit 196 dhe ai i pikës 6 të po këtij neni krijojnë kushtet për trajtim të pabarabartë të magistratëve që ndodhen në kushte të njëjta, pa përlligje objektive dhe të arsyeshme. Për më tepër, Gjykata çmon se trajtimi financiar i pabarabartë i magistratëve pas datës 1 janar 2019 nuk është mjeti i duhur për të përmbushur objektivin e ligjvënësit për të siguruar dinjitetin e profesionit dhe një pagë të përshtatshme si domosdoshmëri për të mbrojtur gjyqtarët nga ndërhyrje të jashtme të papërshtatshme.

100. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi kërkuesve në lidhje me nenin 169, pika 5, fjalia e fundit dhe pika 6, është i bazuar dhe duhet pranuar.

C.5 Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor

101. Kërkuesit pretendojnë se gjatë procedimit disiplinor të magistratëve nuk respektohen standardet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (neni 147, pika 2), të së drejtës së mbrojtjes efektive dhe të barazisë së armëve (neni 141, pika 1), të së drejtës së ankimit (nenet 48, pika 12 dhe 93, pika 7), parimit *ne bis in idem* (nenet 23, 104 dhe 112, pika 1), prezumimit të pafajësisë (nenet 138, pika 1 dhe 169, pika 5).

102. Gjykata vlerëson paraprakisht se pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të së drejtës së ankimit, të prezumimit të pafajësisë, si dhe të barazisë dhe mosdiskriminimit gjatë procedimit disiplinor nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në këtë kuptim, analiza në vijim, bazuar edhe në parimin *iura novit curia*, përfshin pretendimet që lidhen me cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, të barazisë së armëve dhe aksesit, si dhe të parimit *ne bis in idem*.

103. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por

edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr.67, datë 11.11.2016; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

104. Gjykata është shprehur se njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur. Në nenin 44 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se çdokush që ka interes të ligjshëm, ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ. Palët pjesëmarrëse në një procedim administrativ janë autoriteti kompetent, nga njëra anë, dhe pala e interesuar, nga ana tjetër. Në këtë gjykim secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Pala kërkuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr.67, datë 11.11.2016; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

105. Nga ana tjetër, parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që në radhë të parë legjislacioni procedural dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr.2, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

106. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se neni 141 objekt kundërshtimi parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor, duke përcaktuar ato që lidhen me fillimin e procedimit, ashtu dhe gjatë zhvillimit të tij. Konkretisht, magjistrati në

momentin e njoftimit për fillimin e procedimit disiplinor njihet me të drejtën për të paraqitur një parashtrësë me shkrim në afatin e caktuar; për të marrë pjesë në seancë dëgjimore; për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen; për të paraqitur dokumente; për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij; për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në KPA-ve; për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore të tij/saj në rastet kur nuk vendoset masë disiplinore. Përveç sa më sipër, neni 141 parashikon, nga njëra anë, të drejtën e magjistratit ose të përfaqësuesit për akses në dosje, por nga ana tjetër, përcakton edhe kufijtë e kësaj të drejtë, që synojnë të garantojnë: a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit.

107. Duke e analizuar rregullimin e mësipërm ligjor në kontekstin e garancive që përcakton neni 23 i Kushtetutës për të drejtën e informimit dhe veçanërisht me kuptimin që merr kjo e drejtë në procedurat administrative, sipas KPA-së, Gjykata vëren se të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore (neni 45). Nga ana tjetër, e drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike garantohet edhe nga ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (neni 1). Në lidhje me kufizimin e së drejtës për akses në informacion (dokumentet e dosjes) Gjykata konstaton se si KPA-ja, ashtu edhe ligji nr.119/2014 përcaktojnë kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte. Konkretisht, neni 46 i KPA-së parashikon se drejta e palëve për t'u njohur me dokumentet e dosjes kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, kurse sipas nenit 17 të ligjit nr.119/2014, e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të përcaktuar shprehimisht nga norma, ku përcaktohet edhe mbarëvajtja e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor.

108. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, nisur nga rëndësia që paraqet respektimi gjatë procedimit disiplinor i parimeve të përcaktuara në nenin 100 të ligjit, vlerëson se shprehja e përdorur nga ligjvënësi në pikën 1 të nenit 141 të ligjit "*në masën që nuk cenon a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit*" nuk siguron garancinë kushtetuese që buron nga e drejta

për një proces të rregullt ligjor për mbrojtje efektive dhe barazi të armëve gjatë procedimit disiplinor të gjyqtarëve.

109. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit *ne bis in idem*, Gjykata është shprehur se parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe një nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare, sipas të cilit, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr.5, datë 08.03.2005, nr.10, datë 02.04.2009; nr.33, datë 22.07.2011; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

110. Ndalimi i gjykimit të dyfishtë dhe ndëshkimit për të njëjtën shkelje në dy procese të ndryshme penale, referuar nenit 4 të Protokollit nr.7 të KEDNJ-së, në parim nuk përjashton fillimin e procesit disiplinor për të njëjtën shkelje paralelisht me procesin penal. Megjithatë, natyra penale e një procesi sipas legjislacionit kombëtar nuk është i vetmi kriter, prandaj GJEDNJ-ja merr gjithashtu në konsideratë natyrën e shkeljes ose ashpërsinë e dënimit, me qëllim që të përcaktojë nëse një procedurë e kategorizuar si “disiplinore” sipas legjislacionit vendas mund të ketë në të vërtetë natyrë penale sipas Konventës, rast në cilin zbatohet neni 4 (1) i Protokollit nr.7 (*shih opinionin e përbashkët për Gjeorgjinë (CDL-AD(2014)032*).

111. Përgjegjësia penale dhe ajo disiplinore kanë natyrë dhe objektiva të ndryshëm, janë subjekt i standardeve të ndryshme mbi provën dhe kanë elemente të ndryshme përbërëse, si dhe po ashtu nuk përjashtojë njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, autoritetet disiplinore nuk janë të detyruar të përfundojnë procedimin disiplinor kur fillon një çështje penale për të njëjtën shkelje. Për të evituar shkeljen e parimit *ne bis in idem* këto autoritete duhet të kenë mundësinë të përfundojnë procedurën nëse ata e konsiderojnë që çështja disiplinore ka natyrë penale (natyra e shkeljes dhe pesha e masës disiplinore korresponduese do të jenë kriteret drejtuese në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së). Në rast se shkelja subjekt i

procesit penal nuk është e njëjta shkelje që lind nga fakte identike ose kur procesi disiplinor nuk ka natyrë penale, nuk ka arsye për të përfunduar procesin disiplinor për shkak të fillimit të procesit penal bazuar në të njëjtin material disiplinor (*supra, shih paragrafët 50-60*).

112. Në rastin konkret, Gjykata vëren se neni 112, pika 1 parashikon masat disiplinore plotësuese, duke përcaktuar se kur magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e korrupsionit, KLGJ-ja, përveç shkarkimit, e dënon atë edhe me kthimin e shumës së pagës bruto të vitit të fundit në detyrë të përfutur prej tij.

113. Gjykata konstaton se në referim të Kodit Penal, korrupsioni aktiv dhe pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë përfshihet në veprat penale kundër sistemit të drejtësisë dhe dënohet nga 1 deri 4 vjet burgim (*neni 319 i Kodit Penal*). Në lidhje me dënimin me gjobë që parashikonte neni 319 si dënim kryesor, Gjykata vëren se ligjvënësi e ka shfuqizuar atë me ligjin nr.144/2013. Po ashtu, Gjykata vëren se neni 30 i KP-së përcakton si dënim plotësues edhe konfiskimin e produkteve të veprës penale, kurse sipas neneve 34 dhe 36 për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata e zakonshme cakton konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe të produkteve të veprës penale ose, në mungesë të tyre, dënimin me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milionë lekë.

114. Gjykata thekson se ashpërsia e masës disiplinore plotësuese me natyrë financiare në rastin konkret është e tillë sa ajo në thelb shndërrohet në dënim penal, që konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash e barabartë me pagën bruto të përfutur nga magjistrati i dënuar për veprën penale të korrupsionit gjatë vitit të fundit të ushtrimit të detyrës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se parashikimi njëkohësisht si nga Kodi Penal, ashtu dhe neni 112, pika 1, e ligjit i dy dënimeve penale për të njëjtin fakt bie ndesh me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër.

115. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuesve është i bazuar.

D. Për pretendimet e tjera

116. Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke argumentuar se nenet 46, pika 5, 66, pika 1, shkronja "b" dhe pika 4, 146 dhe 147, u japin organeve, si: Prokurorisë së Posaçme, Këshillave apo edhe ILD-së kompetenca që me Kushtetutë u janë dhënë shprehimisht organeve të tjera kushtetuese, si:

Presidentit, Gjykatës Kushtetuese, KLGJ-së, etj. Neni 119/2 “Ankesat” siguron ndërhyrje të papërshtatshme të pushtetit ekzekutiv në pushtetin gjyqësor, për shkak të paraqitjes së ankesës në ILD nga ministri i Drejtësisë, dhe po ashtu për shkak të njohjes vetëm një anëtarit të Këshillit të së drejtës së ankesës, konfondohet kompetenca kushtetuese e organit kolegjial për caktimin e masave disiplinore.

117. Po ashtu, kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e parimit të proporcionalitetit si rezultat i përcaktimit të niveleve të pagave (neni 12, pika 1, shkronja “b”), i parashikimit të pezullimit si masë disiplinore (neni 105, pika 1, shkronja “d” dhe neni 110), i kohëzgjatjes së saj 3 muaj deri 2 vjet, si dhe marrjes së një page minimale, i parashikimit të afateve të parashkrimit më të gjata për një shkelje disiplinore që nuk përbën vepër penale (neni 117), si dhe kufizimit kohor për marrjen e pagës së re, pavarësisht kohës së përfundimit me sukses të procesit të rivlerësimit (neni 169, pika 5).

118. Përveç sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë parashtruar argumente edhe për cenimin e së drejtës për punë, si rezultat i transferimit në një gjykatë tjetër të magjistratit pa pëlqimin e tij (neni 8), detyrimit për kthimin deri në 50% të shumës të përfituar gjatë studimit në SHM, nëse mandati përfundon në 5 vjetët e parë (neni 19), uljes së pagës nga KLGJ-ja për shkak të uljes së ngarkesës për shkaqe të pavarura nga vullneti i gjyqtarit (neni 26, pika 4) ndërprerjes së mandatit të kryetarëve të gjykatave (neni 161, pika 3 dhe neni 164, pika 2) dhe parashikimit të pagesave që nuk janë në përputhje me vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional (neni 169, pika 5).

119. Gjykata, duke pasur në konsideratë kuptimin që jurisprudenca kushtetuese u ka dhënë parimit të ndarjes dhe balancimit midis pushteteve, parimit të proporcionalitetit dhe së drejtës për punë, vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuesve nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të vijojë me analizën e mëtejshme të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e në vijim të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së

Shqipërisë të nenit 8; nenit 9, pika 1, shkronja “c”, fjalia e fundit, si dhe pikat 7 dhe 8; nenit 23, pika 10; nenit 26, pika 4, shkronja “b”; nenit 44, pika 1, shkronja “c”; nenit 64, pika 5; nenit 78, pika 3, shprehja “nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm”” dhe pika 5, shkronja “b”, fjalia e fundit; nenit 95, pika 7, shprehja “me një nivel më të ulët sesa “mirë””; nenit 101; nenit 102; nenit 103; nenit 104; nenit 112, pika 1; nenit 141, pika 1, shprehja “në masën që nuk cenon” dhe shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike; nenit 152; nenit 161, pika 2, shprehja “në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji” dhe pika 3; nenit 162, pika 1, shprehja “në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji” dhe pika 6, shprehja “në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”; nenit 164, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2; nenit 167, pika 3, shkronja “b”, shprehja “në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”; nenit 168, pika 2, shprehja “në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji”, nenit 169, pika 5, fjalia e fundit dhe pika 6 e këtij neni.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

1. Bashkohem me qëndrimin e Gjykatës për shfuqizimin e disa neneve dhe pikave të ligjit nr.96/2016, sipas dispozitivit, por jam i qëndrimit që Gjykata duhej të kishte marrë parasysh edhe problemet e antikushtetutshmërisë që paraqesin disa dispozita të tjera, të cilat ose duhej të ishin shfuqizuar ose duhej të ishin interpretuar konform Kushtetutës, me qëllim garantimin e pavarësisë së gjyqësorit. Në vijim, po paraqes argumentet lidhur me secilin prej neneve.

A. Për pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 12, pika 2, shkronja “b” dhe “c”

2. Neni 12, pika 2 shkronja “b” dhe “c” parashikon:

“Paga e magjistratit ndahet sipas grupeve të pagave (G), bazuar në këto tregues:

...

b) *magjistrati që ushtron funksionin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, prokuroritë pranë gjykatave së apelit, magjistratët që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar shkalla e parë (G2);*

c) *magjistrati që ushtron funksionin në Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, ashtu si dhe magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme (G3).”*

3. Nisur nga përmbajtja e këtyre pikave të nenit 12, rezulton se parashikimi

ligjor bën një dallim pa shkaqe të arsyeshme midis gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme dhe prokurorëve pranë këtyre gjykatave, dallim i cili duke qenë i pajustificuar, çon në diskriminim. Konkretisht, sipas këtij parashikimi të ligjit, gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme përfshihen në grupin e II-të të pagave ose "G2", ndërkohë që për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme parashikon që paga e tyre përfshihet në grupin e pagës "G3". Ky diskriminim ligjor bie ndesh me nenin 18 të Kushtetutës, si dhe me aktet ndërkombëtare që përcaktojnë parime dhe rregulla lidhur me ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe të prokurorit si p.sh Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 2, pika 1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 26), Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 i Protokollit Shtesë nr.12), të cilat ndalojnë diskriminimin duke përfshirë edhe rastet e diskriminimit për shkak të profesionit.

4. Nisur nga fakti se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme pranë saj janë organe kushtetuese është e papranueshme që gjyqtarët dhe prokurorët që do të ushtrojnë detyrën pranë këtyre organeve të përfshihen në nivele të ndryshme pagash, pa pasur një element dallues që të mund të justifikojë këtë dallim. Mendoj se edhe Gjykata në vendimin e saj duhej të kishte arritur në të njëjtin përfundim, pra që kemi të bëjmë me diskriminim midis gjyqtarëve dhe prokurorëve pranë Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe si rrjedhim të bënte të paktën një interpretim pajtues, i cili do të mund të shmangte cenimin e së drejtës së pagës së barabartë për të dy kategoritë e magistratëve, gjyqtarë dhe prokurorë. Nëpërmjet një interpretimi pajtues Gjykata gjithashtu do të mund t'i rekomandonte Kuvendit marrjen e iniciativës për miratimin e ndryshimeve ligjore të përshtatshme në këtë dispozitë me qëllim shmangien e këtij diskriminimi, duke parashikuar shprehimisht që paga e magistratëve që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Posaçme të jetë minimalisht e barabartë ose të përfshihet në të njëjtin grup me pagën e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.

5. Në këto kushte, jam i qëndrimit se ligjvënësi ka parashikuar një dispozitë ligjore diskriminuese, duke cenuar nenin 18 të Kushtetutës dhe si e tillë duhej të ishte shfuqizuar nga Gjykata.

B. Për pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 42, pika 3, shkronja "a", "b", "c" dhe "ç", pika 4 shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", pika 8 dhe 9.

6. Neni 42 i ligjit nr.96/2016 parashikon parimet e transferimit të magistratit duke përkufizuar edhe termin "*transferim*" si lëvizje e përkohshme ose e përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion

në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel. Ndërsa në pikën 3 dhe 4 të këtij neni parashikohen rregulla të detajuara për mënyrën se si veprohet në marrjen parasysh të kërkesave për të plotësuar vendet e lira nga magjistratët. Në nenet në vijim, konkretisht nenet 43, 44, 46 dhe 47 parashikohen procedurat për transferimin e magjistratëve.

7. Të gjitha këto dispozita parashikojnë për herë të parë një rregullim ligjor që, megjithëse ka pasur si synim pozitiv rregullimin në detaje të çështjeve, të cilat kanë krijuar konfuzion dhe situata antikushtetutshmërie për sa i takon respektimit të pavarësisë së gjyqtarëve, ligjvënësi duket se nuk i ka arritur të mbajë parasysh standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare që garantojnë zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratëve.

8. Jam i qëndrimit se këto dispozita jo vetëm nuk mundësojnë por pengojnë që gjyqtarët e shkallës së parë, pasi të kenë plotësuar kushtet ligjore për ngritjen në detyrë, të kenë mundësi të paraqesin kërkesë për t'u emëruar si gjyqtarë pranë gjykatave të apelit. Sipas parashikimit ligjor, vendet e lira që krijohen në çdo gjykatë apeli mund të plotësohen vetëm me anë të lëvizjes paralele nga gjyqtarët e tjerë të gjykatave të apelit duke mos lejuar që këto vende të lira të plotësohen edhe nga gjyqtarët e shkallës së parë, gjë e cila pengon ecurinë në karrierë të këtyre gjyqtarëve.

9. Ky kufizim ligjor bie ndesh me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës pasi është joproportional dhe nuk diktohet nga ndonjë arsye e përligjur. Vlen të theksohet se ky parashikim ligjor është në thelb i ngjashëm me parashikimet e ligjit nr.151/2013, neni 3, pika 1 shkronja "b/1", që ndryshonte ligjin nr.8588/2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë*" që parashikonte shtesën, sipas së cilës, për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë kërkohej që gjyqtari të kishte 13 vite punë si gjyqtar, nga të cilat 5 vjet si gjyqtar në gjykatën e apelit. Kjo shtesë u gjet antikushtetuese dhe u shfuqizua me vendimin nr. 40/2014 të Gjykatës Kushtetuese, pasi u konsiderua se heqja e së drejtës së gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë që të konkurrojë për një vend vakant në Gjykatë të Lartë, kur ai plotëson të gjitha kushtet ligjore, bie ndesh me nenin 138 të Kushtetutës.

10. Për sa më lart, jam i qëndrimit se neni 42 në pikat e përmendura më lart, paraqet probleme kushtetutshmërie në përmbajtje. Është pozitive që ligjvënësi është përpjekur të rregullojë në detaje karrierën e gjyqtarëve me përgatitje sa më të mirë profesionale, por mjetet e përdorura kufizojnë së tepërmi dhe në mënyrë jo objektive të drejtën e gjyqtarëve për t'u ngritur në karrierë. Nisur nga dyshimi që ngrihet për sa i takon antikushtetutshmërisë të këtyre parashikimeve, jam i qëndrimit që Gjykata duhej të kishte marrë parasysh të paktën mundësinë për të bërë

një interpretim pajtues të tyre duke i dhënë mundësinë ligjvënësit që në ndryshimet që do t'i bëjë këtij ligji, sipas orientimeve të Gjykatës të shprehura në këtë vendim, të analizonte edhe këto dispozita. Konkretisht mendoj se detyrimet që rrjedhin nga dispozitat që parashikojnë transferimin dhe ngritjen në detyrë duhen kuptuar dhe interpretuar në atë mënyrë që kushtet dhe kriteret e vendosura nga ligji nuk duhet të përbëjnë pengesë për gjyqtarët e shkallës së parë që të ngrihen në detyrë, nëse plotësojnë kushtet ligjore të përgjithshme. Kriteret specifike që vendosen në dispozitat e sipërpërmendura mund të parashikohen si kriteret që përbëjnë avantazh ose preferencë në përzgjedhje ndaj gjyqtarëve të tjerë por jo të jenë pengesë për konkurrim, pasi si të tilla ato cenojnë ecurinë në karrierë të gjyqtarit si një nga parimet bazë të pavarësisë së sistemit gjyqësor.

C. Për pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 138, pika 1.

11. Neni 138, pika 1 e ligjit nr.96/2016 parashikon: *“Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.”*. Jam i qëndrimit se përmbajtja e kësaj dispozite paraqet probleme antikushtetutshmërie dhe për këtë arsye Gjykata duhej ta kishte shfuqizuar edhe këtë parashikim ligjor, pasi ai bie ndesh me nenin 30 të Kushtetutës si dhe me aktet ndërkombëtare që garantojnë prezumimin e pafajësisë. Gjithashtu, ky parashikim bie ndesh edhe me një sërë vendimet të Gjykatës, e cila ka vlerësuar se parimi i prezumimit të pafajësisë duhet të gjejë zbatim jo vetëm në procesin penal por edhe në procesin administrativ (*Shih vendimet nr. 49/2015 dhe nr.83/2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, neni 140, pika 3 shkronja “c” i Kushtetutës parashikon pezullimin nga detyra të gjyqtarit me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kur ndaj tij fillon procedimi disiplinor, gjë e cila nënkupton se fillimi i procedimit disiplinor mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme, sipas parashikimeve të nenit 138, pika 1, sjell automatikisht pezullimin e gjyqtarit nga detyra.

13. Nisur nga sa më lart, jam i qëndrimit se Gjykata duhej të kishte bërë edhe në këtë rast të paktën një interpretim pajtues për këtë dispozitë, me qëllim shmangien e çdo mundësie për të abuzuar apo për të cenuar ushtrimin e pavarur të detyrës nga gjyqtari. Konkretisht, jam i qëndrimit se shprehja *“dyshime të arsyeshme”* e parashikuar nga pika 1 e nenit 138 të ligjit duhet të nënkuptojë dyshime që mbështeten në fakte dhe prova dhe jo në supozime apo hamendësime. Vetëm duke u interpretuar në këtë mënyrë nga Gjykata kjo dispozitë do të ishte në përputhje me Kushtetutën

dhe aktet ndërkombëtare që garantojnë prezumimin e pafajsisë gjatë ushtrimit të detyrës nga gjyqtari duke mos i cenuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Gani Dizdari

SHTOJCA 3

**VENDIM KLGJ-së
Nr. 316, datë 14.09.2020**

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 140, pika 1, nenin 147, pika 1, dhe nenin 147/a, pika 1, germa "b" të Kushtetutës, në nenet 100-159, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në nenet 61-63, nenet 66-70, nenet 72-76, nenin 97, pika 1, germa "ç" dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRYETAR
Naureda Llagami**

**RREGULLORE
PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË KËSHILLIN E LARTË
GJYQËSOR**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRERGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

Neni 2 **Objekti**

1. Kjo rregullore përcakton:
 - a) kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetarit, Relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;
 - b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe të mbledhjes plenare, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, gjyqtarin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;
 - c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore;
 - ç) rregulla për krijimin, trajtimin, qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.

Neni 3 **Përkufizime**

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Ankim" është mjeti procedural i parashikuar në ligj, për kundërshtimin e veprimeve apo të mosveprimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- b) "Ditë" janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune.
- c) "Fillimi i hetimit disiplinor" është fillimi i procedurës hetimore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin për fillimin e hetimit, sipas nenit 123, të ligjit "Për statusin".
- ç) "Magjistrat" është subjekti procedural me detyrë gjyqtar, ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë disiplinore nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, kryesisht apo mbi bazën e një ankese.
- d) "ILD" është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve.
- dh) "Këshilli" është Këshilli i Lartë Gjyqësor.
- e) "Komisioni" është Komisioni Disiplinor.
- ë) "Këshilltari ligjor përgjegjës" është anëtari i personelit të Këshillit, i emëruar në strukturën e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, i

cili caktohet nga Kryetari i Komisionit, për të mbështetur një nga anëtarët e Komisionit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje.

- f) "Ligji për qeverisjen" është ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
- g) "Ligji për statusin" është ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- gj) "Marrëveshje e përbashkët e pranimit" është marrëveshja e përbashkët, me shkrim, e nënshkruar midis magjistratit dhe ILD-së, në të cilën magjistrati pranon llojin konkret të shkeljes disiplinore dhe masën disiplinore të përshtatshme.
- h) "Përfaqësues" është subjekti procedural, përfaqësues i magjistratit apo subjekte të tjera procedurale, i cili legjitimohet si i tillë, sipas parashikimeve të neneve 35-38 të Kodit të Procedurës Administrative.
- i) "Raporti i hetimit" është akti me të cilin ILD-ja i jep fund hetimit disiplinor, me anë të mbylljes së hetimit ose fillimin e procedimit disiplinor me propozimin për caktimin e masës përkatëse, i hartuar sipas nenit 133 pika 3, e ligjit "Për statusin".
- j) "Relator" është çdo anëtar i Komisionit Disiplinor, i caktuar me short për një çështje, në zbatim të nenit 63, të ligjit "Për qeverisjen", i cili kryen dhe kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative dhe disiplinore në Komision dhe Këshill.

Neni 4

Parimet e procedurave disiplinore

1. Këshilli, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në ligj, udhëhiqet dhe synon në zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si dhe parimet e procedimit disiplinor, si vijon:

- a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;
- b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e "mosdënimit p^aligj";
- c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;
- ç) parimin e barazisë para ligjit;
- d) prezumimin e pafajësisë;
- dh) parimin e dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;
- e) parimin e proporcionalitetit;

- ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e subjektit të proceduar;
- f) parimin e drejtësisë së hapur;
- g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Këshilli dhe Komisioni duhet të marrin parasysh, veçanërisht:

- a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e subjektit të proceduar nga akuzat e pabaza;
- b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

Neni 5 Procedurat disiplinore

Procedurat disiplinore, të parashikuara në ligjin "Për statusin", janë si vijon:

- a) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit;
- b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së, për dënimin me gjobë, sipas nenit 116 pika 4 dhe nenit 132, pika 4 e ligjit;
- c) shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit, si dhe të ankimit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas pikës 9 të këtij neni;
- ç) shqyrtimi e procedimeve disiplinore, të filluara nga ILD-ja, sipas neneve 138—147 të ligjit, dhe kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;
- d) marrja e të gjitha masave të nevojshme dhe sigurimin e zbatimit dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor;
- dh) pezullimi i detyruar të magjistratit nga detyra, në bazë të nenit 151 të ligjit;
- e) pezullimi i magjistratit, ndaj të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 138, kryesisht apo mbi kërkesën e ILD-së.

Neni 6 Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit, i pranishëm, përkatësisht, në mbledhjen e Këshillit

ose të Komisionit, i cili është në dijëni të një konflikti i interesit ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenin 72, 73, 74, 75, të ligjit "Për qeverisjen", është i detyruar për sa më poshtë:

- a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;
- b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;
- c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

2. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose Komisionit, në rastin, kur:

- a) anëtari ka paraqitur tek ILD-ja kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;
- b) si anëtar i Komisionit, ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të ligjit "Për qeverisjen".

3. Çdo anëtar i Këshillit, menjëherë pas marrjes së rendit të ditës dhe materialeve për një mbledhje të ardhshme të Këshillit ose të Komisionit, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse, deklaron konfliktin e interesit ose pengesën ligjore, sipas neneve 73 dhe 74, të ligjit "Për qeverisjen". Anëtari i Këshillit i cili ka deklaruar konfliktin e interesit ose pengesën nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në Komision dhe në Këshill.

4. Nëse rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 75, të ligjit "Për qeverisjen", anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit, merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

5. Nëse një anëtar ka dijëni se një anëtar tjetër i Këshillit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose pengesës ligjore, sipas neneve 73, 74 apo 75, të ligjit "Për qeverisjen", e deklaron atë menjëherë pas marrjes dijëni, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse.

6. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklaron qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje plenare ose në mbledhje të Komisionit, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

7. Gjyqtari i proceduar ose përfaqësuesi ligjor i tij ose ILD-ja mund

të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75, të ligjit "Për qeverisjen", dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Vendimi për përjashtimin e një anëtari, nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose në Komision, merret nga Këshilli në mbledhje plenare, sipas rregullave të parashikuara në nenin 72, të ligjit "Për qeverisjen". Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja plenare kryesohet nga zëvendëskryetari i Këshillit.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI SEKSIONI I ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 7 Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, pa afat të caktuar.
2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe dy anëtarë zëvendësues. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit zgjidhen nga Këshilli. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit shërbejnë për një mandat dy vite e gjysmë nga data e zgjedhjes së tyre.

Neni 8 Kuorumi dhe mbledhja e Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme vetëm kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Komisioni mblidhet, në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga Kryetari. Komisioni mblidhet edhe me propozim të një anëtari.
2. Kryetari i Komisionit cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët. Para mbledhjes, çdo anëtar i Komisionit mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë, pro kërkesës, jo më pak se dy anëtarë.
3. Mbledhjet e Komisionit drejtohen nga Kryetari. Çdo anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Komisionit.
4. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion, i cili konsiderohet

i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit.

5. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të dëgjohej për mendimin e tij në lidhje me çështjen që diskutohet. Vendimet në Komision merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

6. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit

1. Kryetari i Këshillit është Kryetari i Komisionit, në rastin kur është një nga anëtarët e tij. Në rastet e tjera, Kryetari i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit, me propozim të Kryetarit të Këshillit.

2. Kryetari i Komisionit është përgjegjës, për:

- a) funksionimin e duhur të Komisionit;
- b) mbikëqyrjen e punës dhe administrimin e Komisionit;
- c) përgatitjen për mbledhjen;
- ç) shpërndarjen e të gjitha materialeve të mbledhjes, në kohën e duhur, për anëtarët e Komisionit;
- d) caktimin e orës, datës dhe vendit të mbledhjes;
- dh) caktimin e rendit të ditës dhe kryesimin e mbledhjeve të Komisionit;
- e) ndarjen e barabartë dhe të drejtë të detyrave, duke marrë në konsideratë angazhimin profesional të anëtarëve të Komisionit;
- ë) caktimin e këshilltarit ligjor përgjegjës, për të asistuar anëtarin në përmbushjen e detyrave të tij;
- f) raportimin në Këshill për punën e realizuar nga Komisioni.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë:

- a) të marrin pjesë, të respektojnë dhe zbatojnë procedurat për mbledhjet e Komisionit;
- b) të realizojnë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga Komisioni dhe Këshilli;
- c) të informojnë sa më herët të jetë e mundur Kryetarin, kur nuk mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit;
- ç) të mos nxjerrin asnjë informacion sensitiv nga mbledhjet me dyer të mbyllura të Komisionit;
- d) të shmangin favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrtojnë çështje, marrin vendime ose votojnë për çështje

që i paraqiten Komisionit;
dh) të përdorin ekskluzivisht adresën e postës zyrtare të Këshillit për të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e Komisionit dhe të Këshillit.

Neni 10

Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit

1. Në rastin kur një nga anëtarët e Komisionit heq dorë nga pjesëmarrja në mbledhje të Komisionit ose përjashtohet, për shkak të konfliktit të interesit, pengese tjetër ligjore, si dhe kur ai mungon në detyrë, për shkak të rasteve të tjera të pamundësisë së përkohshme, në shqyrtimin çështjes futet anëtari zëvendësues.

2. Anëtari zëvendësues shërben si anëtar aktiv i Komisionit, sa herë që një anëtar i përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për arsye objektive ose pengese ligjore. Anëtarët jogjyqtarë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët jogjyqtarë dhe anëtarët gjyqtarë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët gjyqtarë të Komisionit.

3. Kohëzgjatja e zëvendësimit varet nga natyra e arsyes dhe rrethanave për të cilat është bërë zëvendësimi:

- a) nëse anëtari i përhershëm që zëvendësohet, ka pengesë ligjore në trajtimin e një çështje konkrete, anëtari zëvendësues merr pjesë për kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes.
- b) nëse gjendja e padisponueshmërisë së anëtarit të rregullt zgjat më shumë se 5 ditë, anëtari zëvendësohet dhe zëvendësuesi shërben deri në përfundim të kësaj gjendje.

4. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson Kryetarin e Komisionit, kryetari i ri zgjidhet me short ndërmjet anëtarëve të përhershëm të Komisionit. Kryetari i ri ushtron këtë funksion për sa kohë zgjat gjendja e zëvendësimit të anëtarit të përhershëm. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson një anëtar të Komisionit, i cili shërbente si relator, zgjidhet një relator i ri me short. Në çdo rast, nëse anëtari zëvendësues shërben si relator, ai ushtron funksionin e anëtarit zëvendësues deri në përfundim të çështjes për të cilën ai është caktuar si relator.

SEKSIONI II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE MBËSHTETËSE TË KOMISIONIT

Neni 11

Njësia Mbështetëse e Komisioneve

1. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, e cila përbën strukturën ndihmëse dhe këshillimore, që mbështet punën profesionale të anëtarëve të Komisionit.
2. Njësia Mbështetëse e Komisioneve ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, duke përfshirë:
 - a) përgatitjen e çështjes për shqyrtim;
 - b) kryerjen e kërkimeve shkencore;
 - c) dhënien e opinioneve ligjore.
3. Kryetari i Komisionit cakton një Këshilltar Ligjor përgjegjës, nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, për secilin nga anëtarët e Komisionit.
4. Këshilltari Ligjor përgjegjës, gjatë shqyrtimit të një çështjeje në Komision, ka kryesisht detyrat e mëposhtme:
 - a) jep mendimin e tij Relatorit të çështjes, pranë të cilit është caktuar, në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me shqyrtimin e saj dhe veprimet procedurale që duhet të kryhen nga Relatori dhe Komisioni, me qëllim përgatitjen sa më të shpejtë të çështjes për në Këshill;
 - b) përgatit projektaktet dhe relacionin paraprak, duke dhënë mendimin e tij si mbi pranueshmërinë dhe mbi zgjidhjen në themel të çështjes;
 - c) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Relatori i çështjes ose Komisioni.
5. Këshilltari Ligjor përgjegjës, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit "Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor". Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Kryetarit të Komisionit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe këshilltarin ligjor përgjegjës zëvendësues nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve.

Neni 12 Personeli administrativ i Këshillit

1. Komisioni mbështetet në veprimtarinë e tij nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përbushur këto detyra, por pa u kufizuar në to:

- a) regjistrimin e të dhënave në regjistrat e posaçëm, në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill dhe, në veçanti:
 - i. identifikon natyrën e çështjes;
 - ii. regjistron dhe numëron atë në regjistrin përkatës;
 - iii. krijon dosjen e çështjes.
- b) përcjelljen e çështjes Kryetarit të Këshillit për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;
- c) dorëzimin e dosjes së çështjes te Relatori dhe bashkëpunon me Këshilltarin Ligjor përgjegjës, për mbarëvajtjen e të gjithë procedurës;
- ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit;
- d) mbajtjen e të gjitha komunikimet e vazhdueshme të njoftimeve dhe të akteve shpresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Komisionit ose të Këshillit;
- dh) redaktimin e akteve të Komisionit në këndvështrimin gjuhësor;
- e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;
- ë) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të Relatorit;
- f) marrjen në dorëzim të dosjes nga Relatori në përfundim të procedurës dhe depozitimim e saj për arkivim;
- g) ndjek procedurën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit, mbi ankimin e palëve në procedurë, përveç kur me vendim të Këshillit vendoset ndryshe;
- gj) vënien në dispozicion strukturave të Këshillit dhe Komisionit të çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike sipas kërkesës së tyre, për qëllime të procedurës.

2. Me fillimin e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm cakton personelin administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Personeli administrativ i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore, në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj

çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit "Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor". Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

SEKSIONI III VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Neni 13 **Depozitimi për shqyrtim**

1. Në Këshill depozitohen për shqyrtim administrativ sipas kësaj rregulloreje:
 - a) ankimi i magjistratit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit "Për statusin";
 - b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së për dënimin me gjobë;
 - c) marrëveshja e përbashkët e magjistratit dhe ILD-së, për pranimin e shkeljes disiplinore;
 - ç) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas nenit 135, pika 9, e ligjit "Për statusin";
 - d) kërkesa e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor, së bashku me raportin hetimor dhe dosjen përkatëse;
 - dh) kërkesa e ILD-së për pezullimin e magjistratit nga detyra, si dhe kërkesat e palëve për ndryshimin ose revokimin e pezullimit të vendosur.
2. Data e marrjes në Këshill, të akteve të parashikuara në pikën 1, në regjistrin përkatës, është:
 - a) data e depozitimit në Këshill, në rastin kur akti paraqitet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur, nga subjekti përkatës;
 - b) data e depozitimit në Këshill nga shërbimi postar, në rastin kur akti është dërguar nëpërmjet shërbimit postar;
 - c) data e mbërritjes në adresën elektronike zyrtare të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimin dhe dokumentin elektronik.

Neni 14

Regjistri i posaçëm

1. Pranë Këshillit, krijohet dhe administrohet një regjistër i posaçëm, në të cilin regjistrohen:

- a) çështjet në lidhje me ankimet e paraqitura në Këshill nga subjektet e përcaktuara në ligj dhe sipas kësaj rregulloreje;
- b) kërkesat për pezullimin e magjistratit nga ushtrimit i detyrës gjatë një procedure disiplinore, si dhe ato për ndryshimin apo revokimin e pezullimit;
- c) çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime.

2. Nëse është e nevojshme, Këshilli, për nevoja të punës, mund të miratojë edhe regjistra të tjerë, duke përcaktuar llojin e të dhënave që do të hidhen në secilin prej tyre.

3. Regjistrimi dhe gjithë procesi i menaxhimit të çështjeve, dokumentohet në regjistra manualë që mbahen në Këshill, si dhe në çdo formë tjetër që përcaktohet në të ardhmen për këtë qëllim.

Neni 15

Formimi i dosjes

Për çdo çështje, të regjistruar për shqyrtim sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje në Komision, si dhe në Këshill.

Neni 16

Procedura e shortit

1. Procedura e shortit realizohet duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve të Komisionit.

2. Bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi bazën e kërkesës së motivuar të Kryetarit ose të çdo anëtari të Komisionit, mbledhja plenare e Këshillit gjatë procedurës së hedhjes së një shorti, mund të vendosë:

- a) përjashtimin e një anëtari nga shorti;
- b) përfshirjen në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, dhe të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast, Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose jogjyqtarëve,

në varësi të radhëve nga vjen anëtari zëvendësues, i caktuar si relator;
c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë.

4. Shorti hidhet midis anëtarëve të Komisionit, duke u bazuar në forma elektronike për caktimin e relatorit. Deri në përcaktimin dhe vendosjen e tyre, shorti hidhet manualisht, sipas procedurës së vendosur në Këshill.

Neni 17 **Kalimi i çështjes te Relatori**

Pas përfundimit të procedurës së shortit, personeli administrativ kompetent i dorëzon menjëherë Relatorit, dosjen e regjistruar, e cila përmban kryesisht:

- a) në rastin e ankimeve dhe kërkesave për pezullim, ankimin/kërkesën, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues të depozituar nga subjektet;
- b) në rastin e procedurave për pezullimin për shkak të ligjit, informacionin e njoftuar, sipas neneve 127, 151 dhe 154 të ligjit "Për Statusin";
- c) në rastin e procedimeve disiplinore, kërkesën për procedim disiplinor, raportin e hetimit, marrëveshjen, dosjen personale, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, të depozituar nga ILD-ja.

Neni 18 **Radha e shqyrtimit**

Radha e shqyrtimit të çështjeve përcaktohet duke pasur në konsideratë përparësitë e procedimeve disiplinore dhe kërkesave me natyrë urgjente, si edhe datën e depozitimit të çështjes në Këshill.

Neni 19 **Veprimet paraprake të Relatorit dhe Komisionit në përgatitjen e çështjes**

1. Relatori përgatit çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit, si dhe në mbledhjen plenare të Këshillit.

2. Relatori, me mbështetjen e Këshilltarit përgjegjës dhe personelit administrativ të caktuar, kryen dhe kujdeset për detyrat si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- a) përgatit projektaktin dhe relacionin mbi çështjen;
- b) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së Komisionit dhe mbledhjes plenare të Këshillit;
- c) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e çështjes;
- ç) koordinon me Kryetarin e Këshillit ose Komisionit për përgatitjen, respektivisht, të mbledhjes së Këshillit ose Komisionit;
- d) njofton subjektet e procedimit administrativ.

3. Këshilltari përgjegjës, pas studimit të çështjes përgatit një relacion paraprak, nën kujdesin e Relatorit të çështjes, dhe e shpërndan atë tek anëtarët e Komisionit. Nëse anëtarët e Komisionit kanë pyetje apo kërkesa për shpjegime në lidhje me të, ia dërgojnë ato Relatorit dhe Këshilltarit përgjegjës.

4. Pas mbylljes së veprimeve përgatitore, Kryetari i Komisionit, me kërkesë të Relatorit dhe në koordinim me anëtarin tjetër, cakton datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes.

5. Komisioni, pas shqyrtimit të çështjes dhe relacionit, verifikon procedurën e ndjekur dhe kur e konsideron të rregullt vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhje plenare.

Neni 20

Mënyrat e njoftimit të akteve

1. Aktet e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, u njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;
- b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;
- c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 21

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

KREU III
PROCEDURA TË VEÇANTA

SEKSIONI I
SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I ANKIMEVE

Neni 22
Paraqitja e ankimit

1. Ankimi paraqitet nga pala ankuese ose nga përfaqësuesi i zgjedhur prej saj. Përfaqësuesi legjitimohet si i tillë dhe kryen disa ose të gjitha veprimet procedurale, sipas parashikimeve të nenit 38 të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Çdo akt drejtuar Këshillit vlerësohet si ankim edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë, por del nga përmbajtja e këtij akti dhe është mjaftueshëm i qartë. Ankimi paraqitet në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, qartë dhe kuptueshëm, si dhe duhet të përmbajë:

- a) emrin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndaj të cilit drejtohet ankim;
- b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;
- c) emërtimin e personit juridik ankues, përfaqësuesin e tij ligjor, vendbanimin ose vendqëndrimin dhe/ose përfaqësuesin e zgjedhur;
- ç) vendimin e ILD-së kundër të cilit paraqitet ankim ose mosveprimin administrativ të ILD-së;
- ç) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;
- d) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:

i) akti i përfaqësimit, në rast se ankim paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;

ii) kopje të vendimit të ILD-së objekt ankimi;

iii) dokumente, prova, apo materiale të tjera që shoqërojnë ankimin, në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

dh) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankim paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhëna shprehimisht në aktin e përfaqësimit.

Neni 23
Verifikimi i ankimit

1. Relatori verifikon nëse ankim plotëson kriteret formale të parashikuara

në pikën 2 të këtij neni. Ankimi që nuk plotëson këto kritere konsiderohet i metë. Relatori njofton ankuesin, me shkrim, duke i caktuar një afat 10 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ankuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, Komisioni vendos mospranimin e ankimit.

2. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit "Për qeverisjen".

Neni 24

Shqyrtimi paraprak i ankimit

1. Pas verifikimit të kriterëve formale të ankimit, Relatori verifikon kushtet e pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Ankimi është i pranueshëm për shqyrtim, nëse plotëson këto kushte:

- a) është bërë kundër një vendimi apo mosveprimi administrativ të ILD-së;
- b) ankuesi ka legjitimitet sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin";
- c) është paraqitur brenda afateve të parashikuara në ligj.

2. Për ankimin që nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni vendos mospranimin e ankimit. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit "Për qeverisjen".

Neni 25

Pushimi i shqyrtimit të ankimit

1. Ankuesi mund të heqë dorë nga ankimi derisa Komisioni nuk ka marrë një vendim në lidhje me të. Në këtë rast, Komisioni vendos pushimin e ankimit.

2. Komisioni vendos në të njëjtën mënyrë edhe në rastin kur objekti për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankimit apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

3. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit "Për qeverisjen".

Neni 26

Shqyrtimi në themel i ankimit

1. Pas verifikimit të plotësimit të kushteve të pranueshmërisë, Relatori përgatit relacionin dhe projekt-aktin për shqyrtimin në themel të ankimit.

Komisioni mund të vendosë pranimin ose rrëzimin e ankimit.

2. Kundër vendimit të rrëzimit ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99 të ligjit "Për qeverisjen".

3. Në rastin e ankimit, sipas nenit 132, pika 4, të ligjit "Për statusin", Relatori kërkon menjëherë nga ILD-ja dhe një kopje të akteve që kanë shërbyer për marrjen e vendimit.

4. Në rastin e ankimit ndaj mosveprimit administrativ, Relatori kërkon që menjëherë ILD-ja të paraqesë pa vonesë një kopje të dosjes së çështjes dhe arsyet e mosveprimit administrativ.

SEKSIONI II

SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESËS PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATIT

Neni 27

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për pezullimin e magjistratit nga detyra paraqitet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e ILD-së, sipas nenit 152, pika 1, të ligjit "Për statusin".

2. Pas regjistrimit, kërkesa i nënshtrohet menjëherë procedurës së shortit në caktimin e Relatorit të çështjes, nëse paraqitet njëkohësisht me kërkesën për procedim disiplinor. Nëse procedimi disiplinor ka filluar, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim Relatorit të çështjes.

Neni 28

Shqyrtimi i kërkesës

1. Relatori, brenda 24 orëve nga caktimi i tij apo paraqitja e kërkesës, i propozon mbledhjes plenare të Këshillit:

a) rrëzimin e kërkesës;

b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e pezullimit kryesisht të magjistratit nga detyra, sipas neneve 151 dhe 152, të ligjit

"Për STATUSIN". Në këtë rast afatet llogariten nga dita e marrjes së informacionit nga ILD-ja apo prokuroria ose gjykata përkatëse ose nga konstatimi i rrethanave të parashikuara në nenin 152, të ligjit "Për statusin".

4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 29

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesave në lidhje me kohëzgjatjen dhe revokimin e pezullimit

1. Kërkesa për ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimin e pezullimit paraqitet në Këshill nga ILD-ja apo magjistrati. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, i cili duhet të provojë që pezullimi nuk mund të vazhdojë, për shkak se arsyet e vendosjes së pezullimit, të parashikuara në nenet 151 dhe 152, të ligjit "Për statusin", kanë pushuar së ekzistuari.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim Relatorit të çështjes.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimit të pezullimit, kryesisht, sipas nenit 156, të ligjit "Për statusin".

4. Komisioni i propozon mbledhjes plenare, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

SEKSIONI III PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 30

Paraqitja e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe dosja përkatëse, sipas nenit 133, të ligjit "Për statusin".

2. Pas regjistrimit, kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i nënshtrohet procedurës së shortit në caktimin e Relatorit të çështjes. Në

rastin kur kërkesa përmban kërkimin për pezullimin e magjistratit nga detyra, procedura e shortit në caktimin e Relatorit të çështjes zhvillohet menjëherë.

3. Relatori verifikon nëse kërkesa plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Kërkesa që nuk plotëson këto kritere konsiderohet e metë. Relatori njofton ILD-në, me shkrim, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ILD-ja nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, Komisioni mund të vendosë kthimin e kërkesës bashkë me aktet e depozituara.

4. ILD-ja ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit "Për qeverisjen".

Neni 31

Shqyrtimi paraprak i çështjes

1. Relatori, pas verifikimit të kriterëve formale, mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit:

- a) mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139, të ligjit "Për statusin" ose;
- b) përcaktimin e seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga ILD-ja. Afati për caktimin e seancës dëgjimore mund të zgjatet deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat bëhen publike.

2. Në rastin e vendimit për caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në vlerësim:

- a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj; si dhe
- b) afatin brenda të cilit magjistrati duhet të paraqesë parashtrësit me shkrim, sipas nenit 141, pika 2, germa "a", të ligjit "Për statusin".

3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor sipas pikës 1, germa "a", të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban dhe shkaqet e mbylljes së procedimit.

4. Vendimet sipas këtij neni u njoftohen palëve në procedurë, brenda 5 ditëve, nga marrja e tyre.

Neni 32

Të drejtat e magjistratit pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore

1. Relatori, me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur magjistratit të drejtat, si vijon:

- a) për t'u njohur me dokumentet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;
- b) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim brenda një afati të caktuar;
- c) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- ç) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
- d) për të paraqitur dokumente;
- dh) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
- e) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Administrative;
- ë) për të kërkuar përjashtimin e Relatorit, të një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e nenit 75, të ligjit "Për qeverisjen" dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes;
- f) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

2. Komisioni mund të vendosë kufizimin e së drejtës së aksesit me dosjen, vetëm në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 141, pika 1/1, të ligjit "Për statusin". Magjistrati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit "Për qeverisjen".

Neni 33 **Veprimet paraprake**

1. Veprimet paraprake janë të gjitha ato veprime procedurale, të cilat kanë si qëllim përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore. Ato kryhen nga ana e Komisionit, me anë të Relatorit të çështjes.
2. Komisioni dhe Relatori, në këtë fazë të procedurës, kujdeset për kryerjen e detyrave që lidhen me:
 - a) shqyrtimin e të gjithë faktorëve që kanë rëndësi për çështjen dhe të dokumentacionit të depozituar nga subjektet procedurale;
 - b) njoftimin e magjistratit të proceduar se ndaj tij ka filluar një procedim disiplinor, si dhe njoftimin e të drejtave të tij sipas nenit 32 të rregullores;
 - c) njoftimin e subjekteve procedurale për vendimin e caktimit të seancës dëgjimore dhe afatin brenda të cilit magjistrati i proceduar duhet të paraqesë parashtrësat me shkrim;
 - ç) marrjen e vendimeve nga mbledhja plenare e Këshillit, për:

- i. pranueshmërinë e provave;
 - ii. thirrjen, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, kur e konsideron të përshtatshme ose kërkon nga ILD-ja thirrjen e ekspertëve;
 - iii. marrjen e provave shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;
 - iv. kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ILD-ja, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin;
 - v. paraqitjen nga ana e magjistratit të të dhënave, dokumenteve ose çdo lloj prove si marrjen pjesë të tij në seance dëgjimore në trajtimin e çështjes;
 - vi. bashkimin e procedimeve, sipas nenit 140, të ligjit "Për statusin";
 - vii. ndryshimin ose shtimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas nenit 144, të ligjit "Për statusin";
 - viii. pezullimin e procedimit disiplinor, sipas neneve 145 dhe 126, të ligjit "Për statusin";
- d) kryerjen e çdo veprimi tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm;
- dh) si dhe përgatitjen e relacionit paraprak mbi çështjen, i cili duhet t'iu vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit, para seancës dëgjimore. Ky relacion, përmban në mënyrë të përmbledhur:
- i. të dhënat e subjekteve procedurale;
 - ii. objektin e kërkesës;
 - iii. parashtrimin e pretenduar të fakteve dhe rrethanave;
 - iii. pretendimet e organit procedues dhe parashikimet ligjore, mbi të cilat bazohet kërkimi;
 - iv. parashtrimet e subjektit të proceduar; si dhe
 - v. çdo propozim të Komisionit, për marrjen e vendimeve sipas pikës 2, germat "ç" dhe "d" të këtij neni.

Neni 34 **Publiciteti i seancës**

1. Seanca dëgjimore është publike.
2. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënies me medien, të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit.

3. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:

- a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
- b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;
- c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

4. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur dhe publik.

Neni 35 **Solemniteti i seancës**

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:

- a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;
- b) respektimi i rendit dhe i qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;
- c) respektimi nga palët i kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;
- ç) respektimi i anëtarëve të Këshillit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në gjykim;
- d) mbajtja e togës së posaçme nga avokatët dhe veshjes serioze dhe të përshtatshme nga pjesëmarrësit e tjerë në sallë.

2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, Kryetari i Këshillit merr masat për zhvillimin e duhur të seancës. Nëse është e nevojshme, ndërpret diskutimin ose u heq palëve të drejtën e fjalës, ose mund të urdhërojë largimin e personave nga salla.

3. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës, Kryetari i Këshillit ndihmohet nga punonjësi i ngarkuar për sigurinë, i cili kryen kryesisht detyrat e mëposhtme.

- a) ndihmon në rregullimin e të pranishmëve në sallë;
- b) ndihmon në shmangien e sjelljes së papërshtatshme të personave të pranishëm në sallë;
- c) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore.

Neni 36 Zhvillimi i seancës

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë në mbledhje në distancë, Kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, Kryetari i Këshillit, si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

- a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative;
- b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;
- c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;
- ç) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore, sipas nenit 142, pika 4, e ligjit "Për statusin";
- d) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

- i. organit procedues, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;
- ii. subjektit të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse. Në çdo rast magjistrati i proceduar ka të drejtën e fjalës së fundit;

dh) komunikon vendimin e Këshillit:

- i. për shtyrjen e seancës dëgjimore, në çdo rast, jo më shumë se një muaj, kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë;
 - ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;
 - iii. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;
 - iv. për mbylljen e fazës së shqyrtimit;
- e) fton palët për pretendimet e fundit;
- ë) shpall vendimin përfundimtar të procedimit.

3. Këshilli, gjatë seancës dëgjimore, me kërkesë ose kryesisht, merr çdo vendim sipas nenit 33, pika 2, germet "ç" dhe "d", të kësaj rregulloreje.

4. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara për mbledhjet plenare.

Neni 37

Masat për shmangien e vonesave

1. Këshilli zbaton rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, për aq sa këto rregulla gjejnë zbatim, për magjistratin ose përfaqësuesin e tij, në rastet e deklarimit në mungesë, si dhe të procedimit disiplinor në mungesë të tij.
2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cenojnë dinjtetin e ILD-së ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, Këshilli paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Në rast se sjellja vazhdon, Këshilli vendos dënimin me gjobë deri në 100 000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme, për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim, brenda 24 orëve nga marrja dijani e tij në Gjykatën Administrative të Apelit. Këshilli i njofton vendimin për dënimin me gjobë Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

Neni 38

Bashkimi i procedimeve disiplinore

Këshilli vendos bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet e mëposhtme:

- a) procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat të proceduar;
- b) kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Në këtë rast, Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve, sipas rregullave të përbashkëta të miratuara paraprakisht prej tyre.

Neni 39

Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor të magjistratit

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:
 - a) të urdhërojë ILD-në të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me ligjin "Për statusin", si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuajor;
 - b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.

2. Në këto raste, ILD-ja vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të ligjit "Për statusin":
 - a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;
 - b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose të ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

Neni 40 **Pezullimi i procedimit disiplinor**

1. Këshilli vendos pezullimin e procedimit disiplinor, kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:
 - a) në të cilët, njëra nga palët është magjistrati i proceduar;
 - b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.
2. Procedimi disiplinor pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.
3. Ankuesi, magjistrati i proceduar, gjykata, prokuroria dhe subjektet proceduese njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Këshillit, pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.
4. Këshilli u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit të proceduar, nuk pengon procedimin disiplinor të Këshillit për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të tij.
5. Vendimi për pezullimin e procedimit nuk ankimohet.

Neni 41 **Marrja e vendimit në një procedim disiplinor**

1. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli në mbledhje plenare:
 - a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
 - b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

2. Vendimi jepet i arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës. Nëse vendimi përfundimtar nuk shpallet menjëherë, Këshilli vendos për datën e marrjes së tij, datë e cila caktohet të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore¹.

3. Relatori i çështjes garanton aksesin e të gjithë anëtarëve të Këshillit në njohjen e akteve të administruara në dosje, gjatë shqyrtimit të çështjes dhe para marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 42 **Përgatitja e vendimit**

1. Arsyetimi dhe zbardhja e plotë e vendimit bëhet brenda dy javëve, nga data e shpalljes së tij. Vendimi arsyetohet nga Relatori, duke mbajtur parasysh deklaratimet për arsyet e votimit në marrjen e vendimit. Relatori u përcjell anëtarëve të Këshillit projektvendimin e dhënë.

2. Secili prej anëtarëve, mund të japë komentet dhe propozimet e tij me shkrim, të cilat përfshihen në projektvendim. Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë me anë të nënshkrimit versionin përfundimtar të vendimit.

3. Nëse pas votimit dhe shpalljes së vendimit, Relatori është në pakicë, Kryetari i Këshillit, mund të caktojë një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar.

Neni 43 **Publikimi i vendimeve disiplinore**

1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.

2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojtë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast, në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit.

¹ Neni 146, pika 3, e ligjit "Për statusin" — "Këshilli nuk është i detyruar t'i qëndmë masës disiplinore të propoguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve ngapërfundimi i seancës."

Neni 44
Shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit

Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e shqyrtimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit, sipas nenit 135, të ligjit “Për statusin”, për aq sa gjen zbatim.

KREU IV
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 45
Shfuqizime

Rregullorja “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, të miratuar me vendimin nr. 137, datë 21.2.2003, ndryshuar me vendimin nr. 282/9, datë 16.12.2011, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 46
Akte të tjera të zbatueshme

Në organizimin dhe funksionimin e Këshillit, Komisionit dhe personelit administrativ, sipas kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim rregullore të tjera të Këshillit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 47
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 4

VENDIM i KLP-së
Nr. 260, datë 17.11.2020

MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR NË ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE DISIPLINORE NDAJ PROKURORËVE

Bazuar në nenin 149, pika 1, nenin 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159 dhe 189, të ligjit nr. 115/2016,, “Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
Gent Ibrahimim

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RREGULLORE

**MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR NË ZHVILLIMIN
E PROCEDURAVE DISIPLINORE NDAJ PROKURORËVE**

Kjo rregullore bazohet në nenin 149 pika 1, nenin 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 100–157, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 159–162, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në funksion të zhvillimit të procedurave disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magistratëve prokurorë në Republikën e Shqipërisë.

2. Kjo veprimtari administrative dhe procedurale bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 115/2016, “Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Kodin e Procedurës Administrative, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, që përmban rregullime specifike që kanë lidhje me këtë veprimtari.

Neni 2 Objekti

Kjo rregullore përcakton;

- a) përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kryetarit, relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;
- b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, prokurorin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;
- c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore;
- ç) rregulla për krijimin, trajtimin, qarkullimin, përdorimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit, që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.

Neni 3 Përkufizime

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Ankim" është mjete procedurali parashikuar në ligj, për kundërshtimin e veprimeve apo të mosveprimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- b) "Ditë" janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune.
- c) "Fillimi i hetimit disiplinor" është fillimi i procedurës hetimore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin për fillimin e hetimit, sipas neneve 123 dhe 124, të ligjit "Për statusin".
- ç) "Magjistrat" është subjekti procedural me detyrë prokuror ose i komanduar në një detyrë tjetër, sipas nenit 53, pika 1, e ligjit, "Për statusin", ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë disiplinore nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, kryesisht apo mbi bazën e një ankese.
- d) "ILD" është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për pranimin dhe verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, si dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve.
- dh) "Këshilli" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
- e) "Komisioni" është Komisioni Disiplinor.
- ë) "Këshilltari ligjor përgjegjës" është anëtari i personelit të Këshillit, i emëruar në strukturën e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, i cili caktohet nga kryetari i Komisionit, për të mbështetur një nga anëtarët Komisionit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje.
- f) "Ligji për qeverisjen" është ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
- g) "Ligji për statusin" është ligji nr. 96/2016, "Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- gj) "Marrëveshje e pranimit" është marrëveshja e përbashkët, me shkrim, nëpërmjet së cilës magjistrati dhe ILD, dakordësojnë pranimin e shkeljes disiplinore që i atribuohet magjistratit, llojin e shkelës dhe masën disiplinore, sipas përcaktimit të nenit 135, të ligjit "Për statusin".
- h) "Përfaqësues" është subjekti procedural përfaqësues i magjistratit apo subjekte të tjera procedurale, i cili legjitimohet si i tillë sipas parashikimeve të neneve 35–38 të Kodit të Procedurës Administrative.
- i) "Raporti i hetimit" është akti me të cilin ILD-ja i jep fund hetimit disiplinor, me anë të mbylljes së hetimit ose fillimin e procedimit disiplinor me propozimin për caktimin e masës përkatëse, i hartuar sipas nenit 133 pika 3 e ligjit, "Për statusin".
- j) "Relator" është çdo anëtar i Komisionit Disiplinor, i caktuar me short për një çështje, në zbatim të nenit 161, të ligjit "Për qeverisjen", i cili kryen dhe kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative dhe disiplinore në Komision dhe Këshill.

Neni 4

Fusha e veprimtarisë së Komisionit

1. Komisioni Disiplinor ka si objekt të veprimtarisë së tij trajtimin e çdo çështje, që ka lidhje me procedurat me natyrë disiplinore, përveç vendimmarrjes si e drejtë ekskluzive e Këshillit, të parashikuara në ligjin, “Për statusin”, si vijon:

- a) ankimin ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit;
- b) ankimin ndaj vendimit të ILD-së, për dënimin me gjobë, sipas nenit 116 pika 4 dhe nenit 132, pika 4 e ligjit;
- c) shqyrtimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit, si dhe të ankimit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas pikës 9 të këtij neni;
- ç) shqyrtimin e procedimeve disiplinore, të filluara nga ILD-ja, sipas neneve 138–147 të ligjit dhe, kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;
- ç) marrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe sigurimin e zbatimit dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor, sipas neneve 148–150 të ligjit;
- d) pezullimin e detyruar të magjistratit nga detyra, në bazë të nenit 151 të ligjit;
- dh) pezullimin e magjistratit, ndaj të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 127, kryesisht apo mbi kërkesën e ILD-së.

2. Komisioni është kompetent edhe për çdo çështje tjetër të parashikuar me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni.

3. Në shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Këshilli dhe Komisioni mbështeten nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni dhe Këshilli janë ligjshmëria, transparenca, mosdiskriminimi, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia dhe eficientia.

Neni 6

Parimet e procedimit disiplinor

1. Komisioni dhe Këshilli, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë rregullore dhe në ligj, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:

- a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;
- b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të vlerësojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;
- c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;
- ç) parimin e barazisë para ligjit;
- d) prezumimin e pafajësisë;
- dh) parimin e dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;
- e) parimin e proporcionalitetit;
- ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë të subjektit të proceduar;
- f) parimin e drejtësisë së hapur;
- g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Këshilli dhe Komisioni duhet të marrin parasysh, veçanërisht:

- a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e subjektit të proceduar nga akuzat e pabaza;
- b) rëndësinë që ka informimi i publikut, në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

Neni 7

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit, i pranishëm, përkatësisht, në mbledhjen e Këshillit ose të Komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenet 172, 173, 174, 175 të ligjit “Për qeverisjen”, është i detyruar për sa më poshtë:

- a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;
 - b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;
 - c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.
2. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit, në rastin kur:
- a) anëtari ka paraqitur tek ILD-ja kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;
 - b) ka marrë vendim si anëtar i komisionit të përkohshëm, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të arkivimit ose pushimit e hetimit, ndaj një prokurori, sipas parashikimit të nenit 160, pika 13, të ligjit “Për qeverisjen”.
3. Çdo anëtar i Këshillit, menjëherë pas marrjes së rendit të ditës dhe materialeve për një mbledhje të ardhshme të Këshillit ose të Komisionit, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse, deklaron konfliktin e interesit ose pengesën ligjore, sipas neneve 172 dhe 173 të ligjit “Për qeverisjen”. Anëtari i Këshillit i cili ka deklaruar konfliktin e interesit ose pengesën nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në Komision dhe në Këshill.
4. Në rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 174 të ligjit “Për qeverisjen”, anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit, merret nga kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.
5. Nëse një anëtar ka dijeni se një anëtar tjetër i Këshillit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose pengesës ligjore, sipas neneve 172, 173 apo 174 të ligjit “Për qeverisjen”, e deklaron atë menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse.
6. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklaron qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje plenare ose në mbledhje të Komisionit, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.
7. Prokurori i proceduar ose përfaqësuesi ligjor i tij ose ILD-ja mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të

procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 174 të ligjit “Për qeverisjen”, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Vendimi për përjashtimin e një anëtari, nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose në Komision, merret nga Këshilli në mbledhje plenare, sipas rregullave të parashikuara në nenin 171 të ligjit “Për qeverisjen”. Kur kërkohet përjashtimi i kryetarit të Këshillit, mbledhja plenare kryesohet nga zëvendëskryetari i Këshillit.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

SEKSIONI I ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 8 Komisioni Disiplinor

1. Komisionit Disiplinor, i përcaktuar nga ligji si Komision i përhershëm, ushtron veprimtarinë e tij, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.
2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, dy nga radhët e prokurorëve dhe një jo prokuror, si dhe dy anëtarë zëvendësues, një nga radhët e anëtarëve prokuror dhe një nga radhët e anëtarëve joprokurorë. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit zgjidhen nga Këshilli. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit, shërbejnë për një mandat dy vite e gjysmë nga data e zgjedhjes së tyre.
3. Kryetari i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit, me propozim të kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i Komisionit, në rastin kur është një nga anëtarët e tij.

Neni 9 Kuorumi dhe mbledhja e Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme vetëm kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Komisioni mblidhet, në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga kryetari. Komisioni mblidhet edhe me propozim të një anëtari.
2. Kryetari i Komisionit cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët. Para mbledhjes, çdo anëtar i komisionit mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë, pro kërkesës, jo më pak se dy anëtarë.

3. Mbledhjet e Komisionit drejtohen nga kryetari i Komisionit.
4. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion, i cili konsiderohet i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit
5. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të dëgjohet për mendimin e tij, në lidhje me çështjen që diskutohet. Vendimet në komision merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.
6. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës, për:
 - a) funksionimin e duhur të Komisionit;
 - b) mbikëqyrjen e punës dhe administrimin e Komisionit;
 - c) kujdeset për hedhjen e shortit, për caktimin e relatorit;
 - ç) përgatitjen për mbledhjen;
 - d) shpërndarjen e të gjitha materialeve të mbledhjes, në kohën e duhur, për anëtarët e Komisionit;
 - dh) caktimin e orës, datës dhe vendit të mbledhjes;
 - e) caktimin rendit të ditës dhe kryesimin e mbledhjeve të Komisionit;
 - ë) ndarjen e barabartë dhe të drejtë të detyrave, duke marrë në konsideratë angazhimin profesional të anëtarëve të Komisionit;
 - f) caktimin e këshilltarit ligjor përgjegjës, për të asistuar anëtarin në përmbushjen e detyrave të tij;
 - g) raportimin në Këshill për punën e realizuar nga Komisioni.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë:
 - a) të marrin pjesë, të respektojnë dhe zbatojnë procedurat për mbledhjet e Komisionit;
 - b) të realizojnë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga Komisioni dhe Këshilli;
 - c) të informojnë sa më herët të jetë e mundur kryetarin, kur nuk mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit;
 - ç) të mos nxjerrin asnjë informacion sensitiv nga mbledhjet me dyer të mbyllura të Komisionit;

- d) të shmangin favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrtojnë çështje, marrin vendime ose votojnë për çështje që i paraqiten Komisionit;
- dh) të përdorin ekskluzivisht adresën e postës zyrtare të Këshillit për të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e Komisionit dhe të Këshillit.

Neni 11

Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit

1. Në rastin kur një nga anëtarët e Komisionit heq dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen e Komisionit ose përjashtohet për shkak të konfliktit të interesit, pengese tjetër ligjore, si dhe kur ai mungon në detyrë, arsye të tjera pamundësie të përkohshme, në shqyrtimin e çështjes, futet anëtari zëvendësues.
2. Anëtari zëvendësues shërben si anëtar aktiv i Komisionit, sa herë që një anëtar i përhershëm nuk është në gjendje të ushtrijë funksionin për arsye objektive ose pengese ligjore. Anëtarët joprokurorë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët joprokurorë dhe anëtarët prokurorë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët prokurorë të Komisionit.
3. Kohëzgjatja e zëvendësimit varet nga natyra e arsyes dhe rrethanave për të cilat është bërë zëvendësimi:
 - a) nëse anëtari i përhershëm që zëvendësohet, ka pengesë ligjore në trajtimin e një çështje konkrete, anëtari zëvendësues merr pjesë për kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes.
 - b) nëse gjendja e padisponueshmërisë së anëtarit të përhershëm zgjat më shumë se 7 ditë, atëherë anëtari zëvendësues shërben deri në përfundim të kësaj çështje.
4. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson kryetarin e Komisionit, kryetari i ri zgjidhet me short ndërmjet anëtarëve të përhershëm të komisionit. Kryetari i ri ushtron këtë funksion, për çështjen për të cilën ka filluar procedimi disiplinor, për sa kohë zgjat gjendja e zëvendësimit të anëtarit të përhershëm. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson një anëtar të Komisionit, i cili shërbente si relator, zgjidhet një relator i ri me short. Në çdo rast, nëse anëtari zëvendësues shërben si relator, ai ushtron funksionin e anëtarit zëvendësues deri në përfundim të çështjes për të cilën ai është caktuar si relator.

SEKSIONI II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE MBËSHTETËSE
TË KOMISIONIT

Neni 12
Njësia Mbështetëse e Komisioneve

1. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, e cila përbën strukturën ndihmëse dhe këshillimore, që mbështet punën profesionale të anëtarëve të Komisionit.
2. Njësia Mbështetëse e Komisioneve ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, duke përfshirë:
 - a) përgatitjen e çështjes për shqyrtim;
 - b) kryerjen e kërkimeve shkencore;
 - c) dhënien e opinioneve ligjore;
 - ç) ndjek ecurinë e ankimit të palëve ndaj vendimit të Këshillit për çështjen konkrete të trajtuar, duke informuar në vazhdimësi njësinë e shërbimeve të përgjithshme ligjore, përgjegjëse për përfaqësimin e KLP-së, në gjyq.
3. Kryetari i Komisionit cakton një këshilltar ligjor përgjegjës, nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, për secilin nga anëtarët e Komisionit, të caktuar si relator.
4. Këshilltari ligjor përgjegjës, gjatë shqyrtimit të një çështje në Komision, ka kryesisht detyrat e mëposhtme:
 - a) jep mendimin e tij relatorit të çështjes, pranë të cilit është caktuar, në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me shqyrtimin e saj dhe veprimet procedurale që duhet të kryhen nga relatori dhe Komisioni, me qëllim përgatitjen sa më të shpejtë të çështjes për në Këshill;
 - b) përgatit projektaktet dhe relacionet, duke dhënë mendimin e tij si mbi pranueshmërinë dhe mbi zgjidhjen në themel të çështjes;
 - c) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga relatori i çështjes ose Komisioni.
5. Këshilltar ligjor përgjegjës, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit, "Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë të

Prokurorisë". Kërkesa për dorëheqje i drejtohet kryetarit të Komisionit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe këshilltarin ligjor përgjegjës zëvendësues nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve.

Neni 13 **Personeli administrativ i Këshillit**

1. Komisioni me kërkesë të kryetarit të tij, në varësi të ngarkesës së punës, mbështetet në veprimtarinë e tij nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përmbushur këto detyra, por pa u kufizuar në to:

- a) regjistrimin e të dhënave në regjistrat e posaçëm në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill dhe në veçanti:
 - i. identifikon natyrën e çështjes;
 - ii. regjistron dhe numërton atë në regjistrin përkatës;
 - iii. krijon dosjen e çështjes.
- b) përcjelljen e çështjes kryetarit të Këshillit për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;
- c) dorëzimin e dosjes së çështjes te relatori dhe bashkëpunimin me këshilltarin ligjor përgjegjës, për mbarëvajtjen e të gjithë procedurës;
- ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit;
- d) mbajtjen e të gjitha komunikimeve të vazhdueshme të njoftimeve dhe të akteve shpresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Komisionit ose të Këshillit;
- dh) redaktimin e akteve të Komisionit në këndvështrimin gjuhësor;
- e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;
- ë) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të relatorit;
- f) marrjen në dorëzim të dosjes nga relatori në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;
- g) vënien në dispozicion të strukturave të Këshillit dhe Komisionit çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike, për qëllime të procedurës, duke përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, sipas përcaktimeve të nenit 148–150, të ligjit për statusin.

2. Me fillimin e procedimit disiplinor, sipas kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm me kërkesë të kryetarit të Komisionit, cakton personelin

administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni. Në mungesë të kërkesës së kryetarit për caktimin e personelit administrativ ndihmës, të gjitha detyrat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përmbushen nga Njësia Mbështetëse e Komisionit.

3. Personeli administrativ i caktuar, sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijëni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit, "Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë të Prokurorisë". Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

SEKSIONI III VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Neni 14 **Depozitimi për shqyrtim**

1. Në Këshill depozitohen për shqyrtim administrativ aktet e parashikuara në ligj, të tilla si:

- a) ankimi i magjistratit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur brenda afatit 3- mujor nga marrja e ankesës, nuk ka vendosur arkivimin ose fillimin e hetimit, për shkeljen e pretenduar, sipas parashikimeve të nenit 118, pikat 1 deri në 4, të ligjit "Për statusin";
- b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së për dënimin me gjobë sipas nenit 116, pika 4 dhe nenit 132, pika 4, të ligjit "Për statusin";
- c) marrëveshja e përbashkët e magjistratit dhe e ILD-së, për pranimin e shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit "Për statusin";
- ç) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, për rifillimin ose vazhdimin e veprimeve hetimore disiplinore ndaj prokurorit brenda 1 muaji nga dita e refuzimit të marrëveshjes nga Këshilli, sipas përcaktimeve të nenit 135, pika 9 e ligjit "Për statusin";
- d) ankimi sipas nenit 121, pika 3, ndaj vendimit të ILD-së për arkivimin e ankesës që nuk përmbush kriteret e pikës 1 të nenit 120 të ligjit "Për statusin", si dhe ankimin, sipas nenit 122 pika 5, të ligjit "Për statusin", për rastet kur ILD-ja, arkivon ankesën për mungesë të fakteve që do të

justifikonin fillimin e hetimit.

- dh) ankimi sipas nenit 134, pika 2, të ligjit “Për statusin”, ndaj vendimit të ILD-së për mbylljen e hetimit sipas pikës 1 të këtij neni.
- e) kërkesa e ILD-së, për procedim disiplinor, së bashku me raportin hetimor dhe dosjen përkatëse;
- ë) kërkesa e ILD-së për pezullimin e magjistratit nga detyra, si dhe kërkesat e palëve për ndryshimin ose revokimin e pezullimit të vendosur.
- f) referimi i ecurisë disiplinore nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 12, të ligjit, “Për statusin”.
- g) marrëveshja e pranimit e dakordësuar ndërmjet magjistratit dhe ILD-së, lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.

2. Data e administrimit në Këshill, e akteve të parashikuara në pikën 1, në regjistrin përkatës, është:

- a) data e depozitimit në Këshill, në rastin kur akti paraqitet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur, nga subjekti përkatës;
- b) data e depozitimit në Këshill nga shërbimi postar, në rastin kur akti është dërguar nëpërmjet shërbimit postar;
- c) data e mbërritjes në adresën elektronike zyrtare të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimin dhe dokumentin elektronik.

Neni 15 **Regjistri i posaçëm**

1. Pranë Komisionit, krijohet dhe administrohet një regjistër fizik dhe elektronik i posaçëm, në të cilin regjistrohen:

- a) çështjet në lidhje me ankimet, e paraqitura në Këshill, nga subjektet e përcaktuara në ligj dhe sipas kësaj rregulloreje;
- b) kërkesat për pezullimin e magjistratit nga ushtrimi i detyrës gjatë një procedure disiplinore, si dhe ato për ndryshimin apo revokimin e pezullimit;
- c) çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime, si dhe të gjithë ecurinë që i përket fazës së ekzekutimit të masave disiplinore.

2. Nëse është e nevojshme, Këshilli, për nevoja të punës, mund të miratojë edhe regjistra të tjerë, duke përcaktuar llojin e të dhënave që do të hidhen në secilin prej tyre.

Neni 16 **Formimi i dosjes**

Për çdo çështje, të regjistruar për shqyrtim sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje, formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërtohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështje në Komision, si dhe në Këshill.

Neni 17 **Procedura e shortit për zgjedhjen e relatorit**

1. Procedura e shortit realizohet menjëherë, duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve të Komisionit.

2. Përveç rasteve të konfliktit të interesit apo pamundësisë në ushtrimin e funksionit, bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, me kërkesën e motivuar të kryetarit ose të çdo anëtari të Komisionit, Këshilli, mund të vendosë:

- a) përjashtimin e një anëtari të komisionit nga shorti;
- b) përfshirjen në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast anëtari zëvendësues që përfshihet në short, zgjidhet sipas përkatësisë, prokuror ose jo prokuror, të anëtarit që zëvendëson.
- c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë.

4. Shorti hidhet midis anëtarëve të Komisionit, duke u bazuar në forma elektronike për caktimin e relatorit. Deri në përcaktimin dhe vendosjen e këtyre, shorti hidhet manualisht, sipas procedurës së vendosur në Këshill.

Neni 18 **Kalimi i çështjes te relatori**

Pas përfundimit të procedurës së shortit, personeli administrativ kompetent ose Njësia e Mbështetjes së Komisioneve i dorëzon menjëherë relatorit, dosjen e regjistruar, e cila përmban të gjithë dokumentacionin që lidhet me çështjen që do të shqyrtohet.

Neni 19

Radha e shqyrtimit

Radha e shqyrtimit të çështjeve përcaktohet duke pasur në konsideratë përparësitë e procedimeve disiplinore dhe kërkesave me natyrë urgjente, si edhe datën e depozitimit të çështjes në Këshill.

Neni 20

Veprimet paraprake të relatorit dhe të Komisionit në përgatitjen e çështjes

1. Relatori përgatit çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit, si dhe në Këshill.
2. Relatori, me mbështetjen e këshilltarit përgjegjës dhe personelit administrativ të caktuar, kryen dhe kujdeset për detyrat si më poshtë, por pa u kufizuar në to:
 - a) përgatit relacionin paraprak mbi çështjen, që do të diskutohet nga Komisioni dhe Këshilli;
 - b) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së Komisionit dhe Këshillit;
 - c) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e çështjes;
 - ç) koordinon me kryetarin e Këshillit ose Komisionit për përgatitjen, respektivisht, të mbledhjes së Këshillit ose Komisionit;
 - d) njofton subjektin e procedimit administrativ.
3. Nën kujdesin e relatorit të çështjes, këshilltari përgjegjës, pas studimit të çështjes përgatit një relacion paraprak dhe e shpërndan atë tek anëtarët e Komisionit. Nëse anëtarët e Komisionit kanë pyetje apo kërkesa për shpjegime në lidhje me të, ia dërgojnë ato relatorit dhe këshilltarit përgjegjës.
4. Pas mbylljes së veprimeve përgatitore, kryetari i Komisionit, me kërkesë të relatorit dhe në koordinim me anëtarin tjetër, cakton datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes.
5. Komisioni, pas shqyrtimit të çështjes, vendos me shumicën e votave e të gjithë anëtarëve, në lidhje me relacionin paraprak, relacionin përfundimtar dhe projektvendimet që do të kalojnë për shqyrtim në Këshill.

6. Në rast se njëri nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe relatorin, ka mendim ndryshe, ai pasqyrohet në relacionin përfundimtar të komisionit.

Neni 21

Diskutimi dhe votimi në mbledhje plenare

1. Në diskutimin e çështjes relatori flet i pari. Anëtarët e Këshillit diskutojnë pas relatorit sa herë e çmojnë të nevojshme.
2. Pas përfundimit të diskutimeve lidhur me një çështje, kryetari fton anëtarët për të votuar mbi propozimin e ardhur nga Komisioni. Nëse gjatë diskutimeve, një anëtar i Këshillit, që mund të jetë edhe anëtar i mbetur në pakicë në komision, ka një propozim të ndryshëm nga ai i paraqitur nga Komisioni, fillimisht votohet mbi propozimin e Komisionit dhe me pas propozimi ndryshe.
3. Votimi është i hapur dhe publik. Kryetari shpall rezultatet e votimit, duke treguar sa vota janë dhënë pro ose kundër propozimit mbi të cilin u votua. Votimi bëhet në të njëjtën kohë nga të gjithë anëtarët. Votimi kryhet në formë elektronike. Kur votimi elektronik nuk është i mundur, anëtarët votojnë duke ngritur dorën. Pasi të japin të gjithë votën e tyre “pro” dhe “kundër”, kryetari i Këshillit jep rezultatit e votimit. Në rast votimi të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.
4. Vendimi përgatitet në aq kopje sa duhen për njoftimin e subjekteve, si dhe një kopje tjetër për praktikën dokumentare të çështjes.

Neni 22

Mënyrat e njoftimit të akteve

1. Aktet e Këshillit gjatë procedurave, sipas kësaj rregulloreje, u njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:
 - a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;
 - b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;
 - c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.
2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 23

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit së Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

KREU III

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 24

Paraqitja e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe dosja përkatëse sipas nenit 133 të ligjit "Për statusin".
2. Brenda 3 ditëve nga regjistrimi, kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i nënshtrohet, procedurës së shortit për caktimin e relatorit të çështjes. Shorti hidhet në praninë e të gjithë anëtarëve të komisionit, nën kujdesin e kryetarit të tij. Në rastin kur kërkesa përmban kërkimin për pezullimin e magjistratit nga detyra, procedura e shortit në caktimin e relatorit të çështjes zhvillohet menjëherë.
3. Relatori verifikon nëse kërkesa plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Kërkesa që nuk plotëson këto kriteret konsiderohet e metë. Relatori njofton ILD-në, me shkrim, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ILD -ja plotëson të metat brenda afatit të caktuar, afati për fillimin e procedimit disiplinor, do të konsiderohet data e plotësimit të këtyre të metave. Në rast se ILD-ja nuk plotëson të metat brenda afatit 5-ditor të caktuar, Komisioni, menjëherë me propozim të relatorit, vendos kalimin e çështjes për vendimmarrje në Këshill. Këshilli vendos mbi pranueshmërinë e kërkesës së ILD-së, brenda 10 ditëve nga plotësimi i afati të caktuar.
4. Në rast se konstatohet mosplotësim i kriterëve formale, Këshilli merr vendim për mospranimin e kërkesës së paraqitur nga ILD-ja.

Neni 25

Shqyrtimi paraprak i çështjes

1. Kur kërkesa vlerësohet se i plotëson kriteret formale, mbi bazën e relacionit të relatorit, Komisioni mund t'i propozojë Këshillit të vendosë,

mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit “Për statusin” ose caktimin e seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga ILD-ja. Afati për caktimin e seancës dëgjimore, mund të zgjatet deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat bëhen publike.

2. Në rastin kur kërkesa e ILD-së plotëson kriteret formale të pranueshmërisë, Komisioni brenda 3 ditëve nga fillimi i procedimit, i propozon Këshillit marrjen e vendimit për caktimin e datës së seancës dëgjimore. Në këtë rast Këshilli duhet të mbajë në vlerësim:

- a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj; si dhe
- b) afatin brenda të cilit magjistrati duhet të paraqesë parashitjet me shkrim sipas nenit 141, pika 2, germa “a”, të ligjit “Për statusin”.

3. Kur Këshilli mbyll procedimin disiplinor sipas, përcaktimeve të nenit 139 të ligjit “Për statusin”, merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban shkaqet e mbylljes së procedimit.

4. Vendimet sipas këtij neni u njoftohen palëve në procedurë, brenda 5 ditëve, nga marrja e tyre.

Neni 26

Të drejtat e magjistratit pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore

1. Relatori, me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur magjistratit të drejtat, si vijon:

- a) të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;
- b) të paraqesë parashitjet me shkrim brenda një afati të caktuar;
- c) të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- ç) të thërrasë dëshmitarë, që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
- d) të paraqesë dokumente;
- dh) të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
- e) të përfaqësohet në seancë, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Administrative;
- ë) të kërkojë përjashtimin e relatorit, të një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e nenit 174, të ligjit “Për qeverisjen” dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes;

f) të kërkojë kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

2. Komisioni, mbi propozimin e relatorit, mund të vendosë kufizimin e së drejtës së aksesit me dosjen vetëm në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 141, pika 1/1, të ligjit “Për statusin”. Magjistrati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 191 të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 27

Veprimet paraprake

1. Veprimet paraprake janë të gjitha ato veprime procedurale, të cilat kanë si qëllim përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore. Ato kryhen nga ana e Komisionit, me anë të relatorit të çështjes.

2. Komisioni dhe relatori, në këtë fazë të procedurës, kujdesen për kryerjen e detyrave që lidhen me:

- a) shqyrtimin e të gjithë faktorëve që kanë rëndësi për çështjen dhe të dokumentacionit të depozituar nga subjektet procedurale;
- b) njoftimin e magjistratit të proceduar se ndaj tij ka filluar një procedim disiplinor, si dhe njoftimin e të drejtave të tij, sipas nenit 141, pika 2, e ligjit “Për statusin”;
- c) njoftimin e subjekteve procedurale për vendimin e caktimit të seancës dëgjimore dhe afatin brenda të cilit magjistrati i proceduar duhet të paraqesë parashtrësat me shkrim;
- ç) marrjen e vendimeve nga Këshilli, për:
 - i. pranueshmërinë e provave;
 - ii. thirrjen, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, kur e konsideron të përshtatshme, ose kërkon nga ILD -ja thirrjen e ekspertëve;
 - iii. marrjen e provave shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;
 - iv. kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ILD -ja, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin;
 - v. paraqitjen nga ana e magjistratit të të dhënave, dokumenteve ose çdo lloj prove, si marrjen pjesë të tij në seance dëgjimore në trajtimin e çështjes;
 - vi. bashkimin e procedimeve sipas nenit 140 të ligjit “Për statusin”;
 - vii. ndryshimin ose shtimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas nenit 144 të ligjit “Për statusin”;
 - viii. pezullimin e procedimit disiplinor sipas neneve 145 dhe 126 të ligjit “Për statusin”;

- d) kryerjen e çdo veprimi tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm;
- dh) si dhe përgatitjen e relacionit paraprak mbi çështjen, i cili duhet t'u vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore. Ky relacion, përmban në mënyrë të përmbledhur:
- i. të dhënat e subjekteve procedurale;
 - ii. objektin e kërkesës;
 - iii. parashtrimin e pretenduar të fakteve dhe rrethanave;
 - iv. pretendimet e organit procedues dhe parashikimet ligjore, mbi të cilat bazohet kërkimi;
 - v. parashtrimet e subjektit të proceduar;
 - vi. çështjet apo rrethanat për të cilat Komisioni, vlerëson se duhet të sqarohen në seancën dëgjimore;
 - vii. si dhe çdo propozim të Komisionit, për marrjen e vendimeve, sipas pikës 2, geramat "ç" dhe "d" të këtij neni.

Neni 28 **Publiciteti i seancës**

1. Seanca dëgjimore është publike.
2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:
 - a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
 - b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;
 - c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.
3. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur dhe publik.

Neni 29 **Solemniteti i seancës**

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:
 - a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;

- b) respektimin e rendit dhe i qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;
- c) respektimin nga palët të kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;
- ç) respektimin e anëtarëve të Këshillit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në gjykim;
- d) mbajtjen e togës së posaçme nga avokatët dhe veshjes serioze dhe të përshtatshme nga pjesëmarrësit e tjerë në sallë.

2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, Kryetari i Këshillit merr masat për zhvillimin e duhur të seancës. Nëse është e nevojshme, ndërpret diskutimin ose u heq palëve të drejtën e fjalës, ose mund të urdhërojë largimin e personave nga sallë.

3. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi nga mediet e pranishme, gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen ,sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me medien, të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit.

4. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës, Kryetari i Këshillit ndihmohet nga punonjësi i ngarkuar për sigurinë dhe, në mungesë të tij nga drejtori i kabinetit të kryetarit, i cili kryen kryesisht detyrat e mëposhtme.

- a) ndihmon në rregullimin e të pranishmëve në sallë;
- b) ndihmon në shmangien e sjelljes së papërshtatshme të personave të pranishëm në sallë;
- c) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore.

Neni 30

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë në mbledhje në distancë, kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, kryetari i Këshillit, si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

- a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të

- tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative;
- b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;
 - c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;
 - ç) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore, sipas nenit 142, pika 4 e ligjit, “Për statusin”;
 - d) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:
 - i. organit procedues, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;
 - ii. subjektit të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse. Në çdo rast magjistrati i proceduar ka të drejtën e fjalës i fundit.
 - iii. secilit prej anëtarëve të Këshillit që ka pyetje për palët, apo rrethana për të sqaruar. Fillimisht kjo e drejtë i jepet relatorit.
 - dh) komunikon vendimin e Këshillit:
 - i. për shtyrjen e seancës dëgjimore, në çdo rast jo më shumë se një muaj, kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë;
 - ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;
 - iii. për thirrjen e ekspertëve dhe caktimin e detyrave;
 - iv. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;
 - e) mbyll fazën e shqyrtimit dhe fton palët për pretendimet e fundit;
 - ë) njofton datën e shpalljes së vendimit të arsyetuar, brenda 2 javëve nga data e mbylljes së seancës dëgjimore.

3. Këshilli, gjatë seancës dëgjimore, me kërkesë ose kryesisht, merr çdo vendim sipas nenit 36, pika 2, germa “ç” dhe “d”, të kësaj rregulloreje.

4. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara për zhvillimin e mbledhjeve plenare.

Neni 31

Përgjegjësia disiplinore e Magjistratit të Komanduar

1. Magjistrati i Komanduar ka përgjegjësi disiplinore të njëjtë me magjistratët që ushtrojnë detyrën si prokuror, në përputhje me parashikimet e dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore, sipas ligjit, “Për statusin”.

2. Ecuria disiplinore mund të fillohet edhe nga institucionin në të cilin prokurori i komanduar ushtron detyrën, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me nenin 53, pika 12, e ligjit, “Për statusin”.

3. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes në Këshill.

4. Në rast se magjistrati kërkon referimin e çështjes në Këshill, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, atëherë procedimi disiplinor zhvillohet në përputhje me ligjin, “Për statusin”, pjesa V, “Përgjegjësia disiplinore, civile dhe penale”.

Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në rastet kur çështja nuk kërkohet të referohet në Këshill nga magjistrati, procedimi disiplinor zhvillohet nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Nëse në përfundim të procedimit disiplinor sipas kësaj pike, vendoset shkarkimi i magjistratit të komanduar, ky shkarkim sjell ndërprerjen e menjëhershme të komandimit të këtij magjistrati, i cili konstatohet me vendim të Këshillit.

Në këtë rast, secili anëtar i Këshillit ka të drejtë që, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 119 të ligjit “Për statusin”, të paraqesë ankesë tek ILD-ja, të shoqëruar me praktikën e plotë disiplinore si dhe vendimin e shkarkimit të magjistratit të komanduar.

Neni 32

Masat për shmangien e vonesave

1. Në rastet kur ndonjëra nga palët nuk paraqitet në seancë dëgjimore, ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për t’u paraqitur, Këshilli deklaron mungesën dhe seanca zhvillohet pa praninë e palës.

2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cenojnë dinjitetin e ILD-së ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, Këshilli paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Në rast se sjellja vazhdon, Këshilli vendos dënimin me gjobë deri në 100 000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme,

për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.

3. Ndaj vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankim brenda 24 orëve nga marrja dijani e tij në Gjykatën Administrative të Apelit. Këshilli i njofton vendimin për dënimin me gjobë Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

Neni 33

Bashkimi i procedimeve disiplinore

Këshilli vendos bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet e mëposhtme:

- a) procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat të proceduar;
- b) kur prokurori dhe gjyqtari janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Në këtë rast, të dy Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve, sipas rregullave të përbashkëta të miratuara paraprakisht prej tyre.

Neni 34

Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor të magjistratit

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:

- a) të urdhërojë ILD-në të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me ligjin, "Për statusin", si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit një mujor;
- b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.

2. Në këto raste, ILD-ja vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të ligjit "Për statusin":

- a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;
- b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

Neni 35

Pezullimi i procedimit disiplinor

1. Këshilli vendos pezullimin e procedimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, ku njëra nga palët është magjistrati i proceduar dhe shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi disiplinor.
2. Procedimi disiplinor pezullohet deri në administrimin nga Këshilli të vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.
3. Ankuesi, magjistrati i proceduar, gjykata, prokuroria dhe subjektet proceduese njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Këshillit, pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.
4. Këshilli u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës, në favor të magjistratit të proceduar, nuk pengon procedimin disiplinor të Këshillit për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të tij.
5. Vendimi për pezullimin e procedimit nuk ankimohet.

Neni 36

Marrja e vendimit në një procedim disiplinor

1. Këshilli vendos për datën e marrjes së vendimit, datë e cila caktohet brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore.
2. Komisioni miraton dhe i paraqet Këshillit brenda 4 ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore, relacionin përfundimtar si dhe projekt vendimin, bashkë me propozimin për vendimmarrje. Propozimi sipas këtij relacioni shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Këshillit, por jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitja e relacionit përfundimtar të Komisionit.
3. Relatori i çështjes garanton aksesin e të gjithë anëtarëve të Këshillit në njohjen e akteve të administruara në dosje, gjatë shqyrtimit të çështjes dhe para marrjes së vendimit përfundimtar.
4. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:
 - a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
 - b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.
5. Vendimi jepet i arsyetuar me shkrim, brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore.

Neni 37

Përgatitja e vendimit

1. Arsyetimi dhe zbardhja e plotë e vendimit bëhet nga relatori brenda dy javëve, nga data e përfundimit të seancës dëgjimore, sipas arsyetimit të shumicës së anëtareve që kanë votuar pro vendimit.
2. Nëse pas votimit të vendimit, relatori është në pakicë, kryetari i Këshillit, cakton një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar.
3. Anëtarët e mbetur në pakicë, mund të kërkojnë që opinioni i tyre kundër t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, pakica është përgjegjëse për hartimin dhe dorëzimin të relatori të opinionit të tyre brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastin e mendimit paralel.
4. Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë me anë të nënshkrimit versionin përfundimtar të vendimit.

Neni 38

Publikimi i vendimeve disiplinore

1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.
2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojtë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit.

KREU IV

PROCEDURA TË VEÇANTA

SEKSIONI I

SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I ANKIMEVE

Neni 39

Paraqitja e ankimit

1. Ankimi paraqitet nga pala ankuese ose nga përfaqësuesi i zgjedhur prej saj. Përfaqësuesi legjitimohet si i tillë dhe kryen disa ose të gjitha

veprimet procedurale, sipas parashikimeve të nenit 38, të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Çdo akt drejtuar Këshillit vlerësohet si ankim edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë, por del nga përmbajtja e këtij akti dhe është mjaftueshëm i qartë. Ankimi paraqitet në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, qartë dhe kuptueshëm, si dhe duhet të përmbajë:

- a) adresimin e ankesës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;
- c) emërtimin e personit juridik ankues, përfaqësuesin e tij ligjor, vendbanimin ose vendqëndrimin dhe/ose përfaqësuesin e zgjedhur;
- ç) vendimin e ILD-së kundër të cilit paraqitet ankimi ose mosveprimin administrativ të ILD-së; ç) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;
- d) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:
 - i. akti i përfaqësimit, në rast se ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;
 - ii. kopje të vendimit të ILD-së objekt ankimi;
 - iii. dokumente, prova apo materiale të tjera që shoqërojnë ankimin, në original ose të njësuara me origjinalin;
- dh) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankimi paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhëna shprehimisht në aktin e përfaqësimit.

Neni 40 Verifikimi i ankimit

Relatori verifikon nëse ankimi plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 2, të nenit 39, të kësaj rregulloreje. Ankimi që nuk plotëson këto kriteret konsiderohet i metë. Relatori njofton ankuesin, me shkrim, duke i caktuar një afat 10 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ankuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, mbi bazën e relacionin të relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare mospranimin e ankimit.

Neni 41 Shqyrtimi paraprak i ankimit

1. Pas verifikimit të kriterëve formale të ankimit, relatori verifikon kushtet e pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Ankimi është i pranueshëm për shqyrtim nëse plotëson këto kushte:

- a) është bërë kundër një vendimi apo mosveprimi administrativ të ILD-së;
 - b) ankuesi ka legjitimitet sipas parashikimeve të ligjit “Për statusin”;
 - c) është paraqitur brenda afateve të parashikuara në ligj.
2. Për ankimin që nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, sipas pikës 1, të këtij neni, mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, refuzimin e tij.

Neni 42 **Pushimi i shqyrtimit të ankimit**

1. Ankuesi mund të heqë dorë nga ankimi deri sa Këshilli nuk ka marrë një vendim, në lidhje me të. Në rast të heqjes dorë nga ankimi, Komisioni i propozon mbledhjes plenare pushimin e shqyrtimit të ankimit.
2. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin kur objekti për të cilin kishte nisur shqyrtimi ankimit apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

Neni 43 **Shqyrtimi në themel i ankimit**

1. Pas verifikimit të plotësisë të kushteve të pranueshmërisë, relatori përgatit relacionin dhe projekt aktin për shqyrtimin në themel të ankimit. Mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare pranimin ose rrëzimin e ankimit.
2. Në rastin e ankimit, mbi gjobën e vendosur nga ILD -ja ndaj personave apo subjekteve që nuk përmbushin kërkesat e tij, sipas nenit 132, pika 4, të ligjit “Për statusin”, relatori kërkon menjëherë nga ILD -ja, një kopje të akteve që kanë shërbyer për marrjen e vendimit.
3. Në rastin e ankimit ndaj mosveprimit administrativ, relatori i kërkon që menjëherë ILD -ja, të paraqesë pa vonesë një kopje të dosjes së çështjes dhe arsyet e mosveprimit administrativ.

Neni 44 **Ankimi kundër vendimeve të arkivimit dhe pushimit të çështjes nga ILD-ja**

1. Ankimet drejtuar Këshillit, që kundërshtojnë vendimin e ILD-së për arkivimin e ankesave ose pushimin/mbylljen e hetimit të filluar mbi bazën e tyre, shqyrtohen nga një komision i përkohshëm. Ky komision, përbëhet nga dy anëtarë joprokurorë dhe një anëtar prokuror.

2. Vendimet e këtij Komisioni janë përfundimtare dhe nuk mund të apeloohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

3. Anëtarët e përhershëm dhe ata zëvendësues të Komisionit Disiplinor si rregull, nuk mund të jenë anëtarë të këtij komisioni të përkohshëm.

4. Në çdo rast anëtari i Komisionit Disiplinor, që ka marrë pjesë në komisionin e përkohshëm për trajtimin e një ankese si më sipër, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit, dhe Këshillit, që shqyrton procedimin disiplinor, për të njëjtën çështje. Në këtë rast, ky anëtar zëvendësohet në këtë çështje në Komision nga anëtari zëvendësues, sipas përcaktimit të nenit 17 pikës 2, germa “b”, të kësaj rregulloreje.

5. Rregullat e parashikuara në këtë seksion zbatohen edhe nga ky Komision i përkohshëm, për aq sa gjejnë zbatim.

SEKSIONI II SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESËS PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA E MAGJISTRATIT

Neni 45 Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për pezullimin e magjistratit nga detyra paraqitet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e ILD-së, sipas nenit 152, pika 1, e ligjit, “Për statusin”.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i nënshtrohet menjëherë procedurës së shortit në Komision, për caktimin relatorit të çështjes, nëse paraqitet njëkohësisht me kërkesën për procedim disiplinor. Nëse procedimi disiplinor ka filluar, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim relatorit të çështjes.

Neni 46 Shqyrtimi i kërkesës

1. Komisioni, brenda 48 orëve nga caktimi i relatorit të çështjes apo paraqitja e kërkesës, mbi relacionin e relatorit, i propozon mbledhjes plenare të Këshillit:

- a) rrëzimin e kërkesës;
- b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e pezullimit kryesisht të magjistratit nga detyra, sipas neneve 151 dhe 152 të ligjit "Për statusin". Në këtë rast afatet llogariten nga dita e marrjes së informacionit nga ILD-ja apo prokuroria ose gjykata përkatëse ose nga konstatimi i rrethanave të parashikuara në nenin 152 të ligjit "Për statusin".

4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 47

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesave në lidhje me kohëzgjatjen dhe revokimin e pezullimit

1. Kërkesa për ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimin e pezullimit paraqitet në Këshill nga ILD-ja apo magjistrati. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, i cili duhet të provojë që pezullimi nuk mund të vazhdojë, për shkak se arsyet e vendosjes së pezullimit, të parashikuara në nenet 151 dhe 152 të ligjit "Për statusin", kanë pushuar së ekzistuari.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim relatorit të çështjes.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimit të pezullimit kryesisht, sipas nenit 156 të ligjit "Për statusin".

4. Mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

Neni 48

Shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit

Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e shqyrtimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit, sipas nenit 135 të ligjit "Për statusin", për aq sa gjen zbatim.

KREU V
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 49
Akte të tjera të zbatueshme

Në organizimin dhe në funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisionit Disiplinor dhe personelit administrativ, sipas kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim rregullore të tjera të brendshme të Këshillit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët
e Kombit”, Godina nr.13**

Tiranë, Shqipëri

EMAIL: info@ild.al

WEB: ild.al



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

